



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Këshilli Gjyqësor i Kosovës
Sudski Savevt Kosova - Kosovo Judicial Council

Gjykata Supreme
Vrhovni Sud - Supreme Court

**PËRMBLEDHJE E MENDIMEVE JURIDIKE,
UDHËZUES TË GJYKATËS SUPREME
DHE OPINIONE TË KOMITETIT
KËSHILLËDHËNËS PËR ETIKË GJYQËSORE**



PRISHTINË, 2022

PARATHËNIE

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, përveç rritjes së transparencës dhe efikasitetit të sistemit gjyqësor, rëndësi të veçantë i kushton edhe unifikimit të praktikës gjyqësore si dhe rritjes së sigurisë juridike në vend. Përmes unifikimit të praktikës gjyqësore përveç të tjerash garantohet drejtësia e barabartë për të gjithë qytetarët.

Paqartësitë në lidhje me mënyrën e zbatimit të dispozitave ligjore janë arsye jo vetëm për zvarritjen e zgjidhjeve të lëndëve, si rezultat i ndryshimeve të vendimeve në shkallët ankimore, por shumë herë ato edhe marrin përfundime të ndryshme.

Prandaj, me qëllim të unifikimit të praktikave gjyqësore dhe për të mundësuar që procedurat të jenë sa më qarta, KGJK në bashkëpunim me Gjykatën Supreme ka bërë përzgjedhjen dhe sistemimin e një numri të Mendimeve Juridike dhe Udhëzimeve të cilat janë përmbledhur në këtë publikim. Kjo përmbledhje sqaron një numër paqartësish ligjore në zbatimin e legjislacionit në Republikën e Kosovës si dhe ofron një numër udhëzimesh si procedurale ashtu edhe përmbajtësore.

Në drejtim të eliminimit të paqartësive për shkelje disiplinore eventuale nga ana e gjyqtarëve, KGJK ka themeluar Komitetin Këshilldhënës për Etikë Gjyqësore. Kjo përmbledhje përfshinë të dhënat mbi aktivitetet dhe opinioniet e Komitetit Këshilldhënës për Etikë Gjyqësore. Ky Komitet gjatë vitit 2022 ka përgatitur një numër opinionesh këshilldhënëse disa me vetiniciativë e disa tjera duke u përgjigjur në pyetjet e dërguar nga vet gjyqtarët. Opinionet e tilla shërbejnë si një burim i rëndësishëm reference për ndërtimin e standardeve të reja e moderne në gjyqësore. Këto opinione jo vetëm që do ndikojnë në rritjen e cilësisë dhe efikasitetit por edhe do kontribuojnë drejtpërdrejtë në avancimin e etikës së gjyqtarëve dhe përmirësimin e besimit të publikut në gjyqësor.

Kjo përmbledhje do ju shërbejë në radhë të parë gjyqtarëve dhe stafit gjyqësor, gjithashtu i njëjti mund të përdoret si nga studiuesit dhe profesionistët ligjorë ashtu edhe nga qytetarët të cilët mund të kenë interesim rreth këtyre temave.

Ky botim nuk do ishte i mundur pa përkrahjen direkte të projektit të Bashkimit Evropian për Evidencën Penale (NCCR) të cilin jo vetëm që e falenderojmë por edhe i shprehim mirënjohjen më të thellë për ndihmën e ofruar për të ndërtuar një sistem modern të evidencës penale në Republikën e Kosovës.

Albert Zogaj

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

PËRMBAJTJA

MENDIME JURIDIKE TË GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS.....	7
MENDIM JURIDIK LIDHUR ME SHLYERJEN E DËNIMEVE NGA EVIDENCA PENALE (PËRFSHIRË EDHE CERTIFIKATËN E GJENDJES PENALE).....	9
MENDIM JURIDIK LIDHUR ME KODIN E DREJTËSISË PËR TË MITUR.....	15
MENDIM JURIDIK LIDHUR ME VEPRËN PENALE – MOSVEPRIMI SIPAS DISPOZITAVE SHËNDETËSORE GJATË EPIDEMISË.....	17
MENDIM JURIDIK LIDHUR ME NDJEKJEN PENALE.....	19
MENDIM JURIDIK PARASHKRIMI I EKZEKUTIMIT TË DËNIMIT ME BURG/GJOBË	21
MENDIM JURIDIK LIDHUR ME TRAJTIMIN SI VEPËR PENALE APO KUNDËRVAJTJE NË RAST AKSIDENTI ME TË LËNDUAR.....	23
MENDIM JURIDIK PËR KOMPENSIMIN E DREJTPËRDREJTË TË DËMIT DHE DËMEVE TË PA PËRFSHIRA NË VENDIMIN PËRFUNDIMTAR PËR SHPRONËSIM.....	25
MENDIM JURIDIK PËR KAMATËN.....	31
QËNDRIM PARIMOR LIDHUR ME KONTESTET E PUNËS.....	49
UDHËZUES TË GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS	52
UDHËZUES I VEÇANTË PËR KORRUPSION ZYRTAR DHE VEPRAT PENALE KUNDËR DETYRËS ZYRTARE.....	54
UDHËZUES PËR APLIKIMIN E DISPOZITAVE LIGJORE NË PROCEDURËN KUNDËRVAJTËSE.....	116
UDHËZUES LIDHUR ME CILËSIMIN JURIDIK DHE TRAJTIMIN E RASTEVE TË DHUNËS NË FAMILJE SIPAS KODIT PENAL TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS.....	119
UDHËZUES I VEÇANTË ÇAKTIMI I GJOBËS SI SANKSION PËR VEPRAT PENALE SIPAS KODIT PENAL TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS.....	128
UDHËZUES LIDHUR ME KONFISKIMIN E PASURISË.....	150
UDHËZUES LIDHUR ME KOMPETENCËN LËNDORE TË DEPARTAMENTIT TË KRIMEVE TË RËNDA DHE DEPARTAMENTIT SPECIAL TË GJYKATËS THEMELORE PRISHTINË.....	153
UDHËZUES LIDHUR ME VEPRAT PENALE KUNDËR SIGURISË NË TRAFIK.....	156
PLOTËSIM I UDHËZIMIT NR.183/2019 LIDHUR ME RREGULLAT E TRAFIKUT PUBLIK.....	161
UDHËZUES PËR PROCEDURËN E TRANSFERIMIT TË PERSONAVE TË DËNUAR.....	163

UDHËZUES LIDHUR ME EVIDENCËN E MASAVE DHE DËNIMEVE NDAJ TË MITURIT.....	166
UDHËZUES PËR POLITIKËN NDËSHKIMORE NË KOSOVË.....	168
UDHËZUES LIDHUR ME KOMPETENCËN E DEPARTAMENTIT PËR ÇËSHTJE ADMINISTRATIVE QË LIDHET ME AUTORITETIN KOSOVAR TË KONKURRENCËS	329
UDHËZUES LIDHUR ME ORGANIN KOMPETENT PËR SHQIPTIMIN E MASAVE NDËSHKIMORE SIPAS LIGJIT 07/L-006 PËR PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN E PANDEMISË COVID – 19 NË REPUBLIKËN E KOSOVËS.....	334
UDHËZUES PËR KOMPETENCËN E ORGANIT PËRMBARIMOR DHE PËR PROCEDURËN E PËRMBARIMIT TË VENDIMEVE GJYQËSORE PËR GJOBAT E DHËNA PËR KUNDËRVAJTJE.....	337
UDHËZUES PËR KOMPETENCËN E ORGANIT PËRMBARIMOR LIDHUR ME VENDOSJEN NË PROCEDURËN E PËRMBARIMIT DHE LIDHUR ME ZBATIMIN E PËRMBARIMIT PËR ÇËSHTJET NGA E DREJTA FAMILJARE, KTHIMIN E PUNËTORËVE DHE SHËRBYESVE CIVIL NË PUNË DHE KOMPENSIME TË TJERA	343
UDHËZUES PËR FILLIM TË PROCEDURËS SË LIKUIDIMIT DHE PËR PUBLIKIM TË LISTAVE TË PUNËTORËVE.....	348
UDHËZUES PËR TË HYRAT NGA QIRATË.....	353
OPINIONE TË KOMITETIT KËSHILLËDHËNËS PËR ETIKË GJYQËSORE.....	359
OPINION KËSHILLËDHËNËS LIDHUR ME TRAJTIMIN ME PRIORITET TË RASTEVE TË PËRFSHIRA NË KËRKESËN E KRYETARES SË GJYKATËS THEMELORE NË PRISHTINË.....	361
OPINION KËSHILLËDHËNËS PËR STANDARDET ETIKE TË ZBATUESHME, NË RASTIN E KOMUNIKIMIT TË GJYQTARIT ME MEDIA DHE ME MONITORUESIT E SISTEMIT TË DREJTËSISË DHE MBROJTJES SË INTEGRITETIT TË PROCEDURËS GJYQËSORE GJATË TRAJTIMIT TË NJË RASTI KONKRET.....	367
OPINION KËSHILLËDHËNËS LIDHUR ME KËRKESËN E ZYRËS PËR VLERËSIM DHE VERIFIKIM GJYQËSOR (ZVVGJ).....	374
OPINION KËSHILLËDHËNËS PËR STANDARDET ETIKE TË ZBATUESHME, NË RASTIN E BARAZISË SË PALËVE, TRAJTIMIT TË LËNDËVE GJYQËSORE SIPAS PRIORITETIT DHE RADHËS SË REGJISTRIMIT TË TYRE NË GJYKATË.....	377

**MENDIME JURIDIKE TË GJYKATËS
SUPREME TË KOSOVËS**



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, në seancën e përgjithshme të të gjithë gjyqtarëve, në bazë të nenit 26, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.4. dhe nenin 27, paragrafi 1. të Ligjit për Gjykatat (Ligji Nr. 06/L-054, i datës 23 nëntor 2018), më datën 7 nëntor 2022, nxjerr këtë:

MENDIM JURIDIK

I. Zyra Qendrore për Evidencë Penale pranë Këshillit Gjyqësor të Kosovës (në vijim “ZQEP”) është e autorizuar që të bëjë edhe shlyerjen grupore (shlyerjen në bllok) nga evidenca penale e të të gjitha dënimeve që janë shqiptuar nga gjykatat në Kosovë që nga viti 1999 e tutje, nëse vlerësohet se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore përkatëse për një gjë të tillë, sipas ligjeve penale që kanë qenë në fuqi në kohën kur aktgjykimi është bërë i formës së prerë.

II. Nëse është zëvendësuar dënimi me burgim në dënim me gjobë, duke u bazuar në nenin 44 të KPRK, atëherë konsiderohet se ndaj të pandehurit është shqiptuar vetëm dënimi me gjobë.

III. Në rastet kur në procedurën e ekzekutimit, dënimi me gjobë i shqiptuar me aktgjykim të formës së prerë është zëvendësuar në dënim me burgim, atëherë një gjë e tillë nuk do të ndikoj në pozitën juridike të të dënuarit, në kuptim të pasojave juridike të dënimit dhe procesit të rehabilitimit.

IV. Në Certifikatën e Gjendjes Penale duhet të shënohen vetëm dënimet që janë shqiptuar me aktgjykim të formës së prerë e të cilat ende nuk janë shlyer nga evidenca penale. Gjithashtu, në certifikatat e tilla duhet të shënohet edhe dënimi me gjobë dhe vërejtja gjyqësore, të cilat ende nuk janë shlyer nga evidenca penale, por me konstatimin se këto sanksione penale (dënimi me gjobë dhe vërejtja gjyqësore) nuk krijojnë pasoja juridike.

Ar sy e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës (në vijim “KGjK”), me vendimin KGjK.nr.168/2022, të datës 5 maj 2022, kishte themeluar grupin punues për shqyrtimin e çështjeve të ngritura, në kuadër të procesit të konsolidimit të Sistemit Qendror të Evidencës Penale (në vijim “SQEP”), ku përgjegjësi e grupit punues kishte qenë trajtimi dhe përgatitja e rekomandimeve përkatëse për çështjet që i referohen procesit të rehabilitimit ligjor; evidentimi në sistem i dënimeve, të cilat nuk krijojnë pasoja juridike, pastaj vlerësimi i përmbajtjes së certifikave të reja të gjendjes penale, të cilat do të procedohen nga SQEP, si dhe adresimi i çështjeve tjera që do të dalin si rezultat i këtij procesi.

Duke ju referuar rrethanave aktuale dhe nevojave për konsolidimin sa më të mirë të SQEP, anëtarët e këtij grupi punues kanë ardhur në përfundim se çështjet e shënuara më poshtë janë të rëndësishme që të trajtohen nga ana e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, duke pasur parasysh edhe mungesën e një baze të mirëfilltë ligjore dhe mungesën e një praktike të unifikuar nëpër gjykatat e Kosovës, duke propozuar që të shqyrtohet mundësia e nxjerrjes së një mendimi juridik në lidhje me këto pyetje:

- Nëse ZQEP është e autorizuar për të bërë shlyerjen në grup (shlyerjen në bllok) të dënimeve nga evidenca penale që ende nuk janë shlyer që nga viti 1999, edhe pse janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për shlyerje?

- Në kuptim të pasojave juridike të dënimeve dhe rehabilitimit ligjor, si të vepohet nëse është zëvendësuar dënimi me burgim në dënim me gjobë, duke u bazuar në nenin 44 të KPRK?

- Në kuptim të pasojave juridike të dënimeve dhe rehabilitimit ligjor, si të vepohet në rastet kur në procedurën e ekzekutimit, dënimi me gjobë i shqiptuar me aktgjykim të formës së prerë është zëvendësuar në dënim me burgim?

- Çka duhet të përmbaj Certifikata e Gjendjes Penale?

Duke e parë rëndësinë e madhe të çështjeve të lartcekura, kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Enver Peci, ka ftuar seancën e përgjithshme të të gjithë gjyqtarëve, në të cilën është vendosur që të nxirret ky mendim juridik me përgjigjet si në vijim:

I. Nga raporti i lartcekur i grupit punues të KGjK-së, shihet se me procesin e digjitalizimit të të gjitha dënimeve të shqiptuara me aktgjykime të formës së prerë nga viti 1999 e tutje, në SQEP janë evidentuar të gjitha dënimet, duke përfshirë edhe dënimet, të cilat sipas ligjeve apo kodeve përkatëse penale i kanë arritur afatet ligjore për shlyerje apo fshirje. Deri tani, procesi i rehabilitimit ligjor në Kosovë nuk është zhvilluar, me përjashtim të rasteve, kur të dënuarët me kërkesë kishin kërkuar shlyerjen apo fshirjen e dënimeve, të cilat kanë arritur afatet ligjore për një gjë të tillë. Gjykatat, procesin e rehabilitimit ligjor, deri tani e kanë trajtuar sipas rregullave dhe procedurës, e cila do të duhej të ndiqej për rehabilitim gjyqësor. Shlyerja apo fshirja e dënimeve deri tani nga gjykatat, ishte bërë vetëm sipas kërkesës së të dënuarve dhe si

rezultat i kësaj gjendje, pjesa më e madhe e dënimeve nuk janë shlyer nga evidenca e personave të dënuar, edhe pse kanë kaluar të gjitha afatet ligjore për një gjë të tillë. Edhe pse kanë kaluar të gjitha afatet ligjore për shlyerje për raste të caktuara, si dhe në anën tjetër, edhe pse është vendosur që në bazë të kërkesës së të dënuarve të shlyhen dënimet e tyre (rehabilitimi gjyqësor), evidenca për këta persona nuk është mbajtur në mënyrë standarde apo mënyrë uniforme nëpër gjykata të ndryshme në Kosovë. Në kuadër të përgatitjeve për fillimin e implementimit të plotë të SQEP, është konstatuar se është një numër jashtëzakonisht i madh lëndëve (dënimeve) në sistem, të cilat i plotësojnë kushtet për shlyerje, andaj edhe si të tilla duhet që t'i nënshtrohen procesit të rehabilitimit ligjor, përkatësisht shlyerjes së këtyre dënimeve nga evidenca, sipas kriterëve të cilat përcaktohen me ligjet përkatëse penale. Duke e pasur parasysh se bëhet fjalë për një numër shumë të madh të këtyre dënimeve (nga viti 1999 - e tutje), paraqitet nevoja e fshirjes apo shlyerjes grupore apo në bllok, kështu që në këtë drejtim është kërkuar nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës që të sqarojë nëse është e mundur që të bëhet një shlyerje e tillë.

Në lidhje me këtë çështje, Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, duke pasur për bazë faktet e lartcekura, konstaton se ZQEP është e autorizuar që të bëjë edhe shlyerjen grupore (shlyerje në bllok) nga evidenca penale e të gjitha dënimeve që janë shqiptuar nga gjykatat në Kosovë, që nga viti 1999 e tutje, nëse vlerësohet se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore përkatëse për një gjë të tillë, sipas ligjeve penale që kanë qenë në fuqi, në kohën kur aktgjykimi është bërë i formës së prerë.

Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës ka parasysh se në rastin e tillë bëhet fjalë për një situatë “*Sui generis*” të zbatimit të procesit të rehabilitimit për një numër të madh të lëndëve dhe faktin se baza aktuale ligjore e rregullon vetëm procesin e rehabilitimit ligjor individual. Mirëpo, pavarësisht kësaj, Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës konsideron se me këtë situatë, do të mundësohet veprimi retroaktiv i procesit të rehabilitimit për të gjitha lëndët e identifikuar për shlyerje nga evidenca, duke qenë kështu në harmoni me parimin e ekonomizimit dhe të efikasitetit të procedurës penale. Gjithashtu, Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës vlerëson se duke u bazuar në dispozitat ligjore që i referohen shlyerjes së dënimeve nga evidenca penale, që është rregulluar me nenet 520 - 524 të Kodit të Procedurës Penale (në vijim “KPP”), si dhe dispozitave të ligjeve penale dhe dispozitave të tjera relevante, duke u respektuar procedura përkatëse ligjore dhe identifikuar paraprakisht rastet në mënyrë individuale, nuk do të ishte pengesë ligjore të kemi një shlyerje në grup apo bllok të të gjitha dënimeve për të gjitha kategoritë, nëse përmbushen kriteret përkatëse ligjore. Në këtë mënyrë, ZQEP duhet që paraprakisht të përgatis listën e dënimeve të cilat i plotësojnë kriteret ligjore për shlyerje dhe më pastaj, e njëjta është e autorizuar që të zbatojë procesin e rehabilitimit ligjor, ashtu siç parashihet edhe në dispozitat ligjore të ligjeve përkatëse penale, në instrumentet ndërkombëtare, si dhe Rregulloren nr.01/2018 për Sistemin Qendror të Evidencës Penale në Kosovë, të datës 2 maj 2018. Shlyerja grupore e këtyre dënimeve, do të bëhet në tërësi sipas kriterëve të përcaktuara, me dispozita përkatëse penale. Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës e sheh të nevojshme që të dhënat e shlyerjes sipas kësaj procedure duhet të ruhen në data bazën qendrore të evidencës penale dhe të njëjtat do të administrohen nga ZQEP, sipas procedurave përkatëse ligjore, ndërsa dënimet e shlyera do të mund të përdoren dhe zbulohen vetëm për qëllime të specifikuar në nenin 98 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në

vijim “KPRK”). Procedura e rehabilitimit me shlyerjen në grup të dënimeve sipas rehabilitimit ligjor, do të aplikohet vetëm për lëndët (dënimet) e vjetra, për të cilat kanë kaluar të gjitha afatet ligjore të shlyerjes së tyre. Pas përfundimit të këtij procesi, duke u bazuar në dispozitat e lartcekura ligjore, ZQEP do të vazhdojë, mandej procesin e rehabilitimit individual, për raste të caktuara, ashtu siç parashihet me dispozitat përkatëse ligjore.

II. Siç është theksuar edhe më parë, si çështje e dytë që është ngritur, është edhe fakti se në kuptim të pasojave juridike të dënimeve dhe rehabilitimit ligjor, si të vepohet nëse është zëvendësuar dënimi me burgim në dënim me gjobë, duke u bazuar në nenin 44 të KPRK?

Në lidhje me këtë çështje, Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, fillimisht e vë në dukje faktin se në nenin 44, paragrafi 1. të KPRK, është parashikuar se *“Kur gjykata shqipton dënimin me burgim deri në gjashtë (6) muaj, gjykata njëkohësisht mund të vendosë që dënimin me burgim të zëvendësohet me dënim me gjobë, me pëlqimin e personit të dënuar”*. Duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore, në raste të tilla, kur gjykata vendosë që të zëvendësojë dënimin me burgim në dënim me gjobë, atëherë Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës konstaton se ndaj të pandehurit konsiderohet se është shqiptuar vetëm dënimin me gjobë. Kështu që mbi bazën e kësaj, në kuptim të pasojave juridike të dënimeve dhe rehabilitimit ligjor, duhet të zbatohen dispozitat ligjore që i referohen dënimit me gjobë.

III. Si çështje e tretë që është paraqitur në raportin e lartcekur të grupit punues të KGjK-së, është fakti se në kuptim të pasojave juridike të dënimeve dhe rehabilitimit ligjor, si të vepohet në rastet kur në procedurën e ekzekutimit, dënimi me gjobë i shqiptuar me aktgjykim të formës së prerë është zëvendësuar në dënim me burgim?

Sa i përket kësaj çështje, Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës konstaton se kur dënimin me gjobë i shqiptuar me aktgjykim të formës së prerë është zëvendësuar me dënim me burgim në procedurën e ekzekutimit, atëherë një gjë e tillë nuk duhet të ketë efekt në kuptim të pasojave juridike dhe rehabilitimit. Kjo do të thotë se mënyra se si ekzekutohet dënimin me gjobë, nuk duhet të ndikojë në pozitën juridike të të dënuarit, në kuptim të pasojave juridike të dënimit dhe procesit të rehabilitimit. Kjo për faktin se ndaj të dënuarit me aktgjykim të formës së prerë është shqiptuar dënimin me gjobë, ndërsa fakti se ndaj të njëjtit, në procedurën e ekzekutimit, ky dënim mund të zëvendësohet në dënim me burgim, nuk do të duhej të kishte ndonjë efekt në pasojat juridike dhe as në proces të rehabilitimit. Në situata të tilla (kur dënimin me gjobë i shqiptuar me aktgjykim të formës së prerë, në procedurën e ekzekutimit është zëvendësuar në dënim me burgim), atëherë në kuptim të pasojave juridike të dënimit dhe rehabilitimit, duhet që ndaj personit të dënuar të zbatohen dispozitat ligjore që i referohen dënimit me gjobë.

IV. Sa i përket çështjes së katërt, nga raporti i lartcekur i grupit punues të KGjK-së, shihet se me operacionalizimin e plotë të SQEP, ndryshime përmbajtësore parashihet të bëhen edhe në sistemin e ri të certifikatave dhe ekstrakteve, të cilat do të procedohen me bazë në të dhënat e centralizuara të SQEPK. Me fillimin e implementimit të sistemit të ri të certifikatave dhe ekstrakteve, do të bëhet zëvendësimi i certifikatave aktuale, të cilat procedohen nga gjykatat e vendit. Me fillimin e zbatimit të SQEP-së, ndryshime përmbajtësore pritet të ketë edhe vet përmbajtja e certifikatës e cila i procedohet palëve kërkuese sipas kërkesës së tyre dhe përmbajtja e ekstrakteve, të cilat i procedohen institucioneve përkatëse. Aktualisht certifikatat

e gjendjes penale, të cilat lëshohen nga gjykatat në Republikën e Kosovës, përmbajnë informacione për: Hetimet e zhvilluara kundër palës kërkuese; aktakuzës së ngritur dhe të dhëna për dënimet shqiptuara. Përveç kësaj, në gjykatat e Republikës së Kosovës nuk kemi një praktikë të unifikuar në lidhje me mënyrën e lëshimit të certifikatave dhe përmbajtjen e tyre. Në disa gjykata, në Certifikata të Gjendjes Penale shënohet edhe fakti se ndaj të pandehurit është shqiptuar dënimi me gjobë dhe vërejtja gjyqësore, ndërsa në disa gjykata tjera, jo. Andaj, mbi bazën e këtyre rrethanave, grupi punues i KGJK-së, i është drejtuar Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës me këtë pyetje se: Çka duhet të përmbajë Certifikata e Gjendjes Penale?

Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës konsideron se përmbajtja e certifikatave të gjendjes penale, të cilat aktualisht procedohen në vend është tejet sfiduese, duke e pasur për bazë parimin e prezumimit të pafajësisë dhe se kjo formë e procedimit të certifikatave nuk praktikohet në vendet e tjera, duke përfshirë edhe vendet kryesore të Bashkimit Evropian (në vijim “BE”), me të cilat sistemi ynë synon të jetë kompatibil. Nëse nisemi nga praktika e vendeve të BE-së, duke përfshirë edhe vendet kryesore si Franca, Gjermania, Italia, etj., certifikatat e tilla, përmbajnë informacione vetëm për dënimet e shqiptuara me aktgjykime të formës së prerë, kurse aspekte tjera të procedurës penale nuk merren parasysh. Kurse, sa i përket aspektit krahasimor me vendet e rajonit, gjendja sa i përket certifikatave të gjendjes penale është e njëjtë si me vendet perëndimore të BE-së, në të cilat, certifikatat e tilla, përmbajnë vetëm informacione për dënimet e shqiptuara nga gjykata.

Siç është theksuar edhe më lart, certifikata aktuale, të cilat procedohen nga gjykatat në Republikën e Kosovës, do të duhej të kishin parasysh në radhë të parë parimin e prezumimit të pafajësisë, një parim bazë i procedurës penale, i cili është i garantuar jo vetëm me ligjet përkatëse dhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, por edhe me një numër të madh të dokumenteve juridike ndërkombëtare. Gjithashtu, Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, konsideron se certifikatat e tilla, duhet që të kenë për bazë edhe nenin 98 të KPRK. Në paragrafët 1. dhe 4. të këtij neni, është parashikuar se *“Në dosje penale përfshihen të dhënat në vijim: të dhënat personale mbi kryesin e veprës penale; të dhënat mbi dënimin, vërejtjen gjyqësore, masën e trajtimit të detyrueshëm ose lirimin e kryesit nga dënimi i shqiptuar; ndryshimet në të dhënat mbi dënimet që janë futur në dosjen penale dhe të dhënat mbi dënimet e mbajtura, si dhe mbi shlyerjen e dënimeve të gabueshme. Çdo personi, me kërkesën e tij, mund t’i jepen të dhëna për dosjen e tij penale kur këto të dhëna i nevojiten, përveç nëse kjo do të rrezikonte sigurinë kombëtare apo sigurinë e përgjithshme ose do të rrezikonte parandalimin, hetimin, zbulimin dhe ndjekjen e veprave penale”*. Në këtë mënyrë, përmbajtja e certifikatave të tilla, duhet të ishte në harmoni edhe me këtë dispozitë ligjore të KPRK-së, si ligj organik dhe me përparësi ndaj çdo akti tjetër në këtë fushë. Procedimi i certifikatës së tillë, e cila do të përmbante edhe informacione tjera jashtë informacioneve për dënimet e shqiptuara me aktgjykime të formës së prerë (duke përfshirë këtu edhe vërejtjen gjyqësore, si sanksion penal), do të cenonte sigurinë juridike, do të ishte në kundërshtim të hapur me parimin e prezumimit të pafajësisë në procedurë penale dhe po ashtu, nuk do të ishte në harmoni me bazën ligjore në dispozicion dhe me praktikën e vendeve tjera perëndimore të BE-së në fushën e administrimit të gjendjes penale. Gjithashtu, edhe në nenin 17, paragrafët 4. dhe 5. të Rregullores nr. 01/2018 për Sistemin Qendror të Evidencës Penale në Kosovës, e cila është miratuar nga ana e KGJK-së, më datën 2 maj 2018, është parashikuar shprehimisht se: *“Në*

Certifikatën e Gjendjes Penale shënohen vetëm dënimet e formës së prerë të cilat nuk janë shlyer. Në Certifikatën e Gjendjes Penale nuk duhet të shënohet asnjë informacion për asnjë lëndë apo procedurë penale që është në zhvillim e sipër pranë ndonjë gjykatë në Kosovë”. Në fund, në Certifikatat e Gjendjes Penale duhet të shënohen edhe dënimi me gjobë dhe vërejtja gjyqësore, të shqiptuara me aktgjykime të formës së prerë, nëse të njëjtat nuk janë shlyer nga evidenca penale brenda afateve të përcaktuara me ligj, përkatësisht me nenin 96, paragrafi 2. të KPRK (Versionet në gjuhën serbe dhe në gjuhën boshnjake). Në lidhje me këtë çështje, Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës thekson se pasojat juridike të dënimeve dhe rehabilitimi janë dy institute të ndryshme juridike, andaj si të tilla duhet të trajtohen edhe me rastin e procedimit të certifikatave të tilla. Në këtë mënyrë, duke u bazuar në të gjitha këto që u theksuan më lart, Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës konstaton se në Certifikatën e Gjendjes Penale duhet të shënohen vetëm dënimet që janë shqiptuar me aktgjykim të formës së prerë, e të cilat ende nuk janë shlyer nga evidenca penale. Gjithashtu, në certifikata të tilla, duhet të shënohet edhe dënimi me gjobë dhe vërejtja gjyqësore, të cilat ende nuk janë shlyer nga evidenca penale, por me konstatimin se këto sanksione penale (dënimi me gjobë dhe vërejtja gjyqësore) nuk krijojnë pasojë juridike.

(Mendim juridik i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës i miratuar më datën 7 nëntor 2022)



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Mbledhja e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 26 paragrafi 1 pika 1.4 të Ligjit për Gjykatat, më datë 01.12.2020, me vota unanime nxjerr këtë:

MENDIM JURIDIK

Dispozita e nenit 64.par.1.fjalja e dytë e Kodit të Drejtësisë për të Mitur (KDM), bie ndesh me dispozitën e nenit 68.par.2.të këtij Kodi dhe kanë kundërthënie mes vete, pasi që masa ose dënimi ndaj të miturit nuk mund të shqiptohen me aktvendimin me të cilin procedura pushohet dhe si e kështu, nuk mund të aplikohet.

A r s y e t i m

Gjykata Supreme me datë 23 shtator 2020 ka pranuar kërkesë për mendim juridik nga Gjykata Themelore në Mitrovicë, përmes gjyqtareve Pranvera Ademi dhe Gordana Virijeviq, për të sqaruar paqartësitë lidhur me paragrafin 1 të nenit 64 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur.

Çështja e cila është paraqitur si problematike është se çfarë domethënie ka fjalja e dytë në paragrafin 1 të nenit 64 të KDM, sipas së cilës, njëra prej mundësive është që gjyqtari për të mitur ose trupi gjykues për të mitur mundet që të ***pushoj procedurën nëse gjyqtari kompetent e sheh të arsyeshme shqiptimin e ndonjë mase ose dënimi.***

Dispozita e nenit 64.të KDM është si në vijim:

*1. Kur gjyqtari për të mitur ose trupi gjykues për të mitur merr propozim nga prokurori i shtetit për të mitur, ai mund të merr aktvendim për hedhjen e propozimit apo transferimin e çështjes në gjykatë tjetër, nëse ekzistojnë kushtet e parapara me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, ***pushon procedurën nëse gjyqtari kompetent e sheh të arsyeshme shqiptimin e ndonjë mase ose dënimi.****

2. Nëse nuk merret aktvendim për hedhjen e propozimit ose transferimin e çështjes në gjykatë tjetër, caktohet shqyrtimi gjyqësor brenda tetë (8) ditëve nga pranimi i propozimit.

Nga kjo del se gjyqtari për të mitur ose trupi gjykues për të mitur pasi e merr propozimin e prokurorit për shqiptimin e dënimit apo masës edukuese, ka tre mundësi:

- a) e hedh propozimin (p.sh. vërteton se kryesi në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë nën moshën 14 vjeç, është arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale ose ekzistojnë pengesat tjera të parapara me KPPK);
- b) e transferon çështjen në gjykatën tjetër (e cila ka kompetencë territoriale në bazë të nenit 51.të KDM);
- c) nëse nuk merr asnjë prej këtyre vendimeve, e cakton shqyrtimin gjyqësor.

Fjalja “**pushon procedurën nëse gjyqtari kompetent e sheh të arsyeshme shqiptimin e ndonjë mase ose dënim**” është e paqartë dhe nuk mund të aplikohet nga arsyet në vijim:

-masa ose dënimi nuk mund të shqiptohen me aktvendimin me të cilin procedura pushohet;

-masa apo dënimi nuk mund të shqiptohen pa mbajtur shqyrtimin gjyqësor (neni 68.i KDM)

Nëse intenca e ligjdhënësit ka qenë që në rastet kur nuk është oportune që të miturit t'i shqiptohet as masë e as dënim (neni 68.par.2.të KDM) dhe kjo të bëhet pa mbajtur shqyrtimin gjyqësor, atëherë në këtë fjali mungon fjala “nuk”, gjegjësisht të jetë: “*pushon procedurën nëse gjyqtari kompetent **nuk** e sheh të arsyeshme shqiptimin e ndonjë mase ose dënimi*”.

Formulimi i këtij neni, pa fjalën “nuk”, është në kundërshtim me dispozitën e nenit 68.par.2.të KDM sipas së cilës gjyqtari për të mitur ose trupi gjykues për të mitur pushon procedurën në shqyrtimin gjyqësor në rastet kur te madhori, kishte për t'u marrë aktgjykim lirues apo refuzues si dhe kur konstatohet se nuk është oportune respektivisht në interesin më të mirë të miturit, t'i shqiptohet masë apo dënim.

Kjo dispozitë përcakton se pushimi i procedurës ndaj të miturit për shkak të jo oportunitetit, është i mundur por vetëm pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor.

Andaj, dispozita e nenit 68.par.2. të KDM është e qartë.

Dispozita e nenit 64.par.1.fjalja e dytë të këtij Kodi, me të drejtë potencohet si një dispozitë e paqartë. Ajo bie ndesh me dispozitën e nenit 68.par.2.të KDM. Përveç kësaj, nuk mund të aplikohet sepse ka kundërthënie me vete, pasi që masa ose dënimi nuk mund të shqiptohen me aktvendimin me të cilin procedura pushohet.

(Mendim juridik i miratuar në seancën e përgjithshme të Gjykatës Supreme, i mbajtur më 01.12.2020)



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 26, paragrafi 1. Pika 1.4 të Ligjit për Gjykatat, në Seancën e Përgjithshme, të mbajtur me datë 20 gusht 2020, me shumicë votash, miratoi këtë:

MENDIM JURIDIK

Vepra Penale e “Mosveprimit sipas dispozitave shëndetësore gjate epidemisë” nga neni 250 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, nuk mund të konsiderohet e konsumuar nga i dyshuari kur kemi të bëjmë me shkeljen e vendimit nr. 01/15 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, për masat e parapara që detyronin qytetarët.

Kjo veprë penale mund të konsiderohet e konsumuar vetëm kur kemi të bëjmë me vendime individuale që organet kompetente të autorizuara me ligj, kanë lëshuar ndaj cilitdo person apo grupi personash për ndonjë masë konkrete që ai/ata të mos veprojnë.

A r s y e t i m

Kryetari i Gjykatës Themelore në Gjilan, me parashtrësën e datës 20.05.2020 ka kërkuar nga seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Kosovës, dhënien e mendimit juridik në lidhje me veprën penale të Mosveprimit sipas dispozitave shëndetësore gjatë epidemisë, e cila sanksionohet në kuadër të nenit 250 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, duke theksuar po ashtu se kemi një vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës 01/15 të datës 23.03.2020, me të cilin është ndaluar qarkullimi i lirë i qytetarëve dhe automjeteve në Republikën e Kosovës nga ora 10 h – 16 h dhe 20 h- 06 h e gjithashtu në kuptim edhe të aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës KO 54/20 të datës 31.03.2020.

Duke analizuar dispozitën e nenit 250, ku parasheh se: “Kushdo që gjatë kohës së epidemisë ose të ndonjë sëmundjeje ngjitëse nuk vepron sipas urdhrave apo vendimeve tjera të nxjerra në bazë të dispozitave të organit kompetent, i cili cakton masat që kanë për qëllim luftimin apo parandalimin e tyre, dënohet me burgim deri në dy (2) vjet”.

Marrë për bazë faktin se Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka shqyrtuar kushtetutshmërinë e vendimit të qeverisë, nr. 01/15 të datës 23.03.2020, dhe se me Aktgjykimin nr.54/20 të datës 31.03.2020 ka konstatuar se vendimi i Qeverisë nuk është në përputhshmëri me Kushtetutën e Kosovës.

Fillimisht duhet pasur parasysh se kjo vepër penale kryhet me mosveprim, në përputhje me masat e paracaktuara, që si të tilla, masat duhet të jenë të marra me “vendimin e organit kompetent”, bazuar në nenin 41 dhe 44 të Ligjit për Luftimin dhe parandalimin e Sëmundjeve Ngjitëse nr. 02/L-109 dhe neneve 12 (1.11) dhe 89 të Ligjit nr.04/L-125 për Shëndetësi. Ndërsa sipas kërkesës së Gjykatës Themelore në Gjilan rezulton se aktakuzat e ngritura nga Prokuroria, mbështeten në mosveprimet e të dyshuarve bazuar në vendimin e lartcekur të Qeverisë.

Në rrethana të rastit konkret, të kërkesës së parashtruar, duhet të kemi parasysh dy fakte qenësore: Fillimisht se kjo dispozitë ku inkriminohet vepra penale ka natyrë blankete, pasi që udhëzon në dispozitat e ligjit nga ku merret vendimi nga organi i caktuar për masat për luftimin e epidemisë, gjë që rezulton se nuk ishte marrë nga organi kompetent e në anën tjetër nuk kemi vendim mbi centralizimin e kompetencave brenda ekzekutivit për luftimin e epidemisë përkatësisht pandemisë, e po ashtu tashmë kemi një standard kushtetues të krijuar në raport me vendimin e tillë, që është konsideruar si kundër-kushtetues, çka nënkupton se vendimi i tillë është me efekt të nulitetit absolut e kjo edhe sipas ligjit për procedurën e përgjithshme administrative, ku në nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 ka paraparë, se një akt administrativ është i kundërligjshëm kur, “organi publik që e nxjerr ka vepruar pa pasur kompetencë”. Në këto rrethana, konsideroj se aktin administrativ që edhe Gjykata Kushtetuese e ka konsideruar se nuk është në përputhshmëri me Kushtetutën, ne duhet ta marrim për bazë aspektin e kundërligjshmërisë së tij, vetëm për të nxjerr qëndrimin e drejtë dhe të ligjshëm, për sa i përket veprës penale, për të cilën, është kërkuar qëndrim parimor.

Njëkohësisht duhet të kemi parasysh edhe rrethanën tjetër: ngase, siç rezulton, kërkesës së parashtruar nga Gjykata Themelore në Gjilan, i është bashkangjitur një kopje e akuzës së prokurorisë, dhe nga rrethanat faktike, rezulton se kemi të bëjmë me veprimin e mos respektimit të kufizimit të lirisë së lëvizjes, sipas Vendimit të Qeverisë. Pikërisht Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka konstatuar se vendimi me të cilin është kufizuar liria e lëvizjes është në kundërshtim me Kushtetutën, ku në piken 5 të aktgjykimit, Gjykata Kushtetuese e ka shpallur të pavlefshëm vendimin e tillë të Qeverisë.

Masat ndëshkuese të karakterit penal në kontekst të mbrojtjes së shëndetit publik gjatë kohës së emergjencave shëndetësore, siç janë epidemitë mund të aplikohen vetëm kur ato masa janë rreptësisht në pajtim me ligjin dhe të nxjerra nga autoritetet përkatëse të mandatuara me ligj për nxjerrjen e tyre, në të kundërtën, zbatimi i tyre në kontekst penal, do të ishte arbitrar.

(Mendim Juridik i miratuar në Seancën e Përgjithshme të Gjykatës Supreme, mbajtur më 20 gusht 2020)



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 26, paragrafi 1. pika 1.4 të Ligjit për Gjykatat, në Seancën e Përgjithshme, të mbajtur më datë 30 maj 2019, me shumicë votash, miratoi këtë:

MENDIM JURIDIK

- a) Dispozita e nenit 106 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, ka përcaktuar, në mënyrë shprehimore, afatet kohore për ndjekje penale dhe në rast të kalimit të këtyre afateve nuk mund të ndërmerret ndjekja penale, kurse dispozita e nenit 106 par.2 të KPRK-së, ka specifikuar se afati i parashkrimit caktohet sipas dënimit më të rëndë.
- b) Afati i parashkrimit duhet të llogaritet sipas dënimit më të lartë të përcaktuar me atë veprë penale, ashtu që në rastet kur për veprën penale bazë, afati i parashkrimit të ndjekjes penale është më i shkurtër se te vepra penale e krimit të organizuar, afati i parashkrimit duhet të llogaritet sipas dënimit më të rëndë e që në këtë rast është vepra penale e krimit të organizuar.

A r s y e t i m

Disa gjyqtarë të Gjykatës Themelore në Pejë, me parashtresën e datës 13.02.2018, nga Gjykata Supreme e Kosovës, kanë kërkuar dhënien e mendimit juridik në lidhje me llogaritjen e afatit të parashkrimit relativ dhe absolut të ndjekjes penale, në rastet kur kemi të bëjmë me veprën penale krimi i organizuar në raport me veprën penale bazë, për të cilën udhëhiqet procedura penale, pasi që janë paraqitur dilema që afati i parashkrimit të ndjekjes penale të llogaritet sipas veprës bazë, e cila ka afat më të shkurtër të parashkrimit apo veprës penale krimi i organizuar, e cila ka afat më të gjatë të parashkrimit të ndjekjes penale.

Duke analizuar parashtresën për dhënien e mendimit juridik e në kontekst të dispozitës së nenit 106 par.2 të KPRK-së, ku shprehimisht është përcaktuar se afati i parashkrimit caktohet sipas dënimit më të rëndë. Ashtu që në rastin konkret dilema e parashtruar zgjidhet duke i marrë për bazë dënimet e përcaktuara për veprën penale krimi i organizuar në raport me veprën bazë dhe

dispozitat e parashkrimit duhet që të llogariten duke ndjekur logjikën e dënimit më të lartë të përcaktuar për atë vepër penale. Në rastet kur te vepra penale bazë afati i parashkrimit të ndjekjes penale është më i shkurtër në raport me veprën penale krimi i organizuar, atëherë afati duhet të llogaritet sipas afatit më të gjatë e në rastin konkret sipas veprës penale të krimit të organizuar.

Andaj, mbi këtë bazë, Gjykata Supreme në Seancën e Përgjithshme të Gjykatës Supreme të Kosovës, me shumicë votash, miratoi këtë mendim juridik.

(Mendim Juridik i miratuar në seancën e përgjithshme të Gjykatës Supreme, mbajtur më 30 maj 2019)



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Mbledhja e Përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 26 paragrafi 1. pika 1.4 të Ligjit për Gjykatat , më datë 11.03.2019, me shumicë votash miratoi këtë:

MENDIM JURIDIK

Kodi Penal i Republikës së Kosovës ka rregulluar parashkrimin e ekzekutimit të dënimeve, për situata që ndërlidhen me lartësinë e dënimit të shqiptuar me burgim si dhe dënimit me gjobë. Në rast se për të njëjtën veprë penale shqiptohet dënim me burgim dhe dënim me gjobë siç është parapa në KPK, afati i parashkrimit duhet të caktohet sipas dënimit me burgim si dënim kryesor.

A r s y e t i m

Kryetari i Gjykatës Themelore në Gjakovë, me parashtrësën Agj.I.nr.351/18 datë 30.08.2018 nga Gjykata Supreme e Kosovës, ka kërkuar dhënien e mendimit juridik në lidhje me llogaritjen e afatit të parashkrimit në rastin e shqiptimit të dënimit me burg dhe me gjobë si dënim i veçantë për veprën e njëjtë penale, duke i ofruar gjykatës edhe rast konkret dhe interpretimin nga ana QK Dubravë, të cilët kanë dilema rreth llogaritjes së parashkrimit të situatave tjera të ngjashme.

Duke analizuar në kontekst të përgjithshëm të parashkrimit të ndjekjes penale, dispozita e nenit 106 paragrafi 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, ka përcaktuar në mënyrë shprehimore se afati i parashkrimit caktohet sipas dënimit më të rëndë. Në anën tjetër komentari i KPK i vitit 2014 (autor Ismet Salihu faqja 329 dhe 330) shpjegon po citoj“ nëse për një veprë penale janë paraparë shumë dënime në mënyrë kumulative, p.sh. dënimi me burgim dhe dënim me

gjobë, afati i parashkrimit caktohet sipas dënimit me burg si dënim kryesor”, ndërsa duke komentuar dispozitën e nenit 108 të Parashkrimit i ekzekutimit të dënimeve (faqja 336) autori në komentat përkufizon po citoj, "Kohëzgjatja e afatit të parashkrimit varet prej lartësisë së dënimit të shqiptuar. Kohëzgjatje e afateve të parashkrimit është përcaktuar sipas dënimit kryesor."

Andaj edhe te parashkrimi i ekzekutimit të dënimeve në rast se për një vepër penale është shqiptuar dënim burgimi dhe dënim me gjobë pasi që në disa raste në KPK parashihet obligimi i gjykatës që të shqiptoj të dy dënimet, afati i parashkrimit të ekzekutimit të dënimit caktohet nga kohëzgjatja e dënimit kryesor dhe nuk mundë të ndahet dënim me gjobë si dënim i veçantë kuptohet se në rast se i dënuari e paguan gjobën i njëjti e përmbush pjesën e detyrimit që ia ka caktuar gjykata, por në rast se nuk e paguan atëherë ai dënim nëse zëvendësohet në dënim burgimi kohëzgjatja e afateve të parashkrimit përcaktohet sipas dënimit kryesor.

(Mendim juridik i miratuar në seancën e përgjithshme të Gjykatës Supreme, i mbajtur më 11.03.2019)



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Mbledhja e Përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 22 të Ligjit për Gjykatat e Rregullta, më datë 26.07.2018, me shumicë votash miratoi këtë:

MENDIM JURIDIK

Ligji nr.05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor në nenin 261 në dispozitat përfundimtare në paragrafin 1. shprehimisht ka parapa se, “ Dispozitat për kundërvajtje dhe masa mbrojtëse sipas këtij ligji nuk e paragjykojnë zbatimin e kodit penal”, andaj në rastin konkret ndaj çdokujt që shkel ligjin për rregullat e trafikut rrugor dhe me këtë i shkakton dikujt lëndime trupore, ose dëm të përcaktuar pasuror me këtë kod, duhet aplikohet Kodi Penal i Republikës së Kosovës për elementet qenësore të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 të këtij kodi.

A r s y e t i m

Gjykata e Apelit e Kosovës , me parashtrësën GJ.A.SU.A 484/18 dt.05.07.2018, nga Gjykata Supreme e Kosovës, ka kërkuar të jap mendim juridik në lidhje me konfliktin e nenit 255 të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor dhe nenit 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës cili ligj duhet të zbatohet në rast të konfliktit mes këtyre ligjeve në lidhje me përcaktimin e kompetencës lëndore të gjykatës, respektivisht të trajtimit si vepër penale apo kundërvajtje në rast të shkakimit të aksidentit të trafikut me persona të lënduar.

Gjykata Supreme e Kosovës analizoj dispozitën e nenit 255 të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor i cili parasheh si masat e veçanta për kundërvajtje në paragrafin 2. se “ Nëse është shkaktuar aksident trafiku me persona të lënduar, kryesi i kundërvajtjes nga ky ligj dënohet me gjobë të paraparë për atë kundërvajtje, duke e rritur shumën për 200 euro. Në anën tjetër Kodi Penal i Republikës së Kosovës në kapitullin XXXI te veprat penale kundër sigurisë së trafikut publik, në nenin 378 ka parapa veprën penale Rrezikimi i trafikut publik i cili shprehimisht ka

parapa në paragrafin 1. se “ Kushdo që shkel ligjin mbi trafikun publik apo transportin rrugor dhe rrezikon jetën e njerëzve apo pasurin dhe me këtë i shkakton dikujt lëndim të lehtë trupor ose dëm pasurorë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në 3(tre) vjet. Paragrifi 2. parasheh po ashtu kryerjen e kësaj vepre penale në rast të shkeljes së ligjit mbi trafikun rrugor apo transportin rrugor, në rastet kur rrezikohet trafiku hekurudhor, me tramvaj, me trolejbus, me autobus, me teleferik ose trafikun ujor në rast se rrezikohet jeta e njerëzve, siguria fizike ose pasuria. Paragrafi 3 i këtij neni specifikon elementet e posaçme te parag.2 në rast se aksidenti rezulton me lëndime të lehta trupore të ndonjë personi ose dëm pasuror në vlerë prej pesëmbëdhjetë mijë (15.000) euro apo më shumë. Paragrafi 4 specifikon elementet e posaçme të paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni të lëndimit të rëndë trupor të ndonjë personi ose dëmin pasuror në vlerë prej njëzet mijë (20.000) euro apo më shumë. Ndërsa paragrafi 5 i këtij neni e parasheh pasojën nga paragrafi 1 dhe 2 e që rezulton me vdekjen e një ose më shumë personave. Paragrafi 6 e parasheh elementin e pakujdesisë së kryerjes së veprës penale të rrezikimit të trafikut publik nga paragrafi 1 dhe 2 të nenit 378 dhe përcakton dënimin me gjobë ose me burgim deri në një(1) vit.

Nga analiza e tillë e këtyre dispozitave ligjore rrjedh se këto dispozita ligjore janë në konflikt njëra me tjetrën, mirëpo, në nenin 261 të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor, kapitulli XIII, dispozitat kalimtare dhe përfundimtare, paragrafi 1. parasheh se“ Dispozitat për kundërvajtje dhe masa mbrojtëse sipas këtij ligji nuk e paragjykojnë zbatimin e kodit penal”, andaj në rastin konkret kushdo që shkel ligjin për rregullat e trafikut rrugor dhe rrezikon jetën e njerëzve apo pasurin dhe me këtë i shkakton dikujt lëndime trupore, ose dëm të përcaktuar pasuror me këtë kod, përmbushen elementet qenësore të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 të KPK.

Meqenëse ligjvënësi në dispozitën e cituar kalimtare ka prapa edhe situatën kur mund të vij deri te kolizioni mes të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor dhe KPK-së, shprehimisht i ka parapa se dispozitat për kundërvajtje dhe masat mbrojtëse sipas Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor nuk paragjykojnë zbatimin e kodit penal e në anën tjetër siç u potencua më lart se gjer sa kemi në fuqi një KPK dhe dispozitën e nenit 378 të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik, konsideroj se duhet zbatuar Kodi Penal i Kosovës.

Kjo gjykatë nuk u lëshua në sqarimin e çështjes se cili ligj-kod penal apo Ligji për Rregullat e Trafikut Rrugorë është më i favorshëm për kryesin, sepse konform nenit 3. të KPK zbatimi i ligjit më të favorshëm ka të bëjë vetëm me ligjin penal (e jo edhe me ligjet tjera) dhe vetëm në rast të ndryshimit të ligjit penal (KPK) para shqiptimit të vendimit të formës së prerë.

(Mendim Juridik i miratuar në Mbledhjen e Përgjithshme të Gjykatës Supreme, mbajtur më 26.07.2018)



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 26 paragrafi 1 pika 1.4 të Ligjit për Gjykatat, në Seancën e Përgjithshme, të mbajtur me datë 12 maj 2022, me shumicë votash, miratoi këtë:

MENDIM JURIDIK

PËR

**KOMPENSIMIN E DREJTPËRDREJTË TË DËMIT DHE DËMEVE TË PA
PËRFSHIRA NË VENDIMIN PËRFUNDIMTAR PËR SHPRONËSIM**

Ligji i aplikueshëm:

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Prishtinë/ nr.91 datë 10 dhjetor 2010)

I. Gjykata në procedurë jokontestimore e cila zhvillon procedurën e caktimit të kompensimit për shpronësim të paluajtshmërisë, me aktvendim me të cilin cakton kompensimin për shpronësim, me kërkesën e pronarit/zotëruesit të ndonjë interesi/cakton edhe kompensimin për dëmet tjera, dhe atë:

- kompensimin e drejtpërdrejtë të dëmit i cili mund të dëshmohet, i cili i shkaktohet personit si pasojë e shpronësimit të paluajtshmërisë, plus vlerën e pronës së paluajtshme të shpronësuar, duke përfshirë - nëse është e aplikueshme - pjesët aksesore dhe frutat e saj;
- kompensimin për humbjen e vlerës për shkak të shuarjes së një servituti real si pasojë e shpronësimit të një prone të paluajtshme i cili kompensim duhet të jetë i barabartë me vlerën e servitutit plus dëmet e drejtpërdrejta të cilat kanë rezultuar nga shuarja e këtij servituti;
- kompensimi në rastin e shpronësimit të pjesshëm ose shuarjes së interesit të siguar, servitutit personal, të drejtës së ndërtimit, të drejtës së parablerjes, uzufuktit ose të drejtës së shfrytëzimit, të cilat nuk janë përfshirë në Vendimin Përfundimtar për shpronësim.

- kompensimi në rastin e zgjidhjes së kontratës së qiramarrjes.

II. Në rastet e ngjashme të cilat sipas ankesës së pronarit ose zotëruesit të një interesi në pronën e paluajtshme, për këtë pjesë të kompensimit, janë në procedurë ankimore në shkallë të dytë, e njëjta gjykatë (gjykata e shkallës së dytë) do të vendos në mënyrë analoge sipas pikës I, të këtij mendimi juridik.

III. Nëse në ankesën për caktimin e kompensimit për shpronësim nuk paraqitet kërkesa edhe për kompensimin e dëmeve tjera të cekura në pikën I, të këtij Mendimi Juridik, e të cilat nuk janë përfshirë në Vendimin përfundimtar për shpronësim, të cilat dëme lidhen me tërë paluajtshmërinë e shpronësuar apo me një pjesë të saj, kjo nuk do të thotë se ankuesi nuk ka të drejtë që të kërkojë kompensimin në procedurë kontestimore siç përcaktohet me dispozitat e Ligjit për Procedurë Kontestimore dhe Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

IV. Ky mendim juridik nuk ka efekt retroaktiv - prapaveprues, kjo do të thotë, që në rastet të cilat janë në zhvillim e sipër sipas ankesave, për kompensimin e humbjes së vlerës së pjesës së pa shpronësuar dhe për kompensime tjera të përcaktuara si në pikën I, të këtij Mendimi Juridik, në të cilat është pezulluar apo ndërprerë procedura jokontestimore për vendosje sipas ankesave/kërkesave/të tilla, në gjykatën e shkallës së parë ndërsa edhe në shkallë të dytë, në procedurë ankimore është vërtetuar ky pezullim apo ndërprerje e procedurës, apo në mungesë të ankesës në këtë pjesë të aktvendimit, ky pezullim apo ndërprerje e procedurës jokontestimore ka mbetur e pa shqyrtuar nga gjykata e shkallës së dytë, pronarit ose zotëruesit të një interesi në pronën e paluajtshme i mbetet mundësia e vetme që në procedurë kontestimore të kërkon kompensimin siç përcaktohet me dispozitat e Ligjit për Procedurë Kontestimore dhe Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

V. Për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga punët përgatitore të cilat kryhen për përcaktimin e përshtatshmërisë potenciale të një ose më shumë parcelave të pronës së paluajtshme për qëllim përkatës publik, pronari ose zotëruesi i një interesi në pronën e paluajtshme në këto parcela, kompensimin mund ta realizojë në kontest civil duke paraqitur padi me kërkesë për caktimin e një kompensimi të tillë.

Arsyetim

Gjykata Supreme e Kosovës, në praktikën gjyqësore gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimeve të gjykatave të instancave më të ulëta ka konstatuar praktikë jo unike lidhur me çështjen e kompensimit të dëmeve tjera të pa përfshira në vendimin përfundimtar për shpronësim. Praktika jo unike e gjykatave të instancave më të ulëta kryesisht ka të bëjë me zbatimin e gabuar të nenit 15 paragrafi 1 e 2, 17, 18, 19, 36 paragrafi 6 dhe 37 paragrafi 1 i

Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Prishtinë/ nr.91 datë 10 dhjetor 2010).

Gjykata Supreme nga praktika e saj, por edhe nga kërkesat e vazhdueshme që ka pranuar nga gjykatat dhe gjyqtarët e vlerëson me interes për standardizimin e praktikës gjyqësore, adresimin e çështjes së kompensimit të dëmeve tjera të pa përfshira në vendimin përfundimtar për shpronësim përmes një mendimi juridik.

Juridiksioni i Gjykatës Supreme të Kosovës, që të nxjerrë mendim juridik në rastet kur vërehet praktika jo unike e zbatimit të ligjit nga gjykatat e rregullta, apo sfidat në zbatimin dhe interpretimin e dispozitave ligjore, përcaktohet me Ligjin për Gjykatat, neni 27 i Ligjit, me dispozitat e të cilit përcaktohet Seanca e Përgjithshme e Gjykatës Supreme, ndërsa nevoja e adresimit të kësaj çështjeje përmes mendimit juridik ka rrjedhë si propozim dhe konkludim i Degës Civile të Gjykatës Supreme, pas shqyrtimit, analizës dhe vlerësimit të një numri të konsiderueshëm të vendimeve gjyqësore për çështjen e kompensimit të dëmeve tjera të pa përfshira në vendimin përfundimtar për shpronësim, e po ashtu edhe nga kërkesat, pyetjet apo sugjerimet e gjykatave të rregullta apo gjyqtarëve.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se nxjerrja e këtij mendimi juridik do t'i kontribuojë në radhë të parë unifikimit të praktikës gjyqësore, vendosjes së standardit të ligjshmërisë në vendimmarrjen gjyqësore për çështjen e kompensimit të dëmeve tjera të pa përfshira në vendimin përfundimtar për shpronësim, efikasitetit, performancës së gjyqtarëve dhe besimit të publikut në gjykata. Kjo për shkak se përmes standardizimit të praktikës gjyqësore ndikohet në ligjshmërinë e vendimmarrjes, efikasitetin dhe besueshmërië e publikut në gjykata.

Objekt i këtij mendimi juridik janë pothuajse të gjitha situatat e kërkesave për kompensim të dëmeve tjera të pa përfshira në vendimin përfundimtar për shpronësim për sa i përket ligjit të aplikueshëm.

Arsyetimi i këtij mendimi juridik ndjek kronologjinë e çështjeve të trajtuara sipas ndarjes në pika.

I. Arsyetimi për pikën I, të mendimit juridik

Në praktikën gjyqësore në gjykatën e shkallës së parë dhe të dytë, Gjykata Supreme ka vërejtur se në shumë raste është vendosur ndryshe për kompensimin e dëmeve tjera të pa përfshira në vendim përfundimtar për shpronësim dhe atë: për anekse të ndryshme në paluajtshmërinë e shpronësuar, pjesët aksesore dhe frutat e saj, fitimin e humbur, kompensimin për humbjen e vlerës për shkak të shuarjes së një servituti real si pasojë e shpronësimit të një prone të paluajtshme, kompensimin në rastin e shpronësimit të pjesëshëm ose shuarjes së interesit të siguruar, servitutit personal, të drejtës së ndërtimit, të drejtës së parablerjes, uzufuktit ose të drejtës së shfrytëzimit dhe kompensimi në rastin e zgjidhje së kontratës së qiramarrjes. Edhe pse ankuesi e kërkon kompensimin për kategoritë e dëmit siç është theksuar me lartë, gjykata që e zhvillon procedurën e kompensimit nuk vendos meritorisht për këtë pjesë të kërkesës së ankuesit, ku në disa raste pezullohet e në disa ndërpritet procedura jokontestimore për kompensimin e këtyre kategorive të dëmeve, dhe

ankuesi - kërkuesi udhëzohet në procedurë kontestimore, për realizimin e kësaj të drejte. Po ashtu është vërejtur se në shumicën e rasteve, gjykatat që zhvillojnë procedurën për caktimin e shpronësimit për paluajtshmërinë e shpronësuar, përkitazi me kërkesën e ankuesit për kompensimin e vlerës së zvogëluar të pjesës së paluajtshmërisë të mbetur të pa shpronësuar, pezullojnë procedurën e vendosjes sipas rregullave të procedurës jokontestimore, dhe këto palë i udhëzojnë në kontest civil, në këtë mënyrë, Gjykata Supreme gjendet para aktit të kryer të pranimit të një qëndrimi të tillë të kundërligjshëm nga se ligjërisht nuk mund të ndërvejojë për shkak se revizioni në këtë pjesë të aktvendimit të kundërshtuar nuk është i lejuar pasi që për atë pjesë nuk është vendosë meritoret nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë. Për këto arsye paraqitet si e domosdoshme që të unifikohet praktika gjyqësore, andaj aprovimi i një mendimi juridik nga Gjykata Supreme, për këto çështje është më se i nevojshëm.

Gjykata Supreme konsideron se nuk ka asnjë pengesë ligjore që në të njëjtën procedurë jokontestimore me rastin e caktimit të kompensimit për shpronësim të paluajtshmerisë, njëkohësisht me aktvendim, në të njëjtën procedurë (Procedurë jokontestimore), të vendoset edhe lidhur me pjesën e ankesës për kompensimin e dëmeve tjera të pa përfshira në vendimin përfundimtar për shpronësim, për arsye se me nenin 23.3.2 të *ligjit të lartpërmendur* është përcaktuar se: *Zyra për vlerësim të pronës së paluajtshme në aktin e vlerësimit përshinë edhe një vlerësim të gjitha dëmeve - nëse ka, të cilat duhet të paguhet sipas ligjit.* Po ashtu edhe gjykata në kuptim të *nenit 15 paragrafi 1 e 2, 17, 18, 19, 36 paragrafi 6 dhe 37 paragrafi 1 të këtij ligji nëse konstaton se shuma e kompensimit dhe/ose dëmeve, e përcaktuar në vendimin e organit shpronësues është më e ulët ose më e lartë se shuma e cila kërkohet sipas këtij ligji, ose kompensimi i këtyre dëmeve nuk është përfshirë fare në vendimin Përfundimtar për Shpronësim, do të nxjerr aktvendim me të cilin e ndryshon vendimin përfundimtar të organit shpronësues dhe e rregullon shumën e kompensimit për shpronësim duke e plotësuar edhe me kompensimin e këtyre dëmeve tjera të parapara në pikën I, të këtij Mendimi Juridik.* Andaj, në zbatim të këtyre dispozitave ligjore, e duke marrë për bazë parimin e ekonomizimit të procedurës dhe zbatimit të *nenit 2 të LPK-së, ku përcaktohet se: "Në Procedurë Kontestimore gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse, dhe gjykata nuk mund të refuzoj shqyrtimin dhe vendosjen mbi kërkesat që janë në kompetencat e saj"*, e cila dispozitë është e aplikueshme edhe në procedurë jokontestimore sipas nenit 30 të Ligjit për Procedurë Jokontestimore, gjykata duhet që me aktvendim me të cilin cakton kompensimin për shpronësim, të vendos edhe lidhur me kompensimin e dëmeve tjera të precizuara si në pikën I, të këtij Mendimi Juridik.

Në këto raste gjykatat janë duke vepruar në kundërshtim me nenin *15 paragrafi 1 e 2, 17, 18, 19, 36 paragrafi 6 dhe 37 paragrafi 1 të këtij ligji*, si dhe në kundërshtim me nenin 2 të LPK-së, për arsye se nëse i referohemi dispozitave të lartë cekura rezulton pa dyshim se gjykata nuk ka asnjë pengesë ligjore në procedurë jokontestimore të vendosë njëkohësisht me aktvendim lidhur me kërkesat e ankuesit, për të gjitha kategoritë e dëmeve të lart cekura, çka ka qenë edhe qëllimi i ligjdhënësit, e jo vetëm për zbatimin e parimit të ekonomizimit të procedurës, por edhe për faktin se pronari ose zotëruesit të një interesi në pronën e paluajtshme, paluajtshmeria e të cilit shpronësohet të kompensohet plotësisht jo vetëm për pjesën e shpronësuar por edhe për dëmin i cili vjen si pasojë e këtij shpronësimi e i cili shprehet në zvogëlimin e vlerës së pjesës së mbetur të pa shpronësuar si dhe kompensimet

tjera, me vendimin përfundimtar për shpronësim. Pezullimi apo ndërprerja e procedurës jokontestimore për vendosje lidhur me kërkesën/at e ankuesit që në këtë procedurë të mos vendoset edhe për kërkesën për kompensimin e vlerës së zvogëluar të paluajtshmerisë së shpronësuar si dhe për kompensimet tjera, pa dyshim është në kundërshtim me nenin 2 të LPK-së, të përshkruar më lartë. Gjykata e ka detyrim që të vendos lidhur me të gjitha kërkesat e paraqitura sipas ankesës respektivisht propozimit, dhe mos vendosja sipas të gjitha kërkesave të tilla paraqet shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës. Faktikisht vendosja e gjykatës me aktvendim, në procedurë jokontestimore, në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikon edhe në efikasitetin dhe zvogëlimin e numrit të lëndëve civile në Gjyqësorin e Kosovës, dhe në këtë mënyrë në zbatimin efikas të drejtësisë në Kosovë, kjo nga se ankuesi/propozuesi me këtë veprim nuk detyrohet që të inicioj kontest civil të veçantë, për tu kompensuar për vlerën e zvogëluar të paluajtshmerisë dhe kompensimet tjera, të cilat nuk janë përfshirë me vendimin përfundimtar për shpronësim.

II. Arsyetimi për pikën II, të mendimit juridik

Duhet theksuar se edhe gjykata e shkallës së dytë, në rastet e ngjashme sipas ankesës së pronarit ose zotëruesit të një interesi në pronën e paluajtshme, për këto kategori të kompensimit janë duke u shqyrtuar në procedurë ankimore, do të duhej të vendos në mënyrë analoge sipas pikës I. të këtij mendimi juridik, për arsyet e paraqitura më lartë.

III. Arsyetimi për pikën III, të mendimit juridik

Në rastet kur ankuesi/propozuesi, në procedurën jokontestimore për caktimin e kompensimit për pjesën e paluajtshmerisë së shpronësuar dhe kategoritë e dëmeve tjera nuk paraqet ankesë me kërkesë për caktimin e kompensimit të humbjes së vlerës së pjesës të pa shpronësuar, pronari ose zotëruesit të një interesi në pronën e paluajtshme nuk mund të ketë pasoja juridike të dëmshme, pasi që të njëjtit nuk mund t'i mohohet e drejta që në procedurë kontestimore të kërkojë kompensimin siç përcaktohet me dispozita të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

IV. Arsyetimi për pikën IV, të mendimit juridik

Ky mendim juridik nuk ka efekt retroaktiv, kjo do të thotë që në raste në të cilat janë paraqitur ankesa/propozime me kërkesa për kompensimin e humbjes së vlerës së pa shpronësuar dhe për kategoritë tjera të kompensimit, e në të cilat raste është pezulluar apo ndërprerë procedura jokontestimore për vendosje sipas këtyre kërkesave, ndërsa edhe në shkallë të dytë në procedurë ankimore është vërtetuar vendimi i shkallës së parë, apo në mungesë të ankesës në këtë pjesë të aktvendimit, pezullimi apo ndërprerje ka mbetur i pashqyrtuar nga gjykata e shkallës së dytë, pronarit ose zotëruesit të një interesi në pronën e paluajtshme, i mbetet mundësia ligjore që në procedurë kontestimore të kërkojë kompensimin siç përcaktohet me dispozitat ligjore të cekura më lartë.

V. Arsyetimi për pikën V, të mendimit juridik

Gjykata Supreme konsideron se në rast të mos pajtimit të organit shpronësues dhe pronarit ose zotëruesit të interesit për shumën e kompensimit të paraparë në paragrafin 1, të nenit 6 të këtij Ligji, pronari përkatës ose zotëruesi i interesit ka të drejtë të paraqesë padi, për kompensim në gjykatën kompetente, në kontest civil, dhe në këtë situatë neni 6 paragrafi 1,2,3 dhe 4 i këtij ligji nuk ka lënë dilema, andaj për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga punët përgatitore të cilat kryhen për përcaktimin e përshtatshmërisë potenciale të një ose më shumë parcelave të pronës së paluajtshme, për qëllim përkatës publik, pronari ose zotëruesi i interesit në këto parcela kompensimin mund ta realizojë në kontest civil duke paraqitur padi, me kërkesë për caktimin e një kompensimi të tillë.

(Mendim Juridik i miratuar në Seancën e Përgjithshme të Gjykatës Supreme, mbajtur më 12 maj 2022)



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Mbledhja e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 26 paragrafi 1 pika 1.4 të Ligjit për Gjykatat, më datë 01.12.2020, me vota unanime nxjerr këtë:

MENDIM JURIDIK

PËR

KAMATËN

(Lidhur me ligjin e aplikueshëm, lartësinë dhe periudhën e llogaritjes)

PJESA E PARË

Ligji i aplikueshëm:

- I. Për marrëdhëniet e detyrimeve që kanë lindur para datës 20.12.2012, për kamatën zbatohen dispozitat e Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, nr.29/78, 39/85, 57/89).
- II. Për marrëdhëniet e detyrimeve që kanë lindur pas datës 19.12.2012, për kamatën zbatohen dispozitat e Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, nr.04/L-077, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.19/19, datë 19.06.2012.
- III. Për kërkesat periodike të cilat kanë lindur nga marrëdhëniet e detyrimeve para datës 20.12.2012, por të cilat shtrihen (*arrijnë për pagesë*) edhe në periudhë pas datës 19.12.2012, ndërsa gjykata për çështjen objekt kontesti sipas padisë vendos pas datës 19.12.2012, atëherë ligj i zbatueshëm është:

-për kërkesat periodike që kanë arritur për pagesë deri me datën 20.12.2012, lidhur me kamatën zbatohen dispozitat e Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, nr.29/78, 39/85, 57/89);

-për kërkesat periodike që arrijnë për pagesë pas datës 19.12.2012, për kamatën zbatohen dispozitat e Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Ligji nr.04/L-077.

PJESA E DYTË:

Shkalla/lartësia e kamatës:

IV. Për marrëdhëniet e detyrimeve që kanë lindur para datës 20.12.2012, shkalla/lartësia e kamatëvonesës caktohet si për mjetet e depozituara në bankë, mbi një vit, pa destinim të caktuar.

V. Për marrëdhëniet e detyrimeve që kanë lindur para datës 20.12.2012, shkalla/lartësia e kamatës së kontraktuar në qoftë së është më e larte se shkalla/lartësia e kamatëvonesës, ajo do të rrjedh (*në shkallë/lartësi të njëjtë*) edhe pas vonesës se debitorit.

VI. Për marrëdhëniet e detyrimeve që kanë lindur pas datës 19.12.2012, shkalla/lartësia e kamatëvonesës vjetore për të gjitha kërkesat do të caktohet në lartësi prej 8%, përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj të veçantë.

VII. Kreditori dhe debitori mund të pajtohen me kontratë për lartësinë e kamatëvonesës, e cila mund të jetë me e ultë ose me e lartë sesa niveli i kamatëvonesës së përcaktuar me ligj prej 8%.

VIII. Për marrëdhëniet e detyrimeve që kanë lindur pas datës 19.12.2012, nëse palët janë dakorduar që debitori duhet të paguajë edhe kamatën kontraktore, por pa e caktuar lartësinë e kamatës dhe kohën e arritjes së pagesës, atëherë kamata caktohet në lartësi prej 6% vjetore, dhe rrjedh për pagesë në kohën e njëjtë me arritjen për pagesë të kryegjësë (shumës kryesore).

IX. Për kërkesat e kreditorëve për rimbursim të dëmit nga të gjitha bazat e përgjegjësisë kur kreditorët kanë të drejtë në rimbursim të dëmit, lartësia e kamatës caktohet sipas pikës IV (katër) dhe VI (gjashtë) të këtij mendimi juridik, varësisht se cili ligj është zbatuar (*ka qenë në fuqi*) kur kreditori në cilësinë e debitorit ka përmbushur detyrimin ndaj palës së tretë.

X. Për kërkesat e kreditorëve për rimbursim të dëmit nga të gjitha bazat e përgjegjësisë kur kreditorët kanë të drejtë në rimbursim të dëmit, kamata rrjedh nga dita e parashtrimit të kërkesës së kreditorit për rimbursim (*e pranuar nga debitori*), kurse në rast të mos parashtrimit të kërkesës, atëherë nga data e parashtrimit të padisë e deri në pagesën e plotë.

XI. Për rastet e kërkesave për kompensim të dëmit apo mbulimit të shpenzimeve për rastin e siguruar (*kompensimin e rastit të siguruar*) me policë vullnetare (*sigurim vullnetarë*), lartësia e kamatës caktohet sipas pikës IV (katër) dhe VI (gjashtë) të këtij mendimi juridik, varësisht se cili ligj është në zbatim në kohën kur paraqitet rasti i siguruar.

Përjashtimet nga pika IV (katër), V (pesë), VI (gjashtë), VII (shtatë), VIII (tetë), IX (nëntë) dhe X (dhjetë) për lartësinë e kamatës.

XII. Për kërkesat e palëve të treta ndaj Kompanive të Sigurimeve, kamata në lartësi prej 12% të interesit vjetor zbatohet/llogaritet kur plotësohen kushtet ligjore, në rastet e mos respektimit të afateve (*neni 26 paragrafi 1 dhe 2 Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto Përgjegjësia, nr.04/L-018, i shpallur në Gazetën Zyrtare nr.4, me datën 14 korrik 2011, i cili ka hyrë në fuqi me datën 30 korrik 2011*) dhe mos përmbushjes së detyrimit (*neni 26 paragrafi 4, i ligjit të njëjtë*) nga ana e siguruesve përgjegjës (*Kompanitë e Sigurimeve*) për çdo ditë vonese deri në shlyerjen e detyrimit nga siguruesi përgjegjës, duke filluar nga data e paraqitjes së kërkesës për dëmshpërblim.

Situatat kur aplikohet norma e interesit vjetor prej 12 %:

-Kur kërkesat e paraqitura tek Kompanitë e Sigurimeve, për dëmin në persona, nuk trajtohen në afat prej 60 ditësh;

-Kur kërkesat e paraqitura tek Kompanitë e Sigurimeve, për dëmin në pasuri, nuk trajtohet brenda 15 ditësh;

-Në pamundësi të përcaktimit të dëmit, respektivisht trajtimit të dëmshpërblimit në tërësi, siguruesi përgjegjës është i detyruar t'i paguaj palës së dëmtuar pjesën jokontestuese të dëmit në formë paradhënie, brenda afatit prej 60 ditësh për dëmin në persona dhe 15 ditësh për dëmin në pasuri.

XIII. Për pagesat në vonesë të debitorëve ndaj kreditorëve-institucioneve financiare, kredidhënëse, kamatëvonesa do të llogaritet në procedurën e përcaktuar me akte nën ligjore nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK), sipas normës/lartësisë së përcaktuar me kushte dhe afatet e marrëveshjes përkatëse të instrumentit kreditor, ndaj institucionit financiar përkatës.

PJESA E TRETË

Periudha e pagesës së kamatës:

XIV. Pavarësisht se kur është lindur marrëdhënia e detyrimeve¹ për kërkesat që i referohen dëmit material (*dëmi i zakonshëm apo fitimi i munguar*), kamata fillon që të rrjedhë nga data e parashtrimit të kërkesës së kreditorit për kompensim (*e pranuar nga debitori*) dhe në rast të mos parashtrimit të kërkesës nga ana e kreditorit për kompensim, atëherë kamata fillon që të rrjedhë nga data e parashtrimit të padisë e deri në pagesën e plotë.

Nëse pala e dëmtuar e ka mënjeluar vetë dëmin para se të jepet vendimi i gjykatës, kamatëvonesa fillon nga dita e mënjanimit të dëmit, përkatësisht nga dita që janë bërë shpenzimet për mënjanimin e tij, (*kjo vlen vetëm për rastet kur dëmi është mënjeluar apo shpenzimet janë bërë para së të jetë ngritur padia, përndryshe kamata fillon nga data e parashtrimit të padisë*).

XV. Pavarësisht se kur është lindur marrëdhënia e detyrimeve² për kërkesat që i referohen dëmit jo material, kamata fillon të rrjedhë nga data e marrjes së aktgjykimit në gjykatën e shkallës së parë e deri në pagesën e plotë.

Përjashtimet nga pika XIV (katërbëdhjetë) dhe XV (pesëmbëdhjetë) për periudhën e pagesës së kamatës.

XVI. Nëse palët kontraktuese me rastin e krijimit të raportit juridiko civil kanë përcaktuar me kontratë se kur fillon (*periudha*) të rrjedhë kamata, atëherë vlen mënyra e përcaktuar me kontratë.

XVII. Për pagat dhe kërkesat tjera materiale nga marrëdhënia e punës, kamata fillon të rrjedhë nga dita e arritjes, për secilën kërkesë veç e veç (*parimisht mujore*), pavarësisht nga data kur kërkohet mbrojtja gjyqësore apo kur bëhet vlerësimi (*zakonisht me ekspertizë*) i kërkesave të arritura.

XVIII. Për kërkesat lidhur me alimentacion, mbajtjen financiare (*ushqimin*), shpërblimin e dëmit për ushqimin e humbur dhe fitimin e humbur, kamata fillon që të rrjedhë nga dita e arritjes së secilës kërkesë veç e veç (*parimisht mujore*), pavarësisht nga dita se kur kërkohet mbrojtja gjyqësore apo se kur bëhet vlerësimi (*zakonisht me ekspertizë*) i kërkesave të arritura.

¹ Në kohën e zbatimit të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, nr.29/78, 39/85, 57/89) apo (Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, nr.04/L-077, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.19/19, datë 19.06.2012).

² Në kohën e zbatimit të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, nr.29/78, 39/85, 57/89) apo (Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, nr.04/L-077, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.19/19, datë 19.06.2012).

XIX. Për kërkesat për mbrojtjen nga dhuna në familje lidhur me masat pasurore në të holla, kamata fillon që të rrjedh nga dita e caktimit të urdhrit mbrojtës, respektivisht nga dita e përfundimit të afatit për përmbushje vullnetare të detyrimeve të caktuara me urdhër mbrojtës.

Ndalimi i kamatës në kamatë dhe supozimi i kontratës me fajde

XX. Ndalimi i kamatës në kamatë - në kamatën e kontraktuar e cila është arritur për pagesë, por nuk është paguar nuk rrjedh kamatëvonesa, megjithatë palët mund të pajtohen paraprakisht me kontratë se shkalla e kamatëvonesës do të jetë me e lartë në rast se debitori nuk i paguan kamatat e rrjedha për pagesë në kohën e duhur.

XXI. Supozimi i kontratës me fajde - konsiderohet për shkak të lartësisë së kamatës, kur niveli i kamatëvonesës së kontraktuar është për 50% me i lartë se niveli i kamatëvonesës (50% me i lartë se 8%, respektivisht mbi 12%).

Përrjashtim nga rregulli i mësipërm bëjnë rastet kur kreditori provon se nuk e ka shfrytëzuar:

- gjendjen e pavolitshme të debitorit;
- vështirësinë e situatës së tij financiare;
- pamaturin ose varësin e krijuar prej saj; ose
- që përfitimet e rezervuara për kreditorin ose personin e tretë nuk janë në shpërpjesëtim me atë që kreditori ka ofruar ose ka ndërmarr të ofroj ose bëj.

Përrjashtimet nga ky mendim juridik

XXII. Me këtë mendim juridik nuk përrfshihet kamatëvonesa në transaksionet tregtare e rregulluar me Ligjin nr.05/L-100 për Kamatë-Vonesat në Transaksionet Tregtare, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.38/21 Nëntor 2016, dhe kamatëvonesa për shpronësimin e pronës së paluajtshme, e rregulluar me Ligjin Nr.03/L-139, për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.52/08 Maj 2009.

Arsyetim

Gjykata Supreme e Kosovës, në praktikën e saj gjyqësore gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimeve të gjykatave të instancave më të ulëta ka konstatuar praktikë jo unike lidhur me çështjen e kërkesave për kamatën. Praktika jo unike e gjykatave të instancave më të ulëta kryesisht ka të bëjë me ligjin e aplikueshëm, normën e interesit dhe kohën e rrjedhës së kamatës.

Gjykata Supreme nga praktika e saj, por edhe nga kërkesat e vazhdueshme që ka pranuar nga gjykatat dhe gjyqtarët e vlerëson me interes për standardizimin e praktikës gjyqësore, adresimin e çështjes së kamatave përmes një mendimi juridik.

Juridiksioni i Gjykatës Supreme të Kosovës, që të nxjerrë mendim juridik në rastet kur vërehet praktika jo unike e zbatimit të ligjit nga gjykatat e rregullta, apo sfidat në zbatimin dhe interpretimin e dispozitave ligjore, përcaktohet me Ligjin për Gjykatat, neni 27 i Ligjit, me dispozitat e të cilit përcaktohet Seanca e Përgjithshme e Gjykatës Supreme, ndërsa nevoja e adresimit të kësaj çështjeje përmes mendimit juridik është rrjedhë si propozim dhe konkludim i Degës Civile të Gjykatës Supreme, pas shqyrtimit, analizës dhe vlerësimit të një numri të konsiderueshëm të vendimeve gjyqësore për çështjen e kamatës, e po ashtu edhe nga kërkesat, pyetjet apo sugjerimet e gjykatave të rregullta apo gjyqtarëve.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se nxjerrja e këtij mendimi juridik do t'i kontribuojë në radhë të parë unifikimit të praktikës gjyqësore, vendosjes së standardit të ligjshmërisë në vendimmarrjen gjyqësore për çështjen e kamatave, efikasitetit, performancës së gjyqtarëve dhe besimit të publikut në gjykata. Kjo për shkak se përmes standardizimit të praktikës gjyqësore ndikohet në ligjshmërinë e vendimmarrjes, efikasitetin dhe besueshmërinë e publikut në gjykata.

Objekt i këtij mendimi juridik janë pothuajse të gjitha situatat e kërkesave për kamatën për sa i përket ligjit të aplikueshëm, normës së interesit dhe kohën e rrjedhës së kamatës me disa përjashtime që kanë të bëjnë me çështje që rregullohen me ligje të veçanta.

Arsyetimi i këtij mendimi juridik ndjek kronologjinë e çështjeve të trajtuara sipas ndarjes në pika.

Arsyetimi për pikën I (një) të mendimit juridik – Është standard i së drejtës civile që ligji material do të vlej në kohë të caktuar dhe territor të caktuar. Në këtë kontekst përcaktohet edhe zbatimi i dispozitave të Ligjit mbi/për Marrëdhëniet e Detyrimeve, duke marrë si bazë kohën e lindjes së marrëdhënieve juridike civile.

Në praktikë është paraqitur si dilemë, dhe në disa raste është zbatuar në mënyrë të gabuar dispozita e ligjit i cili nuk ka qenë në fuqi në kohën e lindjes së marrëdhënies juridike civile.

Kjo për shkak se në disa raste marrëdhënia juridiko-civile është lindur në kohën kur ka qenë në fuqi Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, nr.29/78, 39/85, 57/89), ndërsa padia është parashtruar pasi që ka hyrë në fuqi Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, nr.04/L-077, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.19/19, datë 19.06.2012, apo çështja është gjykuar pasi që ka hyrë në fuqi Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve, nr.04/L-077, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.19/19, datë 19.06.2012. Siç duket këto situata në disa raste kanë krijuar dilemën se cili ligj duhet të zbatohet.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të çështjeve nga praktika e saj, por edhe sipas parimit për zbatimin e ligjit material përmes këtij mendimi juridik në pikën I (një) të këtij mendimi thekson se për të gjitha marrëdhëniet e detyrimeve që janë lindur para datës 20.12.2012, për kamatën zbatohen dispozitat e Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, nr.29/78, 39/85, 57/89). Nga kjo rrjedh, se, si ligji material do të zbatohet edhe sa i përket kamatës, ligji i cili ka qenë në fuqi në kohën kur ka lindur marrëdhënia juridiko-civile.

Arsyetimi për pikën II (dy) të mendimit juridik - Sa i përket pikës II (dy) të këtij mendimi juridik, duke qenë se bëhet fjalë për zbatimin e ligjit material lidhur me marrëdhëniet juridiko-civile të cilat janë lindur pas datës 19.12.2012, Gjykata Supreme thekson se ligj i zbatueshëm është Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve, nr.04/L-077, Gazet Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.19/19, datë 19.06.2012.

Arsyetimi për pikën II (dy) të këtij mendimi juridik është i ndërlidhur me arsyetimin në pikën I (një) të këtij mendimi juridik, përveç se në këtë rast pika II (dy) i referohet marrëdhënies juridiko-civile të cilat kanë lindur pas hyrjes në fuqi të Ligjit (*të ri*) për Marrëdhëniet e Detyrimeve, nr.04/L-077, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.19/19, datë 19.06.2012.

Arsyetimi për pikën III (tre) të mendimit juridik – Sa i përket zbatimit të ligjit material për kamatën lidhur me kërkesat periodike të cilat janë lindur nga marrëdhëniet e detyrimeve para datës 20.12.2012, por të cilat shtrihen (*arrin për pagesë*) edhe në periudhë pas datës 19.12.2012 (*për kërkesat të cilat arrin për pagesë pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, nr.04/L-077, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.19/19, datë 19.06.2012*) në praktikën gjyqësore janë konstatuar interpretime, vlerësime dhe mënyra të ndryshme të vendosjes, lidhur me atë se cili ligj duhet të zbatohet.

Qëndrimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, parimisht e mbështet konceptin se edhe për kërkesat periodike zbatohen dispozitat e ligjit material i cili ka qenë në fuqi në kohën kur është lindur marrëdhënia juridiko-civile, në qoftë se çështja kontestuese është gjykuar dhe vendosur nga ana e gjykatës deri sa ka qenë në fuqi ai ligj.

Mirëpo, në qoftë se disa kërkesa periodike arrijnë për pagesë në kohën sa ka qenë në fuqi ligji i zbatueshëm duke pasur parasysh lindjen e marrëdhënies juridiko-civile, e po ashtu disa nga

kërkesat arrijnë për pagesë në kohën kur është në fuqi ligji i ri, atëherë në qoftë se çështja nuk është gjykuar ende, për kërkesat që kanë arritur për pagesë për derisa ka qenë në fuqi ligji i mëparshëm për kamatën zbatohen dispozitat e atij ligji, ndërsa për kërkesat që arrijnë për pagesë pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri zbatohen dispozitat e ligjit të ri për kamatën.

Përfundimi i zbatimit të ligjit material (*vlen vetëm për kamatën që rrjedh nga kërkesat periodike*) vlen për kërkesat që arrijnë për pagesë në kohën kur është në fuqi ligji i ri, pavarësisht se marrëdhënia juridiko-civile është lindur në kohën kur ka qenë në fuqi ligji i mëparshëm, dhe justifikohet nga shkak se secila kërkesë periodike ka një moment të caktuar dhe të veçantë të arritjes, ka një moment të caktuar dhe të veçantë të rrjedhës së afatit të parashkrimit dhe rrjedhimisht, ka një afat të veçantë të rrjedhës së kamatës, prandaj, Gjykata Supreme e Kosovës, mbi këtë logjikë duke pasur parasysh veçanërisht kohën e arritjes së kërkesës periodike për pagesë, pranon konceptin se si ligj material për zbatim duhet të jetë ligji i cili është në fuqi në kohën arritjes për pagesë të kërkesës periodike (*pavarësisht se marrëdhënia juridiko-civile është lindur në kohën kur ka qenë në fuqi ligji i mëparshëm*). Ky përfundim gjithmonë vlen në qoftë se çështja kontestuese ende është e pagjykuar-e pa vendosur).

Në kontekstin e diskutimit më sipër, Gjykata Supreme e Kosovës sqaron se në asnjë rast për çështjen e kamatës për sa i përket ligjit që duhet të aplikohet nuk është me rëndësi koha e parashkrimit të padisë.

Arsyetimi për pikën IV (katër) të mendimit juridik - Ligji i mëparshëm mbi marrëdhëniet e detyrimeve që ka qenë në fuqi deri me datë 19.12.2012, dhe ligji aktual i cili është në fuqi nga data 20.12.2012, për kamatëvonesën nuk përcaktojnë normë unike të interesit, prandaj, përmes këtij mendimi juridik, Gjykata Supreme e Kosovës sqaron se cila është norma e kamatëvonesës që aplikohet varësisht nga fakti se cili është ligji material i cili zbatohet si bazë juridike e çështjes kontestuese. Në këtë kontekst përmes këtij mendimi juridik sqarohet se për të gjitha marrëdhëniet juridiko-civile që janë lindur para datës 20.12.2012, shkalla/lartësia e kamatëvonesës caktohet si për mjete e depozituara në bankë, mbi një vit, pa destinim të caktuara. Kjo për shkak se me ligjin mbi marrëdhëniet e detyrimeve i cili ka qenë në fuqi deri me datë 19.12.2012, me dispozitën e nenit 277 al 2 të LMD-së, përcaktohet se: *“Për detyrimin në të holla të rezultuar nga kontrata në ekonomi, kamatëvonesën e cakton Këshilli Ekzekutiv Federativ”*, nga rrjedh se dispozita ligjore nuk ka paracaktuar një normë standarde të interesit, por ajo nominalizohet varësisht nga vendimi i Këshillit Ekzekutiv Federativ. Duke qenë se interpretimi dhe zbatimi i dispozitave ligjore bëhet edhe sipas metodës sistematike dhe historike, për shkak të ndryshimit të rrethanave shoqërore, rezulton se norma e interesit tani duhet të caktohet sipas normës së mjeteve të deponuara në bankë mbi një vit pa destinim të caktuar. Kjo edhe për shkak se nuk ekziston një mekanizëm i cili do ta caktonte një normë fikse të interesit për kamatëvonesën.

Arsyetimi për pikën V (pesë) të mendimit juridik – Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, nr.29/78, 39/85, 57/89), dispozita e nenit 277 al 3, e ka rregulluar situatën kur kamata e kontraktuar është me e lartë se kamatëvonesa duke paracaktuar se niveli

i kamatës së kontraktuar do të vlej edhe për vonesat e debitorit si kamatëvonesë. Pra, për marrëdhëniet e detyrimeve që kanë lidhur para datës 20.12.2012, në qoftë se norma e kamatës së kontraktuar është me e lartë se norma e kamatëvonesës, atëherë kamatëvonesa do të llogaritet në nivelin e kamatës së kontraktuar. Shembull, nëse norma e interesit vjetor të kontraktuar është caktuar në shkallë prej 10%, ndërsa norma mesatare e kamatëvonesës ligjore sipas principit sikurse për mjetet e depozituara në bankë pa destinim të caktuar është mesatarisht 2-3 %, atëherë për vonesat e debitorit nuk zbatohet kamatëvonesa ligjore (psh.2-3 %) por zbatohet norma e kamatës së kontraktuar prej 10 % edhe si kamatëvonesë.

Arsyetimi për pikën VI (gjashtë) të mendimit juridik - Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, nr.04/L-077, Gazet Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.19/19, datë 19.06.2012, me dispozitën e nenit 382 paragrafi 1, ka përcaktuar detyrimin e pagesës së kamatëvonesës, citoi: *“Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën”*, ndërsa në paragrafin 2, të nenit të njëjtë është përcaktuar se: *“Lartësia e kamatëvonesës është tetë për qind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”*. Për dallim nga Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, nr.29/78, 39/85, 57/89), ligji aktual e ka përcaktuar në normë fikse prej 8% kamatëvonesën vjetore. Nga kjo normë fikse prej 8% janë përjashtuar situata e kamatëvonesës së kontraktuar (rasti kur kamatëvonesa është kontraktuar por nuk është caktuar niveli i kamatës dhe rasti kur është kontraktuar kamatëvonesa dhe është caktuar niveli i kamatëvonesës), e paraparë me dispozitën e nenit 385 paragraf 2, të LMD-së.

Arsyetimi për pikën VII (shtatë) të mendimit juridik - Me dispozitën e nenit 383 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, nr.04/L-077, Gazet Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.19/19, datë 19.06.2012, është përcaktuar përjashtimi nga dispozita e nenit 382 paragrafi 2, lidhur me lartësinë e kamatëvonesës sepse palëve kontraktuese u është dhënë mundësia ligjore që përveç se të kontraktojnë kamatën për detyrimet që rrjedhin nga marrëdhënia kontraktuale, kanë të drejtë të përcaktojnë edhe lartësinë e kamatës. Duke qenë se bëhet fjalë për marrëdhënie juridike civile të karakterit relativ, është në diskrecionin e palëve kontraktuese që me vullnetin e tyre të lirë të shprehur të përcaktojnë edhe shkallën/lartësinë e kamatëvonesës, e cila mund të jetë më e ulët ose më e lartë se kamatëvonesa ligjore prej 8%. Pra, nëse palët dakordohen për lartësinë/shkallën e kamatëvonesës, atëherë vlen norma e kontraktuar dhe përjashtohet norma ligjore.

Arsyetimi për pikën VIII (tetë) të mendimit juridik - Me dispozitën e nenit 385 paragraf 2, të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, nr.04/L-077, Gazet Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.19/19, datë 19.06.2012, është rregulluar situata ligjore kur palët kontraktuese përveç të tjerash kanë përcaktuar që debitori duhet të paguaj edhe kamatëvonesën, por nuk kanë përcaktuar shkallën/lartësinë e kamatëvonesës. Në këto raste shkalla vjetore e kamatëvonesës do të jetë 6%.

Është e rëndësishme të theksohet se kamatëvonesa vjetore prej 6%, fillon që të rrjedh për pagesë në kohën e njëjtë me arritjen për pagesë të kryegjësë (shumës kryesore). Fillimi i rrjedhës së kamatës nga arritja për pagesë e kryegjësë është logjike për shkak se në këtë rast

kemi të bëjmë me kamatën e kontraktuar, e për të cilën vetëm lartësia/shkalla e normës vjetore zbatohet sipas ligjit duke qenë se palët me marrëveshjen e tyre e kanë përcaktuar detyrimin e pagesës së kamatës, por nuk e kanë përcaktuar shkallën/lartësinë.

Në praktikën gjyqësore duhet të bëhen dallimet nga situata e kamatëvonesës vjetore në lartësi prej 8%, e cila aplikohet për të gjitha rastet kur debitori ka rënë në vonesë për detyrimet që nuk është kontraktuar kamata, me situatën kur është kontraktuar kamata, por nuk është kontraktuar lartësia e kamatës, e për të cilën aplikohet norma e interesit vjetorë prej 6%, si dhe situatës kur kamatëvonesa është kontraktuar në normë fikse, dhe për të cilën vlen marrëveshja kontraktuale.

Nga analiza e dispozitave të referuara për kamatëvonesën dhe kamatëvonesën e kontraktuar, rezulton se ligjdhënësi u ka dhënë hapësirë të nevojshme palëve të përfshira në kontratë që vullneti i tyre të jetë përcaktues për efektet e marrëdhënies kontraktuale për sa i përket kamatës, por duke qenë njëkohësisht i kujdesshëm që të rregullojë situatat kur palët me vullnetin e tyre nuk kanë përcaktuar se si do të veprohet në rast vonese.

Arsyetimi për pikën IX (nëntë) të mendimit juridik - Në praktikën gjyqësore paraqiten raste të shpeshta të kreditorëve për rimbursim të dëmit të cilët kanë përmbushur detyrimet paraprakisht ndaj palëve të treta, e të cilat kryesisht ndërlidhen me rastet e siguruara nga kompanitë e sigurimeve vendore dhe kompanitë e huaja. Për këtë lloj të kërkesave në praktikën e gjykatave është vërejtur interpretim dhe zbatim i dispozitave ligjore në disa forma sa i përket shkallës/lartësisë së kamatëvonesës për rastet e kërkesave për rimbursim. Kjo ka ndodhur për shkak se kreditorët me rastin e paraqitjes së kërkesave për rimbursim të dëmit duke i'u referuar nenit 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto Përgjegjësia, nr.04/L-018, i shpallur në Gazetën Zyrtare nr.4, me datën 14 korrik 2011, i cili ka hyrë në fuqi me datën 30 korrik 2011, kanë kërkuar që rimbursimi i kërkesës të bëhet me normë vjetore prej 12%, mirëpo Gjykata Supreme e Kosovës në Seancën e Përgjithshme të saj përmes këtij mendimi juridik ka vlerësuar se nuk mund të aplikohet norma/kamatëvonesa vjetore prej 12% në të gjitha rastet. Kjo për shkak se kërkesat e kreditorëve për rimbursim të dëmit kryesisht u referohen situatave për marrëdhëniet juridiko-civile (*jokontraktuale për kreditorin dhe debitorin*), prandaj, në një rast të tillë sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, kamatëvonesa vjetore duhet të paguhet sipas pikës IV (*katër*) dhe VI (*gjashtë*) të këtij mendimi juridik. Kjo nënkupton se në rast se kreditori ka përmbushur detyrimin ndaj palës së tretë, para datës 20.12.2012, norma e interesit do të zbatohet si për mjetet e deponuara në bankë mbi një vit pa destinim të caktuar, ndërsa në rast se kreditori ka përmbushur detyrimin ndaj palës së tretë pas datës 19.12.2012, atëherë shkalla/lartësia e kamatëvonesës do të zbatohet në shkallë prej 8%.

Përveç të cekurave Gjykata Supreme vlerëson se shkalla/lartësia e kamatëvonesës vjetore prej 12%, nuk mund të zbatohet edhe për shkak të faktit se sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto Përgjegjësia, nr.04/L-018, i shpallur në Gazetën Zyrtare nr.4, me datën 14 korrik 2011, i cili ka hyrë në fuqi me datën 30 korrik 2011, interesi vjetor prej 12%, vjen në shprehje për shkak të neglizhencës së kompanive të sigurimeve (*të cilat pastaj paraqiten si kreditor regresues*), sepse sikur kreditorët regresues t'i kishin trajtuar konform

përgjegjësi ligjore kërkesat e palëve të treta, ndaj tyre nuk do të mund të zbatohet shkalla/lartësia e kamatëvonesës prej 12%, në vendimet e gjykatës, por do të zbatohet shkalla/lartësia si për mjetet e deponuara mbi një vit pa destinim të caktuar, apo shkalla/lartësia prej 8%, varësisht se cili ligj ka qenë në fuqi në kohën e lindjes së marrëdhënies së detyrimit.

Arsyetimi për pikën X (dhjetë) të mendimit juridik - Lidhur me kërkesat e kreditorëve për rimbursimin e dëmit sa i përket momentit/periudhës së rrjedhjes së kamatëvonesës në praktikën gjyqësore janë paraqitur situata të ndryshme të veprimit nga ana e gjykatave. Në këtë kontekst në praktikë gjyqësore janë paraqitur rastet kur gjykatat si moment të rrjedhjes së kamatës për pagesën e kërkesës regresuese e kanë marrë ditën e ekzekutimit të detyrimit nga ana e kreditorit tek pala e tretë, pastaj është paraqitur situata kur gjykata si moment të rrjedhës së kamatës e ka marrë ditën e parashtrimit të kërkesës së kreditorit tek debitori për rimbursim, apo ditën e parashtrimit të padisë së kreditorit në gjykatë pa përjashtuar këtu edhe situatat kur si moment/periudhë e rrjedhës së kamatës është marrë data e marrjes së vendimit gjyqësor në gjykatën e shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës për shkak të praktikës jo unike të krijuar nga ana e gjykatave, e ka vlerësuar si të nevojshme adresimin e kësaj çështjeje përmes mendimit juridik duke vlerësuar dhe vendosur si në pikën X (dhjetë) të këtij mendimi juridik.

Gjykata Supreme e Kosovës për këtë çështje ka vlerësuar se si moment/periudhë e rrjedhës së kamatës për kërkesat regresuese të kreditorëve duhet të merret data e parashtrimit të kërkesës së kreditorit tek debitori (*data e pranimit të kërkesës nga ana e debitorit*), apo data e parashtrimit të padisë në gjykatë për rastet kur kreditori nuk ka paraqitur paraprakisht një kërkesë të tillë tek debitori. Arsyetimi i veprimit në këtë formë me alternativë (*data e parashtrimit të kërkesës apo padisë*), arsyetohet me faktin se debitori vetëm në momentin e pranimit të kërkesës së kreditorit për rimbursim, apo pranimit të padisë, njoftohet me përmbajtjen e detyrimit për pagesën e kërkesës regresuese të kreditorit. Vlerësohet se kjo mënyrë e veprimit është në përputhje edhe me parimet e marrëdhënieve të detyrimeve (*parimi i ndershmërisë dhe ndërgjegjshmërisë*) që nënkupton se palët në marrëdhëniet detyrimore duhet të sillen sipas këtyre parimeve, gjë që nënkupton se kreditori duhet të veprojë me urgjencë në parashtrimin e kërkesës, respektivisht parashtrimit të njoftimit për ekzistimin e detyrimit që ka debitori ndaj kreditorit në mënyrë që të ndikojë në zvogëlimin e dëmit që mund t'i shkaktohet debitorit nga sjellja e kreditorit. Thënë thjesht, një prej qëllimeve në rastin e interpretimit në këtë mënyrë është që të nxitet komunikimi pa vonesa i kreditorit me debitorin, dhe të nxitet sjellje sipas parimeve të ndershmërisë dhe ndërgjegjshmërisë.

Arsyetimi për pikën XI (njëmbëdhjetë) të mendimit juridik - Sipas legjislacionit në fuqi, përveç sigurimit të detyrueshëm nga auto përgjegjësia, ekziston edhe alternativa e sigurimit vullnetar për rastin e siguruar pa marrë parasysh llojin e dëmit material apo jo material.

Është e rëndësishme të theksohet se tek sigurimi vullnetar pa marrë parasysh llojin e sigurimit (*Kasko, Shëndetësore, Aksidentet personale, etj.*) palët (*siguruesi dhe i siguruari*), përveç të

tjerash kanë mundësi ligjore që të përcaktojnë edhe shkallën/lartësinë e kamatëvonesës, mirëpo në rast se palët nuk kanë përcaktuar me klauzolë në sigurim shkallën/lartësinë e kamatëvonesës, atëherë vlejné dispozitat ligjore për kamatëvonesën. Kjo nënkupton se për këto raste shkalla/lartësia e kamatëvonesës caktohet sipas pikës IV (katër) dhe VI (gjashtë) të këtij mendimi juridik, që nënkupton se në rast se rasti i siguruar ka ndodhur para datës 20.12.2012, do të zbatohet Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, nr.29/78, 39/85, 57/89), ndërsa në rast se rasti i siguruar ka ndodh pas datës 13.12.2012, do të zbatohet Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve, nr.04/L-077, Gazet Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.19/19, datë 19.06.2012. Shkalla/lartësia e kamatëvonesës për rastet e siguruar që kanë ndodhur para datës 20.12.2012, zbatohet si për mjetet e deponuara në bankë mbi një vit pa destinim të caktuar, dhe për këtë qëllim vlen arsyetimi i pikës IV (katër) të këtij mendimi, ndërsa në rast se rasti i siguruar ka ndodhur pas datës 19.12.2020, do të zbatohet shkalla/lartësia e kamatëvonesës vjetore prej 8%, dhe për këtë qëllim vlen arsyetimi i pikës VI (gjashtë) të këtij mendimi.

Arsyetimi për pikën XII (dymbëdhjetë) të mendimit juridik - Me Ligjin për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto Përgjegjësia, nr.04/L-018, i shpallur në Gazetën Zyrtare nr.4, me datën 14 korrik 2011, i cili ka hyrë në fuqi me datën 30 korrik 2011, dispozita e nenit 26, paragrafi 4, është përcaktuar se kompanitë e sigurimeve janë të detyruara që kreditorëve (*palëve të treta*) t'u paguajnë kamatën në lartësi prej 12% të interesit vjetor, kur plotësohen kushtet ligjore me këtë ligj, dhe atë në rast të mosrespektimit të afateve ligjor për trajtimin e kërkesave të palëve të treta (*neni 26 paragrafi 1 dhe 2 i këtij ligji*), dhe në rast të mos përmbushjes së detyrimit (neni 26 paragrafi 4) nga ana e siguruesve përgjegjës për çdo ditë vonesë deri në shlyerjen e detyrimit nga siguruesi përgjegjës, duke filluar nga data e paraqitjes së kërkesës për dëmshpërblim.

Me dispozitat e nenit 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto Përgjegjësia, nr. 04/L-018, i shpallur në Gazetën Zyrtare nr.4, me datën 14 korrik 2011, i cili ka hyrë në fuqi me datën 30 korrik 2011, janë rregulluar dy çështje dhe atë: lartësia e interesit vjetor prej 12% në rast të mos respektimit të afateve dhe mos përmbushjes së detyrimit, si dhe momenti/periudha prej kur fillon të rrjedh kamata e që është dita e parashtrimit të kërkesës për dëmshpërblim e deri në pagesën e plotë. Mos respektimi i afateve në këtë rast nënkupton kur nuk trajtohet kërkesa e palëve të treta për dëme në persona në afat prej 60 ditësh, dhe kur nuk trajtohet kërkesa e palëve të treta për dëme në pasuri në afat prej 15 ditësh.

Ligji për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto Përgjegjësia, nr.04/L-018, i shpallur në Gazetën Zyrtare nr.4, me datën 14 korrik 2011, i cili ka hyrë në fuqi me datën 30 korrik 201, e ka përcaktuar në mënyrë të qartë së trajtimi i kërkesës nënkupton njoftimin me shkrim për palën e dëmtuar lidhur me ofertën për dëmshpërblim me shpjegime përkatëse, apo vendimin dhe arsyet ligjore të refuzimit të kërkesës për dëmshpërblim, kur janë kontestuese përgjegjësia dhe lartësia e dëmshpërblimit.

Përveç këtyre është rregulluar edhe situata kur është e nevojshme plotësimi i kërkesës me dokumentet e nevojshme për dëmshpërblim dhe afate brenda të cilave duhet të plotësohet

kërkesa (neni 26 paragrafi 2, i Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto Përgjegjësia, nr.04/L-018, i shpallur në Gazetën Zyrtare nr.4, me datën 14 korrik 2011, i cili ka hyrë në fuqi me datën 30 korrik 2011).

Mos përmbushja e detyrimit nënkupton rastin kur në pamundësi të përcaktimit të dëmit, respektivisht trajtimit të dëmshpërblimit në tërësi, siguruesi përgjegjës është i detyruar t'i paguaj palës së dëmtuar pjesën jo kontestuese të dëmit në formë paradhënie, brenda afatit prej 60 ditësh, për dëmet në persona, dhe brenda afatit prej 15 ditësh për dëmet në pasuri.

Ne kontekstin e arsyeve të paraqitura më sipër rezulton se lartësia prej 12% të interesit vjetor do të llogaritet në rastet kur gjykata vlerëson se siguruesi përgjegjës nuk ka respektuar afatet në pajtim me nenin 26 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto Përgjegjësia, nr.04/L-018, i shpallur në Gazetën Zyrtare nr.4, me datën 14 korrik 2011, i cili ka hyrë në fuqi me datën 30 korrik 2011, apo nuk ka përmbushur detyrimin në pajtim me nenin 26, paragrafin 4 për pjesën jo kontestuese të dëmit në formë të paradhënies brenda afatit prej 60 ditësh për dëmet në persona, dhe brenda afatit prej 15 ditësh për dëmet në pasuri. Në çdo rast kur gjykata e gjen të bazuar kërkesën për pagesën e interesit vjetor prej 12%, si periudhë të rrjedhës së kamatës duhet ta marrë datën e paraqitjes së kërkesës për dëmshpërblim.

Arsyetimi për pikën XIII (trembëdhjetë) të mendimit juridik - Banka Qendrore e Kosovës (BQK) si institucion qendror financiar në Republikën e Kosovës, është mbikëqyrëse dhe rregullatore për institucionet financiare kredi-dhënëse, e cila me aktet nënligjore përcakton çështje nga fushë-veprimtaria e këtyre institucioneve. Në këtë kontekst BQK-ja, ka miratuar rregulloren për kamatëvonesën e instrumenteve kreditore në të cilën ka përcaktuar se për pagesat në vonesë të debitorëve ndaj kreditorëve-institucioneve financiare kredi-dhënëse, kamatëvonesa do të llogaritet në procedurën e përcaktuar me akte nënligjore nga BQK, e sipas normës/lartësisë së përcaktuar me kushtet dhe afatet e marrëveshjes përkatëse të instrumentit kreditor, ndaj institucionit financiar përkatës.

Pika 13 e këtij mendimi juridik nuk synon të ndërhyjë në aktivitetet e rregullativës së BQK-së, ndaj institucioneve financiare kredi-dhënëse, por sqaron për gjykatat se në rast kontesti nga marrëdhëniet e tilla kontraktuale kamatëvonesa do të llogaritet në procedurën e përcaktuar me aktet nënligjore të BQK-së, dhe marrëveshjes përkatëse me kontratë.

Arsyetimi për pikën XIV (katërbëdhjetë) të mendimit juridik - Qëndrimi i Gjykatës Supreme i shprehur në pikën XIV (katërbëdhjetë) të këtij mendimi juridik është i ndërlidhur me dispozitën e nenit 70 të LMD-së, me të cilën përcaktohet se: *“Detyrimi i shpërblimit të dëmit konsiderohet se ka arritur, për pagesë që nga momenti i shkaktimit të dëmit”*, dhe rrjedhimisht i lidhur me disponibilitetin e palës së dëmtuar e cila e zgjedhë momentin se kur do të parashtrijë kërkesë për kompensimin e dëmit.

Duke qenë se kamata është kërkesë aksesore kjo nënkupton se është e ndërlidhur me kërkesën kryesore, prandaj, duke iu referuar dispozitës së cituar dhe standardit që kanë të bëjnë me disponibilitetin e palës së dëmtuar për të parashtruar kërkesë për kompensimin e dëmit, apo për të filluar procedurën gjyqësore, Gjykata Supreme e Kosovës, pas analizës së tërësishme të dispozitave ligjore për çështjen e kamatës dhe vlerësimit të praktikës gjyqësore përmes këtij

mendimi juridik ka vendosur si në pikën XIV (katërmbëdhjetë) për sa i përket kohës se kur fillon të rrjedh kamata për dëmin material.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, kamata për dëmin material fillon të rrjedhë nga momenti i parashtrimit të kërkesës për kompensimin e dëmit, dhe në rast të mos parashtrimit të kërkesës në procedurë jashtëgjyqësore, atëherë si moment i fillimit të rrjedhës së kamatës është data e parashtrimit të padisë. Kjo arsyetohet me faktin se është në diskrecionin e palës së dëmtuar që të zgjedhë momentin se kur do të parashtrojë kërkesë për kompensim të dëmit në procedurë jashtëgjyqësore apo padi në gjykatë. Ndërlidhja e rrjedhës së kamatës nga momenti i parashtrimit të kërkesës në procedurë jashtëgjyqësore apo parashtrimit të padisë në gjykatë e eviton rritjen e vëllimit të dëmit të cilën duhet ta paguajë debitori për shkak të veprimit të kreditorit. Kjo për shkak se në disa raste në qoftë se rrjedha e kamatës nuk do të ndërlidhej me parashtrimin e kërkesës në procedurë jashtëgjyqësore, apo me parashtrimin e padisë, do t'i jepte mundësi kreditorit që ta rrit vëllimin e kërkesës kompensuese duke e parashtruar të njëjtën në limitet e parashkrimit të kërkesës. P.sh, në rast se një kërkesë do të parashkruhej brenda afatit prej 3 vitesh, kreditori do të mund ta parashtronte të njëjtën pak kohë para se të parashkruhej kërkesa, dhe në këtë mënyrë do të ndikonte që të akumulohesh intereset vjetor në dëmin e debitorit.

Ky mendim juridik, i Gjykatës Supreme, për sa i përket fillimit të rrjedhës së kamatës për dëmin material përveç se synon që të unifikojë praktikën e gjykatave të nivelit më të ulët, është edhe qëndrim edhe sa i përket praktikës edhe të vetë Gjykatës Supreme, e cila mund të konsiderohet se ndryshon nga praktika e deritanishme. Faktorët që kanë ndikuar në ndryshimin e kësaj praktike, janë të ndërlidhur drejtpërdrejtë me qëllimin e dispozitave ligjore për kompensimin e dëmit material nga neni 169 të LMD-së, e që i referohen rivendosjes së gjendjes së mëparshme dhe shpërblimit të plotë. Në praktikën e deritanishme për dëmin material merret për bazë rivendosja e gjendjes së mëparshme sipas momentit të nxjerrjes së ekspertizës në gjykatë, e cila merrte për bazë çmimet e tregut në kohën e hartimit të ekspertizës dhe nga ky moment fillonte të rridhte kamatëvonesa.

Duke marrë parasysh kohën e gjatë që kalonte prej shkakimit të dëmit e deri në momentin e nxjerrjes së ekspertizës, zakonisht çmimet e tregut për dëmin material lëviznin në dëm të palës së dëmtuar e cila njëkohësisht dëmtohej për shkak të mos shfrytëzimit të sendit, prandaj, Gjykata Supreme e Kosovës, ka vlerësuar se kamatëvonesa për këtë situatë duhet të rrjedhë nga momenti i parashtrimit të kërkesës për kompensim në procedurë jashtëgjyqësore, apo parashtrimit të padisë në gjykatë. Mos shfrytëzimi i sendit përveç të tjerash e justifikon rrjedhën e kamatëvonesës, dhe nuk mund të ndërlidhet në mënyrë klasike me fitimin e munguar për të cilën kërkesë kreditori mund të parashtrojë padi dhe t'a provojë në gjykatë një kërkesë të tillë.

Me pikën 14 të këtij mendimi juridik ka një përjashtim për sa i përket momentit të rrjedhës së kamatës e që i referohet situatës kur pala e dëmtuar e ka mënjeluar vetë dëmin para se të jepet vendimi i gjykatës, e që nënkupton se kamatëvonesa fillon nga dita e mënjanimin të dëmit, përkatësisht nga dita që janë bërë shpenzimet për mënjanimin e dëmit.

Në këtë rast pala e dëmtuar duhet ta provojë në gjykatë se ka mënjanuar vetë dëmin dhe kohën kur e ka mënjanuar dëmin, respektivisht kur janë shkaktuar shpenzimet për mënjanimin e dëmit.

Arsyetimi për pikën XV (pesëmbëdhjetë) të mendimit juridik - Për sa i përket rrjedhës së kamatës për dëmin jo material Gjykata Supreme përmes këtij mendimi juridik në pikën XV (pesëmbëdhjetë) e konfirmon praktikën e kësaj gjykate të krijuar deri tani e cila është unike për Gjykatën Supreme, e që nënkupton se momenti i fillimit të rrjedhës së kamatës për dëmin jo material është dita e nxjerrjes së vendimit gjyqësor në gjykatën e shkallës së parë.

Kjo nënkupton se dëmi jo material për sa i përket vëllimit caktohet sipas masave dhe kriterëve që merren në konsideratë për caktimin e lartësisë së kompensimit në ditën e nxjerrjes së aktgjykimit. Praktikisht mund të thuhet se masat dhe kriteret për caktimin e lartësisë së kompensimit për dëmin jo material me kalimin e kohës evulojnë, dhe praktikisht për situatën e njëjtë mund të diktojnë kompensim me vëllim të ndryshëm në qoftë se do të merrej p.sh. për bazë dita e shkaktimit të dëmit, dita e parashtrimit të padisë, apo dita e nxjerrjes së aktgjykimit.

Në këtë kontekst si rrethanë për përcaktimin e lartësisë së kompensimit për dëmin jo material duhet të merret edhe kohëzgjatja nga shkaktimi i dëmit e deri tek vendosja, gjë që justifikon fillimin e rrjedhës së kamatës nga momenti i nxjerrjes së vendimit gjyqësor në gjykatën e shkallës së parë.

Përveç të tjerave deri tek caktimi i kompensimit për dëmin jo material në shumicën e rasteve është e kuptueshme që duhet të kalojë një periudhë e caktuar nga momenti i shkaktimit të dëmit e deri tek momenti kur mund të konstatohen në mënyrë objektive pasojat e dëmit, prandaj, momenti i nxjerrjes së aktgjykimit është edhe moment i konfirmimit se një lëndim trupor apo formë tjetër e cenimit të personalitetit që në parim nuk përbën një çështje tipike civile valorizohet në një shumë konkrete si satisfaksion dhe rrjedhimisht shërben si moment kur dihet vlera e dëmit.

Arsyetimi për pikën XVI (gjashtëmbëdhjetë) të mendimit juridik - Mendimi juridik në pikën XVI (gjashtëmbëdhjetë) është përjashtim nga pika 14 (katërmëdhjetë) dhe 15 (pesëmbëdhjetë) e këtij mendimi juridik, për shkak se i referohet situatës kur palët kontraktuese me vullnetin e tyre të lirë dhe të shprehur kanë përcaktuar një moment të caktuar prej kur fillon të rrjedhë kamatëvonesa në rast të vonesës së debitorit për ndonjë detyrim të caktuar. Në marrëdhëniet detyrimore vullneti i palëve është përcaktues për efektet që do të krijojë marrëdhënia përkatëse juridike pa përjashtuar këtu edhe çështjen e kamatës, prandaj, në çdo rast kur çështja e kamatës për sa i përket momentit të rrjedhjes së saj është e kontraktuar me kontratë nënkupton se përjashtohet zbatimi i dispozitës ligjore që e rregullon çështjen e njëjtë.

Arsyetimi për pikën XVII (shtatëmbëdhjetë) të mendimit juridik - Mendimi juridik si në pikën XVII (shtatëmbëdhjetë) është përjashtim nga pika 14 (katërmëdhjetë) dhe 15 (pesëmbëdhjetë), për shkak se i referohet kërkesës për pagesën e pagave dhe kërkesave të tjera nga marrëdhënia e punës, e që nënkupton se kamata fillon të rrjedhë nga dita e arritjes për secilën kërkesë veç e veç, pavarësisht nga data kur kërkohet mbrojtja gjyqësore, bëhet vlerësimi me ekspertizë apo nxjerrët vendimi i gjykatës së shkallës së parë.

Kjo mënyrë e vlerësimit të kamatës për secilën kërkesë (pagë) vlen për të gjitha rastet, përveç kur kërkesa është e parashkruar. Arsyetimi për fillimin e kamatës sipas së cilës kërkesë (pagë) arsyetohet me vetë natyrën e kërkesës, e cila është periodike (parimisht mujore), dhe arrin për pagesë veç e veç. Përveç se këto kërkesa arrijnë për pagesa veç e veç, për të njëjtat edhe afati i parashkrimit fillon të rrjedhë për secilën veç e veç. Kërkesa për paga ka edhe një përjashtim tjetër sepse mund të gjykohet edhe për të ardhmen, por nuk mund të ekzekutohet pa arritur, prandaj, në kuptim të arsyeve të theksuara vlerësohet se mendimi juridik është në përputhje me dispozitat ligjore, por edhe me praktikën gjyqësore për këtë çështje. Gjykata Supreme thekson se është e rëndësishme që në çështjet e tilla kontestuese gjykatat të jenë të kujdesshme me rastin e vlerësimit të kërkesave të arritshme për pagesë, dhe të evitojnë mundësinë e zbatimit të kamatës mbi kamatë. Vlerësimi i kamatës për çdo kërkesë veç e veç mund të jetë edhe kompleks (si detyrë e ekspertit), prandaj, moskujdesi me rastin e vlerësimit mund ta përfshijë çështjen në zbatimin e kamatës mbi kamatë.

Arsyetimi për pikën XVIII (tetëmbëdhjetë) të mendimit juridik - Mendimi juridik në pikën XVII (tetëmbëdhjetë) për çështjen lidhur me alimentacion, mbajtjen financiare (*ushqimin*), shpërblimin e dëmit për ushqimin e humbur dhe fitimin e humbur, po ashtu përbën përjashtim. Është përjashtim nga pika 14 (katërmëdhjetë) dhe 15 (pesëmbëdhjetë) e këtij mendimi sepse natyra e kërkesave është periodike (parimisht mujore), të cilat arrijnë për pagesë veç e veç e për të cilat po ashtu fillon të rrjedhë kamata veç e veç nga momenti i arritjes për secilën kërkesë. Arsyetimi në pikën XVII (shtatëmbëdhjetë) vlen edhe për pikën XVIII (tetëmbëdhjetë) të këtij mendimi juridik.

Arsyetimi për pikën XIX (nëntëmbëdhjetë) të mendimit juridik - Mendimi juridik në pikën XIX (nëntëmbëdhjetë) për çështjen e masave pasurore për mbrojtjen nga dhuna në familje po ashtu përbën përjashtim nga pika 14 (katërmëdhjetë) dhe 15 (pesëmbëdhjetë) e këtij mendimi sepse i referohet kryesisht kërkesave periodike si qiraja, alimentacioni apo mbajtja financiare, të cilat arrijnë për pagesë veç e veç e për të cilat po ashtu fillon të rrjedhë kamata veç e veç nga momenti i arritjes për secilën kërkesë.

Arsyetimi në pikën XVII (shtatëmbëdhjetë) vlen edhe për pikën XIX (nëntëmbëdhjetë) të këtij mendimi juridik, me një përjashtim se në rastin e kërkesave pasurore nga mbrojtja në rastet e dhunës në familje, kërkesat nuk kanë ekzistuar më pare, por lindin nga momenti i kryerjes së aktit të dhunës, ndërsa ekzekutohen nga momenti i caktimit me vendimin e gjykatës.

Arsyetimi për pikën XX (njëzet) të mendimit juridik - Në pikën XX (njëzet) të këtij mendimi juridik rikonfirmohet se në praktikën gjyqësore duhet të përjashtohet çdo mundësi e zbatimit të kamatës mbi kamatë. Kjo nënkupton se në kamatën e kontraktuar e cila ka arritur për pagesë por nuk është paguar nuk rrjedhë kamatëvonesa, përveç nëse është paraparë ndryshe me ligj.

Palët kontraktuese nuk janë të penguara që me kontratë të përcaktojnë se shkalla e kamatës do të jetë më e lartë në rast se debitori nuk i paguan kamatat e rrjedha për pagesë në kohën e duhur. Përveç të tjerash duhet theksuar se për detyrimet në të holla në rast të vonesës së debitorit për pagesën e kamatave sipas rrjedhës së paraparë mund të kontraktohet kamatë më e lartë, por nuk mund të kontraktohen dënime kontraktuale të cilat me dispozitat e Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve vlejné për vonesat e debitorit në përmbushjen e detyrimeve jo në të holla.

Sipas dispozitave ligjore nga neni 379, paragrafi 4 të LMD-së, lejohet që në shumën e papaguar të kamatës të kërkohet kamatëvonesa vetëm nga dita kur gjykatës i është paraqitur kërkesë për pagimin e saj. Kjo nënkupton se shuma e papaguar e kamatës është shndërruar në borxh kryesor mbi të cilën mund të aplikohet kamatëvonesa pas parashtrimit të kërkesës në gjykatë.

Arsyetimi për pikën XXI (njëzete e një) të mendimit juridik - Mendimi juridik në pikën 21 i referohet supozimit të kontratës me fajde e cila mund të kualifikohet si e tillë për shkak të lartësisë së kamatës së kontraktuar.

Me dispozitën e nenit 381 të LMD-së, është rregulluar çështja e supozimit të kontratës me fajde për shkak të lartësisë së kamatës dhe që nënkupton situatën kur niveli i kamatëvonesës së kontraktuar është për 50%, më i lartë se niveli i kamatëvonesës. Praktikisht kjo nënkupton se lartësia e kamatëvonesës sipas dispozitës së nenit 382 paragrafi 2 të LMD-së, është 8%, ndërsa kur kamatëvonesa është për 50% më e lartë arrin në nivelin prej 12%, ashtu që në rastin kur kamatëvonesa e kontraktuar është mbi 12%, futet në zonën e supozimit të kontratës me fajde.

Është e rëndësishme të theksohet se kamata e kontraktuar mbi 12%, në mënyrë automatike nuk nënkupton supozim të kontratës me fajde sepse nëse kreditori e provon para gjykatës se me rastin e kontraktimit të kamatëvonesës nuk e ka shfrytëzuar gjendjen e pavolitshme të debitorit, vështirësinë e situatës së tij financiare, pamaturinë apo varësinë e krijuar prej saj, ose që përfitimet e rezervuara për kreditorin ose personin e tretë nuk janë në shpërpjesëtim me atë që kreditori ka ofruar, ose ka ndërmarrë të ofrojë, ose të bëjë një kontratë të tillë, nuk supozohet si kontratë me fajde.

Në procedurë gjyqësore është e thjeshtë të kalkulohet niveli i kamatëvonesës së kontraktuar mbi 50% më e lartë se niveli i kamatëvonesës, mirëpo është mjaftë sfiduese që gjykata të vlerësojë rrethana të tjera që kanë të bëjnë me gjendjen e pavolitshme të debitorit etj, për të vlerësuar nëse çështja kualifikohet si kontratë me fajde. Në këtë kontekst sugjerohet që gjykata në mënyrë objektive t'i shqyrtojë dhe vlerësojë pretendimet e palëve ndërgjyqësore dhe me mjetet e përshtatshme provuese të konstatojë rrethanat nëse kontrata supozohet me fajde apo jo.

Arsyetimi për pikën XXII (njëzet e dy) të mendimit juridik - Mendimi juridik i Gjykatës Supreme për kamatën nuk përfshin kamatëvonesa në transaksionet tregtare, e rregulluar me Ligjin nr.05/L-100 për Kamatë-Vonesat në Transaksionet Tregtare, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.38/21 Nëntor 2016, dhe kamatëvonesa për shpronësimin e pronës së paluajtshme, e rregulluar me Ligjin Nr.03/L-139, për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.52/08 Maj 2009.

(Mendim juridik i miratuar në seancën e përgjithshme të Gjykatës Supreme, i mbajtur më 01.12.2020)



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 26, paragrafi 1. pika 1.4 të Ligjit për Gjykatat, Ligji Nr. 06/L-054, në Seancën e Përgjithshme, të mbajtur më datë 07 nëntor 2022, me shumicë votash, miratoi këtë:

QËNDRIM PARIMOR

Në kontestet e punës, në të cilat punëtorit i është ndërprerë marrëdhënia e punës për shkelje të detyrave të punës, në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr.2001/27 të datës 8 tetor 2001 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë, përkitazi me çështjen e fillimit, zhvillimit dhe përfundimit të procedurës disiplinore, nuk zbatohen dispozitat e Ligjit të Punës të Jugosllavisë i vitit 1977 me amendamentet përkatëse, dispozitat e Ligjit mbi marrëdhëniet e punës të KSA të Kosovës (Gazeta zyrtare nr. 24/22 qershor 1984), dhe Ligjit për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për marrëdhëniet e punës (Gazeta zyrtare e KSA të Kosovës nr. 14/1987 datë 24 prill 1987) e as dispozitat e Ligjit të mëvonshëm për marrëdhëniet e punës i KSA të Kosovës – gazeta Zyrtare nr.12/1989 datë 14 prill 1989, i cili nuk ishte në fuqi më datën 22 mars 1989, në të cilën datë referon Rregullorja e UNMIK-ut nr.1999/24, datë 12 dhjetor 1999 e cila në nenin 1.1 pika b, parasheh si Ligj të zbatueshëm në Kosovë legjislacionin i cili ishte në fuqi në Kosovë më 22 mars 1989.

Mirëpo në rastet e tilla të ndërprerjes së marrëdhënies së punës për shkak të shkeljes së detyrave të punës, nëse tek punëdhënësi me rregullore të brendshme parashihet zhvillimi i procedurës disiplinore, ata punëdhënës janë të obliguar që t'i respektojnë dhe zbatojnë këto rregullore përkitazi me procedurën disiplinore.

Lidhur me afatshmërinë për të kërkuar mbrojtje gjyqësore e cila çështje nuk është e rregulluar me dispozitat e Rregullores së UNMIK-ut nr.2001/27 të datës 8 tetor 2001 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë, do duhej zbatuar neni 178, 179 dhe 181 të Ligjit mbi punën e bashkuar, Gazeta zyrtare e RSFJ nr.11/1988 datë 10 shkurt 1988 ku parashihet ankimimi intern brenda organeve të punëdhënësit dhe në gjykatë, si dhe afatshmëria e kërimit të mbrojtjes së të drejtave nga marrëdhënia e punës tek punëdhënësi dhe në gjykatë.

Ar sy e t i m

Me dispozitat e Rregullores së UNMIK-ut nr.2001/27 të datës 8 tetor 2001 për Ligjin Themelor të Punës, prej nenit 9 deri në nenin 12, marrëdhënien e punës së punëtorit e parasheh si marrëdhënie kontraktuale midis punëdhënësit dhe punëtorit, dhe parasheh rastet kur shkëputet kontrata e punës: neni 11.1 (pika a, b, ç, d, e, dhe f); rastet e rënda të sjelljes së keqe të punëtorit neni 11.2 dhe 3, dhe procedurën përkatëse të ndërprerjes së marrëdhënies së punës në këto raste, si dhe shkëputjen e kontratës së punës për shkak të ndryshimeve ekonomike, teknologjike ose strukturale në ndërmarrje. Nga kjo rezulton se me këtë Rregullore nuk parashihet fare zhvillimi i procedurës disiplinore në rastet e shkëputjes së marrëdhënies së punës për shkak të rasteve të rënda të sjelljes së keqe nga punonjësi, por mjafton që në këto raste sipas nenit 11.5 pika a dhe b, të kësaj Rregulloreje punëdhënësi ta njoftoi punonjësin me shkrim për qëllimin e tij për ta ndërprerë kontratën e punës, i cili njoftim duhet të përmbajë edhe shkaqet për shkëputjen e kontratës së punës, dhe që punëdhënësi do të mbajë një takim me punonjësin me ç’rast punëdhënësi ia shpjegon me gojë punonjësit shkaqet e shkëputjes së kontratës. Në atë takim punonjësi ka të drejtë që të kërkojë të jetë i pranishëm edhe një përfaqësues i sindikatës. Mirëpo në rast të ndërprerjes së marrëdhënies së punës për shkak të shkeljes së detyrave të punës, nëse tek punëdhënësi me rregullore të brendshme parashihet zhvillimi i procedurës disiplinore, ata punëdhënës janë të obliguar që t’i respektojnë dhe zbatojnë këto rregullore përkitazi me procedurën disiplinore.

Meqë kjo Rregullore për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë nuk përmban fare dispozita për ankimim ndaj vendimeve të punëdhënësit për ndërprerje të marrëdhënies së punës e as për afatshmërinë e paraqitjes së ankesave ndaj këtyre vendimeve, në njërën anë, kurse në anën tjetër e drejta e punonjësit për t’u ankuar ndaj këtyre vendimeve është e drejtë fundamentale e njeriut e garantuar me nenin 32 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, atëherë bazën ligjore për ankimim dhe afatshmëri të kërimit të mbrojtjes interne brenda organeve të punëdhënësit dhe në gjykatë, duhet kërkuar në legjislacionin në fuqi sipas Rregullores së UNMIK-ut nr.1999/24 datë 12 dhjetor 1999 e cila në nenin 1.1 pika b, parasheh si Ligj në fuqi në Kosovë legjislacionin i cili ishte në fuqi në Kosovë më 22 mars 1989.

Në nenin 178, 179 dhe 181 të Ligjit mbi punën e bashkuar, Gazeta zyrtare e RSFJ nr.11/1988 datë 10 shkurt 1988 parashihet ankimimi intern brenda organeve të punëdhënësit dhe në gjykatë, si dhe afatshmëria e kërimit të mbrojtjes së të drejtave nga marrëdhënia e punës tek punëdhënësi dhe në gjykatë. Këto dispozita që duhet zbatuar në rastet e sipër përmendura ishin në fuqi deri më datën 14.10.1989 kur ka hyrë në fuqi Ligji për të drejtat themelore nga marrëdhënia e punës Gazeta Zyrtare e RFJ nr. 60/89 i cili me nenin 92 të tij shfuqizon këto dispozita si dhe disa dispozita tjera të Ligjit mbi punën e bashkuar.

(Qëndrim Parimor, i miratuar në Seancën e Përgjithshme të Gjykatës Supreme, mbajtur me datë 07.11.2022)

**UDHËZUES TË GJYKATËS SUPREME TË
KOSOVËS**



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 26, paragrafi 1. pika 1.4 të Ligjit për Gjykatat, Ligji Nr. 06/L-054, në Seancën e Përgjithshme, të mbajtur më datë 10 qershor 2021, me shumicë votash, miratoi këtë:

UDHËZUES I VEÇANTË

KORRUPSIONI ZYRTAR DHE VEPRAT PENALE KUNDËR DETYRËS ZYRTARE

Hyrje

Ryshfeti dhe korrupsioni janë të dëmshme për institucionet demokratike. Ato dekurajojnë investimet dhe minojnë përpjekjet e qytetarëve për të arritur nivel më të lartë të mirëqenies ekonomike, sociale dhe mjedisore dhe pengojnë përpjekjet për të zvogëluar varfërinë.

Ndjekja dhe gjykimi i korrupsionit është përpjekje e vështirë dhe shumë sfiduese. Kjo vështirësi vjen për shkak të natyrës së fshehtë të korrupsionit dhe në shumicën e rasteve, mosparaqitjes së individëve si viktimë potenciale të cilat do të jepnin informacion rreth akteve korruptive që do të përdreshin për inicim të hetimeve. Në përpjekje për të zbuluar rastet e ryshfetit, personat mund t'i frikësohen hakmarrjes nga i akuzuari, veçanërisht kur ai raportim çon në fillimin e hetimit dhe potencialisht edhe dënimin e kryesit. Derisa ofrimi i ryshfetit ndaj zyrtarit publik, konsiderohet vepër e rëndë, në rastet kur një zyrtar publik merr ose kërkon ryshfet, kjo e dëmton rëndë besimin e publikut në institucione.

Vështirësi të veçanta lindin kur hetimi përfshin politikanë të shquar dhe biznesmenë të pasur. Hetimi i rasteve të profilit të lartë shpesh karakterizohet nga shkallë e lartë e sofistikimit në lidhje me metodat e kryerjes dhe kamuflimit të veprave penale. Shumë shpesh, kriminaliteti i “jakave të bardha” mund të duket si i padëmshëm dhe në sipërfaqe pa viktimë të dukshme. Mirëpo, ai është gjithçka tjetër përveç kësaj. E gjithë shoqëria jonë, është viktimë kur zyrtarët publik shkelin besimin e dhënë atyre.

Zbatimi i Udhëzuesit dhe kuadri legjislativ

Në përputhje me nenin 26, paragrafin 1.4 i Ligjit për Gjykatat,³¹ Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, sipas rekomandimit të Komisionit këshillëdhënës për politikën ndëshkimore miraton udhëzimet e mëposhtme specifike lidhur me korrupsionin zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare.

Udhëzuesi parashih pikënisje specifike, rrethana përkatëse lehtësuese dhe rënduese për veprat penale nga ky kapitull, si dhe dënime të tjera alternative dhe plotësuese. Ky Udhëzues nuk ka për qëllim të zëvendësojë Udhëzuesin e përgjithshëm të vitit 2018 apo Udhëzuesin për shqiptimin e gjobave penale të vitit 2020, por për t'i plotësuar ato duke hyrë në detaje të specifikave të veprave të kësaj natyre. Andaj edhe parimet dhe konceptet e Udhëzuesve të mëparshëm vazhdojnë të aplikohen edhe për veprat nga ky Kapitull.

Ky Udhëzues specifik është kryesisht i bazuar në veprat penale sipas Kapitullit XXXIII, Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Megjithatë, konceptet dhe parimet e përfshira në këtë dokument vlejné edhe për dispozitat e tjera të këtij Kodi, të cilat i referohen keqpërdorimit të detyrës zyrtare, si për kodet e mëparshme penale, të cilat janë të zbatueshme për veprat penale të kryera në kohën kur ato kode ishin në fuqi. Ky udhëzues vlen edhe për legjislacionin tjetër penal të rëndësishëm për çështjet e caktimit të dënimit për forma të ndryshme të keqpërdorimit të detyrës zyrtare.

Disa nga elementet kyçe të veprave penale kundër detyrës zyrtare

Për të kuptuar më qartë veprat e sanksionuara në Kapitullin XXXIII është i domosdoshëm edhe qartësimi i disa prej elementeve kyçe të këtyre veprave. Për disa nga elementet janë dhënë përkufizime tashmë si në Kodin penal ashtu edhe në komentare të ndryshëm që shtjellojnë këto përkufizime andaj edhe nuk do synohet përsëritja e tyre por vetëm shtjellimi më specifik i elementeve në kontekst të veprave nga ky kapitull.

Personi zyrtar

Për dallim nga kodet e mëparshme, KPRK i vitit 2019 jep një përkufizim më të detajuar për atë se kush konsiderohet person zyrtar. Përkufizimi i tillë është i përfshirë në Nenin 113 Par.2. të këtij Kodi dhe atë si në vijim:

Person zyrtar - nënkupton:

1.1 personi i cili në organin shtetëror kryen punët zyrtare;

³¹Ligji nr.06 / L-054 për Gjykatat, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, 18 dhjetor 2018.

1.2 personi i zgjedhur, i emëruar ose i caktuar në organin shtetëror, në organin e pushtetit lokal ose personi që përherë ose përkohësisht kryen detyrat zyrtare ose funksionet zyrtare në ato organe;

1.3 personi në institucion, ndërmarrje ose në ndonjë subjekt tjetër, të cilit i janë besuar kryerja e autorizimeve publike, që vendos për të drejtat, obligimet ose interesat e personave fizik apo juridik ose për interesin publik;

1.4 person zyrtar konsiderohet edhe personi të cilit i është besuar kryerja faktike e detyrave të caktuara zyrtare apo punëve;

1.5 person ushtarak përpos kur janë në pyetje dispozitat e Kreut XXXIII (Veprat penale kundër detyrave zyrtare) të këtij Kodi.

Nuk ka ndonjë definicion të veçantë se kush mund të cilësohet si person zyrtar dhe kjo duhet të vlerësohet në çdo rast individualisht, duke marrë parasysh natyrën e pozitës, funksionit dhe me theks të veçantë detyrave të kryera nga ai person . Kjo për faktin se Republika e Kosovës ka një numër jashtëzakonisht të madh të ligjeve të veçanta që rregullojnë fusha shumë specifike andaj edhe të njëjtat mund të përfshijnë detaje më të zbërthyer sesa te ato që mund të gjenden në kuadër të përkufizimeve të përgjithshme. Po ashtu, duhet pasur parasysh se varësisht se për cilën veprë penale brenda këtij Kapitulli është fjala, atëherë mund të paraqitet nevoja që për të plotësuar atë përkufizim duhet të shohim se si janë adresuar ato çështje edhe me ligje apo dispozita tjera të veçanta. Kur flasim për personin zyrtar duhet kuptuar se cilësimi si person zyrtar ndërthen në vete jo vetëm personin zyrtar si subjekt aktiv, por edhe si subjekt pasiv. Pra, bashkë me mbrojtjen shtesë që u ofron legjislacioni këtyre personave zyrtar vije edhe përgjegjësia shtesë për çfarëdo keqpërdorimi të detyrave dhe autorizimeve që iu janë mveshur.

Person zyrtar mund të konsiderohet vetëm ai individ i cili në mënyrë të drejtpërdrejt (duke qenë i punësuar në institucione publike) apo të tërthortë (person i cili mund të ushtrojë funksion jashtë institucioneve publike) kur të njëjtit i janë deleguar autorizime publike, menaxhimi i parasë publike apo ushtrimi faktik i detyrave/punëve zyrtare. Në momentin që menaxhon me të mirat publike, nuk ka rëndësi pozita që e mban, me rëndësi është që i ka keqpërdor mjetet publike, respektivisht që ka keqpërdor autorizimet dhe detyrat apo punët zyrtare të cilat i ushtron në mënyrë faktike. Persona zyrtar nuk konsiderohen personat që menaxhojnë me të mira apo kapital privat, përveq kur të njëjtëve iu janë deleguar autorizime publike siç është sqaruar më poshtë.

Për të konstatuar nëse një person i cili ka statusin e personit zyrtar ka keqpërdorur detyrën zyrtare duhet shikuar nëse ai person ka përdorur detyrat dhe autorizimet që ka për qëllime tjera nga ato që i janë lejuar sipas funksionit, respektivisht detyrës.

Për situatat kur edhe përkundër shkresave të lëndës dhe shpjegimeve të mëposhtme rreth këtij përkufizimi, ka ende paqartësi nëse një person konsiderohet person zyrtar në kuptim të Kodit penal, rekomandohet që gjyqtari të shqyrtojë dhe analizojë ligjet e veçanta që rregullojnë

lëminë apo çështjen në fjalë me qëllim të konstatimit nëse një person është person zyrtar apo jo, bazuar në natyrën e autorizimit apo edhe punët faktike që ai person mund të kryejë apo edhe autorizimet që mund të keqpërdorë. Më poshtë do të japim disa shembuj vetëm si ilustrim në këtë aspekt.

Sipas asaj si është rregulluar ky përkufizim më sipër, është me rëndësi të bëhet domosdoshmërisht një zbërthim i elementeve të mëposhtme:

1. **Pozitën që mban personi** - Personi në organin shtetëror, organin e pushtetit lokal, institucionin, ndërmarrjen ose subjektin tjetër. Me një fjalë këta janë zyrtarët shtetëror, anëtarët e bordeve të ndryshme, personat që kryejnë detyra zyrtare administrative, profesionale etj. Legjislacioni ynë vendor parasheh kryesisht autorizimet e institucioneve, autoriteteve dhe organeve publike dhe jo atë të personave që punojnë në to. Andaj është e domosdoshme të bëhet një zbërthim i asaj se çfarë nënkuptojmë me institucion, autoritet apo organ publik për të zbërthyer më tutje nëse të punësuarit në këto institucione konsiderohen person zyrtar. Natyrisht, për shkak të fragmentarizimit të rregullimit të çështjeve të ngjashme në ligje të shumta në Republikën e Kosovës, zakonisht, analiza duhet bazuar në ligjet relevante dhe se si ato e plotësojnë njëra-tjetrën për të kuptuar qartë këtë çështje.

- Sipas Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, “*Autoritet Publik*”- do të thotë secilën nga vijueset: (i) një organ, autoritet apo agjenci publike e cila në bazë të një ligji ose Rregulloreje të UNMIK-ut ushtron kompetenca ekzekutive, legjislative, rregullative, administrative-publike apo gjyqësore, dhe përfshin (ii) departamentet apo pjesët ose nën njësitë e këtij organi apo autoriteti publik;”⁴² Përderisa janë të qarta pothuajse të gjitha kompetencat e sipërpërmendura që një organ mund të ketë, e vetmja dilemë në këtë definicion është se çfarë nënkuptohet me kompetencë administrative-publike dhe nëse shërbimet publike përfshihen në këtë definim? Një gjë e tillë nuk është e sqaruar në ligjin e sipërpërmendur. Megjithatë sipas Ligjit për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore⁵ në kuadër të funksionit administrativ janë të përfshira:
 - **Funksioni i hartimit të politikave** (përgatitja e politikave publike, hartimi i akteve ligjore, miratimi i akteve nënligjore dhe përcaktimi i standardeve të detyrueshme);
 - **Funksioni i dhënies së shërbimeve publike** (veprimtaria e ofrimit të shërbimeve apo e prodhimit të të mirave materiale, të përcaktuara me ligj si shërbime publike, për të cilat Qeveria apo një komunë ka detyrimin ligjor t’i ofrojë apo të sigurojë për qytetarët e Republikës së Kosovës, siç janë shërbimi shëndetësor publik, arsimi publik, furnizimi me ujë, pastrimi i ujërave të ndotura, mbledhja e mbeturinave apo shërbime të tjera në fushën e kulturës, rinisë, artit, përkujdesjes shoqërore, etj.);
 - **Funksioni i zbatimit të politikave** (është zbatimi i legjislacionit, politikave dhe dhënia e shërbimeve publike); dhe

⁴ Ligji Nr. 03/L-048, për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Neni 1.par.1, Gazeta Zyrtare e Republikës Së Kosovës / Prishtinë: Viti Iii / Nr. 27 / 03 Qershor 2008.

⁵ Ligji Nr. 06/L -113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, Neni 2 Përkufizimet, Gazeta Zyrtare e Republikës Së Kosovës / Nr. 7 / 01 Mars 2019, Prishtinë.

- **Funksioni i brendshëm mbështetës** (menaxhimi i burimeve njerëzore, menaxhimin financiar, menaxhimin e përgjithshëm të pronave, të pasurisë, teknologjisë informative, logjistikës, auditim, si dhe të funksioneve të tjera të ngjashme mbështetëse, që bëjnë të mundur funksionimin normal të institucioneve).
- Sa i përket ndërmarrjeve siç përmendet në par. 2.3 sugjerohet që të shikohet si referencë lista e ndërmarrjeve publike të parapara me **Ligjin për Ndërmarrjet publike**.⁶
- **Ligji për procedurën e përgjithshme administrative**⁷ nga ana tjetër referohet në termin “organ publik” dhe autoritetin publik të këtij organi kur: vendos për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave, si dhe çdo rast tjetër kur ligji parashikon shprehimisht nxjerrjen e një akti administrativ, ose
- lidh një kontratë administrative, ose
- zbaton kompetencat e veta përmes akteve reale, që kanë të bëjnë me të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave.

Sipas po të njëjtit nen, “Ky ligj zbatohet, gjithashtu, kur çdo entitet tjetër publik apo person privat, bartës i autoritetit publik, sipas një autorizimi të shprehur me ligj ose në bazë të ligjit, duke vepruar në realizimin e këtij autoriteti, vendos në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni.”⁸ Ky rregullim në paragrafin e mësipërm lidhet edhe me elementin e 2-të të mëposhtëm që ka të bëjë me llojin e autorizimit që i jepet një personi.

2. **Llojin e autorizimit që ka ai person** - Personi që ka kompetencë dhe autorizim për ruajtjen dhe mbrojtjen e të mirave publike, që në kuadër të organit shtetërorë kryen detyra zyrtare, vendos për të drejtat, obligimet ose interesat e individëve ose për interesin publik.

Siç u tha edhe më lart, paragrafi i mësipërm sqaron çështjen e autorizimit për entitetet publike por edhe për personat privat të mveshur me autorizime publike. Edhe Ligji për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore ka paraparë po ashtu mundësinë që “Administrata shtetërore mund të delegojë ushtrimin e detyrave të caktuara për realizimin e funksioneve administrative sipas këtij ligji, personave fizikë apo juridikë fitimprurës dhe jofitimprurës... Delegimi mund të bëhet vetëm për fushat e përcaktuara shprehimisht nga legjislacioni në fuqi për partneritetin publik privat apo nga legjislacioni tjetër i veçantë.”⁹ Edhe pse fushëveprimi i këtij Ligji është Administrata shtetërore e cila përbëhet nga struktura hierarkike të organizuara.

⁶ Ligji Nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 31 / 15 Qershor 2008, Prishtinë.

⁷ Ligji Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Neni 2 Fushëveprimi, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 20 / 21 Qershor 2016, Prishtinë

⁸ Ibid. par.2.

⁹ Ligji Nr. 06/L -113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, Neni 33, Delegimi i detyrave , par.1 dhe 2, Gazeta Zyrtare e Republikës Së Kosovës / Nr. 7 / 01 Mars 2019, Prishtinë.

nën drejtimin, kontrollin dhe mbikëqyrjen e Qeverisë,¹⁰ megjithatë ky nen, kombinuar dhe krahasuar me paragrafin 2 të nenit 2 të Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative, na jep të njëjtin konstatim për të gjitha organet publike dhe personat që u delegohen këto autorizime publike.

Nëse p.sh. i referohemi Përmbauesit privat, sipas Ligjit për procedurën përmbaimore¹¹ më saktësisht në Nenin 2 par.1.11 të këtij Ligji Përmbaues privat është *“personi fizik i emëruar nga Ministri i Drejtësisë në pajtim me dispozitat e këtij ligji, i cili në kryerjen e autorizimeve publike të besuara sipas këtij ligji, vendos për veprimet nga kompetenca e tij në zbatimin e përmbaimit të lejuar dhe ndërmerr veprime për përmbaimit.”* Siç shihet nga kjo dispozitë është e qartë se përmbauesi privat bie në përkufizimin e personit zyrtar siç është paraparë në veçanti me par.2.3 të nenit 113. Qartazi sipas po të njëjtës logjikë, këtu hyn edhe zëvendësi i përmbauesit privat dhe personat e autorizuar nga përmbauesi privat të cilët veprojnë në emër dhe për llogari të përmbauesit privat. Roli i përmbauesit është jashtëzakonisht i madh duke qenë se të njëjtit sipas Nenit 340 kanë për detyrim *“... të kryej obligimet zyrtare për të cilat është i autorizuar në territorin e Gjykatës themelore për të cilin është emëruar.”*

Një tjetër shembull është rasti i gjeodetëve të cilët sipas Ligjit për kadastrin¹² dhe Udhëzimit Administrativ për licencimin e kompanive gjeodete dhe të gjeodetëve¹³ ushtrojnë funksion publik. Ky konstatim gjendet në Nenin 6 par.1 të këtij Ligji ku thuhet; *“Me rastin e kryerjes së funksionit publik, kompanitë e licencuara dhe gjeodetët e licencuar i kryejnë përgjegjësitë e tyre në bashkëpunim me AKK-në dhe ZKK-në.”* Për të forcuar tutje këtë qëndrim shikuar Udhëzimin Administrativ në fjalë, më saktësisht në Nenin 23 par.1.3 si arsye për pushimin e personit fizik të licencuar merret kur *“kur me aktgjykim të formës së prerë të gjykatës është dënuar për veprën penale përvetësim në detyrë apo.”* Pra edhe përmes kësaj rregullative nënligjore është konsideruar pa dyshim se gjeodetët e licencuar janë persona zyrtarë, kjo për faktin se të njëjtit ushtrojnë funksion publik, respektivisht punë kadastrale dhe gjeodezike me ndikim në të drejtat, obligimet ose interesat e personave fizik apo juridik ose për interesin publik siç e kërkon edhe par.2.3 i përkufizimit të personit zyrtar sipas Nenit 113 të Kodit Penal.

Logjika e njëjtë sikurse në rastin e gjeodetëve është edhe me noterët. Edhe sipas Ligjit për noterinë¹⁴ thuhet se shërbimi i noterisë është shërbim publik¹⁵ dhe një nga arsyet e parapara për pushimin e shërbimit të noterit është edhe nëse i njëjti dënohet për veprën penale të përvetësimit në detyrë¹⁶.

¹⁰ Ibid. neni 8 par.2.

¹¹ Ligji nr. 04/L-139 për Procedurën përmbaimore, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 3 / 31 Janar 2013, Prishtinë.

¹² Ligji nr.04/L0-13 për Kadastrë, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 13 / 1 shtator 2011, Prishtinë.

¹³Udhëzimi Administrativ nr.13 për licencimin e kompanive gjeodete dhe të gjeodetëve, Ministria e Mjedisit dhe planifikimit hapsinor, 21.11.2019.

¹⁴ Ligji nr.06/L-010 për Noterinë, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Nr.23 / 26 dhjetor 2018, Prishtinë.

¹⁵ Ibid. Neni 2 par.1

¹⁶ Ibid. Neni 22 par.1.4

3. **Formën si personi merr autorizimin për kryerje të detyrave të mësipërme -** Personi mund të ushtrojë përkohësisht ose përherë funksionet dhe detyrat e mësipërme duke qenë: person i zgjedhur, i emëruar, i caktuar, i autorizuar apo duke iu besuar të njëjtat në çfarëdo forme. Nisur p.sh. nga Ligji për ndërmjetësimin¹⁷ është e rëndësishme të zërthejmë detyrat e ndryshme që ushtron ndërmjetësuesi. Sipas këtij Ligji, më saktësisht Nenit 8 par.1, janë katër forma se si ndërmjetësuesi angazhohet në ndërmjetësim. Tre nga këto kanë të bëjnë me referimin e lëndës nga: Gjykata, Prokurori apo organi kompetent administrativ, ndërkaq forma e katërt ka të bëjë me vet-inicimin nga ana e palëve. Gjersa për tre format e para të inicimit, situata është më e qartë duke qenë se ndërmjetësuesi autorizohet nga institucioni përkatës për kryerjen e ndërmjetësimit e me këtë nënkuptohet pra një punë/detyrë zyrtare, dilema mund të ngriten në rastet kur kemi të bëjmë me vet-inicimin duke qenë se ky proces kryhet nga ndërmjetësuesi privat mes **dy palëve private** të cilat nuk kanë inicuar ndonjë procedurë para këtyre organeve. Megjithatë, edhe në këtë rast duhet pasur parasysh se me rastin e përfundimit të procedurës ky dokument bëhet dokument përmbarues dhe nëse i njëjti ka të bëjë me të drejtat, obligimet ose interesat e personave fizik apo juridik atëherë i bie që kjo detyrë hyn në kuadër të par.2.3. të përkufizimit të personit zyrtar.

Një nga risitë e Kodit penal të vitit 2019 ka të bëjë me ushtrimin faktik të detyrave të caktuara zyrtare apo punëve në par.2.4. Kjo nënkupton që për të vlerësuar statusin e një personi zyrtar nuk është e domosdoshme të ketë një kërkesë formale p.sh. vendim apo diçka të ngjashme, por mjafton që në kuadër të pozitës ose autorizimeve të caktuara të ushtrojë faktikisht detyra të caktuara zyrtare të karakterit publik. Në këtë kontekst është me rëndësi të përmendet se par.2.4 i këtij neni pra duhet të lexohet i ndërlidhur me ndonjërin nga paragrafët paraparak (2.1-2.3) dhe atë sa i përket detyrave që ata ushtrojnë në organet shtetërore, pushtetin lokal, apo detyrave tjera për interesin publik. Qëllimi i kësaj dispozite është që përpos formave të përfshira në më sipër të përfshihet edhe cilado formë tjetër përmes së cilës një zyrtar mund të caktohet në kryerjen e detyrave të mësipërme. Kjo edhe për të mos lënë ndonjë mundësi shmangie në titullin që një personi i jepet mundësia të ushtrojë një punë zyrtare.

Shembujt e dhënë më sipër nuk japin një listë shteruese mbi atë se kush mund të konsiderohet person zyrtar, por ofrohen me qëllimin për të sqaruar logjikën e konstatimit nëse një person konsiderohet person zyrtar.

Vlen të theksohet se për veprat penale nga nenet 414, 416, 417, 418, 419, 421, 425, 426, 427, 428, 429 dhe 430 nga Kapitulli XXXIII Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare kërkohet që fillimisht të përcaktohet statusi i personit zyrtar, kurse e njëjta kërkesë nuk vlen për veprat penale nga nenet 415, 420, 422, 423 dhe 424.

¹⁷ Ligji nr.06/L-009 për ndërmjetësim, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr.14/ 20 gusht 2018, Prishtinë.

Përgjegjësia penale

Neni 17 i KPRK jep përkufizimin si në vijim:

- 1. Kryesi i veprës penale është penalisht përgjegjës nëse është mendërisht i aftë dhe veprën penale e ka kryer me dashje apo nga pakujdesia.*
- 2. Një person është penalisht përgjegjës për veprën penale të kryer nga pakujdesia vetëm nëse këtë shprehimisht e përcakton ligji.*

Elementet subjektive të dashjes dhe qëllimit të kryerjes së veprës vijnë në shprehje në shumicën e veprave në kapitullin XXXIII të KPRK. Për këtë shkak, është shumë me rëndësi që këto elemente të kuptohen dhe argumentohen qartë në përcaktimin e Përgjegjësive së kryesit. Këto elemente vijnë në shprehje si në veprat e kryera me veprim ashtu edhe mosveprim.

Është karakteristike e këtyre veprave penale kundër detyrës zyrtare se të njëjtat konsiderohet se janë kryer vetëm nëse janë kryer me dashje apo dijeni dhe me qëllim të caktuar. Kjo është e nënkuptueshme kur të kemi parasysh p.sh., veprën penale Keqpërdorimin e pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414, pasi zakonisht nënkupton veprim të vullnetshëm të paligjshëm të kryer nga personat zyrtar, të përcjell si rregull, me qëllim të përfitimit për vete apo për të tjerë, respektivisht për t'i shkaktuar tjetrit dëm. Nga të gjitha veprat në këtë Kapitull, është vetëm në nenin 426 Zbulimi i fshehtësisë zyrtare, ku Kodi parasheh në mënyrë decidive që kryesi do të dënohet edhe kur vepra e tillë është kryer nga pakujdesia.

Dashja

Neni 21 i KPRK

- 1. Vepra penale mund të kryhet me dashje direkte ose eventuale.*
- 2. Personi vepron me dashje direkte kur është i vetëdijshëm për veprën e vet dhe e dëshiron kryerjen e saj.*
- 3. Personi vepron me dashje eventuale kur është i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit ose i mosveprimit të tij dhe ai pranon shkaktimin e saj.*

Dashja paraqet formën bazë të fajit së bashku me pakujdesinë. Dashja paraqet raportin psikik të kryesit ndaj veprës. Ky raport shprehet në vetëdijen dhe vullnetin e kryesit. Dashja ekziston kur kryesi ka pasur parasysh pasojat, ka qenë i vetëdijshëm që me veprimet e veta mund të shkaktoi pasojën, pa marrë parasysh nëse e ka dashur apo jo një pasojë të tillë.

Tek keqpërdorimi i detyrës zyrtare për ekzistimin e kësaj vepre përpos dashjes nevojitet edhe

qëllimi i kryesit që përmes kryerjes së kësaj vepre të përfitohet diçka apo të shkaktohet dëm i caktuar. Kryesi i veprës penale nuk kryen vepra vetëm për të kryer vepër por që përmes kryerjes së asaj vepre të arrijë edhe një qëllim tjetër si arsye për kryerje të veprës.

Në praktikë ka ndodhur shpesh keqinterpretime nëse një veprim i një zyrtari publik konsiston në vepër penale apo në shkelje administrative. Një analizë e tillë ka shpie në situata kur një vepër është trajtuar si penale edhe pse nuk është në fakt e asaj natyre. Duhet pasur të qartë se është pikërisht **dashja** ajo që e kualifikon një veprim të një zyrtari publik si vepër penale dhe që e dallon nga shkeljet tjera të natyrës administrative. Qëllimi i procedurës penale nuk është rregullimi i raporteve biznesore apo zyrtare. Qëllimi është që të vlerësohet dhe hetohet nëse një individ për qëllime përfitimi për vete apo për të tjerë, ka keqpërdorur detyrën apo autorizimin që i është besuar. Nëse mungon qëllimi i tillë, apo nëse një zyrtar nuk ka vepruar në një mënyrë i udhëhequr nga interesi publik, atëherë edhe nëse konsiderohet se ka pasur shkelje të procedurave dhe dispozitave të ligjeve të natyrave tjera jo penale, ato shkelje duhen trajtuar për nga përgjegjësia administrative, disiplinore apo tjetër (varësisht nga rasti konkret) dhe përmes organeve të parapara me ligjet relevante e jo në aspektin penal.

I pandehuri i cili vepron qëllimshëm, përfshihet me dashje në sjellje të asaj natyre dhe e dëshiron rezultatin e caktuar. Një person vepron **qëllimshëm** lidhur me elementin thelbësor të veprës penale: (i) kur elementi ka të bëjë me natyrën e sjelljes së tij apo pasojën e shkakuar, personi me vetëdije përfshihet në sjellje të asaj natyre apo për të shkakuar atë pasojë; dhe (ii) kur elementi ka të bëjë me rrethanat shoqëruese, personi është në dijeni të ekzistimit të rrethanave të tilla ose beson apo shpreson që ato ekzistojnë.¹⁸

Dijenja

Nënkupton që i pandehuri është në dijeni për natyrën e veprimit dhe pasojat e mundshme të saj. “Dijenja” dallon nga “qëllimshmëria” duke qenë se i pandehuri nuk vepron për të shkakuar rezultatin e caktuar, por vepron me dijeninë se pasoja është e sigurt se do të ndodh. Kodi penal model e përshkruan dijeninë si në vijim: Një person vepron me **dijeni** lidhur me elementin thelbësor të veprës penale: (i) kur elementi ka të bëjë me natyrën e sjelljes së tij apo rrethanat shoqëruese, personi është në dijeni se sjellja është e asaj natyre apo që ato rrethana ekzistojnë; dhe (ii) kur elementi ka të bëjë me pasojën e sjelljes së tij, personi është në dijeni se praktikisht është e sigurt se sjellja e tij do të shkaktojë një pasojë të tillë.¹⁹

Motivi

Motivi në të drejtën penale nënkupton diçka që ka shtyrë kryesin të kryejë një vepër penale. Motivi nuk hyn në kuadër të kushteve që duhen përmbushur për Përgjegjësinë pasi kjo e fundit ekziston pavarësisht se cilat janë motivet që kanë përcjell kryerjen e veprës penale. Qëllimi

¹⁸ American Law Institute, Kodi Penal Model: Politika ndëshkimore [Model Penal Code: Sentencing] § 2.02 (2) (a), 10 prill 2017.

¹⁹ Ibid. § 2.02(2) (b).

nuk duhet ngatërruar me motivin. Motivi i një personi nuk merret parasysh në përcaktimin nëse një person ka pasur “Mendje kriminale” dhe ka kryer veprën penale. Motivi është i një rëndësie të veçantë tek matja e dënimit. Vepra mund të kryhet për motive të ulëta, jo morale apo jonjerëzore, ndërkaq mund të kryhet edhe për arsye morale (p.sh., për t’i ndihmuar një personi). Megjithatë për vepra të caktuara mund të jetë edhe rrethanë kualifikuese duke e bërë një vepër më të rëndë.

Pakujdesia

Neni 23 i KPRK

- 1. Vepra penale mund të kryhet me pakujdesi të vetëdijshme apo të pavetëdijshme.*
- 2. Personi vepron me pakujdesi të vetëdijshme kur është i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit ose të mosveprimit të tij, por me mendjelehtësi mendon se ajo nuk do të shkaktohet apo se ai do të mund ta parandalojë shkaktimin e saj.*
- 3. Personi vepron me pakujdesi të pavetëdijshme kur nuk është i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit ose mosveprimit të tij edhe pse në rrethanat dhe sipas vetive të tij personale ka mund të ishte apo do duhej të ishte i vetëdijshëm për këtë mundësi.*

Komentarët e Kodit Penal përfshijnë një zbërthim të mjaftueshëm të dy formave të pakujdesisë andaj duke qenë se pakujdesia parashihet vetëm për një nen nga ky Kapitull, respektivisht në nenin 426 edhe ky Udhëzues do të jep sqarime shumë të kufizuara lidhur me të.

Do marrim si shembull nenin 415 të KPRK ku përgjatë tërë këtij neni vërehet përdorimi elementit të dashjes duke përdorur shprehjet si “**me vetëdije**”, “**me qëllim**” , “**qëllimshëm**” që të gjitha këto duke shtuar barrën e të provuarit dhe duke vënë në pah se një vepër e tillë nuk konsiderohet si e tillë nëse është kryer pa vetëdije respektivisht nga pakujdesia. Në këtë rast duke qenë se neni nuk ka sanksionuar kryerjen e veprës nga pakujdesia atëherë është e nënkuptueshme se përjashtohen edhe kryerja e veprës nga pakujdesia nga Neni 23 par.2 i KPRK.

Për fund, do të inkorporojmë edhe përkufizimin e Kodit penal model për këto dy forma të përgjegjësisë.

Pakujdesia e vetëdijshme apo mendjelehtësia - Një person vepron me mendjelehtësi lidhur me elementin thelbësor të një vepre, kur me vetëdije shpërfill një rrezik të madh se elementi thelbësor ekziston ose do të rezultojë nga sjellja e tij. Rreziku duhet të jetë i asaj natyre dhe shkalle që, duke pasur parasysh dhe qëllimin e sjelljes së kryesit dhe rrethanat e ditura nga i njëjti, shpërfillja e rrezikut paraqet shmangie të rëndë nga standardi i sjelljes që një person që

i bindet ligjit do të vëzhgonte në situatë si ajo e kryesit.²⁰

Pakujdesia e pavetëdijshme apo neglizhenca - Një person vepron me neglizhencë lidhur me elementin thelbësor të një veprë kur i njëjti do duhej të jetë në dijeni për rrezikun thelbësor dhe të paarsyeshëm se ai element ekziston ose do të rezultojë nga sjellja e tij. Rreziku duhet të jetë i asaj shkalle dhe natyre që dështimi i kryesit për ta perceptuar atë, duke pasur parasysh natyrën dhe qëllimin e sjelljes së tij dhe rrethanat e ditura për të, paraqet devijim të rëndë nga standardi i kujdesit që një person i arsyeshëm do të vëzhgonte po të ishte në situatë si ajo e kryesit.²¹

Dijenja, dashja, pakujdesia ose qëllimi

Neni 22 i KPRK

Dijenja, dashja, pakujdesia ose qëllimi i kërkuar si element i veprës penale mund të nxirret nga rrethanat faktike.

Ky nen në përmbajtjen e vet është i njëjtë me dy nga nenet e Konventës së OKB kundër krimit të organizuar ndërshtetëror²² si dhe Konventën e OKB kundër korrupsionit.²³

Natyrisht që tek veprat si ryshfeti dhe ushtrimi i ndikimit mund të jetë e vështirë të gjendet dhe dëshmohet për shkak të natyrës së fshehtë dhe pasi të dyja palët e transaksionit nuk duan që vepra të ekspozohet. Andaj, gjendja mendore e kryesit do mund të duhet të nxirret nga rrethanat faktike. Shembull, një furnizues paraqet ofertën për një tender lidhur me një kontratë.

Menjëherë më pas, i njëjti ofron një udhëtim të shtrenjtë jashtë vendit për personin zyrtar i cili do të bëjë përzgjedhjen e ofertuesit të suksesshëm. Nga kjo mund të nxirret se furnizuesi ka pasur për qëllim të ndikojë në vendimmarrjen e zyrtarit në përzgjedhjen e fituesit nga ana e personit zyrtar. Është jetike që rregullat e provave në Kodet e procedurës penale të lejojnë këtë formë të të provuarit.²⁴

Sipas OECD, secili shtet anëtar duhet të ketë kornizën ligjore e cila mundëson që dijenia, dashja, qëllimi, synimi apo marrëveshja e përmendur të Nenin 5(1), të nxirret nga rrethanat faktike objektive. Nëse rregullativa e provave në një shtet nuk lejon që provat e tilla rrethanore të përdoren që të konstatohet elementi i tillë mental, ai shtet duhet të rishikojë ligjet e veta në mënyrë që të jetë në përputhje me këtë paragraf. Kjo kërkesë është e rëndësisë së veçantë pasi shpesh është e pamundur të nxjerrën prova subjektive të gjendjes mendore së të akuzuarit dhe

²⁰ Ibid.§ 2.02(2) (c).

²¹ Ibid.§ 2.02(2) (d).

²² Konventa e OKB kundër krimit të organizuar ndërshtetëror dhe protokoleve të saj [United Nations Convention against Transnational Organized Crime and the Protocols thereto], Kriminalizimi i grupeve të organizuara kriminale (neni 4 par.2), kriminalizimi I shpërlarjes së dobisë së veprës penale (neni 6 par.2(f)), New York, 2004.

²³ Konventa e OKB kundër Korrupsionit [United Nations Convention against Corruption (UNCAC)], Dijenia, dashja dhe qëllimi si elemente të një veprë (neni 28), New York 2004.

²⁴ Organizata për bashkëpunim dhe zhvillim ekonomik (OECD), Korrupsioni, Përmbledhje e Standardeve ndërkombëtare penale, 2002, fq.27 Shih vegzën, <http://www.oecd.org/corruption/anti-bribery/39532693.pdf>

kjo mund të shpie në lirimin e pamerituar nga dënimi.²⁵

Shtetet do të dështonin në luftën kundër korrupsionit publik e veprat e krimit financiar nëse do insistohet që këto vepra mund të dëshmojnë vetëm me prova direkte dhe pohim nga i pandehuri si mënyrë për të dëshmuar dashjen në kryerjen e këtyre veprave. Të provuarit përtej dyshimit të bazuar edhe pse është shumë i vështirë në këto vepra megjithatë, nisur pikërisht nga përkufizimi i nenit 22 nënkupton se nuk është i paarritshëm gjithnjë kur gjykatat marrin parasysh rrethanat faktike dhe provat rrethore.

Dashja është e njëjtë tek të gjitha veprat penale. Ajo që dallon është mënyra e të provuarit tek këto vepra duke qenë se të provuarit e dashjes tek veprat korruptive nuk është gjithnjë një detyrë e lehtë pasi provat direkte (shemb. pohimi) zakonisht nuk janë në dispozicion. Gjykata, konkludimin duhet ta bëjë bazuar në dy faktorë:

- A është provuar akti, pra veprimi/mosveprimi?;
- A është realizuar pasoja e natyrshme e synuar nga ai veprim/mosveprim?

Të mësipërmet mund të konstatohen përmes provave rrethore që mbështesin rrethanat faktike. Gjykata duhet të ketë të qartë se konstatimi i dashjes përmes provave rrethore nuk ul standardin e të provuarit.

Të provuarit e dashjes përmes rrethanave faktike sipas praktikës gjyqësore

Në shumicën e instancave ne nuk e dimë se çfarë mendon individit dhe duhet mbështetur në prova rrethore apo në fakte përcjellëse. Më së lehti do të ishte sikur një person bën një deklaratë apo një pohim. Megjithatë kjo rrallë herë ndodh në këtë kategori të veprave. Nëse prokuroria dhe gjykata do të ndiqnin penalisht, respektivisht do gjykonin vetëm në bazë të pohimit, atëherë numri i të dënuarve në këtë kategori do të ishte jashtëzakonisht i ulët. Është pikërisht kjo kategori e veprave ku merr kuptim neni 22 i KPRK i shpjeguar më lartë.

Në vijim do prezantohen disa shembuj të rasteve të trajtuara në praktikën ndërkombëtare për të parë se si edhe pse në natyra të ndryshme, dashja në të gjitha është konstatuar përmes rrethanave faktike e jo përmes pohimit direkt dhe një gjë e tillë ka qenë e mjaftueshme për gjykatën.

Shembulli i parë është nga Tribunali Ndërkombëtar Penal për Ruandë (ICTR) në rastin Prokurori ndaj Clement Kayishema duke vendosur lidhur me ekzistimin apo jo të dashjes ka theksuar:

“Trupi gjykues ka gjetur se Kayishema ka poseduar dashjen e nevojshme për të shkatërruar

²⁵ Zyra e kombeve të Bashkuara për drogë dhe krim (UNODC), Udhëzues legjislativ për implementimin e Konventës së OKB për krimin e organizuar ndërshtetëror [Legislative Guide for the implementation of the United Nations Convention against Transnational Organized crime], Kapitulli B.Kriminalizimi I pjesmarrjes në një grup të organizuar kriminal, Seksioni(c)Parashikimi i elementeve mentale (neni 5(2)), Par.101. fq 31.

grupin Tutsi tërësisht apo pjesërisht”, gjë që është konstatuar nga rrethanat në vijim: (i) numri i viktimave të vrara; (ii) mënyra në të cilën janë kryer vrasjet (metodologjia); dhe (iii) shprehjet e përdorura nga Kayishema gjatë dhe pas masakrave Në caktimin e mens rea, Trupi gjykues ka vlerësuar dhe peshuar të gjitha provat relevante të prezantuara para Gjykatës, bazuar edhe aspektet tjera të dëshmisë së O. Në bazë të këtyre provave, ka gjetur përtej dyshimit të bazuar se mens rea e nevojshme ishte e pranishme.”²⁶

Dhoma e Apelit ndërkaq, duke vendosur sipas ankesës në po të njëjtin rast²⁷ lidhur me mungesën e manifestimit shprehimor të qëllimit dhe duke kuptuar se vërtetimi i kësaj rrethane duhet nxjerrë nga rrethanat faktike, ka konstatuar si në vijim:

“Dhoma e Apelit vëren fillimisht se Trupi Gjykues, gjersa njohin “vështirësitë në gjetje të manifestimit shprehimor të qëllimit”, ka konstatuar përgjithësisht se qëllimi i tillë mund të demonstrohet përmes një vistri të veprimeve të qëllimshme dhe të nxjerrët nga fjalët dhe punët apo faktet... Siç është shprehur nga Trupi gjykues, manifestimet shprehimore të qëllimit kriminal janë, për arsytet të qarta, shumë të rralla të gjenden gjatë një procedure penale. Me qëllim të parandalimit të mundësisë për shmangie nga përgjegjësia për shkak të mungesës së një manifestimi të tillë, qëllimi i nevojshëm mund zakonisht të nxjerrët nga faktet dhe rrethanat relevante. Rrjedhimisht, qasja e miratuar e Trupit gjykues në përcaktimin nëse Ruzindana ka poseduar mens rea të nevojshme për krimin e gjenocidit korrespondon me atë se si gjykatat përgjithësisht do të zgjidhnin një çështje të tillë.”

Sfida për të gjetur prova të këtyre elementeve ekzistojnë kudo në botë, andaj edhe gjykatat në vende të ndryshme njëlloj sikur në rastin e sipërpërmendur të Tribunalit për Ruandë, me vendimet e veta kanë dhënë interpretimin e tyre lidhur me nivelin e përgjegjësisë së një individi bazuar në vlerësimin e qëllimit kriminal të tyre dhe atë përmes rrethanave faktike dhe provave rrethore.

Të marrim shembull, një vepër të shmangies nga tatimi. Fakti se i pandehuri ka falsifikuar regjistrat financiar, paraqet dëshmi të fuqishme se ai kishte për qëllim të mashtronte. Gjykata mund të konstatojë prezencën e dashjes apo mendjes kriminale duke konstatuar se ka pasur regjistra të falsifikuar, se i pandehuri ka qenë në njohuri por ka fshehur informacionin, se i pandehuri është paralajmëruar për sjellje të tillë dhe përkundër kësaj ka vazhduar me veprimet e njëjta, prezenca e sjelljes së pazakontë jashtë sjelljes së zakonshme të atij biznesi apo profesioni.

Shembuj të tillë nga praktika gjyqësore amerikane janë përfshirë më poshtë duke qenë se në këto raste janë dhënë në detaje sqarime nga gjykata se si e kanë konstatuar dashjen.

²⁶ Prokurori ndaj Clement Kayishema dhe Obed Ruzindana, Nr.rastit No. ICTR-95-I, Aktgjykim i Dhomës së Apelit, par.148, fq.58, 1 qershor 2001.

²⁷ Ibid. Par. 158-159, fq.61.

Shtetet e Bashkuara kundër Toll ²⁸

Zyrtari kryesor financiar (ZKF) i një kompanie të quajtur InnoVida e sfidoi mjaftueshmërinë e provave për mbështetjen e dhjetë dënimeve të tij (bashkëpunim kriminal për të kryer mashtrim me transferim të shpejtë, mashtrim me transfere të shpejta dhe shkelje tjera të lidhura me to, dhe deklarata të rreme) për skema për mashtrim të investitorëve dhe të Shteteve të Bashkuara.

U konstatua se i pandehuri, Toll, kishte bërë një larmi keqinterpretimesh për huadhënësit, investitorët, anëtarët e bordit dhe Shtetet e Bashkuara. Kryesisht, kishte ndihmuar në përgatitjen e dy grupeve të pasqyrave financiare - një grupi duke përdorur parimet e pranuar të kontabilitetit ("GAAP") që tregonin se InnoVida po funksiononte me humbje, dhe një tjetër të ashtuquajtur pasqyrë "pro forma" që tregonte se InnoVida ishte duke operuar me fitim të konsiderueshëm. Toll prezantonte rregullisht pasqyrat "pro forma" para investitorëve, anëtarëve të bordit dhe huadhënësve, ndërsa nuk ua zbulonte atyre praninë e pasqyrave tjera që do të kishin treguar se kompania po funksiononte me humbje. Pasqyrat me humbje ai i rezervoi për auditimet e jashtme. U zbulua gjithashtu se ai e kishte mashtruar një huadhënës për mënyrën se si po shpenzoheshin fondet e kredisë dhe si po ecnin përpara operacionet e kompanisë.

Me rastin a apelimit të vendimit të instancës së parë, Toll argumentoi, ndër të tjera, se nuk kishte prova të mjaftueshme për të mbështetur se ai ishte përfshirë në mashtrim dhe komplot për mashtrim. Ai argumentoi se nuk kishte asnjë provë se ai kishte lidhur marrëveshje me ndonjë bashkëpunëtor kriminal për të mashtruar investitorët ose që Toll kishte njohuri për një bashkëpunim të tillë kriminal.

Gjykata hodhi poshtë të gjitha këto argumente, duke vlerësuar se provat e prokurorisë ishin të mjaftueshme.

Gjykata në veçanti konstatoi se provat e mëposhtme i mbështetnin konkluzionet e nevojshme:

1. Toll e mbikëqyrte përgatitjen e dy grupeve të pasqyrave financiare, ua paraqiste investitorëve vetëm pasqyrat "pro forma" dhe nuk arriti të kualifikonte numrat e paraqitur në pasqyrat pro forma; Toll ua paraqiste pasqyrat e me humbje auditorëve të jashtëm;
2. megjithëse Toll paraqiti disa prova të përpjekjes për ta bërë sistemin e kontabilitetit më transparent, Gjykata konstatoi se ai në secilin rast, kishte paraqitur pasqyrat mashtruese për investitorët, të cilat, duke pasur parasysh nivelin e arsimit dhe përvojën e tij, çojnë në përfundimin se ai duhet ta ketë ditur se po punonte drejt mashtrimit të investitorëve për avancimin e skemës;
3. për gjykatën nuk kishte rëndësi që prokuroria nuk e provoi se pasqyrat "pro forma"

²⁸ United States v. Toll, 804 F.3d 1344(11th Cir. 2015).

nuk ishin në përputhje me parimet e kontabilitetit, sepse provat treguan se ato pasqyra ishin materialisht çorientuese;

4. nuk kishte rëndësi që Toll kurrë nuk i merrte drejtpërdrejt të ardhurat e skemës, sepse duke e vazhduar këtë situatë ai ishte në gjendje të mbetej i punësuar me fitim si ZKF;
5. në lidhje me mashtrimin rreth huave, provat treguan se Toll e dinte që përfaqësimet e tij në lidhje me mënyrën e shpenzimit të të ardhurave të huasë, kontributin e kapitalit të InnoVida dhe kontratat që InnoVida i kishte fituar, ishin të rreme, sepse kur të tjerët në InnoVida e kishin nuhatur tashmë pavërtetësinë e këtyre përfaqësimeve të Toll, ai i kishte reviduar ose fabrikuar dokumentet përkatëse (ose e dinte që ishin bërë revidime fabrikime të tilla) dhe mund të konstatohet përfundimisht që si ZKF ka qenë në dijeni për çështje të tilla se si janë shpenzuar fondet e huasë, nëse InnoVida ka kontribuar në kapitalin e kërkuar sipas kontratës së huasë dhe sa ishte vlera e kontratave të InnoVida.

Gjykata për fund deklaroi se ishte e lejueshme që të përcaktohet pjesëmarrja në grupin kriminal mashtrues përmes konkluzioneve të bazuara në prova rrethanore.

SHBA kundër Hansen²⁹:

Në ankesën e tij në apel, i pandehuri ("Hansen"), partner i përgjithshëm i një fondi investues, e sfidoi dënimin e tij për mashtrim me postë, me transfere të shpejta dhe bashkëpunimin kriminal për t'i kryer ato vepra penale. Në këtë formë ai kishte mashtruar shumë investitorë të cilët kishin humbur miliona dollarë. Hansen argumentoi se prokuroria nuk kishte prova të mjaftueshme për të provuar akuzat kundër tij pasi që ky ishte një rast fatkeq i humbjes në investime e që një gjë e tillë është normale në këtë lloj biznesi.

Gjykata konstatoi se Hansen e kishte "dashjen për të mashtruar". Gjykata konstatoi se provat e mëposhtme ishin të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se Hansen kishte dashje kriminale për mashtrim:

1. Investitorët humbën miliona dollarë si rezultat i investimeve në fondin investues.
2. Hansen luajti rol të rëndësishëm në veprimtarinë e fondit investues dhe zotëronte kontroll të rëndësishëm mbi operacionet e tij;
3. Hansen u tha investitorëve shumë gjëra në lidhje me fondin investues që ishin të gabuara ose më vonë dolën të jenë të rreme;
4. Hansen përgatiti dhe dërgoi pasqyra të fitimeve që përmbajnë numra të rremë dhe u tha në mënyrë të rreme pranuesve se pasqyrat ishin përgatitur nga një firmë kontabiliteti;
5. Hansen nuk iu kishte treguar investitorëve se firma e kontabilitetit nuk po bënte më auditime në fondin e investimeve pasi që firma kishte mësuar për parregullsitë;
6. Hansen nuk iu tregoi investitorëve se firma ligjore e fondit investues ndaloi së

²⁹ United States v. Hansen , 791 F.3d 863 (8th Cir. 2015).

përfaqësuar atë pasi që kishte mësuar për parregullsitë;

7. Hansen nuk arriti t'iu tregonte investitorëve se partnerët e tij të fondit investues po përballeshin me akuza penale dhe civile për mashtrim me letra me vlerë; dhe
8. kur ekonomia u përkeqësua në 2008 dhe investitorët filluan të kërkonin kthimin e fondeve të tyre, Hansen përdori pasurinë e tij personale për të kompensuar pagesat nga fondi investues dhe në një rast përdori investimin e një investitori të ri për të shlyer investitorët e tjerë (si skemat piramidale).

Gjykata theksoi se ndonëse Hansen pohoi se nuk e dinte që fondi investues ishte mashtrues dhe se ai mbështetej në garancitë e partnerëve të tij se gjithçka ishte e qartë pasi provat e mësipërme demonstroi qartazi ekzistimin e dashjes për të mashtruar.

Gjykata gjithashtu konstatoi që, edhe nëse, siç argumentoi Hansen, ai nuk kishte njohuri për mashtrimin dhe se kishte vepruar me mirëbesim, konkluzat e gjykatës ishin se në këtë rast mund të kishin të bëjnë me "verbëri të qëllimshme ndaj së vërtetës".

- Gjykata për të ardhur tek konkludimi përfundimtar u bazua edhe në praktikën e Gjykatës Supreme sipas së cilës një i pandehur mund të dënohet në bazë të teorisë së verbërisë së qëllimshme nëse plotësohen dy kushte:
- i pandehuri në mënyrë subjektive duhet të besojë se ekziston probabilitet i lartë që ekziston një fakt; dhe
- i pandehuri duhet të ndër marrë veprime të qëllimshme për të shmangur të mësuarit e këtij fakti.

Andaj për fund, Gjykata konstatoi se provat e mëposhtme janë të mjaftueshme për ta përcaktuar verbërinë e qëllimshme:

1. ndërprerja e auditimit nga firma e kontabilitetit;
2. tërheqja e përfaqësimit të firmës ligjore pasi firma e kontabilitetit e kishte pushuar auditimin e saj;
3. Pranimi i Hansen se pas tërheqjes së firmës ligjore ai "u shqetësua për mungesën e transparencës së fondit investues";
4. Të mësuarit e Hansen për pretendimet e mashtrimit me letra me vlerë kundër partnerëve të tij;
5. Njohuria e Hansen se shumë investitorë u larguan nga fondi investues pasi mësuan për ato akuza;
6. që fondi mbrojtës nuk ishte në gjendje të plotësonte kërkesat e klientëve për tërheqje;
7. që Hansen bëri pagesa në formë të skemës piramidale.

Gjykata konkludoi po ashtu se kishte prova që Hansen qëllimisht nuk kishte bërë hetime, duke dashur të mbetej i pa njoftuar:

1. Hansen refuzoi ta lejojë firmën e kontabilitetit që ta shihte një pasqyrë

ndërmjetësimi/brokerimi në lidhje me investimet e fondit investues dhe nuk gjeti kurrë auditor tjetër pas tërheqjes së firmës;

2. Hansen foli me partnerin e tij për të pyetur në lidhje me gjendjen e investimeve të fondeve investuese dhe konfirmoi se partneri kishte një llogari tregtare por nuk kërkoi informacion mbi gjendjen e veçantë të fondit investues, siç e kishte udhëzuar firma ligjore e Hansen që të bënte;
3. Hansen nuk mori më shumë informacion në lidhje me akuzat për mashtrim kundër partnerëve të tij;
4. Hansen kurrë nuk e konfirmoi strategjinë e investimeve të fondit investues edhe kur fondi filloi të mos ishte në gjendje të paguante kërkesat e investitorëve për tërheqje; dhe
5. përkundër të gjithave që janë cekur më lart, Hansen, i cili ishte partneri i përgjithshëm i fondit dhe person përgjegjës për raportimin e performancës së fondit tek investitorët, asnjëherë nuk i konfirmoi investimet e fondit dhe vazhdoi të mbështetej tek partnerët e tij për të siguruar numrat e performancës së fondit.

Raste të tilla janë të shumta dhe të zakonata në praktikën gjyqësore në SHBA, kjo pasi si rregull, pohimi i kryerjes së veprave të natyrave korruptive dhe të kimit financiar ndodh vetëm në raste të rralla. Shembujt e tillë janë paraqitur për të treguar se si në vepra kaq komplekse siç janë krimet financiare, ku zakonisht të pandehurit mundohen të mos lënë gjurmë, është e mundur prapëseprapë gjetja e provave të mjaftueshme për të dëshmuar fajësinë.

Janë përzgjedhur më poshtë edhe dy raste tjera nga praktika e SHBA, të cilat janë të natyrës korruptive të cilat lidhen me dashjen, dijeninë dhe qëllimin e kryesit.

SHBA kundër Viktor Kozeny dhe Frederic Bourke³⁰

Në rastin Bourke, Gjykata në udhëzimet e dhëna porotës sipas rregullave të procedurave ka potencuar: *“sa i përket shpërfilljes së vetëdijshme, dijenia e Bourke mund të konstatohet kur personi është në dijeni për probabilitetin e lartë të ekzistencës së një fakti dhe me vetëdije dhe qëllimshëm iu është shmangur konfirmimit të atij fakti. Dijenia mund të dëshmohet në këtë formë, por vetëm nëse personi ka dyshuar për këtë fakt dhe ka kuptuar probabilitetin e lartë të tij, por nuk ka marr konfirmimin përfundimtar sepse ka dashur më pas të jetë në gjendje të mohoj këtë dijeni. Në anën tjetër, dijenia nuk konstatohet në këtë mënyrë nëse personi thjeshtë ka dështuar për të kuptuar këtë fakt përmes pakujdesisë apo nëse personi në fakt ka besuar se transaksioni ishte i ligjshëm. ”*Gjykata e Qarkut gjersa ishte duke vendosur në bazë të ankesës së të pandehurit Bourke ka theksuar se *“porota, duke konstatuar se Bourke ka qenë në dijeni dhe ka pasur për qëllim shkeljen e rregullave të FCPA duke dhënë ryshfet zyrtarëve të huaj dhe me këtë me domosdoshmëri kanë konstatuar se i njëjti ka pasur qëllim korruptiv me*

³⁰ Gjykata e Qarkut per Distriktin jugor të New York-ut, rasti SHBA kundër Viktor Kozeny dhe Frederic Bourke, JR, New York, 13 tetor 2009. Fq.44 dhe 48, lidhur me vendimin për shpalljen fajtor të Bourke për shkelje të Aktit për Praktikën korruptive jashtë vendit (Foreign Corrupt Practices Act) apo FCPA.

dashje."

SHBA kundër Abovyan³¹

Rasti ka të bëjë me një profesionist mjekësor (abovyan) i cili ishte përfshirë në një skemë mashtrimi të kujdesit shëndetësor. Mjeku shkruante receta false dhe urdhëronte teste të tepërta të urinës dhe pështymës në një nga dy qendrat e trajtimit të abuzimit të substancave në mënyrë që përmes mashtrimit të siguronte fitime në mënyrë indirekte nga kompanitë e sigurimeve dhe sistemi shtetëror i kujdesit mjekësor përmes të cilit paguheshin këto shërbime.

Me parashtrimin e ankesës, Abovyan pohoi ndër të tjera se kishte prova të pamjaftueshme për ta mbështetur dënimin e tij sepse nuk kishte prova të drejtpërdrejta që ai ishte dakorduar për pjesëmarrje në bashkëpunim kriminal. Një nga mjekët e përfshirë në këtë rast, pretendonte se me sinqeritet të plotë ishte i brengosur për shëndetin e pacientëve andaj edhe kishte rekomanduar zhvillimin e këtyre testeve.

Gjykata e hodhi poshtë këtë argument, në thelb, sepse provat treguan se "bashkëpunimi i plotë i Abovyan me [udhëheqësin e bashkëpunimit kriminal], së bashku me sjelljen mjekësore të vetë Abovyanit, e kishin avancuar skemën e mashtrimit të kujdesit shëndetësor".

Gjykata konstatoi se provat e mëposhtme veçanërisht e mbështetnin dënimin për mashtrim duke qenë se Abovyan:

1. krijoi urdhërpagesa në laboratorin Smart Lab në mënyrë që institucioni të mund të porosiste teste të mjekësore të panevojshme e të shtrenjta të urinës tre herë në javë për një pacient;
2. formularët e nënshkruar paraprakisht nga Abovyan, në mënyrë që institucioni të mund të porosiste edhe më shumë teste të panevojshme nga laboratorë të tjerë, si Ally;
3. të dhënat statistike tregonin se ai e eliminoi nevojën për të shkuar në testimin laboratorik për pacientët e pasiguruar. Duke dëshmuar në këtë mënyrë se ai kishte vepruar ndryshe kur kishte përfitim financiar, ndërkaq kishte vepruar në formë totalisht ndryshe kur nuk kishte këtë përfitim.
4. shqyrtoi dhe firmosi në rezultate të caktuara të testeve laboratorike pa i diskutuar ato me pacientët;
5. pranoi që institucioni të bënte "teste për gjithçka", madje edhe për ilaçe që nuk krijonin varësi që nuk testohen zakonisht në trajtimin e varësisë
6. kishte siguruar regjistrimin e të dhënave të tij mjekësore dhe i kishte nënshkruar paraprakisht recetat mjekësore për infermierët e tij për të përshkruar ilaçe pacientëve pa qenë vetë i pranishëm;
7. pranoi letër paralajmëruese nga kompania e sigurimit në fazat e hershme të kësaj skeme, megjithatë ai kishte vazhduar me sjelljen edhe pas kësaj. Pra me vet faktin që ai është paralajmëruar për veprimet jo të duhura ai kishte vazhduar. Me këtë

³¹ United States v. Abovyan, 988 F.3d 1288 (11th Cir. 2021).

- është bërë e qartë se ai nuk ka vepruar pa qëllim
8. pranoi se e kishte lejuar kolegun e tij Chatman që të merrte të gjitha vendimet e testimi - edhe pse Chatman nuk kishte asnjë trajnim mjekësor dhe testimi ishte i tepruar; dhe
 9. pranoi se merrte 5,000 dollarë në muaj që Chatman të përdorte licencën e tij mjekësore për të faturuar kompanitë e sigurimeve për "trajtim" në spital".

Sipas gjykatës provat treguan se pjesëmarrja e Abovyan ishte thelbësore për bashkëpunimin kriminal dhe suksesin e tij, se ai vazhdimisht mori pjesë në skemë gjatë gjithë mandatit të tij dhe se ai arriti fitime të konsiderueshme financiare nga skema.

Definime konkrete sipas Konventës së Këshillit të Evropës për marrje të ryshfetit

Për dallim nga shtjellimet e përgjithshme më sipër për format e ndryshme të përgjegjësisë penale, Konventa e Këshillit të Evropës për korrupsionin, jep sqarime më të detajuara për elementet specifike të veprës penale të marrjes së ryshfetit. Sipas kësaj Konvente, dashja është e vetmja formë e përgjegjësisë penale tek marrja e ryshfetit dhe duhet të përfshihet për të gjitha elementet thelbësore të veprës. Dashja duhet të jetë e ndërlidhur me një rezultat të ardhshëm: personi zyrtar me veprim apo mosveprim në pajtim me qëllimin e dhënësit të ryshfetit.³²

Vepra penale konsiderohet e kryer me vet faktin e kërkimit apo pranimit të dhuratës apo çfarëdo dobie tjetër nga ana e personit zyrtar. Kjo nënkupton që nuk është e domosdoshme që veprimi apo mosveprimi ndaj detyrës zyrtare të ketë ndodh. Kjo e fundit është me rëndësi me rastin e matjes së dënimit apo për të konstatuar nëse janë përmbushur edhe elementet e ndonjë vepre tjetër penale.

- **Kërkimi i dhuratës apo përfitimit tjetër** mund të kryhet në forma të ndryshme. Me “kërkim” duhet nënkuptuar çfarëdo deklarate (gojarisht apo me shkrim) si dhe çfarëdo veprimi përmes së cilit nuk ka dilemë se personi zyrtar kërkon dhuratë apo çfarëdo dobie tjetër. **“Kërkimi”** p.sh., mund t’i referohet një veprimi të njëanshëm ku zyrtari publik i bën të ditur personit tjetër në mënyrë shprehimore apo të nënkuptueshme se ai duhet të “paguejë” në mënyrë që të kryhet apo mos kryhet një veprim zyrtar. **Është e parëndësishme nëse është vepruar në bazë të kërkesës, pasi vet kërkesa paraqet figurën e veprës penale.** Njëjtë, sikurse nuk është me rëndësi nëse zyrtari publik ka kërkuar dobinë e paligjshme për vete apo për dike tjetër.³³
- **Pranimi** p.sh. mund të nënkuptojë pranimin faktik të përfitimit, ose nga zyrtari publik ose nga dikush tjetër (bashkëshorti, kolegu, organizata, partia politike etj) për vete apo për dike tjetër. Situata e fundit nënkupton të paktën një formë të pranimit nga zyrtari publik. Ndërmjetësit mund të jenë të përfshirë: fakti se një ndërmjetës është përfshirë, e që do të zgjeronte fushëveprimin e ryshfetit pasiv duke përfshirë veprim indirekt nga zyrtari, me domosdoshmëri përfshinë identifikimin e natyrës kriminale të sjelljes së

³² Këshilli i Europës, Raporti shpjegues për Konventën e të drejtës penale për korrupsionin,[Council of Europe Explanatory Report to the Criminal Law Convention on Corruption], Nr.173, Strasburg, 27.1.1999, Par.34 .Shih vegzën <https://rm.coe.int/16800cce441999>

³³ Ibid. par. 41.

zyrtarit, pa marrë parasysh nëse ndërmjetësi ka qenë me mirëbesim apo keqbesim.³⁴ Pranimi i dhuratës ekziston edhe kur kryesi në formë deklarative e refuzon dhuratën ndërkaq me veprimet e veta të mëtutjeshme tregon se të njëjtën e ka pranuar (përmes duke vënë dhuratën në xhep, shpenzimeve etj.) Dhurata pra siç shihet mund të jepet në formë direkte ose indirekte. Për dhënien e dhuratës apo çfarëdo dobie tjetër në mënyrë indirekte nuk është i rëndësishëm numri i ndërmjetësuesve e as nëse dhënësi i dhuratës, i cili këtë e bën përmes ndërmjetësuesit, të njoh me emër pranuesin e dhuratës, por është e mjaftueshme që ndërmjetësuesi të ketë caktuar rrethin e personave zyrtarë të cilët do të pranojnë dhuratën.

- **Pranimi i premtimit** për dhuratë ekziston kur kryesi shpreh, në mënyrë të qartë, gatishmërinë e vet që të pranojë dhuratën apo ndonjë dobi tjetër që do u jepet më vonë. Në këtë rast është e nevojshme që dhurata apo dobia tjetër t'i premtohet dhe kjo mund të bëhet në forma të ndryshme, direkte apo indirekte.
- **Përfitim i paligjshëm** është zakonisht i natyrës ekonomike por mund të jetë edhe e natyrës jomateriale. Është me rëndësi që kryesi (apo cilido person tjetër, për shembull i afërmi) të vihet në pozitë më të mirë sesa ka qenë para kryerjes së veprës dhe që i njëjti të mos kishte të drejtë në atë përfitim. Përfitime të tilla mund të konsiderohen p.sh. të holla, pushime, hua, ushqime dhe pije, procesim më të shpejtë të një rasti, perspektivë më të mire në karrierë etj.³⁵

Përfitim "i paligjshëm" për qëllime të Konventës duhet interpretohet si diçka për të cilën pranuesi nuk ka të drejtë ligjërisht për ta pranuar. Për hartuesit e Konventës, fjala "i paligjshëm" synon të përjashtojë përfitimet e lejuara me ligj apo me rregulla administrative si dhe dhurata minimale, dhurata të vlerës së ulët apo dhuratat e pranueshme shoqërisht.³⁶

Nëse ka kërkesë të njëanshme apo pakt korruptiv, është thelbësore që veprimi apo mosveprimi nga zyrtari publik të bëhet pas kërkesës apo paktit, kurse është e parëndësishme se kur është bërë në fakt pranimi i përfitimit. Andaj, nuk është vepër penale sipas Konventës të pranojnë një përfitim pas veprimit të kryer nga zyrtari publik, pa ofertë paraprake, kërkesë apo pranim. Për më tepër, fjala "pranim" nënkupton mbajtja e përfitimit apo dhuratës të paktën për një kohë, në mënyrë që zyrtari që nuk e ka kërkuar atë, menjëherë e kthen dhuratën tek dërguesi në atë rast nuk do konsiderohej kryes sipas nenit 3. Kjo dispozitë nuk është e aplikueshme as në përfitimet që nuk ndërlidhen me një veprim specifik në ushtrimin e detyrave të zyrtarit publik.³⁷

Shprehja e formave të ndryshme të Përgjegjësisë sipas Kodit penal

Kodi penal model përpos që përkufizon secilën nga format e ndryshme të përgjegjësisë të sipërpërmendura, por njëkohësisht shtjellon edhe si konstatohen ato në situata të ndryshme kur

³⁴ Ibid par.42

³⁵ Ibid.Par.37

³⁶ Ibid. Par.38

³⁷ Ibid. Par.43

janë paraparë apo nuk janë paraparë shprehimisht me një dispozitë ligjore³⁸.

- Kur përgjegjësia e kërkuar për të konstatuar elementin thelbësor të veprës penale nuk është e paraparë me ligj, një element i tillë konstatohet kur personi vepron qëllimshëm, me dijëni apo me mendjehetësi lidhur me atë element.
- Kur ligji që përcakton veprën përshkruan edhe nivelin e përgjegjësisë që është e mjaftueshme për të konstatuar kryerjen e veprës penale, por pa bërë dallimin për cilat elemente thelbësore, një dispozitë e tillë do të vlejë për të gjitha elementet thelbësore të veprës, përveç nëse qartë na paraqitet një qëllim i kundërt.
- Kur ligji parashihet që neglizhenca është e mjaftueshme për të përcaktuar elementin e një vepre penale, një element i tillë konstatohet edhe kur një person vepron me qëllim, me dijëni dhe me mendjehetësi.
- Kur mendjehetësia është e mjaftueshme për të përcaktuar elementin, një element i tillë konstatohet edhe nëse personi vepron qëllimshëm apo me dijëni.
- Kur të vepruarit me dijëni është e mjaftueshme për të përcaktuar elementin, një element i tillë konstatohet edhe nëse personi vepron qëllimshëm.
- Kur një qëllim i caktuar paraqitet si element i një vepre, ai element konstatohet edhe nëse qëllimi është i kushtëzuar, përveç nëse kushti është në kundërshtim me dëmin ose të keqen që kërkohet të parandalohet nga ligji që sanksionon veprën.
- Kur dijenia për ekzistimin e një fakti të caktuar paraqet element të veprës, dijenia e tillë konstatohet nëse personi është në dijëni të probabilitetit të lartë për ekzistencën e tij, përveç nëse ai beson se me të vërtetë se ai fakt nuk ekziston.
- Kërkesa që një vepër të kryhet me dashje konstatohet nëse personi vepron me dijëni lidhur me elementin thelbësor të veprës, përveç nëse shfaqet një qëllim për të vendosur kërkesa të mëtejme.
- As dijenia, as mendjehetësia e as neglizhenca mbi atë nëse një veprim paraqet vepër penale apo lidhur me ekzistencën, kuptimin apo zbatimin e ligjit që përcakton elementet e një vepre penale nuk është një element i kësaj vepre penale, përveç nëse përkufizimi i veprës ose Kodi parashikon kështu.

Lidhja kauzale mes sjelljes së paligjshme dhe pasojës

Parashtrahet pyetja se a konsiderohet vepra penale e keqpërdorimit të detyrës zyrtare nga ana e personit zyrtar ka mbetur në tentativë apo konsiderohet e kryer, kur i njëjti ka keqpërdorur pozitën me qëllim të përfitimit për vete apo të tjerë, por kur këtë përfitim nuk ka arritur ta realizojë? Në raste të tilla gjithnjë kemi të bëjmë me vepër të kryer, pa marrë parasysh nëse një përfitim i tillë nuk është finalizuar me sukses. Kjo për faktin se personi zyrtar me vetëdije e ka dëshiruar kryerjen e veprës dhe ka ndërmarrë veprime të caktuara për ta realizuar, respektivisht nuk ka ndërmarrë veprimet që kërkohen nga ai sipas detyrës kur vepra kryhet me mosveprim.

Dispozita në fjalë nuk kërkon që përfitimi të jetë realizuar por vetëm kërkon që motivi për

³⁸ American Law Institute, Kodi Penal Model: Politika ndëshkimore [Model Penal Code: Sentencing] § 2.02 pikat (3)-(9), 10 prill 2017.

kryerjen e kësaj vepre të ketë qenë përfitimi. Nëse dispozita do ishte ndërtuar në vend të “...me qëllim që të përfitoj dobi pasurore...” të thotë “...duke realizuar dobi pasurore” në këtë të fundit nëse dobia nuk do ishte realizuar vepra do të konsiderohej e mbetur në tentative. Shembull i tillë është dispozita e nenit 420 (Përdorimi i paautorizuar i pasurisë) ku në mënyrë decisive kërkohet që paratë, letrat me vlerë apo pasuria tjetër e luajtshme të jetë përdor në mënyrë që vepra të konsiderohet e kryer.

Në kuadër të këtyre sqarimeve, duhet potencuar po ashtu edhe shembullin nga par. 2 i nenit 415 sipas së cilës dispozitë parashihet se kjo vepër mund të kryhet **ose me qëllim të përfitimit ose duke shkaktuar dëme buxhetore** që automatikisht nënkupton se konsiderohet se vepra është e kryer edhe nëse personi përgjegjës nuk ka përfituar vet asgjë nga kryerja e veprës por vetëm ka shkaktuar dëm buxhetor, natyrisht gjithnjë përderisa nuk janë përmbushur elementet e ndonjë vepre tjetër penale.

Sipas Kodit penal model sjellja është shkak i një pasoje kur³⁹:

- i paraprin pasojës dhe se pa të rezultati në fjalë nuk do të kishte ndodhur; dhe
- marrëdhënia midis sjelljes dhe pasojës plotëson çdo kërkesë tjetër kauzale të paraparë me Kod apo nga ligji që përcakton atë vepër.

Kur shkaktimi me dashje apo dijeni i një pasoje konkrete paraqet element të veprës penale, elementi nuk konstatohet nëse pasoja konkrete nuk është brenda qëllimit ose synimit të kryesit, përveç nëse:

- pasoja konkrete ndryshon nga pasoja e synuar apo projektuar, sipas rastit, vetëm në lidhje me atë se një person tjetër ose pronë tjetër është dëmtuar ose ndikuar ose kur dëmtimi ose dëmi i synuar apo parashikuar do të kishte qenë më i rëndë ose në shkallë më të gjerë sesa ajo e shkaktuar; ose
- pasoja konkrete përfshin të njëjtin lloj të dëmtimit apo dëmit si ai i synuar apo parashikuar dhe nuk është shumë i rastësishëm apo aksidental për të pasur një ndikim domethënës në përgjegjësinë e kryesit apo peshën e veprës së tij.

Kur shkaktimi i një pasoje të caktuar nga mendjehetësia apo neglizhenca është element i veprës penale, elementi nuk përcaktohet nëse pasoja konkrete nuk është brenda rrezikut për të cilin kryesi është i vetëdijshëm ose, në rastin e neglizhencës, për të cilin duhet të jetë i vetëdijshëm përveç nëse:

- pasoja konkrete ndryshon nga pasoja e mundshme vetëm në lidhje me atë se një person tjetër ose pronë tjetër është dëmtuar ose ndikuar ,apo se dëmi ose dëmtimi i mundshëm

³⁹ American Law Institute, Kodi Penal Model (Dispozita të zgjedhura): Lidhja kauzale mes sjelljes dhe pasojës; dallimi mes pasojës së paraparë apo synuar dhe pasojës konkrete apo mes pasojës së mundshme me atë aktuale [Model Penal Code (Selected provisions): Causal relationship between conduct and result; divergence between result designed or contemplated and actual result or between probable and actual result] § 2.03, 10 prill 2017. Link: <https://www.inazu-crimlaw.com/model-penal-code>, shikuar për herë të fundit më 21 janar 2021.


- do të kishte qenë më i rëndë ose më i gjerë se ai i shkaktuar; ose
- pasoja konkrete përfshin të njëjtin lloj të dëmtimit apo dëmit si pasoja e mundshme dhe nuk është shumë i rastësishëm apo aksidental për të pasur një ndikim domethënës në përgjegjësinë e kryesit apo në peshën e veprës së tij.

Kur shkaktimi i një pasoje konkrete paraqet element thelbësor të një vepre penale për të cilën vendoset përgjegjësi absolute me ligj, elementi nuk përcaktohet nëse rezultati aktual nuk është pasojë e mundshme e sjelljes së kryesit.

Hapat e matjes së dënimit

Gjetja e pikënisjes

Hapi i parë në caktimin e dënimit për veprën penale është që së pari të shikohet pikënisja për kategorinë përkatëse të veprës penale. Gjykata duhet të kenë parasysh se pikënisja tek veprat e këtij kapitulli është rregulluar më në detaje në pjesën tabelare të këtij udhëzuesi. Gjersa, Udhëzuesi i përgjithshëm për matjen e gjobës i referohet në çdo rast pikënisjes si mesi i dënimit nga minimumi dhe maksimumi i paraparë ligjor për atë nen/paragraf, ky Udhëzues shkon edhe më në detaje. Kjo është bërë me qëllimin që, siç do të zërthehet më poshtë, gjykata të bëj dallimin mbi lartësinë e dënimit varësisht nga shkalla e përgjegjësisë dhe dëmit të shkaktuar si dy nga elementet/rrethanat më të rëndësishme për veprat e këtij kapitulli. Veprat kundër detyrës zyrtare janë vepra të kryera me qëllim përfitimi dhe vepra me potencial për një dëm të lartë si financiar ashtu edhe në format tjera siç është zërthyer më poshtë. Duhet sqaruar se ky Udhëzues specifik nuk del nga kornizat e Udhëzuesit të përgjithshëm por e plotëson edhe më shumë atë. Edhe në rastin e këtij udhëzuesi, nga gjykata kërkohet që të gjej pikënisjen, por tani pikënisja është brenda një ndarje të paraparë. P.sh. nëse dënimi i paraparë në tabele për një zyrtar me përgjegjësi të lartë i cili ka shkaktuar dëm të substancial është paraparë shtrirja prej 10-12 vite atëherë pikënisja do ishte 11 vite. Ndërkaq kur ka pasiguri nëse një kryes duhet klasifikuar në përgjegjësinë e lartë apo të mesme, atëherë pikënisje konsiderohet minimumi i shtrirjes së paraparë për përgjegjësinë e lartë dhe maksimumi i shtrirjes për përgjegjësinë e mesme. I njëjti parim vlen edhe për raportin mes përgjegjësisë së mesme dhe asaj të ulët. Për sqarim po paraqesim edhe një ilustrim grafik të këtij zërthimi:



Nëse i pandehuri është duke u dënuar gjykuar për më shumë vepra, gjykata duhet të gjejë pikënisjen për secilën prej veprave individuale. Pikënisja vlen për të gjithë kryesit, pavarësisht se si janë deklaruar apo pavarësisht dënimeve të mëparshme, pasi kjo pjesë më pas llogaritet se ku në shtrirje do i bie dënimi final. Edhe përfitimi për marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë merret në konsideratë vetëm pasi të jetë identifikuar dënimi i duhur. Të njëjtat parime vlejné edhe për veprat penale për të cilat Kodi parasheh dënim me gjobë qoftë si dënim individual ose si dënim i përbashkët me burg dhe gjobë.

Nëse kryesi është duke u gjykuar për më shumë se një veprë penale, ose nëse ai tashmë është në vuajtje të dënimit, merrni parasysh nëse dënimi i përgjithshëm është i drejtë dhe proporcional me sjelljen e kryesit në përgjithësi.

Gjykata duhet t'i marrë në konsideratë tiparet e tjera të veprës penale ose të shkelësit që kërkojnë rregullimin e dënimit, përfshirë rrethanat rënduese dhe ato lehtësuese.

Rrethanat rënduese

Rrethanat përkatëse rënduese sipas Kodit

Kodi penal përmban një numër rrethanash rënduese në nenin 70 par.2, të cilat duhet të merren parasysh nga gjykata gjatë vlerësimit të peshës së veprës penale. Rrethanat rënduese më të rëndësishme për këtë kategori të veprave penale përfshijnë:

- 2.1 Shkallën e lartë të pjesëmarrjes së personit të dënuar në veprën penale;
- 2.2 shkallën e lartë të dashjes nga ana e personit të dënuar;
- 2.3 prezencën e dhunës ose kanosjes me dhunë në kryerjen e veprës penale;
- 2.5. nëse vepra penale përfshin disa viktime;
- 2.8. shkallën e dëmit të shkaktuar nga personi i dënuar, përfshirë vdekjen, lëndimin e përhershëm, transmetimin e sëmundjes tek viktime apo çfarëdo dëmi tjetër të shkaktuar viktimës ose familjes së tij;
- 2.9 çfarëdo keqpërdorimi të pushtetit ose pozitës zyrtare nga personi i dënuar në kryerjen e veprës penale;
- 2.10 dëshmi të shkeljes së besimit nga ana e personit të dënuar;
- 2.11. nëse vepra penale është kryer si pjesë e veprimtarisë së grupit të organizuar kriminal;
- 2.13 ndonjë dënim penal të mëparshëm i personit të dënuar.

Përgjithësisht, rrethanat nga paragrafët 2.4, 2.6, 2.7, 2.12 nuk është se gjejné shumë zbatim në rastet e korrupsionit zyrtar dhe veprat tjera penale kundër detyrës zyrtare. Kjo nuk do të thotë se ato kurrë nuk do të jenë të pranishme, por thjesht më rrallë mund të ndodh që të jenë të

aplikueshme.

Shtjellimi në hollësi i rrethanave rënduese të rëndësishme për çështjet e korrupsionit

Qëllimi i kësaj njësie është të shtjellojë më tej fushëveprimin e rrethanave rënduese të parapara me Kod penal si dhe të shikoj se si do të përkthehen ato në vlerësim dhe arsyetim të rasteve gjatë përdorimit të tyre. Në përgjithësi, për qëllime të individualizimit të dënimit, më shumë vëmendje i është kushtuar matjes së Përgjegjësisë së kryesit të veprës penale, si komponent kryesor në lëvizjen lart ose poshtë gjatë matjes së dënimit për këtë kategori të kryerësve. Kjo nuk do të thotë që rrethanat tjera ligjore që kanë të bëjnë me kryesin nuk janë relevante, por vetëm për të theksuar që rrethanat që i referohen Përgjegjësisë duhet të kenë më shumë peshë në caktimin e dënimit.

Niveli i Përgjegjësisë përcaktohet duke peshuar të gjitha rrethanat e çështjes për të përcaktuar rolin e kryesit dhe shkallën në të cilën vepra ishte planifikuar si dhe sa e sofistikuar ka qenë. Kur ekzistojnë karakteristika të cilat bien në nivele të ndryshme të Përgjegjësisë, gjykata duhet të balancojë këto karakteristika për të arritur vlerësim të drejtë të Përgjegjësisë së kryesit.

Kategori tjetër shumë e rëndësishme për vlerësimin e dënimit është vlerësimi i dëmit të shkaktuar nga vepra e kryer. Kodi penal në nenin 113 ka bërë ndarjen e llojit të dëmit në kategori të ndryshme varësisht nga lartësia e tij.⁴⁰ Dëmi vlerësohet në lidhje me çdo ndikim të shkaktuar nga vepra penale (qoftë viktimat që mund të identifikohen ose dëmi në kontekst më të gjerë) apo me përfitimin e vërtetë ose të synuar për kryesin. Veprat penale të lidhura me korrupsionin në KP, në pjesën më të madhe, e kanë përcaktuar veprën penale duke u bazuar në nivelin e dëmit të shkaktuar nga ajo vepër, duke ia caktuar një lartësi specifike dëmit të shkaktuar. Kjo do të thotë se ndryshe nga rrethanat e Përgjegjësisë, rrethanat që lidhen me dëmin për shumicën e veprave penale në këtë kategori janë përfshirë tashmë si element i veprës penale. Në raste të tilla, vlerësimi i dëmit duhet të bëhet duke e vlerësuar nivelin e dëmit brenda kufijve të caktuar me ligj, por jo duke i llogaritur dyfish. Për më shumë detaje rreth ndarjes së dëmit sipas Kodit penal mund ti referoheni edhe Udhëzuesit specifik për gjrobat.⁴¹

Rreziku i shkaktimit të dëmit përfshinë marrjen në konsideratë edhe të gjasave të shkaktimit të dëmit dhe shkallën e atij dëmi nëse do ishte shkaktuar. Rreziku i shkaktimit të dëmit është më pak serioz sesa ekzistimi i dëmit real. Kur vepra penale ka rrezikuar shkaktim të dëmit por kur në realitet një dëm i tillë nuk është shkaktuar (ose është shkaktuar në masë shumë të të vogël), qasja normale do të ishte është që të kalohet në kategorinë tjetër më të ulët të dëmit.

Kjo mund të mos jetë e përshtatshme nëse gjasat ose shtrirja e dëmit të mundshëm është

⁴⁰ Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Nr.06/L-074, Neni 113, par.31-34, Përkufizimet, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, 14.01.2019.

⁴¹ Udhëzues specifik për caktimin e gjobës si sanksion për veprat penale sipas Kodit penal të Republikës së Kosovës, miratuar nga Gjykata Supreme më 27 shkurt 2020.

veçanërisht e lartë.

Ashtu si për të gjitha veprat penale, rrethanat rënduese sipas nenit 70 paragrafi 2 nuk kufizohen VETËM në ato të përmendura në Kodin Penal. Ato iu referohen përgjithësisht të gjitha veprave penale në Kod, kështu që ekziston nevojë për interpretim më të gjerë të së njëjtave për t'u siguruar që atyre u jepet rëndësia e duhur sipas kategorisë së veprës penale të përfshirë në këtë Udhëzues.

Më poshtë do të gjeni shpjegim më të hollësishëm të rrethanave rënduese të cekura më sipër, të cilat kur shoqërohen me karakteristikat specifike të këtij lloji të veprave penale i japin kuptim më të mirë nivelit të Përgjegjësisë dhe dëmit, i cili përfundimisht çon në njëtrajtshmëri më të madhe në dënimin e kryerësve për vepra të ngjashme në rrethana të ngjashme. Për ta bërë këtë, rrethanat rënduese të cekura në ligj do të ndahen sipas nivelit të Përgjegjësisë dhe dëmit.

Rrethanat e përgjithshme të Përgjegjësisë dhe dëmit për këtë kategori të veprave penale demonstrohen por nuk kufizohen vetëm në rrethanat e mëposhtme:

Kodi Penal, neni 70 par. 2:
<p>2.1. Shkalla e lartë të pjesëmarrjes së personit të dënuar në veprën penale;</p> <p>2.2. Shkalla e lartë të dashjes nga ana e personit të dënuar,</p> <p>2.11. Nëse vepra penale është kryer si pjesë e veprimtarisë së grupit të organizuar kriminal;</p>

Rrethanat e përfshira në këtë kategori përfshijnë rastet kur më shumë se një kryes janë të përfshirë në kryerjen e veprës penale dhe/ose kur ekziston natyrë më e sofistikuar. Që të tre këto elemente janë përshkruar në shumë detaje në Udhëzuesin e përgjithshëm të Gjykatës Supreme mbi Politikën ndëshkimore⁴² dhe gjyqtarët dhe profesionistët tjerë ligjore inkurajohen që të shqyrtojnë me kujdes elaborimin e këtyre rrethanave sipas atij Udhëzuesi pasi i njëjti përmban edhe praktikatat e Tribunalit penal për ish-Jugosllavi në Hagë. Për secilën nga rrethanat e sipërme elaborimi që jepet në Udhëzuesin e përgjithshëm është shumë relevant për veprat e natyrës korruptive. Andaj, qëllimi i kësaj rezymeje të dhënë më poshtë nuk është përsëritja e koncepteve të shprehura në atë Udhëzues, por në identifikimin e nën-kategorive të rrethanave të mësipërme që mund të jenë më specifike për veprat korruptive dhe të keqpërdorimit të detyrës zyrtare. Nën-kategoritë e përshkruara më poshtë kanë marrë për bazë edhe disa nga rrethanat e përshkruara në Udhëzuesin për veprat e korrupsionit të Komisionit për Politikë ndëshkimore të Britanisë së madhe.⁴³

⁴² Udhëzuesi për politikën ndëshkimore, miratuar nga Gjykata Supreme më 14 shkurt 2018. Par.5.1; 5.2 dhe 5.6.

⁴³ Udhëzues final për veprat e Mashtrimit, Ryshfetit dhe Shpërlarjes së parave, Komisioni për Politikë ndëshkimore, Britania e madhe, tetor 2014.

- **Natyra e sofistikuar e veprës penale/shkalla e lartë e planifikimit.**- Ky është element që veçanërisht lidhet me elementin e veprës penale ose bashkëkryerjen. Është element shumë i zakonshëm në veçanti në veprat penale që përfshijnë keqpërdorimin e autorizimeve me qëllim të përfitimit të konsiderueshëm dhe rrethanë shumë domethënëse që duhet të merret në konsideratë gjatë ashpërsimit. **Shpesh është e ndërlidhur me rastet kur vepra penale është kryer përgjatë një periudhe të gjatë kohore.** Ekziston mundësia e dyfishimit të rrethanës-shkalla e lartë e pjesëmarrjes me shkallën e lartë të dashjes. Gjykata duhet t'ia atribuojë planifikimin kësaj rrethane. Kjo bazohet në faktin që planifikimi është vetëm një nga çështjet që ndikojnë në shkallën e pjesëmarrjes. Ndërsa ekzistimi i planifikimit është provë e drejtpërdrejtë e paramendimit. **Një element i cili tregon tutje për një sofistifikim më të lartë dhe pjesëmarrje më të madhe të kryesit është edhe përpjekja apo edhe angazhimi i kryesit për të fshehur apo shkatërruar provat.** Me Kodin e ri penal kjo e fundit është paraparë si vepër e veçantë penale.⁴⁴ Megjithatë nëse nuk është e mundur të përfshihet si vepër e veçantë penale atëherë gjykata mund ta përfshijë si rrethanë rënduese pasi e njëjta lidhet me shkallën e lartë të dashjes dhe shpesh me planifikim më të madh në kryerjen e veprës penale.

-**Roli udhëheqës kur kryerja e veprës është pjesë e veprimtarisë grupore.**- Ekzistimi i elementit të bashkëkryerjes ose grupit të organizuar duhet të ketë peshën më të madhe gjatë caktimit të dënimit. Gjyqtari duhet të marrë parasysh çdo herë rolin e kryesit individual në kryerjen e veprës penale. Si rregull i përgjithshëm, kryesi me rol udhëheqës në kryerjen e kësaj vepre penale duhet të dënohet më rëndë e jo të trajtohen njëjtë të gjithë pa marrë parasysh rolin individual të secilit.

-**Vepra e kryer për ta lehtësuar aktivitetin tjetër kriminal.**- ky lloj i rrethanave është shumë i zakonshëm në veprat penale të lidhura me korrupsionin dhe në veçanti në veprat penale që përfshijnë grupe të organizuara kriminale. Kurdo që një rrethanë e tillë nuk është e shënuar si element i veprës penale, ajo duhet të merret në konsideratë për ashpërsim. Kjo rrethanë është e sqaruar shumë mirë në Udhëzuesin për politikë ndëshkimore më saktësisht në pikën 5.1 të këtij Udhëzuesi.⁴⁵

- **Veprat e natyrës transnacionale.**- Ky është element tjetër rëndues me rëndësi specifike në caktimin e dënimit pasi përfshin elementin transnacional të veprës penale. Ekzistimi i kësaj rrethane tregon një shkallë më të lartë të sofistifikimit gjë që domosdoshmërisht kërkon edhe dënueshmëri më të lartë për kryesi/t.

- **Përfshirja e të tjerëve përmes presionit.**- Për dallim nga pozita drejtuese si pjesë e veprimtarisë grupore, kjo rrethanë përqendrohet në përdorimin nga ana e të pandehurit të personave apo zyrtarëve të tjerë, të cilët nuk janë të akuzuar penalisht, në përgatitjen ose ekzekutimin e veprës penale. Nuk çon peshë nëse veprimet e ndërmarra nga zyrtarët e tjerë ishin të ligjshme apo jo. Kjo rrethanë ashpërsohet edhe më tej nëse ata zyrtarë të përfshirë janë

⁴⁴ Kodi penal i Republikës së Kosovës Nr.06/L-074, Neni 389, Manipulimi me prova, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, 14.01.2019.

⁴⁵ Ibid. supra note 5, fq. 59.

vartës të pandehurit ose pozita e të pandehurit në lidhje me zyrtarin tjetër ishte rrethanë domethënëse motivuese për ndërmarrjen e veprimit. Ashpërsimi bazohet në dëmin e shtuar të shkaktuar institucionit(eve) përfshirë dhe ndikimin në individë. Mund të ketë dyfishim me veprën nga neni 419 i Kodit penal (Mashtrimi në detyrë) nëse është ngritur akuzë për këtë veprë penale dhe përdorimi i zyrtarëve tjerë përfshin mashtrim- në këtë rast kjo rrethanë nuk mund të përdoret për ashpërsim.

Kodi Penal, neni 70 par 2

2.3. Prezenca e dhunës ose kanosjes me dhunë në kryerjen e veprës penale;

2.5 nëse vepra penale përfshin disa viktima;

2.8 Shkalla e dëmit të shkaktuar nga personi i dënuar, përfshirë vdekjen, lëndimin e përhershëm, transmetimin e sëmundjes tek viktima apo çfarëdo dëmi tjetër të shkaktuar viktimitës ose familjes së tij;

Këto rrethana grupohen në një kategori pasi në përgjithësi ato i referohen jo vetëm peshës së veprës penale, por edhe nivelit të dëmit. Në përgjithësi, këto rrethana mund të lidhen me veprat penale kundër jetës dhe trupit ose integritetit seksual, megjithatë ato mund të aplikohen edhe në vepra penale të lidhura me korrupsionin nëse u jepet interpretim më i gjerë. Ne vijim është paraqitur përmbledhje e disa prej nën-rrethanave, të cilat mund të konsiderohen si shtjellim i rrethanave ligjore të paraqitura më lart.

- Hapat e ndërmarrë për të parandaluar palën e dëmtuar ose personat tjerë që të raportojnë, ndihmojnë ose mbështesin ndjekjen penale. Përveç rrethanës së fshehjes ose shkatërrimit të provave, kryesi mund të shkoj edhe më tej e të ndërmarr veprime specifike për të parandaluar 'sinjalizuesit e mundshëm' që të raportojnë këtë dukuri dhe eventualisht të kontribuojnë në ndjekjen penale të këtyre kryerësve. Prania e elementit të tillë është shumë e rëndësishme për ashpërsimin e dënimit. Këto mund të jenë veprime që ndërmerren kundër dëshmitarëve ose viktimitave të mundshme para zbulimit të veprës penale. Mund të ketë situata kur kanosja me dhunë përveç viktimitës mund ti drejtohet palëve të treta. Në këto raste gjykata duhet të shqyrtoj raportin ndërmjet veprës së përgjithshme dhe kanosjes me dhunë. Nëse kanosja me dhunë që i bëhet palëve të treta ka ndonjë lidhje me veprën e përgjithshme, atëherë gjykata duhet ta konsideroj si rrethanë rënduese, edhe nëse kanosja nuk i është drejtuar viktimitës. Kjo rrethanë nuk bënë dallim ndërmjet viktimitës së krimit dhe palës së tretë.

Sikurse edhe referenca e mësipërme, gjykata duhet të ketë kujdes ndaj dyfishimit të rrethanës rënduese me elemente të veprës penale nëse kemi akuzë të ngritur edhe për veprat e veçanta si:

- Pengimi i të provuarit apo procedurës zyrtare (neni 386);
- Frikësimi gjatë procedurës penale (neni 387);
- Hakmarrja (neni 388);
- Manipulimi me prova (neni 389); etj.

- Motivuar nga pritjet për përfitim financiar, tregtar ose politik.- Në disa prej veprave penale të lidhura me korrupsionin nuk është e mundur të përcaktohet niveli i përfitimit për shkak të natyrës së veprës penale. Në veprat e tilla penale kur kjo rrethanë nuk është element i veprës penale, por konstatohet se i pandehuri e ka kryer atë me qëllim të ndonjë favoriti tjetër ose përfitimi për veten e tij, është shumë e rëndësishme që të merret në konsideratë për ashpërsim të veprës. Shembull, nëse një person zyrtar duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin e tij zyrtar në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë kryen një veprim që bie në kundërshtim me detyrat e tij, në këmbim të një vlere të caktuar, atëherë i njëjti ka kryer veprën penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare. Nëse, tutje po i njëjti person nga po i njëjti veprim, përfiton më vonë edhe në aspektin politik, p.sh. duke përfituar vota në procesin e ardhshëm politik për shkak të atij veprimi, një rrethanë e tillë do duhej përfshirë si rrethanë rënduese (nëse është e mundur të bëhet lidhja e tillë).

- Ndikimi më i gjerë në shoqëri - Në veprat penale të lidhura me korrupsionin, kjo kategori e rrethanave përfshin vlerësimin e dëmit jo vetëm ndaj individit, por edhe më shumë ndaj shoqërisë në përgjithësi. Megjithatë, gjykata duhet të ketë parasysh se përdorimi shabllon i kësaj rrethane nuk është i rekomandueshëm. Zakonisht për përfshirjen e rrethanave rënduese kërkohet një standard më i lartë i të argumentuarit sesa tek rrethanat lehtësuese. Në këtë rast nuk bëhet fjalë vetëm përhapjen e veprave të kësaj natyre, por ndikimi më i gjerë që një veprim i kryesit mund të ketë në shoqëri. Shembull konkret do të ishte nëse shpronësimi pa kurrfarë kriteri dhe në masë të madhe i tokave bujqësore për ndërtimin e infrastrukturës rrugore ka ndikuar në degradim të tokave e rrjedhimisht ka ndikuar në mirëqenien e qytetarëve të një rajoni të caktuar apo të Kosovës në përgjithësi nëse është e një përmase shumë të madhe. Në përfshirje si rrethanë rënduese, do mund të jepet një përmbledhje e përmasave të këtij veprimi e jo vetëm të shikohet dobia pasurore nga e cila mund të ketë përfituar një individ apo grup individësh.

- Ndikim në kategori të ndjeshme të shoqërisë apo fondeve që ndërlidhen me këto kategori. Ndonëse viktime e krimit është shpesh edhe Shteti, humbja e fondeve mund të ketë ndikim anësor në përfituesit e atyre fondeve të shtetit të cilët mund të jenë të ndjeshëm. Ashpërsimi aplikohet kur abuzimi ose shkelja është kryer nga zyrtari i punësuar brenda në institucione apo kur dëmi shkaktohet brenda një nënsektori/departamenti institucional që ofron asistencë të drejtpërdrejtë publike për qytetarët e Kosovës në formë të shërbimeve ose financimit për:

- Shërbime mjekësore të mbështetura ekskluzivisht ose në masë të konsiderueshme nga fondet publike;
- Programe të asistencës sociale për familjet ose individët e varfër;
- Mbështetje për personat me aftësi të kufizuara mendore ose fizike;
- Fonde të pensioneve që shpërndahen ose mbahen nga institucionet publike;
- Institucione publike të arsimit përfshirë Universitetin;
- Çdo situatë tjetër në të cilën gjykata konstaton dëmtim të aftësisë së institucionit për të ofruar shërbime për personat e ndjeshëm.

- **Kërcënimi për shëndetin publik** - Nëse veprimtaria kriminale paraqet kërcënim për shëndetin publik, gjykata duhet ta merr në konsideratë këtë si rrethanë të rëndësishme për ashpërsim. Shembull tipik mund të jetë ofrimi i mallrave ose shërbimeve të standardit të ulët që vijnë si rezultat i sjelljes korruptive. Këtu mund të përfshihet edhe tregtimi i mallrave me rrezik të shtuar për shëndetin publik. Ky mund të jetë kërcënim i drejtpërdrejtë dhe i menjëhershëm ose që zhvillohet në periudhë më të gjatë kohore duke ndikuar në sigurinë dhe jetën e qytetarëve të Kosovës. Ashpërsimi do të varet drejtpërsëdrejti nga numri i qytetarëve të ekspozuar dhe urgjenca e serioziteti i dëmit të mundshëm. Ekzistojnë raste të shumta të dokumentuara ku korrupsioni rezulton drejtpërdrejt në ekspozimin e qytetarëve të Kosovës ndaj mallrave të dyshimta ose të standardeve të ulëta. Këto shpesh janë të lidhura me mashtrimet në prokurim dhe mund të përfshijnë:

- Blerjen e materialeve të ndërtimit ose shërbimeve të ndërtimit;
- Blerjen, shpërndarjen ose licencimin e ilaçeve nën standardin e kërkuar ose të falsifikuara;
- Blerjen, shpërndarjen ose licencimin e artikujve ushqimorë nën standardin e kërkuar.

Sikurse edhe në referencat e mësipërme gjykatat gjithnjë duhet të kenë parasysh nëse veprimet e kryesit përmbushin elementet e veprave përkatëse nga Kapitulli XXII i Kodit penal (Veprat penale kundër shëndetit publik), për të u siguruar se nuk kemi dyfishim të numërimit edhe si rrethanë edhe si element nëse i pandehuri ngarkohet me keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe me ndonjë nga veprat nga ky Kapitull. Megjithatë, ndikimi në shëndetin publik asnjëherë nuk duhet të anashkalohet dhe atë duke e marrë gjithnjë ose si element rëndues ose si vepër të veçantë penale varësisht nga specifikat e rastit.

- **Ndikimi në mjedis** - kjo rrethanë është për nga natyra e ngjashme me atë që është përshkruar më lart, por shpesh shpërfillet gjatë ndjekjes penale dhe gjykimit të veprave penale të lidhura me korrupsionin. Ndonëse Kodi Penal përmban kapitull të veçantë për veprat penale kundër mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore (Kapitulli XXVII), në rastet kur jo të gjitha elementet e një vepre të tillë konfirmohen, gjykata duhet ta merr në konsideratë këtë rrethanë për ashpërsim të dënimit. Ndikimi në mjedis duhet gjithnjë të ketë peshë në ashpërsim të dënimit. Se sa do të jetë pesha varet nga serioziteti i këtij ndikimi. Duke pasur parasysh ndryshimet e mëdha klimatike në nivel global, BE në veçanti ka avanuar Direktivat e saj në mbrojtjen e mjedisit duke kërkuar që edhe çështje si investimet në ekonomi, tregtia dhe çështje tjera të jenë në pajtueshmëri me legjislacionin e BE për mbrojtje të mjedisit. Duke qenë se Kosova mbetet ende një shtet jashtë integritetit Evropian, mund të jetë shënjestër e atyre kompanive që tentojnë që me një kosto të ulët të invesojnë në Kosovë pa pasur parasysh ndikimet që investimet e tyre mund të kenë në mjedis. Kompani të tilla mund të jenë të predispozuar në korrupsion të akterëve në Kosovë që do u mundësojnë një investim të tillë. Andaj është me rëndësi që me rastin e zhvillimit të hetimeve dhe trajtimit të këtyre rasteve nga sistemi i drejtësisë, gjithsesi të merret në konsideratë elementi i ndikimit në mjedis, jo vetëm për qëllim të hulumtimit të korrupsionit por edhe për të shërbyer si preventivë e përgjithshme për çfarëdo investimi pa kriter në Kosovë. Indikacionet potenciale për korrupsion janë të

elaboruara me shembuj më në detaje në pjesën e 1rë të këtij Udhëzuesi.

Kodi Penal, neni 70 par 2

2.9 çfarëdo keqpërdorimi të pushtetit ose pozitës zyrtare nga personi i dënuar në kryerjen e veprës penale;

2.10 dëshmi të shkeljes së besimit nga ana e personit të dënuar;

Në rastet kur keqpërdorimi i pushtetit është element i dukshëm dhe i qartë, kjo rrethanë nuk duhet të merret në konsideratë për ashpërsim për shkak të llogaritjes së dyfishtë. Mirëpo, natyra e rrethanave rënduese nga paragrafi 2.9 dhe 2.10 në lidhje me korrupsionin zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare në përgjithësi do të jetë minimale. Për të përcaktuar nëse paragrafi 2.9 është marr në konsideratë tashmë në kuadër të veprës penale, Gjykata duhet ta marrë në konsideratë që keqpërdorimi përfshin si veprimet ashtu edhe mosveprimet, si dhe ushtrimin e autorizimeve përtej atyre që i janë dhënë me ligj.

Ne vijim është paraqitur zbërthim i disa prej nën-rrethanave, të cilat mund të konsiderohen si shtjellim i rrethanave ligjore të paraqitura më lart:

- Keqpërdorimi i pozitës së pushtetit të konsiderueshëm apo besimit ose përgjegjësisë;
- Korrupsioni i synuar (i drejtpërdrejt ose i tërthortë) i një zyrtari të lartë që ushtron funksion publik;
- Korrupsioni i synuar (i drejtpërdrejt ose i tërthortë) i gjyqtarit, prokurorit ose zyrtarit të zbatimit të ligjit;
- Përgjegjësimi i tjerëve në mënyrë të gabueshme.

Hetimi i rasteve të profilit të lartë shpesh karakterizohet nga shkalla e lartë e sofistikutimit në lidhje me metodën e kryerjes së veprës dhe kamuflimit të krimit. Pozita e kryesit është rrethana më e rëndësishme për këtë kategori të veprave penale pasi që përcakton peshën e veprës penale. Sa më e lartë të jetë pozita e kryesit të veprës penale (në Qeveri ose institucione të tjera), aq më i ashpër duhet të jetë dënimi. Si e tillë, vlerësohet se forma më e rëndë e korrupsionit dhe ryshfetit nënkupton ryshfetin e gjyqtarëve, prokurorëve, zyrtarëve të policisë dhe pozitave tjera të ndjeshme. Mungesa e besimit në drejtësi në veçanti është fatale për demokracinë dhe zhvillimin si dhe inkurajon përsëritjen e korrupsionit. Pranimi i ryshfetit ose ryshfeti në tentativë i një personi që është në pozitë për të ndikuar drejtpërsëdrejti në administrimin e drejtësisë është çështje jashtëzakonisht e rëndë dhe parandalimi dhe dekurajimi i përgjithshëm për kryerjen e këtyre veprave është shumë i rëndësishëm. Duke parë përtej vetë veprimeve, për faktin që publiku shpesh ka tendencë që ta shohë gjyqësorin si autoritet të korruptuar, çdo akt korruptimi i sistemit të drejtësisë është veçanërisht i rëndë. Kur qëllimi i ryshfetit është të prishë rrjedhën e drejtësisë, veçanërisht në rastet e një vepre të rëndë penale, kryesit duhet të

ndëshkohen rëndë.

Për qëllime ilustrimi do marrim edhe shembullin pikërisht lidhur me ryshfetin por kësaj radhe lidhur me nenin 422 (Dhënia e ryshfetit) e cila mund të ushtrohet nga kushdo me qëllim që të ndikojë në personin zyrtar. Në këto raste nëse ryshfet jep një person zyrtar për një person tjetër zyrtar atëherë edhe rrethana e keqpërdorimit të pushtetit apo pozitës zyrtare duhet të merret parasysh pasi personi zyrtar nuk përmendet si element i veprës penale. Në këtë rast kjo rrethanë duhet të ketë peshë shumë më të madhe në matjen e dënimit për shkak të pozitës dhe ndikimit që i njëjti ka shfrytëzuar duke qenë si person i mveshur me autoritet zyrtar.

Kodi Penal, neni 70 par 2

2.12. nëse vepra penale është akt i urrejtjes, që nënkupton cilëndo vepër penale të kryer ndaj personit, grupit të personave, ose pronës, motivuar në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, identitetit gjinor, gjuhës, fesë, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronë, gjendjes ekonomike, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal, ose për shkak të afërsisë me personat me karakteristikat e lartpërmendura,, përveç nëse ndonjë nga këto karakteristika përbën element të veprës penale;

Edhe në rastet e veprave penale nga Kapitulli XXXIII, përkatësisht Korrupsionit zyrtar dhe veprave penale kundër detyrës zyrtare, ka raste kur vepra penale nga ky kapitull mund të kryhet ndaj personit ose grupit të personave ose pronës për shkak të origjinës etnike, shtetësisë, gjuhës, besimeve fetare, mungesës së besimeve fetare dhe dallimeve të tjera. Ky dallim mund të shfaqet nga personi zyrtar qoftë shprehimisht ose në mënyrë të heshtur gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare duke qenë kështu në shkelje të neneve 414 par.3 nënpar.3.2, 3.5 dhe 3.6 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Kodi Penal, neni 70 par 2

2.13 ndonjë dënim penal të mëparshëm të personit të dënuar;

Dënimet e mëparshme janë rrethanë shumë e rëndësishëm në matjen e dënimit. Kur të caktohet dënimi për kryesit që janë dënuar edhe më parë, gjykata duhet të marrë parasysh:

- natyrën e veprës penale me të cilën lidhet dënimi dhe rëndësinë ose ngjashmëria e saj me veprën aktuale;
- koha që ka kaluar që nga dënimi paraprak;

Ky vlerësim duhet gjithashtu të përfshijë çdo mosrespektim të urdhrave të gjykatës (përderisa nuk është trajtuar si vepër e veçantë penale sipas nenit 393, Mospërfillja e gjykatës), dorëzaninë, dënimin me kusht etj.

Rrethanat lehtësuese sipas Kodit Penal

Rrethanat përkatëse lehtësuese sipas ligjit

Kodi penal përmban një numër rrethanash lehtësuese në nenin 70 par.3, të cilat duhet të merren parasysh për caktimin e dënimit të duhur të veprës penale. Pothuajse të gjitha rrethanat lehtësuese të numëruara në paragrafin 3 mund të konsiderohen të aplikueshme për këtë kategori të veprave penale, por ka nevojë të zërthehen në më shumë hollësi për ato që janë relevante për llojet e veprave penale të përfshira në këtë udhëzues. Më poshtë është lista e rrethanave lehtësuese që janë më së shumti të aplikueshme për këtë kategori siç përcaktohet nga Kodi penal

- 3.3. rrethanat personale dhe karakteri i personit të dënuar;
- 3.4. dëshmia që personi i dënuar ka luajtur rol relativisht të vogël në veprën penale;
- 3.5. fakti që personi i dënuar ka marrë pjesë në veprën penale jo si kryes kryesor por përmes ndihmës, inkurajimit ose duke ndihmuar tjetrin në ndonjë mënyrë tjetër;
- 3.6. mosha e personit të dënuar, i ri apo i moshuar;
- 3.7. dëshmia që personi i dënuar ka bërë dëmshpërblimin apo kompensimin e viktimës;
- 3.8. bashkëpunimi i përgjithshëm i personit të dënuar me gjykatën, përfshirë dorëzimin vullnetar;
- 3.9. bashkëpunimi i përgjithshëm i personit të dënuar në hetimin ose ndjekjen penale
- 3.10. pranimi i fajit;
- 3.11. keqardhja e shfaqur nga personi i dënuar;
- 3.12. sjellja e personit të dënuar pas konfliktit;

Paragrafët e mëposhtëm shërbejnë për qëllim të grupimit të rrethanave lehtësuese ligjore të ngjashme në të njëjtën kategori, duke shpjeguar rëndësinë e tyre dhe duke përfshirë më shumë hollësi për nën-rrethanat tjera që bien në ato kategori.

Rrethanat që lidhen me rrethanat personale të kryesit

Kodi Penal, neni 70 par 3

3.3 rrethanat personale dhe karakteri i personit të dënuar;

3.6 mosha e personit të dënuar, i ri apo i moshuar;

Këto rrethana përfshijnë rrethana të ndryshme që zakonisht tregojnë një cilësi ose situatë të caktuar të kryesit, të cilat qojnë peshë në lartësinë e dënimit të shqiptuar. Rrethanat janë shtjelluar më me hollësi në vijim:

- Karakteri i mirë dhe/ose sjellja shembullore;
- Moshë;
- Pendimi;
- Kushtet e rënda mjekësore që kërkojnë trajtim urgjent, intensiv ose afatgjatë;
- Kujdestar i vetëm ose parësor i familjarëve të varur nga ai/ajo;
- Nuk është motivuar nga përfitimi personal;
- Vetëdije të kufizuar të peshës së veprimeve korruptive.
- Koha e kaluar që nga zbulimi, kur kalimi i kohës nuk ka rrjedh si rezultat i veprimit apo sjelljes së kryesit.

Ajo që është vërejtur nga analiza e vendimeve të gjykatës është se gjykata zakonisht i referohet vetëm rrethanave të ndryshme lehtësuese dhe në veçanti atyre që lidhen me rrethanat personale të kryesve pa bërë përpjekje për ta përcaktuar të vërtetën prapa një rrethane lehtësuese personale si p.sh. duke kërkuar dëshmi ose dokumente mbështetëse për gjendjen financiare të të pandehurit, sigurimin e mbështetjes për familjen/fëmijët, kushtet mjekësore etj.⁴⁶ Derisa rrethanat e mësipërme mund të jenë shumë të rëndësishme për rastet individuale, pesha e tyre duhet të vlerësohet në matjen e dënimit dhe si rregull i përgjithshëm e njëjta duhet të ketë peshë shumë më të vogël në krahasim me rrethanat që lidhen me dëmin e shkaktuar apo/dhe përgjegjësinë e kryesit. Duke qenë se përdorimi i rrethanave lehtësuese të kësaj kategorie është shumë i pranishëm për të gjitha kategoritë e veprave penale, konsiderohet se një zbrëthim i mëtutjeshëm i tyre e ka vendin në udhëzuesin e përgjithshëm dhe gjykata duhet referuar në atë Udhëzues. Megjithatë ajo që duhet potencuar, dhe që është potencuar në vazhdimësi, është se tek veprat e këtij kapitulli, rrethanat e tilla duhet të luajnë një rol minimal në matjen e dënimit dhe as për së afërmi të mos kenë peshën e rrethanave që lidhen me dëmin dhe përgjegjësinë e kryesit. Natyrisht siç është potencuar në vazhdimësi, në një sistem akuzator kërkohet angazhim më i madh i palëve (prokurorit dhe mbrojtjes) në ofrimin e të dhënave të mbështetura në mënyrë që gjykata të bëjë një përcaktim nëse rrethanat e tilla qëndrojnë dhe nëse kanë peshë të mjaftueshme sa të ndikojnë në uljen e dënimit. Duke iu referuar prapë Udhëzuesit për politikë

⁴⁶ Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, Analizë e Politikës ndëshkimore në rastet e korrupsionit, fq.17, Prishtinë 2019.

ndëshkimore, aty gjejmë një numër shembujsh të dhënë në veçanti nga Tribunali për ish-Jugosllavi që i referohen vendimmarrjes së këtij tribunali lidhur me rrethanat personale të kryesit.⁴⁷ Është karakteristike se nga praktika e gjykatave në Kosovë ende nuk ka një përcaktim të qartë se çfarë konsiderohet moshë e re dhe çfarë moshë e shtyrë. Moshë e re konsiderohet si dikush që ka arritur moshën 21 vjeç, 35 apo edhe 40 vjeç, gjersa mosha si rrethanë lehtësuese i referohet edhe moshës mbi 55 vjeç.

Kodi Penal, neni 70 par 3

3.4 dëshmia që personi i dënuar ka luajtur rol relativisht të vogël në veprën penale;

3.5 fakti që personi i dënuar ka marrë pjesë në veprën penale jo si kryes kryesor por përmes ndihmës, inkurajimit ose duke ndihmuar tjetrin në ndonjë mënyrë tjetër;

Rrethanat e mësipërme janë kryesisht të tilla që tregojnë Përgjegjësi më të ulët të të pandehurit. Të njëjtat janë elaboruar bashkë edhe në Udhëzuesin e përgjithshëm për Politikë ndëshkimore më saktësisht në pikën 6.5 të këtij Udhëzuesi.⁴⁸ Ato janë veçanërisht domethënëse sepse këto kategori e veprave penale shpesh mund të kryhen si pjesë e aktivitetit grupor. Gjykata duhet të përcaktojë nivelin e Përgjegjësisë për kryesit individual dhe të caktojë dënimin për ta bazuar në nivelin e Përgjegjësisë. Si të tillë tregues të nivelit më të ulët të Përgjegjësisë do të ishin:

- Roli më i vogël ose periferik në veprimtarinë e organizuar;
- Të përfshirë përmes dhunës, shtrëngimit, frikësimit ose shfrytëzimit;
- Planifikim shumë i vogël ose joekzistues;
- Vepër penale oportuniste, e kryer një herë të vetme;

Natyrisht kur i referohemi rrethanës se vepra është kryer përmes shtrëngimit, frikësimit ose shfrytëzimit, duhet të kemi parasysh edhe dispozitat e Kodit penal të cilat përjashtojnë përgjegjësinë në rast të dhunës, shtrëngimit apo kanosjes së papërbalueshme. Rrethana e mësipërme më saktësisht i referohet paragrafëve 2 dhe 3 të nenit 14 dhe paragrafit 3 të nenit 15 me të cilat dispozita edhe është thënë shprehimisht se këto rrethana mund të ndikojnë në zbutjen e dënimit.

Kodi Penal, neni 70 par 3

3.7. dëshmia që personi i dënuar ka bërë dëmshpërblimin apo kompensimin e viktimës;

3.8. bashkëpunimi i përgjithshëm i personit të dënuar me gjykatën, përfshirë dorëzimin vullnetar;

3.9. bashkëpunimi i përgjithshëm i personit të dënuar në hetimin ose ndjekjen penale;

3.10. pranimi i fajit;

3.11. keqardhjen e shfaqur nga personi i dënuar;

3.12. sjelljen e personit të dënuar pas konfliktit;

⁴⁷ Ibid. supra note 5, fq.110-121.

⁴⁸ Ibid. supra note 5, fq.115.

Është fakt i njohur se veprat penale të lidhura me korrupsionin janë nga veprat më të vështira për tu provuar sepse në shumicën e rasteve të dy palët kanë një lloj interesi ose ekzistojnë disa rrethana tjera që e bëjnë të vështirë raportimin e tyre nga viktimat e mundshme apo edhe bashkëkryesit. Për shkak të arsyeve të mësipërme, rrethanat procedurale të elaboruara në këtë pjesë mund të luajnë rol të rëndësishëm në procesin e vendimmarrjes për caktimin e dënimit dhe si rrjedhojë edhe në shqiptimin e dënimit përfundimtar. Sidoqoftë, përdorimi i tyre ashtu si të rrethanat tjera duhet të arsyetohet siç duhet.

- **Sjellja korrekte e kryesit.**- është një nga rrethanat më së shpeshti të përdorura nga gjykatat nga ana e kryesit. Siç është shpjeguar në Udhëzuesin e përgjithshëm për politikën ndëshkimore⁴⁹ kjo është rrethanë konfuze që mezi mund të thuhet se kualifikohet si rrethanë lehtësuese. Kjo ‘rrethanë’ është bërë pjesë e terminologjisë gjyqësore gjatë shqiptimit të dënimeve pa specifikuar në asnjë rast se çka nënkupton kjo rrethanë dhe në veçanti në rastet e korrupsionit të trajtuara në raportin analitik të Komisionit Këshilldhënës për Politikë Ndëshkimore. Paraqitja në gjykatë siç është urdhëruar, mos prishja e rendit në proces gjyqësor dhe trajtimi i të tjerëve me respekt minimal janë detyrime themelore të të qenit qytetar i Republikës së Kosovës dhe nuk meritojnë shpërblim me zbutje të dënimit. Natyrisht, ligji lejon përdorimin e kësaj rrethane, por ajo duhet të kuptohet siç duhet dhe të përdoret në raste të kufizuara.⁵⁰
- **Dëmshpërblimi.**- pagesa e kompensimit apo dëmshpërblimi nga ana e kryesit është rrethanë e rëndësishme që mund të ndikojë në një dënim më të ulët edhe tek veprat penale nga ky kapitull. Megjithatë, është e rëndësi të bëhet dallimi nëse kompensimi apo dëmshpërblimi është bërë në mënyrë vullnetare dhe meritore nga kryesi ende pa u urdhëruar nga gjykata. Në këtë rast do të konsiderohej edhe si shprehje e pendimit nga kryesi.
- **Te bashkëpunimi i kryesit me gjykatën** përfshirë dorëzimin vullnetar është e rëndësishme që ky bashkëpunim të jetë i sinqertë dhe të minimizojë shpenzimet e gjykatës për ta sjell kryesin në seancë gjyqësore, në mënyrë që të merret si rrethanë lehtësuese me rastin e caktimit të dënimit.
- **Rrethana e pranimit të fajit** dhe ajo e keqardhjes së shfaqur nga personi i dënuar ndodh shpesh që të dyfishohet në llogaritjen e dënimit përfundimtar. Kjo për arsye se keqardhja e shfaqur paraqet një lloj të pranimit të fajit. Pranimi i fajit si rrethanë lehtësuese është i rëndësishëm dhe i jepet pesha e duhur varësisht nga koha e pranimit. Duke pasur parasysh ekonomizimin e procesit gjyqësor gjegjësisht shmangies së shpenzimeve të mëdha të procesit gjyqësor, pranimi i hershëm i fajit është bazë për zbutje më të madhe të dënimit se rasti i momentit të fundit të gjykimit kur i pandehuri bindet se nga administrimi i të gjitha provave gjasat janë që do të shpallet fajtor dhe do të dënohet andaj edhe, vendos ta pranoj Përgjegjësinë me qëllim që të përfitojë nga

⁴⁹ Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, Udhëzues për politikën ndëshkimore, Kosovë, 15 shkurt 2018.

⁵⁰ Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, Analizë e Politikës ndëshkimore në rastet e korrupsionit, fq.17, Prishtinë 2019.

zbutja e dënimit.

Kategorizimi i rrethanave dhe elementeve me peshë në matjen e dënimit tek veprat nga Kapitulli XXXIII

Pas zberthimit në detaje të dispozitave të KPRK që kanë të bëjnë me rrethanat lehtësuese dhe rënduese që mund të jenë relevante në matjen e dënimit tek veprat e kësaj kategorie, për ta bërë më të lehtë për Gjykatën peshimin e këtyre rrethanave si dhe mënyrën se si shprehen elementet e ndryshme të veprës penale, më poshtë janë dhënë dy kategori të tabelave. Tabelat e mëposhtme japin një pasqyrim se si mund të peshohen rrethanat e ndryshme për nga rëndësia e tyre. Tabelat i orientojnë gjyqtarët mbi atë se cilat nga rrethanat e elaboruara më sipër bijnë në kuadër të rrethanave që lidhen me Përgjegjësinë e kryesit apo lartësinë e dëmit të shkaktuar pa marrë parasysh nëse janë të shprehura si rrethana apo si element i veprës penale- pra duke i analizuar dhe peshuar me të njëjtën logjikë. Me rëndësi është të kuptohet se rrethanat e mëposhtme i referohen vetëm shkallës së Përgjegjësisë dhe Dëmit, të cilat edhe sipas Udhëzuesit të përgjithshëm të politikës ndëshkimore konsiderohen rrethanat më të rëndësishme në matjen e dënimit. Për qëllim të kalkulimit më të lehtë këto rrethana janë grupuar në kategori. Kombinimi i kategorive shpie deri tek shtrirje e dënimit.

Kategoritë e mëposhtme pra i referohen vetëm fajit dhe dëmit dhe nuk përfshijnë:

- **Recidivizmin** - Kjo për faktin se për këtë është e elaboruar më qartë edhe në dispozitat e Kodit penal që lidhen me ashpërsimin përtej kufirit të paraparë maksimal për atë vepër.
- **Rrethanat personale të pandehurit; apo**
- **Rrethanat procedurale.**

Këto dy të fundit më pas mund të ndikojnë në lartësinë e dënimit brenda diapazonit të dënimit të paraparë në tabelat e parapara në pjesën e dytë të këtij Udhëzuesi ku janë përfshirë tabelat për secilën vepër penale veç e veç. Në këtë mënyrë ky Udhëzues hap pas hapi fillon nga pjesa më e përgjithshme për matjen e dënimit për të kaluar më pas edhe në rekomandime dhe ilustrime konkrete se si mund të bëhet matja e dënimit sipas sanksionit të paraparë me secilin nen dhe paragraf të këtij Kapitulli.

Përgjegjësia

Tabela e mëposhtme jep një zberthim dhe njëkohësisht edhe grupim të rrethanave të cilat kanë të bëjnë me Përgjegjësinë e të pandehurit ose për të bërë diferencimin kur të njëjtat janë të shprehura si elemente të veprës penale ose kur mund të jenë të shprehura si rrethana në matjen e dënimit. P.sh. fakti se dikush është person zyrtar është element i veprës penale në shumicën e veprave nga ky kapitull por është me rëndësi (siç u përmend në pjesën narrative por edhe siq është shprehur në tabelën e mëposhtme), se çfarë pozite zyrtare mban ai person, a është pozitë

e lartë/me influencë apo pozitë me më pak ndikim. Në veprat ku personi zyrtar nuk paraqitet si element i veprës penale (neni 415, 420, 422, 423 dhe 424) fakti se personi i përfshirë në atë vepër është person zyrtar në një pozitë të lartë/me influencë apo pozitë më të ulët/më me pak ndikim paraqitet si rrethanë në kuadër të paragrafit 2.9 të nenit 70 të KPRK, dhe sipas zbërthimit të kësaj rrethane në këtë Udhëzues, duhet të ketë ndikim në matjen e dënimit sipas tabelave përkatëse të shprehura për ato nene. Tabela ka për synim të ju ndihmojë gjyqtarëve në përcaktimin e peshës që mund ti japin rrethanave që lidhen me Përgjegjësinë duke u bazuar në intenzitetin/shkallën e shprehur të asaj Përgjegjësie. Kjo arrihet duke peshuar të gjitha rrethanat që lidhen me rastin si dhe duke gjetur rolin dhe shkallën e përfshirjes së të pandehurit, përpjekjet e ndërmarra në planifikimin dhe kryerjen e veprës. Në rastet kur elementet gjyqtari gjen rrethana të Përgjegjësisë veç e veç në kategoritë e ndryshme të Përgjegjësisë, atëherë gjykata do të vlerësojë cilat nga ato rrethana është më dominuese dhe më pas llogaritjen e dënimit e bën sipas tabelës përkatëse për atë kategori dominuese.

Përgjegjësia demonstron nga një ose më shumë rrethana si më poshtë:

A – Përgjegjësi e lartë
Bërja e kërkesës
Rol udhëheqës, kur kryerja e veprës penale është pjesë e veprimtarisë grupore
Përfshirja e të tjerëve përmes presionit, ndikimit
Keqpërdorimi i pozitës së fuqisë së konsiderueshme ose besimit ose përgjegjësisë
Personi zyrtar në pozitë të lartë lokale apo qendrore apo funksion të rëndësishëm (zyrtar i lartë, prokurorë, gjyqtarë, zbatues të ligjit etj)
Natyra e sofistikuar e veprës penale / shkalla e lartë e planifikimit/vepër transnacionale
Vepra penale e kryer gjatë një periudhe kohore të vazhdueshme
Përpjekja apo angazhimi për të fshehur apo shkatërruar provat
Vepra e kryer për ta lehtësuar aktivitetin tjetër kriminal
B – Përgjegjësia e mesme
Rol i rëndësishëm kur kryerja e veprës penale është pjesë e veprimtarisë në grup
Përfshirja e të tjerëve përmes mashtrimit
Raste të tjera që bien midis kategorive A ose C sepse:
Faktorët janë të pranishëm në A dhe C të cilët ekuilibrojnë njëri-tjetrin ose
Përgjegjësia e kryesit të veprës penale bie midis faktorëve të përshkruar në A dhe C
C – Përgjegjësi e ulët
Kryesi i veprës penale i përfshirë përmes shtrëngimit, frikësimit ose shfrytëzimit
Roli i vogël apo periferik në veprimtarinë e organizuar
Paraqitet si vepër e parë ‘oportuniste’;
Personi zyrtar në pozitë shumë të ulët
Nuk është motivuar nga përfitimi personal
Shumë pak ose aspak planifikim

Dëmi

Dëmi nuk demonstron vetëm nga lartësia e dëmit të kuantifikuar por edhe në rrethanat mund të përmbajë një ose më shumë rrethana të mëposhtme. Në shumicën e rasteve nga ky Kapitull lartësia e dëmit e shprehur në vlerën monetare në Euro paraqet element të veprës penale. Edhe pse ky element bën që të ndryshojë edhe lartësia e dënimit nga njëri paragraf në tjetrin, KPRK nuk e bën lidhjen mes lartësisë së dëmit të shprehur në para me atë se kush e shkakton atë dëm për ta peshuar siç duhet. Njëkohësisht, në shumicën e paragrafëve vetëm referohet p.sh. në dëmin mbi 5000€ por nuk bëhet diferencimi veç e veç për dëmin e konsiderueshëm, substancial apo dëmin në shkallë të madhe siç i ndan Neni 113 par.3.1-3.4 të KPRK. Pikërisht kjo është arsyeja pse në tabelat e dhëna për secilin paragraf dhe nen në pjesën e fundit të këtij Udhëzuesi është bërë ky dallim. Në mënyrë që dënimi i shqiptuar të jetë sa më proporcional me dëmin e shkaktuar dhe në raport me përgjegjësinë e kryesit.

Megjithatë, siç u shpreh edhe më lartë, dëmi jo domosdoshmërisht shprehet vetëm në vlerë monetare. Tabela e mëposhtme përfshin edhe një mori rrethanash të zërthyer qoftë në formën narrative më sipër qoftë në tabelën e mëposhtme. Sa më shumë rrethana që shprehen në një rast aq më i rëndë është dëmi edhe brenda vet një kategorie dhe rrjedhimisht meriton edhe dënimin maksimal brenda diapazonit apo kalim në kategori më të lartë të diapazonit. Dëmi vlerësohet në bazë të ndikimit që ka pasur kryerja e veprës në kontekst individual apo më të gjerë dhe përfitimi i synuar apo konkret⁵¹. Njëjtë siç është shprehur edhe më sipër lidhur me Përgjegjësinë, i njëjti parim vlen edhe për shkallën e dëmit kur i njëjti nuk është vetëm financiar, apo nuk ka të bëjë fare me rrethanë financiare por me rrethanat tjera të shprehura më poshtë veç e veç. Në rastet kur gjyqtari gjen rrethana të dëmit veç e veç në kategoritë e ndryshme të dëmit, atëherë gjykata do të vlerësojë cilat nga ato rrethana janë më dominuese dhe më pas llogaritjen e dënimit e bën sipas tabelës përkatëse për atë kategori dominuese.

Kategoria 1 (i lartë)
Dëm, shkatërrim ose humbje në shkallë të madhe (>50.000€) dhe/ose
Efekt serioz dëmtues për individët (për shembull nga ofrimi i mallrave ose shërbimeve standarde që vijnë nga sjellja korruptive)
Ndikim serioz mjedisor, urban apo në shëndetin publik
Ndikimi më i gjerë në shoqëri
Ndikim në kategori të ndjeshme apo fondeve që ndërlidhen me këto kategori
Motivuar në masë të madhe nga fitimi financiar, politik, ekonomik apo avantazhi tregtar
Dëmi ka të bëjë me dokumente/çështje të rëndësishme madhore (psh, siguria nacionale, buxheti shtetëror etj).

⁵¹ Udhëzuesi definitiv për Mashtrimin, Ryshfetin dhe shpërlarjen e parave, Britania e Madhe [U.K Sentencing Council, Fraud, Bribery and Money Laundering Definitive Guidelines], fq.42, 1 tetor 201

Kategoria 2 (i mesëm)
Dëm i madh, dëm substancial ose humbje substanciale (15.000-50.000€) dhe/ose
Efekt i konsiderueshëm dëmtues tregtar, biznesor, buxhetor apo tjetër tek individët, institucioni apo organizata
Ndikim i konsiderueshëm mjedisor dhe urban
Keqpërdorim i konsiderueshëm i funksionit të duhur të qeverisjes lokale apo qendrore
Fitimi i një avantazhi të konsiderueshëm tregtar/biznesor
Rrezik për dëm nga kategoria 1

Kategoria 3 (i ulët)
Dëm i konsiderueshëm ose humbje e konsiderueshme (5000-15.000€) dhe/ose
Ndikim i kufizuar i dëmshëm për individët, mjedisin, qeverinë, biznesin ose shërbimet publike
Fitim i kufizuar financiar
Rrezik për shkaktim të dëmit nga kategoria 2

Kategoria 4 (minimal)
Dëm në vlerë të vogël apo maksimum deri në 5000€ dhe/ose
Ndikim minimal i dëmshëm për individët, mjedisin, qeverinë, biznesin ose shërbimet publike
Synim për fitim të kufizuar
Rrezik për shkaktim të dëmit nga kategoria 3

Dënimet plotësuese

Me hyrjen në fuqi të Kodit të ri penal dhe veçanërisht me ndryshimet në nenin 62 dhe 63, Gjykatave u jepen udhëzime të qarta për caktimin e dënimeve plotësuese për zyrtarët që kanë keqpërdorur detyrën e tyre. Zgjerimi i këtyre dispozitave është bërë për shkak të rëndësisë dhe shpeshësisë së veprave penale që lidhen me funksionet zyrtare dhe nevojës për largimin e kryesit nga ai mjedis për një periudhë kohore përtej asaj të caktuar në dënimin kryesor/alternativ. Ndalimet e tilla për zyrtarët publik janë thelbësore jo vetëm për të siguruar besimin e publikut në administratë, por shërbejnë edhe si masë individuale dhe e përgjithshme e parandalimit të veprave të tilla në administratën publike.

Ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik⁵²

Është e rëndësishme për gjykatën që neni 62 i Kodit penal krijon sistem me shumë nivele në lidhje me ushtrimin e funksionit publik pas shqiptimit të dënimit për një vepër, varësisht nga lloji i dënimit dhe vepra penale. Më poshtë janë dispozitat kryesore që përfshijnë shpjegim të dënimit plotësues, si dhe disa interpretime të rëndësishme.

1. Gjykata ia ndalon kryesit ushtrimin e funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik prej një (1) deri në pesë (5) vjet pas mbajtjes së dënimit me burgim,

⁵² Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Nr.06/L-074, neni 62 ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik, botuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më datën 14.01.2019

- nëse personi i tillë ka keqpërdorur këto funksione dhe është dënuar me burgim.*
- 2. Gjykata mund t'ia ndalojë kryesit ushtrimin e funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik prej një (1) deri në tre (3) vjet, nëse personi i tillë i ka keqpërdorur këto funksione dhe është dënuar me gjobë ose me dënim me kusht.*
 - 3. Gjykata ia ndalon një personi zyrtar ushtrimin e funksionit në administratë publike apo funksioneve të shërbimeve publike prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet pas mbajtjes së dënimit me burgim, nëse personi është dënuar për ndonjë nga veprat që përfshihen në Kapitullin XXXIII të këtij Kodi.*

- **Paragrafi 1**

Kërkon nga Gjykata që nëse e dënon të pandehurin me burgim, t'ia ndalojë atij ushtrimin e funksionit publik për 1-5 vjet. Periudha fillon pas vuajtjes së dënimit me burgim.

Dispozita kërkon një formë të keqpërdorimit të administratës publike ose funksionit publik gjatë kryerjes së veprës penale. Është e rëndësishme të theksohet se nuk kërkohet që abuzimi të jetë njëri nga elementet e veprës penale ose që të ngritet akuzë formale për keqpërdorimin e autorizimeve. Në fakt, nuk ka asnjë mënyrë kualifikuese se sa i rëndësishëm ose domethënës është ushtrimi i autoritetit publik për kryerjen e veprës penale ose nuk kërkon të ketë ndonjë lidhje midis këtyre dyjave. Sidoqoftë, duhet të ekzistojë një lidhje midis të dyjave dhe për sa kohë që abuzimi e ndihmon kryerjen e veprës penale në çfarëdo mënyre, pezullimi është i domosdoshëm.

Së fundmi, paragrafi 1 kërkon ndalimin e ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik. Është e rëndësishme që Gjykata ta ketë para sysh se kjo NUK kufizohet vetëm në pozitën që i pandehuri e ka mbajtur në kohën e kryerjes së veprës penale. Dispozita kërkon një ndalim të përgjithshëm të ushtrimit të funksionit në administratën ose shërbimin publik. Për shembull, nëse i pandehuri i keqpërdor autorizimet e tij si inspektor ndërtimi, Gjykata kërkohet që t'ia ndalojë ushtrimin e funksioneve në gjithë administratën publike dhe shërbimin publik.

- **Paragrafi 2** – përfshin të gjitha kriteret e paragrafit 1, përveç:
 - Diskrecionit për caktimin e ndalimit,
 - Periudha e ndalimit është 1-3 vjet dhe fillon në momentin kur aktgjykimi merr formë të prerë, dhe
 - Dënimi i shqiptuar është dënim me gjobë ose me kusht.
- **Paragrafi 3** - paraqet risi në dënimet plotësuese në vitin 2019 dhe duhet të interpretohet si vijon:
 - I pandehuri duhet të jetë person zyrtar,
 - Dënimi kryesor duhet të jetë me burgim dhe dënimi plotësues fillon pas vuajtjes së dënimit;
 - Periudha e pezullimit është 1-10 vjet dhe NUK është e kufizuar në pezullimin për pozitën në të cilën i pandehuri ishte duke shërbyer në kohën e kryerjes së veprës

- penale, dhe
- I pandehuri është i dënuar për veprë penale nga Kapitulli XXXIII. Është e rëndësishme që Gjykata të ketë në mendje se kriteri i vetëm është dënimi për veprë penale nga Kapitulli. Nuk ka kriter që vepra penale të jetë e lidhur ose të lidhet drejtpërdrejt me pozitën zyrtare të mbajtur nga i pandehuri në atë kohë ose me kohën e ushtrimit të autorizimeve zyrtare.

Duke pasur parasysh që Kapitulli XXXIII përmban disa vepra penale me mundësi të dënimeve alternative (shiko më poshtë për më shumë detaje mbi veprat e tilla penale) dhe Paragrafi 3 vlen vetëm për dënimet me burgim, kur shqipton dënim me gjobë ose me kusht, Gjykata mund dhe duhet të merr fuqishëm në konsideratë ndalimin sipas paragrafit 2.

Ndalimi i ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës⁵³

1. Gjykata mund t'ia ndalojë kryesit të veprës penale ushtrimin e profesionit të caktuar, veprimtarisë së pavarur, detyrës menaxhuese apo administrative ose detyrave që janë të lidhura me sistemimin, menaxhimin apo shfrytëzimin e pasurisë në pronësi publike apo mbrojtjen e pasurisë së tillë, nëse ai person e ka keqpërdoruar pozitën e tij, veprimtarinë apo detyrën me qëllim të kryerjes së veprës penale ose nëse ka arsye të pritet që ushtrimi i profesionit, veprimtarisë apo detyrës së tillë nga ai mund të keqpërdoret për kryerjen e veprës penale.

2. Gjykata ia ndalon një personi zyrtar ushtrimin e profesionit, aktivitetit të pavarur, të detyrës menaxhuese apo administrative prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet, nëse personi është dënuar për ndonjë nga veprat në Kapitullin XXXIII të këtij Kodi.

Ndonëse neni 62 dhe 63 janë disi të ngjashëm në ndalimin e formave të punësimit, ato ndryshojnë në një aspekt kryesor - objektin e ndalimit. Derisa neni 62 përqendrohet në ndalimin që lidhet me keqpërdorimin e pozitës aktuale të personit, neni 63 lejon gjykatën që ta zgjerojë ndalimin në fushë më të gjerë të individëve nga një profesion ose veprimtari tjetër që nënkupton personat që nuk shërbejnë aktualisht në pozita publike por që në të ardhmen nuk mund të ushtrojnë asnjë detyrë që lidhet me sistemimin, menaxhimin apo shfrytëzimin e pasurisë në pronësi publike. Më poshtë janë dispozitat kryesore që përfshijnë shpjegim të dënimit plotësues dhe disa interpretime të rëndësishme.

- **Paragrafi 1**

- **Kryesi ushtron profesion/veprimtari të pavarur/detyrë menaxhuese apo administrative dhe që lidhet me shitjen, menaxhimin ose shfrytëzimin e pronës publike ose mbrojtjen e saj.** Është e rëndësishme këtu që kriteri i vetëm është që pozita të lidhet me shitjen, administrimin ose përdorimin e pronës publike ose mbrojtjen e saj. Nuk

⁵³ Po aty. [Neni 63, Ndalimi i ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës]

kërkohej që i pandehuri të shërbejë në pozitë të shërbimit ose administratës publike. Andaj, punonjësi i një kontraktuesi privat i kontraktuar nga shteti i plotëson kriteret për ndalim për sa kohë që ekziston një lidhje me pronën publike ose mbrojtjen e saj.

- Nëse ai person ka keqpërdorur pozitën në kryerjen e veprës penale OSE (2) ka arsye për të pritur që ushtrimi i autorizimeve mund të keqpërdoret për kryerjen e veprës penale. Këtu përsëri, (1) nuk kërkohej elementi i keqpërdorimit të autorizimeve ose nivel i rëndësisë së veçantë që keqpërdorimi të luaj rol në kryerjen e veprës penale. Duhet të ketë keqpërdorim vetëm në kryerjen e veprës penale. Sa i përket pjesës pasuese (2), aty kemi shkëputje të plotë midis veprës penale dhe keqpërdorimit të ndonjë autorizimi. Këtu Gjykata vetëm duhet të vijë në përfundim se ka arsye për të besuar se i pandehuri mund ta keqpërdorë marrëdhënien për të kryer veprë penale.

- **Paragrafi 4**

- I ngjashëm në thelb me nenin 62, te paragrafi 4 kriteret parësore përqendrohen te kryesi si person zyrtar dhe kryerjen e një veprë nga Kapitulli XXXIII, pavarësisht se a ka ndonjë lidhje midis veprës penale dhe pozitës së të pandehurit.
- Aty ku ky paragraf ndryshon shumë, është te aftësia e Gjykatës për ta ndaluar ushtrimin e ndonjë profesioni, veprimtarie ose detyre përtej asaj që personi zyrtar mban në kohën e kryerjes së veprës penale. Megjithëse të dyja zakonisht do të jenë të lidhura, nëse Gjykata beson se një ndalim më i madh ose më gjithëpërfshirës është i nevojshëm, ajo mund ta bëjë këtë.

Sipas kësaj dispozite ligjore Gjykata nuk ka diskrecion pasi norma është e natyrës imperative. Përveç kësaj, duhet cekur se ky dënim plotësues nuk është i lidhur me llojin e dënimit kryesor të dhënë. Pra, pavarësisht llojit të dënimit kryesor (dënim me burgim, me gjobë apo alternativ), gjykata ka për obligim shqiptimin e tij në rastet kur personat zyrtarë kryejnë vepra penale të parapara në kapitullin e veprave penale kundër korrupsionit dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare.

Dënimet plotësuese nga nenet e mësipërme konsiderohen si hap shumë i rëndësishëm për integritetin e pozitave publike dhe në veçanti në lidhje me proceset e prokurimit të cilat kritikohen më së shumti nga publiku. Derisa ndalimi i përgjithshëm për veprat penale të lidhura me korrupsionin përcaktohet në nenet e mësipërme, ligjvënësi ka paraparë edhe ndalime më specifike për shkelje që lidhen me prokurimin duke përfshirë në nenin 415 par.4 të veprës penale të "Keqpërdorimit dhe mashtrimit në prokurim publik" dispozitë që thotë se "*Në rastet e shpalljes fajtor të kryesit, përveç dënimit, gjykata do t'i shqiptojë kryesit ndalimin e marrjes pjesë në procedurat për dhënien e kontratave në prokurim publik.*" Me sa duket, për veprat penale të lidhura me prokurimin, ligjvënësi e ka paraparë këtë ndalim pavarësisht nga lartësia e dënimit.

Ligji për përgjegjësinë e personave juridikë⁵⁴ ka paraparë që ndalime të tilla mund të bëhen edhe kundër personave juridikë. Përveç gjobës, Ligji përcakton gjithashtu që Gjykata mund të lëshoj masa tjera sigurie⁵⁵, që përfshijnë konfiskimin.

Urdhrat për kompensim

Neni 61 i KP kërkon që Gjykata të urdhërojë dëmshpërblimin ose kompensimin për çdo veprë penale që përfshin "vjedhjen, humbjen, dëmtimin ose shkatërrimin e pasurisë". Ky është dënim plotësues për të gjitha veprat penale që plotësojnë kriteret e mësipërme dhe duhet të vlerësohet gjithmonë kur i pandehuri ka aftësi për të paguar. Urdhrat për kompensim duhet të kenë përparësi ndaj gjobave të caktuara si dënim kryesor nëse Gjykata konstaton se kryesi nuk është në gjendje t'i paguajë të dyja dhe se gjoba duhet të zëvendësohet me dënim tjetër kryesor ose alternativ.

Në shumicën e rasteve, viktimat e veprave nga Kapitulli XXXIII do të jetë shteti, por Gjykata duhet ta shohë nga aspekti se përfundimisht viktimë e këtyre veprave janë vetë taksapaguesit e Kosovës. Andaj, edhe kthimi i atyre fondeve duhet të jetë prioritet për gjyqësorin.

Në shumë raste, përfitimi material i kryesit të veprës penale është i barabartë me lartësinë e dëmit të shkaktuar viktimës. Në këto situata, Gjykata duhet ta konfiskojë përfitimin material dhe me të të përmbushë kërkesën për kompensim/dëmshpërblim. Mirëpo, mosrealizimi i kërkesës për konfiskim të përfitimeve materiale nuk duhet të ndikojë në aftësinë e Gjykatës për t'ia dhënë shumën si dëmshpërblim viktimës kur të dyja janë të njëjta nëse viktimat ka përmbushur sa duhet kriteret për kërkesë pasurore-juridike. Së fundmi, është e mundur që kërkesa për kompensim të jetë më e gjerë dhe më e madhe se shumta e masës së konfiskimit nëse ka dëm shtesë përtej shumës së përfitimit material nga krimi.

Dënimi me kusht

Së bashku me parimin e parandalimit të krimit, një tjetër parim themelor i caktimit të dënimit është kontributi për respektimin e ligjit dhe ruajtjen e një shoqërie të drejtë, paqësore dhe të sigurt. Përdorimi i duhur i dënimeve me kusht është përbërës i rëndësishëm i këtij parimi dhe krijon mekanizëm për ta bërë dënimin proporcional dhe të mëshirshëm kur një gjë e tillë është e përshtatshme. Mirëpo, nëse përdoret tepër, ose përdoret pa dallim dhe pa arsytim, ai mund të bëjë që të humbë besimi i publikut për sistemin e drejtësisë dhe efektin e tij parandalues. Shqiptimi i dënimit me kusht pa përmendur rrethanat që paraqesin rrethanë jashtëzakonisht lehtësuese që do të shpinin në zbutje të dënimit dhe pa i arsytuar ato paraqet tejkalim të autorizimeve që një gjykatë ka me ligj.

Megjithatë Kodi Penal lejon përdorimin e dënimit me kusht për një gamë të gjerë të veprave

⁵⁴ Ligji për përgjegjësinë e personave juridikë i botuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, neni 12 Dënimi me kusht, 14 shtator 2011.

⁵⁵ Po aty. [Neni 13 Masat e sigurisë]

penale, përfshirë disa të rënda, gjyqtarët duhet të mbajnë në mend parimet dhe qëllimin e dënimit para se të vendosin për shqiptimin e dënimit të tillë një të pandehuri për veprat penale të lidhura me korrupsionin. Vetëm për shkak se Kodi lejon një mundësi të tillë nuk do të thotë se ekziston mundësi absolute për shqiptimin e dënimit me kusht. Në veçanti, gjykatat duhet ta shpjegojnë pse kërcënimi i dënimit me burg, si përbërës thelbësor i dënimit me kusht, është i mjaftueshëm për ta rehabilituar të pandehurin dhe ende t'i shërbejë qëllimeve të tjera të dënimit.

Krahas shqiptimit të obligimeve tjera, tek veprat që lidhen me korrupsion dhe keqpërdorim të detyrës zyrtare është po aq e rëndësishme shqiptimi i dënimit plotësues që ka të bëjë me ndalimin e ushtrimit të funksionit, edhe me rastin e shqiptimit të dënimit me kusht, e që tanimë me Kodin e ri shqiptimi i këtij dënimi është mandator për gjykatën.

Më në fund, kur shqiptohet dënimi me kusht, ai duhet të shoqërohet me detyrime të tjera për të pandehurin. Detyrimet e tilla janë të numëruara në nenin 56 të Kodit dhe detyrimet më të rëndësishme për këtë kategori të kryerësve do të ishin tre detyrimet në vijim⁵⁶:

1.12. të kompensojë ose dëmshpërblejë viktimën e veprës penale;

1.13 të kthejë dobinë pasurore të fituar me kryerjen e veprës penale;

1.15. të ofrojë raporte financiare siç kërkohet nga gjykata.

Dënimi me kusht është paraparë edhe me Ligjin për përgjegjësinë e personave juridikë, i cili në këtë rast do të nënkuptonte pezullimin e dënimit me gjobë prej 50.000 € me një kohë verifikimi prej 2 vite nëse krimi është kryer për qëllime të përfitimit material.⁵⁷

Po aq e rëndësishme sa arsyetimi i Gjykatës për dënimin me kusht dhe caktimin e kushteve është edhe gatishmëria e Gjykatës për caktimin e burgimit kur i pandehuri nuk i përmbahet kushteve të pezullimit. Për fund, dënimi me kusht përmban periudhë të burgosjes që mbahet e pezulluar për sa kohë që i pandehuri plotëson kushtet e përcaktuara nga Gjykata. Derisa arsyet legjitime mund të kërkojnë vazhdimin e dënimit, dështimi duhet të përcillet me burgim të menjëhershëm për ta parandaluar dëmtimin e mëtejshëm të qëllimeve të dënimit dhe besueshmërisë së Gjykatës.

KONFISKIMI

Konfiskimi i përfitimit material dhe urdhri për kompensim

Pavarësisht nëse dënimi është dënim me burg, dënim me kusht, punë në dobi të përgjithshme, gjobë dhe/apo ndonjë dënim tjetër plotësues, Gjykata duhet të sigurohet që konfiskimi dhe dëmshpërblimi të bëhen në mënyrë të pavarur dhe në pajtim me KPP-në. Në situatat kur i

⁵⁶ Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Nr.06/L-074, neni 56 Llojet e detyrimeve të caktuara në dënimin me kusht, botuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më datën 14.01.2019.

⁵⁷ Ligji për përgjegjësinë e personave juridikë, neni 12, dënimin me kusht, i butuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 14 shtator 2011.

pandehuri nuk është në gjendje që t'i përmbushë të gjitha detyrimet financiare të parapara nga Gjykata, përparësia është si më poshtë:

- 1) dëmshpërblimi i viktimave,
- 2) konfiskimi i përfitimeve dhe
- 3) gjoba.

Konfiskimi i instrumentalitetit dhe dobisë pasurore

Zhveshja e krimit nga përfitimet është parandalues i rëndësishëm dhe domethënës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe Gjykata duhet të jetë më e vendosur në shqiptimin e masave të konfiskimit. Për më tepër, neni 92 i Kodit penal parasheh një dispozitë të detyrueshme të zëvendësimit të pasurisë që do të thotë se çdo fond ose pronë në posedim të të pandehurit mund të përdoret për të përmbushur urdhrin e konfiskimit, edhe nëse i pandehuri i ka fituar fondet ose pasurinë përmes mënyrave legjitime, mjete të ligjshme.⁵⁸

Derisa dispozitat e konfiskimit vlejnë për të gjithë Kapitullin XXXIII, Gjykata duhet të jetë veçanërisht e vëmendshme për nenin 414 "Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar", nenin 416 "Keqpërdorimi i informatës zyrtare", nenin 418 "Përvetësimi në detyrë" dhe nenin 429 "Përvetësimi i kundërligjshëm i pasurisë me rastin e bastisjes apo ekzekutimit të vendimit gjyqësor." Në të gjitha këto vepra penale, qëllimi për të përfituar dobi materiale (ose përfitim) është element i veprës penale, dhe në disa raste në fakt marrja e përfitimit do ta rëndojë dënimin. Në të gjitha këto situata, Gjykata duhet të jetë veçanërisht e ndjeshme për ta parë nëse në të vërtetë ka pasur përfitim material dhe të adresojë çështjet e duhura me prokurorin nëse dispozitat e KPP-së për konfiskim nuk janë përmbushur, por është e qartë se kryesi ka përfituar materialisht nga kryerja e veprës penale.

Natyrisht e gjitha ajo që u diskutua më lartë i referohet konfiskimit të pasurisë në aspektin penal. Kur kompleksitetit të këtyre procedurave iu shtohet edhe legjislacioni në fuqi mbi kompetencat e zgjeruara të konfiskimit të pasurisë, atëherë bëhet edhe më e qartë se kjo paraqet një temë në vete e cila është trajtuar dhe kërkon trajtim të veçantë. Një gjë është me rëndësi, se pa marrë parasysh se cila procedurë do të ndiqet, relevant është fakti se në rastet e veprave penale të korrupsionit dhe keqpërdorimit të detyrës zyrtare, është primare të shikohet gjithnjë potenciali për konfiskim të pasurisë. Është po ashtu me vlerë që të jetë qartazi e specifikuar nëse vepra është kryer për qëllim të përfitimit personal, për përfitim të personit të tretë, ose për ti shkaktuar dëm një personi. Kjo lehtëson shumë vendimmarrjen për atë se çfarë në fakt konfiskohet dhe nga kush.

⁵⁸ Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Nr.06/L-074, neni 92 Konfiskimi i mjeteve dhe dobisë pasurore, botuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më datën 14.01.2019.

Arsyetimi

Nenin 370 të KPP-së parasheh obligimin për dhënien e arsyeve për dënimin dhe të shpjegojë efektin e tij. Kjo, jo vetëm që është në pajtim me kriteret e të drejtave të njeriut dhe i siguron të pandehurit njoftimin e kërkuar se si dhe pse u caktua dënimi, por gjithashtu i jep publikut njohuri më të mëdha rreth funksionimit dhe logjikës së sistemit të drejtësisë por edhe besimin se janë duke u shërbyer interesat e drejtësisë. Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur të trajtohen veprat korruptive që shkaktojnë reagim të fortë të publikut. Shembulli i dhënë më poshtë përdoret për qëllimin e demonstrimit të një vendimi të arsyetuar si duhet në një rast shumë të rëndë të korrupsionit në SH.B.A.:

Në rastin SH.B.A. kundër Joseph Paulus⁵⁹, gjykata e dënoi të pandehurin me 58 muaj burg, që ishte tejkalim i maksimumit të paraparë në udhëzues i cili parashihte kufijtë prej 27 deri në 33 muaj. Paulus ishte ish-prokuror i qarkut që pranoi 22 ryshfete gjatë një periudhe dy vjeçare për dakordim për trajtim të favorshëm të klientëve të një avokati mbrojtës. Gjykata e arsyetoi tejkalimin e maksimumit bazuar në natyrën e shkeljes së besimit, numrin e ryshfeteve gjatë një periudhe të konsiderueshme dhe vështirësinë në zbulimin e korrupsionit.

"Ryshfeti, për nga natyra, është vepër penale e vështirë për tu zbuluar. Ashtu si prostitucioni, ndodh vetëm midis palëve që japin pëlqim, ku që të dyja kanë interes të madh në fshehjen e veprimeve të tyre. Dhe shpesh, kur veprat e tilla përfshijnë korrupsionin publik si në këtë rast, njëra nga palët mban pozitë të besimit të publikut që e bën atë, të dyshuar të paparamenduar. Në dritën e këtyre fakteve, është e pazakontë që të zbulohet qoftë edhe një rast i ryshfetit nga një zyrtar publik, e lëre më njëzet e dy. Ky fakt e nxjerr çështjen jashtë asaj që është e zakonshme.... Se ka pasur ndërhyrje në funksionin e prokurorisë në një shkallë të pazakontë dhe humbje të besimit të publikut tek prokuroria si rezultat i veprës së tij, janë fakte që i ka konstatuar kjo gjykatë."

Mungesa e arsytimit, apo arsytimi i pamjaftueshëm i vendimit mbi dënimin paraqet indikator për brishtësinë e sistemit të drejtësisë dhe element kyç në humbjen e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë, sidomos duke pasur parasysh natyrën e veprave penale të trajtuara në këtë Udhëzues. Ashtu siç është potencuar edhe në Udhëzuesin e përgjithshëm të Politikës Ndëshkimore, edhe në Republikën e Kosovës ka pasur disa raste kur gjykata më e lartë ka kthyer vendimet e gjykatës më të ulët pikërisht për shkak të mungesës së arsytimit. Mungesa e arsytimit është trajtuar njëkohësisht edhe rishtazi në vendimin e Gjykatës Kushtetuese si një nga gjetjet e kësaj Gjykate: "Sa i përket mungesës së vendimit të arsyetuar gjyqësor, Gjykata konstatoi se me nxjerrën e Aktgjykimit Pml. nr. 253/2019, të 30 shtatorit 2019, Gjykata Supreme ka dështuar të arsyetojë pretendimet thelbësore të parashtruesit të kërkesës dhe nuk e ka arsyetuar vendimin e saj përkitazi me cilësimin e tij si person zyrtar."⁶⁰

⁵⁹ Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kundër Joseph F. Paulus. Nr. 04-3092, Gjykata e Apelit e Shteteve të Bashkuara, Rrethi i Shtatë, 22 gusht 2005.

⁶⁰ Aktgjykim në rastin nr. KI230/19, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 253/2019, të 30 shtatorit 2019, Nr. ref.:AGJ1691/21, pika 162, Prishtinë, më 08 janar 2021.

Veprat e veçanta në Kapitullin XXXIII dhe matja e dënimit

Dënueshmëria për veprat në Kapitullin XXXIII varion nga dispozitat në të cilat cilësimi i veprës është bërë përgjithësisht dhe pa u shprehur lartësia e dënimit në Euro (€) deri tek dispozitat në të cilat ky dëm është i potencuar shprehimisht. Këto të fundit përbëjnë shumicën e neneve të këtij Kapitulli. Andaj më poshtë do paraqesim secilën nga veprat e parapara me këtë kapitull si dhe tabelën me dënimet e parapara për veprat e trajtuara në këtë Udhëzues dhe cili është shtrirje e dënimit për ato sanksione të parapara.

Diapazonet e parapara në tabelat e mësipërme janë plotësisht mes minimumeve dhe maksimumeve të parapara me Ligj dhe asnjëherë nuk dalin përtej tyre. Është në vlerësim të Gjykatës të vlerësojë në secilin rast individualisht nëse dënimi nën minimumin apo mbi maksimumin e paraparë ligjor arsyetohet nga rrethanat jashtëzakonisht lehtësuese, respektivisht rënduese. Njëjtë vlen edhe vlen edhe për vlerësimin e gjykatës nëse duhen shqiptuar dënime tjera alternative. Megjithatë ajo që është e rëndësishme së veçantë është kërkesa që gjykata krahas kësaj të sigurohet në një arsyetim adekuat pse ka ardhur deri tek një konkluzion i tillë.

Siç edhe është përmendur me sipër, Gjykata duhet të ketë parasysh se në këto diapazone nuk janë përfshirë çështje tjera me rëndësi për matjen e dënimit siç janë: Recidivizmi, rrethanat personale të pandehurit apo rrethanat që kanë të bëjnë me çështje procedurale.

Për të bërë sqarimin paraprakisht të tabelave është me rëndësi të sqarohen variacionet e ndryshme të dënimit brenda të njëjtit paragraf, duke llogaritur dënimin varësisht nga variacionet e lartësisë së dëmit dhe Përgjegjësisë. Kjo do shpjgohet më gjerësisht në nenin 414 si neni i parë i Kapitullit XXXIII për të vazhduar me metodologjinë e njëjtë edhe në nenet tjera.

Duke qenë se ligjdhënësi për veprën nga paragrafi 1 ka paraparë dënimin prej 1-8 vjet atëherë edhe tabela e mëposhtme bën ndarjen e kësaj vepre në tre diapazone varësisht nga shkalla e Përgjegjësisë së kryesit dhe dëmi i shkaktuar, e që në këtë paragraf nuk është kuantifikuar. Ndryshe na paraqitet rasti me paragrafin 2 ku ligjdhënësi ka specifikuar se përveç dëmit nga paragrafi 1 gjithnjë kur vlera e dëmit material është e mundur të jetë e përcaktuar dhe kur ai dëm është mbi 5000€ atëherë vepra e kryer bie në paragrafin 2 të nenit 414. Kjo rrjedhimisht shpie në arsyetimin se çfarëdo vlere e dëmit material nën këtë vlerë bie nën paragrafin 1.

Një tjetër dallim mes dy paragrafëve është se ligjvënësi në paragrafin 2 ka paraparë që përpos minimumit dhe maksimumit më të lartë të ketë dënim kumulativ me burgim dhe me gjobë. Në këtë rast lartësia e gjobës duhet caktuar në pajtim me parimet për llogaritjen e gjobës sipas Udhëzuesit për matjen e gjobës. Paragrafi 1 ndërkaq nuk parasheh fare dënim me gjobë.

NENI 414 - KEQPËRDORIMI I POZITËS APO AUTORITETIT ZYRTAR

Par.1: Dënim me gjobë dhe burgim deri 1-8 vjet.

Neni	Dëmi	Përgjegjësia		
		A (Lartë)	B (Mesme)	C (Ulët)
	Kateg. 4 (Minimale)	Shtrirje e dënimit	Shtrirje e dënimit	Shtrirje e dënimit
Par.1 (1-8v)	Deri në 1000€	3-5 vite	2-3 vite	1-2 vite
	1000-2500€	5-7 vite	3-5 vite	2-3 vite
	2500-5000€	7-8 vite	5-7 vite	3-5 vite

Tabela e mësipërme është zbërthyer në disa ndarje brenda të njëjtës kategori. Duhet fillimisht të potencohet se vet ky paragraf nuk jep në mënyrë eksplicite lartësinë e dëmit (siç ndodh edhe në shumicën e paragrafëve 1 të neneve në këtë Kapitull), megjithatë kjo është e nënkuptueshme për shkak të faktit se vet paragrafi 2 i këtij neni i referohet nëse dëmi është mbi 5000€. Ndarja në tabelë është bërë me qëllimin që të mos ketë situata kur shqiptohet sanksion i njëjtë për një dallim shumë të madh në mes vlerës së dëmit. Përgjithësisht është përcjell edhe logjika e ndarjes së kategorive tjera siç edhe demonstron në paragrafin 2 më poshtë. Marrim shembull p.sh. nëse një zyrtar i mesëm duke keqpërdorur pozitën zyrtare shkakton dëm të vlerës 500€ atëherë sanksioni adekuat vetëm në aspekt të Përgjegjësisë dhe lartësisë së dëmit do ishte 2-3 vite. Natyrisht se pjesë e konsideratë së metutjeshme të gjykatës për të caktuar sanksionin ndaj tij do ishin edhe rrethanat tjera përcjellëse të paraqitura në pjesën e përgjithshme të këtij Udhëzuesi. Është me rëndësi për tu potencuar jo vetëm në këtë nen por edhe nenet tjera të kësaj natyre se sidomos në rastet e tilla kur vlera e dëmit nuk është e përmendur siç ndodh në par.1, atëherë jo domosdoshmërisht dëmi ka të bëjë me vlerë monetare, por mund të jetë i lidhur me rrethanat tjera të cilat janë të përfshira në tabelën e përgjithshme e që mund të ketë të njëjtën shkallë të dëmit. Gjykata duhet të ketë parasysh se në këtë rast sanksioni i paraparë është edhe vet reflektim i peshës që ka kryerja e një veprë të tillë duke qenë se nuk kemi të bëjmë me një shkelje të një norme të thjeshtë ligjore, por me shkeljen e normave ligjore nga një person zyrtar të cilit iu janë besuar detyra dhe autorizime publike. Andaj vet keqpërdorimi i atyre autorizimeve, pa marrë parasysh vlerën e dëmit është i rëndë mjaftueshëm dhe meriton sanksion. Tabelat e dhëna janë zbërthyer me qëllimin që gjykatës t'ia bëjnë më të lehtë matjen e dënimit në bazë të parimit të proporcionalitetit. Kuptohet gjithnjë se gjykata ka edhe mjaft rrethana tjera në diskrecion për të vlerësuar dhe atë nisur nga qëllimi i dënimit, sjelljen dhe rrethanat e kryesit ashtu siç edhe parashihet me nenin 69 të KP.

Par.2: Dënim me gjobë dhe burgim prej 3-10 vjet.

Neni	Dëmi	Përgjegjësia		
		A (Lartë)	B (Mesme)	C (Ulët)
414		Shtrirje e dënimit	Shtrirje e dënimit	Shtrirje e dënimit
Par.2 (3-10v)	Kateg. 3 (Ulët)	5-6 vite	4-5 vite	3-4 vite
	Kateg. 2 (Mesme)	7-8 vite	5-6 vite	4-5 vite
	Kateg. 1 (Lartë)	9-10 vite	7-8 vite	5-6 vite

NENI 415- KEQPËRDORIMI DHE MASHTRIMI NË PROKURIM PUBLIK

Par.1 dhe 2: Dënim me gjobë dhe burgim deri 5 vjet.

Neni	Dëmi	Përgjegjësia		
		A (Lartë)	B (Mesme)	C (Ulët)
415	Kateg. 4 (Minimale)	Shtrirje e dënimit	Shtrirje e dënimit	Shtrirje e dënimit
Paragraf 1 dhe 2 (deri 5vj)	Deri në 1000€	2-3 vite	1-2 vite	1muaj – 1 vit
	1000-2500€	3-4 vite	2-3 vite	1-2 vite
	2500-5000€	4-5 vite	3-4 vite	2-3 vite

Par.3: Dënim me gjobë dhe burgim prej 1-8 vjet.

Neni	Dëmi	Përgjegjësia		
		A (Lartë)	B (Mesme)	C (Ulët)
415		Shtrirje e dënimit	Shtrirje e dënimit	Shtrirje e dënimit
Par.3 (1- 8v)	Kateg. 3 (Ulët)	4-5 vite	3-4 vite	1-3 vite
	Kateg.2 (Mesme)	5-6 vite	4-5 vite	3-4 vite
	Kateg.1 (Lartë)	6-8 vite	5-6 vite	4-5 vite

NENI 416 - KEQPËRDORIMI I INFORMATËS ZYRTARE

Par.1: Dënim me gjobë dhe burgim 6 muaj - 5 vjet.

Neni	Dëmi	Përgjegjësia		
		A (Lartë)	B (Mesme)	C (Ulët)
416	Kateg. 4 (Minimale)	Shtrirje e dënimit	Shtrirje e dënimit	Shtrirje e dënimit
Paragr.1 (6m-5vj)	Deri në 1000€	2-3 vite	1-2 vite	6 muaj – 1 vite
	1000-2500€	3-4 vite	2-3 vite	1-2 vite
	2500-5000€	4-5 vite	3-4 vite	2-3 vite

Par.2: Dënim me gjobë dhe burgim 2-8 vjet.

Neni	Dëmi	Përgjegjësia		
		A (Lartë)	B (Mesme)	C (Ulët)
415		Shtrirje e dënimit	Shtrirje e dënimit	Shtrirje e dënimit
Par.2 (2-8v)	Kateg. 3 (Minimale)	4-5 vite	3-4 vite	2-3 vite
	Kateg.2 (Ulët)	5-6 vite	4-5 vite	3-4 vite
	Kateg.1 (Mesme)	6-8 vite	5-6 vite	4-5 vite

Qëllimi i ligjvënësit në këtë paragraf duket mjaft konfuz. Në fakt ky paragraf ndoshta shumë më tepër do të kishte vendin në nenin 415 më sipër duke qenë se i referohet aktiviteteve që lidhen me prokurimin publik. Duket qartë se me paragrafin 2 ligjvënësi ka dashur të vej theksin në veprimtaritë me prokurimin publik duke dashur ta sanksionojë më rëndë dhe atë me burgim 2-8 vite. Ajo që nuk ishte e qartë gjatë ndarjes së tabelave ishte nëse ligjvënësi për këtë nen kishte fjalën për dëmin që mund të jetë shkaktuar deri në vlerën 5000€ apo më lartë? Megjithatë, gjatë analizës së paragrafëve pasuese mund të konkludohet se lartësia e dëmit që mund të përfshihet brenda këtij paragrafi nuk mund të jetë më e lartë se 50.000€. Çfarëdo shume mbi atë vlerë llogaritet sipas paragrafit 3 me dënueshmërinë 3-12 vite. Kjo arsyetohet edhe me faktin se është e pamundur që ligjvënësi të ketë menduar se në këtë paragraf përfshihen vetëm dëmi deri në 5.000€ (siç është rasti me paragrafët 1 dhe 3) dhe të dënojë me burgim 1-8 vite sipas paragrafit 3 për vlerat mbi këtë shumë, kur dihet se sanksioni sipas paragrafit 2 është më i lartë (të paktën sa i përket minimumit ligjor) dhe atë 2-8 vite. Një gjë e tillë do binte ndesh me parimin e ashpërsimit të sanksionit nga ligjvënësi të mishëruar në paragrafin 2.

Par.3: Dënim me gjobë dhe burgim prej 1-8 vjet.

Neni	Dëmi	Përgjegjësia		
		A (Lartë)	B (Mesme)	C (Ulët)
		Shtrirje e dënimit	Shtrirje e dënimit	Shtrirje e dënimit
Par.2 (1-8v)	Kateg. 3 (Ulët)	5-6 vite	3-4 vite	1-2 vite
	Kateg. 2 (Mesme)	7-8 vite	5-6 vite	3-4 vite

Par.4: Dënim me gjobë dhe burgim 3-12 vjet.

Neni	Dëmi	Përgjegjësia		
		A (Lartë)	B (Mesme)	C (Ulët)
		Shtrirje e dënimit	Shtrirje e dënimit	Shtrirje e dënimit
Par.4 (3-12v)	Kateg. 1 (Lartë)	10-12 vite	7-9 vite	3-6 vite

Bazuar në atë sa u shtjellua edhe më sipër, paragrafi 3 përfshin edhe veprat e kryera në lidhje me prokurimin apo ankandin publik. Në kuadër të respektimit të parimit të vënë edhe nga ligjvënësi, gjykata duhet të ketë parasysh që kur kemi të bëjmë me këto të fundit, matjen e dënimit ta bëj në kufijtë maksimal brenda secilit diapazon, krahasuar me veprën nga paragrafi 1.

Shembull:

- Në rastet kur informata zyrtare ka të bëj me dëmin nga Kategoria 1 dhe Përgjegjësia A dënimi mund të jetë 10vite.
- Në rastet kur informata zyrtare ka të bëj me dëmin nga Kategoria 1 dhe Përgjegjësia A por kur në këtë rast kemi të bëjmë me veprim të prokurimit apo ankandit publik, atëherë lartësia e dënimit vetëm sa i përket dëmit dhe Përgjegjësisë do prekte maksimumin prej 12 vite.

NENI 417 KONFLIKTI I INTERESIT

Ky nen bashkë me disa nene tjera në këtë kapitull paraqesin rastet kur cilësimi i veprës në Kodin penal është bërë përgjithësisht dhe pa u shprehur lartësia e dëmit në Euro (€). Konsiderohet se ndarja në kategoritë kryesore (1-4) është e mjaftueshme për këtë nen pa pasur nevojë të lëshohemi më shumë në ndarje të kategorisë minimale. Kjo si për shkak të natyrës së kësaj vepre e po ashtu edhe për shkak të margjinës mes minimumit dhe maksimumit që edhe ashtu është mjaft e vogël. Andaj konsiderohet se një zberthim i mëtutjeshëm në rastin e kësaj dispozite është i panevojshëm.

Par.1: Dënim me gjobë dhe burgim deri 3 vjet.

Neni		Përgjegjësia		
417	Dëmi	A (Lartë)	B (Mesme)	C (Ulët)
		Shtrirje e dënimit	Shtrirje e dënimit	Shtrirje e dënimit
:1 (Deri- 3vite)	Kateg.4 (Minimale)	1-1.5 vite	6muaj-1 vit	1-6 muaj
	Kateg.3 (Ulët)	1.5-2 vite	1-1.5 vite	6muaj- 1 vit
	Kateg. 2 (Mesme)	2-2.5 vite	1.5-2 vite	1-1.5 vite
	Kategoria 1 (Lartë)	2.5 - 3 vite	2-2.5 vite	1.5-2 vite

Par.2: Dënim me burgim prej 1-5 vjet.

Neni		Përgjegjësia		
417	Dëmi	A (Lartë)	B (Mesme)	C (Ulët)
		Shtrirje e dënimit	Shtrirje e dënimit	Shtrirje e dënimit
Par.2 (1-5 vite)	Kateg.4 (Minimale)	2 – 2.5 vite	1.5 - 2vite	1- 1.5 vite
	Kateg. 3 (Ulët)	2.5-3 vite	2-2.5 vite	1.5-2 vite
	Kateg. 2 (Mesme)	3-4 vite	2.5-3 vite	2-2.5 vite
	Kateg. 1 (Lartë)	4-5 vite	3-4 vite	2.5 – 3vite

NENI 418 - PËRVETËSIMI NË DETYRË

Par.1: Dënim me gjobë dhe burgim 6 muaj - 5 vjet.

Neni		Përgjegjësia		
418	Dëmi	A (Lartë)	B (Mesme)	C (Ulët)
	Kateg. 4 (Minimale)	Shtrirje e dënimit	Shtrirje e dënimit	Shtrirje e dënimit
Paragr.1 (6m-5vj)	Deri në 1000€	2-3 vite	1-2 vite	6 muaj – 1 vit
	1000-2500€	3-4 vite	2-3 vite	1-2 vite
	2500-5000€	4-5 vite	3-4 vite	2-3 vite

Par.2: Dënim me gjobë dhe burgim 1-8 vjet.

Neni		Përgjegjësia		
418	Dëmi	A (Lartë)	B (Mesme)	C (Ulët)
Par.2 (1-8v)	Kateg. 3 (Ulët)	Shtrirje e dënimit 5-6 vite	Shtrirje e dënimit 3-4 vite	Shtrirje e dënimit 1-2 vite
	Kateg. 2 (Mesme)	7-8 vite	5-6 vite	3-4 vite

Par.3: Dënim me gjobë dhe burgim 3-12 vjet.

Neni		Përgjegjësia		
418	Dëmi	A (Lartë)	B (Mesme)	C (Ulët)
Par.3 (3-12v)	Kateg. 1 (Lartë)	Shtrirje e dënimit 10-12 vite	Shtrirje e dënimit 7-9 vite	Shtrirje e dënimit 3-6 vite

NENI 419 - MASHTRIMI NË DETYRË

Par.1: Dënim me gjobë dhe burgim 6 muaj - 5 vjet.

Neni		Përgjegjësia		
419	Dëmi	A (Lartë)	B (Mesme)	C (Ulët)
	Kateg. 4 (Minimale)	Shtrirje e dënimit	Shtrirje e dënimit	Shtrirje e dënimit
Paragr.1 (6m-5vj)	Deri në 1000€	2-3 vite	1-2 vite	6 muaj- 1 vit
	1000-2500€	3-4 vite	2-3 vite	11-2 vite
	2500-5000€	4-5 vite	3-4 vite	2-3 vite

Par.2 dhe 3: Dënim me gjobë dhe burgim 1-8 vjet.

Neni		Përgjegjësia		
418	Dëmi	A (Lartë)	B (Mesme)	C (Ulët)
ar.2 & 3 (1-8v)	Kateg. 3 (Ulët)	Shtrirje e dënimit 5-6 vite	Shtrirje e dënimit 3-4 vite	Shtrirje e dënimit 1-2 vite
	Kateg. 2 (Mesme)	7-8 vite	5-6 vite	3-4 vite

Par.4: Dënim me gjobë dhe burgim 3-12 vjet.

Neni	Përgjegjësia			
419	Dëmi	A (Lartë)	B (Mesme)	C (Ulët)
Par.4 (3-12v)	Kateg. 1 (Lartë)	Shtrirje e dënimit 10-12 vite	Shtrirje e dënimit 7-9 vite	Shtrirje e dënimit 3-6 vite

NENI 420 - PËRDORIMI I PAAUTORIZUAR I PASURISË

Dënueshmëria mvarësisht nga Përgjegjësia dhe shkalla e dëmit				
Neni	Përgjegjësia			
420	Dëmi	A (Lartë)	B (Mesme)	C (Ulët)
Par.1 (Deri 3)	Kateg. 4 (Minimale)	Shtrirje e dënimit gjobë ose 1 vjet	Shtrirje e dënimit gjobë ose deri 9 muaj	Shtrirje e dënimit gjobë ose 6 muaj
	Kateg.3 (Ulët)	1.5-2 vite	1-1.5 vite	6 muaj- 1vit
	Kateg. 2 (Mesme)	2-2.5 vite	1.5-2 vite	1-1.5 vite
	Kateg.1 (Lartë)	2.5-3 vite	2-2.5 vite	1.5-2 vite

Dënim me gjobë ose burgim deri 3 vjet.

NENI 421- MARRJA E RYSHFETIT

Par.1: Dënim me gjobë dhe burgim 1-8 vjet.

Neni	Përgjegjësia			
421	Dëmi	A (Lartë)	B (Mesme)	C (Ulët)
Par.1 (1-8v)	Kateg. 4 (Minimale)	Shtrirje e dënimit	Shtrirje e dënimit	Shtrirje e dënimit
	Deri në 100€	2-3 vite	1.5-2vite	1-1.5 vite
	100-1000€	3-4 vite	2-3 vite	1.5-2 vite
	1000-2500€	4-5 vite	3-4 vite	2-3 vite
	2500-5000€	5-6 vite	4-5 vite	3-4 vite
	Kateg. 3 (Ulët)	6-8 vite	5-6 vite	4-5 vite

Për dallim nga tabelat e mësipërme që i referohen vlerës deri në 5000€, tek marrja e ryshfetit kemi bërë më shumë ndarje të kësaj vlere për shkak të rasteve më të shpeshta kur lartësia e ryshfetit mund të jenë minimale, deri në 100€ dhe për ta dalluar ato mbi këtë vlerë.

Par.2: Dënim me gjobë dhe burgim prej 3-12 vjet.

Neni	Dëmi	Përgjegjësia		
		A (Lartë)	B (Mesme)	C (Ulët)
421	Kateg. 4 (Minimale)	Shtrirje e dënimit	Shtrirje e dënimit	Shtrirje e dënimit
Par.2 (3-12v)	Deri në 100€	4-5 vite	3.5-4 vite	3-3.5 vite
	100-1000€	5-6 vite	4-5 vite	3.5-4 vite
	1000-2500€	6-7 vite	5-6 vite	4-5 vite
	2500-5000€	7-9 vite	6-7 vite	5-6 vite
	Kateg. 3 (Ulët)	10-12 vite	7-9 vite	6-7 vite

Par.3: Dënim me gjobë dhe burgim 5-15 vjet.

Neni	Dëmi	Përgjegjësia		
		A (Lartë)	B (Mesme)	C (Ulët)
421	Kateg. 2 (Mesme)	Shtrirje e dënimit	Shtrirje e dënimit	Shtrirje e dënimit
Par 3 (5-15v)	Kateg. 2 (Mesme)	10-12 vite	7-9 vite	5-7 vite
	Kateg. 1 (Lartë)	13-15 vite	10-12 vite	7-9 vite

422 - DHËNIA E RYSHFETIT

Par.1: Dënim me gjobë dhe burgim deri - 5 vjet.

Par.2: Dënim me gjobë dhe burgim 6 muaj – 5 vjet.

Neni	Dëmi	Përgjegjësia		
		A (Lartë)	B (Mesme)	C (Ulët)
422	Kateg. 4 (Minimale)	Shtrirje e dënimit	Shtrirje e dënimit	Shtrirje e dënimit
Par.1 (- 5v) Par.2 (6m-5v)	Deri në 100€	1-1.5 vite	9muaj-1vit	6-9 muaj
	100-1000€	1.5-2vite	1-1.5 vite	9 muaj – 1 vit
	1000-2500€	2-2.5vite	1.5-2 vite	1-1.5vite
	2500-5000€	2-3 vite	2-2.5 vite	1.5-2vite
	Kateg. 3 (Ulët)	4-5 vite	3-4 vite	2-3 vite

Sqarim: Duke qenë se në rastin konkret ka një dallim shumë të vogël mes paragrafit 1 dhe 2, është bërë fuzionimi i të dyja paragrafëve në një tabelë.

Par.3: Dënim me gjobë dhe burgim prej 1-8 vjet.

Neni		Përgjegjësia		
422	Dëmi	A (Lartë)	B (Mesme)	C (Ulët)
Par.3 (1-8v)	Kateg. 3 (Mesme)	Shtrirje e dënimit 5-6 vite	Shtrirje e dënimit 4-5 vite	Shtrirje e dënimit 1-3 vite
	Kateg. 2 (Lartë)	7-8 vite	5-6 vite	4-5 vite

NENI 423 - DHËNIA E RYSHFETIT ZYRTARIT PUBLIK TË HUAJ APO PERSONAVE TË HUAJ ZYRTAR

Par.1: Dënim me gjobë dhe burgim 1-8 vjet.

Neni		Përgjegjësia		
423	Dëmi	A (Lartë)	B (Mesme)	C (Ulët)
	Kateg. 4 (Minimale)	Shtrirje e dënimit	Shtrirje e dënimit	Shtrirje e dënimit
Par.1 (1-8v)	Deri në 100€	2-3 vite	1.5-2 vite	1-1.5 vite
	100-1000€	3-4 vite	2-3 vite	1.5-2 vite
	1000-2500€	4-5 vite	3-4 vite	2-3 vite
	2500-5000€	5-6 vite	4-5 vite	3-4 vite
	Kateg. 3 (Ulët)	6-8 vite	5-6 vite	4-5 vite

Par.3: Dënim me gjobë dhe burgim 3-12 vjet i ndërlidhur me par.1.

Neni		Përgjegjësia		
423	Dëmi	A (Lartë)	B (Mesme)	C (Ulët)
Par.3 (3-12v)	Kateg. 3 (Mesme)	Shtrirje e dënimit 8-10 vite	Shtrirje e dënimit 6-8 vite	Shtrirje e dënimit 3-6 vite
	Kateg. 2 (Lartë)	10-12 vite	8-10 vite	6-8 vite

Par.2: Dënim me gjobë dhe burgim prej 3-12 vjet.

Neni		Përgjegjësia		
423	Dëmi	A (Lartë)	B (Mesme)	C (Ulët)
	Kateg. 4 (Minimale)	Shtrirje e dënimit	Shtrirje e dënimit	Shtrirje e dënimit

Par.2 (3-12v)	Deri në 100€	4-4.5 vite	3.5-4vite	3-3.5vite
	100-1000€	4.5- 5 vite	4- 4.5 vite	3.5-4 vite
	1000-2500€	5- 5.5 vite	4.5- 5 vite	4- 4.5 vite
	2500-5000€	5.5 -6 vite	5- 5.5 vite	4.5- 5 vite
	Kateg. 3 (Ulët)	7- 8 vite	5.5- 6 vite	5- 5.5 vite
	Kateg.2 (Mesme)	9-10 vite	7-8 vite	5.5- 6 vite
	Kateg 1 (Lartë)	11-12 vite	9-10 vite	7-8 vite

NENI 424 - USHTRIMI I NDIKIMIT

Par.1: Dënim me gjobë dhe burgim 1-8 vjet.

Neni	Dëmi	Përgjegjësia		
		A (Lartë)	B (Mesme)	C (Ulët)
424	Kateg. 4 (Minimale)	Shtrirje e dënimit	Shtrirje e dënimit	Shtrirje e dënimit
Par.1 (1-8v)	Deri në 1000€	2-2.5 vite	1.5 – 2 vite	1- 1.5 vite
	1000-2500€	2.5-3 vite	2-2.5 vite	1.5- 2 vite
	2500-5000€	3-4 vite	2.5-3 vite	2-2.5 vite
	Kateg. 3 (Ulët)	5-6 vite	3-4 vite	2.5-3 vite
	Kateg.2 (Mesme)	6-7 vite	5-6 vite	3-4 vite
	Kateg.1 (Lartë)	7-8 vite	6-7 vite	5-6 vite

Par.2: Dënim me gjobë dhe burgim 6 muaj- 8 vjet.

Neni	Dëmi	Përgjegjësia		
		A (Lartë)	B (Mesme)	C (Ulët)
424	Kateg. 4 (Minimale)	Shtrirje e dënimit	Shtrirje e dënimit	Shtrirje e dënimit
Par.2 (6m-8v)	Deri në 1000€	1.5-2 vite	1-1.5 vite	6muaj – 1vit
	1000-2500€	2-3 vite	1.5-2 vite	1-1.5 vite
	2500-5000€	3-4 vite	2-3 vite	1.5-2 vite
	Kateg. 3 (Ulët)	5-6 vite	3-4 vite	2-3 vite
	Kateg.2 (Mesme)	6-7 vite	5-6 vite	3-4 vite
	Kateg.1 (Lartë)	7-8 vite	6-7 vite	5-6 vite

NENI 425 - NXJERRJA E KUNDËRLIGJSHME E VENDIMEVE GJYQËSORE

Dënim me burgim prej 6 muaj deri 5 vjet.

Neni	Dëmi	Përgjegjësia		
		A (Lartë)	B (Mesme)	C (Ulët)
425		Shtrirje e dënimit	Shtrirje e dënimit	Shtrirje e dënimit
6muaj 5vite	Kateg. 4 (Minimale)	1.5-2 vite	1-1.5 vite	6 muaj – 1 vit
	Kateg. 3 (Ulët)	2-3 vite	1.5-2 vite	1-1.5 vite
	Kateg.2 (Mesme)	3-4 vite	2-3 vite	1.5-2 vite
	Kateg.1 (Lartë)	4-5 vite	3-4 vite	2-3 vite

Ndarja e mësipërme është thjeshtuar për faktin se në këtë rast qartazi kemi të bëjmë vetëm me një kategori-atë të gjyqtarëve. Andaj, kemi bërë thjeshtëzimin e lartësisë së dëmit në 4 kategoritë kryesore (pa nëndarjet e tyre). Sa i përket përgjegjësisë, ajo në rastin konkret reflekton në instancat e gjyqësorit duke filluar nga niveli i themelores, apelit dhe supremes. Një ndarje e tillë në bazë të instancës është e logjikshme për faktin se vendimi i një gjykate themelore mund të korrigjohet kur lënda ngritet para Gjykatës së Apelit. E njëjta logjike vlen edhe për raportin mes vendimeve të gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit me Gjykatës Supreme.

NENI 426 - ZBULIMI I FSHEHTËSISË ZYRTARE

Par.1: Dënim me burgim prej 6 muaj – 3 vjet.

Neni	Dëmi	Përgjegjësia		
		A (Lartë)	B (Mesme)	C (Ulët)
426		Shtrirje e dënimit	Shtrirje e dënimit	Shtrirje e dënimit
Par.1 (6m-3v)	Kateg.4(Minimale)	1-1.5 vite	9 muaj- 1 vit	6-9 muaj
	Kateg.3 (Ulët)			9 muaj -1vit
	Kateg.2 (Mesme)	1.5-2 vite	1-1.5 vite	1-1.5 vite
	Kateg.1 (Lartë)	2- 2.5 vite	1.5 -2 vite	
		2.5 - 3 vite	2-2.5 vite	

Par.2: Dënim me gjobë dhe burgim prej 1 – 10 vjet.

Neni	Dëmi	Përgjegjësia		
		A (Lartë)	B (Mesme)	C (Ulët)
426		Shtrirje e dënimit	Shtrirje e dënimit	Shtrirje e dënimit
Par.2 (1-10 vite)	Kateg.4 (Minimale)	3-4 vite	2-3 vite	1-2vite
	Kateg.3 (Ulët)	5-6 vite	3-4 vite	2-3 vite

Kateg.2 (Mesme)	7-8 vite	5-6 vite	3-4 vite
Kateg.1 (Lartë)	9-10 vite	7-8 vite	5-6 vite

Par.3: Dënim me gjobë ose burgim deri 3 vjet.

Duke qenë se par.3 parasheh rastet kur vepra kryhet nga pakujdesia, atëherë në këtë rast nuk mund të bëhet zberthimi sikurse për dy paragrafët e para pasi nuk mund të ketë nivele të ndryshme të pakujdesisë. Në rastin nga par.3 vlen llogaritja e dënimit sipas tabelën së matjes së dënimit sipas Udhëzuesit të përgjithshëm dhe parimeve të sqaruara edhe në këtë Udhëzues sa i përket Pakujdesisë së vetëdijshme dhe pakujdesisë së pavetëdijshme.

NENI 427 - FALSIFIKIMI I DOKUMENTIT ZYRTAR

Dënim me burgim prej 6 muaj deri 5 vjet

Neni	Dëmi	Përgjegjësia		
		A (Lartë)	B (Mesme)	C (Ulët)
427	Kateg. 4 (Minimale)	Shtrirje e dënimit	Shtrirje e dënimit	Shtrirje e dënimit
6muaj-5vite	Deri në 1000€	1.5- 2vite	1-1.5 vite	6 muaj- 1 vit
	1000-2500€	2-2.5 vite	1.5 -2 vite	1-1.5 vite
	2500-5000€	2.5-3 vite	2-2.5 vite	1.5-2 vite
	Kateg. 3 (Ulët)	3-3.5 vite	2.5-3 vite	2-2.5 vite
	Kateg.2 (Mesme)	3.5-4 vite	3-3.5 vite	2.5-3 vite
	Kateg.1 (Lartë)	4-5 vite	3.5-4 vite	3-3.5 vite

NENI 428 - ARKËTIMI DHE PAGESA E KUNDËRLIGJSHME

Par.1: Dënim me gjobë dhe burgim deri 3 vjet.

Neni	Dëmi	Përgjegjësia		
		A (Lartë)	B (Mesme)	C (Ulët)
428	Kateg. 4 (Minimale)	Shtrirje e dënimit	Shtrirje e dënimit	Shtrirje e dënimit
Par.1 deri 3v	Deri në1000€	9 muaj-1 vit	6-9 muaj	3-6 muaj
	1000-2500€	1-1.5 vite	9 muaj-1 vit	6-9 muaj
	2500-5000€	1.5-2vite	1-1.5vite	9-1 vit
	Kateg. 3 (Ulët)	2-3 vite	1.5-2 vite	1-1.5 vite

Par.2: Dënim me burgim deri 3 vjet.

Ajo që duhet vënë në pah për këtë paragraf është lartësia e dënimit me burgim e njëjtë me paragrafin 1, përkundër faktit se lartësia e dëmit sipas paragrafit 2 është dukshëm më e madhe sesa paragrafi 1. Nga kjo mund të konkludohet se më shumë bëhet fjalë për një gabim teknik në llogaritje të dënimit për këtë dispozitë nga ana e ligjvënësit. Ky konkludim përforcohet edhe më shumë nëse përmendim edhe faktin se gjersa paragrafi 1 përfshin dënim me gjobë dhe me burgim, paragrafi 2 nga ana tjetër përmban në vete vetëm dënimin me burgim. Natyrisht duke qenë se ky Udhëzues është i kufizuar vetëm në minimumin dhe maksimumin e paraparë ndarja e tabelës për këtë paragraf është e pamundur. Udhëzuesi nuk mund të jep një tabelë me dënim të njëjtë si në rastet nga paragrafi 1 kur vlera maksimale e dëmit mund të jetë 15.000€ sikurse edhe në paragrafin 2 kur kemi të bëjmë potencialisht me shumat mbi 15.000€ respektivisht mbi 50.000€. Megjithatë, gjykata gjithnjë ka diskrecionin që përkundër maksimumit ligjor, nëse pagesa apo arkëtimi ka të bëjë me shuma më të larta se 15.000€ e posaçërisht nëse shuma është mbi 50.000€ atëherë mund të shqiptohet edhe dënim mbi maksimumin e paraparë ligjor nëse konstatohet ekzistimi i rrethanave jashtëzakonisht ashpërsuese.

NENI 429 - PËRVETËSIMI I KUNDËRLIGJSHËM I PASURISË ME RASTIN E BASTISJES APO EKZEKUTIMIT TË VENDIMIT GJYQËSOR

Dënimi me burgim prej 6 muaj deri 5 vjet

Neni	Dëmi	Përgjegjësia		
		A (Lartë)	B (Mesme)	C (Ulët)
429	Kateg. 4 (Minimale)	Shtrirje e dënimit	Shtrirje e dënimit	Shtrirje e dënimit
6muaj-5vite	Deri në 1000€	1.5- 2vite	1-1.5 vite	6 muaj- 1 vit
	1000-2500€	2-2.5 vite	1.5 -2 vite	1-1.5 vite
	2500-5000€	2.5-3 vite	2-2.5 vite	1.5-2 vite
	Kateg. 3 (Ulët)	3-3.5 vite	2.5-3 vite	2-2.5 vite
	Kateg.2 (Mesme)	3.5-4 vite	3-3.5 vite	2.5-3 vite
	Kateg.1 (Lartë)	4-5 vite	3.5-4 vite	3-3.5 vite

NENI 430 - MOS RAPORTIMI OSE RAPORTIMI I RREMË I PASURISË, I TË ARDHURAVE, I DHURATAVE, I DOBISË TJETËR MATERIALE OSE I DETYRIMEVE FINANCIARE

Edhe pse në nenin konkret vlera e dëmit nuk është e shprehur në të holla, megjithatë është e nënkuptueshme se në këtë rast kemi të bëjmë me përfitim të një vlere të caktuar i cili nuk është raportuar. Po ashtu duke pasur parasysh se sipas Ligjit për deklarimin e pasurisë përgjithësisht subjekti deklarues ka për obligim të raportojë çfarëdo pasurie apo përfitimi material që tejkalon vlerën prej 3000€, për këtë arsye nuk është parë e nevojshme të bëhen nëndarje si në nenet e mësipërme tek Kategoria minimale pasi në këtë rast nuk kemi të bëjmë me vlera të vogla siç mund të kemi tek nenet tjera.

Par.1: Dënim me gjobë ose me burgim deri 3 vjet.

Neni		Përgjegjësia		
430	Dëmi	A (Lartë)	B (Mesme)	C (Ulët)
		Shtrirje e dënimit	Shtrirje e dënimit	Shtrirje e dënimit
:1 (Deri- 3vite)	Kateg.4 (Minimale)	1-1.5 vite	6muaj-1 vit	1-6 muaj
	Kateg.3 (Ulët)	1.5-2 vite	1-1.5 vite	6muaj- 1 vit
	Kateg. 2 (Mesme)	2-2.5 vite	1.5-2 vite	1-1.5 vite
	Kategoria 1 (Lartë)	2.5 - 3 vite	2-2.5 vite	1.5-2 vite

Par.2: Dënim me gjobë dhe me burgim 6 muaj – 5 vjet.

Neni		Përgjegjësia		
430	Dëmi	A (Lartë)	B (Mesme)	C (Ulët)
		Shtrirje e dënimit	Shtrirje e dënimit	Shtrirje e dënimit
6muaj 5vite	Kateg. 4 (Minimale)	1.5-2 vite	1-1.5 vite	6 muaj – 1 vit
	Kateg. 3 (Ulët)	2-3 vite	1.5-2 vite	1-1.5 vite
	Kateg.2 (Mesme)	3-4 vite	2-3 vite	1.5-2 vite
	Kateg.1 (Lartë)	4-5 vite	3-4 vite	2-3 vite

(Udhëzimi i miratuar në seancën e përgjithshme të Gjykatës Supreme, i mbajtur më 10.06.2021)



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Mbledhja e Përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 26 paragrafi 1. pika 1.4 të Ligjit për Gjykatat, më datë 24.09.2020, me shumicë votash nxjerr këtë:

UDHËZIM

Gjykatat Themelore – Divizioni për Kundërvajtje në Republikën e Kosovës sipas Ligjit nr. 05/L-087 Për Kundërvajtje, me rastin e vendosjes më aktgjykim lidhur me shqiptimin e dënimit me gjobë për kundërvajtjet e trafikut rrugor apo të kundërvajtjeve tjera të parapara me ligj, nuk janë të lidhura me ekzekutimin e dënimit me gjobë sipas Ligjit nr. 05/L-88 Për Rregullat e Trafikut Rrugor të nenit 255 e as të Ligjit nr. 06/L-069 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 05/L-88 Për Rregullat e Trafikut Rrugor neni 25, për pagesën e gjysmës së gjobës, pasi që kjo është kompetencë vetëm e organit të kundërvajtjes për masat e veçanta për kundërvajtje të shkeljeve të rregullave të trafikut rrugor.

A r s y e t i m

Kryetari të Gjykatës Supreme të Kosovës i është drejtuar me kërkesë për dhënien e mendimit juridik, gjyqtari i gjykatës Themelore në Prishtinë- Divizioni për Kundërvajtje Sadik Sadikaj përmes Kryetares së kësaj gjykate Afërdita Bytyqi, në situatën kur gjykatat shqiptojnë dënim me gjobë të paraparë me Ligjin nr. 05/L-88 Për Rregullat e Trafikut Rrugor por edhe ligjet tjera, si të veprohet që me aktgjykimin e gjykatës të dënuarit t’ia mundësoj që në rast se paguan gjobën brenda 15 dite të paguaj gjysmës së gjobës në rastet e komunikacionit apo në të gjitha kundërvajtjet. Me ankesë të ngjashme kësaj gjykate i është drejtuar edhe Avokati i Popullit me pretendim se i njëjti ka pranuar ankesa kundër gjykatave të rregullta përkitazi me

moszbatimin e dispozitive Ligjit nr. 05/L-88 Për Rregullat e Trafikut Rrugo dhe të Ligjit nr. 06/L-069 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 05/L-88 Për Rregullat e Trafikut Rrugor.

Fillimisht dega penale e Gjykatës Supreme të Kosovës gjatë analizës paraprake ka marr qëndrim që në bazë të nenit 26 paragrafi 1. pika 1.4 të Ligjit për Gjykatat ka kompetencë mes tjerash edhe të nxjerr një udhëzim për zbatimin unik të ligjeve nga gjykatat në territorin e Kosovës.

Kësisoj, gjatë analizës u konstatua si vijon:

Ligjit nr. 05/L-87 Për Kundërvajtje sipas nenit 1 rregullon mes tjerash kushtet për përcaktimin e kundërvajtjeve dhe sanksioneve, palët dhe përgjegjësia për kundërvajtje , pastaj edhe procedurën në përgjithësi por edhe procedurën e ekzekutimit të sanksioneve për kundërvajtje. Nenin 55 ka rregulluar çështjen e Kompetencës dhe përbërjen e gjykatës, kësisoj paragrafi 1 përcakton se, gjykata gjykon në kufijtë e kompetencës së saj lëndore të paraparë me ligj ndërsa në paragrafin 4 thuhet se, për disa kundërvajtje të përcaktuara me ligj apo rregullore të Kuvendit të Komunës, procedura e kundërvajtjes mund të zhvillohet dhe sanksionin kundërvajtës mund ta shqiptoj organi i administratës shtetërore ose organi i cili kryen autorizime publike të mbikëqyrjes për zbatimin e ligjit, në të cilin janë paraparë kundërvajtje.. Në neni 56 të këtij ligji është përcaktuar kompetenca e organit të kundërvajtjes sipas të cilit shprehimisht në paragrafi 1. të këtij neni thuhet se “ organi i kundërvajtjes zhvillon procedurën kundërvajtës nëse me ligj është parapa kompetenca ekskluzive për veprimin e saj “. Në paragrafin 2 parashihet rregulli i përjashtimit nga paragrafi 1 i këtij nenin, kur organi për kundërvajtje është kompetent për të gjitha kundërvajtjeve e që janë: për të cilat është parapa sanksioni i gjobës në shumën e caktuar; për të cilat është paraparë sanksioni për personat fizik gjopa deri 500 (pesëqind) euro dhe personin juridik 1000 (njëmijë) euro, si dhe për kundërvajtjet për të cilat është parapa shqiptimi i gjobës në vend, kështu që për këto raste nuk është kompetent Divizioni i Kundërvajtjeve të Gjykatave Themelore në Kosovë . Kësisoj në kapitullin XI ky ligj rregullon procedurën e veçantë të kundërvajtjes para organit të kundërvajtjes, me autorizime dhe rregulla të veçanta jashtë kompetencës së gjykatave të rregullta. Për më tepër kundër vendimeve përfundimtare të organit të kundërvajtjes sa i takon mbrojtjes gjyqësore mundë të zhvillohet konflikt administrativ sipas padisë pranë gjykatës kompetentë e që është Departamenti Administrativ i Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe vlejné rregullat e Ligjit Për Konflikt Administrativ.

Lidhur me paqartësitë e dispozitive ligjore të adresuara në kërkesën për dhënien e mendimit juridik qëndrimi i Gjykatës Supreme është si vijon:

Ligji nr. 5/L-088 Për Rregullat e Trafikut Rrugor i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 06/L-069, përcakton rregullat bazë të sjelljes së pjesëmarrësve dhe subjekteve të tjera në trafikun rrugorë dhe vlen vetëm për këto raste. Kësisoj, në nenin 255 të ligjit në fjalë respektivisht nenin 25 të këtij ligji të ndryshuar dhe plotësuar përcakton se: “Kryesi i kundërvajtjes i cili paguan gjobën në të holla brenda tetë(8) ditësh do ta paguaj vetëm gjysmën e gjobës së paraparë për kundërvajtjen e shkaktuar “ ndërsa neni 25 i Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin të këtij ligji

këtë afat e ka zgjat pesëmbëdhjetë (15) ditë. Andaj ky ligj rregullon vetëm pagesat e gjobave që shqiptohen nga organi kompetent i kundërvajtjes respektivisht organi i cili kryen autorizime publike të mbikëqyrjes për zbatimin e Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor , dhe sipas interpretimit konsiderohen dënimet e parapara sipas Ligjit nr. 05/L-87 Për Kundërvajtje nga neni 56 paragrafi 2 . Meqenëse ligji në fjalë është i specifikuar për rregullat e trafikut rrugor rastet e parapara në nenin 255 si “Masat e veçanta për kundërvajtje” nënkupton vetëm për gjobat e shqiptuara me urdhër të organit i cili kryen autorizime publike të mbikëqyrjes për zbatimin e këtij ligji në rastin konkret “Divizioni i Komunikacionit Rrugor “.

Ligji nr. 05/L-087 Për Kundërvajtje në nenin 30 me titullin “ Afati për pagesën e gjobës “ paragrafin 3 përcakton se: “ Në rastin e pagimit të gjobës, në afatin e përcaktuar me urdhrin kundërvajtjes, i dënuari lirohet nga pagimi i 50% nga shuma e gjobës së shqiptuar “, pra nuk parasheh që kjo mund të bëhet me aktgjykim, ndërsa paragrafi 4 përcakton ekzekutimin e gjobës nëse kryesi i kundërvajtjes pjesërisht ose në tersi nuk e paguan gjobën në afatin e përcaktuar në at rast, do të zbatohet përmbarimi i detyrueshëm në pajtim me dispozitat e Ligjit për Përmbarim dhe si i tillë urdhri kundërvajtës përmes të cilit shqiptohet gjoba do të cilësohet dokument përmbarues në përputhje me dispozitat e Ligjit për procedurën përmbarimore. Në këtë drejtim Ligji për kundërvajtje pagesën e gjobave të shqiptuara nga Gjykata e rregullon ndaras nga dispozitat e urdhrin kundërvajtës të cekur më lartë, kështu në nenin 163 paragrafi 1 përcakton se gjobën e dhënë për kundërvajtjen dhe shpenzimet e procedurës së kundërvajtjes i ekzekuton gjykata që e ka dhënë ndëshkimin, me këtë rast nuk përcakton ndonjë pagës 50% apo ndonjë shumë tjetër fikse siç e përcakton Ligji për Trafikun Rrugor.

Pra organi i kundërvajtjes i ka fikse të parapara shumat për shqiptimin e gjobës, ndërsa gjykata ka detyrim që pas seancës ta shqiptoj dënimin duke vlerësuar nga ana e gjyqtarit të gjitha rrethanat e matjes së dënimit të parapara në nenin 31 të Ligjit për Kundërvajtje.

(Udhëzimi i miratuar në seancën e përgjithshme të Gjykatës Supreme, i mbajtur më 24.09.2020)



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Mbledhja e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, në kuadër të kompetencave të parapara me nenet 26 dhe 27 të Ligjit për Gjykatat, më 11 qershor 2020 me shumicë votash miratoi:

UDHËZIM

**LIDHUR ME CILËSIMIN JURIDIK DHE TRAJTIMIN E RASTEVE TË DHUNËS
NË FAMILJE SIPAS KODIT PENAL TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

Me hyrjen në fuqi të Kodit të ri, penal, në prill të vitit 2019, me të cilin kod në nenin 248, Dhuna në familje është paraparë si veprë e veçantë penale, për shkak të mënyrës së formulimit të dispozitave të këtij neni janë paraqitur edhe dilema të ndryshme rreth cilësimit juridik të kësaj vepre.

Dilemat kryesisht kanë pasur të bëjnë me çështjet:

- Si sanksionohet Dhuna në familje sipas nenit 248 të Kodit penal?
- Si definohet dhuna psikologjike dhe ekonomike si formë e dhunës në familje, referuar në nenin 248 të Kodit penal?
- Në cilat raste cilësimi bëhet sipas veprës bazë e në cilat sipas nenit 248?
- Si të veprohet në rast të shkeljes së Urdhrit mbrojtës të lëshuar sipas LMDHF?

Pas analizimit me kujdes të dispozitave të nenit 248 dhe neneve tjera përkatëse si dhe pas konsultimeve me akterë relevant, me qëllim të sqarimit të dilemave të ngritura, Gjykata Supreme lëshon këtë Udhëzim për cilësimin juridik dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje sipas Kodit penal të Republikës së Kosovës.

- I. Si parim kryesor kualifikimi i veprës penale të dhunës në familje në të gjitha ato raste kur përmbushen elementet e veprës/ve bazë duhet të bëhet sipas nenit/ve dhe paragrafit/ve përkatës e jo të bëhet njëkohësisht edhe lidhja me nenin 248 të Kodit penal.

- II.** Në të gjitha rastet kur elementet e ndonjë vepre tjetër bazë nuk janë përmbushur, për shkak të pasojës së shkaktuar e cila është e natyrës më të lehtë apo kur mungon prova mbi pasojën e shkaktuar, cilësimi bëhet sipas paragrafit përkatës të nenit 248 varësisht nga lloji i dhunës së shkaktuar.
- III.** Në rast të shkeljes së Urdhrit mbrojtës, vendoset me dy dispozitivë, gjithnjë përderisa shkelja e atij urdhri është e shoqëruar edhe me kryerjen e një vepre tjetër penale të ndërlidhur.

A r s y e t i m

Me qëllim të ngritjes së efikasitetit në trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe sanksionimit sa më adekuat të kryesve të këtyre veprave, duke synuar në plotësimin e standardeve për ofrimin e mbrojtjes së duhur viktimave të dhunës në familje, në pajtim me Konventën e Stambollit, ligjvënësi me dispozitën e nenit 248 të Kodit penal ka paraparë dhunën në familje (me të katër format si ajo mund të shfaqet) si vepër të veçantë penale. Megjithatë, po i njëjti nen njëkohësisht ka krijuar edhe paqartësi rreth asaj se si duhen interpretuar dispozitat e këtij neni veç e veç dhe cila është mënyra më efektive për trajtimin e lëndëve të kësaj natyre.

Duke pasur parasysh kërkesat e shumta të paraqitura nga gjyqtarë dhe profesionistë tjerë lidhur me kualifikimin adekuat në rast të veprave penale të kryera ndaj anëtarëve të familjes apo në kuadër të marrëdhënies familjare, Gjykata Supreme ka analizuar kuadrin ligjor relevant me qëllim të harmonizimit të qëndrimeve dhe praktikave në tërë Republikën e Kosovës. Kjo është bërë me qëllim që të qartësohet cila do të ishte qasja për këto vepra varësisht nga specifikat e rastit konkret. Për më gjerësisht, më poshtë do të bëjmë një ekspozë të neneve relevante të Kodit penal që lidhen me dhunën në familje, për të sqaruar tutje lidhjen mes tyre.

I. Analizë e nenit 248 - Fillimisht, dilema specifike lidhur me nenin 248 paraqitet në paragrafet 1 dhe 3 të këtij neni, pasi vërehet një duplikim i paragrafeve por me një ndryshim substancial sa i përket formave të dhunës në familje dhe qëllimit të kryerjes së veprës penale. Kështu sipas paragrafit 1 dhuna e ushtruar pasqyrohet në tre format e saj si dhunë apo keqtrajtim fizik, psikologjik dhe ekonomik, në paragrafin 3 të po këtij neni është shtuar edhe forma e katërt e dhunës e që është ajo seksuale.

Një tjetër konfuzion mes paragrafit 1 dhe 3 lidhet me atë se përderisa paragrafi 1 potencon se dhuna e ushtruar kryhet “me qëllim *“...të cenimit të dinjitetit të personit tjetër brenda një marrëdhënie familjare...”* paragrafi 3 nuk përmend fare qëllimin e kryerjes së kësaj vepre. Në dukje, paragrafi 1 duket se përmban elemente të një veprë më të rëndë sesa ajo e paragrafit 3, pikërisht për shkak se paraqet një indikacion se veprimet e tilla mund të jenë kryer në vazhdimësi ndaj viktimës nga ana e kryesit për ta arritur qëllimin e cenimit të dinjitetit të viktimës, përderisa, paragrafi i 3 mund të nënkuptojë edhe një veprim të çastit pa një karakteristikë të ushtrimit të dhunës apo presionit të vazhdueshëm e cila do të përmbushte elementin e cenimit të dinjitetit. Megjithatë, nëse e analizojmë në aspekt të sanksionimit, në

mënyrë absurde është paraparë sanksion i njëjti si për par.1 po ashtu edhe për paragrafin 3 të këtij neni.

Paragrafi 2 i po këtij neni, nuk bën asgjë më tepër veçse rithekson atë që tashmë është paraparë me nenin 70 të Kodit penal par.2.14 ku thuhet se rrethanë rënduese do të konsiderohet “*nëse vepra penale kryhet brenda marrëdhënies familjare.*” Pra praktikisht, një paragraf i tillë në nenin 248 na paraqitet i panevojshëm dhe nuk luan ndonjë rol të veçantë përpos se rikujton obligimin sipas par.2.14 të nenit 70. Duke ditur se një nga parimet kryesore në matjen e dënimit është se nuk lejohet duplikimi i elementeve të veprës penale me rrethanat rënduese apo lehtësuese, atëherë i bie që ky paragraf të mos jetë fare relevant në trajtimin e temës së këtij Udhëzuesi, duke pasur parasysh se marrëdhënia familjare është kushti primar për t’u konsideruar një vepër dhunë në familje.

Nëse analizojmë par.3.2 i njëjti në lidhje me përkufizimet e të katër formave të dhunës i referohet Ligjit nr.03/L-182 për mbrojtje nga Dhuna në Familje (tutje LMDHF). Kur shohim LMDHF, këto forma të dhunës në familje, janë vetëm të listuara në një listë gjithëpërfshirëse, por nuk janë decidivisht të përkufizuara.⁶¹ Kjo domosdoshmërisht na shpie tek nevoja e dhënies së disa analizave bazike për disa nga format e dhunës të parapara me Kodin penal, përdërisa kjo të mos zgjidhet përfundimisht përmes amandamentimit potencial të LMDHF.

II. Përcaktimi i dhunës psikologjike dhe ekonomike.- Me miratimin e Kodit të ri janë ngritur menjëherë dilemat se si mund të përcaktohet në veçanti dhuna psikologjike dhe ajo ekonomike? Analiza e mëposhtme është dhënë vetëm me qëllim që të ndihmojë në vlerësim të elementeve që mund të përbëjnë dhunë psikologjike apo ekonomike si në aspekt të përmbushjes së elementeve të veprës bazë ashtu edhe në atë të nenit 248. Për të vërtetuar dhunën psikologjike apo ekonomike duhet të vlerësohen sjelljet dhe veprimet e kryesit dhe metodologjia e ushtrimit të kontrollit të vazhdueshëm nga ana e kryesit që çojnë në format e ndryshme të dhunës psikike dhe ekonomike ndaj viktimës.

a.) Dhuna psikologjike mund të përfshijë kontrollin e vazhdueshëm, keqtrajtimin verbal, izolimin, poshtërimin apo abuzimin emocional përmes sharjes, ofendimit, shantazhit, frikësimit, përcjelljes dhe vëzhgimit të vazhdueshëm, trajtimin degradues, kanosjen apo format e ngjashme të kontrollit apo mbajtjen nën shqetësim të vazhdueshëm emocional duke e vënë viktimën në frikë të arsyeshme nga përdorimi i dhunës ndaj saj apo personave në marrëdhënie familjare.

Të gjitha këto, në të shumtën e rasteve përbëjnë elemente që gjenden në njërin apo tjetrin vepër penale të paraparë me Kod Penal dhe mbetet që si me rastin e kualifikimit të veprës penale e po ashtu edhe të vendosjes së këtyre rasteve të konstatohet nëse janë përmbushur

⁶¹ Edhe pse si parim Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje ka për qëllim trajtimin e procedurave për lëshimin e Urdhërave mbrojtës civil, pikërisht për shkak të references që I bën neni 248 këtij Ligji, në vitin 2019 është ndërmarrë iniciativë parlamentare për amandamentimin e LMDHF. Është parashikuar që ligji i amandamentuar të jep përkufizime veq e veq për secilën formë të dhunës në Familje të paraparë edhe me Kod penal. Drafti ka mbetur pa u finalizuar dhe pritet që i njëjti të kalojë në ndërkohë nëpër procedurat e nevojshme për miratim.

elementet e veprës së veçantë penale apo nëse ky lloj i dhunës duhet kualifikuar sipas nenit 248 të Kodit penal.

b.) Dhuna ekonomike përfshinë mohimin e qasjes apo kontrollit të burimeve bazike përmes kufizimit të mjeteve të domosdoshme për jetë, mohimin e qasjes në shërbime mjekësore, shkollim apo punësim, dëmtimin e pasurisë apo formave tjera të presionit me qëllim të mbajtjes së një personi në pozitë të varur ekonomike. Dhuna ekonomike mund të jetë e shprehur si formë e vetme e presionit apo e kombinuar me format tjera të keqtrajtimit apo dhunës e në veçanti e kombinuar me dhunën psikologjike.

P.sh., një element të tillë e vërejmë tek vepra penale e dhunimit nga neni 227 ku në paragrafin 4.10.1 kemi përzierjen e elementit të abuzimit ekonomik të viktimës “...duke keqpërdorur kontrollin e tij mbi gjendjen financiare, familjare, shoqërore, shëndetësore, të punësimit, shkollimit, fetare ose rrethanave tjera të personit të tillë apo të personit të tretë” me rastin e ushtrimit të dhunës seksuale.

Siç mund të shihet edhe nga elaborimi i këtyre dy formave të dhunës, të gjitha elementet i referohen veprimeve të kryesit që në fund kanë edhe efektin e tyre në aspektin e mirëqenies ekonomike apo psikologjike të viktimës.

Andaj, për të vërtetuar dhunën psikologjike apo ekonomike duhet të vlerësohen sjelljet dhe veprimet e kryesit dhe metodologjia e ushtrimit të kontrollit të vazhdueshëm nga ana e kryesit e jo vetëm efekti që këto veprime mund të kenë në viktimën. Kjo pasi efekti është pasojë e veprimeve që përbëjnë dhunë psikologjike dhe ekonomike që shpijnë në format e ndryshme të dhunës psikike dhe ekonomike ndaj viktimës.

Analiza e mësipërme do të shërbejë për të kuptuar elementet e njërës formë të dhunës apo tjetrës. Nëse konsiderohet se është i domosdoshëm angazhimi i ekspertit, atëherë pyetja e adresuar për shembull për qëllim të konstatimit të dhunës psikologjike duhet të jetë në aspekt të asaj se:

A konsistojnë veprimet e kryesit në dhunë të atij llojit që mund të ketë efekt psikologjik në viktimën e jo vetëm nëse viktimë ka ndonjë çrregullim psikologjik pasi në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me vlerësimin e shkallës së përgjegjshmërisë apo shkallës së dëmit për qëllim të vërtetimit të dëmshpërblimit.

Sugjerohet që ekspertiza të caktohet kryesisht në rastet kur paraqitet nevoja të ftohet për të dëshmuar një ekspert i cili në aspekte të dokumentuara shkencore do të mund të sqaronte ndikimin që trauma e përjetuar si pasojë e dhunës në familje mund të ketë në trurin e viktimës dhe reagimin e viktimës pas ngjarjes traumatike, posaçërisht gjatë kontaktit me një varg akterësh institucional.

III. Përkufizimet tjera me rëndësi në Kodin penal, relevante për dhunën në familje

Një ndryshim pozitiv në Kodin e ri penal Neni 113, par 25, shihet në formën se si është kategorizuar ‘Marrëdhënia familjare’. Shihet qartë se është dhënë një përkufizim pothuajse identik me përkufizimin e dhënë në Ligjin për mbrojtje nga dhuna në familje, por që bëhet një ndarje e raportit familjar në paragrafin 25.1 ku përfshihet raporti mes dy personave apo çiftit, ndërsa në paragrafin 25.2 grupohen raportet familjare kur është fjala për anëtarët tjerë të familjes më të gjerë.

Definicioni tjetër me rëndësi për rastet e dhunës në familje është përkufizimi i dhënë sipas nenit 113, par.26 “Anëtar i familjes - prindi, prindi adoptues, fëmija, fëmija i adoptuar, vëllai ose motra, bashkëshorti ose bashkëshortja, i afërmi i gjakut që jeton në të njëjtën shtëpi ose personi me të cilin kryesi jeton në bashkësi jashtëmartesore”. Ky përkufizim në krahasim me përkufizimin e mësipërm të marrëdhënies familjare paraqet një listë më të ngushtë.

Një tjetër definicion me rëndësi i cili me Kodin e vitit 2019 ka pësuar ndryshime thelbësore është definicioni i Viktimës së ndjeshme paraparë me nenin 113 par.39 i cili thotë si në vijim: “*Viktimë e ndjeshme - është viktima e veprës penale e cila është fëmijë, person me aftësi të kufizuara fizike apo mendore, person me aftësi të zvogëluar, grua shtatzënë, i/e moshuar ose person marrëdhënia apo varësia e të cilit ndaj kryesit e bën atë veçanërisht të ndjeshëm ndaj viktimizimit të përsëritur, frikësimit të përsëritur apo hakmarrjes së përsëritur.*” Pra nëse analizojmë pjesën e dytë të këtij definicioni, gjejmë se pikërisht janë këto elemente që janë karakteristika më së shumti e shprehur tek rastet e dhunës në familje. Kjo pasi përmes këtij definimi jepen të gjitha ato elemente të cilat pasqyrojnë ciklin e “*Pushtetit dhe Kontrollit*”⁶² si karakteristike e dhunës në familje.

Për të dhënë analizën se sipas cilit nen dhe paragraf duhet të cilësohet vepra penale kur kryhet brenda marrëdhënies familjare është me rëndësi që gjithnjë të qartësohet si në vijim:

- Lloji i veprës penale;
- Konstatimi për ekzistim të raportit mes kryesit dhe viktimës.
- Pasoja e shkaktuar e veprës penale;

Kur është fjala për llojin e veprës penale dhe raportin mes kryesit dhe viktimës, primare është të shikohet nëse neni relevant parasheh në mënyrë specifike marrëdhënien familjare si rrethanë që ndikon në përcaktimin e një dënimi më të rëndë?

Disa nga nenet nuk parashohin marrëdhënien familjare apo anëtarin e familjes, por i referohen viktimës së ndjeshme. Më poshtë do të listojmë disa nga nenet më relevante të Kodit penal për format më të shpeshta se si shprehet dhuna në familje dhe si ato janë të parapara me nenet e veçanta të Kodit penal:

⁶² “Power and Control wheel”, zhvilluar nga Domestic Abuse Intervention Project, SHBA. Cikli i Pushtetit dhe kontrollit pasqyron format e dhunës dhe abuzimit në rastet e dhunës në Familje duke dhënë një përshkrim të shkurtër se çfarë përfshin secila nga ato forma.

a.) Nenet e Kodit penal ku është paraparë kryerja e veprës ndaj viktimës së ndjeshme:

1. Neni 180 par.3 - Gjymtimi i organeve gjenitale femërore;
2. Neni 181 par.4 – Kanosja;
3. Neni 184 par.3 – Sulmi;
4. Neni 185 par.3 - Lëndimi i lehtë trupor;
5. Neni 186 par.4 - Lëndimi i rëndë trupor;
6. Neni 192 par.2.4 – Shtrëngimi;
7. Neni 193 par.2.1 - Privimi i kundërligjshëm i lirisë;

Në të gjitha nenet e mësipërme nuk kemi referencë në anëtarin e familjes, por viktimës së ndjeshme. Kjo nënkupton që duhet plotësuar domosdo kushti i marrëdhënies apo varësisë së viktimës ndaj kryesit dhe se pikërisht është kjo marrëdhënie apo varësi që e bën atë person “...veçanërisht të ndjeshëm ndaj viktimizimit të përsëritur, frikësimit të përsëritur apo hakmarrjes së përsëritur”. Andaj, përpos elementeve të parapara për veprën përkatëse, duhet analizuar nëse ekziston elementi i varësisë ndaj kryesit? Nëse ky element mungon, atëherë nuk bëhet referim i menjëhershëm në paragrafin që i referohet viktimës së ndjeshme, pasi ekzistimi i varësisë është element kyç për të determinuar se në cilin paragraf duhet referuar.

Në rastet kur nuk mund të cilësohet një viktimë si viktimë e ndjeshme sipas parimit të mësipërm, mbetet që me rastin e shqiptimit të dënimit, gjykata, bazuar edhe në kërkesën e prokurorit, të merr parasysh rrethanën rënduese sipas nenit 70 par.2.14.

Shemb. Nëse kryesi për shkak të një zënke rreth një çështje pronësore i shkakton lëndim të lehtë trupor viktimës, që njëkohësisht është vëllai i tij me të cilin jeton në një shtëpi të përbashkët, por nuk kanë ndonjë raport varësie si dhe nuk raportohet se ka pasur incidente të mëparshme, atëherë në rastin konkret, vepra do të cilësohej sipas Nenet 185 par.1 apo 2 varësisht nga mënyra e kryerjes së veprës e jo par.3 që i referohet viktimës së ndjeshme.

b.) Nenet e Kodit penal ku është paraparë kryerja e veprës ndaj personit me të cilin kryesi është në marrëdhënie familjare apo anëtarin e familjes:

1. Neni 163 par.3- Skllavëria, kushtet e ngjashme me skllavërinë dhe puna e detyruar;
2. Neni 173 par.1.3 – Vrasja e rëndë.
3. Neni 182 par.2 – Ngacmimi (përfshin edhe referimin në ish anëtarin apo anëtarin aktual të familjes);
4. Neni 227 par.4.9 – Dhunimi;
5. Neni 229 par.3.9- Sulmi seksual
6. Neni 230 par.3.9 - Degradimi i integritetit seksual nga neni 230

Për dallim nga nenet e mësipërme, situata është shumë më e qartë tek këto nene ku ekzistimi i një marrëdhënie familjare mes kryesit dhe viktimës automatikisht e bën një vepër të cilësuar. Është me rëndësi të theksohet në veçanti neni 227 (Dhunimi) ku me Kodin e ri është shtuar edhe marrëdhënia familjare e cila në mënyrë decisive nuk ka qenë e përmendur më herët, e që

në gjuhën e njohur ndërkombëtarisht quhet ‘Dhunim martesor’ duke e ngritur automatikisht lartësinë e dënimit. E njëjta situatë është edhe me dy nenet e tjera të mësipërme për veprat kundër integritetit seksual.

c.) Nenet tjera relevante ku jepet një formë e referimit në anëtarin e familjes

1. **Neni 183 par.1 dhe 3 - Ngacmimi seksual** (personi në ndonjë mënyrë tjetër ka pozitë të autoritetit mbi atë person apo ekziston gjendja e varësisë);

Nëse analizohet neni për ngacmimin seksual edhe pse nuk i referohet drejtpërdrejtë viktimës së ndjeshme apo ekzistimit të marrëdhënies familjare megjithatë, në të tre paragrafet 1,2 dhe 3 mund të gjejmë elementet që përmbushin kërkesën e varësisë dhe qëllimin e kryerjes së veprës:

Par.1 “... personin i cili është i ndjeshëm për shkak të ... varësisë...”

Par.2 “... me qëllim të cenimit të dinjitetit apo që cenon dinjitetin e personit, dhe krijon një mjedis i cili është objektivisht frikësues, armiqësor, degradues ose poshtërues.”

Par.3 “...kryesi... ka pozitë të autoritetit mbi atë person ...”.

Elementet e mësipërme kombinuar me rrethanën rënduese të ekzistimit të marrëdhënies familjare sipas nenit 70 par.2.14 shpijnë në vlerësim të peshës së veprës penale dhe rrjedhimisht edhe të një sanksioni më të rëndë për kryesin.

Siç shihet edhe nga analiza e mësipërme, cilësimi i veprës penale të kryer brenda marrëdhënies familjare, ndaj anëtarit të familjes apo ndaj viktimës së ndjeshme, si parim do duhej të bëhet në bazë të veprës apo veprave bazë (nëse ka më shumë se një vepër të kryer), e jo sipas nenit 248, nëse janë përmbushur të gjitha elementet e asaj vepre bazë. Kjo është në pajtim me frymën e Kodit penal, i cili siç u pa edhe më lartë në çdo rast kur vepra e caktuar penale është kryer në kuadër të një marrëdhënie familjare është sanksionuar më rëndë nga format tjera, brenda të njëjtit nen apo në raport me nenin 248 (Dhuna në familje).

IV. Rastet që mund të trajtohen sipas nenit 248

Duke u bazuar në analizën e mësipërme se vepra e cilësuar për shkak të raportit familjar ka ngelur e shpërndarë përgjatë tërë Kodit, rrjedhimisht edhe vijmë në konkludimin se qëllimi i ligjdhënësit ka qenë që neni 248 të shërbejë më shumë si referencë dhe cilësim i këtyre formave të dhunës si dhunë në familje sesa që të gjitha veprat që kryhen brenda marrëdhënies familjare të sanksionohen sipas nenit 248. Kjo pasi në të kundërtën ne do të vepronim në kundërshtim me parimet e njohura edhe ndërkombëtarisht se veprat e tilla duhet të dënohen më ashpër. Për këtë, konkludojmë se qëllimi i nenit 248 është që t’i përfshijë format më të lehta të dhunës në familje. Në çdo rast kur nuk janë përmbushur elementet e ndonjë nga veprat bazë, si për shkak të shkallës së dhunës së ushtruar apo mungesës së provave për atë element, kualifikimi i veprës bëhet sipas nenit 248. Për qëllime ilustrimi më poshtë do të prezantojmë një situatë hipotetike nga neni 248:

Për shkak të një mosmarrëveshje, kryesi godet në kokë viktimën, vëllain e tij. Viktima e paraqet rastin në polici, por i njëjti nuk trajtohet nga ndonjë mjek për shkak të goditjes së marrë dhe kështu nuk ka asnjë raport mjekësor.

Në mungesë të raportit mjekësor dhe mungesës së konstatimit të lëndimeve të pësuar, i pandehuri do të ndiqet për veprën penale, dhuna në familje nga neni 248 të KPRK-së. Ndërsa paragrafi 1 apo 3 plotësohet në varësi të asaj nëse goditja është bërë me **qëllim të cenimit të dinjitetit të tij**.

Një rast për dy mundësi të cilësimit të veprës do të gjenim tek veprat kundër pasurisë, më saktësisht do të marrim si shembull nenin 321 (Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë).

Paragrafi 1 i këtij neni pasqyron disa nga elementet e dhunës ekonomike të sqaruar në pikën II.b. të këtij Udhëzuesi. Ky paragraf sanksionon **asgjësimin, dëmtimin apo bërjen të papërdorshme të pasurisë së personit tjetër** dhe sanksioni i paraparë është gjobë ose burgim deri në 1 vit. Edhe pse, edhe neni 248 sanksionon dhunën ekonomike si një nga format se si mund të jetë e shprehur dhuna në familje, në respektim të parimit të elaboruar më lartë, cilësimi i veprës në rast se është kryer ndaj anëtarit të familjes, do të bëhet sipas veprës bazë (nenit 321 në këtë rast) gjithnjë kur paraqitet si vepër e izoluar pasurore. Ndërkaq, është me rëndësi të theksohet se në situatat kur vepra e kryer është bërë me qëllim të cenimit të dinjitetit, si formë e presionit, dhunës ekonomike dhe psikologjike ndaj viktimës, në këto raste cilësimi bëhet sipas nenit 248 të KP.

V. Shkelja e Urdhrit mbrojtës

Një tjetër dilemë ka qenë edhe çështja se si të veprohet në rastet kur ka shkelje të Urdhrit mbrojtës të lëshuar nga gjykata në pajtim me Ligjin për mbrojtje nga Dhuna në familje? Për rastet e tilla duhet bërë po ashtu vlerësimi nëse shkelja e Urdhrit mbrojtës është bërë duke kryer një vepër tjetër penale, që edhe ndodh në shumicën e rasteve.

a.) Duke qenë se urdhri mbrojtës në përmbajtje kryesisht ka ndalesa për kryesin për të mos kryer një veprim të caktuar, domosdoshmërisht supozohet se në këtë rast do të kemi dy vepra të shkaktuara: shkeljen e Urdhrit mbrojtës sipas nenit 393 (Mospërfillja e gjykatës) dhe veprën tjetër që ka shpie deri te shkelja e atij urdhri psh. Ngacmimi, kanosja, lëndimi trupor etj. Për qartësim të kësaj situatë do japim shembullin kur një person ka të shqiptuar nga Gjykata Urdhrin mbrojtës nga neni 6 i Ligji për mbrojtje nga Dhuna në familje⁶³ me qëllimin që të ndalohet ushtrimi i dhunës së mëtutjeshme ndaj viktimës.

Kur kryesi, ndaj të cilit është shqiptuar një urdhër i tillë, përsërit dhunën ndaj viktimës p.sh. duke ushtruar dhunë fizike dhe duke i shkaktuar lëndim të lehtë trupor, në këtë rast kryesi do duhej të ngarkohet me dy vepra penale:

⁶³ Ligji nr. 03/l-182 për mbrojtje nga dhuna në familje, neni 6 (Masa mbrojtëse e ndalimit të shqetësimit personave të ekspozuar dhunës), Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.76, Prishtinë, 10 gusht 2010.

- Mospërfillja e Gjykatës nga neni 393;
- Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185;

b.) Në rastin tjetër kur përpos shkeljes së Urdhrit mbrojtës si më sipër kryesi ka ushtruar dhunë ndaj viktimës por siç është përshkruar edhe më lartë në Pikën IV, ose nuk janë përmbushur ndonjë nga elementet e veprës bazë (lëndimi i lehtë trupor) ose nuk ka raport për lëndimet, kryesi do mund të ngarkohet me dy vepra:

- Mospërfillja e Gjykatës nga neni 393;
- Dhuna në familje nga neni 248.

c.) Për fund, në rastet kur kryesi ka shkelur vetëm Urdhrin mbrojtës, atëherë kryesi mund të ngarkohet vetëm për mospërfillje nga neni 393.

Ky Udhëzim do të shërbejë për trajtimin më efikas të veprave penale që kryhen brenda marrëdhënies familjare dhe atyre që ndërliken me dhunën në familje si dhe unifikimin e praktikës ligjore të kualifikimit të veprës penale të dhunës në familje, duke pasur parasysh formulimin aktual në Kodin penal të kësaj vepre.

(Udhëzimi i miratuar në seancën e përgjithshme të Gjykatës Supreme, i mbajtur më 11 qershor 2020)



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Mbledhja e përgjithshme e Gjykatës Supreme e Republikës së Kosovës, pas shqyrtimit të Udhëzuesit për shqiptimin e gjobave, në bazë të nenit 26 dhe 27 të Ligjit për Gjykatat, më datë 27 shkurt 2020, në mënyrë unanime me votat e të gjithë gjyqtarëve prezent miratoi:

UDHËZIM SPECIFIK

**CAKTIMI I GJOBËS SI SANKSION PËR VEPRAT PENALE SIPAS KODIT PENAL
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

Dispozitat e përgjithshme për llogaritjen e gjobave

Një nga detyrat më sfiduese në hartimin e Udhëzuesit është gjetja e një mënyre për të harmonizuar shqiptimin e gjobave ashtu që të arrihet qëllimi i tyre në mënyrë të barabartë për të gjithë kryerësit. Në vijim është paraqitur një elaborat i llogaritjes së gjobave me qëllim që të sigurohet më shumë njëtrajtshmëri ndaj qasjes në caktimin e gjobave në rastet kur Kodi penal i Republikës së Kosovës parasheh gjobën si një nga llojet e sanksioneve.

Ajo që vlen të theksohet qysh në hyrje të këtij Udhëzuesi, është domosdoshmëria e angazhimit aktiv të organit të akuzës por edhe mbrojtjes në sigurimin e të dhënave të nevojshme gjatë procedurës në mënyrë që gjykata të mund të vendos sa më drejtë sanksionin adekuat për kryesin me qëllim të individualizimit të dënimit. Vet neni 7 i Kodit të Procedurës penale shpreh obligimin e institucioneve të drejtësisë (gjykatës dhe prokurorisë) në vërtetimin e plotë dhe të saktë të gjendjes faktike “Gjykata, prokurori i shtetit dhe policia të cilët marrin pjesë në procedurën penale detyrohen që saktësisht dhe tërësisht ti vërtetojnë faktet të cilat janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm”.⁶⁴

Si parim i përgjithshëm, shuma e gjobës duhet të pasqyrojë peshën e veprës penale dhe të marrë

⁶⁴ Kodi Procedurës penale të Republikës së Kosovës, Nr.04/L-123, Neni 7, Detyrimi i përgjithshëm përvërtetimin e plotë dhe të saktë të fakteve, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, 28.12.2012

parasysh rrethanat financiare të kryerësit duke siguruar që niveli i gjobës të mos jetë më i lartë se mundësia e kryesit për të paguar. Është me rëndësi të potencohet që në shumë raste edhe shqiptimi i një gjobe si dënim ekonomik, mund të godasë shumë më rëndë kryesin sesa dënimi me burgim. Megjithatë, për shkak të, shpesh shabllonizimit të lartësisë së gjobës, gjobat shumë më tepër godasin kryesit me gjendje të dobët financiare sesa kryesit që qëndrojnë mirë financiarisht.

Një kryes i pasur shpesh nuk ndikohet nga gjoba dhe mund të jetë i gatshëm ta trajtojë gjobën si kosto e pranueshme që i njëjti duhet të paguaj si kundërshpërblim i përfshirjes në sjellje të ndaluar. Një i pandehur me mjete të kufizuara financiare nga ana tjetër mund të shkatërrohet edhe nga një gjobë e ulët pasi mund ti krijojë vështirësi ekonomike si për të ashtu edhe për familjen e tij.⁶⁵

Kodi penal⁶⁶ thekson që në përcaktimin e gjobës gjykata merr parasysh:

- gjendjen pasurore të kryerësit, dhe,
- në veçanti, shumën e të ardhurave personale të tij/saj,
- të ardhura të tjera,
- pasuritë dhe
- detyrimet.

Qëllimi është që gjoba të ketë një ndikim të barabartë mbi kryerësit me gjendje të ndryshme financiare. Kur shpenzimet e jetesës së kryerësit të veprës penale janë substancialisht më të ulëta nga sa do të pritej normalisht, mund të jetë e përshtatshme që të rregullohet shuma e gjobës për të reflektuar këtë. Kjo mund të ndodh për shembull, në rastet kur një kryes nuk kontribuon financiarisht në shpenzimet e tij të jetesës. Në anën tjetër në rastet kur kryesi pranon të ardhura të larta dhe dënohet për shembull për veprë penale të korrupsionit, për shkak të përfitimit material që shpesh shoqërohet me këto vepra penale, gjoba duhet të caktohet në përputhje me parimet e mësipërme dhe duke pasur parasysh kategoritë specifike të gjobave dhe peshën e veprës penale.

Duhet të jetë e qartë se qëllimi i gjobës nuk është që të merret dobia pasurore e përfituar nga vepra penale nga kryerësit. Kjo për shkak se gjoba është dënim dhe duhet të llogaritet në përputhje me dispozitat që vlejné për llogaritjen e dënimit. Çështja e heqjes së fitimit nga vepra penale nga ana tjetër bëhet në pajtim me nenit 92⁶⁷ të Kodit Penal, dispozitave përkatëse të Kodit të procedurës penale si dhe Ligjit për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë⁶⁸.

⁶⁵ Kodi penal model [Model Penal Code: Sentencing Reporters' Introduction], Kevin R.Reitz, Raportues, Cecelia M.Klinge, Ndihmës raportues, fq.174, 2019.

⁶⁶ Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Nr.06/L-074, Neni 69 Rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, 14.01.2019.

⁶⁷ Ibid. Neni 92, Konfiskimi i mjeteve dhe përfitimit material nga vepra penale.

⁶⁸ Ligji nr.06/L-087 për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, 26.12.2018.

Kur kemi parasysh dispozitat e Kodit penal që i referohen pasojave juridike të dënimit⁶⁹ sipas së cilave pasojat juridike të dënimit nuk krijohen kur kryesit i shqiptohet gjoba apo vërejtja gjyqësore, automatikisht kjo kërkon një vlerësim më të thellë nga gjykata se në cilat raste shqiptimi i gjobës do të shërbejë si dekurajim dhe parandalim individual apo i përgjithshëm për kryerje të veprës penale nëse asnjë pasojë nuk krijohet për kryesin. Andaj, do ishte shqetësuese nëse për vepra shumë të rënda penale, të cilat edhe përbëjnë dëm të madh për individin dhe shoqërinë kryesi të mund të kalojë shumë lehtë. Kjo vlen sidomos edhe në rastet kur përpos dënimit me gjobë kryesit nuk i caktohet asnjë masë tjetër kufizuese apo edhe dënim plotësues për veprën e kryer (shemb.nuk caktohet dëmshpërblimi, ndonjë obligim plotësues apo edhe konfiskimi i pasurisë).

Pesha e veprës penale sipas nivelit të dëmit

Duke qenë se një nga parimet bazë të caktimit të sanksionit për një kryes, jo vetëm tek caktimi i dënimit me burg por edhe tek gjobat, është pesha e veprës penale, për qëllim edhe të këtij Udhëzuesi është e nevojshme të specifikohet edhe lartësia e dëmit. Kategorizimi i lartësisë së dëmit, kur i njëjti mund të kuantifikohet është i paraparë me dispozitat e nenit 113 par.31-34. Më poshtë do të paraqesim një elaborim të këtyre dispozitave duke i ndarë në grupe për referim më të lehtë:

Grupi A. - Dëm - kur vlera e përfitimit dhe/ose dëmit është deri në ose më pak se 5.000€. Kjo nën-kategori përfshin raste kur vlera e dëmit përmendet qoftë në mënyrë specifikesi shuma nën 5000€ ose vlerësohet të jetë deri në atë shumë veçanërisht kur paragrafët e tjerë të neneve të njëjtë përcaktojnë dëmin më të lartë se 5000 €.

Grupi B. - Dëm i konsiderueshëm, kur vlera e dëmit/ humbjes është më e lartë se 5.000€ dhe më pak se 15.000€. KP përmban dy dispozita të ndryshme që lidhen me nivelin e dëmit: ato që përcaktojnë dëmin/përfitimin më të lartë se 5,000 € dhe tjerat që parashohin raste ku dëmi është më i vogël se 15,000 €. Për shkak se të dyja këto kategori janë brenda të njëjtit nivel të dëmit (> 5,000 <15,000 €), dispozitat e tilla u grupuan në një grup të vetëm pasiniveli i dëmit/humbjes mund të ndryshojë. Gjykatës do t'i duhet të mbajë në mend vetëm përkufizimet e dëmit në nenin 113 të Kodit për të dhënë referencën e duhur për dëmin.

Grupi C. Dëm i madh, dëm i konsiderueshëm ose humbje e konsiderueshme - Kur vlera e dëmit/humbjes është më shumë se 15.000 € dhe deri në 50.000 €. Ndonëse Kodi penal zakonisht i referohet vetëm sasisë minimale në kategorinë përkatëse, fakti që grupi pasues i referohet një dëmi më të madh se 50.000€, Udhëzuesi i jep shumën maksimale këtij grupi në pajtim me kategorizimin e dhënë në Kodin penal.

Grupi D. Dëm i shkallës së madhe, shkatërrim në shkallë të madhe ose humbje në shkallë të madhe - Kur vlera e dëmit/humbjes është më shumë se 50.000 €. Ky grup përfshin të gjitha veprat penale, të cilat në vete përmbajnë dëmin/humbjen më të lartë të paraparë nga

⁶⁹ Ibid. supra note 3, Neni 93, Pasojat juridike të dënimit, par.2.

Kodi. Si e tillë, gjykata duhet të jetë shumë e kujdesshme kur të merr vendim përtë shqiptuar dënime dhe gjoha më të buta për këtë kategori, pasi që kjo nuk do të ishte në pajtim me qëllimin e ligjvënësimit. Natyrisht, ashtu siç theksohet në Udhëzuesin e Përgjithshëm për caktimin e Dënimeve, gjyqtarët duhet të marrin në konsideratë së pari konfiskimin e pasurive të fituara në mënyrë të paligjshme dhe/ose dobinë pasurore, dëmshpërblimin, dënimin me burgdhe në fund të caktojnë edhe nivelin e gjobës.

Arsyeja e caktimit të nivelit të dëmit/humbjes është faktor shumë i rëndësishëm për veprat penale të kryera me qëllim të përfitimit, sidomos në ato vepra që kanë të bëjnë me korrupsion, pasi dëmi i një pale mund të nënkuptojë përfitim të palës tjetër në po atë vlerë.

Dispozitat për minimumin dhe maksimumin e gjobave sipas Kodit Penal

Neni 43⁷⁰ të KP në par.1 përcakton kufijtë minimal dhe maksimal të gjobës:

*"Dënimi me gjobë nuk mund të jetë më pak se **njëqind (100) Euro** evropiane. (Në tekstin e mëturjeshëm "EURO"). Dënimi me gjobë nuk mund të tejkalojë **njëzet e pesëmijë (25.000) Euro** ndërsa për veprat penale lidhur me terrorizëm, trafikim me njerëz, krim të organizuar ose veprat penale të kryera me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore nuk mund të tejkalojë **pesëqind mijë (500.000) Euro**."*

Nga dispozita e mësipërme shihet qartë se tek veprat e kryera me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore diskrecioni i gjykatës për shqiptimin e gjobës është shumë i lartë gjë që mund të shpie në laramani të caktimit të gjobave për vepra të ngjajshme. Prandaj, me qëllim të sigurimit të një praktike më të njëtrajtshme, ekziston nevojë për më shumë udhëzime që gjyqtarët të pasqyrojnë parimet themelore të llogaritjes së gjobës duke marrë parasysh rrethanat kryesore të cekura më sipër.

Po i njëjti nen i Kodit penal ka paraparë edhe mundësinë e pagesës së gjobës me këste. Kjo është rregulluar në nenin 43 par.2 i cili parasheh:

"Në aktgjykim caktohet afati i pagesës së dënimit me gjobë. Afati nuk mund të jetë më i shkurtër se pesëmbëdhjetë (15) ditë e as më i gjatë se tre (3) muaj, mirëpo në rrethana të arsyeshme gjykata mund të lejojë që dënimi me gjobë të paguhet me këste për një periudhë që nuk tejkalon dy (2) vjet. Aktgjykimi po ashtu duhet të përcaktojë se kur duhet të paguhet këstet dhe duhet të cek se mundësia e pagesës me këste do të revokohet nëse personi i dënuar nuk e paguan këstin me kohë."

⁷⁰ Ibid.supra note 3.,Neni 43, Dënimi me gjobë.

Shtjellimi i llojeve të gjobave sipas Kodit penal

Kategorizimi i gjobave

Janë një numër mjaft i madh i dispozitave të Kodit penal të cilat parashohin edhe dënimin me gjobë si një nga sanksionet ndaj kryesve të veprave penale. Dispozita të tilla gjejmë në të gjithë kapitujt e Kodit penal. Duke pasur parasysh laramaninë e dispozitave të Kodit penal që i referohen shqiptimit të dënimit me gjobë si sanksion, është e nevojshme paraprakisht të bëhen dy lloje të ndryshme të kategorizimeve të veprave, në mënyrë që përcaktimi i gjobës të bëhet sa më drejtë.

Përgjithësisht, Kodi penal parasheh dy grupe të veprave penale:

- **Kategoria I. - Veprat penale të kryera me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore;**
- **Kategoria II. - Veprat tjera penale të kryera për qëllime tjera por jo-me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore**

Ndarja e mësipërme është e rëndësishme për faktin se përcakton kriteret për përcaktimin e pikënisjes dhe matjes së gjobës. Kështu, gjersa te kategoria e parë një nga kriteret përcaktuese është vlera e dëmit të shkaktuar apo përfitimit të kryesit dhe lartësia e të hyrave dhe pasurisë së kryesit, tek kategoria e dytë kriteri primar është lartësia e të hyrave dhe pasurisë.

Në secilën nga dy grupet të veprave të mësipërme në Kodin penal i gjejmë dispozitat e përcaktimit të gjobës sipas sistemit “ose” gjobë apo “dhe” gjobë. Për referim më të lehtë edhe këto dy nën-kategori do të klasifikohen si në vijim:

- **Nën-kategoria A.** - Dispozitat që parashohin burgim “ose” gjobë
- **Nën-kategoria B.** - Dispozitat që parashohin burgim “dhe” gjobë

Hapi i parë në llogaritjen e gjobës është përcaktimi i kategorisë dhe nën-kategorisë së veprës penale. Kjo është domethënëse sepse secila nga kategoritë dhe nën-kategoritë e mësipërme të nivelit të veprave penale përmban pikënisje të ndryshme. Kjo sepse derisa në nën kategorinë A ('ose gjobë') gjoba shërben si zëvendësim i dënimit me burg dhe jo dënim i përbashkët me burgim dhe gjobë, në nënkategorinë B ('dhe gjobë') gjoba lëshohet së bashku me dënimin me burgim dhe si e tillë është automatikisht, sipas kuptimit të ligjit, dënim më i rëndë.

Duke dashur të sqarojmë edhe më tutje mënyrën si ligjvënësi ka përcaktuar dispozitat e dënimit me gjobë, më poshtë do të sqarojmë disa dallime që vërejmë në Kodin penal lidhur me definimin e këtyre gjobave si tek dispozitat “ose” gjobë, ashtu edhe tek dispozitat “dhe” gjobë, pikërisht për shkak të laramanisë që hasim në këto dispozita.

Dispozitat me burgim “ose”gjobë

Kjo kategori e gjobës shqiptohet për vepra penale që bartin dënim me burgim më të ulët të cilin gjykata mund ta zëvendësojë me gjobë. Për të gjitha veprat penale në të cilat është paraparë mundësia e dënimit me burg “ose” me gjobë, dënimi maksimal i paraparë është 8 vite burgimi cili mund të zëvendësohet me dënim me gjobë. Për shkak se shqiptohet si dënim individual, niveli më i lartë i gjobës duhet të ketë efektin e preventivës individuale për të demotivuar kryesin nga kryerja e veprave të tilla.

Shumica e dispozitave të cilat parashohin mundësinë e caktimit të dënimit me burgim ose gjobë parashohin vetëm mundësinë e gjobës pa paraparë ndonjë maksimum apo minimum specifik të dënimit me gjobë. Në përgjithësi, në këto raste përcaktimi nëse gjykata duhet të caktojë dënimin me burg ose gjobën duhet të bëhet duke u bazuar në nivelin e dëmit, fajësinë dhe ndikimin që dënimi do të ketë jo vetëm në preventivën individuale dhe/ose të përgjithshme, por edhe përgjithësisht ndikimi që do të ketë në besimin e publikut në gjyqësor. Kjo nënkupton se për të gjitha këto raste vlejné rregullat e maksimumit të përgjithshëm të caktimit të gjobës sipas Kodit penal.

Përfundimisht nga sa u tha më sipër, nga të gjitha dispozitat e Kodit të cilat parashohin dënim me burgim “ose” me gjobë është vetëm njëra nga to e cila parasheh dënim me gjobë fikse. Bëhet fjalë për nenin 140 paragrafi 1, (Kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare) i cili parasheh që kryesi, për këtë veprë dënohet **me dyqind e pesëdhjetë (250) Euro gjobë** ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj.

Një tjetër dispozitë e Kodit për dallim nga dispozitat tjera parasheh minimumin dhe maksimumin e dënimit me gjobë. Bëhet fjalë për nenin 404 paragrafi 4 (Pjesëmarrja në turmë që kryen veprë penale dhe huliganizmi), i cili parasheh se për huliganizëm me pasoja të vogla kryesi dënohet me dënim **me gjobë prej dyqind (200) deri dhjetë mijë (10.000) Euro**.

Për fund, në tabelën e mëposhtme janë pasqyruar të gjitha ato dispozita të Kodit penal të cilat parashohin maksimumin e dënimit me gjobë i cili mund të shqiptohet në vend të dënimit me burgim.

Neni	Titulli i nenit	Lartësia maksimale e gjobës	Dënimi me burgim
140 p.2	Kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijëskufitare	250€	Deri 6 muaj
366 p.1	Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve	7.500€	Deri 5 vite
368 p.1	Lejet, pëlqimet dhe licencat e rreme të armëve dhe dhënia e informatave të rreme	5.000€	Deri 3 vite
368 p.2	Lejet, pëlqimet dhe licencat e rreme të armëve dhe	5.000€	Deri 3 vite

	dhënia e informatave të rreme		
368 p.3	Lejet, pëlqimet dhe licencat e rreme të armëve dhe dhënia e informatave të rreme	2.500€	Deri 3 muaj
385.p.2	Deklaratat e rreme të dëshmitarëve bashkëpunues	500€	Deri 3 muaj

Tabela 1.

Dispozitat me burgim "dhe" gjobë

Kodi penal dhe ligjet e tjera që përmbajnë dispozita penale lejojnë dënim të kombinuar me burg dhe gjobë. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për veprat penale kur kryesi ka përfituar financiarisht. Kombinimi i këtyre dënimeve me gjasë është i përshtatshëm në veçanti kur dënimi me burg është i shkurtër dhe/ose kur kryerësi i veprës penale qartazi ka ose do t'i ketë, mjetet për ta paguar.⁷¹

Tek dispozitat burgim "dhe" me gjobë, kemi disa lloje të gjobave të përcaktuara.

1. Dispozita të cilat parashohin shumë fikse të gjobës dhe atë në nenet si në vijim:

- **Neni 274** - Konvertimi apo transferimi i pasurisë që rrjedh nga veprat penale nga ky kapitull (Veprat penale të narkotikëve), ku në paragrafin 1 të këtij neni parashihet që kryesi përveq dënimit me burgim deri në 10 vite do të dënohet edhe **me gjobë në vlerë tre herë më të lartë se vlera e pronës së transferuar apo konvertuar**. Nëse i referohemi edhe Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, do të gjemë të njëjtën mënyrë të kalkulimit të gjobës në nenin 56 ku thuhet se *"Kushdo që, duke e ditur ose ka arsye për të ditur se pasuria e caktuar buron nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal, pasuri kjo e cila në të vërtetë fitohet me veprë penale, apo kushdo që duke besuar se pasuria e caktuar fitohet nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal bazuar në përfaqësimet e bëra si pjesë e një hetimi zbulues të zhvilluar në pajtim me Kapitullin IX të Kodit të procedurës penale të Kosovës, zhvillon veprimet e mëposhtme, kryen veprë penale të dënueshme me burgosje deri në dhjetë (10) vjet dhe me gjobë deri në tri (3) herë më të madhe në vlerë të pasurisë e cila është subjekt i veprës penale,..."*⁷²
- **Neni 295** – Keqpërdorimi i pozitës së monopolit (Kapitulli i veprave penale kundër ekonomisë), ku në paragrafin 2 të këtij neni parashihet që kryesi përveq dënimit me burgim prej 1-5 vite do të dënohet edhe me **gjobë, vlera e së cilës është e barabartë me 25% të vlerës së mallrave të shitur nga organizata e tij e biznesit** e cila ka qenë subjekti marrëveshjes së përbashkët.

⁷¹ Këshilli për Caktimin e Dënimeve në Mbretërinë e Bashkuar, Caktimi i gjobave me dënim me burg,

⁷² Ligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, L.Nr.05/L-096, Neni 56 Vepra penale e pastrimit të parave, par.1, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, 14.06.2016.

- **Neni 312** - Shmangia nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore ose tarifave akcizoreku në paragrafin 5 të këtij neni parashihet që nëse shuma e akcizës kalon shumë prej njëzet e pesë mijë (25.000) euro, kryesi përveq dënimit me burgim deri në 5 vite do të dënohet edhe me **me gjobë në lartësi deri në pesë herë të shumës së akcizës të paevidentuar apo të pa-papaguar**. Është për tu theksuar se përderisa paragrafet 1-4 të këtij neni poashtu kanë të paraparë dënimin me gjobë dhe dënimin me burgim duke bërë dallimin sipas vlerës së dëmit të shkaktuar, këto paragrafe nuk japin udhëzim preciz për definim të gjobës sikurse paragrafi 5 i këtij neni.

Ajo që mbetet për tu theksuar për tre dispozitat e mësipërme është fakti se që të tre dispozitat lartësinë e gjobës e lidhin me lartësinë e dëmit të shkaktuar.

2. Dispozitat ku parashihet gjoba maksimale. Tabela e mëposhtme pasqyron këto dispozita dhe lartësinë e maksimumit të paraparë:

Neni	Titulli i nenit	Lartësia maksimale e gjobës	Dënimi me burgim
164 p.2	Kontrabandimi me migrantë	Deri në 500.000€	Deri 5 vite
164 p.5	Kontrabandimi me migrantë	Deri në 500.000€	7-20 vite
164 p.10.4	Kontrabandimi me migrantë	Deri në 500.000€	/
165 p.3	Trafikimi me njerëz	Deri në 500.000€	7-20 vite
277 p.1	Pjesmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar	Deri në 250.000€	7 vite
277 p.2	Pjesmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar	Deri në 500.000€	10 vite
277 p.3	Pjesmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar	Deri në 500.000€	10 vite deri përjetshëm
364 p.1	Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse	Deri në 7.500€	1-8 vite
367 p.2	Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm	Deri në 10.000€	1-10 vite
387	Frikësimi gjatë procedurës penale	Deri në 125.000€	2-20 vite

Tabela 2

Përcaktimi i pikënisjes për llogaritjen e gjobës për secilën kategori

Të gjitha dispozitat e Kodit penal të cilat nuk janë përmendur në dy nën-kategoritë e mësipërme (“dhe” “ose” gjobë), janë ato dispozita të cilat vetëm përcaktojnë mundësinë e dënimit me gjobë si dënim kumulativ me dënimin me burgim apo si zëvendësim i dënimit me burgim, por të njëjtat nuk parashohin një minimum apo maksimum të gjobës. Në të gjitha këto raste vlejné dispozitat e përgjithshme për minimumin dhe maksimumin e gjobës. Për të bërë më të qartë kriteret për përcaktimin e pikënisjes secila nga kategoritë dhe nënkategoritë do të sqarohen veq e veq më poshtë në mënyrë tabelare dhe narrative. **Për të qartësuar, pikënisja shërben vetëm si orientim për gjykatën se si do duhej të matej lartësia e gjobës duke pasur parasysh faktorët që ndikojné në matjen e gjobës sipas parimeve të nenit 69 par.5 të Kodit penal dhe asesi të përcaktojë në mënyrë precize lartësinë e gjobës.** Kjo për faktin se gjykata ka diskrecion të caktojë lartësinë e gjobës mvarësisht nga rrethanat relevante lehtësuese apo rënduese të aplikueshme në një rast konkret dhe duke pasur parasysh dispozitat e përgjithshme të Kodit mbi minimumin dhe maksimumin e dënimit me gjobë.

Për të lehtësuar kalkulimin e gjobës sipas parimeve të dhëna në këtë Udhëzues, të cilat janë të barazuara në dispozitat e Kodit dhe standardet ndërkombëtare, për gjyqtarët do vëhet në dispozicion një kalkulator në të cilën gjyqtarët do të kenë nevojë të fusin vetëm disa nga të dhënat e kërkuara dhe më pas sistemi jep llogaritjen përfundimtare të pikënisjes apo pikës startuese.

Veprat penale të kryera me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore

Tek kjo kategori e veprave siq edhe u theksua më lartë llogaritja e pikënisjes bëhet në bazë të vlerës së dëmit/përfitimit (si faktorë në përcaktimit të peshës së veprës penale) dhe të gjendjes financiare të kryesit. Që të kemi të qartë, duke qenë se dënimi me burgim apo gjoba nuk janë të vetmet masa të mundshme të parapara me ligj, Gjykata duhet pasur parasysh se qëllimi i gjobës nuk është që përmes saj të kthehet dëmi i shkaktuar apo përfitimi i kryesit. Një gjë e tillë arrihet përmes **dëmshtëpërblimit, respektivisht konfiskimit të dobisë pasurore të përfituar me veprë penale të cilat kanë gjithnjë prioritet ndaj shqiptimit të gjobave.**

Në vijim është dhënë një shembull se si përcaktohet pikënisja për veprat sipas kësaj kategorie dhe dallimi që bëhet në kalkulim për secilën nën-kategori dhe atë në përqindjen (%) e kalkuluar. Për ta bërë më të qartë për të dyja nën-kategoritë kemi marrë për bazë vlerën e njëjtë të dëmit/përfitimit, lartësinë e njëjtë të dënimit, të hyrave dhe pasurisë së kryesit:

KALKULIMI I GJOBËS TE VEPRAT E KRYERA ME QËLLIM TË PËRFITIMITTË DOBISË PASURORE							
KATEGORIA I.A. Gjobë “ose” burgim (dënimet deri në 8 vite)							
a. Burgimi shprehur në muaj	b. Burgimi konvertuar në ditë	c. Nën-totali (2€/ Ditë)	d. Vlera e dëmit/përfitimit	e. 30% e vlerës së dëmit	f. Të hyrat mujore	g. Përqindja e të hyrave x kohëzgjatja e burgimit	h. Pikënisja preliminare
6	180	360.00 €	5,000.00€	1,500.00€	170.00 €	306.00 €	2,166.00€
					1,020.00€		
				i. Vlera e pasurisë tjetër të kryesit	j. Totali i borxheve dhe obligimeve per kete periudhe	k. Kalkulimi përfundimtar i pikënisjes	
				10,000.00€	5,000.00 €		3,666.00€
				1,500.00€	5,000.00€		

Tabela Nr.3

KALKULIMI I GJOBËS TE VEPRAT E KRYERA ME QËLLIM TË PËRFITIMITTË DOBISË PASURORE							
KATEGORIA I.B. Gjobë “dhe” burgim (dënimet deri në burgim të përjetshëm)							
a. Burgimi shprehur në muaj	b. Burgimi konvertuar në ditë	c. Nën-totali (2€/ Ditë)	d. Vlera e dëmit/përfitimit	e. 30% e vlerës së dëmit	f. Të hyrat mujore	g. Përqindja e të hyrave x kohëzgjatja e burgimit	h. Pikënisja preliminare
6	180	360.00 €	5,000.00€	1,500.00€	170.00 €	306.00 €	1,083.00€
					1,020.00€		
Vëmendje: Në rast të dënimit me kusht vlen kalkulimi sipas Kategorisë I.A				Vlera e pasurisë tjetër të kryesit	Totali i borxheve dhe obligimeve	Kalkulimi përfundimtar i pikënisjes	
				10,000.00€	5,000.00 €		2,583.00€
				1,500.00€	5,000.00€		

Tabela nr.4

Në vijim do të sqarojmë përmbajtjen nga tabela 3 dhe 4 dhe se si bëhet përlogaritja e pikënisjes. Fillimisht duhet sqaruar se në Kategorinë I.A kryesi i shmanget dënimet me burg për këtë edhe përlogaritja ndryshon nga llogaritja në Kategorinë I.B ku sipas Kodit kryesi dënohet me burg dhe me gjobë. Tutje sqarohet secili nga elementet që merret për bazë në secilin kalkulim. Tabelat e dhëna nuk nënkuptojnë se gjyqtari do të plotësojë të gjitha këto fusha, por

është dhënë vetëm me qëllimin për të sqaruar se si vie deri te kalkulimi i gjobës, ndërkaq vetëm fushat e hijëzuara me të kaltër janë fushat që do plotësohet nga ana e gjyqtarit:

- a. Burgimi i shprehur në muaj.-** Kjo fushë specifikon lartësinë e dënimit të shprehur në muaj të cilin gjyqtari do të duhej fillimisht të përcaktojë në mënyrë që tek në fund të caktohet pesha e veprës dhe gjobën relevante. Kjo për faktin se brenda të njëjtës dispozitë dallimi mes minimumit dhe maksimumit të dënimit të paraparë është shpesh shumë i madh, andaj edhe gjykata duhet të vendos cili do të ishte dënimi meritor nëse i njëjti do ishte i shprehur në dënim me burg. Kjo fushë duhet plotësuar nga gjyqtari. Në rastin konkret në këto tabela është paraqitur dënimi me burgim prej 6 muajsh. Duhet pasur parasysh se burgimi i shprehur në muaj merret domosdoshmërisht si kriter bazë për caktimin e gjobës për faktin se bashkë me dënimin e shkaktuar paraqesin elementet bazë për caktimin e shkallës dhe peshës së veprës penale.
- b. Burgimi konvertuar në ditë.-** Kjo fushë vetëm paraqet dënimin e caktuar nga gjyqtari në fushën (a.) duke e konvertuar automatikisht në ditë për të mundësuar që në fushën (c.) të reflektohet kalkulimi i vlerës së gjobës për ditë.
- c. Nën-totali.-** Kjo fushë paraqet vlerën ditore të gjobës e cila barazohet me 2€ për ditë e përcaktuar vetëm për qëllim të llogaritjes së pikënisjes e jo të gjobës finale. Duhet pasur parasysh siq edhe është pasqyruar në tabelat e këtij udhëzuesi, se burgimi dhe të hyrat e marra si shembull në këtë udhëzues janë në vlerat minimale. Nëse në një rast konkret kemi të bëjmë me të hyra 10fish më të larta mujore, dëm material dhjetëfish më të lartë apo edhe pasuri 10 fish më të lartë të kryesit, atëherë pikënisja finale do të ishte shumë më e lartë. Për këtë, në kalkulim të gjobës duhet të kemi parasysh edhe kufijtë maksimal të gjobës të paraparë me Kod, andaj edhe nuk është e mundur që vlera ditore e gjobës të jetë më e lartë se kaq, sidomos duke pasur parasysh shkallën e lartë të papunësisë dhe gjendjen e vështirë ekonomike që mbizotëron në Kosovë.
- d. Vlera e dëmit/përfitimit.-** Vlera e dëmit tek veprat të cilat kryhen me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore është një rrethanë shumë e rëndësishme e cila është edhe tregues i peshës së veprës penale. Këtë rëndësi e vërejmë edhe në faktin se vet Kodi penal i ndan veprat sipas lartësisë së dëmit të shkaktuar. Fusha (d.) është një fushë të cilën duhet ta plotësojë gjyqtari dhe nuk është e thënë që vlera e dëmit të jetë saktësisht e precizuar. Nëse gjyqtari nuk ka të dhënat e sakta mbi lartësinë e dëmit, atëherë mund të vendoset një shifër e përafërt sipas përkufizimit të dëmit në Kodin e Procedurës Penale, i cili thotë se "*Gjykata mund të urdhërojë pagesën e dëmit bazuar në një vlerësim të arsyeshëm të vlerës monetare të dëmit të drejtpërdrejtë ose të shkaktuar në mënyrë të tërthortë si pasojë e veprës penale.*"⁷³ Kjo bëhet për faktin se në rastin konkret për qëllim të përcaktimit të gjobës nuk po flasim për dëmshpërblim por vetëm për caktimin e lartësisë së dëmit. Në tabelat e dhëna si vlerë e dëmit është marrë si shembull lartësia prej 5,000€. Pavarësisht se në cilën kategori bie vepra penale, niveli i dëmit dhe/ose përfitimit material është shumë i rëndësishëm. Do të marrim shembullin e nenit 415 (Keqpërdorimi dhe mashtrimi në prokurim publik) par.3: "Nëse kryerësit e veprave penale nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, përfitojnë ose shkaktojnë dëme të

⁷³ Ibid.supra note.1, Neni 19 Përkufizimet, par.1.14 (Dëmi).

konsiderueshme pasurore, në vlerat mbi pesëmijë euro (5.000) ...". Kur e analizoni fjalën "të konsiderueshme" në frymën e nenit 113, par.2 të Kodit, ky dëm mbulon gamën mes 5.000 -15.000Euro. Sidoqoftë, nëse për të njëjtën vepër dëmi është më i lartë se 15.000 ose 50.000Euro, atëherë pikënisja për atë vepër penale do të jetë natyrisht shumë më e lartë, që korrespondon me nivelin e dëmit.

- e. **Përqindja e vlerës së dëmit.**- Në kalkulimin e lartësisë së dëmit është marrë 30% i totalit të vlerës së dëmit apo përfitimit. Përqindja është kufizuar duke pasur parasysh se sa i përket vlerës 100% të dëmit, kryesi do të bëj dëmshpërblimin i cili gjithmonë në raport me gjobën duhet të ketë prioritet në ekzekutim.
- f. **Të hyrat e kryesit.**- Kjo fushë paraqet një nga obligimet e gjykatës që rrjedhin nga Neni 69 par.5 ku ligjvënësi ka kërkuar që të hyrat e kryesit janë një nga kriteret në vlerësimin e lartësisë së gjobës. Në këtë fushë, nga gjyqtari kërkohet të futen të hyrat mujore të kryesit, nga pagat apo burimet tjera. Në fushën e pasqyruar në të katër tabelat si shumë është marrë një pagë minimale prej 170€. Pra sa më të larta të jenë të hyrat aq më e lartë do të jetë edhe gjoba.
- g. **Përqindja e të hyrave të kryesit.**- Natyrisht me rastin e caktimit të gjobës duke u bazuar edhe në të hyrat mujore të kryesit duhet pasur parasysh se kryesi ka obligime shpesh në mbajtjen e anëtarëve të familjes apo obligime tjera, pra për të mos rrezikuar pjesën e domosdoshme. Andaj edhe si pikënisje për qëllime të llogaritjes është marrë 30% i të hyrave (njëlloj sikurse te vlera e dëmit) dhe kjo lartësi shumëzohet për kohëzgjatjen e dënimit të paraparë në fushën (a.). Një sistem i tillë i llogaritjes së të hyrave është i aplikueshëm edhe në sistemin britanik të caktimit të dëmit ku si pikë e parë caktohet lartësia e të hyrave të kryesit. Megjithatë duke pasur parasysh se sipas Kodit penal një kryes mund të dënohet me burgim më pak se 1 vit, apo edhe mund të mos ketë punësim të qëndrueshëm, nuk është parë si e arsyeshme që vlera e gjobës të caktohet në raport me pagën vjetore.
- h. **Pikënisja preliminare.**- Kjo fushë jep gjobën preliminare me ç' rast merr për bazë fushat (c.), (e.) dhe (g.). Duhet pasur parasysh se duke qenë se në dënimet e parapara me burg "dhe" gjobë kryesi shkon në vuajtje të dënimit dhe obligohet të paguajë edhe gjobë, tek kjo kategori (Kategoria I.B.) totali i pikënisjes në fushën (h.) zvogëlohet me 50% gjë që nuk ndodh tek Kategoria I.A pasi kryesi nuk shkon në vuajtje të burgimit. **Është shumë e rëndësishme të theksohet se në rast se kryesi dënohet me dënim me kusht, nuk vlen zbritja prej 50% dhe në këtë rast kalkulimi bëhet automatikisht sipas Kategorisë I.A.**
- i. **Vlera e pasurisë tjetër të kryesit.**- Plotësimi i kësaj fushe së bashku me fushën (f.) është mjaft i rëndësishëm nëse me të vërtetë dëshirohet të arrihet qëllimi punitiv i gjobës si dënim për kryesin. Arsyeja pse edhe gjendja e përgjithshme financiare përfshihet në kalkulim është sepse ka kryes të cilët realisht dhe ligjërisht mund të realizojnë të hyra të ulëta në krahasim me gjendjen e tyre të përgjithshme financiare. Andaj nëse do bazoheshim vetëm në të hyrat mujore të kryesit për një kryes që qëndron shumë mirë materialisht, realisht nuk do arrinim efektin punitiv të gjobës pasi i njëjti me lehtësi do ta paguante gjobën. Kjo llogaritje siq u përmend edhe më sipër për të dhënat e futura në fushën (j.) janë plotësisht në pajtim me dispozitën e nenit 69 par.5 të Kodit penal e cila thekson se " *Me rastin e caktimit të dënimit me gjobë, gjykata merr parasysh edhe*

gjendjen pasurore të kryesit dhe posaçërisht merr parasysh shumën e të ardhurave personale, të ardhurat e tjera, pasurinë dhe detyrimet e tij. Gjykata nuk cakton gjobë në lartësinë që është mbi mundësitë e kryesit.”⁷⁴ Edhe për këtë shumë nuk kërkohet vlera precize e pasurisë së kryesit.

- j. Totali i borxheve dhe obligimeve të kryesit.-** Shënimi i borxheve edhe obligimeve të kryesit është shumë me rëndësi edhe nëse nuk dihet saktë vlera e tyre, duke pasur parasysh se me gjithnjë me rastin e caktimit të gjobës duhet pasur parasysh se edhe kryesi dhe anëtarët e familjes që i njëjti psh mund të mbajë të kenë mjete të mjaftueshme edhe pas pagesës së gjobës.
- k. Kalkulimi përfundimtar i pikënisjes së gjobës.-** Kalkulimi përfundimtar i gjobës paraqet edhe aktin final të përcaktimit të pikënisjes apo pikës startuese për matjen e gjobës. Kjo përfshin edhe 30% e vlerës së pasurisë së kryesit duke i hequr obligimet/borxhet e tij.

Nga tabela dhe përshkrimi i mësipërm kuptohet se për marrjen e vendimit mbi gjobën adekuate për kryesin, gjykata ka nevojë të ketë në dispozicion të dhëna financiare për kryesin. Siq edhe u tha më sipër të dhënat **duhen siguruar gjatë procedurës penale në veqanti me angazhimin e prokurorisë drejtpërdrejtë ose përmes institucioneve relevante në pajtim me legjislacionin në fuqi. Mbrojtja nga ana tjetër ka mundësi të kundërshtojë të dhënat e siguruar nga prokuroria duke prezantuar të dhënat nga mbrojtja.**

Të dhënat financiare paraqiten të domosdoshme për proces sidomos në rastet kur kemi të bëjmë me hetimin e veprave të kryera me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore pasi që këto të dhëna janë relevante potencialisht për konfiskim të pasurisë.

Veprat penale të kryera jo me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore

Siq edhe është përmendur më sipër gjoha si dënim nuk është paraparë vetëm në veprat penale të cilat janë kryer me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore por edhe në shumicën e veprave tjera të parapara me Kod penal. Tek kjo kategori e veprave kriteri primar për caktimin e lartësisë së gjobës është lartësia e të hyrave dhe pasuria e kryesit, duke qenë se veprat e tilla nuk kryhen me qëllim të përfitimit pasuror. Natyrisht edhe tek këto vepra vlen rregulli i përgjithshëm që dëmshpërbliimi ka prioritet ndaj caktimit të gjobës. Edhe tek këto vepra gjejmë dispozitat të cilat parashohin dy nënkategoritë e dënimeve burgim **“dhe”** gjobë dhe burgim **“ose”** gjobë.

Më poshtë do të pasqyrojmë në formë tabelare se si duket llogaritja e gjobës tek kjo kategori e veprave

⁷⁴ Ibid.supra note 3.

KALKULIMI I GJOBËS TE VEPRAT JO-ME QËLLIM TË PËRFITIMIT TË DOBISË PASURORE					
KATEGORIA II.A. Gjobë “ose” burgim (deri në 8 vite burgim)					
Burgimi shpreur në muaj	Burgimi konvertar në ditë	Nën-totali (2€/Ditë)	Të hyrat mujore	Përqindja e të hyrave x Kohëzgjatja e burgimit	Pikënisja preliminare
6	180	360.00 €	170.00 €	306.00 €	666.00€
				1,020.00 €	
			Vlera e pasurisë tjetër të kryesit	Totali i borxheve dhe obligimeve	Kalkulimi përfundimtar i pikënisjes
			10,000.00€	5,000.00 €	2,166.00€
			1,500.00€	5,000.00€	

Tabela 5.

KALKULIMI I GJOBËS TE VEPRAT JO-ME QËLLIM TË PËRFITIMIT TË DOBISË PASURORE					
KATEGORIA II.B. Gjobë “dhe” burgim (deri në burgim te perjetshem)					
Burgimi shpreur në muaj	Burgimi konvertar në ditë	Nën-totali(2 €/Ditë)	Të hyrat mujore	Përqindja e të hyrave x kohëzgjatja e burgimit	Pikënisja preliminare
6	180	360.00 €	170.00 €	306.00 €	333.00€
				1,020.00 €	
			Vlera e pasurisë tjetër të kryesit	Totali i borxheve dhe obligimeve	Kalkulimi përfundimtar i pikënisjes
			10,000.00€	5,000.00 €	1,833.00€
			1,500.00€	5,000.00€	

Vëmendje: Në rast të dënimit me kusht vlen kalkulimi sipas Kategorisë II.A

Tabela 6.

Pra si mund të shihet nga tabelat 5 dhe 6 përgjithësisht tek llogaritja e gjobës për kategorinë II (A dhe B.) bëhet në të njëjtin sistem sikurse tek kategoria I. (A dhe B). Dallimi mes dy llojeve të veprave qëndron vetëm në sa vijon:

- a. **Mospërfshirje të vlerës së dëmit në llogaritje të gjobës.**- Duke qenë se te veprat të cilat nuk janë kryer me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore nuk flitet si rregull për dëm apo përfitim financiar pasi veprat e tilla kryesisht kryhen për motive tjera të ndryshme, andaj është e arsyeshme që tek këto vepra në kalkulim të gjobës të mos jetë e përfshirë edhe vlera e ndonjë dëmi. Gjithcka që është me rëndësi në këto lloje të veprave është që **shkalla e dëmit të shkaktuar viktimit të kalkulohet për qëllime të dëmshpërblimit por jo për qëllime të caktimit të gjobës.**

Rrethanat që ndikojnë në lartësinë e gjobës

Në kapitujt e mësipërm u elaborua ndarja e kategorive të gjobave dhe si mund të bëhet kalkulimi i pikës startuese apo pikënisjes. Duhet pasur parasysh se pika startuese nuk nënkupton automatikisht edhe gjobën përfundimtare. Gjykata ka diskrecion që në bazë të rrethanave rrethanave relevante lehtësuese apo rënduese për rastin konkret, të ngris apo ul gjobën. Të njëjtat rrethana lehtësuese dhe rënduese të parapara me nenin 69 të Kodit penal janë të aplikueshme edhe për dënimin me gjobë. Qëllimi i zbrërthimit të mëposhtëm të rrethanave nuk është të përsëris as zëvendësojë sqarimin e dhënë me Udhëzuesin për politikën ndëshkimore të vitit 2018, por më shumë për të treguar se sa të njëjtat mund të jenë apo jo të aplikueshme edhe në matjen e gjobës. Kjo është në linjë edhe me parimet e përcaktuara në Ligjin për përgjegjësinë e personave juridik për vepra penale i cili parasheh rrethanat e rëndësishme për matjen e dënimit me gjobë për persona juridik.⁷⁵

Më poshtë do japim disa sygjerime dhe referenca lidhur me mënyrën se si rrethanat e ndryshme mund të ndikojnë në lartësinë e gjobës, gjithnjë duke pasur parasysh që rrethanat të cilat kanë ndikuar në caktimin e pikënisjes të mos rinumërohen edhe për ashpërsim apo zbutje.

Rrethanat që mund të merren parasysh për ashpërsim

Përgjithësisht nëse i referohemi rrethanave të parapara me Kod penal mund të konstatojmë se me përjashtim të rasteve të recidivizmit dhe kur vepra është kryer si pjesë e veprimtarisë së grupit të organizuar kriminal pothuajse të gjitha rrethanat tjera meritojnë përqindje të njëjtë në ashpërsim të dënimit. Natyrisht përjashtim mund të bëjnë disa nga veprat më specifike për të cilat ka rrethana shumë më specifike që mund të bëjnë që dënimi me gjobë të jetë më i lartë. Mund të aplikohen rrethana tjera rënduese dhe gjykata mund t'u jap përqindje të caktuar për ashpërsim në varësi të peshës së saj për veprën e caktuar penale. Llogaritja e rrethanave rënduese bëhet duke ia shtuar % përkatëse të kësaj rrethane pikës startuese të llogaritit paraprakisht me sistemin e kalkulimit të paraqitur më lartë.

⁷⁵ Ligji nr.04/L-030 për përgjegjësinë e personave juridik për vepra penale, neni 10, Matja e dënimit me gjobë, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, 14.09.2011

Është shumë me rëndësi të potencohet se për dallim prej pikënisjes e cila në masë të madhe bazohet në gjendjen pasurore të kryesit, prezenca e rrethanave të mëposhtme nuk ndihmon vetëm në caktim të lartësisë së gjobës. Këto rrethana edhe më shumë do të duheshin ti ndihmonin gjyqtarit të merr vendimin nëse vepra e kryer nga kryesi përkatës për shkak të peshës së veprës dhe dëmit të shkaktuar (qoftë financiar apo material e psikologjik) a meriton konvertim të një dënimi në vetëm një dënim me gjobë, e rrjedhimisht edhe pa pasoja juridike për kryesin, apo vepra është e asaj natyre dhe peshe që nuk arsyeton shqiptimin e dënimit me gjobë si sanksion i vetëm.

Në vijim është paraqitur lista e rrethanave të parapara me Kod⁷⁶ duke i kombinuar ato rrethana aty ku të njëjtat janë pak a shumë të ngjajshme me njëra tjetrën në mënyrë që këto rrethana të mos dyfishohen në numërim:

- a. **Shkalla e lartë të pjesëmarrjes së personit të dënuar në veprën penale (p.2.1) dhe Shkalla e lartë e dashjes nga ana e personit të dënuar (p.2.2).**- Këto dy rrethana janë shumë me rëndësi në përcaktimin e dënimit të kryesit për shkak se në këtë formë arrihet edhe shkallëzimi i përgjegjësisë penale siq kërkohet me dispozitat e Kodit penal. Një shkallëzim i tillë nuk do duhej të vlejë vetëm për organizimin kriminal por edhe për të gjitha veprat penale të kryera në bashkë-kryerje (neni 31) dhe tek marrëveshja për kryerje të veprës penale (neni 35) duke bërë dallimin mvarësisht nga shkalla e përgjegjësisë penale të secilit person individualisht- sa më e lartë përgjegjësia penale aq më e lartë edhe gjoba, gjithnjë duke pasur parasysh edhe gjendjen financiare të kryesit.
- b. **Prezenca e dhunës ose kanosjes me dhunë në kryerjen e veprës penale (p.2.3), Vepra penale e kryer në mënyrë posaçërisht mizore (p.2.4), Nëse vepra penale përfshin disa viktima (p.2.5), Nëse viktima e veprës penale ka qenë posaçërisht e pambrojtur apo e ndjeshme (p.2.6), Moshë e viktimës, nëse është i ri apo i moshuar (p.2.7), Dëshmi të shkeljes së besimit nga ana e personit të dënuar (p.2.10) dhe nëse vepra penale kryhet brenda marrëdhënies familjare (p.2.14).**- Siq shihet të gjitha rrethanat që i referohen viktimës janë grupuar qëllimshëm në një grup. Kjo nuk është bërë për të ulur rëndësinë e kësaj rrethane. Në fakt është e kundërta, këto janë rrethanat që sidomos për disa nga veprat që lidhen me integritetin trupor e seksual të viktimës janë më të rëndësishmet në përcaktimin e peshës së veprës penale dhe përgjegjësisë së kryesit. Megjithatë, konsiderojmë se në raport sidomos me këto rrethana, ajo që është më e rëndësishme është përcaktimi i dëmshpërblimit të viktimës dhe konfiskimi i pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme nga të cilat mjete do kompensohej viktima sesa caktimi i gjobës.
- c. **Çfarëdo keqpërdorimi të pushtetit ose pozitës zyrtare nga personi i dënuar në kryerjen e veprës penale (p.2.9)** – Kjo rrethanë thuhet në të gjitha rastet do jetë element i veprës penale dhe duke qenë si e tillë dhe nuk është se do të hynte aq në përdorim si rrethanë rënduese tek matja e gjobës. Megjithatë, kur flitet për këtë rrethanë, njëjtë sikurse edhe tek pika a. duhet pasur parasysh se gjykata duhet të bëjë dallimin mes një zyrtari

⁷⁶ Ibid. Supra note 3., Neni 70, Rregullat e përgjithshme për zbutjen ose ashpërsimin e dënimit, par.2.

që gjendet në një pozitë të lartë zyrtare ndaj dikujt në një pozitëshumë më të ulët dhe me shumë më pak kompetenca.

- d. **Nëse vepra penale është akt i urrejtjes (p.2.12)** përveç nëse përbën element të veprës penale është element i rëndësishëm i motivit për kryerje të veprës dhe me këtë edhe paraqet indikator të shkallës së përgjegjësisë së personit dhe peshën e veprës penale. Duke qenë se e njëjta nuk është e llogaritur me rastin e caktimit të pikënisjes, do mund të merrej parasysh edhe në lartësinë e gjobës por nuk ka një përcaktim më të saktë se sa do të ndikonte kjo rrethanë në ashpërsim të gjobës.
- e. **Nëse vepra penale është kryer si pjesë e veprimtarisë së grupit të organizuar kriminal (p.2.11).**- kjo rrethanë zakonisht paraqitet si element i veprës penale andaj edhe rrallëherë do të ketë raste kur përdoret në ashpërsim të dënimit. Gjoha e paraparë sipas nenit 277 të Kodit penal përmban maksimumin prej 250,000.00€ dhe 500,000.00€. Duke qenë se pikënisja e dhënë në formë tabelare nuk ka marr parasysh elementin e organizimit kriminal, gjyqtari me rastin e matjes së dënimit me gjobë duhet të ketë parasysh shumëfishimin e pikënisjes për të qenë në pajtim me minimumin dhe maksimumin e gjobës së paraparë për veprimtari të grupit të organizuar kriminal.
- f. **Ndonjë dënim penal të mëparshëm të personit të dënuar (p.2.13).**- Njëjtë sikurse edhe rrethana që i referohet veprimtarisë së grupit të organizuar kriminal edhe recidivizmi është një nga rrethanat që më së shumti mund të ndikojë në caktimin e njëdëimi më të lartë me gjobë. Kjo rrethanë nuk ndikon vetëm në ashpërsimin e dënimit brenda maksimumit të paraparë me ligj por i referohet edhe ashpërsimit të dënimit përshkak të recidivizmit ku mund të bëhet ashpërsimi i dënimit mbi maksimumin e paraparë me ligj "*Gjykata mund t'i shqiptojë dënim më të rëndë recidivistit duke shtuar jo më shumë se gjysmën e maksimumit të dënimit.*"⁷⁷ Duke qenë se pikënisja e dhënë në formë tabelare nuk merr parasysh elementin e recidivizmit, gjyqtari me rastin e matjes së dënimit me gjobë duhet gjithnjë të ketë parasysh shumëfishimin e pikënisjes për recidivizëm, me ç'rast për ashpërsim mbi maksimumin e dënimit do të zbatoheshin dispozita e mësipërme, ndërkaq për ashpërsim brenda maksimumit, do merreshin parasysh edhe rrethanat tjera relevante në raport me kryesin dhe llojin e veprës.

Rrethanat që mund të merren parasysh për zbutje

Njëjtë sikurse të rrethanat rënduese edhe rrethanat lehtësuese mund të shfrytëzohen për të llogaritur gjobën e cila do të ishte adekuate për kryesin. Më poshtë do japim listën e këtyre rrethanave të parapara me Kodin penal.⁷⁸ Llogaritja e rrethanave të mëposhtme lehtësuese bëhet duke e ulur lartësinë e gjobës mvarësisht se sa ato rrethana aplikohen:

- a. **Aftësia e zvogëluar mendore (p.3.1).**- Kjo është një rrethanë mjaft me rëndësi e cila mund të ketë ndikim shumë të madh mvarësisht edhe nga gjendja materiale e kryesit. Nëse i njëjti nuk ka të hyra dhe pasuri, kjo rrethanë realisht dhe automatikisht mund ta bëjë të pamundur shqiptimin e gjobës për këtë kategori të kryesve.
- b. **Dëshmia për provokim nga ana e viktimës (p.3.2)**- siq edhe është elaboruar në

⁷⁷ Ibid.supra note 3. Neni 75, Ashpërsimi i dënimit për recidivizëm të shumfishtë, par.2.

⁷⁸ Ibid.supra note 13.

Udhëzuesin për politikën ndëshkimore⁷⁹ provokimi mund të paraqes një rrethanë mjaft me rëndësi në disa kategori të veprave penale për të përcaktuar lartësinë e dënimit të kryesit por shumë pak rëndësi do të kishte në caktimin e lartësisë së gjobës për kryesin, përpos në rastet kur dënimi me burg konvertohet në dënim me gjobë (dispozitat burgim “ose” gjobë) me ç’rast fillimisht kjo rrethanë mund të jetë me rëndësi për caktim të dënimit fillimisht me burgim i cili më pas konvertohet në gjobë.

- c. **Rrethanat personale dhe karakteri i personit të dënuar (p.3.3) dhe mosha e personit të dënuar, i ri apo i moshuar (p.3.6).**- Rrethanat nga par.3.3 dhe 3.6 qëllimshëm janë futur në të njëjtën kategori pasi i referohen rrethanave personale të kryesit. Janë një nga rrethanat që më së tepërmi kanë gjetur zbatim në vendimmarrjen e gjykatave dhe shumë shpesh janë mbivlerësuar në krahasim me rrethanat tjera. Ajo që duhet pasur parasysh kur i referohemi rrethanave personale të kryesit e që përgjithësisht citohen si statusi martesor dhe vartësit në familje, tek llogaritja e dënimit me gjobë, nëse i kthehemi tabelave të mësipërme në fakt këto rrethana tashmë janë të përfshira në caktimin e pikënisjes, pasi tek të hyrat dhe pasuria e kryesit, janë marrë vetëm 30% duke hequr obligimet e borxhet e kryesit. Pra llogaritja e këtyre rrethanave prapë në zbutje do të nënkuptonte dyfishim të këtyre rrethanave. Ndërkaq në raport memoshën, kjo prapë do lidhej me mundësinë materiale të kryesit për pagesë.
- d. **Personi i dënuar ka luajtur rol relativisht të vogël në veprën penale (p.3.4) dhe Personi i dënuar nuk ka marrë pjesë si kryes kryesor (p.3.5).**- Edhe këto dy rrethana janë kombinuar së bashku pasi që në fakt janë shumë të ngjajshme. Këto dyja rrethana të marra bashkë mund të luajnë rol mjaft të rëndësishëm në gjobën finale pasi sikurse tek dënimi me burg edhe në rastin e dënimit me gjobë duhet bërë përshkallëzimi i përgjegjësisë kur kemi të bëjmë me bashkëkryerje dhe dënimi individual i secilit kryes nuk duhet të jetë i njëjtë pasi në këtë rast do shkelej një nga parimet bazë të drejtës penale mbi shkallën e përgjegjësisë penale.⁸⁰
- e. **Restituimi apo kompensimi i viktimës (p.3.7).**- Siq edhe është potencuar disa herë në këtë udhëzues, dëmshpërblimi i viktimës apo palës së dëmtuar gjithnjë ka prioritet ndaj caktimit të çfarëdo gjobe për kryesin. Si rrethanë lehtësuese ndërkaq, e njëjta mund të jetë edhe shprehje e shprehjes së keqardhjes (par.3.11) nga ana e kryesit andaj edhe mund të ketë ndikim në uljen e lartësisë së dënimit.
- f. **Bashkëpunimi i përgjithshëm i personit të dënuar me gjykatën (p.3.8) dhe në hetimin ose ndjekjen penale (p.3.9).**- Këto dy rrethana janë kombinuar qëllimshëm pasi që të dyja në fakt mund të jenë indikatorë për të treguar gadishmërinë e kryesit për bashkëpunim dhe lehtësim të kryerjes së procedurave ligjore mvarësisht se në cilin stad ato mund të jenë. Edhe neni 277⁸¹ i Kodit penal tek grupi kriminal i organizuar parasheh se gjykata mund të zbus dënimin anëtarit të grupit kriminal të organizuar i cili raporton rastin dhe jep informata për grupin kriminal. Natyrisht në këto raste do mund të hynin në zbatim edhe ashtu dispozitat e Marrëveshjes për pranimin e fajësisë qoftë në një dënim më të ulët brenda kufijëve të dënimit apo kur ka rrethana posaqërisht lehtësuese edhe në zbutje të dënimit sipas nenit 71⁸² të Kodit penal. Megjithatë, se sa ndikojnë ato në uljen e gjobës në rastin konkret do mvarej nga vlerësimi i gjykatës në rastin konkret.

⁷⁹ Udhëzues për politikën ndëshkimore, miratuar nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, shkurt 2018.

⁸⁰ Ibid. supra note 3.

⁸¹ Ibid. Neni 277, Pjesëmarja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar, par.4.

⁸² Ibid. Neni 71, Zbutja e dënimeve, par.1.3.

- g. **Pranimi i fajit (p.3.10) dhe shfaqja e keqardhjes (p.3.11).** – Që të dyja këto rrethana mund të kenë ndikim në uljen e lartësisë së gjobës por gjithnjë kombinuar mes vete. Është gjykata ajo që vlerëson gjatë vendimmarrjes së saj nëse pranimi i fajit dhe keqardhja e shprehur janë të sinqerta për të vlerësuar gjobën e cila do të kishte efekt punitiv.
- h. **Sjellja e personit të dënuar pas konfliktit (p.3.12).**- Kjo rrethanë lirisht mund të kombinohej me rrethanat nga paragrafet (f.) dhe (g.) dhe të numërohen si një rrethanë nëse kanë të njëjtin synim, apo të llogaritet si rrethanë e veçantë në rastet kur i referohet ndihmës që kryesi për shembull mund ti ofroj viktimës pas kryerjes së veprës penale. Në këtë të fundit kjo rrethanë mund të kishte më shumë ndikim në lartësinë e gjobës e atë veqanërisht kur kemi të bëjmë me veprat penale në të cilat gjoba caktohet si zëvendësim i dënimit me burg.
- i. **Heqja dorë nga veprimtaria terroriste para se të ketë pasoja të rënda dhe ofrimi i informatave autoriteteve (p.3.14).**- Janë vetëm dy dispozita të Kodit penal të cilat në rastet e veprave terrosite shprehimisht parashohin dënimin me gjobë- Neni 131, Lehtësimi dhe financimi në kryerjen e terrorizmit dhe Neni 136, organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist. Që të dyja këto dispozita kanë paraparë maksimumin e dënimit me gjobë i cili arrin shumën prej 500,000.00€. Andaj, nëse gjykata konstaton se rrethanat sipas këtij paragrafi kanë peshë të madhe në matjen e dënimit, të njëjtat mund të ndikojnë shumë në lartësinë e gjobës e cila edhe ashtu si maksimum është shumë e madhe. Duhet pasur parasysh se edhe Ligji për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit⁸³ ka paraparë të njëjtën lartësi maksimale të gjobës për veprën penale të financimit të terrorizmit.

Pamundësia e kryerësit për ta paguar gjobën

Qëllimi i gjobës sikurse edhe i dënimeve tjera të parapara në të drejtën penale është që të arrihet efekti punitiv ndaj të pandehurit. Një gjë e tillë mund të arrihet vetëm nëse dënimi i shqiptuar është proporcional me peshën e veprës penale dhe mundësitë financiare të kryesit për pagesën e gjobës. Caktimi shabllon i gjobave shkon në dëm të efektit punitiv dhe në fakt e rëndon edhe më tepër gjendjen e kryesit dhe pamundëson rehabilitimin e të njëjtit nëse kryesi është i gjendjes së varfër materiale. Kodi penal përcakton se me rastin e caktimit të gjobës “... *Gjykata nuk cakton gjobë në lartësinë që është mbi mundësitë e kryesit.*”

Andaj, gjykata nuk ka nevojë të bëjë përcaktim të nivelit të gjobës sipas tabelës së dhënë për gjetjen e pikënisjes, por thjeshtësisht dispozita në mënyrë imperative kërkon caktim të gjobës, gjykata mund të vendos edhe për shqiptimin e dënimit minimal të paraparë me dispozitat e Kodit penal (sipas nenit 43) në një rast në të cilin të pandehurit i mungon aftësia për të paguar dëmshpërblimin ose gjobën minimale. Kur është lehtësisht e konstatueshme që i pandehuri nuk mund dhe nuk ka gjasë që të jetë në gjendje ta paguajë gjobën, përcaktimi i nivelit të gjobës është i panevojshëm pasi që, nuk do të caktohet asnjë gjobë. Megjithatë, duhet pasur parasysh

⁸³ Ligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, L.Nr.05/L-096, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, 14.06.2016.

se edhe në rastet kur mbrojtjapretendon si më sipër, prokurori dhe gjykata duhet prapëseprapë të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për të vërtetuar pretendimet e tilla e jo ta marrin si të mirëqenë deklarin. Fundja, një informatë e tillë mbi gjendjen financiare të kryesit do të duhej ta kishinorganet e drejtësisë qysh në fillim të procedurës penale dhe atë me qëllimin për të ditur nëse kryesi mund të angazhoj mbrojtës apo nëse një i tillë do ti caktohet sipas detyrës zyrtare.

Konsiderata tjera rreth llogaritjes së gjobës

Llogaritja e gjobës për vepra penale por edhe e % së zbutjes ose ashpërsimit të gjobës bazuar në rrethana lehtësuese dhe rënduese nuk ka nevojë të jetë llogaritje e saktë matematikore. Me rëndësi është që matja e gjobës sikurse edhe ndëshkimi i kryesve përgjithësisht të kuptohet si proces i cili ven në veprim të gjitha dispozitat relevante të Kodit penal e jo vetëm me një konsideratë të vetëm njërës nga ato dispozita pasi kjo do të cungonte parimet dhe konceptet e dhëna të të drejtës penale.

Matja e gjobës tek bashkimi i veprave penale

Kur flasim për llogaritje të gjobës duhet adresuar edhe çështjen e llogaritjes së gjobës në rastet kur kryesit akuzohen për më shumë se një vepër penale. Kjo do shpiente tek një kalkulim më ndryshe edhe të gjobës pasi në këtë rast vie në shprehje edhe parimi i llogaritjes së gjobës si dënim unik për bashkim të veprave penale sipas nenit 76 të Kodit penal *“Nëse gjykata ka shqiptuar dënime me gjobë për secilën nga veprat penale, dënimi unik me gjobë është shuma e dënimeve të shqiptuara por nuk mund të tejkalojë shumën prej njëzet e pesë mijë (25.000) Euro, përkatësisht pesëqind mijë (500.000) Euro kur një apo shumë vepra penale janë kryer me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore.”*⁸⁴ Pra sipas kësaj dispozite edhe nëse kryesi do të gjendej fajtor për dy apo më shumë vepra penale edhe nëse secila nga këto vepra penale parasheh dënim maksimal me gjobë, prapëseprapë totali i maksimumit për të gjitha veprat nuk mund të jetë më i lartë se maksimumi prej 25,000.00€ respektivisht 500,000.00€.

Matja e gjobës tek personat juridik

Parimet e shtjelluara në këtë Udhëzues janë të aplikueshme për kryes si persona fizik dhe në pika të caktuara prekin edhe rastet kur personat juridik janë të përfshirë në kryerjen e veprës penale. Tek këto të fundit lartësia e gjobës është e paraparë në mënyrë specifike me Ligjin për përgjegjësinë e personave juridik për vepër penale⁸⁵ dhe për dispozitat e ndryshme janë paraparë minimumet dhe maksimumet e gjobës në varësi të peshës së veprës penale dhe lartësisë së dënimit të paraparë për ato vepra me Kod penal. Siq edhe u përmend më sipër pothuajse të njëjtat parime që vlejné sa i përket matjes së dënimit në Kodin penal do jenë

⁸⁴ Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Nr.06/L-074, Neni 76, Dënimi për bashkim të veprave penale, par.2.4, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, 14.01.2019.

⁸⁵ Ligji nr.04/L-030 për përgjegjësinë e personave juridik për vepra penale, neni 9, Dënimi me gjobë, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, 14.09.2011

relevante edhe tek personat juridik me disa specifika pak më ndryshe tek ky Ligj.⁸⁶ Në përputhje me këtë ligj, gjykata duhet të marrë në konsideratë që kur të kryhet një veprë penale nga personi juridik, ekziston nevoja për ta vlerësuar siç duhet nivelin e dëmit dhe fajësisë së shkaktuar nga personi juridik dhe të caktoj gjobën e duhur për të. Ligji i ka përcaktuar rrethanat për përcaktimin e peshës së veprës penale si më poshtë:

1. peshën e veprës penale të kryer;
2. pasojat që kanë lindur ose që kanë mundur të lindin;
3. rrethanat në të cilat është kryer vepra penale;
4. fuqinë ekonomike dhe madhësinë e personit juridik;
5. pozitën dhe numrin e personave përgjegjës në personin juridik të cilët kanë kryer veprë penale;
6. sjelljen e personit juridik pas kryerjes së veprës penale;
7. masat të cilat i ka ndërmarr personi juridik me qëllim të pengimit dhe zbulimit të veprës penale;
8. raporti ndaj viktimës së veprës penale;
9. sjellja e personit juridik ndaj veprës së kryer penale, duke përfshirë dhe pranimin epërgjegjësisë për veprën e kryer penale.

I njëjti nen përcakton që gjykata do të marrë parasysh në veçanti:

- se a është dënuar personi juridik për vepra penale e kryera më parë,
- a është vepra e njëllotë me veprën e re penale dhe
- sa kohë ka kaluar nga dënimi i mëparshëm.

Me rastin e caktimit të gjobës për recidivizëm përcakton edhe kuptimin e recidivizmit të shumëfishtë dhe atë si në vijim:

- **personi juridik ka qenë të paktën dy herë i dënuar për veprë penale të ngjashme me mbi tridhjetepesëmijë (35.000) Euro** dhe nëse prej dënimit të fundit që është dhënë në formë të prerë nuk kanë kaluar më tepër se pesë (5) vjet;
- **për veprat e ngjashme penale ka qenë të paktën dy herë i dënuar me burg ose me gjobë prej pesëmbëdhjetëmijë (15.000) Euro**, nëse prej dënimit të fundit me burg, përkatësisht prej dënimit të fundit me gjobë të formës së prerë që i është caktuar nuk kanë kaluar më tepër se pesë (5) vjet dhe nëse kryesi tregon prirje për kryerjen e veprave të tilla penale.

Zbatueshmëria e parimeve të këtij udhëzuesit në veprat tjera penale sipas legjislacionit tjetër penal

Edhe pse Udhëzuesi referimin primar e ka në dispozitat e Kodit penal, asgjë nuk ndalon gjykatat që këto parime të zbatojnë edhe në ligjet tjera të cilat parashohin apo në të ardhmen mund të

⁸⁶ Ibid. neni 10, Matja e dënimit me gjobë.

parashohin sanksione penale. Një nga këto është edhe Ligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit²⁴ i cili i referohet në shumë vende gjobave të ndryshme administrative dhe penale të lëshuara në bazë të Ligjit. Sidoqoftë, për qëllim të këtij udhëzuesi, siq edhe është përmendur më sipër tek shtjellimi i rrethanave rënduese, në rastin e caktimit të gjobave relevant është më saktë neni 56 i këtij ligji. Është interesante të shihet se për shkak të peshës së veprave të tilla, i njëjti nen në par.1 të tij e paraqet mënyrën e llogaritjes së gjobave:

1. *Kushdo që, duke e ditur ose ka arsye për të ditur se pasuria e caktuar buron nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal, pasuri kjo e cila në të vërtetë fitohet me veprë penale, apo kushdo që duke besuar se pasuria e caktuar fitohet nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal bazuar në përfaqësimet e bëra si pjesë e një hetimi zbulues të zhvilluar në pajtim me Kapitullin IX të Kodit të procedurës penale të Kosovës, zhvillon veprimet e mëposhtme, kryen veprë penale të dënueshme me burgosje deri në dhjetë (10) vjet dhe me gjobë deri në tri (3) herë më të madhenë vlerë të pasurisë e cila është subjekt i veprës penale”.*

Siç shihet nga neni i mësipërm, Ligji parasheh shuma shumë të larta të gjobave për këto vepra penale, të cilat konsiderohen si më të rëndat për nga natyra të kategorisë së veprave penale të bazuara në përfitime materiale. Kjo qasje e njëjtë mund të përdoret në veprat penale që përfshijnë dëm në shkallë të gjerë.

(Udhëzim i miratuar në Mbledhjen e Përgjithshme të Gjykatës Supreme, i mbajtur më 27 shkurt 2020).



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Mbledhja e Përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 26 paragrafi 1, pika 1.4 të Ligjit për Gjykatat, më datë 27 shkurt 2020, me shumicë votash nxjerr këtë:

UDHËZIM

- I. Gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues, në kuptim të nenit 284, paragrafi 1, të Kodit të Procedurës Penale/ tutje KPPK/, duhet që në dispozitivin e aktgjykimit, përveç pjesës dënuese, nëse ka propozim në aktakuzë të vendosë edhe nëse pasuria konfiskohet apo jo. Gjithashtu, nëse vendos për konfiskimin e pasurisë, është obligim, që të lëshon edhe urdhrin e arsyetuar që përcakton nëse duhet të konfiskohen apo të lirohen ndërtesat, pasuritë e paluajtshme, pasuri të luajtshme apo asete të përcaktuara në aktakuzë, në pajtim me nenin 241, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.9 të këtij Kodi.
- II. Sipas paragrafit 6 të nenit 284 të KPPK-së, urdhri duhet të përmbajë udhëzime specifike për Agjencinë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar, lidhur me veprimet e mëtutjeshme të agjencisë rreth pasurisë së konfiskuar. Kësisoj, urdhri duhet të përcaktojë që pasuria e konfiskuar a duhet shitur, të likuidohet ose të mbajë ndërtesën, pasurinë e paluajtshme, pasurinë e luajtshme, ose asetin. Nëse paraqiten kërkesa specifike nga prokurori i shtetit, i dëmtuari ose mbrojtësi i viktimave, gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues, me urdhër duhet të përcaktojë kushte shtesë lidhur me përdorimin e pasurisë, e që nënkupton se nga mjetet e shitura të urdhërojnë kompensimin e të dëmtuarit, ndërsa mjetet e mbetura të mbahen nga Qeveria.
- III. Dispozita e nenit 487, paragrafi 3 të KPPK-së, përcakton ekzekutimin e aktgjykimit të formës së prerë, në rast se me aktgjykim shqiptohet dënimi plotësues ikonfiskimit të sendit, të cilat sipas kësaj dispozite ligjore menjëherë kalojnë në pronësi të shtetit, ndërsa është obligim i gjykatës që menjëherë kopjen e certifikuar të aktgjykimit të formës së prerë t'ia dërgojnë agjencisë për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar, e cila mund të bëjë shitjen ose dorëzimin e tyre për shfrytëzim nga Qeveria.

Ar sy e t i m

Agjencinë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar ka kërkuar nga Gjykata Supreme e Kosovës sqarime rreth zbatimit të nenit 284, paragrafi 1 i KPPK-së, si dhe problemeve në praktikë që ndodhin sa i përket urdhrin të arsyetuar së bashku me aktgjykimin si dhe zbatimin e nenit 487, paragrafi 3 të KPPK-së.

Gjykata Supreme e Kosovës analizoi kërkesën në fjalë por edhe problemet nga praktika që përballen gjykatat, në raport me konfiskimin e pasurisë, në veçanti se si duhet gjykatat të veprojnë në rastin e vendosjes për konfiskimin e pasurisë në raport edhe me agjencinë në fjalë. Dispozita e nenit 284, paragrafi 1 të KPPK-së është dispozitë imperative sa i përket urdhrin të arsyetuar për konfiskimin e pasurisë, kështu që gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues siç ceket në këtë nen përcakton se “gjyqtari i vetëm gjykues, ose trupi gjykues, së bashku me aktgjykimin lëshon edhe urdhrin e arsyetuar”. Më tutje sipas kësaj dispozite ligjore specifikohet se me urdhrin përcaktohet “nëse duhet të konfiskohen apo lirohen ndërtesat, pasuritë e paluajtshme, pasuritë e luajtshme apo asetet e përcaktuara në aktakuzë, në pajtim me nenin 241, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.9 të këtij Kodi. Kësisoj, prokurori duhet të aktakuzë të përcaktojë saktë çdo pasuri që mund t’i nënshtrohet konfiskimit, ndërsa, sipas paragrafit 3 dhe 4 të nenit 284 të kërkojë nga Gjykata që pasuria të shitet apo likuidohet apo të mbetet në shfrytëzim nga Qeveria e Kosovës. Në paragrafin 5 të këtij neni parashihet që nga mjetet e konfiskuara i është lënë mundësia prokurorit të shtetit, të dëmtuarit ose mbrojtësit të viktimave të kërkojnë që mjetet të përdoren për kompensimin e të dëmtuarit ndërsa mjetet e mbetura të kalojnë në buxhetin e shtetit.

Në situatën e përshkruar procedurale KPPK, përcakton se procedura e konfiskimit të pasurisë zhvillohet sipas kërkesës së prokurorit dhe lidhur me kërkesat vendosë Gjykata, andaj pasi që veç u konstatua se përveç aktgjykimin në dispozitivin e të cilit duhet të vendoset për konfiskim, ligjdhënësi ka paraparë edhe lëshimin e urdhrin të posaçëm i cili sipas paragrafit 6 të nenit 284 të KPPK-së përcakton se urdhri duhet të përmbajë udhëzime specifike për Agjencinë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar lidhur me veprimet e mëtutjeshme të saj rreth pasurisë së konfiskuar. Andaj, urdhri sipas këtij paragrafi duhet të përcaktojë nëse pasuria e konfiskuar duhet shitur, të likuidohet ose të mbajë ndërtesën, pasurinë e paluajtshme, ose asetin varësisht nga propozimet respektivisht kërkesës së prokurorit të shtetit. Pra, duhet urdhër i veçantë i gjyqtarit të vetëm gjykues ose trupit gjykues pasi që sipas paragrafit 7 të nenit 284 parashihet që urdhri t’i dërgohet cilitdo person që ka të drejtën pronësore në pasurinë e konfiskuar të cilët mund të ankimojnë.

Sa i përket nenit 487 paragrafi 3 të KPPK-së, kjo dispozitë ligjore rregullon situatën kur me aktgjykim shqiptohet dënimi plotësues i konfiskimit të sendit, ose siç është cekur në Kodin Penal të Kosovës i vitit 2013, marrja e sendit, dhe nuk i takon kapitullit VII të Kodit në fjalë “Konfiskimi i dobisë pasurore të fituar me anë të kryerjes së veprave penale”. Andaj, dispozita e nenit 487 paragrafi 3 të KPPK-së përcakton ekzekutimin e aktgjykimin të formës së prerë në rast se me aktgjykim shqiptohet dënimi plotësues i konfiskimit të sendit të cilat sipas kësaj

dispozite ligjore menjëherë kalojnë në pronësi të shtetit, ndërsa është obligim i gjykatës që menjëherë kopjen e certifikuar të aktgjykimit të formës së prerë t'ia dërgojnë Agjencinë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar, e cila mund të bëjë shtijën ose dorëzimin e tyre për shfrytëzim nga Qeveria.

(Udhëzim i miratuar në Seancën e Përgjithshme të Gjykatës Supreme, i mbajtur më 27 shkurt 2020)



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Mbledhja e Përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 26 paragrafi 1, pika 1.4 të Ligjit për Gjykatat , më datë 25 shtator 2019, me shumicë votash nxjerr këtë:

UDHËZIM

Bazuar në dispozitën e nenit 42 paragrafi 4 të Ligjit për Gjykatat , në rast se Departamenti Special i Gjykatës së Apelit anulon lëndën e Departamentit të krimeve të Rënda e cila ka qenë në kompetencë të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, dhe e kthen në rigjykim dhe vendosje, varësisht prej rastit konkret në situatë kur anulohet lënda për shkak shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale në të cilën është konstatuar shkelja në shqyrtimin fillestar dhe për eliminimin e shkeljes duhet të mbahet shqyrtimi fillestar, kompetent për vendosje është **Departamenti Special i Gjykatës Themelore në Prishtinë**, në të gjitha rastet tjera në të cilat konstatohet se për lëndën e caktuar nuk ka nevojë të mbahet shqyrtimi fillestar kompetent për vendosje është **Departamenti i Krimeve të rënda i Gjykatës përkatëse Themelore**.

A r s y e t i m

Udhëheqësi i Departamentit Special i Gjykatës së Apelit të Kosovës Vaton Durguti, me Kërkesën 630/10 datës 29.08.2019, nga Gjykata Supreme e Kosovës, ka kërkuar dhënien e mendimit juridik në lidhje me kompetencën lëndore të Departamentit të Krimeve të Rënda dhe Departamentit Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë në rastet kur Departamenti Special i Gjykatës së Apelit anulon aktgjykimin dhe vendos që lënda të kthehet në rigjykim dhe vendim, cili departament duhet të gjykoj lëndën.

Gjykata Supreme e Kosovës analizoj kërkesën në fjalë dhe konstatoj si vijon:

Ligji Nr. 06/L-054 për Gjykatat (tutje Ligjit për Gjykatat) i cili ka hyr në fuqi më datë 02 janar 2019, në nenin 13 ka përcaktuar organizimin e brendshëm të Gjykatës Themelore në Prishtinë, në kuadër të së cilës vepron Departamenti Special për lëndët në kompetencë të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës për tërë territorin e Republikës së Kosovës. Po ashtu në

nenin 24 paragrafi 1 pika 1.3 të ligjit në fjalë është përcaktuar organizimi i brendshëm i Gjykatës së Apelit në kuadër të së cilës është parapa Departamenti Special për lëndët në Kompetencë të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës.

Në dispozitat Kalimtare dhe Përfundimtare të ligjit për gjykatat në nenin 42 paragrafi 4 parashihet po citoj se “me hyrjen në fuqi të këtij ligji, lëndët e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, për të cilat ende nuk është mbajtur shqyrtimi fillestar, do të transferohen për shqyrtim në Departamentin Special për Lëndët në Kompetencë të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës. Lëndët për të cilat është mbajtur shqyrtimi fillestar, do të vazhdojnë të shqyrtohen në gjykatat përkatëse, deri në përfundimin e tyre.

Duke analizuar dispozitat ligjore të nenit 42 paragrafi 4 të Ligjit për Gjykata, rrjedh se ligjdhënësi ka përcaktua fazën e shqyrtimit të lëndës penale e cila ka qenë në punë në kompetencë të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës në Departamentin e Krimeve të Rënda të Gjykatave Themelore **me shqyrtimin fillestar** dhe e ka ndërlidh deri në përfundimin e shqyrtimit gjyqësor në shkallë të parë, kështu që nëse ka kaluar faza shqyrtimit fillestar atëherë dispozita në fjalë ka caktua se kompetent për shqyrtimin e lëndës është Departamenti i Krimeve të Rënda i gjykatave përkatëse themelore. Lidhur me kërkesën e parashtruar për mendim juridik ligjdhënësi nuk ka parapa zgjidhje të situatës procedurale, në rast se Departamenti Special i Gjykatës së Apelit anulon lëndën e Departamentit të krimeve të Rënda e cila ka qenë në kompetencë të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, dhe e kthen në rigjykim dhe vendosje.

Andaj në seancën e përgjithshme të kësaj gjykate u diskutua dhe u miratua mendimi i shumicës së gjyqtarëve se, në interpretimin juridik të dispozitës ligjore të nenit 42 paragrafi 4 të Ligjit për Gjykata, vlerëson se varësisht prej rastit konkret në situatë kur anulohet lënda për shkak shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, në të cilën është konstatuar shkelja në shqyrtimin fillestar dhe për eliminimin e shkeljes duhet të mbahet shqyrtimi fillestar, do të thotë që në këtë situatë procedurale konsiderohet se shqyrtimit fillestar nuk është mbajtur, pasi që ka mundësi që disa shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të parapara nga neni 384 të KPPK të cilat konstatohen nga vendimi i shkallës së dytë kërkohet që për eliminimin e tyre domosdoshmërisht, duhet të mbahet shqyrtim fillestar, (*psh. në shqyrtimin fillestar ka marrë pjesë gjyqtari i cili është dashur të përjashtohet, pastaj nëse nuk është respektuar gjuha e të akuzuarit apo mbrojtësit të tij, te instituti i pranimit të fajësisë etj*), kompetent për vendosje është **Departamenti Special i Gjykatës Themelore në Prishtinë**, e në të gjitha rastet tjera në të cilat konstatohet se në lëndën konkrete nuk ka nevojë të mbahet shqyrtimi fillestar, por duhet vazhduar shqyrtimi gjyqësor, kompetent për vendosje është **Departamenti i Krimeve të rënda i Gjykatës përkatëse Themelore** në të cilën është mbajtur shqyrtimi gjyqësor.

Departamenti Special i Gjykatës së Apelit gjatë vendimmarrjes për secilin rast varësisht nga shkelja e konstatuar në vendimin për anulimin e lëndës gjegjësisht vendimit, konstaton shkeljen dhe në udhëzimet që jep për gjykatën e shkallës së parë përcaktohen saktësisht edhe shkeljet

në cilën fazë të procedurës kane ndodh, kështu që në këtë mënyrë mundë të caktohet edhe kompetenca e Departamentit përkatës për vendosje.

Me shumicë votash të gjyqtarëve u vendos që për kërkesën në fjalë të nxjerrët udhëzim i cili është ma i përshtatshëm për aplikim.

(Udhëzimi i miratuar në seancën e përgjithshme të Gjykatës Supreme, i mbajtur më 25 shtator 2019)



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 26 paragrafi 1. pika 1.4 të Ligjit për Gjykatat, në Seancën e Përgjithshme, të mbajtur më datë 30 maj 2019, me shumicë votash, miratoi këtë:

UDHËZIM

Kodi Penal i Republikës së Kosovës nr. **06/L-074**, i cili ka hyrë në fuqi më 14 prill 2019, në kapitullin XXX, ka paraparë Veprat Penale kundër sigurisë së trafikut publik. Kësisoj, në nenin 370 është paraparë edhe vepra penale Rrezikimi i trafikut publik. Sipas kësaj dispozite ligjore, në paragrafin 1. përcaktohet se: “Kushdo që shkel ligjin mbi trafikun publik apo transportin rrugor dhe rrezikon jetën e njerëzve apo pasurinë dhe me këtë i shkakton dikujt dëme të konsiderueshëm pasurore”. Paragrafi 2. sanksionon këtë vepër penale, nëse me shkeljen e Ligjit mbi trafikun rrezikohet trafiku hekurudhor, me tramvaj, me trolejbus, me autobus, me teleferik ose trafikun ujor.

Paragrafi 3. në mënyrë shprehimore ka përcaktuar se: “Nëse veprat penale nga paragrafi 1 ose 2, të këtij neni rezultojnë me dëm pasuror në vlerë prej pesëmbëdhjetë mijë (15.000) Euro apo më shumë “ndërsa paragrafi 4 parasheh si vepër penale nëse ka rezultuar me lëndime të rënda trupore ose me dëm pasuror, në vlerë prej njëzet mijë (20.000) Euro apo më shumë, si dhe paragrafi 5, nëse ka rezultuar me vdekjen e një ose më shumë personave.

Në bazë të dispozitave të nenit 370 të KPK-së, të cekura në pikën a) të këtij Udhëzimi, tani më nuk parashihet vepra penale Rrezikimi i trafikut publik, e cila rezulton me lëndime të lehta trupore.

Të gjitha rastet e shkeljes së rregullave të trafikut publik apo transportit rrugor nga hyrja në fuqi e këtij Kodi, e të cilat kanë rezultuar me lëndime të lehta trupore, Organi i kundërvajtjes duhet t’i parashtojë Kërkesën për fillimin e procedurës së kundërvajtjes, gjykatës kompetente themelore – Divizionit për Kundërvajtje.

Lëndët, të cilat janë në punë, në Gjykatat Themelore të Kosovës, sipas aktakuzës së Prokurorit të Shtetit, për shkak të veprës penale, Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par.1 ose 2 të KPK-së, të shfuqizuar, në të cilat nuk ka filluar shqyrtimi gjyqësor, duhet të hidhen, ndërsa nëse ka filluar shqyrtimi gjyqësor, gjykata duhet ta vendos në bazë të aktgjykimit refuzues.

Lëndët do t'i procedohen organit të kundërvajtjes për iniciimin e procedurës së kundërvajtjes sipas Ligjit për Kundërvajtje.

Për kryesin e dënuar me aktgjykim të formës së prerë me KPK-në e mëparshme, të shfuqizuar, sanksioni penal nuk fillon të ekzekutohet ose ndërpritet, në rast se ka filluar.

A r s y e t i m

Me hyrjen në fuqi të Kodit Penal të Republikës së Kosovës nr. **06/L-074** nga data 14 prill 2019, janë krijuar probleme në praktikë, sa i përket zbatimit të tij, sidomos në dispozitën e nenit 370 të veprës penale, Rrezikimi i trafikut publik, si nga ana e gjykatave, prokurorive ashtu edhe te organi i kundërvajtjes. Kryetarit të kësaj gjykate, i është drejtuar me parashtresë edhe U.D., Drejtori i Divizionit të Komunikacionit Rrugor, Nënkolonel Jeton Rexhepi, si dhe ka pasur biseda me kryetarë të gjykatave dhe prokurorë të shtetit si dhe me Këshillin Gjyqësor dhe atë Prokurorial, rreth zbatimit konkret të kësaj dispozite ligjore, për veprimet e mëtutjeshme në menaxhim, trajtim si dhe procedim të rasteve të rrezikimit të trafikut publik, i cili ka rezultuar me lëndime të lehta trupore.

Fillimisht, dega penale e Gjykatës Supreme të Kosovës, gjatë analizës paraprake ka marrë qëndrim, që në bazë të nenit 26 paragrafi 1. pika 1.4 të Ligjit për Gjykatat, ka kompetencë, mes tjerash edhe të nxjerr një Udhëzim, i cili do të shërbejë për trajtimin në mënyrë unike, veprimet, të secilit organ, pas hyrjes në fuqi të këtij kodi.

Kësisoj, gjatë analizës u konstatua si vijon:

Kodi Penal i Republikës së Kosovës i cili ka hyrë në fuqi më 14 prill 2019, në kapitullin XXX i ka paraparë të gjitha veprat penale kundër sigurisë së trafikut publik, ndërsa vepra bazë e cila ka qenë objekt i trajtimit ka qenë vepra penale, Rrezikimi i trafikut publik nga neni 370. Në paragrafin 1 dhe 2 përkufizohen në mënyrë të përgjithshme shkeljet e ligjit mbi trafikun publik apo transportin rrugor dhe rrezikohet jeta e njerëzve apo pasuria dhe me këtë i shkakton dikujt dëm të konsiderueshëm pasuror.

Paragrafi 3 i kësaj dispozite ligjore, përkufizon elementet qenësore të veprës penale - Rrezikimi i trafikut publik në atë mënyrë që për ekzistimin e kësaj vepre penale përcakton se, nëse veprat penale nga paragrafi 1 ose 2 të këtij neni, rezultojnë me dëm pasuror në vlerë

prej pesëmbëdhjetë mijë (15.000) Euro apo më shumë “ndërsa paragrafi 4. parasheh si vepër penale nëse ka rezultuar me lëndime të rënda trupore ose me dëm pasuror në vlerë prej njëzet mijë (20.000) Euro apo më shumë, si dhe paragrafi 5. nëse ka rezultuar me vdekjen e një ose më shumë personave. Pra për ekzistimin e kësaj vepre penale, duhet të përcaktohet vlera e dëmit pasuror pesëmbëdhjetë mijë (15.000) Euro apo më shumë, pastaj, nëse ka rezultuar me lëndime të rënda trupore ose me dëm pasuror në vlerë prej njëzet mijë (20.000) Euro apo më shumë, si dhe nëse ka rezultuar me vdekjen e një ose më shumë personave.

Në dispozitat e Kodit në fuqi, përkundër Kodit Penal të shfuqizuar, i cili, në nenin 378 ka paraparë veprën penale, Rrezikim i trafikut publik, i cili në paragrafin 1 përcakton se: “kushdo që shkel ligjin mbi trafikun publik apo transportin rrugor dhe rrezikon jetën e njerëzve apo pasurinë dhe me këtë i shkakton dikujt lëndim të lehtë trupor ose dëm pasuror”, si element qenësor të veprës penale, nuk ka paraparë shkaktimin e lëndimit të lehtë trupor. Kështu që, në rastin konkret, ligjdhënësi, sipas dispozitës ligjore të nenit 255 të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor, ka paraparë si masa të veçantë për kundërvajtje, në paragrafin 2, se, “Nëse është shkaktuar aksident trafiku me persona të lënduar, kryesi i kundërvajtjes nga ky ligj, dënohet me gjobë të paraparë për atë kundërvajtje, duke e rritur shumën për 200 euro”.

Duke vlerësuar këtë situatë ligjore, konstatojmë se të gjitha rastet e rrezikimit të trafikut publik, të cilat rezultojnë me lëndime të lehta trupore, në veprimet e kryesve, mund të sajohen vetëm elementet qenësore të kundërvajtjes.

Duke analizuar kompetencën lëndore të organeve kompetente, sa i përket trajtimit të kundërvajtjeve, bazuar në legjislacionin në fuqi, konstatojmë si vijon:

Ligji nr. 05/L-87 Për Kundërvajtje, me nenin 55, ka rregulluar çështjen e Kompetencës dhe përbërjen e gjykatës, kështu paragrafi 1 përcakton se, gjykata gjykon në kufijtë e kompetencës së saj lëndore të paraparë me ligj, ndërsa në paragrafin 4 thuhet se, për disa kundërvajtje të përcaktuara me ligj apo rregullore të Kuvendit të Komunës, procedura e kundërvajtjes mund të zhvillohet dhe sanksionin kundërvajtës, mund ta shqiptojë organi i administratës shtetërore ose organi i cili kryen autorizime publike, në tekstin e mëtutjeshëm, organi për kundërvajtje të mbikëqyrjes për zbatimin e ligjit, në të cilin janë paraparë kundërvajtje. Neni 56 i Ligjit Për Kundërvajtje, ka rregulluar Kompetencën e organit të kundërvajtjes, kështu në paragrafin 1 thuhet se, organi kundërvajtës zhvillon procedurën e kundërvajtjes, nëse me ligj është paraparë kompetenca ekskluzive për veprimin e saj, ndërsa paragrafi 2 parasheh që, përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, organi për kundërvajtje është kompetent që të veprojë sipas të gjitha kundërvajtjeve ashtu që: nën-paragrafi 2.1. specifikon, për të cilat është paraparë sanksioni i gjobës në shumën e caktuar; nën-paragrafi 2.2. për të cilat është paraparë sanksioni për personin fizik, gjoba deri në pesëqind (500) euro; nën-paragrafi 2.3., për të cilat është paraparë sanksioni për personin juridik, gjoba deri në njëmijë (1.000) euro dhe nën-paragrafi 2.4., për të cilat është paraparë shqiptimi i gjobës në vend.

Për të përcaktuar kompetencën në situatën kur rrezikohet trafiku publik i cili rezulton me lëndime të lehta trupore, seanca e përgjithshme e kësaj gjykate konstaton se Gjykata Themelore përkatëse, lëndore - Divizioni për Kundërvajtje është kompetent për trajtimin e kësaj kundërvajtje. Deri te një konstatim i tillë, gjykata erdhi duke analizuar nenin 109 të Ligjit për Kundërvajtje e që rregullon çështjen e ekspertimit në të cilin në paragrafin 1 thuhet se: “Ekspertimi caktohet me propozimin e palëve kur për konstatimin ose për vlerësimin e ndonjë fakti të rëndësishëm duhet të sigurohet konstatimi dhe mendimi nga personi, i cili ka njohuri të nevojshme profesionale, pastaj se: “Gjykata, sipas detyrës zyrtare mund të caktojë ekspertimin, nën kushtet e përcaktuara me ligj”, dhe paragrafi 3 se: “Ekspertimi caktohet me urdhëresën me shkrim të gjyqtarit, i cili e zhvillon procedurën”. Në urdhëresë do të shënohet lidhur me cilat fakte duhet të bëhet ekspertimi dhe kujt i besohet. Kësisoj, nëse rrezikohet trafiku publik dhe rezulton me lëndime të lehta trupore, lidhur me natyrën e lëndimeve, duhet të sigurohet konstatim dhe mendim nga personi i cili ka njohuri të nevojshme profesionale, gjë që, në rastin konkret, për natyrën e lëndimeve trupore duhet mendimi dhe konstatimi i ekspertit mjeko-ligjor. Përveç kësaj situatë ligjore, Ligji nr.06/L-069 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 05/L-088 Për Rregullat e Trafikut Rrugor, në nenin 26, shprehimisht përcakton se, “teksti i nenit 259 të ligjit bazik, zëvendësohet me tekstin “Polici i cili e rregullon dhe e mbikëqyrë trafikun rrugor, në vendin e shkaktimit të kundërvajtjes shqipton gjobë me të holla deri në pesëqind (500) euro për personin fizik dhe njëmijë (1,000) euro për personin juridik, duke përfshirë edhe shqiptimin e masës mbrojtëse dhe pikët negative. Kundërvajtjet më gjobë të parapara mbi këtë shumë duke përfshirë edhe shqiptimin e masës mbrojtëse dhe pikët negative procedohen në gjykatën kompetente”.

Edhe pse në mënyrë specifike, ligjvënësi nuk ka përcaktuar se për lëndime të lehta trupore, a mundet polici, i cili e rregullon dhe mbikëqyr trafikun rrugor në vendin e shkaktimit të kundërvajtjes, të shqiptoi gjobë në të holla, sipas vlerësimit të kësaj gjykate, një gjë të tillë, nuk ka të drejtë ta bëjë pikërisht për shkak se kemi të bëjmë me vërtetimin e natyrës së lëndimit trupor, i cili duhet të konstatohet ashtu siç u tha në procedurë të mëtutjeshme dhe kjo provë nuk mund të sigurohet në vendin e shkaktimit të kundërvajtjes, pasi që duhet mendimi dhe konstatimi i ekspertit të lëmisë përkatëse dhe varësisht prej natyrës së lëndimeve më tutje, përcaktohen se a ka elemente të kundërvajtjes apo veprës penale. Po ashtu, siç u citua më lartë, edhe dispozita e nenit 26 e Ligjit për ndryshimin e ligjit për rregullat e trafikut rrugor, që përveç kundërvajtjeve të parapara për shqiptimin e gjobave mbi shumat e cekura, nëse parashihet shqiptimi i masës mbrojtëse dhe pikët negative, atëherë rastet procedohen në gjykatën kompetente.

Andaj, në bazë të dispozitave të nenit 370 të KPK-së në fuqi, tani më nuk parashihet vepër penale, Rrezikimi i trafikut publik, e cila rezulton me lëndime të lehta trupore dhe për këtë arsye, të gjitha rastet e shkeljes së rregullave të trafikut publik apo transportit rrugor nga hyrja në fuqi e këtij Kodi, e të cilat kanë rezultuar me lëndime të lehta trupore, organi i kundërvajtjes duhet t’i parashtojë Kërkesën për fillimin e procedurës së kundërvajtjes Gjykatës kompetente themelore – Divizionit për kundërvajtje.

Meqenëse Kodi Penal në fuqi me nenin 433 ka shfuqizuar Kodin nr. 04/L-082 Penal të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-129 si dhe Ligjin nr. 04/L-273, në kuptim të nenit 3 të këtij Kodi të zbatimit të institutit të ligjit më të favorshëm që si parim përcakton se në rast se ligji në fuqi ndryshon para shqiptimit të vendimit të formës së prerë, atëherë ndaj kryesit zbatohet ligji që është më i favorshëm e që në rastin konkret kemi këtë situatë, atëherë ashtu siç u cek në pikën c) dhe d) të këtij Udhëzimi, lëndët të cilat janë në punë në gjykatat themelore të Kosovës, sipas aktakuzës së Prokurorit të Shtetit, në të cilat nuk ka filluar shqyrtimi gjyqësor duhet të hidhen në bazë të nenit 253 paragrafi 1 pika 1.1 KPPK , pasi që tani vepra me të cilën akuzohen nuk përbën vepër penale, ndërsa nëse ka filluar shqyrtimi gjyqësor, gjykata duhet ta vendos në bazë të aktgjykimit refuzues, bazuar në nenin 363 paragrafi 1 pika 1.3 të KPPK-së. Gjithashtu, në kuptim të nenit 3 paragrafi 3 të KPK-së, i cili përcakton se: “Nëse ligji i ri nuk e inkriminon veprën, por kryesi është dënuar me aktgjykim të formës së prerë, në pajtim me ligjin e mëparshëm, sanksioni penal nuk fillon të ekzekutohet ose ndërpritet në rast se ka filluar”, atëherë duhet vepruar sipas kësaj dispozite ligjore, sa i përket ekzekutimit të dënimit.

(Udhëzimi i miratuar në seancën e përgjithshme të Gjykatës Supreme, mbajtur më 30 maj 2019)



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Mbledhja e Përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 26 paragrafi 1. pika 1.4 të Ligjit për Gjykatat, më datë 7 nëntor 2022, me shumicë votash nxjerr këtë:

PLOTËSIM I UDHËZIMIT

Pas pikës e) të udhëzimit **Agj.nr.183/2019 të datës 30 maj 2019**, i shtohet edhe pika;

ë) Rastet e shkeljes së rregullave të trafikut publik apo transportit rrugor, sipas nenit 255, të Ligjit për Rregullat e Trafikut Publik, në të cilën është shkaktuar vet-aksident trafiku dhe me këtë rast ka pësuar lëndime vetëm vozitësi i mjetit, pa dëm pasuror të dikujt tjetër, kryesi i kundërvajtjes përgjigjet vetëm për shkelje të ndonjë rregulli tjetër të trafikut publik, por jo edhe për lëndimet trupore që i ka shkaktuar vetes.

A r s y e t i m

Gjykata Supreme e Kosovës në Mbledhjen e Përgjithshme më datë 30 maj 2019 me shumicë votash ka nxjerr udhëzimin Agj.nr.183/2019 me të cilin gjykatat në nivel vendi i ka udhëzuar lidhur me risitë e dispozitës së nenit 370 të KPK-së, e që përcakton veprën penale Rrezikimi i trafikut publik.

Drejtorit i Divizionit të Komunikacionit Rrugor Nënkolonel Jeton Rexhepi, kryetarit të kësaj gjykate i është drejtuar me kërkesë që të udhëzojë, se si të veprojnë me rastet e vet-aksidenteve të trafikut, pasi që Gjykatat Themelore – Divizionet për Kundërvajtje në Prishtinë – dega në Lipjan dhe në Prizren, dega në Suharekë, kanë vendosur ndryshe në dy raste të ngjashme. Me këtë rast ka bashkangjitur një aktgjykim të Gjykatës Themelore në Prishtinë –

Divizionit për Kundërvajtje – dega në Lipjan si dhe një akt të Gjykatës Themelore në Prizren- Divizioni për kundërvajtje dega Suharekë, me të cilin kjo gjykatë është shpallur jo kompetente. Pas analizimit të çështjeve juridike kontestuese lidhur me këtë rast, Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e përgjithshme të kësaj gjykate, konstatoi si vijon:

Ligdhënësi edhe te vepra penale nga neni 370 të KPK-së, por edhe te dispozita e nenit 255 të Ligjit për Rregullat e Trafikut Publik në kapitullin - Masat e posaçme të Kundërvajtjes, ekskluzivisht si kryes të veprës penale apo kundërvajtjes e konsideron personin i cili me veprimet e tij i shkakton dikujt tjetër lëndime trupore apo dëm pasuror. Me këtë rast nuk mund që veprimet inkriminuese t'i përshkruhen apo mveshen kryesit të veprës penale ose kundërvajtësit nga gjykata apo organi administrativ kompetent për rregullat e trafikut rrugor, nëse me atë rast kryesi në vet-aksident pëson lëndime, pasi që në të dy rastet nuk mundet me qenë edhe i dëmtuar edhe kryes i veprës penale apo kundërvajtjes. Në këtë situatë, nëse kryesi i kundërvajtjes me veprimet e tij sajton ndonjë kundërvajtje tjetër sipas Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor e që varet prej rastit në rast, organi kompetent ka të drejtë të inicioi procedurën kundërvajtjes për shkelje tjera e jo për lëndimet që me fajin e tij vet i ka pësuar, pasi që në këtë situatë ai do ta marr edhe rolin e palës së dëmtuar.

(Plotësim Udhëzimi, i miratuar në seancën e përgjithshme të Gjykatës Supreme, i mbajtur më 7 nëntor 2022)



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 26 paragrafi 1. pika 1.4 të Ligjit për Gjykatat, në Seancën e Përgjithshme, të mbajtur më datë 30 maj 2019, me shumicë votash, miratoi këtë:

UDHËZIM

PËR PROCEDURËN E TRANSFERIMIT TË PERSONAVE TË DËNUAR

Procedura e transferimit të personave të dënuar nga Republika e Kosovës tek shteti tjetër si dhe transferimi i personave të dënuar nga shtetet tjera në Republikën e Kosovës, zbatohet sipas kushteve të parapara me dispozita të Ligjit nr. 04/L-213 Për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale.

Sipas dispozitës së nenit 62. par. 1 të ligjit në fjalë, shprehimisht është paraparë se:” Ministri mund të lejoj transferimin e personit të dënuar nga shteti tjetër, në institucionet korrektuese të Republikës së Kosovës, me qëllim të vuajtjes së dënimit apo pjesës së mbetur të dënimit, me kusht që vepra penale për kryerjen e të cilës, personi është dënuar në shtetin dënues, është vepër penale edhe në bazë të ligjit vendor”, ndërsa paragrafi 3.i këtij neni specifikon se: “nenet 56,59 dhe 60 të këtij ligji zbatohen *mutatis mutandis*”.

Kërkesën për vlerësimin paraprak të kushteve ligjore të transferimit e ushtron Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar i Ministrisë së Drejtësisë, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, ndërsa para dhënies së lejes ose pëlqimit për transferim të personit të dënuar nga ana e Ministrit, për plotësimin e kushteve të parapara ligjore, vendos gjykata kompetente, në fjalë.

Ar sy e t i m

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë, të Republikës së Kosovës, me parashtresën e datës 23.04.2019, i është drejtuar Gjykatës Supreme të Kosovës me kërkesë për dhënien e opinionit në lidhje me procedurat që duhet ndjekur lidhur me Transferimin e Personave të Dënuar. Në kërkesë është cekur se ka dy opinione të ndryshme në mes të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Departamentit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar (DBJN) të Ministrisë së Drejtësisë. Sipas opinionit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, kërkohet që kjo gjykatë në mënyrë që t'i trajtojë kërkesat, fillimisht të jepet pëlqimi për transferim nga Ministri i Drejtësisë, sipas nenit 62 të ligjit të sipër-cekur, ndërsa opinionin e DBJN-së, është se nuk mund të jepet pëlqimi nga Ministri, pa vlerësimin e kushteve ligjore nga ana e Gjykatës, ngase, sipas nenit 62 të ligjit, duhet të zbatohen nenet 56,59 dhe 60 *mutatis mutandis*, kështu që paraprakisht, gjykata duhet të verifikojë nëse kërkesa është në përputhje me nenet e cekura më lartë e pastaj të jepet pëlqimi.

Gjykatës Supreme të Kosovës, krahas kërkesës i janë bashkangjitur edhe shkresat e komunikimit në mes të Departamentit dhe Gjykatës Themelore në Prishtinë, nga të cilat konstatohen opinionet e ndryshme me përmbajtje si më lartë.

Ligji nr.04/L-213 Për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale, rregullon kushtet dhe procedurat për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale mes Republikës së Kosovës dhe shteteve tjera. Për zbatimin e këtij ligji, Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës, më datë 28.02.2014 ka miratuar Udhëzuesin Për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale, të cilat janë rekomandime për gjykatat, prokurorit dhe autoritetet tjera.

Ligji Për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale, në Kreun IV ka rregulluar Transferimin e personave të dënuar dhe atë; nën-kreu I, parasheh procedurën për transferimin e personave të dënuar nga Republika e Kosovës tek shtetet tjera, ku në mes tjerash në nenin 56 ka paraparë kushtet për transferim, neni 59 kërkesën për transferim dhe dokumentet shtesë si dhe neni 60. rregullon procedurën e transferimit të personave të dënuar në bazë të urdhrin për depërtim apo dëbim.

Nën-kreu II, i këtij ligji ka paraparë rregullat e transferimit të personave të dënuar nga shtetet tjera në Republikën e Kosovës, kështu neni 62. rregullon qëllimin dhe kushtet për transferim, paragrafi 1. parasheh se: “Ministri mund të lejoj transferimin e personit të dënuar nga shteti tjetër, në institucionet korrektuese të Republikës së Kosovës me qëllim të vuajtjes së dënimit apo pjesës së mbetur të dënimit, me kusht që vepra penale për kryerjen e të cilës, personi është dënuar në shtetin dënues, është vepër penale edhe në bazë të ligjit vendor “ ndërsa paragrafi 3. specifikon se, nenet 56,59 dhe 60 të këtij ligji zbatohen *mutatis mutandis*.

Andaj, sipas interpretimit në seancën e përgjithshme të kësaj gjykate, dispozitat ligjore për transferimin e personave të dënuar nga Republika e Kosovës në shtetet tjera ose anasjelltas,

nga shtetet tjera në Republikën e Kosovës, vlejné kushtet e njëjta që duhet plotësuar për një procedurë të rregullt për transferimin e personave të dënuar. Kësisoj, kërkesën për vlerësimin paraprak të kushteve ligjore të transferimit të personave të dënuar e ushtron Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar i Ministrisë së Drejtësisë në Gjykatën Themelore në Prishtinë, e cila sipas ligjit, është e kompetencës ekskluzive, kështu që para dhënies së pëlqimit ose lejes për transferim të personit të dënuar nga ana e ministrit, gjykata vlerëson se a janë plotësuar kushtet ligjore, ngase, në të kundërtën do të ishte e panevojshme procedura e vlerësimit në gjykatë, sikur ministri të jepte lejen ose pëlqimin paraprak, pa ndonjë ekspertizë të organit kompetent (gjykatës).

Pra, në rastin konkret, kemi të bëjmë vetëm me procedurën e plotësimit të kushteve ligjore për transferim të personit të dënuar, do të thotë vlerësim i kushteve ligjore që një i dënuar duhet t'i plotësoi, për t'u transferuar, pastaj, nëse sigurohet leja për transferim nga ministri, i nënshtrohet vlerësimit të procedurës së ekzekutimit të dënimit të shqiptuar nga shteti i huaj dhe pas vlerësimit të të gjitha kritereve, i dënuari mund të transferohet në shtetin tonë.

(Udhëzimi i miratuar në seancën e përgjithshme të Gjykatës Supreme, mbajtur më 30 maj 2019)



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Mbledhja e Përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 26 paragrafi 1. pika 1.4 të Ligjit për Gjykatat , më datë 11.03.2019, me shumicë votash nxjerr këtë:

UDHËZIM

- I.** Evidencën e masave dhe dënimeve të shqiptuara ndaj të miturit e mbanë **gjykata**.
- II.** Të dhënat mbi masat dhe dënimet e shqiptuara ndaj të miturit janë konfidenciale. **Vetëm gjykata dhe prokuroria** mund të marrin informatat e tilla kur kjo është e nevojshme për zbatimin e procedurës ndaj individit të njëjtë derisa ai është i mitur.
- III.** Këto shënime do të **fshihen** kur personi të ketë arritur moshën 21 vjet.
- IV.** Me kërkesë të miturit ose përfaqësuesit të tij ligjor gjykata do të lëshoj vërtetimin për të kaluarën kriminele të kryesit të mitur të veprës penale.
- V.** Kryesi i mitur i veprës penale të cilit i është shqiptuar dënim, mund të kërkojë shlyerjen e dënimit, nëse për këtë janë plotësuar kushtet ligjore të KPK, mirëpo, këtë mund të bëjë para se të mbushë moshën 21 vjeçare.

A r s y e t i m

Shefi i Sektorit për Çështje Ligjore në Policinë e Kosovës, me parashtresën e datës 25.07.2018., i është drejtuar Gjykatës Supreme të Kosovës me kërkesë për dhënien e mendimit juridik në lidhje me lëshimin e vërtetimeve për të kaluarën kriminele të kryesit të mitur të veprës penale dhe shlyerjen e dënimit. Në kërkesë është cekur se ka paqartësi lidhur me atë se cili organ mbanë evidencë për të kaluarën kriminele të kryesit të mitur të veprës penale dhe çfarë janë autorizimet/kompetencat e Policisë së Kosovës në këtë fushë. Kjo për arsye se Policisë së Kosovës iu drejtohen edhe personat të mitur me kërkesë për lëshimin e vërtetimit se nuk janë në evidencën kriminele, për të aplikuar për viza etj. Në anën tjetër, mënyra se si po

veprojnë gjykatat nuk është uniforme (janë bashkëngjitur dy shkresa-njoftime, të Gjykatës Themelore në Prizren dhe në Gjiilan).

Çështja në fjalë është e rregulluar me dispozitën e nenit 13.të Kodit për Drejtësinë për të Mitur (KDM).

Sipas saj, evidencën e masave dhe dënimeve të shqiptuara ndaj të miturit e mbanë **gjykata**. Të dhënat mbi masat dhe dënimet e shqiptuara ndaj të miturit janë konfidenciale. **Vetëm gjykata dhe prokuroria** mund të marrin informatat e tilla kur kjo është e nevojshme për zbatimin e procedurës ndaj individit të njëjtë derisa ai është i mitur. Këto shënime do të **fshihen** kur personi të ketë arritur moshën 21 vjet.

Nga kjo dispozitë rezulton se organi i cili mbanë evidencën e masave dhe dënimeve të shqiptuara ndaj të miturit është **ekskluzivisht gjykata**. Rrjedhimisht, ekskluzivisht gjykata edhe mund të jep vërtetim për “të kaluarën kriminale” e kryesit të mitur të veprës penale, por, vetëm **prokurorit** dhe vetëm kur prokurorit kjo i nevojitet për zbatimin e procedurës ndaj individit të **njëjtë** dhe vetëm derisa ai është ende i **mitur**.

Pjesëmarrësit e seancës së përgjithshme konstatuan se të miturit po i cenohet e drejta e garantuar me Kushtetutë, me faktin se nuk po i mundësohet që ai vet, për nevojat e veta (aplikim për punësim, vizë etj.) të kërkon dhe të siguron një vërtetim nga e kaluara kriminale. Pas analizimit të kësaj të drejte të kryesit të miturit të veprës penale u vendos që me kërkesë të miturit, përfaqësuesit të tij ligjor gjykata do të lëshoj vërtetimin për të kaluarën e tij kriminale.

Sipas dispozitave të KDM, kryesit të mitur të veprës penale mund të shqiptohet dënim apo masë (edukuese apo të diversitetit). Dispozitat e kapitullit XXXV të KPPK për marrjen e vendimit për shlyerjen e dënimit nga evidenca, mund të aplikohen për dënimin e shqiptuar të miturit por jo edhe për masat pasi që ato nuk regjistrohen në evidencën e të dënuarve. Andaj, nuk ka pengesë që edhe kryesi i mitur i veprës penale të cilit i është shqiptuar dënim, të kërkojë shlyerjen e dënimit, nëse për këtë janë plotësuar kushtet ligjore, mirëpo, këtë mund të bëjë para se të mbushë moshën 21 vjeçare, sepse këto shënime fshihen me automatizëm, në kohën kur ai e mbush këtë moshë.

(Udhëzimi i miratuar në seancën e përgjithshme të Gjykatës Supreme, i mbajtur më 11.03.2019)



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Mbledhja e përgjithshme e Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, pas shqyrtimit të udhëzuesit për Politikë Ndëshkimore në Kosovë, në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit nr.03/L-199 për Gjykatat, më datë 15 shkurt 2018, me shumicë votash, miratoi këtë:

UDHËZIM

POLITIKA NDËSHKIMORE NË KOSOVË

Hyrje

Praktika e politikës ndëshkimore nëpër gjykatat e Kosovës i është nënshtruar një vështrimi shumë të kujdesshëm që nga miratimi i Kodit Penal⁸⁷ (KP ose “Kodi”) dhe Kodit të Procedurës Penale⁸⁸ (KPP). Me ngritjen e efikasitetit të gjykatave përmes njohjes më të mirë të Kodeve, po rritet edhe numri i vendimeve të nxjerra. Përderisa adaptimi me Kodet është pozitiv në administrimin e drejtësisë, numri në rritje i vendimeve ka rezultuar në disa trende të cilat shfaqin mangësi serioze në mënyrën në të cilën gjykatat i qasen caktimit të dënimeve, profesionalizmin e gjykatave në nxjerrjen e mendimeve dhe ndikimin përfundimtar të tyre mbi të akuzuarit. Përfundimisht, koha për të bërë ndryshime dhe për të zbatuar reforma në proces është tani para se problemet të bëhen tepër të rrënjosura. Qëllimi i këtij udhëzuesi është që të ofrojë pikëpamje të zgjeruar të ligjeve aktuale të dënimeve, të trajtojë problemet të cilat përmenden shpeshherë dhe të ofrojë një qasje uniforme.

Lexuesi duhet ta ketë të qartë se këto nuk janë udhëzime ligjërish të detyrueshme. Këto nuk përcaktojnë dispozita detyruese gjatë caktimit të dënimit. Megjithatë, duke marrë parasysh se dallimet e paarsyetuara dhe perceptimet e padrejtësisë mund ta sjellin sistemin e drejtësisë

⁸⁷ Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr. 04/L-02, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.19/13korrik 2012, Prishtinë.

⁸⁸ Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, Kodi nr. 04/L-123, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.37/28 Dhjetor 2012, Prishtinë.

penale në pikëpyetje, Këshilli i Evropës në rekomandimet e tij mbi konsistencën e politikës ndëshkimore këshillon që shtetet, duke marrë parasysh parimet e tyre kushtetuese dhe traditat juridike, dhe në veçanti pavarësinë e gjyqësorit, të marrin masat e nevojshme për të shmangur dallimet e paarsyetuara në caktimin e dënimeve.

Andaj këto udhëzime paraqiten si mjet në këtë drejtim dhe nuk do duhej që thjeshtë të hidhen poshtë apo të cilësohen si ndërhyrje në diskrecion. Ato i shërbejnë një qëllimi të qartë dhe të lavdërueshëm. Thelbi i udhëzuesit është që të strukturohet diskrecioni gjyqësor – e jo që të hiqet ai. Në fund të fundit, caktimi i dënimit gjithmonë kërkon një element të gjykimit personal, por ai gjykim do duhej të ushtrohej në kuadër të një kornizetë parimeve që është e qartë, koncize dhe e parapërcaktuar. Kjo rezulton në qasje dhe rezultate konsistente të cilat janë arsyeshëm të parashikueshme.

Këto udhëzime paraqesin mjete të dobishme për gjykatën në vlerësimin e një sërë rrethanash individuale të të pandehurve si dhe një kornizë për vlerësimin e vendimit mbi dënimin. Ato paraqesin një udhërrëfyes për qasjen, një metodë për të trajtuar në mënyrë gjithëpërfshirëse dispozitat përkatëse të Kodit, dhe një format të sugjeruar për mbledhjen e provave për caktimin e dënimit dhe përpilimin e opinioneve. Ato gjithashtu ofrojnë një listë indikative të rrethanave që duhet të shfrytëzohen nga gjyqtarët për zbutjen dhe ashpërsimin e dënimit; së bashku me një shtjellim të peshës që rrethanat e tilla do duhejtë kishin në dënimin përfundimtar. Nëse ndiqen, këto udhëzime jo vetëm që do të përmirësojnë profesionalizmin e gjykatave, por ato do të përmirësojnë edhe respektimin etë drejtave të njeriut në gjykatat e Kosovës në përgjithësi.

Ndonëse Udhëzuesi paraqet hap të rëndësishëm drejt një qasjeje më gjithëpërfshirëse në caktimin e dënimeve dhe rrethanave që merren parasysh në këtë proces, ky nuk do duhej të konsiderohet si dokument jofleksibil që është shkruar në gur. Gjykatat duhet të ndërmarrin hapa për të ndryshuar dhe përshtatur këto udhëzime kur ndryshohet ligji apo kur paraqiten rrethana dhe praktika të paparashikuara. Sugjerohet që në të ardhmen të themelohet një komision për dënime i cili rregullisht do të vlerësonte zbatueshmërinë e udhëzimeve dhe do të bënte ndryshimet e nevojshme.

Në fund, ky doracak bazohet në parimet dhe veprat e përcaktuara në KP dhe KPP të hartuar në vitin 2012, respektivisht 2013. Veprat e përcaktuara jashtë këtyre ligjeve kryesisht nuk janë përdorur si shembuj. Megjithatë, dispozitat e kodeve që kanë të bëjnë me dënimet zbatohen për të gjitha veprat penale, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj.

KAPITULLI I

POLITIKA NDËSHKIMORE NË KOSOVË: Problemet e identifikuara

1.1 Pabarazia apo dallimi në dënime

Sundimi i ligjit, në rend të parë, nënkupton ekzistimin dhe zbatimin efektiv të ligjeve jodiskriminuese dhe të shpallura publikisht. Për këtë qëllim, është detyrë e secilit shtetpër të themeluar institucione të cilat mbrojnë sistemin juridik, përfshirë gjykatat, prokuroritë dhe policinë. Këto institucione edhe vetë janë të detyruara për të respektuar të drejtat e garantuara të njeriut, ashtu siç parashihen në traktatet universale dhe rajonale përmbrojtjen e të drejtave të njeriut, siç është Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike (KNDCP), Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe konventat etraktatet tjera ndërkombëtare. Një prej parimeve themelore të Kartës së Madhe (Magna Karta) për gjyqtarët thotë: "Gjyqësori është një nga tri pushtetet e cilitdo shteti demokratik. Misioni i tij është që të garantojë sundimin e ligjit dhe, rrjedhimisht, të sigurojë zbatimin e duhur të ligjit në mënyrë të paanshme, të drejtë dhe efektive".⁸⁹

E drejta për gjykim të drejtë ndërlidhet me administrimin e drejtësisë në kontekst civil dhe penal. Është me rëndësi të kuptohet që në fillim se administrimi i duhur i drejtësisë ka dy aspekte: institucional (p.sh. pavarësia dhe paanshmëria e gjykatave) dhe procedural (p.sh. korrektësia në seancë dëgjimore). Parimi i gjykimit të drejtë nënkupton një mori të drejtash individuale të cilat garantojnë proces të drejtë ligjor që nga momenti i ngritjes së dyshimit deri në ekzekutimin e aktgjykimit. Të gjithë personat duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë para gjykatave dhe tribunaleve dhe kanë të drejtë në gëzimin e garancive minimale të gjykimit të drejtë në mënyrë plotësisht të barabartë.⁹⁰

Rastet identike që i shkaktojnë dëm shoqërisë duhet të nxisin reagime identike në emër të shoqërisë, si pjesë e konceptit të barazisë para ligjit. Pabarazitë krijojnë pasiguri dhe dëmtojnë qartësinë në zbatueshmërinë e kontrollit socio-juridik...inkurajojnë kryerjen e veprave penale. Kontrolli socio-juridik zbatohet në mënyrë efektive vetëm kur individët ekanë të qartë dhe e dinë me siguri se çfarëdo dëmi ndaj shoqërisë do të trajtohet në mënyrë adekuate dhe proporcionale. Kur individit e din se kryerja e veprës penale do të pasojë me një procedurë penale e cila do të ketë një përfundim të caktuar, ai mund të zbrapset nga kryerja e saj.

⁸⁹ Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropian, Karta e Madhe e Gjyqtarëve, Parimet Themelore, Sundimi i Ligjit dhe Drejtësia, Strasburg, 17 nëntor 2010.

⁹⁰ Kuptimi i të drejtave të njeriut, redaktuar nga Qendra Evropiane për Trajnim dhe Hulumtim për të Drejtat e Njeriut Uofgang Benedek, Manuali për Edukimin mbi të Drejtat e Njeriut (fq. 205)

Vendimet e ndryshme nga gjykatat në raste të ngjashme shpjen në një kulturë shoqërore ku zbatimi i ligjit de jure dallon nga zbatimi de fakto. Kur një panel gjykues është jashtëzakonisht i butë me kryerësit ndërsa paneli tjetër shqipton dënime të ashpra në këtë mekanizëm i cili parandalon kryerësit nga përsëritja e veprës, identiteti i panelit bëhet faktor dhe kryerësit do të bëjnë përpjekje për t'u gjykuar nga njëri panel e jo nga tjetri.⁹¹

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në vendosjen e një prej rasteve të saj, kishte gjykuar si në vijim:

"Vendimmarrja nga gjykatat e rregullta në çështje ligjore që janë tërësisht të njëjta dhe mos mundësia dhe mos dëshira për ta krijuar një praktikë gjyqësore konsistente cenon rëndë parimin e sigurisë juridike si një nga parimet bazë të sundimit të së drejtës, prandaj, nuk ka dyshim që vendimmarrja në këto rrethana përbën shkelje të nenit 6 të KEDNJ dhe nenit 31 të Kushtetutës (shih: Rasti Beian kundër Rumanisë, 30658/05, 2007, GJEDNJ)".⁹²

Në kontekst të dënimeve, pabarazia para ligjit manifestohet përmes pabarazisë apo dallimeve në dënime. Pabarazia kryesisht përkufizohet si formë e trajtimit të pabarabartë pa shpjeguar arsyet dhe si pasojë është e papërshtatshme, e padrejtë dhe e pafavorshme. Thënë shkurt, koncepti është mjaft i thjeshtë – "në përgjithësi kryerësit do duhej të prisnin që veprat e të njëjtës rëndësi, të kryera në rrethana të ngjashme nga kryerës të krahasueshëm të mbartnin pasojat të njëjta".⁹³ Në kontekst të parimeve juridike, trajtimi i pabarabartë i individëve të inkriminuar çenon Kushtetutën e Kosovës dhe bie ndesh me një mori të garancive universale dhe themelore për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.


Fatkeqësisht, ky parim nuk duket se është duke u respektuar në Kosovë në ndonjë mënyrë domethënëse. Kritikën e vazhdueshme lidhur me dënimet tregojnë se të pandehurit po dënohen bazuar në kulturat lokale apo rajonale. Rrjedhimisht gjykata në Gjilan mund të shqiptojë dënim dukshëm më të ndryshëm nga gjykata në Prishtinë. Ndonëse vepra është e njëjtë dhe kryerësit e ngjashëm, ata trajtohen ndryshe. Dëshmitë e pavërtetuara tregojnëse dallime të tilla në shkallë të madhe ka edhe brenda vetë gjykatave. Kjo tregon se të pandehurit nuk po trajtohen në mënyrë të barabartë para ligjit.

Zhvillimi i udhëzimit është hap thelbësor në arritjen e qëllimit të harmonizimit më të madh të dënimeve. Se deri në ç'masë mund ta arrijë këtë qëllim udhëzuesi, varet nga koncepti i konsistencës në qasje. Në formën aktuale të legjislacionit ekzistues me të cilin parashihen dënimet, dispozitat janë shumë të gjera dhe ofrojnë pak apo nuk ofrojnë fare udhëzime.

⁹¹ Hallevey, Gabriel. E drejta për t'u dënuar: dënimi modern doktrinal. Springer Science & Business Media, 2012.

⁹² Aktgjykimi, Prishtinë, 20 korrik 2012, Nr. Ref.: AGJ 285/12, Rasti nr. KI 04/12, Parashtruesi Esat Kelmendi (par.26).


⁹³ Departamenti i Drejtësisë, "Konsultimi mbi mekanizmin e udhëzuesit të dënimeve", 2010.



Në vend të kësaj, gjykatës i janë dhënë kufijtë të gjerë të dënimit të mundshëm pa ndonjë udhëzim lidhur me pikënisjen; rrethanat e përgjithshme rënduese dhe lehtësuese për tu marrë parasysh pa ndonjë udhëzim se si t'i vlerësojë, peshojë dhe/ose krahasojë ato; dhe mundësia për t'i korrigjuar dënimet, gjiashu me pak udhëzime për zbatimin e tyre. Gjersakjo i jep gjykatave diskrecion të konsiderueshëm, një gjë e tillë nuk e përmirëson harmonizimin dhe përderisa ndiqen parimet e përgjithshme, ka pak bazë për ta kritikuar qasjen e gjykatës. Siç ilustron në Figurën 1.1, rezultatet e dënimit janë krejtësisht të rastësishme në kuptim të mënyrës dhe vendit të kryerjes së veprës. Secila gjykatë krijon qasjen e saj, e cila është në pajtim me atë që shkruan në ligj, dhe rezultati është një qasje shpërqendruar.

Në anën tjetër, përcaktimi i një qasjeje të definuar më ngushtë me inkurajim të fuqishëm të gjykatave për ta ndjekur atë, e ngushton fushën e dënimeve të mundshme. Ajo sërish lejon rezultate të ndryshme në dënime, porvetëm në rrethana kur gjykata është në gjendje të artikulojë qartë rrethanat të cilët janë përtej rrethanave tipike apo të zakonshme të të pandehurit.

Kjo ilustron nga Figura 1.2, e cila e shfaq konceptin në praktikë.



Këtu struktura dhe konsistenca në qasje shërben për të ngushtuar fushën e dënimeve të mundshme. Kjo strukturë nuk ua heq diskrecionin gjykatave, por përmes zbatimit uniform të procedurave dhe rrethanave, ato që fillimisht janë dukur si të ndryshme në karakter do të duken në fakt mjaft të ngjashme. Rezultati përfundimtar është një sërë dënimesh të cilat janë të përafërta për një vepër të caktuar të kryer në rrethana të ngjashme, ndërsa në situatat të cilat nuk janë të ngjashme por parashohin, për shembull, më shumë rrethana rënduese apo lehtësuese, gjykata prapë e ka mundësinë që të lëvizë sipas nevojës brenda kufijve të dënimit të paraparë.

Në rastin Mucic dhe të tjerët, Trupi Gjykes kishte dhënë një deklaratë shumë të plotë lidhur me arsyen për konsistencë në caktimin e dënimit: *"Një prej elementeve themelore në çdo sistem të arsyeshëm dhe të drejtë të drejtësisë penale është konsistenca në dënime. Ky është një reflektim i rëndësishëm i nocionit të drejtësisë së barabartë. Përvoja e shumë juridiksioneve vendore përgjatë viteve ka qenë e tillë që besimi i publikut mund të zbehet nëse këto institucione krijojnë perceptimin e padrejtësisë duke lejuar mospërputhje të konsiderueshme në dënimin e kryerësve të ndryshëm, kur rrethanat e veprave të ndryshme dhe të kryerësve janë mjaftueshëm të ngjashme sa që dënimi i shqiptuar do të pritej të ishte gjithashtu i ngjashëm. Kjo nuk nënkupton se trupi gjykes është i detyruar të shqiptojë të njëjtin dënim në një rast sikurse dënimin e shqiptuar në rastin tjetër vetëm për shkak të ngjashmërisë së rrethanave ndërmjet tyre. Me rritjen e numrit të dënimeve të shqiptuara nga Tribunali, eventualisht do të paraqiten edhe kufij apo struktura të dënimeve të shqiptuara në raport me personat kur rrethanat e tyre apo rrethanat e veprave të tyre janë kryesisht të ngjashme. Kur të paraqitet një kufi apo strukturë e tillë, trupi gjykes do të jetë i obliguar që t'i shqyrtojë ata kufij apo strukturë të dënimeve, pa qenë i detyruar nga ajo, në mënyrë që të siguroj se dënimi që shqipton të mos prodhojë pabarazi të paarsyetuar e cila mund të zbeh besimin e publikut në integritetin e administrimit të drejtësisë penale nga ana e Tribunalit".⁹⁴*

Përfundimisht, udhëzimi ndihmon në adresimin e kësaj çështjeje duke ofruar metoda të definuara më qartë për caktimin e dënimeve në raste të caktuara dhe ofron një mjet për nxjerrjen e rezultateve të ngjashme në rrethana të ngjashme. Konsistenca në qasje kërkon që të ketë një qasje unike dhe konsistente në caktimin e dënimeve në të gjitha rastet. Prandaj, diskrecioni në caktimin e dënimit duhet të ushtrohet në mënyrë parimore. Duhet të ketë një qasje koherente gjyqësore në ushtrimin e diskrecionit në caktimin e dënimit, e cila kërkon që të gjitha dënimet të bazohen në standarde të përbashkëta – parimet themelore të përgjithshme – të cilat zbatohen në mënyrë uniforme ndaj fakteve të secilit rast.⁹⁵ Trajtimi i këtyre pabarazive apo dallimeve është i nevojshëm për të qenë në pajtim me Kushtetutën e Kosovës dhe për të përmbushur obligimet që dalin nga ajo në raport me instrumentet ndërkombëtare. Neni 53 parasheh se *"Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut"*.

⁹⁴ Rasti Nr.IT-96-21-A, Aktgjykimi, Prokurori kundër Zejnil Delalic, Adravko Mucic, Hazim Delic dhe Esad Landzo, Tribunali Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavi, (20 shkurt 2001), par.756-757.

⁹⁵ Ashworth. A., Drejt standardeve evropiane të dënimit, *Revista Evropiane për Politika Penale dheHulumtim*, 1994, fq. 9.

Në juridiksionet ku fillimisht ka pasur hezitime dhe shqetësime lidhur me kufizimin e pavarësisë, gjykatat shpesh e kanë përqafuar këtë praktikë. Për shembull, në lidhje me Udhëzimet për Caktimin e Dënimit të Gjykatave të instancës së parë të Mbretërisë së Bashkuar, një gjyqtar ka komentuar: "*Jeta si gjyqtar pa udhëzime për caktimin e dënimit tani duket e paimagjinueshme. Më tepër se çfarëdo tjetër, ato ia mundësojnë të gjithëvënë gjykatë – përfshirë të pandehurit dhe mbrojtësit të tij – që të shohin një proces transparent të caktimit të dënimit... Këto udhëzime, me qasjen e tyre të strukturuar ndaj seriozitetit të veprës, fajësisë dhe dëmit, [janë] të paçmueshme në sqarimin e çështjeve".⁹⁶*

1.1 Vlerësimi joadekuat i rrethanave rënduese/lehtësuese

Një problem tjetër ka të bëjë me dështimin e gjykatave që të përshkruajnë në mënyrë adekuate arsyet për shqiptimin e dënimit të caktuar. Kjo përfshin si procesin e ndjekur nga gjykata ashtu edhe arsyetimin lidhur me gjetjen apo ekzistimin e rrethanës së caktuar lehtësuese apo rënduese. Siç theksohet nga Këshilli i Evropës, "*gjykatat duhet, në përgjithësi, të cekin arsye konkrete për shqiptimin e dënimeve*".⁹⁷

Në kuptim të gjerë, Neni 6 i KEDNJ kërkon që gjykatat të nxjerrin aktgjykime të arsyetuara në procedurë civile dhe penale. Gjykatat nuk janë të detyruara që të japin përgjigje të detajuara në secilën pyetje, por nëse një parashtrësë është thelbësore për rezultatin përfundimtar të rastit, atëherë gjykata duhet ta trajtojë atë në mënyrë specifike në aktgjykimin e saj.

Për shembull, në rastin *HiraBalani kundër Spanjës*,⁹⁸ parashtruesi i kërkesës ka dorëzuar një parashtrësë në gjykatë për të cilën kërkohet përgjigje specifike dhe e menjëhershme. Duke mos trajtuar çështjen në mënyrë adekuate dhe specifike, ishte e pamundur që të përcaktohet nëse gjykata thjeshtë kishte neglizhuar trajtimin e çështjes apo nëse kishte për qëllim që ta hedhte poshtë. Qoftë edhe nëse qëllimi kishte qenë që ta hedhte poshtë, pala e kishte të pamundur t'i kuptonte shkaqet për hedhje. Në këtë rast ishte konstatuar sekishte shkelje të nenit 6 (1).

Mund të thuhet se, përveç vendimit lidhur me fajësinë, për gjykatën nuk mund të ketë vendim më të rëndësishëm sesa vendimi mbi dënimin. Andaj është kërkesë absolute që të jepet shpjegim i mjaftueshëm lidhur me atë se si gjykata ka arritur deri te dënimi i shqiptuar në mënyrë që të njoftohet i pandehuri dhe të mbrohen të drejtat e tij. Për më tepër, në këtë mënyrë parandalohet çfarëdo pretendimi për trajtim diskriminues. Siç theksohet nga GJEDNJ në rastin Lithgov:⁹⁹ "*për qëllim të nenit 14, dallimi diskriminues në trajtim është diskriminues nëse ky dallim nuk ka arsyetim objektiv apo të arsyeshëm, pra nëse nuk ndjek ndonjë qëllim legjitim*".

⁹⁶ Tiede Lydia Brashear, OSBE Shkup, Maqedoni, Analizë e politikave ndëshkimore të Maqedonisë dhe rekomandime për të ardhmen: Drejt një sistemi më të harmonizuar, (Dhjetor 2012), Shtojca 6: Përdorimi i udhëzuesve për dënime nga Anglia dhe Uells. Fq. 40.

⁹⁷ Këshilli i Evropës, Rekomandimi Nr. R(92)17 i Këshillit të Ministrave të Shteteve Anëtare Lidhur me Harmonizimin e Dënimeve, 19 tetor 1992.

⁹⁸ Rita Hiro Balani kundër Spanjës, Appl. Nr. 18064/91, Aktgjykimi i datës 9 dhjetor 1994; citohet gjithashtu edhe në Mendimin Mospajtuës të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në Rastin Nr.KI 55/09, Shqyrtimi Kushtetues i Vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Nr. 2407/2006, 30 shtator 2009, paragrafi 26.

⁹⁹ Lithgov dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar, Kërkesa nr. 9006/80; 9262/81; 9263/81; 9265/81; 9266/81; 9313/81; 9405/81, Strasburg, 8 korrik 1986.

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë ("OSBE") Misioni në Kosovë ka bërë një studim të vendimeve të gjykatave dhe ka publikuar rezultatet e saj në korrik të vitit 2010 në një raport të titulluar "Vlerësimi joadekuat i rrethanave lehtësuese dhe rënduese nga gjykatat". Raporti përshkruan një numër problemesh të përhapura lidhur me dënimet:

- Në përgjithësi, gjykatat nuk kanë dhënë arsye të mjaftueshme, apo në disa raste nuk kanë dhënë arsye fare, për gjetjen e ekzistimit të ndonjë rrethane lehtësuese. Ndonëse gjykatat kanë konstatuar, për shembull, se rrethanat personale të tëpandehurit janë rrethanë lehtësuese, ato nuk kanë shpjeguar se cila provë e mbështet një përfundim të tillë.
- Gjykatat shpesh janë shmangur nga dënimi minimal i paraparë duke cekur rrethana lehtësuese të cilat nuk gjenin mbështetje në asnjë provë në posedim të tyre.
- Gjykatat rregullisht kanë cekur rrethana lehtësuese, sërish pa ndonjë shpjegim, të cilat qartazi ishin jorelevante për zbutjen e dënimit të caktuar.¹⁰⁰

Këto mangësi sistematike në praktikat ndëshkimore janë të rëndësishme dhe dëshmojnë një mungesë orientimi nga ana e gjykatave. Në thelbin e saj, dështimi për të shpjeguar në mënyrë adekuate bazën për caktimin e dënimit paragjykon të dyja palët. Për të akuzuarin, mosdhënia e një arsyetimi të qëndrueshëm për rrethanat rënduese rezulton në një dënim të pambështetur në fakte. Kjo është padrejtësi. Gjithashtu, edhe shqiptimi i një dënimi më të ultë bazuar në rrethana lehtësuese të pambështetura bën që vendimi t'i nënshtrohet ankesës e cila do të mund të shmangej dhe si rrjedhojë të pandehurit i mohohet e drejta për proces të drejtë e të shpejtë. Ngjashëm me këtë, prokurorisë dhe publikut të gjerë gjithashtu i mohohen të drejtat kryesore të shoqërisë lidhur me dënimin pasi që tëpandehurit i shqiptohet dënim më i ultë se që do t'i ishte shqiptuar po t'i përmbahej gjykata detyrimit të saj për t'ia përshtatur dënimin vetëm atyre rrethanave të cilat janë provuar. Problemi rëndohet edhe më shumë kur rrethana lehtësuese të paarsyetuara përdoren për të arsyetuar një dënim nën minimumin e dënimit të paraparë për atë vepër.

Mosdhënia e arsyetimit gjithashtu është një tregues se gjykata nuk e ka kryer në mënyrë adekuate detyrën e saj sipas ligjit. Për shembull, neni 74 i KP thotë qartë se gjykata "*merr parasysh por nuk kufizohet në*" rrethanat e përcaktuara rënduese dhe lehtësuese. Nëse gjykata thjeshtë përsërit gjuhën e kodit për ndonjë rrethanë të caktuar lehtësuese pa dhënë arsyetim për aplikimin e saj, atëherë mund të përfundohet se gjykata ka dështuar që vërtetë të vlerësojë atë rrethanë. Nëse rrethanat të cilat janë cekur në mënyrë specifike janë të mangëta, atëherë mund të përfundohet se ka gjasa të mëdha që gjykata nuk i ka shqyrtuar dhe vlerësuar të gjitha rrethanat ashtu siç kërkohet me ligj.

Gjetja e ndonjë rrethane rënduese apo lehtësuese e cila nuk mbështetet me asnjë fakt në shkresa gjithashtu është shkelje e ligjit. Neni 8, paragrafi 2 përcakton që "*Gjykata merr vendim në bazë të provave që shqyrtohen dhe verifikohen në shqyrtim gjyqësor*". Për më tepër, neni 361 qartazi thotë se "*Gjykata e bazon aktgjykimin vetëm në faktet dhe provat e proceduara në shqyrtim*

¹⁰⁰ Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë "Vlerësimi joadekuat i rrethanave lehtësuese dhe rënduese nga gjykatat", korrik 2010.

gjqësor". Rrjedhimisht dështimi i gjykatës për të paraqitur bazën faktike për vërtetimin e ndonjë rrethane të caktuar mund të shihet si aktgjykim i bazuar në fakte jashtë shkresave të lëndës apo i pabazuar në fakte. Kjo rezulton në vendime të cilat duken arbitrare.

Disa mund të konsiderojnë se argumentet e lartpërmendura nuk paraqesin kërkesë strikte sipas ligjit. Mund të argumentojnë se shpallja publike e aktgjykimit i nënshtrohet kriterëve nga neni 366, paragrafi 2, i cili thotë se gjykata "*shkurtimisht prezenton arsyet e aktgjykimit*". Por përdorimi i shprehjes shkurtimisht nuk e liron gjykatën nga detyrimi për të cekur arsyet të cilat mbështesin vendimin e gjykatës lidhur me fajësinë e të pandehurit dhe dënimin e shqiptuar. Neni 370, paragrafi 8, sqaron se në arsyetimin me shkrim gjykata duhet të përfshijë "*rrethanat të cilat gjykata i ka marr parasysh me rastin e caktimit të dënimit*". Nuk ka asnjë dispozitë në KPP e cila e liron apo e minimizon detyrimin e gjykatës për të ofruar arsyetim të plotë lidhur me vendimin mbi dënimin.

Zbutja e dënimit pa arsyetim, fatkeqësisht, nuk është i vetmi problem kur bëhet fjalë për zbutjen e dënimeve. Më 12 janar 2015, kryetari i Gjykatës Supreme kishte nxjerrë një "Qarkore për Zbutjen e Dënimit" ku shprehte shqetësime lidhur me dënimet e vazhdueshëm të kryerësve madje edhe nën kufijtë e zbutjes së dënimeve të parapara në nenin 76. Siç e përshkruante gjykata, gjyqtarët po zëvendësonin kufizimet e parapara me ligj me vullnetin personal të tyre – gjë që rezultonte në dënimet të paligjshme dhe arbitrare. Kur gjykatat kritikohen për paaftësi në zbatimin e parimeve themelore të ligjit në caktimin e dënimit, atëherë qartazi ka nevojë për udhëzime shtesë.

Krijimi i udhëzuesit për politikën ndëshkimore do të luajë një rol të rëndësishëm në adresimin e këtyre problemeve. Së pari, udhëzimet shtesë lidhur me zbatimin e dispozitave ekzistuese do t'i japin gjykatave shqyrtuese standarde më të qarta për të vlerësuar mjaftueshmërinë e vendimit. Së dyti, përkufizime dhe shembuj më të fuqishëm të rrethanave rënduese dhe lehtësuese do t'i japin gjykatave mundësi më të shumta për të shpjeguar logjikshëm arsyetimin e tyre. Së fundi, miratimi i udhëzimeve do t'i dërgojë mesazh të qartë gjykatave se vlerësimi i rrethanave jorelevante dhe/ose dështimi për të mbështetur gjetjen e rrethanave nga faktet në shkresa është i paligjshëm dhe përbën shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale.

1.1 Transparenca, legaliteti dhe opinioni publik

Praktikat aktuale të dënimeve gjithashtu sjellin deri te ulja e transparencës, cenojnë parimin e legalitetit dhe kontribuojnë në masë të madhe në opinionin negativ për gjyqësorin. Që të tre këta faktorë e zbehin edhe më tej sundimin e ligjit.

1.3.1 Transparenca

Dështimi i praktikës aktuale ndikon negativisht në transparencën e përgjithshme në sundimin e ligjit. KP dhe KPP kanë paraparë kriteret e cilat ngrisin transparencën e përgjithshme të

vendimmarrjes gjyqësore – siç është natyra publike e procedurave gjyqësore dhe detyrimi për shpalljen publike të aktgjykimeve. Publikimi i ligjeve, procedurat e qarta për zbatimin e shqyrtimit gjyqësor dhe kufijtë e dënimeve specifike gjithashtu luajnë një rol të madh në këtë proces. Informacionet mbi funksionimin e sistemit të drejtësisë dhe prania e publikut në procedurë gjyqësore kontribuojnë në pranueshmërinë shoqërore të gjyqësorit. Gjyqtarët sigurojnë transparencën përmes dëgjimeve publike dhe duke dhënë arsyet e tyre për vendimet e marra ndërkohë që ruajnë konfidencialitetin e kërkuar për të respektuar të pandehurin apo për shkak të nevojës për rend publik.¹⁰¹ Në përgjithësi, koncepti është se qasja dhe informimi për funksionimin e sistemit do të rrisë të kuptuarit e përgjithshëm të sistemit. Kjo gjithashtu përmirëson aftësinë e publikut dhe institucioneve përkatëse qeveritare për të monitoruar, vlerësuar dhe, nëse është nevoja, për të ndryshuar sistemin ekzistues juridik.

Megjithatë praktikat aktuale të dënimeve nuk e mbështesin transparencën – ato e ulin atë. Palët, publiku dhe gjykata e shkallës më të lartë nuk mund të kuptojnë bazën për caktimin e një dënimi të caktuar nëse gjykata nuk i referohet fakteve përkatëse. Me dhënien e arsyeve të mjaftueshme dhe ndjekjen e procedurës së paraparë, gjykata dhe procesi bëhen më transparent dhe më të qasshëm.

1.3.1 Parimi i legalitetit

Vendimet aktuale të dënimeve gjithashtu prekin edhe parimin e legalitetit. Në përgjithësi, parimi nënkupton që ligji duhet të jetë i qartë për palët, në veçanti për të pandehurin, dhe që rregullat duhet të jenë të përcaktuara paraprakisht. Rritja e qartësisë së ligjit shpie deri te rritja e korrektësisë së përgjithshme të procedurës për palët e interesuara si dhe shpie deri te rritja e drejtësisë në përgjithësi. Kjo gjithashtu vë një shkallë të parashikueshmërisë së rezultatit përfundimtar dhe i mundëson të akuzuarit qasje në mekanizmat të cilët sistemi i drejtësisë i shfrytëzon për llogaritjen e dënimeve. Kur individit ka qasje në këtë informacion, atëherë ai mund të parashikojë natyrën dhe kohëzgjatjen e dënimit që do të ishte i përshtatshëm për veprën penale.

Parashikueshmëria dhe parimi i legalitetit gjithashtu e rrisin efikasitetin e sistemit të drejtësisë – një gjë kjo shumë e nevojshme në Kosovë. Për shembull, KPP është mjaft i qartë në përcaktimin e detyrimit për dorëzimin e provave të pandehurit para shqyrtimit gjyqësor. Kjo i mundëson të pandehurit për të bërë një vlerësim relativisht adekuat lidhur me gjasën e tij për t'u liruar në shqyrtim gjyqësor. Kodi gjithashtu parasheh kufizime, sipas nenit 233, për negocimin e marrëveshjeve mbi pranim të fajësisë të cilat mundësojnë procedura të përshpejtuara në shkëmbim të një dënimi më të butë. i pandehuri ka mundësi të merr një dënim të njohur për të në shkëmbim të pranimit të fajësisë. Këto dy dispozita krijojnë një proces për të përmirësuar shkallën e lëndëve të kryera. Praktika aktuale nuk jep mundësi për të vlerësuar gjasën e një dënimi të caktuar

në fund të një gjykimi i cili rezulton me aktgjykim dënues. **Me praktika arbitrare – siç është**

¹⁰¹ Rrjeti Evropian i Këshillave për Gjyqësor (RREKGJ), Raporti i Etikës Gjyqësore 2009-2010, fq. 9

paqartësia se ku të përcaktohet pikënisja, shmangia nga dënimet minimale pa arsytim dhe vlerësimi i rrethanave lehtësuese të cilat nuk mbështeten nga shkresate lëndës – nuk ka motivim për të përfituar nga marrëveshja mbi pranimin e fajësisë. Thjeshtë nuk ka ndonjë arsye logjike për të mos e provuar shqyrtimin gjyqësor, i cili mund të rezultojë në aktgjykim lirues, dhe pastaj për të mos e provuar vendimin mbi dënimin, i cili ka gjasa të fuqishme që të jetë më i ultë se dënimi i ofruar në marrëveshje mbi praninë të fajësisë.

Së fundi, zbehja e këtij parimi nga praktikat aktuale dëmton legjitimitetin e sistemit të drejtësisë si tërësi dhe zvogëlon në mënyrë drastike efikasitetin e gjyqësorit. Së bashku me rritjen e pasigurisë dhe natyrën arbitrare të vendimeve, sistemi ka nevojë për udhëzime shtesë. Kjo nuk do të thotë se nevojitet siguri absolute sepse praktikat e dënimitende kërkojnë fleksibilitet për të trajtuar situata anormale. Por ofrimi i udhëzimeve mund të përmirësojë situatën pa ndonjë kufizim të padrejtë. Duke sqaruar procedurat dhe duke siguruar që ato të ndiqen në mënyrë harmonike, të pandehurit dhe shoqërisë në tërësi i jepen mjetet për të kuptuar dhe "njohur" sistemin juridik, dhe rrjedhimisht përmirësohet efikasiteti i përgjithshëm i sistemit.

1.3.1 Opinioni publik

Së fundi, problemet nuk janë të kufizuara vetëm te palët; ato kanë implikime më të gjera për shoqërinë në përgjithësi. Një gjykatë profesionale ka ndikim përtej kufijve të gjykatores së saj. Opinione dhe profesionalizmi i tyre do të ndikojnë në perceptimin e qytetarëve të Kosovës për gjyqësorin. Vendimet për dënimin kanë shumë rëndësi për shoqërinë si tërësi dhe mënyra se si ajo e sheh gjyqësorin në pjesë të madhe ka të bëjë mënyrën e si ajo e sheh aftësinë e gjykatës për të ndarë drejtësi për ta, për të dashurit e tyre dhe për miqtë e tyre. Pakënaqësia nënkupton se publiku nuk beson se ata jetojnë në një shoqëri të drejtë – një shoqëri ku ata të cilët shpallen fajtor për vepër penale dënohen ose rehabilitohen dhe viktimave iu jepet një lloj drejtësie. Besimi në paanshmërinë e sistemit të drejtësisë në fund do të përkthehet në një ndjenjë sigurie dhe besimi dhe do të përforcojë në mënyrë të dukshme parimet e sundimit të ligjit.

Në prill të vitit 2015, UNDP së bashku me USAID-in kishte publikuar rezultatet e "Raportit të Pulsit Publik-IX" të cilat, ndër të tjera, përfshinin një matje të përgjithshme të kënaqësisë me punën e gjyqësorit. Rezultati tregonte se shumë pak nga të anketuarit ishin të kënaqur me punën e sistemit gjyqësor dhe prokurorial.

Duke harmonizuar politikat ndëshkimore në një strukturë më të formalizuar dhe duke rritur kërkesat për të mbështetur me fakte zbutjen e dënimit, gjykatat nuk do të jenë në gjendje që t'u caktojnë dënime të pandehurve pa arsytim. Kjo mund të rezultojë në rritjen e nivelit të përgjithshëm të dënimeve për të pandehurit, e që pastaj mund të rrisë edhe nivelin e besimit të publikut. Të paktën, kjo do të sjell deri te nxjerrja e arsytimeve të logjikshme dhe të mbështetura në fakte. Rezultati së paku do të jetë i mbrojtshëm. Derinë një shkallë kjo do të rrisë besimin e publikut në gjyqësor – të paktën do të rrisë profesionalizmin e përgjithshëm të gjykatave dhe do të ofrojë një mjet për publikun dhe mediat që të edukohen në mënyrë më të thukët lidhur me mënyrën se si është arritur deri te vendimi për dënimin e caktuar. Një vendim

i plotë dhe i arsyetuar mirë, i mbështetur me fakte, ka shumë më pak gjasë që të kritikohet si vendim arbitrar dhe si rezultat i ndërhyrjeve të paligjshme apo ndërhyrjeve të jashtme.

1.4. Vendimet gjyqësore arbitrare

Fusha e fundit problematike është ndoshta edhe më e vështira për t'u trajtuar por gjithashtu ka mangësi rrënjësore në këtë drejtim. Argumenti është se dënimet, të paktën për disa vepra, janë tepër të ulta për shkak se gjykata e caktuar nuk pajtohet me strukturën e dënimit të paraparë për atë veprë. Në thelb kjo është shmangie arbitrare e legjislacionit. **Fakti që gjykata nuk mendon, për shembull, se për veprat penale të armëve duhet të parashihet dënim prej x deri në ë vite, bën që ato të shqiptojnë dënimin minimal. Kjo jo vetëm që tregon mospajtimin e gjykatës me kufijtë eparaparë të dënimit por i zbutë edhe vlerat morale të saj. Duke vepruar kështu, gjykata tejkalon autorizimet e saj sipas kushtetutës.**

KAPITULLI II

ASPEKTET PROCEDURALE TË POLITIKËS NDËSHKIMORE

1.6 Seancat për caktimin e dënimit

Zgjidhja më e mirë sipas ligjit aktual dhe në pajtim me dispozitat e tij është ajo e cila i ngjason procesit para Gjykatës Ndërkombëtare Penale. Dispozita e paragrafit 2 të nenit 76 të GJNP krijon mundësinë e një seance të ndarë të caktimit të dënimit para përfundimit të gjyqimit, në mënyrë që të shqyrtohen provat shtesë apo parashtresat lidhur me caktimin e dënimit. Seanca nuk është e detyrueshme dhe thirret në bazë të kërkesës së palës apo gjykatës. Kjo gjithashtu iu mundëson palëve që në fund të shqyrtimit gjyqësor, pasi të kenë paraqitur të gjitha provat dhe të kenë dhënë argumentet e tyre lidhur me çështjen e fajësisë, të paraqesin prova lidhur me caktimin e dënimit dhe të argumentojnë lidhur me rrethanat rënduese dhe lehtësuese. Zbatimi i kësaj procedure është në pajtim me të drejtën e Kosovës në të gjitha aspektet me përjashtim të ndarjes së fjalës përfundimtare në dy instanca të ndara.

Ky proces nuk duhet të shihet si proces përjashtues ku prokurori bart barrën e vetme përtë paraqitur prova për rrethanat rënduese dhe lehtësuese. Ky është proces gjithëpërfshirës. Te gjitha palët duhet të trajtohen si të barabarta para gjykatës sa i përket mundësisë për të paraqitur prova, dhe po aq me rëndësi është që të kenë mundësi të komentojnë nëse provat e paraqitura mjaftojnë apo jo për të dëshmuar ekzistimin e ndonjë rrethane që ndikon në caktimin e dënimit. Vendimi për caktimin e dënimit mund të konsiderohet i drejtë për nga dhënia e mundësive vetëm nëse lejohet paraqitje e plotë dhe e fuqishme e argumenteve dhe provave nga të gjitha palët, dhe si rrjedhojë ka më pak gjasë që të prishet apo ndryshohet sipas ankesës.

Kjo gjithashtu është në pajtim me parimin e barazisë së armëve të mishëruar në nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut,¹⁰² e cila përcakton që të gjitha palët duhet të kenë mundësi të barabartë në procedurë për të paraqitur dhe komentuar mbi të gjitha provat e paraqitura para gjykatës për shqyrtim.

2.2 Standardi i të provuarit

Në disa sisteme juridike standardi i të provuarit për caktimin e dënimit dallon ngastandardi që kërkohet shpalljen fajtor të të pandehurit për vepër penale. Në shumicën e rasteve kur ky standard është i ndarë, përfundimi i gjykatës nëse ekzistimi i fakteve që mbështesin

¹⁰² Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (1950), Neni 6, 'Edrejta në gjykim të drejtë'.

ashpërsimin ose zbutjen e dënimit është provuar bazohet në një standard të të provuarit i cili është më i ultë se vërtetimi i fajësisë. Në disa raste kjo mund të ndahet edhe më tutje duke bërë që barra e të provuarit të ekzistimit të një rrethane rënduese të jetë barrë më e lartë se barra e të provuarit të një rrethane lehtësuese. Për shembull, lidhur me këtë të fundit, gjykata mund të zbatojë tri standarde të ndryshme: të provuarit përtej dyshimit të arsyeshëm për të vërtetuar fajësinë, të provuarit me prova të qarta dhe bindësepër të vërtetuar ekzistimin e rrethanës rënduese, dhe të provuarit me shumicën e provave për të përcaktuar rrethanën lehtësuese.

Tribunali i Hagës gjatë vendosjes për caktimin e dënimit gjithashtu ka trajtuar standardin e të provuarit për rrethanat rënduese dhe lehtësuese. Në rastin Kunarac, Kovaç dhe Vuković, Trupi Gjykses kishte deklaruar: *"Drejtesia kërkon që prokurori të provojë rrethanat rënduese përtej dyshimit të arsyeshëm, ndërsa mbrojtja duhet të provojë rrethanat lehtësuese vetëm sipas balancit të probabilitetit"*.¹⁰³ Trupi Gjykses ngjashëm kishte ripërsëritur këtë edhe në rastin Simic, duke thënë se: *"Rrethanat lehtësuese duhet të provohen vetëm sipas balancit të probabiliteteve e jo përtej dyshimit të arsyeshëm"*.¹⁰⁴

Shembulli i lartpërmendur është paraqitur vetëm për të ritheksuar – për të mirë apo për të keq – se kjo është një qasje mjaft e zakonshme në një numër të juridiksioneve. Duke marrë parasysh mungesën e udhëzimeve në KPP lidhur me çështjen e caktimit të dënimit, gjykatat të cilat kanë vështirësi në miratimin e qasjes së vet sistematike mund të zbatojnë ndonjë formë të këtij standardi të dyfishtë. Ndonëse gjykata mund të ketë plotësisht të drejtë të kërkojë zgjidhjet e veta për këtë mangësi, problemi është se jo secila gjykatë do të arrijë të i njëjti standard. Sërish këtu, çelësi për të ngritur korrektësinë e përgjithshmetë sistemit dhe për të maksimizuar parimin e legalitetit është që të sigurohet harmonizim në zbatim. Andaj pyetjet më të rëndësishme janë këto në vijim:

- **A përmban kodi, qoftë shprehimisht apo në mënyrë të nënkuptuar, ndonjë standard të të provuarit për të vlerësuar ekzistimin e rrethanave rënduese dhe lehtësuese?**
- **Nëse përmban ndonjë standard të tillë, a është ky standard i njëjtë apo i ndryshëm me standardin i cili zbatohet për përcaktimin e fajësisë?**

Lidhur me pyetjen e parë, nuk ka ndonjë dispozitë konkrete se cili është standardi i të provuarit të cilin gjykata duhet ta zbatojë për të vlerësuar praninë e rrethanave rënduese apo lehtësuese. i njëjti rast është edhe me standardin për përcaktimin e fajësisë, për të cilin gjithashtu nuk ka ndonjë dispozitë konkrete. Megjithatë, ka disa standarde në kuadërtë kodit të cilat japin disa udhëzime.

Në KPP parashihen pesë standarde të cilat zbatohen për procedura të ndryshme: (1) dyshimi i

¹⁰³ Rasti Nr.IT-96-23-T&IT-96-23/1-T, Aktgjykimi, Prokurori kundër Dragoljub Kunarac, Radomir Kovac and Zoran Vukovic, Tribunali Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavi, (22 shkurt 2001), Par.847.

¹⁰⁴ Rasti Nr.IT-95-9/2-S, Aktgjykimi për caktim të dënimit, Prokurori kundër Milan Simic, Tribunali Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavi, (17 tetor 2002), Par.40. Citohet Prokurori kundër Radislav Krstic, Rasti Nr. IT-98-33-T, Aktgjykimi ("Aktgjykimi Krstic"), para. 713.

arsyeshëm, (2) dyshimi i bazuar, (3) shkak i bazuar, (4) gjasa reale, dhe (5) dyshimi i bazuar mirë. Secila prej tyre përmban komponentë të perspektivës, informacionit, dhe nivel të caktuar të bindjes se i pandehuri potencial ka kryer veprën. Kur kombinohen këta komponentë, ata formojnë një standard të qartë të të provuarit që kërkohet për të siguruar çfarëdo veprimi apo hapi që kërkohet në procedurë. Në nivelin më të lartë është koncepti i dyshimit të bazuar mirë, i cili kërkohet për ngritjen e aktakuzës, e që nënkupton prova të pranueshme të cilat do të bindnin një vëzhgues objektiv se vepra penale ka ndodhur dhe që është kryer nga i pandehuri. Pasi që prokurori është i detyruar të plotësojë këtë standard për të ngritur aktakuzë dhe për të vazhduar tutjenë fazën e shqyrtimit gjyqësor, atëherë rrjedh se standardi i të provuarit për gjetjen e fajësisë është për ca shkallë të të provuarit më i lartë se dyshimi i bazuar mirë. Duke marrë parasysh faktin se procedura për caktimin e dënimit është gjithashtu pjesë e këtij procesi, atëherë është e logjikshme që ky standard së paku të jetë dyshimi i bazuar mirë.

Lidhur me atë se cili standard duhet të zbatohet, kodi nuk jep përgjigje definitive. Në përgjithësi, praktikat ndërkombëtare të caktimit të dënimit dhe praktika e Tribunalit të Hagës vënë një standard më të lartë të të provuarit për të vërtetuar ekzistimin e rrethanave të rrethana të rëndueshme në krahasim me ato lehtësuese. Duke marrë parasysh faktin se rrethana të rëndueshme është e ndërtaur për të ashpërsuar dënimin e matur ndaj të pandehurit, gjykata duhet të sigurojë që provat e paraqitura të vërtetojnë ekzistimin e rrethanës të rëndueshme përtej dyshimit të arsyeshëm. Ndërsa sa i përket rrethanave lehtësuese, nuk ka ndonjë konsensus, prandaj edhe standardi, siç u cek më herët, është dyshimi i bazuar mirë.

Kur gjykata dëshiron të merr parasysh si rrethana të rëndueshme ndonjë faktor që nuk është pjesë e përkufizimit të veprës penale, duhet të sigurohet që rrethana të rëndueshme të provohet përtej dyshimit të arsyeshëm, dhe para se gjykata të refuzojë të marrë parasysh ndonjë rrethana lehtësuese, duhet të sigurohet që rrethana të rëndueshme nuk ekziston.¹⁰⁵

2.3 Provat që duhet paraqitur

Lloji i provave që duhet paraqitur nga palët për të vërtetuar rrethanat të rëndueshme dhe lehtësuese është mjaft i thjeshtë. Secila provë e cila paraqitet për t'u shqyrtuar në raport me caktimin e dënimit duhet t'i nënshtrohet të njëjtit nivel të shqyrtimit sikurse provat e paraqitura për të vërtetuar fajësinë e të pandehurit. Ajo që është veçanërisht e rëndësishme është se gjykatat duhet të kërkojnë nga palët që të paraqesin prova të cilat mbështesin pretendimet lidhur me ekzistimin e një rrethane të rëndueshme apo lehtësuese – vetë pretendimi i palëve për ekzistimin e një rrethane të tillë nuk mjafton.

Si përfundim, procedura e mësipërme do të maksimizojë transparencën e procesit të caktimit të dënimit, zbatimin e parimit të legalitetit dhe barazinë e armëve. Duke artikuluar qartë pritshmërinë e gjykatës para fillimit të shqyrtimit gjyqësor, të gjitha palët kuptojnë detyrimet

¹⁰⁵ Rekomandimi i Këshillit të Evropës Nr. R(92) 17 i Këshillit të Ministrave të Shteteve Anëtare lidhur me konsistencën në dënime; Shtojca e Rekomandimit Nr. R(92) 17; C. Rrethanat të rëndueshme dhe lehtësuese, nënparagrafi 3.

e tyre, procedurën që duhet ndjekur, dhe zgjedhjet strategjike të cilat duhet t'i bëjnë. Ato njashtu e kuptojnë se cilat prova duhet paraqitur për të vërtetuar ekzistimin e ndonjë rrethane të caktuar lehtësuese apo rënduese. Në fund, procesi është uniform në zbatim dhe rezulton në vendime të cilat janë plotësisht të informuara, bazuar në vendimet e palëve, dhe që si rrjedhojë ka më pak gjasa që të prishet sipas ankes

KAPITULLI III

PARIMET RELEVANTE TË CAKTIMIT TË DËNIMIT

3.1 Çështje të përgjithshme


Në vijim sugjerohet një metodë e detajuar hap-pas-hapi për caktimin e dënimit përfundimtar. Në përgjithësi, kjo kornizë ndjek, për aq sa është e mundur, dispozitat e nenit 73.1 të KP i cili thotë: *"Kur cakton dënimin për veprë penale, gjykata duhet të ketë parasysh minimumin dhe maksimumin e dënimit të paraparë për atë veprë penale. Gjikata pastaj duhet të merr parasysh qëllimin e dënimit, parimet e përcaktuara në këtë kapitull dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese lidhur me veprën penale të caktuar ose medënimin."*

Vlerësimi dhe caktimi i dënimit mund të ndahet në këto kategori:

1. Përcaktimi i dënimit kryesor që parashihet për atë veprë dhe pikënisjes për caktimin e dënimit.
2. Marrja në konsideratë e qëllimeve të dënimit dhe parimeve.
3. Vlerësimi i provave dhe argumenteve të palëve për rrethanat rënduese dhe lehtësuese dhe vërtetimi i rrethanave që ekzistojnë.
4. Caktimi i peshës së caktuar rrethanave dhe vlerësimi nëse dhe deri në ç'masë njëra mbizotëron mbi tjetrën.
5. Përcaktimi nëse janë të mundshme dënimet alternative për atë veprë dhe nëse janë të zbatueshme.
6. Vlerësimi dhe caktimi i dënimeve plotësuese.
7. Dhënia e arsytimit për dënimin përfundimtar.

Thënë në përgjithësi, ka tri forma të dënimeve të mundshme për vepra të caktuara për të cilat i akuzuari është shpallur fajtor. KP i ndan dënimet në tri kategori të mundshme: (1) dënimet trajtuar një nevojë të caktuar.

Procesi i caktimit të dënimit



3.1 Dënimet kryesore

Dënimet kryesore përbëjnë dispozitat bazike të dënimit të KP dhe janë të shpjeguara në përgjithësi në nenet 43-48. Neni 43 përcakton tri llojet e dënimeve kryesore: (1) dënimi me burgim të përjetshëm, (2) dënimi me burgim, dhe (3) dënimi me gjobë. Megjithatë, jo secili prej tyre është i mundshëm dhe gjykata duhet t'i lexojë këto dispozita të përgjithshme në lidhje me dispozitat e veprave penale specifike. Kur lexohen së bashku, gjykatës i jepen këto mundësi: (1) kufijtë e dënimit me burgim prej dënimit minimal deri në dënimin maksimal; (2) nëse gjoba mund të shqiptohet si zëvendësim i dënimit me burgim; (3) nëse gjoba mund të shqiptohet krahas dënimit me burgim; dhe (4) nëse ka një shumë maksimale apo "kufi" të gjobës.


3.2.1 Kufijtë e dënimit me burgim

Kufijtë e mundshëm të dënimeve me burgim varen nga vepra penale dhe ka një mori të frazave dhe metodave që përdoren për t'i shpjeguar ato. Shumica dërmuese e dënimevetë parapara në kod parashohin një numër të caktuar të viteve si për minimumin ashtu dhe për maksimumin e dënimit. Për shembull, një prej kufijve më të shpeshtë të dënimeve në kod është dënimi prej 6 muaj si minimum deri në 5 vjet si maksimum.

Përveç kufijve definitivë, kodi parasheh edhe dënime tjera të cilat përmbajnë shprehje përshkruese për maksimumet dhe minimumet. Për dënimin minimal, Kodi përdor dy shprehje: "jo më pak se" dhe "së paku". Të dyja këto shprehje janë të ndryshueshme dhe përcaktojnë dënimin minimal por nuk përcaktojnë maksimumin. Gjykata në raste të tilla duhet t'i referohet nenit 45 paragrafit 1 për të konstatuar maksimumin, i cili është njëzet epesë (25) vjet.

Kodi parasheh edhe një numër të dënimeve të cilat përcaktojnë maksimumin, por nuk përcaktojnë minimumin. Këto përdorin shprehjen "deri në" periudhën prej x viteve. Për shembull, dënimi më i shpeshtë në Kod është dënimi "deri në 3 vjet". Minimumi gjithashtu përcaktohet nga neni 45 paragrafi 1 i cili thotë se dënimi minimal nuk mund të jetë më i shkurtë se tridhjetë (30) ditë.

Prandaj kufiri i mundshëm për dënimin për të cilin thuhet "deri në 3 vjet" është nga 30 ditë deri në tre (3) vjet.



3.2.2 Dënimi me burgim të përjetshëm

Dënimi me burgim të përjetshëm parashihet për veprat më të rënda penale të parapara në KP dhe rrjedhimisht mund të shqiptohet vetëm nëse parashihet shprehimisht për atë vepër penale. Dënimi me burgim të përjetshëm parashihet si mundësi për një mori veprash penale të parapara në Kod. Në këto rrethana, gjykatës gjithashtu i jepet mundësia që të zgjedh një dënim me burgim në kuadër të kufirit të viteve të parapara për atë vepër. Udhëzimi i vetëm shtesë që i jepet gjykatës lidhur me atë se kur të shqiptojë dënimin me burgim të përjetshëm në vend të dënimit me burgim gjendet në nenin 44, i cili përcakton së dënimi me burgim të përjetshëm mund të shqiptohet për veprat më të rënda penale të kryera nën "rrethana veçanërisht rënduese" ose për vepra penale që "kanë shkaktuar pasoja shumë të rënda". Bazuar në këtë dispozitë, e cila shtjellohet më hollësisht në vijim, gjykata duhet që të gjejë rrethana të mjaftueshme rënduese edhe brenda vetë veprës për ta ashpërsuar ndëshkimin në dënim me burgim të përjetshëm.

3.2.3 Gjobat

Ndonëse neni 43 parasheh dënimin me gjobë si dënim kryesor, në të nuk specifikohet se në çfarë rrethana mund të shqiptohet. Edhe në këtë rast gjykata duhet të shikojë dënimet eparapara në veprat penale specifike për të parë nëse dënimi me gjobë mund të shqiptohet dhe në çfarë rrethana mund të shqiptohet.

Në përgjithësi KP parasheh dy situata kur përdoret dënimi me gjobë. E para, gjoba parashihet së bashku me dënimin me burgim. Këto në kod janë të futura me lidhëzën "dhe" në përshkrimin e veprës dhe detyrojnë gjykatën që të shqiptojë gjobën së bashkë me dënimin me burgim. Një zgjidhje e tillë është e paraparë në 170 vepra përgjatë KP dhe zbatohet për një mori veprash.

E dyta, KP parasheh gjobën si dënim alternativ në vend të dënimit me burgim, duke përdorur lidhëzën "ose" në përshkrimin e veprës. Një zgjidhje e tillë është paraparë në 215 vepra përgjatë KP dhe zbatohet kryesisht për vepra më pak të rrezikshme. Nga 213 veprat, vetëm 11 lejojnë zëvendësim të plotë për vepra penale për të cilat parashihet dënim maksimal mbi tri (3) vjet burgim.¹⁰⁶

Me përjashtim të njëzet veprave penale të cilat lejojnë zëvendësimin apo dënimin kumulativ me gjobë, të tjerat nuk përcaktojnë minimumin apo maksimumin e gjobës. Kjo parashihet nga neni 46 paragrafi 1 i cili përcakton se kufijtë e dënimit me gjobë janë prej 100-25,000 Euro. Në rastet kur kemi të bëjmë me terrorizëm, trafikim me njerëz, krim të organizuar, ose vepra penale të kryera me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore, kufiri maksimal rritet në 500,000 Euro. Për njëzet vepra penale KP ka përcaktuar kufinj të përshtatur në mënyrë specifike varësisht nga vepra.

3.1 Pikënisja e dënimit dhe kohëzgjatja e presupozuar


Rekomandimi i Këshillit të Evropës lidhur me harmonizimin e dënimeve thotë: "*Kurdoqë është e përshtatshme për kushtetutën dhe traditat e sistemit juridik, mund të merren parasysh disa teknika shtesë për rritjen e harmonizimit të dënimeve. Dy teknika të tilla të cilat janë përdorur në praktikë janë "orientimet në caktimin e dënimit" dhe "pikënisjet". Orientimet në caktimin e dënimit nënkuptojnë kufij të dënimeve për forma të ndryshme të një veprë, varësisht nga prania apo mungesa e rrethanave të ndryshme rënduese apo lehtësuese, por gjykatave u mbetet diskrecioni për t'u shmangur nga orientimet. **Pikënisjet nënkuptojnë një dënim bazik për forma të ndryshme të një veprë, prej së cilës gjykata mund të lëvizë poshtë apo lartë për të reflektuar rrethanat rënduese apo lehtësuese. Në veçanti, për vepra penale të kryera shpesh***

¹⁰⁶ Për të gjitha 11 veprat parashihet dënim me burgim deri në 5 vite.

*apo për vepra penale më pak të rrezikshme apo për vepra që janë të përshtatshme, duhet marrë parasysh inkadrimin e ndonjë forme të orientimeve apo pikënisjeve për caktimin e dënimit si një hap i rëndësishëm drejt harmonizimit të dënimeve”.*¹⁰⁷

Pikënisjet e përcaktojnë pozitën brenda shkallës së kategorisë prej së cilës duhet filluar llogaritja e dënimit. Me të përcaktuar pikënisjen, gjykata duhet të marrë parasysh rrethanat rënduese dhe lehtësuese dhe dënimet e mëparshme për ta përshtat dënimin brenda kufijve. Pikënisjet dhe kufijtë zbatohen për të gjithë kryerësit, pavarësisht nëse kanë pranuar fajësinë apo janë shpallur fajtor pas shqyrtimit gjyqësor. Lehtësimet për pranimitë fajësisë merren parasysh vetëm pasi të jetë identifikuar dënimi përkatës.

Logjikisht, pikënisja gjithmonë do të jetë pika e mesme e kufirit të paraparë në Kod Penal për veprën e caktuar penale. Në pikën e mesme, gjykatës i jepet diskrecion maksimal për të lëvizur poshtë apo lartë brenda kufirit të paraparë me ligj. Si rrjedhojë, kjo e përcakton dënimin për kryerësin e "zakonshëm". Në mungesë të rrethanave lehtësuese dhe rënduese, secilit kryerës do t'i shqiptohej dënim identik prej saktësisht gjysmës së kufirit të paraparë me ligj. Për shembull, një të pandehuri tëshpallur fajtor për pjesëmarrje në rrahje nga neni 190.2 mund t'i shqiptohet dënim nga 1-3 vjet burgim si dënim kryesor. Pikënisja do të ishte dënimi prej 2 vjet për secilin kryerës. Kjo gjithashtu ka kuptim kur vlerësohen kufijtë e paraparë për veprat penale. KPParashihet kufij të mjaftueshëm për secilën veprë në mënyrë që gjyqtari të mund t'i apërshtat dënimin individit përgjatë procesit. Në përgjithësi, KP parashihet kufij më të gjerë për vepra më të rënda penale dhe kufij më të ngushtë për vepra më pak të rënda. Përafërsisht 73% e të gjitha dënimeve parashohin kufij prej së paku tri viteve nga minimumi në maksimum. Më pak se 100 vepra penale parashohin një kufi prej një vitose më pak, dhe nuk është befasi që këto janë veprat për të cilat dënimi maksimal i paraparë është një vit apo më pak. Ka dallim të theksuar në mes të kësaj dhe veprave më të rënda penale, për të cilat kufijtë e paraparë janë mbi 10 vite



¹⁰⁷ Rekomandimi Nr. R (92) 17 i Këshillit të Ministrave të Shteteve Anëtare lidhur me konsistencën në dënime (Miratuar nga Këshilli i Ministrave më 19 tetor 1992).

Përcaktimi i dënimit minimal në pikën e mesme të kufirit të mundshëm trajton një numërtë çështjeve të identifikuar më herët.

- **Së pari, e përcakton një nivel bazë të caktimit të dënimit i cili është lehtë i kuptueshëm nga publiku dhe e rrit legalitetin e procesit të dënimit.** Nuk kontestohet se publiku është i pavetëdijshëm për lartësinë e dënimit, së paku në fillim. Kjo i jep mbështetje argumentit se komponenti primar i çfarëdo niveli efektiv të preventivës së përgjithshme është ndërgjegjësimi për llojin dhe lartësinë e dënimit për secilën veprë.
- Së dyti, kjo e vë sistemin dhe të pandehurin në një pozitë më të mirë për të negociuar marrëveshje mbi pranimin e fajësisë. **i pandehuri i cili e di se gjykata, në mungesë të rrethanave lehtësuese apo rënduese, do të shqiptojë një dënim në mes të kufirit, është në pozitë më të mirë për të vlerësuar nëse marrëveshja mbi pranimin e fajësisë është në interes të tyre. Kjo do të rrisë efikasitetin e përgjithshëm të sistemit.**
- **Së fundi, kjo zvogëlon mundësitë e praktikave të larmishme ndëshkimore.** Derisa ndikimi i larmisë është relativisht minimal kur kufiri në dispozicion të gjykatës është e vogël, sa më e gjerë të jetë kufiri i mundshëm, aq më i madh është ndikimi i pikënisjes së paharmonizuar. Me përcaktimin e pikënisjes, të gjitha gjykatat e fillojnë procesin njësoj.

Në fund të këtij hapi, gjykata do të ketë identifikuar informacionet bazë të cilat i nevojiten për t'ia përshtatur dënimin të pandehurit të caktuar duke vlerësuar rrethanat e pranishme rënduese dhe lehtësuese. Gjykata i ka kufijtë minimal dhe maksimal të dënimeve, pikënisjen, dhe mundësinë eventuale për të shqiptuar gjobën si dënim kumulativ apo si zëvendësim i plotë. Këto informacione duhet të trajtohen nga gjykata si informata presupozuese lidhur me caktimin e dënimit. Kjo nënkupton që gjykata, në shumicën apo në rrethana "normale", do të vendos për caktimin e dënimit në kuadër të këtyre informacioneve. Gjykata mund të shmangët nga kjo bazë vetëm kur arrin në përfundimin se ka rrethana të mjaftueshme jashtë normës apo kryerësit "të zakonshëm" për të arsyetuar shmangien e tillë. Kjo është në pajtim me paragrafin 1 të nenit 74 lidhur me rregullat e përgjithshme të zbutjes dhe ashpërsimit të dënimit i cili thotë se "kryerësit të veprës penale i shqiptohet dënimi i paraparë për veprën e kryer penale, ndërsa dënimi më i butë ose më i rëndë mund të shqiptohet vetëm në pajtim me kushtet e parapara me këtë Kod".

3.2 Ndalimi i llogaritjes së dyfishtë të rrethanave

Njohja e konceptit të llogaritjes së dyfishtë të rrethanës nga ana e gjykatës është shumë e rëndësishme për vlerësimin e drejtë të rrethanave rënduese dhe lehtësuese. Ky problem ndodh në disa raste të cilat diskutohen më hollësisht në vijim.

Së pari, ekziston rreziku potencial për shkeljen e parimit *ne bis in idem* gjatë dënimit duke ndëshkuar të njëjtin të pandehur dy herë për sjelljen e njëjtë: fillimisht për përgjegjësinë e tij individuale dhe pastaj duke përdorur të njëjtat fakte për ta ashpërsuar dënimin përfundimtar duke i zbatuar ato si rrethanë rënduese. Gjykata nuk duhet t'i merr parasysht ato rrethana të cilat janë element i veprës penale edhe për ashpërsimin e dënimit, pasi që ato tashmë janë marrë në konsideratë kur ligjvënësi ka përcaktuar nivelin e kufirit të dënimit të paraparë për atë veprë. Për shembull, për veprën penale të grabitjes së armatosur, gjykata nuk mund ta marrë si rrethanë rënduese faktin se vepra është kryer me kanosje apo përdorim të dhunës pasi që kanosja/përdorimi i dhunës është element i veprës penale.

Është e rëndësishme thelbësore që gjykata të mbajë dallimin në mes të ashpërsimit në kuadër të kufijve të dënimit ndarazi dhe të veçuar nga rregullimi i të gjithë kufijve përkatës. Në shembullin e mësipërm, një vjedhje e thjeshtë pa përdorim të forcës apo kanosjes mbartë dënimin deri në 3 vjet. Në momentin që dhuna apo forca futet si element i veprës, atëherë ligji parasheh kufij tjerë të dënimit të mundshëm prej 3-10 vjet – si formë e cilësuar – për dallim nga përshtatja e dënimit brenda kufijve deri në 3 vjet për shkak të kanosjes. Pasi që përdorimi i forcës veç është përdorur në ngritjen e kufijve të dënimit nga 3-10 vjet, atëherë ai nuk mund të përdoret edhe për rritjen e dënimit përfundimtar brenda kufirit 3- 10 vjet.

Ngjashëm, ndonëse ndodh më rrallë, nëse ndonjë formë e dënimit të zvogëluar është bazuar në ndonjë rrethanë ligjore, të njëjtat fakte nuk mund të përdoren si rrethanë lehtësuese për uljen e mëtutjeshme të dënimit. Për shembull, neni 165 i KP parasheh veprën penale të rrezikimit të sigurisë së aviacionit civil dhe parasheh se kushdo që e drejton fluturaken në mënyrë jo të rregullt dënohet me burgim prej 1-10 vjet. Paragrafi 6 i këtij neni në mënyrë specifike parasheh se nëse vepra kryhet nga pakujdesia dënimi ulet deri në 5 vjet burgim. Pasi që niveli i zvogëluar i fajësisë është zbatuar kur janë formuluar kufijtë e dënimeve për kryerjen e kësaj vepre nga pakujdesia, atëherë gjykata nuk mund t'i përdorë të njëjtat fakte për të ulur dënimin brenda kufijve të paraparë të dënimit duke u thirrur në rrethanën lehtësuese nga paragrafi 3.1 si rrethanë e cila për pak nuk arrin të jetë bazë për përjashtim të përgjegjësisë penale. Ndonëse këto situata nuk janë aq të theksuara sa situatat që kanë të bëjnë me rrethanat rënduese, megjithatë gjykataduhet të ketë kujdes edhe në këto raste.

Një fushë tjetër ku gjykata duhet të ketë kujdes që të mos bëjë llogaritje të dyfishtë është koncepti i rrethanave që përkohë me njëra tjetrën, të cilat mund të ndodhin si për rrethanat lehtësuese ashtu edhe për ato rënduese. Kjo ndodh pasi që Kodi parasheh një kategori të gjerë të rrethanave rënduese dhe lehtësuese të cilat gjykata mund t'i përdorë. Gjykata pashmangshëm do të ballafaqohet me ndonjë rrethanë e cila logjikisht zbatohet për më shumë se një kategori. Ndonëse reagimi fillestar mund të jetë që të njëjtën rrethanë ta merr parasysht në të dyja kategoritë dhe ta trajtojë si të tillë që përmbush dy rrethana rënduese apo lehtësuese, kjo gjithashtu përbën llogaritje të dyfishtë dhe duhet të shmanget nga gjykatat.

Për shembull, KP parasheh pranimin e fajit si rrethanë lehtësuese në paragrafin 3.10. Kodi

gjithashtu parasheh keqardhjen e shfaqur nga i pandehuri si rrethanë lehtësuese në paragrafin 3.11. Mund të argumentohet se pranimi i fajësisë është provë e keqardhjes dhe rrjedhimisht mund të merret parasysh nga gjykata gjatë vlerësimit nëse vërtet ekziston keqardhja apo pendimi nga paragrafi 3.11. Logjika këtu është se i pandehuri, duke pranuar fajësinë, tregon se është duke marrë përgjegjësinë për veprimet e tij dhe se është penduar për to. Ndonëse kjo në vetvete mund të mos jetë bindëse, mund të bëhet faktor i rëndësishëm kur bëhet bashkë me prova shtesë për vlerësimin e tërësishëm të rrethanave. Ngjashëm, mund të argumentohet se i pandehuri i cili bën kompensimin sipas paragrafit

3.7 gjithashtu shfaq një lloj pendimi. i pandehuri i cili provon ta zhdëmtojë viktimën përmes kompensimit me gjasë ka marrë përgjegjësinë për veprimet e tij dhe është duke shprehur një lloj pendimi. Në të dyja rastet, gjykata duhet t'ia atribuoj faktet vetëm një rrethanë lehtësuese. Duke ia atribuuar këtë më shumë se një rrethane lehtësuese, gjykata bën llogaritje të dyfishtë të fakteve që ka para vetes dhe në mënyrë jo të drejtë merr parasysh më shumë rrethana lehtësuese sesa që i pandehuri meriton.

E njëjta gjë vlen edhe për rrethanat rënduese. Mund të argumentohet se nëse viktimja është e re, rrethanë kjo rënduese sipas paragrafit 2.7 (mosha e viktimës), gjithashtu mund të kontribuojë në faktin se viktimja ka qenë e ndjeshme sipas paragrafit 2.6. Apo nëse gjykata arrin në përfundim se viktimja ka qenë veçanërisht e ndjeshme, kjo gjetje mund të kontribuojë në arritjen e përfundimit se vepra është kryer në “mënyrë posaçërisht mizore” sipas nenit 2.4. Logjika këtu është se niveli i lëndimit kur kemi të bëjmë me viktimja të ndjeshme shtohet dukshëm dhe mund ta çojë atë në kategorinë e “mënyrës posaçërisht mizore”. Sërish, gjykata duhet ta kufizoj veten në dallimin e rrethanave dhe të mos i zbatojë ato në më shumë se një rrethanë. Nëse është ndonjë rrethanë diskrete e paraparë në nenin 74, atëherë duhet të mbetet konsideratë e veçantë nga gjykata.

Fusha e fundit e konfliktit potencial mund të shfaqet kur kemi të bëjmë me disa akuza përtë cilat ekzistojnë fakte të cilat janë edhe element i ndonjë vepër penale dhe gjithashtu mund të përdoren si rrethana rënduese apo lehtësuese për ndonjë vepër tjetër sipas nenit

74. Pyetja kryesore është se çfarë ndodh kur kryerësi lirohet nga akuza për veprën e cila e përmban atë rrethanë si element të veprës penale? Për shembull, kryerësi akuzohet për dy vepra, ku për një rrethanë prej tyre përdorimi i dhunës është element i veprës penale, dhe e rrit automatikisht kufirin e dënimit të mundshëm, dhe për tjetrën ku përdorimi i dhunës mund të merret si rrethanë rënduese sipas nenit 74. Nëse i pandehuri lirohet nga akuza për veprën e parë dhe shpallet fajtor për të dytën, gjykata duhet të përcaktojë në mënyrë specifike nëse elementi i përdorimit të dhunës ka qenë komponentë faktike e gjetjes së pafajësisë. Me fjalë tjera, a ka gjetur gjykata se nuk ka pasur përdorim të dhunës? Nëse po, atëherë gjykata në mënyrë afirmative ka konkluduar se kjo rrethanë nuk ekziston, dhërrjedhimisht nuk mund ta përdor si rrethanë rënduese gjatë matjes së dënimit për veprën e dytë. Nëse jo, atëherë gjykata është e lirë që ta merr parasysh si rrethanë rënduese nga neni 74.

Për dallim, nëse skenari i mësipërm rezulton në shpalljen fajtor për të dy veprat, situata do të jetë ndryshe. Në atë rast, vepra për të cilën përdorimi i dhunës është element i veprës do

të konsiderohet si formë e cilësuar e veprës. Megjithatë, gjykata nuk mund të zbatojë rrethanën nga neni 74 për veprën e dytë.

Në fund, në rastet e shpalljes fajtor për disa vepra, përdorimi i rrethanave nga neni 74 duhet të bëhet në kontekst të dënimit të përgjithshëm e jo të dënimeve individuale...

3.3 Qëllimet dhe parimet e dënimit

Neni 73 i Kodit Penal:

“1. Kur cakton dënimin për vepër penale, gjykata duhet të ketë parasysh minimumin dhe maksimumin e dënimit të paraparë për atë vepër penale. Gjikata pastaj duhet të merr parasysh qëllimin e dënimit, parimet e përcaktuara në këtë kapitull dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese lidhur me veprën penale të caktuar ose me dënimin”.

3.5.1 Qëllimet e dënimit

Qëllimet e dënimit të përcaktuara në nenin 41 janë:

1.1 të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij;

1.2. të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale;

1.3. të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale; dhe

1.4. të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Para se të diskutohet ndikimi i këtyre qëllimeve të dënimit në caktimin e dënimit, është e dobishme të bëhet një shtjellim i përgjithshëm i këtyre teorive.

3.5.1.1 Parandalimi specifik/i veçantë

Paragrafi 1.1 kërkon nga gjykata që të merr parasysh konceptin tradicional të parandalimit të veçantë apo specifik. Në këtë drejtim gjykata përqendrohet në individin i cili ka kryer veprën dhe shqyrton nëse dënimi parandalon atë nga kryerja e ndonjë vepre tjetër në të ardhmen. Sipas filozofisë bashkëkohore të penologjisë, dënimi duhet t'ipërshtatet kryerësit e jo vetëm veprës. Është me rëndësi që të theksohet se “individualizimi” i dënimit zbaton parimin se përgjegjësia penale është përgjegjësi individuale në fazën e caktimit të dënimit. Në këtë kuptim, individualizimi i dënimit i mbron individët e akuzuar nga dënimet të cilat nuk adresojnë në

mënyrë strikte veprimete tyre, dhe kësisoj sigurohet drejtësia. Kryerësi nuk shihet më si një shkelës abstrakt i ligjit, por si individ i cili meriton vëmendje të veçantë.

Kjo çështje trajtohet më në tërësi në pjesën e dytë të paragrafit i cili inkorporon koncepte rehabilitimit. Teoria e rehabilitimit në thelb parasheh që objektivi i dënimit është që të bëhet reintegrimi i kryerësit në shoqëri pas një periudhe të caktuar, dhe që dënimi të konstruktohet në mënyrë të tillë që të mundësojë riedukimin e kryerësit. Këtu gjykata vërtetë duhet të përfshihet në individualizimin e dënimit pasi që nga gjykata kërkohet që të trajtojë çështje të caktuara të cilat mund të kenë qenë të ndërlidhura me kryerjen e veprës. Aftësia për ta bërë këtë gjendet në format plotësuese të dënimit të cilat mund të përfshihen në dënimin përfundimtar. Për shembull, nëse një i pandehur kryen sulm dhe është nën ndikimin e alkoolit, gjykata mund të shqiptojë një dënim me të cilin jo vetëm që parandalohet kryerësi nga kryerja e sulmeve në të ardhmen, por e trajton edhe çështjene mundshme të varësisë nga alkooli. Vetëm duke shikuar individin në tërësi gjykata mund të shpresojë që të parandalojë kryerjen e veprave në të ardhmen dhe reintegrimin e kryerësit në shoqëri si anëtar produktiv të saj.

3.5.1.2 Parandalimi i përgjithshëm

Paragrafi 1.2 kërkon nga gjykata që të merr parasysh qëllimin e parandalimit të përgjithshëm. Në këtë koncept tradicional dënimi i shërben qëllimit të parandalimit të individëve tjerë nga kryerja e veprave penale, qoftë të natyrës së ngjashme apo në përgjithësi. Parandalimi i përgjithshëm nuk përqendrohet në individin por në shoqërinë si tërësi. Qëllimi është që kryerësi ta kuptojë se vepra penale “nuk shpaguhet” dhe të ketë parasysh faktin që mund të ndëshkohet kur bën përllogaritjet nëse do ta kryejë veprën apo jo. Në rastin Naletilic dhe Martinovic, Trupi Gjykses kishte mbajtur qëndrimin se “*Parandalimi dhe ndëshkimi janë parime themelore në raport me caktimin e dënimit të individit nga Tribunali. Përderisa ndëshkimi nënkupton një dënim proporcional përveprën e kryer, parandalimi siguron që dënimi i shqiptuar të bind tjerët që të mos kryejnë vepra të tilla*”.¹⁰⁸

Përderisa kryerësi potencial mund të mos “rehabilitohet” në kuptimin tradicional, ata mund thjeshtë të heqin dorë nga kryerja e veprës. Në rastin Mucic kundër të tjerëve, Dhoma e Apelit kishte mbajtur qëndrimin se “*Ndonëse edhe juridiksionet nacionale dhe disa instrumente të caktuara ndërkombëtare dhe rajonale të të drejtave të njeriut parashohin se rehabilitimi duhet të jetë çështja kryesore për gjykatën gjatë matjes së dënimit, kjo nuk mund të ketë rol mbizotërues në procesin e vendimmarrjes së Trupit Gjykses të Tribunalit*”.¹⁰⁹

¹⁰⁸ Rasti Nr.IT-98-34-T, Aktgjykimi , Prokurori kundër Mladen Naletilic dhe Vinko Martinovic, Tribunali Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavi, (31 mars 2003), Par.739, citohet Aktgjykimi për Dënimin e Todorovic, para 29&30; Aktgjykimi për Dënimin e Plavsic, para 23.

¹⁰⁹ Rasti Nr.IT-96-21-A, Aktgjykimi, Prokurori kundër Zejnil Delalic, Adravko Mucic, Hazim Delic dhe Esad Landzo, Tribunali Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavi, (20 shkurt 2001), Par.806.

3.5.1.3 Viktimat dhe komuniteti

Paragrafi 1.3 kërkon nga gjykata që të merr parasysh ndikimin e veprës në viktimën apo komunitetin dhe parasheh që çdo dënim duhet të përfshijë kompensimin për humbjet e shkaktuara. Ky qëllim paraqet një zhvillim relativisht të ri në teorinë e dënimeve me të cilin njihet rëndësia e të drejtave dhe nevojave të viktimës.

Nga kjo perspektivë, qëllimi kryesor i dënimit do të ishte që të sigurojë kompensimin e viktimës dhe komunitetit të gjerë nga kryerësi për veprat penale. Kjo ka disa implikime.

- **Së pari, kjo tregon për rëndësinë e të drejtave të viktimës në matjen e dënimit.** Kjo nuk është vetëm një konsideratë dytësore për gjykatën e cila mund t'i bartet mekanizmave shoqëror të kompensimit nëse kryerësi ka mundësinë që të kompensojë viktimën dhe të zhbëjë dëmin. **Kjo duhet të jetë konsideratë primare gjatë caktimit të dënimit.**
- Së dyti, përfshirja e komunitetit në qëllimin e dënimit tregon qartazi se viktimë mund të përfshijë edhe komunitetin e gjerë. Në veprat penale ku përfshihet, për shembull, asgjësimi i pasurisë, kompensimi do të bëhet në formë të kompensimit monetar. Por kjo nuk përfundon këtu. Ndikimi në komunitet mund të jetë edhe në formë të dëmtimit të përgjithshëm psikik të individëve në komunitet. Kjo mund të përfshijë ndjenjat e sigurisë dhe/ose reputacionit të komunitetit. Ndonëse këto çështje mund të jenë disi të paprekshme dhe të pamatshme në terma monetar, gjykata duhet të përpiket që t'i rikthejë ato në gjendjen e mëparshme.

3.5.1.4. Gjikimi shoqëror, ngritja e moralit dhe forcimi i detyrimit për respektimin e ligjit

Paragrafi i fundit i nenit 41 është shprehje e përgjithshme e qëllimeve të dënimit dhe raportit të tyre me konceptin e përgjithshëm të sundimit të ligjit. Këtu çështja e dënimit shkon përtej individit, viktimës, dhe komunitetit, dhe flet për ndikimin e dënimit në shoqërinë si tërësi. Kjo kërkon nga gjykata që të merr parasysh çështje përtej komunitetit cili e rrethon dhe kërkon që të ketë harmonizim në tërë Kosovën.

3.5.1.4 Implikimet e qëllimeve të dënimit në caktimin e dënimit

Neni 41 parasheh një kornizë të përgjithshme e cila do duhej të udhëheqte gjykatën përgjatë procesit të caktimit të dënimit. Megjithatë, KP nuk përcakton ndonjë strukturë hierarkike. Nuk ka ndonjë kërkesë, për shembull, që të vihet theks më i madh në rehabilitimin e kryerësit sesa në parandalimin e përgjithshëm. Për më tepër, nuk ka ndonjë indikacion se dënimi duhet të plotësojë vetëm një nga qëllimet. Kjo mungesë e udhëzimit e vë gjykatën në pozitë veçanërisht të vështirë pasi që dy gjykata të ballafaquara me vepra dhe kryerës të ngjashëm mund të arrijnë në dënime shumë të ndryshme nëse zbatojnë qëllime të ndryshme. Për shembull, njëra gjykatë, e cila përqendrohet në parandalimin e përgjithshëm, mund të caktojë burgimin si dënim përfundimtar. Ndërkaq gjykata tjetër, e cila përqendrohet në rehabilitimin e

kryerësit, mund të caktojë dënim me kusht. Pa ndonjë udhëzim, secili dënim është njësoj i vlefshëmsipas ligjit. Ky problem potencial në përgjithësi njihet si problematik ndër teoricientët e dënimeve penale pasi që rrit mospërputhjet e dënimeve dhe pjesërisht trajtohet edhe nga Këshilli i Evropës ku thuhet se:

1. Në vendet ku parimet kushtetuese dhe tradita juridike e lejojnë një gjë të tillë, ligjvënësi apo organi tjetër kompetent duhet të bëjë përpjekje për të deklaruar qëllimet e dënimit.
2. Sipas nevojës, dhe në veçanti kur mund të ketë konflikt në mes të qëllimeve të ndryshme, duhet dhënë udhëzime lidhur me mënyrën e përcaktimit të prioriteteve të mundshme në zbatimin e qëllimeve të tilla.
3. Kurdo që është e mundur, dhe në veçanti për kategori të caktuara të veprave apo të kryerësve, duhet deklaruar qëllimin primar.¹¹⁰

Ndonëse kjo çështje nuk trajtohet në mënyrë specifike në Kod, përcaktimi i pikënisjes në kombinim me këto udhëzime, së bashku me kufijtë e mundshëm të dënimeve për vepra të caktuara, në masë të madhe e zbusin problemin. Në përgjithësi, kodi parasheh që me rritjen e peshës së veprës, zvogëlohet mundësia e shqiptimit të formave alternative të dënimit. Kjo vë një theks më të madh në parandalimin specifik dhe të përgjithshëm si qëllime të përgjithshme të dënimit. Me uljen e peshës së veprës, rehabilitimi mundësohet si dënim i mundshëm. Megjithatë, duhet të theksohet se mundësia e shqiptimit të formave alternative të dënimit nuk nënkupton shfrytëzimin e domosdoshëm të tyre. Dhe në fund, konsideratat për kompensimin e viktimës duhet të jenë të pranishme në të gjitha aspektet e caktimit të dënimit. Në pjesë të madhe, rrethanat individuale me të cilat gjykataballafaqohet në rastin e caktuar do të diktojnë se ku hyn në zbatim qëllimi i caktuar i dënimit dhe nëse duhet dhënë njërit qëllim prioritet mbi tjetrin.

3.5.2 Parimet dhe rrethanat tjera

Përveç kërkesës që të merren parasysh qëllimet e dënimit, neni 73 kërkon që të merren parasysh edhe parimet e përcaktuara në atë kapitull. Ndonëse nuk ka parime specifike të përcaktuara në ndonjë nen të caktuar, parimet e përgjithshme janë të mishëruara përgjatë kapitullit kur trajtohen rrethanat e caktuara. Prandaj gjykata nuk obligohet që të merr parasysh ndonjë parim të caktuar në vete, por kërkohet që të merr parasysh dhe të zbatojë cilindo nen që ndërlihet me faktet e caktuara të rastit. Për shembull, sipas nenit 78, gjykata mund ta lirojë nga dënimi kryerësin e veprës penale të kryer nga pakujdesia në rrethana të caktuara. Kjo mishëron parimin se jo të gjitha veprat e kryera nga pakujdesia meritojnë të njëjtin dënim sikurse ato të kryera me dashje. Parimet nuk janë të trajtuara në detaje individuale pasi që shumica e neneve në këtë kapitull do të zbatohen për situata të caktuara faktike. Gjukata duhet të merr parasysh secilën dispozitë që zbatohet në situatën e caktuar faktike dhe duhet të shqyrtojë veçoritë e saj.

¹¹⁰ Rekomandimi i Këshillit të Evropës Nr. R (92) 17, i Këshillit të Ministrave të Shteteve Anëtare lidhur me konsistencën në dënime; Shtojca e Rekomandimit Nr. R (92) 17; A. Qëllimet e dënimit.

Siç ceket në nenin 73 të Kodit Penal, “Dënimi duhet të jetë në proporcion me peshën e veprës dhe me sjelljen dhe rrethanat e kryerësit”. Në pajtim me këtë dispozitë dhedispozitat tjera në Kod, me rastin e caktimit të dënimit gjykata duhet të merr parasysh nivelin e veprës. Vlerësimi i tillë duhet bërë në pajtim me paragrafin 3 të nenit 73 i cili kërkon nga gjykata që të merr parasysh një mori rrethanash. Këto rrethana në masë të madhe janë kategori të përgjithshme në kuadër të së cilave hyjnë rrethanat e caktuara lehtësuese dhe rënduese. Megjithatë, ato gjithashtu mund të konsiderohen si parime të përgjithshme sipas të cilave gjykata duhet të udhëhiqet përshtatshëm. Ato janë:

- 1.1. shkalla e përgjegjësisë penale;
- 1.2. motivet për kryerjen e veprës;
- 1.3. intensiteti i rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur;
- 1.4. rrethanat në të cilat është kryer vepra;
- 1.5. sjellja e mëparshme të kryesit;
- 1.6. pranimi i fajit; dhe
- 1.7. rrethanat personale të kryesit dhe sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale.

3.5.2.1 Shkalla e përgjegjësisë penale

Shkalla e përgjegjësisë penale në përgjithësi përcaktohet bazuar në shkallën epërgjegjshmërisë dhe shkallën e fajësisë së kryerësit. Parimi i përgjithshëm është se shkalla e përgjegjësisë penale të individit do të ndikojë drejtpërdrejtë në dënimin eshqiptuar ndaj të pandehurit.

Në përcaktimin e shkallës së përgjegjësisë, gjykata duhet të merr parasysh nëse vepra është kryer në gjendje të përgjegjësisë dukshëm të zvogëluar apo të zvogëluar. Kjo mund të merr disa trajta dhe kërkon një vlerësim të mirëfilltë të pjesëmarrjes në kryerjen e veprës. Koncepti i përgjithshëm është se sa më e vogël të jetë përgjegjësia e individit ndaj kryerjes së drejtpërdrejtë të veprës aq më e madhe është mundësia për zvogëlimin e dënimit.

Shkalla e fajësisë duhet të vlerësohet duke marrë parasysh llojin e fajësisë (me dashje aponga pakujdesia), ashtu siç kërkohet me ligj për atë vepër të caktuar penale. Në përcaktimin e shkallës së fajësisë, në rastet e veprave të kryera me dashje, gjykata duhet të merr parasysh nëse ekziston dashja direkte apo eventuale, si dhe nëse në rastin specifik mund të identifikohet prania e ndonjërisë prej llojeve të veçanta të dashjes, e cila mund të jetë tregues i shkallës më të ultë apo më të lartë të fajësisë. Në përcaktimin e niveleve të ndryshme të fajësisë për vepra të kryera nga pakujdesia, gjykata duhet të merr parasysh nëse vepra është rezultat i pakujdesisë së vetëdijshme apo të pavetëdijshme dhe gjithashtu nëse vepra përfshinë ndonjë formë të veçantë të pakujdesisë.

3.5.2.2 Motivet për kryerjen e veprës

Në përcaktimin e motivit për kryerjen e veprës, gjykata duhet të përcaktojë në mënyrë të përgjithshme motivin dhe të merr parasysh këtë fakt gjatë shqiptimit të dënimit. Motivi mund të jetë i natyrës pozitive, siç është dhënia e ndihmës personit tjetër, arsyet humane apo shkaqet tjera të dobishme shoqërore, dhe i natyrës negative, siç është urrejtja, poshtërimi, lakmia, interesi vetjak, zilia, apo shkaqet tjera të dëmshme shoqërore.

Koncepti që veprat e kryera për motive të respektueshme dhe altruiste apo me qëllim që t'i sjellin dobi anëtarëve të tjerë të shoqërisë kryesisht konsiderohen se meritojnë dënime më të buta bazohet në teorinë se veprat e kryera për shkak të “dhembshurisë së fortë njerëzore” janë më pak të urryera. Për shembull, shoqëria në përgjithësi konsideron se kryerësi i cili vjedh para për të blerë barna për trajtimin e anëtarit të sëmurë të fëmijës meriton dënim më të butë se ai i cili kryen vjedhje për qëllime të pastra të përfitimit material. Për dallim, ato vepra të cilat kryhen për motive të papranueshme apo të urryera lehtësisht meritojnë dënime më të ashpra.

Sidoqoftë, është me rëndësi që gjykata të zbatojë me kujdes këto parime pasi që për nga natyra ato mund të jenë shumë personale. Andaj, gjykata rrezikon që të imponojë parimete saj personale në përcaktimin e dënimit të cilat mund të mos konsiderohen si parime universale apo t'i jep rëndësi më të madhe një vlere të caktuar sesa që i jepet nëpërgjithësi. Kjo në veçanti gjen zbatim te zbutja e dënimit bazuar në shkaqe siç janë nacionalizmi apo i ashtuquajturit “nder” i individit apo familjes.

3.5.2.3 Intensiteti i rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur

Gjatë përcaktimit të nivelit të veprës së caktuar, gjykata duhet të merr parasysh seriozitetin e veprës së kryer. Me rastin e identifikimit të seriozitetit duhet të përfshihet vlerësimi i intensitetit të dëmit të pasojave të veprës. Kur çështja ka të bëjë kryesisht me rrezikimin e vlerës, atëherë vlerësimi duhet të përqendrohet në të drejtën e mbrojtur dhe probabilitetin e kryerjes.

Në vlerësimin e seriozitetit të rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur, gjykata në veçanti duhet të merr parasysh elementet e mëposhtme:

- seriozitetin dhe kohëzgjatjen e pasojës;
- numrin e palëve të dëmtuara apo viktimave;
- vlerën e dobisë pasurore të fituar me vepër apo dëmin e shkaktuar; dhe
- rrethanat tjera të cilat në rastin specifik tregojnë pasojë më të lartë apo më të ultëtë veprës në të drejtën, vlerën apo interesin e caktuar.

Kjo çështje do të jetë më pak e rëndësishme kur serioziteti i veprës përfshihet në formulimin e vet veprës penale, e cila diskutohet më në hollësi në pjesët në vijim të këtij udhëzuesi.

3.5.2.4 Rrethanat në të cilat është kryer vepra

Gjatë përcaktimit të nivelit të veprës, gjykata duhet të merr parasysh të gjitha rrethanat të cilat e karakterizojnë veprën penale specifike dhe kushtet në të cilat është kryer. Kjo përfshin një vlerësim gjithëpërfshirës të të gjitha fakteve specifike të veprës të cilat mund edhe të mos ndikojnë drejtpërdrejtë në përcaktimin e fajësisë, por që mund të ndikojnë në dënimin përfundimtar.

Këto përfshijnë por nuk kufizohen në:

- kohën, vendin dhe mënyrën e kryerjes së veprës;
- mjete e përdorura për kryerjen e veprës;
- intensitetin e veprës;
- këmbënguljen për kryerjen e veprës;
- vështirësitë dhe pengesat të cilat kryerësi është dashur t'i tejkalojë gjatë kryerjes së veprës;
- rrethanat e veçanta në të cilat është gjendur kryerësi, të cilat i ka shfrytëzuar aponga të cilat ka përfituar në mënyrë që ta kryejë veprën më lehtë;
- personalitetin dhe karakterin e viktimës;
- keqpërdorimin e marrëdhënies së veçantë të besimit reciprok me viktimën;
- llojin dhe formën e pjesëmarrjes në veprën e kryer;
- nëse vepra ka mbetur në tentativë apo është kryer; dhe
- rrethanat tjera objektive apo subjektive të cilat kanë ekzistuar para, gjatë dhe pas kryerjes së veprës dhe të cilat mund të ndikojnë në llojin dhe kohëzgjatjen e dënimit.

3.5.2.5 Sjellja e mëparshme e kryerësit

Kjo kategori e përgjithshme ka të bëjë me sjelljen e mëparshme të kryerësit e cila mund të ndikojë në caktimin e dënimit qoftë përmes zbatimit të drejtpërdrejtë të dispozitave tjera të kodit apo përmes ndryshimit gradual të dënimit përfundimtar.

Këto përfshijnë por nuk kufizohen në:

- dënimet e mëparshme, pavarësisht natyrës dhe ngjashmërisë së tyre me veprën aktuale;
- dënimet e mëparshme për kundërvajtje;
- nëse personi është i diagnostifikuar me ndonjë varësi apo nëse shfaq sjellje që janë të ngjashme me varësitë e tilla;
- nëse personi është i dhunshëm apo shfaq sjellje të ngjashme;
- sjelljet antisociale;
- reputacionin e personit në shoqëri, më saktë në komunitetin në të cilin jeton; dhe
- faktet tjera të cilat mund të shërbejnë si indikatorë të jetës dhe karakterit të mëparshëm të kryerësit para kryerjes së veprës, të cilat mund të ndikojnë në caktimin e dënimit.

3.5.2.6 Pranimi i fajësisë

Çështja e zbutjes së dënimit në rast të pranimit të fajësisë apo marrëveshjes mbi pranim të fajësisë përgjithësisht rregullohet me dispozitat e Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale. Lidhur me marrëveshjet mbi pranim të fajësisë, KPP përcakton zbutje specifike maksimale të dënimeve të negociuara në faza të caktuara të procedurës penale. Megjithatë, nuk ka kufizime të tilla të përcaktuara për gjykatën në rastet kur i pandehuri thjeshtë e pranon fajësinë për akuzat që e rëndojnë në ndonjë fazë para së të shpallet fajtor. Gjykata duhet të ketë kujdes të veçantë në rastet kur bën zbutjen e dënimit bazuar në pranimin e fajit pasi që mungesa e strukturës së parapërcaktuar në këtë fushë mund dhe në fakt shkakton shmangie të konsiderueshme në situata të ngjashme faktike. Gjykata duhet të trajtojë dispozitat e KPP të cilat rregullojnë marrëveshjen për pranim të fajësisësi përafërsisht të zbatueshme në rastet kur kryerësi thjeshtë e pranon fajësinë.

Për më tepër, kur kemi të bëjmë me pranim të fajësisë dhe me marrëveshjen mbi pranim të fajësisë, një përcaktim adekuat i dënimit përfundimtar duhet të përfshijë edhe vlerësimin e një numri të rrethanave tjera që e ‘rrethojnë’ dhe që kanë të bëjnë me pranimin e fajësisë. Këto përfshijnë çështje siç është pranimi i vërtetë i fajit, shfaqja e pendimit nga i akuzuari, sjellja e përgjithshme e të akuzuarit në raport me viktimën dhe sjellja ndaj gjykatës.

3.6 Klasifikimi i rrethanave që duhet marrë parasysh gjatë caktimit të dënimit

Zanafilla e debatit lidhur me rrethanat të cilat mund të ndikojnë në dënim mund të gjurmohet qysh në shekullin e XII, kur dënimet ishin të përcaktuara në mënyrë aq të ngurtë dhe shpesh ishin aq të ashpra sa që studiuesit e drejtësisë filluan të mbështesin nevojën për përshkallëzimin e dënimit sipas situatës së caktuar faktike të rastit. Dënimi i paraparë për një vepër të caktuar do të njihej si *poena ordinaria*, që nënkuptonte dënimin e përcaktuar nga ligjvënësi në lidhje me veprën e caktuar të kryer në rrethana normale të rastit; për më tepër, gjyqtari gjithashtu do të kishte të drejtën për t’u distancuar nga dënimi i paraparë me ligj, duke e zbutur apo ashpërsuar atë, nëse kishte arsye apo rrethana të caktuara të cilat do të ndikonin në ‘normalitetin’ e rastit. Larmia dhe numri i rrethanave të tilla që ndikojnë në dënim duhet të vlerësohen lidhur me ‘dënimin ezakonshëm’, me fjalë tjera, dënimin e zakonshëm që do të rezultonte nga ligji. Në kuadër të këtij procesi teorik të ndërlikuar dhe evolues u zhvilluan një numër i rrethanave të përbashkëta lehtësuese dhe rënduese. Rritja e shfrytëzimit të këtyre rrethanaveeventualisht solli deri te kodifikimi i procesit të individualizimit të dënimit dhe te zhvillimi i një sërë ndryshimesh rrënjësore të përbashkëta.

Kjo përfundimisht solli deri te një vlerësim shumë më i ndërlikuar dhe gjithëpërfshirës i një numri të rrethanave, teorive dhe arsyetimeve. Siç theksohet nga Këshilli i Evropës, dënimet bashkëkohore “...duhet të jenë në harmoni me politikat bashkëkohore të krimit, në veçanti lidhur me zvogëlimin e përdorimit të burgimit, zgjerimin e shfrytëzimit të sanksioneve dhe masave në dobi të komunitetit, ndjekjen e politikave të dekriminalizimit, përdorimin e masave

të diversitetit siç është ndërmjetësimi, dhe sigurimin e kompensimit për viktimat...Në propozimin apo shqiptimin e dënimeve, duhet të merret parasysh ndikimi i mundshëm i dënimit në kryerësin individual, në mënyrë që të shmangen vështirësitë e panevojshme dhe pengesat në rehabilitimin eventual të kryerësit”.¹¹¹

Historikisht, rrethanat në tërësi mund të ndahen në dy kategori të gjera të cilat janë zhvilluar me kohë. Në përgjithësi, ka rrethana që ndërlidhen me “rastin” dhe rrethana që ndërlidhen me “procedurën”. Ndonëse ka ca puthitje në mes të këtyre dy kategorive, e madje edhe në mes të nënkategorive, e para kryesisht përqendrohet në kryerjen e veprës dhe në rrethanat personale të kryerësit, ndërsa e fundit përqendrohet më shumë në procedurën dhe në situatën pas kryerjes së veprës. Në pjesët në vijim paraqitet një vështrim i përgjithshëm i konsideratave të përgjithshme në caktimin e dënimit të cilat propozohen si mjete për të orientuar gjykatën. Rrethanat specifike të përcaktuara në Kosovë diskutohen më hollësisht në pjesët e mëvonshme.

3.6.2 Rrethanat që lidhen me rastin

Rrethanat që lidhen me rastin të cilat ndikojnë në lartësinë e dënimit mund të ndahen në tri kategori të cilat përfaqësojnë të gjitha ato rrethana që janë specifike për rastin:

- Rrethanat lidhur me kryerjen e veprës penale
- Rrethanat lidhur me viktimizimin dhe viktimën
- Rrethanat lidhur me të akuzuarin dhe gjendjen e tij personale.

3.6.1.1 Rrethanat që lidhen me peshën apo kryerjen e veprës

Ka mundësi që të bëhet dallimi në mes të peshës *in abstracto*, bazuar në përkufizimin ligjor të veprës (elementet objektive dhe subjektive të saj) – e cila shpie deri te problemi i hierarkisë së veprave – dhe peshës *in concreto*, i cili varet nga dëmi i shkaktuar në rastin konkret dhe nga shkalla e fajësisë së kryerësit. Përderisa rrethanat *in abstracto* zakonisht janë të absorbuara në dënimin e përgjithshëm të përcaktuar me ligj, rrethanat *in concreto* kërkojnë një analizë më të thellë të fakteve të rastit.

Pesha e veprës penale përfshin aspekte që ndërlidhen me kryerjen e veprës, siç janë:

- lloji i veprës penale,
- mënyra në të cilën është kryer vepra,
- mizoria apo sadizmi në kryerjen e veprës, etj.

¹¹¹ Rekomandimi Nr. R (92) 17 i Këshillit të Ministrave të Shteteve Anëtare lidhur me konsistencën në dënime (Miratuar nga Këshilli i Ministrave më 19 tetor 1992).

Në rastin Mucic dhe të tjerët, Dhoma e Apelit kishte theksuar: “*Trupi Gjykues ka gjetur, në shqyrtimet e tij të përgjithshme para trajtimit të rrethanave relevante për secilin individ të akuzuar, se konsiderata më e rëndësishme, e cila mund të cilësohet si testi i ‘litmusit’ për dënimin adekuat, është pesha e veprës penale... Dënimi i shqiptuar duhet të reflektojë peshën e qenësishme të sjelljes penale të të akuzuarut. Përcaktimi i peshës së veprës kërkon shqyrtim të rrethanave të veçanta të rastit, si dhe formën dhe shkallën e pjesëmarrjes së të akuzuarin në kryerjen e veprës... Dhoma e Apelit përsërit mbështetjen atyre deklaratave dhe konfirmon pranimin nga ana e saj të parimit se pesha e veprës është konsiderata primare në caktimin e dënimit.*”¹¹²

Mizoria

Mënyra e kryerjes së veprës gjithmonë ndërlidhet me caktimin e dënimit. Bazuar në karakteristikat thelbësore të kësaj rrethane, ky logjikisht zbatohet më shumë për kryerësit e drejtpërdrejtë që kryejnë veprën dhe më pak për kryerësit indirekt apo për veprat që përfshijnë eprorët. Me kryerësit e drejtpërdrejtë shkaktimi i vuajtjeve përmes mizorisë drejtpërdrejtë i atribuohet individit i cili e shkakton atë.

Pavarësisht nëse është element i veprës penale apo rrethanë rënduese, gjykata duhet të merr parasysh brutalitetin, zellin, mizorinë apo sadizmin e përdorur nga kryerësi në kryerjen e veprës apo veprave.

Rrethanat dhe faktorët që duhet konsideruar përfshijnë:

- Niveli i brutalitetit mund të varet nga vuajtjet e rënda shtesë të shkaktuara ndaj viktimës, apo të jetë për shkak të mjeteve të tmerrshme të përdorura në kryerjen e veprës apo veprave.
- Përdorimi i mizorisë në mënyrë të vazhdueshme duhet të cilësohet si rrethanë e rëndësishme rënduese që ndërlidhet me rolin e të akuzuarit në kryerjen e veprës dhe që demonstroi keqdashje të veçantë ndaj viktimës.
- Zelli me të cilin janë kryer veprat vazhdimisht duhet të cilësohet si rrethanë rënduese dhe duhet të merret parasysh në përcaktimin e dënimit adekuat.

Paramendimi

Paramendimi është faktor i cili potencialisht mund të zbatohet në disa kategori. Ndonëse në përgjithësi konsiderohet si rrethanë personale e cila mund t’i atribuohet drejtpërdrejtë kryerësit, gjithashtu mund të shihet edhe si rrethanë e cila zbatohet drejtpërdrejtë edhe për vet veprën. Lidhur me këtë të fundit, paramendimi natyrisht do të parashihet me ligj si formë e cilësuar e

¹¹² Rasti Nr.IT-96-21-A, Aktgjykimi, Prokurori kundër Zejnil Delalic, Adravko Mucic, Hazim Delic dhe Esad Landzo, Tribunali Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavi, (20 shkurt 2001), Par.731. duke cituar Aktgjykimin Kupreskic, para 852, i cituar në Aktgjykimin e Apelit në rastin Aleksovski, par. 182.

veprës – duke e rritur nivelin e dënimit të paraparë. Ndërsa sa i përket të parës, ai mund të jetë faktor për t’u konsideruar qoftë si rrethanë rënduese apo lehtësuese në matjen e dënimit.

Për shembull, kur vërtetohet se i akuzuari e ka kryer veprën për të cilën akuzohet me ftohtësi dhe paramendim të kalkuluar, për shkak të hakmarrjes ndaj viktimës individuale apo grupit të cilit i takon viktima, rrethanat e tilla imponojnë shqiptimin e dënimit më të ashpër. Në anën tjetër, kur vërtetohet se i akuzuari e ka kryer veprën për të cilën akuzohet me hezitim dhe nën ndikimin e presionit të grupit dhe, përveç kësaj, ka treguar dhembshuri ndaj viktimës apo grupit të cilit i takon viktima, këto padyshim se janë rrethana lehtësuese të cilat gjyqtarët duhet t’i marrin parasysh gjatë caktimit të dënimit.

Në përgjithësi, vëmendje duhet kushtuar motiveve lidhur me kryerjen e veprës, duke i cilësuar ato jo si element esencial i përgjegjësisë penale por si rrethanë që duhet vlerësuargjatë zbutjes apo ashpërsimit të dënimit pas përcaktimit të përgjegjësisë individuale.

3.6.1.2 Rrethanat lidhur me viktimizimin dhe viktimën

Rrethana e dytë që ndërlidhet me rastin ka të bëjë me “viktimizimin”, e cila ngërthen si shkallën e dëmit të shkaktuar viktimës ashtu edhe rrethanat e ndryshme dhe karakteristikat personale të viktimës.

Rrethanat e tilla gjithnjë duhet të konsiderohen si rrethana të rëndësishme rënduese të cilat shpijnë në shqiptimin e dënimeve më të ashpra dhe që janë të rëndësishme për të përcaktuar rëndësinë e përgjithshme të veprës. Ngjashëm me rrethanat personale të kryerësit, rrethanat që kanë të bëjnë me viktimën i mundësojnë gjykatës që të merr parasysh veçoritë e viktimës, gjë që i mundëson të shqiptojë një dënim i cili reflekton ndikimin e veprës te viktima.

Koncepti themelor i kësaj është se shprehja viktimë për qëllim të këtij vlerësimi mund të përfshijë një numër më të gjerë sesa ato të përfshira në konceptet tradicionale të viktimës. Gjykata mund të merr parasysh ndikimin e veprës në të gjithë ata të cilët mund të jenë prekur nga kryerja e veprës. Për shembull, dëshmitarët e veprës dhe anëtarët e familjes apo më të dashurit e tyre të gjithë mund të konsiderohen si viktima të veprimeve të drejtpërdrejta të kryerësit varësisht nga natyra dhe ndikimi i tyre.

Rrethanat dhe faktorët për tu marr në konsideratë përfshijnë:

- numrin e viktimave;
- kohën gjatë së cilës është kryer vepra apo është shkaktuar viktimizimi;
- nëse vepra është kryer në mënyrë të përsëritur ndaj viktimës së njëjtë apo nëse vepra penale është kryer në vazhdim;
- shkallën e poshtëritimit të shkaktuar ndaj viktimës;
- shkaktimin e qëllimshëm të vuajtjes së viktimës përtej nivelit të nevojshëm për

përmbushjen e elementeve të veprës penale;

- ndjeshmërinë dhe/ose pamundësinë e mbrojtjes nga viktimia;
- traumën mendore dhe vuajtjen psikologjike të shkaktuar ndaj viktimës;
- moshën e viktimës – i ri apo i moshuar;
- nëse vepra është kryer me keqpërdorim të pozitës së superioritetit mbi viktimën apo përmes keqpërdorimit të besimit apo autoritetit;
- traumat afatgjate fizike dhe mendore të përjetuara nga i mbijetuari si pasojë e veprës; dhe
- nëse vepra është kryer për shkak të motivit të diskriminimit në baza racore, etnike, fetare, gjinore, të orientimit seksual apo ndonjë forme tjetër të paragjyqimit bazuar në kategorinë apo vlerën e mbrojtur.

Gjyqtarët gjithnjë duhet ta mbajnë në mend se dënimi duhet të jetë në proporcion me peshën e veprës. Ndonëse caktimi i një dënimi me të cilin janë të kënaqur viktimia, familja e miqtë e viktimës dhe publiku me gjasë do të parandalojë shpagimin apo hakmarrjen private, pakënaqësia e tyre nuk është matës absolut i përshtatshmërisë së dënimit.

3.6.1.3 Rrethanat individuale/personale të të akuzuarit

Rrethanat individuale/personale të të akuzuarit mund të jenë rënduese apo lehtësuese. Përderisa zbutja zakonisht përqendrohet në vetë të pandehurin dhe karakteristikat dhe rrethanat personale të tij, ashpërsimi më shumë shkon kah roli i kryerësit në kryerjen e veprës dhe rrethanat e ndërlydhura me vetë veprën.

Rrethanat personale lehtësuese

Rrethanat lehtësuese personale janë një mori konsideratash të ndërlykuara për gjykatën. Ato mund të jenë ngatërruese dhe ndonjëherë mund të bien në kundërshtim me bindjet personale të një gjyqtari të caktuar. Atë që një gjyqtar e konsideron si rrethanë personale lehtësuese, një gjyqtar tjetër mund ta konsiderojë si rrethanë personale rënduese.

Rrethanave të tilla gjithashtu mund t'u jepen nivele të ndryshme të rëndësisë varësisht nga qëllimi i dënimit i cili udhëheq vendimin e gjykatës.

Praktika ndërkombëtare në këtë fushë, ndonëse e njeh rëndësinë e kësaj kategorie të individualizimit të dënimit, nuk ka përcaktuar rregulla të qarta lidhur me rrethanat të cilat gjithnjë duhet të merren si rrethana lehtësuese. Në shumë aspekte, zbutja personale mund të përcaktohet nga kultura e autoritetit që cakton dënimin apo nga zhvillimet shkencore. Për shembull, zhvillimi i psikologjisë dhe hulumtimit ka sjell deri te një sërë rrethanash personale lehtësuese të cilat përqendrohen në gjendjen psikologjike të kryerësit dhendikimit të saj në fajësinë e tij. Në disa kultura, këto zhvillime janë konsideruar si të përshtatshme dhe janë përfshirë si rrethana specifike lehtësuese për shqyrtim, ndërsa në kultura tjera janë refuzuar.

Në përgjithësi, rrethanat personale lehtësuese kanë të bëjnë me kryerësin dhe jo me veprën, dhe mund të përfshijnë:

- të kaluarën e kryerësit (p.sh. karakterin e mirë, jetën produktive, të kaluarën e vështirë);
- rrethanat e kryerësit në kohën e kryerjes së veprës (p.sh. presionet financiare, problemet psikiatrike, kufizimet intelektuale, papjekuria);
- sjellja e kryerësit pas kryerjes së veprës penale dhe gjatë ndjekjes (p.sh. pendimi, kompensimi, kërkimi i ndihmës për problemet që kanë kontribuar në kryerjen e veprës, bashkëpunimi me policinë, prokurorinë dhe gjykatat);
- gjasat për rehabilitimin e tanishëm dhe në të ardhmen të kryerësit (p.sh. përgjegjësitë familjare, partneri mbështetës, kapaciteti për të trajtuar problemet që kanë çuar deri te sjellja kriminale);

Ato gjithashtu mund të kategorizohen edhe në një numër rrethanash siç janë:

- ato të cilat tregojnë fajësi të zvogëluar, siç është mosha e re apo problemet me shëndetin mendor, nevojat urgjente, karakteri i mirë i mëparshëm dhe ato të cilat tregojnë rrezik të ultë të përsëritjes së veprës – që ndërlidhen me pendimin dhe përpjekjet për të bërë kompensimin, rrethanat e kryerësit, apo hapat e ndërmarrë drejt rehabilitimit.
- ato të cilat tregojnë ndjeshmëri të veçantë ndaj dënimit, siç është dërmimi i shkaktuar nga ndjekja, humbja e reputacionit dhe pozitës në shoqëri apo fakti se kryerësi mund të jetë jashtëzakonisht i papërgatitur për të mbajtur dënimin me burgim; dhe
- Rrethanat të cilët kërkojnë mëshirë, siç është mbështetja e viktimës për kryerësin, përgjegjësitë familjare dhe ‘dëmi kolateral’ që burgimi do të shkaktonte te të afërmit e tij, apo kontributi shoqëror i bërë nga kryerësi.

Duke marrë parasysh natyrën potencialisht kundërtshënese të këtyre rrethanave, gjykatat duhet të jenë veçanërisht të vetëdijshme nëse këto rrethana janë përfshirë në mënyrë specifike në legjislacion për vlerësim apo nëse atyre ligji vetëm u referohet në mënyrë të përgjithshme. Referimi i përgjithshëm në rrethanat personale të të pandehurit apo mundësimi i konsideratave tjera nga gjykata duhet të rrisë nivelin e shqyrtimit të kujdesshëm nga gjykata të ndonjë rrethane të caktuar personale dhe provave të ekzistimit të saj.

Rrethanat personale rënduese

Siç u cek më parë, rrethanat personale rënduese kanë të bëjnë më pak me cilësitë e qenësishme të individit dhe më shumë janë të përqendruara në faktet e vetë veprës penale dhe rolin e të akuzuarit në kryerjen e saj.

Rrethanat dhe faktorët për tu marr në konsideratë përfshijnë:

- nivelin e pjesëmarrjes së kryerësit në kryerjen e veprës,
- nëse i pandehuri ka pasur rol udhëheqës,

- nëse i pandehuri ka qenë në pozitë eprorë në strukturën hierarkike, situatën familjare apo marrëdhënien ndërmjet viktimës dhe të pandehurit;
- nëse viktimja ka qenë në pozitë të varësisë në raport me të pandehurin;
- nëse i pandehuri ka qenë në pozitë të besimit në raport me viktimën;
- nëse i pandehuri ka shfaqur motivime në baza fetare, etnike, politike, diskriminuese dhe/apo të hakmarrjes,
- sjellja e mëparshme kriminale pavarësisht nëse është e llojit të njëjtë apo të ngjashëm, dhe
- mungesa e pendimit.

Siç mund të shihet, disa nga rrethanat apo konceptet e cekura më lartë janë thjeshtë e kundërta e rrethanave të cekura në rrethanat personale lehtësuese. Ky është një shembull tjetër i asaj se sa të ngatërruara dhe të papërcaktuara janë aspektet personale lehtësuese dhe rënduese.

3.6.2 Rrethanat që lidhen me procedurën

Sikur në rastet e mësipërme, rrethanat që lidhen me procedurën janë një përzierje e rrethanave lehtësuese dhe rënduese të cilat kanë të bëjnë me aspektet procedurale të rastit. Ato zakonisht përqendrohen në veprimet e të pandehurit pas kryerjes së veprës dhe vënë theks të veçantë në sjelljen e të pandehurit në raport me zbatuesit e ligjit, gjykatën dhe viktimën.

Rrethanat dhe faktorët për tu marrë në konsideratë përfshijnë:

- sjelljen dhe/apo qasjen e të pandehurit pas kryerjes së veprës penale, si para ashtu edhe pas arrestit;
- nëse i pandehuri është dorëzuar vullnetarisht para organeve të zbatimit të ligjit dhe në cilën fazë të hetimit;
- nëse i pandehuri ka dhënë informata dhe/ose dëshmi lidhur me veprën penale dhe/ose bashkëkryerësit;
- nëse i pandehuri ka dhënë informacione dhe/ose dëshmi lidhur me vepra tjera penale apo aktivitetin kriminal për të cilin i pandehuri ka njohuri;
- nëse i pandehuri ka pranuar pjesëmarrjen në veprë penale dhe në cilën fazë të procedurës;
- nëse i pandehuri ka ndërmarrë veprime proaktive për të rregulluar situatat të cilat kanë kontribuar në kryerjen e veprës;
- kompensimin e dëmit apo kthimin e dobisë së fituar me veprë penale para përfundimit të procedurës;
- përpjekjet për të kompensuar viktimën;
- nëse i pandehuri ka tentuar të asgjësojë provat dhe/ose të ndikojë në dëshmitarë gjatë hetimit dhe ndjekjes;
- arritjen e marrëveshjes mbi pranim të fajësisë apo pranimin e fajësisë për akuzat dhe në cilën fazë të procedurës; dhe

- çfarëdo rrethane tjetër në rastin e caktuar që tregon sjelljen e kryerësit në raportme veprën, e cila mund të ndikojë në dënim.

Varësisht nga lloji i veprës, disa prej kategorive përkojnë me njëra tjetrën ose kanë kufinj të paqartë: për shembull, gjykatat mund ta konsiderojnë dëshminë apo informacionin e dhënë nga i akuzuari si pjesë e bashkëpunimit me prokurorin, ose mund të ketë raste kur këto dy kategori trajtohen ndaras. Gjykata duhet të jetë veçanërisht e kujdesshme për mundësinë e përkimit të rrethanave me njëra tjetrën pasi që ato shpesh cilësohen si rrethanat më të rëndësishme për zbutjen e dënimit të të pandehurit.

ZBUTJA DHE ASHPËRSIMI:
Zbatimi në Kosovë

KAPITULLI IV

ÇËSHITJE TË PËRGJITHSHME PËR ASHPËRSIMIN DHE ZBUTJEN SIPAS NENIT 74 TË KODIT PENAL

Rrethanat e përcaktuara në nenin 74 të KP kryesisht bien nën kategoritë e gjera dhe rrethanat e diskutuara më herët të cilat zakonisht merren parasysh në zbutjen dhe ashpërsimin e dënimit. Asnjëra prej tyre nuk janë të kundërtënësë. Siç është zakonisht rasti, rrethanat rënduese janë të prira për të qenë më specifike dhe të qarta sesa rrethanat lehtësuese. Kjo është në pajtim me konceptin e pranuar se rrethanat të cilat e ashpërsojnë dënimin duhet të jenë të sakta, të qarta dhe të mund të provohen. I pandehuri dhe publiku e kanë të qartë se çfarë veprimesh do të rezultojnë në dënim më të ashpër.

Megjithatë, dispozitat për zbutje janë mjaft të përgjithësuar. Deri në një shkallë kjo i atribuohet faktit se është e pamundur të parashihet çdo lloj rrethane e cila mund të paraqitet para gjyqtarit apo të vendoset në mënyrë autoritative se në ç'mënyrë duhet të zbatohet një rrethanë. Por ndonëse kjo qasje lejon fleksibilitet më të madh, ajo ofron shumë pak udhëzime dhe rrjedhimisht rrit gjasat e ndërtimit të praktikave divergjente ndëshkimore. Kjo pastaj kontribuon në mosharmonizimin e dënimeve, zvogëlon sigurinë juridike, dhe rrit kritikën ndaj gjyqësorit. Në kuptim të caktimit të dënimit, kodi jep udhëzime të pakta lidhur me "individualizimin ligjor" dhe udhëzime të mjaftueshme të "individualizimit gjyqësor".

Çështja e udhëzimeve rëndohet edhe më shumë nga dispozitat "e hapura" si për rrethanat rënduese ashtu edhe ato lehtësuese të parapara në Kod. Gjykatat detyrohen të marrin parasysh rrethanat e cekura, por "nuk kufizohen" nga to. Prandaj gjykata është e lirë për të marrë parasysh dhe për të inkorporuar çfarëdo rrethane tjetër sipas bindjes së saj.

Sërish, ndonëse kjo është padyshim një praktikë ndërkombëtare e rregullt dhe legjitime, megjithatë ofron udhëzime të pakta për të udhëhequr diskrecionin e gjykatës në ndonjë mënyrë domethënëse. Gjykatat duhet ta shohin shfrytëzimin e rrethanave të papërcaktuara si diçka që duhet rezervuar për situata shumë të rralla në të cilat rrethana është qartazi e përshtatshme për t'u marrë parasysh dhe e mbështetur fuqishëm ngaprovat.

OSBE-ja, në vlerësimin e praktikës së dënimeve që nga hyrja në fuqi e Kodit Penal, thekson se në shumë raste gjyqtarëve iu mungon të kuptuarit e drejtë se si rrethanat e ndryshme mund, apo si do duhej, të ndikojnë në vendimin mbi dënimin. Ndonëse llojet e mundshme të rrethanave lehtësuese dhe rënduese janë mjaft të gjera, dhe gjykatat kanë diskrecionin për të vendosur lidhur me mënyrën e zbatimit e tyre në caktimin e dënimit, ka disa rrethana të caktuara të cilat qartazi duhet apo nuk duhet të merren parasysh. Rrethana lehtësuese apo rënduese duhet të jetë relevante për veprën penale apo për rrethanat personale të kryerësit. Referimi standard apo cekja e rrethanave lehtësuese apo rënduese ndonjëherë sjell deri te

referimi në rrethana të cilat nuk janë relevante për rastin specifik.¹¹³

Pjesët në vijim i ofrojnë gjykatës një qasje më specifike ndaj secilës rrethanë rënduese dhe lehtësuese. Ato paraqesin një shtjellim të shkurtë të secilës rrethanë dhe shembuj të asaj se çfarë duhet të përfshijë secila rrethana, si dhe vlerësim të asaj se kur duhet të përjashtohet një rrethanë. Aty gjithashtu flitet lidhur me atë se ç' rëndësi duhet të ketë një rrethanë në vlerësimin e përgjithshëm të gjykatës dhe cilat fakte mund ta ndryshojnë atë vlerësim dhe/apo cilat pyetje duhet të parashtrohen.

Vlerësimi dhe zbatimi i rrethanave të mësipërme është mjete primar në bazë të të cilit gjykata ia përshtat dënimin individit dhe rrethanave specifike që kanë të bëjnë me veprën.

Rezultati përfundimtar i analizimit të këtyre rrethanave është që të arrihet në një dënim i cili është “në proporcion me peshën e veprës dhe sjelljen dhe rrethanat e kryerësit” ashtu siç ceket në nenin 73 të KP.

Neni 74 i Kodit Penal të Kosovës përcakton këto rrethana të cilat gjykata duhet t'i merr parasysh:

Me rastin e caktimit të dënimit, gjykata merr parasysh por nuk kufizohet në rrethanat e mëposhtme rënduese:

- 2.1.shkallën e lartë të pjesëmarrjes së personit të dënuar në veprën penale;
- 2.2.shkallën e lartë të dashjes nga ana e personi të dënuar, përfshirë çfarëdo prove të paramendimit;
- 2.3.praninë e dhunës ose kanosjes me dhunë në kryerjen e veprës penale;
- 2.4.nëse vepra penale është kryer në mënyrë posaçërisht mizore;
- 2.5.nëse vepra penale përfshin disa viktime;
- 2.6.nëse viktime e veprës penale ka qenë posaçërisht e pambrojtur apo e ndjeshme;
- 2.7.mosha e viktimës, nëse është i ri apo i moshuar;
- 2.8.shkallën e dëmit të shkaktuar nga personi i dënuar, përfshirë vdekjen, lëndimin e përhershëm, transmetimin e sëmundjes tek viktime apo çfarëdo dëmi tjetër të shkaktuar viktimës ose familjes së tij;
- 2.9.çfarëdo keqpërdorimi të pushtetit ose pozitës zyrtare nga personi i dënuar në kryerjen e veprës penale;
- 2.10.dëshmi të shkeljes së besimit nga ana e personit të dënuar;
- 2.11.nëse vepra penale është kryer si pjesë e veprimtarisë së grupit të organizuar kriminal dhe/ose;
- 2.12.nëse vepra penale kryhet ndaj personit ose grupit të personave, ose pronës, për shkak të origjinës etnike ose kombëtare, shtetësisë, gjuhës, besimeve fetare, ose mungesës

¹¹³ Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misioni në Kosovë, Departamenti për të Drejta të Njeriut dhe Komunitete, Vlerësimi joadekuat i rrethanave lehtësuese dhe rënduese nga gjykatat, numri 5, korrik 2010, fq. 4.

së besimeve fetare, ngjyrës, gjinisë, orientimeve seksuale, ose për shkak të afërsisë me personat me karakteristikat e lartpërmendura;

2.13.ndonjë dënim penal të mëparshëm të personit të dënuar.

Me rastin e caktimit të dënimit, gjykata merr parasysh por nuk kufizohet në rrethanat e mëposhtme lehtësuese:

3.1.rrethanat të cilat për pak nuk arrijnë të jenë bazë për përjashtimin e përgjegjesisë penale, si për shembull, aftësia e zvogëluar mendore;

3.2.dëshmia për provokim nga ana e viktimës;

3.3.rrethanat personale dhe karakteri i personit të dënuar;

3.4.dëshmia që personi i dënuar ka luajtur rol relativisht të vogël në veprën penale

3.5.fakti që personi i dënuar ka marrë pjesë në veprën penale jo si kryes kryesor por përmes ndihmës, inkurajimit ose duke ndihmuar tjetrin në ndonjë mënyrë tjetër;

3.6.mosha e personit të dënuar, i ri apo i moshuar;

3.7.dëshmia që personi i dënuar ka bërë restituimin apo kompensimin e viktimës;

3.8.bashkëpunimi i përgjithshëm i personit të dënuar me gjykatën, përfshirë dorëzimin vullnetar;

3.9.bashkëpunimin vullnetar të personit të dënuar në hetimin ose ndjekjen penale;

3.10.pranimin e fajit;

3.11.keqardhjen e shfaqur nga personi i dënuar;

3.12.jelljen e personit të dënuar pas konfliktit; dhe/apo

3.13.në rastet kur personi është i dënuar për veprën penale të marrjes së pengjeve, rrëmbimit apo privimit të kundërligjshëm nga liria ose siç përcaktohet në nenet 175, 194 ose 196 të këtij Kodi, kontributi në mënyrë efektive për lëshimin ose për ta sjellë të gjallë personin e rrëmbyer, marrë apo ndalur ose dhënia vullnetare e informatave që kontribuojnë në identifikimin e përgjegjësve të tjerë për vepër penale.

Secila rrethanë e përcaktuar në nenin 74 të Kodit Penal të Kosovës do të shtjellohet në hollësi në Kapitujt në vijim

KAPITULLI V

RRETHANAT RËNDUESE NGA NENI 74

5.1 Shkalla e lartë e pjesëmarrjes së personit të dënuar në veprën penale ¹¹⁴

Vlerësimi i drejtë i pjesëmarrjes së të akuzuarit në kryerjen e veprës penale duhet të bëjë dallimin ndërmjet formave të ndryshme të përgjegjësisë individuale. Rrethanat që ndërlidhen me pozitën dhe rolin e të akuzuarit në kryerjen e veprës penale (siç është ‘pozita superiore’, ‘keqpërdorimi i autoritetit apo besimit’) gjithnjë duhet të merren si rrethana të rëndësishme rënduese. Megjithatë, rrethana e ‘pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë’ është faktor që ndërlidhet më shumë me elementet e veprës dhe pjesëmarrjen e të akuzuarit në të.

Vlerësimi i kësaj rrethane rënduese varet nga disa çështje. E para, që në kryerjen e veprës kanë marrë pjesë të paktën dy individë. E dyta, që të ketë një shkallë të pjesëmarrjes nga njëri prej këtyre personave e cila konsiderohet si më e “lartë” apo më e madhe se tjetra.

Ndonëse faktori i parë është mjaft i thjeshtë, i dyti është më sfidues dhe kërkon shqyrtim të kujdesshëm nga gjykata. Siç është rasti me shumë dispozita lidhur me caktimin e dënimit, kjo nuk është rrethanë për të cilën ofrohen udhëzime të qarta për gjykatën lidhur me mënyrën se si duhet ta zbatojë atë. Sidoqoftë, ka dy vlerësime në të cilat gjykata duhet të përqendrohet gjatë shqyrtimit të ekzistimit të kësaj rrethane rënduese. E para është që të shqyrtojë skenarin faktik të veprës penale dhe kontributin e secilit pjesëmarrës në të. E dyta është që të shqyrtojë rolin e të pandehurit dhe nëse ai mund të konsiderohet udhëheqës.

o Krahasimi i veprimeve individuale

Sa i përket vlerësimit të parë, gjykata duhet të shqyrtojë kontributin individual të secilit pjesëmarrës në raport me njëri tjetrin. Megjithatë, ajo që është e qartë nga gjuha e përdorur në ligj është se gjykata nuk lëshohet në vlerësim të detajuar të asaj nëse një i pandehur thjeshtë ka marrë pjesë më shumë se tjetri. Në të shumtën e rasteve, paskonstatimit të nivelit të duhur të fajësisë, të gjithë të pandehurit do të konsiderohen se kanë marrë pjesë “mesatarisht” në kryerjen e veprës. Prandaj, dallimet e vogla në pjesëmarrje të cilat mund të shpijnë në përfundimin se njëri pjesëmarrës është përfshirë më shumë “veprime” sesa tjetri në përgjithësi nuk duhet të konsiderohen si të mjaftueshme për të arsyetuar aplikimin e kësaj rrethane rënduese.

¹¹⁴ Kodi Penal, neni 74, par.2.1

Në vend të kësaj, gjykata duhet të shqyrtojë nëse dallimi në pjesëmarrje është domethënës dhe nëse sjellja është shumë më e rëndësishme se suksesi i veprës. Faktet nuk duhet lënë asnjë dyshim në mendjen e gjykatës se pjesëmarrja e një akteri të caktuar është qartazi më e rëndësishme se pjesëmarrja e akterëve tjerë dhe rrjedhimisht meriton dënim më të ashpër.

Shembull: Dy të pandehur të armatosur hyjnë në një shitore me qëllim që ta grabisin. Njëri nga të pandehurit (D1) rri te dera e shitores për të vëzhguar, ndërsa i dyti (D2) i afrohet shitësit. D2 e nxjerr armën dhe ia drejton shitësit duke i kërkuar të gjitha paratë. Shitësi refuzon dhe D2 e qëllon shitësin me armë në këmbë. D2 e hap arkën dhe i merr të gjitha paratë. Të dy të pandehurit pastaj largohen nga shitorja dhe ikin me makinë. D1 nuk bën asgjë më shumë përveç pritjes te dera si vëzhgues dhe kurrë nuk e nxjerr armën nga xhepi.

Në këtë shembull, gjykata duhet të merr parasysh të gjitha veprimet e të dy të pandehurve në raport me veprën si dhe në raport me njëri tjetrin. Nuk ka dyshim se të dy të pandehurit kanë marrë pjesë me shkallë të mjaftueshme të përgjegjësisë për t'i gjetur fajtor për veprat e kryera.

Megjithatë D2 qartazi ka kryer shumicën e veprimeve kriminale në krahasim me D1. Përderisa D1 thjeshtë ka qëndruar te dera duke vëzhguar, D2 e ka vringëlluar armën, e ka përdorur kundër viktimës, dhe i ka marrë paratë nga arka. Në fakt, nuk është e pamundshme që edhe po të mos kishte qenë D1 fare i pranishëm, D2 do ta përfundonte veprën i vetëm. Ndonëse veprimet e mjaftueshme nga një pjesëmarrës për ta kryer veprën edhe pa praninë e tjetrit nuk është standardi në bazë të të cilit duhet gjykuar kjo rrethanë rënduese, megjithatë kjo paraqet një shembull shumë të mirë të situatës ku njëri akter ka arritur “shkallën e lartë” të pjesëmarrjes. Në këtë situatë, gjykatamund të konkludoj lehtë se kjo rrethanë rënduese aplikohet për D2.

Kjo natyrisht çon deri te pyetja se çfarë ndikimi do të ketë rrethana rënduese e “shkallës së lartë të pjesëmarrjes” së D2 në të pandehurit tjerë. Më saktësisht, nëse rrethana e tillë rënduese duhet që gjithnjë të çojë deri te gjetja e rrethanës lehtësuese nga paragrafi 3.4 “dëshmia që personi i dënuar ka luajtur rol relativisht të vogël në veprën penale” apo rrethanës nga paragrafi 3.5 “fakti që personi i dënuar ka marrë pjesë jo si kryerës kryesor por përmes ndihmës, inkurajimit ose duke ndihmuar tjetrin në ndonjë mënyrë tjetër”. Ndonëse është padyshim e mundshme që nga faktet e përshkruara më lartë, gjykata të konkludoj se D1 meriton zbutje të dënimit, ky nuk është konkludim automatik. Në shumicën e rrethanave do të jetë e mundur që një apo më shumë nga të pandehurit tjerë prapëseprapë të konsiderohen si pjesëmarrës mesatar në kryerjen e veprës gjersa veprimete ndonjë të pandehuri tjetër të arrijnë “shkallën e lartë të pjesëmarrjes”. Gjkata duhet të jetë veçanërisht e vetëdijshme për potencialin e zbutjes së dënimit në situatat kur janë të përfshirë dy të pandehur dhe njëri prej tyre qartazi ka marrë pjesë më shumë se tjetri.

o Organizimi dhe drejtimi

Çështja e dytë në të cilën gjykata duhet të përqendrohet është roli udhëheqës i të pandehurit në organizimin dhe drejtimin e përgjithshëm të veprës penale. Ky vlerësim mund të ndahet në dy

kategori kryesore.

Së pari, gjykata duhet të vlerësojë rolin e të pandehurit në veprimet përgatitore të cilat kanë çuar deri te kryerja e veprës penale. Në të shumtën e rasteve, ngjarjet të cilat çojnë deri te kryerja e veprës do të kenë ndikim të fortë në vlerësimin e gjykatës. Kjo do të jetë posaçërisht relevante në kryerjen e veprave të ndërlikuara ku vepra përfundimtare në vete është si rezultat i një sërë hapave të cilën mund të mos jenë vepra penale në vetvete, por të cilat janë të rëndësishëm për kryerjen e veprës penale përfundimtare. Ato gjithashtu mund të jenë të pranishme edhe në veprat më pak të ndërlikuara. Në rastin e lartpërmendur, njëri i pandehur mund të ketë siguruar planet e ndërtesës apo armët ose të ketë vëzhguar atë vend. Të gjitha këto mund të jenë bërë disa javë para kryerjes së veprës apo vetëm disa orë më parë. Pavarësisht kohës kur janë bërë, kjo mund të kontribuojë në shkallën e pjesëmarrjes nga i pandehuri në kryerjen e veprës dhe ndikon në ashpërsimin e dënimit.

Së dyti, gjykata duhet të shqyrtojë të gjitha veprimet apo faktet të cilat tregojnë se i pandehuri ka kontrolluar apo drejtuar individët tjerë. Kjo mund të bëhet para kryerjes së veprës gjatë fazës përgatitore dhe gjatë veprimeve aktuale që përbëjnë vetë veprën penale. Në rastin e kësaj të fundit, i pandehuri mund t'iu tregojë pjesëmarrësve tjerë se si të sillen, çfarë të bëjnë gjatë grabitjes dhe të drejtojnë veprimet e tyre gjatë zhvillimit të ngjarjes. Në të dyja rastet, gjykata gjithashtu mund të shqyrtojë nëse ka marrëdhënie, qofshin ato formale apo joformale, të cilat tregojnë drejtimin nga njëri prej tyre. Këto mund të jenë marrëdhënie aktuale apo të së kaluarës. Shembujt përfshijnë marrëdhëniet familjare, strukturat e punës (punëdhënës/punonjës), kontratat, marrëdhëniet e mëparshme ushtarake dhe/apo afariste.

o Praktika ndërkombëtare

Ndonëse nuk ka ndonjë paralele të drejtpërdrejtë në praktikën ndërkombëtare për këtë rrethanë, kjo mund të shqyrtohet në kontekst të pozitës udhëheqëse në strukturën hierarkike. Kjo është konform bindjes se udhëheqësit, veçanërisht ata në struktura të organizuara hierarkike, duhet të dënohen më ashpër sesa vartësit e tyre. Siç theksohet nga TNPJ në rastin Stacic:¹¹⁵

...sikurse te krimet e jakës së bardhë, kryerësi prapa kryerësit të drejtpërdrejtë – kryerësi me dorëza të bardha – mund të meritojë dënim më të lartë sesa ai i cili fizikisht ka marrë pjesë në kryerjen e veprës varësisht nga rrethanat specifike të rastit.

Nuk është për t'u çuditur se kjo rrethanë citohet më së shpeshti nga tribunatet ndërkombëtare në raste të krimeve të luftës dhe gjenocidit. Në raste të tilla, ekzistimi i udhëheqësit, veçanërisht në strukturë formale hierarkike, konsiderohet i rëndësishëm thelbësor për përfundimin e veprës. Pa ekzistimin e strukturës formale ushtarake dhe të gjitha rrethanave që e shoqërojnë atë, veprat mund të mos kishin ndodhur kurrë. Andaj gjykatat kanë konsideruar që kjo duhet të merret si rrethanë rënduese. Ndonëse ka disa raste ndërkombëtare ku nuk merret si rrethanë rënduese,

¹¹⁵ Rasti Nr.IT-97-24-T, Aktgjykimi, Prokurori kundër Milomir Stacic, Tribunali Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavi, (31 korrik 2003), Par.918.

kjo në mënyrë mbizotëruese është zbatuar në situatat në të cilat pozita udhëheqëse ka qenë element i veprës.

Është shumë interesant të shihen nuancat e arsytimit të TNPJ në rastin Plavsic dhe mënyrën se si ata e kanë konsideruar rolin e saj në Presidencë si rrethanë rënduese. Në aktgjykimin e tij, Trupi Gjykyes kishte thënë: *“Trupi Gjykyes pranon se pozita superiore e të akuzuarës është rrethanë rënduese në këtë rast. E akuzuara nuk ka qenë në radhën e parë të udhëheqësisë: të tjerët e kanë mbajtur atë pozitë. Ajo nuk ka ideuar planin i cilika çuar deri te ky krim dhe ka pasur rol më të vogël në ekzekutimin e tij se të tjerët. Pavarësisht kësaj, znj. Plavsic ka qenë në Presidencë, organin më të lartë civil, gjatë fushatës dhe e ka inkurajuar dhe mbështetur atë përmes pjesëmarrjes së saj në Presidencë dhe deklarimeve të saj”*.¹¹⁶

Në anën tjetër, pjesëmarrja indirekte e të akuzuarit në kryerjen e veprave duhet të jetë e lidhur me një teori të formuluar më mirë të llojeve të përgjegjësisë, e jo të cilësohet si rrethanë lehtësuese.

Për shembull, në mendimin e Dhomës së Apelit të TNPJ *“dëshmia e pjesëmarrjes joaktive nga udhëheqësi në veprimet kriminale të vartësve të tij i shtohet shkallës së dështimit të udhëheqësit për të parandaluar apo ndëshkuar ato veprime dhe rrjedhimisht mund ta ashpërsojë dënimin...Dështimi për të parandaluar apo ndëshkuar veprat e kryera nga vartësit është sjellje relevante e fajësisë dhe mungesa e pjesëmarrjes aktive në kryerjen e veprave nuk e zvogëlon fajësinë”*.¹¹⁷

Si i tillë, veprimi i ndihmës në kryerje të veprës është formë e pjesëmarrjes e cila shpeshherë konsiderohet si më pak e rëndë sesa pjesëmarrja personale apo kryerja e drejtpërdrejtë dhe, varësisht nga rrethanat, mund të meritojë dënim më të butë sesadërimi i shqiptuar për kryerje të drejtpërdrejtë.

E njëjta vlen edhe për mosgatishmërinë në kryerjen e veprës penale. Mosgatishmëria në përgjithësi nuk do duhej të kishte rol në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Rrethana e ‘gatishmërisë/entuziazmit’ në kryerje ndërthrin elemente të cilat më shumë janë të ndërlidhura me *mens rea* (dashjen) e nevojshme për veprat e kryerja. Shkalla e përfshirjessë të akuzuarit veç është vlerësuar (dhe peshuar në mënyrë adekuate) në lidhje me elementin mendor, dhe nuk ka nevojë që të merret parasysh sërish në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit.

Lidhur me mundësinë që ekzistimi i urdhrit nga lartë të merret si rrethanë lehtësuese përtë akuzuarin i cili është dashur ta zbatojë atë urdhër (me fjalë tjera, një formë e shtrëngimit), duhet të theksohet se një rrethanë e tillë jo domosdoshmërisht përbën rrethanë lehtësuese, dhe qartazi nuk i garanton ushtarëve mbrojtje të plotë. Padyshim që në rastet kur i akuzuari ka qenë vartës, por në të njëjtën kohë ka qenë pjesëmarrës vullnetar në sjelljen kriminale, nuk do të ketë zbutje të dënimit të tij. Ekzistimi i urdhrit nga lartë mund të cilësohet si rrethanë lehtësuese vetëm kur

¹¹⁶ Rasti Nr.IT-00-39&40/1-S, Aktgjykimi për Dënim, Prokurori kundër Biljana Plavsic, Tribunali Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavi, (27 shkurt 2003) par. 57:

¹¹⁷ Rasti Nr.IT-96-21-A, Aktgjykimi, Prokurori kundër Zejnil Delalic, Adravko Mucic, Hazim Delic dhe Esad Landzo, Tribunali Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavi, (20 shkurt 2001), Par.736-737, citohet Aktgjykimi i Apelit në rastin Aleksovski, par. 183.

virtësi kryen veprë pa vullnetin e tij nën shtrëngim absolut, si rezultat i natyrës shtrënguese të urdhrorit të pranuar nga eprori i tij, mosbindja ndaj të cilit do të mund ta rrezikonte jetën e vet të akuzuarit.

o Dyfishimi dhe kujdesi

Sikurse me vepra tjera, është veçanërisht e rëndësishme që të vlerësohet nëse akuza veç e inkorporon rolin e personit. Për shembull, neni 143 për organizimin dhe pjesëmarrjen në grup terrorist parasheh dënim prej pesë deri në dhjetë vjet për pjesëmarrjen, ndërsa dhjetëderi në njëzet vjet për personin që organizon grupin. Andaj kjo rrethanë nuk do të mund të zbatohet në atë situatë.

Me këtë rrethanë gjithashtu ka rrezik të konsiderueshëm të dyfishimit me kategoritë tjera, veçanërisht kur gjykata merr parasysh planifikimin e veprës si dhe ekzistimin e organizatës. Kur gjykata vlerëson një situatë në të cilën ka paraplanifikim të konsiderueshëm, rrethana 2.2 lidhur me shkallën e lartë të dashjes dhe/apo paramendimit mund të vihet në funksion. Është plotësisht e mundur që paraplanifikimi të përfshijë edhe një shkallë të paramendimit si dhe të ndajë një të pandehur nga të tjerët në kuptim të shkallës së lartë të pjesëmarrjes. Ngjashëm me këtë, mund të ketë dyfishim kur ka strukturë të organizuar e cila përfshin një strukturë më formale siç janë organizatat qeveritare apo ushtarake në të cilat i pandehuri është udhëheqës formal. Në atë rast është e mundur që të zbatohet rrethana 2.9 pasi që përfshihet një lloj i “keqpërdorimit të pushtetit ose pozitës zyrtare”. Varësisht nga faktet, keqpërdorimi i pushtetit mund ta shtyjë të pandehurin në shkallë të lartë të pjesëmarrjes në kryerjen e veprës.

Gjykata duhet të jetë e vetëdijshme për mundësinë e ndërveprimit ndërmjet këtyre rrethanave dhe të shqyrtojë me kujdes rëndësinë e secilës rrethanë në rezultatin përfundimtar. Gjykata nuk duhet që t’i jep peshë maksimale secilës rrethanë thjeshtë sepse ekziston, por duhet që me kujdes ta shpërndajë peshën e tyre në mënyrë të pavarur nga njëra tjetra. Kjo nuk është detyrë e lehtë, por duke marrë parasysh ndikimin që mund ta ketë në ashpërsimin e dënimit duhet të shqyrtohet me shumë kujdes. Pavarësisht kësaj, kur ka dyfishim të të tre faktorëve, kjo është një tregues për gjykatën se ka nevojë për ashpërsim.

o Entuziazmi në pjesëmarrje

Kjo rrethanë gjithashtu nuk kërkon vlerësimin e “entuziazmit” për të marrë pjesë në kryerjen e veprës. Ndonëse disa struktura të caktimit të dënimit e konsiderojnë të nevojshme ashpërsimin e dënimit kur gjendja mendore e të pandehurit tregon zell të veçantë për ta kryer veprën, Kodi Penal i Kosovës nuk e parasheh një gjë të tillë. Me të arritur nivelin e kërkuar të gjendjes mendore për ta mbajtur kryerësin penalisht përgjegjës, nuk ka ndonjë ashpërsim për kryerësin i cili shfaq dëshirë të zjarrtë për ta kryer veprën penale. Ngjashëm me këtë, mungesa e dëshirës për të marrë pjesë në kryerjen e veprës veç është marrë parasysh në *mens rea* (qëllimin) lidhur me veprën. Kjo shtjellohet më në hollësi në pjesën e rrethanave lehtësuese.

- Konsideratat e përgjithshme përfshijnë:
 - Veprimet të cilat në mënyrë të konsiderueshme janë më të mëdha sesa ato të pjesëmarrësve tjerë
 - Planifikimi i aktiviteteve për të shtuar gjasat për përfundimin me sukses të veprës penale
 - Rekrutimi dhe financimi i pjesëmarrësve tjerë
 - Drejtimi i aktiviteteve për të tjerët
 - Sigurimi i mjeteve për ta përfunduar veprën
 - Ndërmarrja e hapave gradual për të çuar tutje veprën

- Pyetjet relevante përfshijnë:
 - A ka qenë i pandehuri në pozitë hierarkike?
 - A ka qenë struktura formale apo joformale?
 - A ka qenë i pandehuri udhëheqës në strukturë apo në grup?
 - A ka qenë roli i të pandehurit i rëndësishëm në planifikimin e veprës?
 - A ka kontribuar pozita e të pandehurit në kryerjen e veprës?
 - A e kanë rritur seriozitetin e veprës veprimet apo pozita e të pandehurit?
 - A do të ishte kryer me sukses vepra pa pjesëmarrjen e të pandehurit?

5.2. Shkalla e lartë e dashjes nga ana e personit të dënuar, përfshirë çfarëdo prove tëparamendimit¹¹⁸

Në përgjithësi, koncepti i paramendimit konsiderohet si planifikim para kryerjes së veprës penale. Konsiderohet si shkallë më e lartë e rrezikut për shoqërinë pasi që kjo esencialisht paraqet sulm ndaj vlerave shoqërore dhe tregon angazhim e ndoshta edhe vazhdimësi më të madhe sesa veprat spontane. Rreziku i tyre ndaj shoqërisë në radhë të parë është i rrënjosur në konceptin që angazhimi më i lartë për të kryer veprën tregon se gjasat për rehabilitim të suksesshëm mund të jenë më të ulta. Siç ceket në aktgjykimin e Trupit Gjykses të TNPJ në rastin Krstic: *“Pjesëmarrja e paramenduar apo entuziaste në veprën penale domosdoshmërisht tregon një shkallë më të lartë të kriminalitetit në anën epjesëmarrësit. Në përcaktimin e dënimit të përshtatshëm, duhet bërë dallim në mes të individëve të cilët i kanë lejuar vetes që të futen në vorbullin e dhunës, qoftë edhe pa dëshirë, dhe atyre të cilët e kanë iniciuar apo rënduar atë dhe rrjedhimisht kanë kontribuar në mënyrë substanciale në shkaktimin e dëmit të përgjithshëm”*.¹¹⁹

¹¹⁸ Kodi Penal, neni 74, par.2.2

¹¹⁹ Rasti Nr.IT-98-33-T, Aktgjykimi, Prokurori kundër Radislav Krstic, Tribunali Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavi, (2 gusht 2001), Par.711.

Paramendimi kryesisht bie në kategorinë e rrethanave personale të kryerësit por edhe në kuadër të rrethanave të përgjithshme që kanë të bëjnë me kryerjen e veprës. Kjo jo vetëm që e përshkruan individin, por edhe atë që ndodh gjatë fazave që çojnë deri te vepra. Prandaj kjo rrethanë kërkon shqyrtim me kujdes të fakteve specifike të situatës.

Në vlerësimin e kësaj rrethane janë dy çështje që gjykata duhet t'i shqyrtojë. E para, shkalla e planifikimit dhe përgatitjes para kryerjes së veprës. Ky është një vlerësim mjafti thjeshtë i cili është diskutuar hollësisht në kuadër të rrethanës 2.1. Gjykata duhet të merrparasysh shkallën e planifikimit dhe veçanërisht kohën e përfshirë në përgatitjen e veprës.

Rrethana e dytë ka të bëjë kryesisht me situatat kur kryerësi vepron në bazë të bindjes se atij i është bërë e padrejtë nga dikush apo nga diçka. Situata klasike do të mund të përshkruhej si vepër e motivuar nga hakmarrja apo ruajtja e “nderit”.

Në këto raste, vlerësimi relevant do të përqendrohet në kohën dhe mundësinë që i pandehuri e ka pasur për të reflektuar lidhur me rrethanat të cilat kanë shkaktuar nevojën për hakmarrje. Të pandehurit i cili ka pasur mundësi të mjaftueshme për t'u “ftohur” dhe prapëseprapë vendos për t'u hakmarrë duhet t'i caktohet shkalla maksimale rënduese, veçanërisht kur ka pasur planifikim të konsiderueshëm.

o Dyfishimi dhe kujdesi

Ekzistimi i shkallës së lartë të dashjes apo paramendimit mund të përkojë me rrethanën 2.1 në situatat kur përfshihen disa kryerës. Në përpjekje për të shmangur llogaritjen e dyfishtë, gjykata duhet t'ia atribuoj planifikimin kësaj rrethane. Kjo bazohet në faktin se planifikimi është vetëm një nga disa çështjet që mund të ndikojnë në shkallën e pjesëmarrjes. Ndërsa ekzistimi i planifikimit është provë e drejtpërdrejtë e paramendimit.

o Pyetjet relevante përfshijnë:

- A ka pasur hakmarrje apo fyerje të pretenduar të të pandehurit?
- Sa kohë ka kaluar ndërmjet fyerjes së pretenduar dhe veprës?
- Çfarë planifikimi ka pasur në kryerjen e veprës?
- Sa kanë qenë të ndërlikuara përgatitjet për kryerjen e veprës?
- A ka qenë e mundur të kryhet vepra pa planifikim?
- A i ka blerë mjetet kryerësi për ta kryer veprën?
- Nëse ka pasur viktimitë, a ka qëndruar kryerësi në pritë para kryerjes së veprës?

5.3 Prania e dhunës apo kanosjes me dhunë në kryerjen e veprës penale

120

Vlerësimi i rrethanave përqendrohet në përdorimin apo kanosjen për përdorim të dhunës në kryerjen e veprës penale. kryerjen e veprës penale. Në të shumtën e rasteve, përdorimi i dhunës apo kanosjes është element i veprës penale. Për shembull, përdorimi i dhunës apo kanosjes e cilëson vjedhjen e thjeshtë në grabitje.

Në këto raste, rrethana rënduese duhet të mos merret parasysh nga gjykata. Zbatimi i kësaj rrethane kufizohet vetëm për ato vepra në të cilat dhuna apo kanosja mungon nga kualifikimi ligjor i veprës penale. Në përgjithësi, dhuna duhet të konsiderohet si rrethanë më rënduese sesa kanosja me dhunë.

Një çështje që gjykata duhet ta merr parasysh është përfshirja e palëve të treta. Mund të ketë situata në të cilat kanosja me dhunë nuk i drejtohet viktimës së veprës, por palës së tretë. Në këto raste, gjykata duhet të shqyrtojë tërësinë e rrethanave dhe raportin ndërmjetveprës dhe kanosjes. Nëse kanosja ka ndonjë lidhje me veprën e përgjithshme, atëherë gjykata duhet ta konsiderojë si rrethanë rënduese, edhe nëse kanosja nuk i është drejtuar viktimës. Kjo rrethanë nuk bën dallim ndërmjet viktimës së krimit dhe palës së tretë. Andaj, nuk duhet të ketë zbutje të peshës së rrethanës vetëm për shkak se kanosja i është drejtuar palës së tretë.

Në kontekst të veprave të dhunës në familje, gjykata në veçanti duhet të bëjë kujdeslidhur me kanosjen me dhunë dhe përdorimin e mundshëm të saj ndaj palëve të treta. Prania e armës në shtëpi shpeshherë është komponent kyç në shkaktimin e frikës te viktima përmes ndjenjës së vazhdueshme të rrezikut. Arma mund të jetë përdorur në ndonjë incident të mëparshëm qoftë të dhunës apo të kanosjes, dhe prania e vazhdueshmeve saj nënkupton mundësinë e përhershme që një veprim i tillë të ripërsëritet. Kjo gjithashtu shërben për të parandaluar viktimën që të mos largohet nga agresori apo raportimi i incidenteve të mëparshme pranë organeve kompetente. Hulumtimet tregojnëse përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm apo kanosja për përdorimin e tyre në kontekst të dhunës në familje paraqet indikator të qartë të eskalimit dhe është indikator vendimtar në përfundimet fatale.

o Pyetjet relevante përfshijnë:

- A është përdorur dhuna?
- A është përfshirë arma?
- Cila ka qenë natyra dhe shkalla e lëndimeve?
- A ka qenë përdorimi/kanosja e dhunës e nevojshme për kryerjen e veprës?
- Nëse ka pasur kanosje, a ka pasur mundësi i pandehuri që ta realizojë atë?
- A ka qenë përdorimi/kanosja e dhunës e drejtuar ndaj palës së tretë?

¹²⁰ Kodi Penal, neni 74, par.2.

- A ka qenë kanosja e dukshme dhe e qartë?
- A ka qenë kanosja e nënkuptuar?

5.4.Kombinimi i rrethanave lidhur me viktimat

Rrethanat 2.4, 2.5, 2.6, 2.7 dhe 2.8 nga neni 74 të gjitha i referohen viktimave dhe rrethanave specifike të cilat do ta ashpësojnë dënimin. Fakti që pesë prej rrethanave rënduese përqendrohen në viktima është dëshmi e rëndësisë që ky vlerësim luan në përcaktimin e dënimit. Në shumë prej skemave të dënimit, ka një lidhje direkte në mes të ndikimit në viktimën dhe peshës së përgjithshme të veprës – dhe këto dyja shpeshkonsiderohen si rrethanat më të rëndësishme që duhet marrë parasysh. Me rritjen eseriozitetit të veprës në këtë mënyrë, rritet edhe nevoja për ta mbrojtur publikun përmes parandalimit të përgjithshëm dhe kompensimit të viktimave për dëmin e shkaktuar me vepër.

Rëndësia e trajtimit të viktimave është e mishëruar në Direktivën e BE 2012/29/EU e cila në mënyrë të saktë thotë se “viktimat e krimit duhet të mbrohen nga riviktimizimi, frikësimi dhe hakmarrja, atyre duhet dhënë ndihmën e nevojshme për të lehtësuar shërimin e tyre dhe duhet ofruar qasje të mjaftueshme në drejtësi”.¹²¹ Kjo shtjellohet edhe më tej në direktivë ku thuhet se “Shtetet Anëtare duhet të sigurohen që viktimat të dëgjohen gjatë procedurës penale dhe të kenë mundësi të paraqesin prova”.¹²² Kur gjykata konsideron se vlerësimi individual i viktimitës dhe rrethanave të veprës duhet të merr parasysh karakteristikat personale të viktimitës siç janë moshë, gjinia, identiteti apo shprehja gjinore, etniciteti, raca, feja, orientimi seksual, shëndeti, aftësitë e kufizuara, statusi i vendbanimit, vështirësitë në komunikim, marrëdhënia apo varësia nga kryerësi dhe përvojat e mëparshme të pësimin nga krimi.

Ato gjithashtu duhet të marrin parasysh llojin apo natyrën dhe rrethanat e veprës siç janë: nëse vepra është krim i urrejtjes, krim i paragjyqimit apo vepër e kryer me motive diskriminuese, të dhunës seksuale, dhunës në marrëdhënie të afërt, nëse kryerësi ka qenë në pozitë të kontrollit, nëse vendbanimi i viktimitës është në një zonë ku ka shkallë të lartë të kriminalitetit ose ku ka banda, aponëse vendi i prejardhjes së viktimitës nuk është Shteti Anëtar në të cilin është kryer vepra”.¹²³ Përfundimisht, “drejtësia nuk mund të arrihet në mënyrë efektive nëse viktimat nuk mund të shpjegojnë në mënyrë adekuate rrethanat e veprës dhe nëse nuk kanë mundësi për të paraqitur provat e tyre në mënyrën e cila është e kuptueshme për organet kompetente”.¹²⁴

Ndonëse qëllimi primar i direktivës është që të themeloj shërbime dhe detyrime bazë të cilat secili shtet anëtar duhet t’ua ofrojë viktimave, megjithatë kjo qartazi përcakton detyrimin e

¹²¹ Direktiva 2012/29/EU e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 25 tetor 2012 për përcaktimin e standardeve minimale mbi të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit, e cila zëvendëson Vendimin Kornizë të Këshillit 2001/22/JHA (9).

¹²² Po aty, Neni 10 Paragrafi 1.

¹²³ Po aty (56).

¹²⁴ Po aty (34)

gjykatave për të konsideruar viktimën në mënyrë gjithëpërfshirëse përgjatë procedurës. Kjo nuk përfshin vetëm të drejtën për të paraqitur prova dhe për t'u dëgjuar nga gjykata, por edhe detyrimin e gjykatës që të merr parasysh rrethanat individuale dhe statusin e viktimës.

Këto parime janë të mishëruara qartazi në KP dhe KPP. Siç u diskutua më herët, KP parasheh që njëri nga qëllimet kryesore të dënimit është kompensimi i viktimave dhe komunitetit për humbjet dhe dëmet e shkaktuara nga vepra penale.¹²⁵ Kjo nuk duhet parësi diçka që kufizohet vetëm në humbjet materiale apo pasurore në kuptimin më tradicional të fjalës, por duhet të parasheh një shkallë të caktuar të drejtësisë restorative – të zhdëmtojë viktimën. Në këtë drejtim, KPP i ofron viktimave mekanizmat përmes mundësisë për të marrë pjesë në gjykim dhe për të paraqitur prova. Kjo përfshin kontributin në paraqitjen e provave dhe dëshmive për vlerësimin e rrethanave rënduese dhe lehtësuese nga gjykata gjatë matjes së dënimit. Është me rëndësi të mbahet në mend se disa prej rrethanave mund të përfshijnë konsiderata të cilat në rrethana të zakonshme nuk do të paraqiteshin nga prokurori për të vërtetuar prima facie rastin kundër të pandehurit. Prandaj gjykata duhet t'i jep liri veprimi paraqitjes së provave nga viktima në mënyrë që të vlerësojë drejtë dhe në mënyrë adekuate shtrirjen e plotë që këto rrethana mund të kenë në përcaktimin e dënimit më të ashpër.

Shkalla e lartë e viktimizimit natyrisht është një element shumë i rëndësishëm dhe, shumë shpesh, një tregues domethënës i peshës së veprës. Kjo në përgjithësi përfshin një numër rrethanash dhe faktorësh, siç janë:

- numri i viktimave,
- koha gjatë së cilës është kryer vepra,
- nëse vepra është kryer në vazhdimësi ndaj viktimës së njëjtë,
- shkallën e vuajtjes dhe poshtërimit të shkaktuar,
- rritja e qëllimshme dhe çnjerëzore e vuajtjeve të viktimave,
- ndjeshmëria dhe/ose pamundësia e mbrojtjes nga viktima;
- dëmi, trauma dhe niveli i vuajtjes së shkaktuar ndaj viktimës;
- mosha – foshnje apo mosha e re e viktimës;
- kryerja e veprës me keqpërdorim të pozitës së superioritetit mbi viktimën apo përmes keqpërdorimit të besimit;
- traumat fizike dhe mendore të përjetuara nga i mbijetuari si pasojë e veprës;
- kryerja e veprës për shkak të motivit të diskriminimit në baza racore, etnike, fetare, gjinore apo ndonjë forme tjetër të paragjykitimit.

Gjykata gjithnjë duhet të mbajë në mend se nëse dënimi është i drejtë, dhe në proporcion me peshën e veprës penale, atëherë viktima, familja e miqtë e viktimës dhe publiku i përgjithshëm do të jenë të kënaqur që ligji është zbatuar dhe nuk do të ketë dëshirë për hakmarrje të mëtejshme private.

¹²⁵ Kodi Penal i Kosovës, Neni 41, paragrafi 1.3.

5.4.1 Nëse vepra penale është kryer në mënyrë posaçërisht mizore¹²⁶

Mizoria është koncept i përbashkët në sistemet e caktimit të dënimit kur kemi të bëjmë me viktima. Ka një pajtim universal se veprimet e kryera ndaj viktimës të cilat përfshijnë ndonjë formë të mizorisë duhet të dënohen më ashpër në raport me dënimin që do të shqiptohet për veprën “mesatare”. Si e tillë, prania e saj shpesh përfshihet si faktor ashtu që viktima dhe rrethanat personale të saj do të jenë faktor i rëndësishëm në caktimin e dënimit. Megjithatë është me rëndësi që gjykata të mbajë në mend se ashpërsimi në këto situata është i kufizuar vetëm për ato raste në të cilat mizoria arrin nivelin “posaçërisht” mizore.

Kodi nuk parasheh ndonjë përkufizim të asaj se çfarë përbën mizori. Koncepti në përgjithësi konsiderohet të jetë veprim i cili shkakton dhimbje apo vuajtje ndaj tjetrit pa kurrfarë konsiderate apo brenge lidhur me shkaktimin e kësaj gjendjeje apo ndikimit të saj në viktimën. Çështjet kryesore për shqyrtim atëherë janë elementet që kërkohen për kryerjen e veprës në lidhje me veprimet e të pandehurit, siç është niveli i lëndimit dhe dashja e të pandehurit për t'i shkaktuar ato lëndime.

Çdo lëndim përtej asaj që kërkohet për të plotësuar elementet e veprës penale apo që zakonisht ndërlihet me veprën natyrisht se në vete përmban një shkallë të caktuar të mizorisë. Në situatat tjera, cilësimi i lëndimit përtej asaj që kërkohet për ta kryer veprën është më i vështirë. Për shembull, në vrasje, përqendrimi do të jetë në veprimet e të pandehurit të cilat tregojnë se ka pasur gjymtim dhe/apo vuajtje përtej asaj që është e nevojshme për të shkaktuar vdekjen, dhe që i pandehuri ka dashur të shkaktojë dhunë të tillë të tepruar.

Nëse niveli i mizorisë e arrin nivelin “posaçërisht” mizore kërkon një shqyrtim më të thellë të rrethanave të përgjithshme, përfshirë ndikimin e veprës në viktimën e caktuar. Mënyra posaçërisht mizore do të ekzistojë kur vepra përfshin shkaktimin e paarsyeshëm të dhembjes dhe mizorisë dukshëm përtej asaj që zakonisht përdoret në kryerjen e veprës së tillë. Në rrethana normale, niveli i lëndimit, krahasuar me nivelin që kërkohet për të përmbushur elementet e veprës, do të jetë një tregues bindës kur shikohet së bashku me dashjen e të pandehurit. Deri në një shkallë kjo do të përfshijë vlerësimin e veprës nga gjykata në dritë të përvojave dhe ekspozimit të saj të mëparshme ndaj situatave të ngjashme. Nuk ka ndonjë formulë apo qasje kuantitative për të përcaktuar nëse kjo rrethanë është e pranishme.

Deri në një masë, ky faktor është trajtuar në shumë raste të Tribunaleve Ndërkombëtare lidhur me peshën e krimeve gjatë konflikteve. Për shembull, në rastin Blaskic, Trupi Gjykses kishte përfunduar: “Fakti që vepra ka qenë aq e tmerrshme është një kriter cilësor i cili mund të nxjerret nga natyra e saj veçanërisht mizore apo poshtëruese”. “Mizoria e sulmit është qartazi një konsideratë e rëndësishme gjatë caktimit të dënimit përkatës. Në këtë rast, tmerrshmëria e veprave përcaktohet nga vetë shkalla dhe planifikimi i veprave të kryera të cilat kanë rezultuar në shkaktimin e qëllimshëm të vuajtjeve ndaj viktimave pavarësisht moshës, gjinisë apo

¹²⁶ Kodi Penal, neni 74, par.2.4

statusit”.¹²⁷

o Ndikimi psikologjik

Vlerësimi adekuat i kësaj rrethane kërkon prova të mjaftueshme për të dëshmuar natyrën dhe shkallën e lëndimeve. Kjo nuk duhet të kufizohet vetëm në lëndimet fizike, por duhet të përfshijë edhe lëndimet e natyrës psikologjike. Kjo mund të përfshijë edhe implikimet psikologjike afatshkurta apo afatgjata dhe aftësinë e viktimës së caktuar për t’u rimëkëmbur pas veprës.

Dhuna psikologjike ndaj viktimës në marrëdhënie familjare ndonjëherë mund të përbëjë lëndimin më të rëndë për viktimën. Mjekësia bashkëkohore dhe sistemet e zhvilluara juridike e pranojnë se dëmi psikologjik me kalimin e kohës mund të ketë ndikim permanent dhe afatgjatë në viktimën. Dëmi psikologjik vazhdon edhe për shumë kohëpas zhdukjes së gjurmëve të dhunës fizike. Kjo mund të marrë disa forma dhe të diagnostifikohet si një mori e gjerë e gjendjeve mjekësore shumica prej të cilave janë të përhershme dhe me efekte të mëdha negative.

Ndonëse kjo është e rrallë, ka raste kur dhuna fizike në historikun e marrëdhënies është minimale apo nuk ekziston fare. Kjo nuk nënkupton se historiku i marrëdhënies nukduhet të merret parasysh. Ndikimi dëmit psikologjik dhe emocional duhet të vlerësohen gjatë një periudhe më të gjatë kohore dhe të shqyrtohet me kujdes nga gjykata.

Në fund, gjykata duhet të shqyrtojë implikimet psikologjike jo vetëm të veprës së kryer por edhe të marrëdhënies afatgjate dhe implikimeve psikologjike të saj. Kjo përveç që ndikon në seriozitetin e veprës aktuale gjithashtu përbën rrethanë rënduese sipas këtij nënparagrafi. Sa më i madh të jetë dëmi psikologjik dhe sjellja gjatë një periudhe më të gjatë kohore, aq më shumë ka gjasa që të gjendet ekzistimi i rrethanës së mënyrës “veçanërisht mizore” dhe të ashpërsohet dënimi për këtë. Kohëzgjatja e lëndimit si fizik ashtu edhe emocional duhet të merret parasysh nga gjykata kur vlerëson këtë rrethanë.

Ndikimi në palët e treta

Gjykata gjithashtu mund të marrë parasysh ndikimin e lëndimit të personat tjerë. Për shembull, një rast i vrasjes në të cilin i pandehuri e varros trupin e viktimës në një lokacion të panjohur mund të ketë ndikim të thellë psikologjik në familjen e viktimës. Përfshirja e anëtarëve të viktimës si viktima në raste të vrasjeve është pranuar nga Trupi Gjykses i TNPJ, i cili thekson: *“Së bashku me lëndimet fizike dhe emocionale të mbartura nga viktimat, vuajtjet e tyre për humbjen e më të dashurve dhe fakti që shumica e tyre ende nuk janë në gjendje të rikthehen*

¹²⁷ Rasti Nr.IT-95-14-T, Aktgjykimi, Prokurori kundër Tihomir Baskic, Tribunali Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavi, (3 mars 2000), Par.783.

*në shtëpitë e tyre as sot e kësaj dite gjithashtu duhet të përmendet”.*¹²⁸

Këto rrethana mund të konsiderohen si prova shtesë të mungesës së konsideratës së të pandehurit për pasojat e veprës së tij. Ngjashëm me këtë, vetë prania e fëmijëve mund të mjaftojë apo fakti që ata kanë parë, dëgjuar apo në ndonjë mënyrë tjetër kanë qenë dëshmitar të kryerjes së veprës.

Përsëritja e veprave kundër së njëjtës viktimë

Është me rëndësi të theksohet efekti veçanërisht shkatërrues në viktimën e cila vazhdimisht i nënshtrohet llojit të njëjtë të sjelljes apo veprimit kriminal përgjatë një periudhe të caktuar kohore. Përsëritja gjithmonë do të ketë ndikim të konsiderueshëm në ashpërsimin e dënimit, posaçërisht kur merret parasysh nëse rrethanat arrijnë nivelin e mënyrës posaçërisht mizore.

Përsëritja më së shpeshti ndodh në raste të dhunës në familje, ku lëndimi dhe dëmi i përgjithshëm shkaktohet gjatë një periudhe të gjatë kohore, e cila mund të përfshijë zbrazëtira të konsiderueshme në kohë ndërmjet veprimeve të caktuara. Ndonëse kohëzgjatja ndërmjet veprimeve është relevante, ajo nuk duhet të merret për të ndarë apo përjashtuar dëmin e shkakuar nga një episod prej tjetrës. Gjykata duhet të merr parasysh llojin e veprës, objektin e veprës dhe qëllimet e kryerësit gjatë vlerësimit nëse një veprim i caktuar duhet të konsiderohet në lidhje me veprën aktuale. Për më tepër, nëse një veprim nuk është teknikisht i mundur për të ashpërsuar dëmin si recidivist, kjo nuk dotë thotë se veprimi i tillë duhet të injorohet. Ai mund të jetë i rëndësishëm për kualifikimin e veprës si formë e cilësuar. Në fund, incidentet për të cilat formalisht nukka akuzë apo që nuk janë gjykuar mund të përdoren për ashpërsimin e dënimit, me kushtin që gjykata të jetë e bindur se ato kanë ndodhur.

Dyfishimi dhe kujdesi

Sikurse me rrethanat tjera, gjykata duhet të jetë e vetëdijshme për mundësinë e dyfishimit. Megjithatë, gjykata nuk duhet të hezitohet në grumbullimin apo kombinimin e disa rrethanave të cilat individualisht nuk mund të merren si rrethana të ndara rënduese. Për shembull, kryerësi kryen ndonjë vepër të dhunshme kundër viktimës dhe ka indikacione që vepra është kryer në mënyrë mizore. Megjithatë, gjykata nuk është e bindur se ka shkaqe të mjaftueshme për ta konsideruar vërtetë si mënyrë posaçërisht mizore. Pas shqyrtimit të mëtutjeshëm, gjykata arrin në përfundim se, ngjashëm me këtë, ka indikacione që viktima ka qenë e pambrojtur, por jo edhe aq e pambrojtur sa të arrijnë përfundim se viktima ka qenë posaçërisht e pambrojtur sipas rrethanës nga paragrafi 2.6.

Në këtë situatë, është e arsyeshme që këta dy faktorë të trajtohen së bashku në mënyrë që të arrihet deri te gjetja e rrethanës rënduese nga paragrafi 2.4 të mënyrës posaçërisht mizore. Çelësi për të arritur deri te ky përfundim është se këto dy çështje janë të lidhura ngushtë me

¹²⁸ Po aty. Par.787.

njëra tjetrën. Në shumë aspekte, është vështirë për t'i izoluar tërësisht në konsiderata të ndara. Çdo gjetje që viktima është e pambrojtur/e ndjeshme natyrisht se do të shpie gjykatën të besojë se një shkallë e caktuar e mizorisë është shkaktuar ndaj viktimës.

Ky është rasti veçanërisht kur ndjeshmëria e viktimës është menjëherë e dukshme për një vëzhgues të arsyeshëm. Megjithatë, nëse baza për gjetjen e një niveli të caktuar të mizorisë varet tërësisht nga përfundimi i gjykatës se viktima ka qenë e pambrojtur, atëherë nuk duhet të ketë ashpërsim.

Në fund, nuk ka ndonjë vepër në Kod për të cilat ligji parasheh formë të cilësuar të dënimit bazuar në elementin e kryerjes së veprës në mënyrë posaçërisht mizore. Megjithatë, ka disa vepra për të cilat parashihet dënim i cilësuar në rastet kur ekziston çfarëdo mizorie. Nëse vepra e caktuar përfshinë elementin e mizorisë për gjetjen e fajësisë, atëherë nuk duhet të ketë ashpërsime për këtë rrethanë pasi që e njëjta konsiderohet si element i veprës.

Pyetjet relevante përfshijnë:

- A kanë qenë lëndimet përtej atyre që kërkohen për të plotësuar elementet ligjore të veprës penale?
- A ka lëndime tjera përveç lëndimit kryesor të cilat plotësojnë kërkesën ligjoretë nivelit të lëndimit?
- A ka indikatorë që i pandehuri ka dashur të shkaktojë atë nivel të lëndimeve?
- A ka efekte anësore afatgjata të lëndimeve?
- A ka lëndime mendore të përfshira, qoftë si rezultat i drejtpërdrejtë apo i tërthortë i veprës penale? Nëse po, a janë ato të përhershme apo afatgjate?
- A ka lëndime apo implikime psikologjike për anëtarët e familjes? Cila është natyra dhe shkalla e tyre?
- A ka indikacione të qarta të shkaktimit të paarsyeshëm të lëndimeve?
- A ka indikacione se i pandehuri ka kryer veprën ndaj viktimës me zell apo kënaqësi?
- A e ka lënë i pandehuri viktimën në gjendje të paaftë

5.4.2 Nëse vepra penale përfshin disa viktima¹²⁹

Qëllimi primar i kësaj rrethane është që të kodifikojë parimin se i pandehuri i cili kryen vepër të dhunshme apo vepër që ka gjasë t'i shkaktoj dëm disa personave është më i fajshëm se i pandehuri i cili i shkakton dëm vetëm një personi.

Në situatë të tillë, dënimi mesatar i kryerësit nuk është i mjaftueshëm për të treguar se secila viktimë individuale është marrë parasysh nga gjykata në shqiptimin e dënimit të përgjithshëm. Varësisht nga natyra e veprës dhe numri i viktimave, gjykata duhet të përshtat kufijtë e dënimit në mënyrë që të reflektojë në mënyrë adekuate faktin e fajësisë më të madhe të kryerësit. Është me rëndësi të mos harrohet se kjo rrethanë mund të zbatohet në situatat të cilat nuk i përshtaten bindjeve tradicionale të asaj se çfarë mund të cilësohet si viktimë – më saktësisht bindjes se

¹²⁹ Kodi Penal, neni 74, par.2.5

viktimat ekzistojnë vetëm kur ka ndonjë akuzë formale për veprë penale dhe viktima formalisht merr statusin e “viktims”.

Ka dy situata kryesore kur kjo rrethanë do të luajë rol në rritjen e dënimit përfundimtar. Epara është kur ka viktims lëndimet e së cilës janë shkaktuar nga vepra, por nuk ka akuza lidhur me viktimsn. E dyta është kur akuza përfshin disa viktims, por nuk bën ndonjë dallim bazuar në numrin e tyre.

Në situatën e parë, viktims zakonisht është palë e tretë e cila nuk është lënduar fizikisht, por i është nënshtruar ndonjë forme të lëndimit emocional apo psikologjik. Kjo zakonisht është e pranishme kur ka një shkallë të konsiderueshme të mizorisë apo dhunës së përdorur në kryerjen e veprës. Kjo mund të shkaktohet me një veprim të vetëm apo përgjatë një periudhe më të gjatë kohore. Këto lëndime, ndonëse formalisht nuk ndiqen si veprë penale nga prokuroria, në praktikën ndërkombëtare vazhdimisht e më shumë po trajtohen si lëndime të cilat kontribuojnë në dëmin e përgjithshëm të shkaktuar nga vepra dhe personat e prekur konsiderohen si viktims.

Ky faktor është domethënës në raste të dhunës në familje ku gjykatat shpeshherë përqendrohen vetëm në marrëveshjet për kujdesin e fëmijëve dhe i injorojnë ndikimin e dhunës në fëmijën i cili është i pranishëm në shtëpi. Nëse fëmija është i pranishëm në shtëpi gjatë veprës, gjykata duhet të shqyrtojë të kaluarën e marrëdhënies dhe ndikimin e saj te fëmija. Edhe nëse vepra për të cilën akuzohet i pandehuri nuk përfshin ndonjë veprim të drejtuar kundër fëmijës, vetë prania e fëmijës mund të konsiderohet si rrethanë rënduese sipas paragrafit 2.5 pasi që fëmija është viktims shtesë.

Me të vërtetuar praninë e fëmijës, gjykata duhet të përcaktojë shkallën e lëndimit dhe të merr parasysh shkallën e ashpërsimit të duhur (ngjashëm me rrethanat kundër viktims primare).

Edhe nëse fëmija nuk i nënshtrohet dhunës fizike, ata shpesh pësojnë trauma emocionale dhe psikologjike nga të jetuarit në shtëpi me etërit e tyre të cilët keqtrajtojnë të ëmat e tyre. Ata të cilët rriten duke parë të ëmat e tyre duke u keqtrajtuar, veçanërisht nga të etërit e tyre, rriten me këtë model të marrëdhënies intime në të cilat njëri person përdor frikësimin dhe dhunën ndaj tjetrit për të arritur qëllimin e tij. Ekspertët besojnë se fëmijët të cilët rriten në shtëpi abuzive mësojnë se dhuna është një mënyrë efektive për të zgjidhur konfliktet dhe problemet. Ka gjasa të mëdha që ata do të përsërisin dhunën të cilën e kanë parë si fëmijë gjatë marrëdhënies të tyre si adoleshentë dhe të rritur dhe përfundimisht edhe gjatë përvojave të tyre prindërore. Fëmijët nga shtëpitë e dhunshme të cilët i nënshtrohen dhunës apo janë dëshmitar të saj gjithashtu janë në rrezik më të lartë nga abuzimi me drogë apo alkool, çrregullimet post-traumatike, delikuenca e të miturve dhe aktiviteti kriminal si të rritur.

Gjykata duhet të shqyrtojë fuqishëm këtë rrethanë rënduese në rastet kur:

- Fëmija apo dëshmitarët (tjerë) kanë qenë fizikisht të pranishëm kur është shkaktuar dhuna.
- Fëmija apo dëshmitarët (tjerë) nuk kanë qenë fizikisht të pranishëm, por kanë qenë në gjendje të dëgjojnë dhunën/keqtrajtimin.
- Fëmija apo dëshmitarët (tjerë) nuk kanë qenë fizikisht të pranishëm dhe nuk kanë mundur të dëgjojnë dhunën/keqtrajtimin, por kanë parë pasojat e saj më vonë.

Situata e dytë përfshin akuzat penale në të cilat ka më shumë se një viktimë por dënimi nuk është i përshtatur proporcionalisht në raport me numrin e viktimave. Kjo situatë më së shpeshti ndodh në krime ekonomike apo masakra të shkallës së madhe. Për shembull, ndonëse neni 289 i KP për dëmtimin e kreditorëve apo debitorëve e rrit nivelin e dënimit kur dëmi i përgjithshëm ndryshon nga 5,000 në 250,000 Euro, ai nuk merr parasysh numrin e viktimave. Zbatimi i kësaj rrethane në dënimin përfundimtar merr parasysh në mënyrë adekuate numrin e viktimave të përfshira.

Në kontekst të krimeve të dhunshme, neni 164 lidhur me rrëmbimin e fluturakes jep një shembull. Këtu KP e rrit dënimin për kryerësin bazuar në dashjen e tij dhe shkallën e lëndimeve ndaj pasagjerëve, por nuk bën dallim në bazë të numrit të viktimave. Andaj, kufijtë e mundshëm të dënimit për gjykatën janë të njëjtë pavarësisht se a vritet një pasagjer apo njëqind pasagjerë gjatë rrëmbimit (paragrafi 2 parasheh dënim prej jo më pak se 5 vjet). Duke marrë parasysh se sa të gjerë janë kufijtë e dënimit të mundshëm nëse vepra përfundon me vdekje, atëherë është e qartë se autorët kanë pasur për qëllim që gjykata të merr parasysh numrin e viktimave gjatë përcaktimit se cilin dënim duhet shqiptuar brenda kufijve të paraparë të dënimit.

Dyfishimi dhe kujdesi

Ashpërsimi bazuar në numrin e viktimave është qartazi rrethanë rënduese dhe gjithnjë duhet të merret parasysh. Sidoqoftë, për shkak të seriozitetit potencial të kësaj konsiderate, asaj duhet qasur me kujdes dhe vetëm pas gjetjeve të mjaftueshme nga gjykata.

Një çështje që duhet marrë parasysh është nëse ka pasur akuza të ndara për veprat ndaj secilës viktimë. Nëse viktimat janë të reflektuara në mënyrë të ndarë në akuzat individuale atëherë kjo rrethanë në kushte normale nuk do të merret parasysh. Rasti i vetëm kur gjykata duhet ta merr parasysh këtë është gjatë ashpërsimit të dënimit për dënimin unik sipas nenit 80 në të cilin ka veprime të ngjashme kundër disa viktimave. Ndonëse gjykata fillimisht shpall dënime për secilën vepër penale, paragrafi 2.2 ndalon mbledhjen e të gjitha dënimeve individuale dhe kërkon një dënim më të ultë se shumica e të gjitha dënimeve individuale. Nëse gjykata është e prirur për të shqiptuar një dënim përfundimtar dukshëm më të ultë se shumica e të gjitha

dënimeve individuale, atëherë duhet të jep arsyetim për këtë dhe të shpjegojë se përse ekzistimi i disa viktimave nuk e justifikon ashpërsimin e dënimit deri në afërsi të shumës totale të dënimeve.

Përveç kësaj, gjykata nuk mund ta merr parasysh këtë rrethanë rënduese nëse prokuroria nuk arrin të provojë se vepra është kryer ndaj viktimës së caktuar apo statusin e tyre si viktimë.

Në thelb kjo nënkupton që gjykata nuk mund ta përdor viktimën e cila ka qenë subjekt i aktgjykimit lirues si viktimë për qëllim të ashpërsimit të dënimit për ndonjë vepër tjetër. Ngjashëm me këtë, nëse gjykata ka dyshime të mjaftueshme lidhur me faktet të cilat e përshkruajnë personin si viktimë, atëherë nuk duhet që t'i konsiderojë ato si viktimë për qëllim të ashpërsimit të dënimit.

Pyetjet relevante përfshijnë:

- A ka pasur dëshmitarë apo të tjerë të pranishëm në atë kohë?
- A është e përfshirë ndonjë marrëdhënie familjare?
- A ka pasur lëndime jofizike të cilat u janë shkaktuar personave tjerë siç janë lëndimet psikologjike, emocionale, etj?
- A është marrë parasysh mjaftueshëm numri i viktimave?
- A mund të cilësohet ndryshe vepra bazuar në numrin e viktimave?
- A është aktiviteti i natyrës së tillë që sa më i madh të jetë numri i viktimave aq më i madh të jetë niveli i dënimit?

5.4.3 Nëse viktima e veprës penale ka qenë posaçërisht e pambrojtur apo e ndjeshme¹³⁰

Ndjeshmëria apo pambrojtshmëria e viktimës është një rrethanë tjetër e cila gjithmonë duhet të shqyrtohet nga gjykata dhe të merret parasysh gjatë caktimit të dënimit. Nocioni se ata të cilët janë në disavantazh për shkak të karakteristikave personale apo rrethanave të caktuara meritojnë mbrojtje më të madhe është një parim i përgjithshëm sikurse që është edhe koncepti se kryerësi i cili shfrytëzon këtë situatë apo pozitë meriton dënim më të ashpër. Rëndësia që i jepet konceptit të viktimës së ndjeshme/të pambrojtur në KP është argument shtesë për rëndësinë e kësaj rrethane gjatë caktimit të dënimit. Kjo rrethanë jo vetëm që konsiderohet si rrethanë rënduese gjatë matjes së dënimit, por shërben edhe për të cilësuar kufijtë e dënimit për veprat e caktuara më shpesh se cilido faktor tjetër. Qëllimi i ligjvënësit qartazi është që kjo rrethanë të jetë prominente.

Ndoshta konsiderata kryesore për gjykatën duhet të jetë niveli i pambrojtshmërisë/ndjeshmërisë së viktimës dhe aftësia e kryerësit për ta perceptuar këtë status të viktimës. Me fjalë tjera, a ndikon aftësia e kryerësit për ta perceptuar këtë status të viktimës në zbatimin e kësaj rrethane dhe rëndësinë e saj? Në përgjithësi, viktima konsiderohet ashtu siç e gjen kryerësi dhe aftësia e tyre për ta kuptuar këtë gjendje është eparëndësishme. Kjo mbështetet nga gjuha e përdorur në këtë rrethanë e cila thjeshtë kërkon vetëm që viktima të

¹³⁰ Kodi Penal, neni 74, par.2.6

ketë qenë e pambrojtur apo e ndjeshme dhe nuk përmend farenëse kryerësi duhet të ketë njohuri për këtë gjendje apo jo. Pranimi i kësaj rrethane nuk duhet të varet nga aftësia e kryerësit për ta perceptuar ndjeshmërinë. Por gjykata pavarësisht kësaj duhet që ta shqyrtojë këtë gjatë vlerësimit të shkallës që do t'ia atribuoj kësaj rrethane rënduese. Nëse gjendja është e dukshme dhe lehtë për t'u perceptuar, gjykata mund ta rrisë dënimin në një shkallë më të madhe bazuar në faktin se kryerësi qartazi dhe me dije e ka shpërfillur gjendjen e viktimës kur e ka kryer veprën. Kjo duhet të vlerësohet nga pikëpamja e personit të zakonshëm për të gjitha konsideratat sipas kësaj rrethane.

Në pjesën e përkufizimeve në KP, neni 120 paragrafi 37 e përkufizon viktimën e ndjeshme si “fëmijë, person me aftësi të kufizuara fizike apo mendore, person me aftësitë zvogëluar, grua shtatzënë ose partner familjar”. Shumica e këtyre shprehjeve shtjellohen më tutje duke lexuar pjesët tjera të Kodit¹³¹ ose janë subjekt i përkufizimeve të njohura botërisht (p.sh. shtatzënë). Fatkeqësisht, nuk ka ndonjë udhëzim tjetër domethënës lidhur me çështjet e aftësisë së kufizuar fizike apo mendore apo aftësisë së zvogëluar. Prandaj gjykata duhet të mbështetet në aftësinë e saj për të vlerësuar provat e paraqitura në mbështetje të këtij pretendimi apo ta konsiderojë gjendjen si fakt të njohur botërisht nëse kjo është e përshtatshme. Sa më e dukshme dhe më e lehtë për t'uidentifikuar që të jetë, aq më shumë rrethana do të ketë ndikim në ashpërsimin e dënimit. Vlen të theksohet se në Kod ka disa dispozita në vepra të caktuara të cilat e zgjerojnë përkufizimin e viktimës së ndjeshme për të përfshirë “moshën” dhe “paftësinë”.

Vlen të theksohet se KP ka përdorur shprehjen “posaçërisht” para shprehjes e pambrojtur, që nënkupton se gjetja e thjeshtë e pambrojtshmërisë nuk mjafton për ta konsideruar këtë si rrethanë rënduese. Ndonëse është e pamundur për ta kuantifikuar saktësisht se ç'nënkuptohej me të, kjo duhet të shihet si diçka që tejkalon konceptin tradicional në kontekst të viktimës, siç është mungesa e armës apo mjeteve adekuate për ta mbrojtur veten nga sulmi. Kjo ka të bëjë me një nivel të pambrojtshmërisë që është pakëz përtej mesatares apo që del nga ndonjë ndjeshmëri tjetër e përkohshme apo e përhershme.

I vetmi vlerësim i cili mbetet për t'u bërë është niveli i rrethanës rënduese që ekziston në situatën e caktuar. Kjo mund të ndodh për shkak të shkallës së lartë të pambrojtshmërisë apo ndonjë aspekti tjetër të ndjeshmërisë. Sikurse kryerësit në përgjithësi, ata të cilët kryejnë vepra në marrëdhënie familjare i bëjnë ato ndaj individëve të ndjeshëm dhe të pambrojtur. Për më tepër, kryerësit e dijnë se ata persona të cilët janë të pambrojtur ka më pak gjasë ta mbrojnë veten apo të kërkojnë ndjekjen e kryerësve. Për shembull, *mosha* (shumë i vjetër, shumë i ri), *paftësia* (psikologjike, mendore, fizike), shtatzënia apo lehonja, *statusi i imigrimit apo vendbanimit* (i padokumentuar, pa letra), asocimi me *komunitete etnike pakicë* (Romë) apo *komunitete fetare* apo *orientimi seksual* (gej apo lezbike) të gjitha këto janë faktorë që mund të

¹³¹ Fëmija përkufizohet si person i cili nuk i ka mbushur 18 vjet sipas nenit 120, par. 20. Shprehja partner familjar mund të kuptohet në kontekst të marrëdhënies familjare siç përkufizohet në par. 23, por është më shumë në linjë me marrëdhëniet e shtjelluara më tej në par. 23.1. Qëllimi i shprehjes partner familjar është që të përshkruajë, pa iu referuar gjinisë, marrëdhënien e cila mund të çojë deri te ndjeshmëria për shkak të afinitetit e jo për shkak të marrëdhënieve familjare.

rrisin rrezikun e varësisë së viktimës nga kryerësi. Këta faktorë mund ta bëjnë të vështirë apo të pamundur që viktimat të kërkojnë ndihmë, ta raportojnë dhunën apo të largohen nga marrëdhënia abuzive.¹³²

Në rastet kur kryerësi ka shfrytëzuar ndjeshmërinë e viktimës (për shembull, kur rrethanat janë shfrytëzuar nga kryerësi për të penguar viktimën nga kërkimi dhe sigurimii ndihmës), kjo rrethanë zakonisht do ta ashpërsojë dënimit. Ngjashëm me këtë, marrëdhëniet familjare të cilat përfshijnë periudha të zgjatura të keqtrajtimit mendor dhe fizik rrisin pambrojtshmërinë e viktimës e me të edhe gjasat për gjetjen e rrethanave rënduese.

Dyfishimi dhe kujdesi

Kjo rrethanë lehtë mund të përkojë me ndonjë tjetër dhe të llogaritet dy herë. Gjykata duhet të sigurohet që vetë vepra të mos jetë cilësuar bazuar në ndjeshmërinë e viktimës. Këto janë veçanërisht të pranishme në veprat penale seksuale. Gjithashtu, ka mundësi të konsiderueshme për dyfishim pasi që shumë kategori mund të ndikojnë në nivelin e ndjeshmërisë dhe pambrojtshmërisë. Për shembull, rrethana 2.7 moshë e viktimës, ka ndikim të drejtpërdrejtë në ndjeshmërinë.

Pyetjet relevante përfshijnë:

- A plotëson viktimja ndonjërin nga kushtet e përfshira në përkufizimin e viktimës së ndjeshme sipas nenit 120 paragrafi 37?
- A ka ndonjë marrëdhënie në mes të viktimës dhe të pandehurit? Cila është natyrë dhe struktura e marrëdhënies?
- A shfaq kjo marrëdhënie veti të varësisë dhe kontrollit?
- A janë kushtet e ndjeshmërisë të dukshme dhe lehtësisht të dallueshme?

5.4.4 Moshë e viktimës, nëse është i ri apo i moshuar¹³³

Ndonëse kjo rrethanë fillimisht mund të duket e lehtë për t'u zbatuar, nuk ka ndonjë përkufizim të qartë për t'i dhënë përgjigje pyetjes së natyrshme se kur përfundon moshë "e re" dhe kur fillon moshë "e vjetër". Përderisa kjo i jep fleksibilitet maksimal gjykatave për të vlerësuar rrethanat, ajo mund të ndikojë në shmangie nga praktikatat e dënimit për shkak të interpretimeve të ndryshme. Ndonëse kjo nuk do të paraqesë ndonjë problem kur moshë qartazi bie në këtë kategori (për shembull, fëmija i moshës 5 vjeçare) ajo bëhet më vështirë kur moshë botërisht nuk konsiderohet në këtë kategori. Fakti se "fëmija" është definuar në kod në nenin 120 paragrafin 20 si person i cili nuk i ka mbushur 18 vjet mund të jetë deri diku definitiv në kualifikimin e viktimës si "i ri", posaçërisht duke marrë parasysh faktin se "madhori" përkufizohet në paragrafin 22 si person i cili i ka mbushur 18 vjet. Megjithatë, kjo nuk duhet

¹³² DCAF, Doracaku i Gjyqtarëve, Konsideratat për vlerësimin e dhunës në familje në Bosnjë dhe Hercegovinë, Sarajevë (2014), fq. 20.

¹³³ Kodi Penal, neni 74, par.2.7

të konsiderohet autoritative.

Siç diskutohet më vonë në mënyrë të detajuar në pjesën e rrethanave lehtësuese lidhur me moshën e kryerësit, praktika ndërkombëtare në krime të luftës ndonjëherë ka konsideruar individin si “i ri” ndonëse kanë qenë të rritur sipas standardeve të pranuar. Në përgjithësi, gjykata duhet të konsideroj viktimat nën moshën 18 si të rinjë, ndërsa ata që janë mbi këtë moshë duhet t’i konsiderojë si të tillë me skepticizëm.

Fatkeqësisht, nuk ka situatë të ngjashme për vlerësimin e statusit “i moshuar”. Gjykatës i lihet tërësisht në diskrecion të saj për të përcaktuar zbatimin e kësaj rrethane. Si pikënisje mund të merret mosha e pensionimit të detyrueshëm për shërbyesit publik si dhe qasja e përgjithshme në përfitimet e pensionimit dhe pensionet. Vështirësia në rritje për të vlerësuar këtë rrethanë duhet të fillojë të ndikojë në nivelin e ashpërsimit i cili zbatohet bazuar në këtë rrethanë, dhe në një fazë të caktuar duhet të eliminohet plotësisht.

Dyfishimi dhe kujdesi

Veprat penale seksuale apo veprat penale kundër fëmijëve janë kryesisht ato raste në të cilat vepra merr formën e cilësuar për shkak të moshës së viktimës. Si në të gjitha rastet, ashpërsimi sipas kësaj rrethane nuk duhet të bëhet nëse mosha veç është e përfshirë në elementet e veprës.

Siç u diskutua te rrethana 2.6, koncepti i moshës shpesh ndikon në nivelin e ndjeshmërisë së viktimës. Megjithatë, gjykata duhet ta ketë parasysh se kjo rrethanë mund të zbatohet si rrethanë rënduese vetëm bazuar në moshën e viktimës – pa pasur nevojë që të konstatohet se viktima ka qenë e ndjeshme. Vetë anëtarësimi në këtë kategori mjafton përtë shqiptuar një nivel më të lartë të dënimit.

Pyetjet relevante përfshijnë:

- A është viktima nën moshën 18 vjet?
- A është viktima mbi moshën 65 vjet?
- A ka ndonjë konstatim se viktima ka qenë e ndjeshme? Nëse po, deri në ç’masë ka kontribuar mosha e viktimës në atë gjetje?
- A mundet mosha e viktimës të ndahet tërësisht nga gjetjet e rrethanave tjera që kanë të bëjnë me viktimen?

5.4.5 Shkalla e dëmit të shkaktuar nga personi i dënuar, përfshirë vdekjen, lëndimin e përhershëm, transmetimin e sëmundjes tek viktimë apo çfarëdo dëmi tjetër të shkaktuar viktimës ose familjes së tij¹³⁴

Ndonëse shkalla e dëmit të shkaktuar viktimës pothuajse gjithnjë do të merret parasysh gjatë përcaktimit të nivelit të veprës, ka ende hapësirë të konsiderueshme për ta rritur dënimin në kuadër të kufijve të paraparë. Kjo rrethanë e bën të qartë se puna e gjykatës është që të shqyrtojë në tërësi të gjitha lëndimet, pavarësisht se a bien ato në sferën më tradicionale të lëndimeve fizike apo në sferat e zgjeruara që duhen konsideruar.

Ashpërsimi duhet të përfshijë dëmtimin e rëndë të menjëhershëm fizik dhe/apo psikologjik i cili paraqet rrezik serioz për jetën e viktimës. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë ashpërsimin për vuajtjet afatgjata të shkaktuara nga lëndimi i përhershëm apo pasojat e ngjitjes së sëmundjes si dhe ndikimin psikologjik afatgjatë siç është çrregullimi post-traumatik. Gjykata duhet të kuptojë nga viktimë dhe/apo eksperti mjekësor ndikimin e veprës në jetën e viktimës në kuptimin afatshkurtë dhe afatgjatë.

Gjykata gjithashtu duhet të merr parasysh ndikimin në familjen e viktimës. Kjo gjithashtu mund të jetë mjaft e gjerë. Nuk duhet të përfshijë vetëm lëndimet ndaj anëtarëve të familjes të cilët janë dëshmitarë të veprës (siç janë rastet e dhunës në familje), por gjithashtu duhet të përfshijë edhe ndikimin në anëtarët e familjes të cilët ballafaqohen me pasojat. Kjo mund të përfshijë lëndimin psikologjik, dëmin emocional dhe/ose humbjen e aftësive të mbajtësit të familjes. Kjo rrethanë gjithashtu mund të zbatohet edhe përfëmijët e pranishëm në shtëpi të cilët e shohin veprën siç sqarohet më hollësisht te rrethana 2.5. Përveç kësaj, keqtrajtimi afatgjatë i pranishëm në marrëdhënie mund të shkaktojë lëndim të përhershëm psikologjik, madje edhe në mungesë të lëndimit aktual fizik. Sërish, gjykata duhet të shqyrtojë tërë historikun e marrëdhënies për të arritur deri të niveli i përshtatshëm i ashpërsimit.

Siç ceket në Direktivën e BE-së të 25 tetorit 2012, “*Është e mundur që anëtarët e familjës së viktimave gjithashtu të dëmtohen si rezultat i veprës penale. Në veçanti, anëtarët e familjes së personit vdekja e së cilit është shkaktuar drejtpërdrejtë nga vepra penale mund të dëmtohen si rezultat i veprës. Anëtarët e tillë të familjes, të cilët janë viktimë indirekte të veprës, gjithashtu duhet të përfitojnë nga garancitë e parapara në këtë Direktivë*”.¹³⁵

Lidhur me lëndimin psikologjik, gjykata duhet të jetë e vetëdijshme për çfarëdo indikacioni që tregon se kryerësi e ka poshtëruar, turpëruar apo degraduar viktimën duke bërë fotografi, video apo audio incizime, duke postuar komente në rrjete sociale (në internet) apo duke kanosur për të zbuluar informata private apo personale lidhur me viktimën. Këto veprime mund të konsiderohen si rrethana rënduese pasi që kryhen për të poshtëruar viktimën edhe më shumë.

¹³⁴ Kodi Penal, neni 74, par.2.8

¹³⁵ Direktiva 2012/29/EU e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 25 tetor 2012 për përcaktimin e standardeve minimale mbi të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit, e cila zëvendëson Vendimin Kornizë të Këshillit 2001/22/JHA (19).

Gjykata inkurajohet që t'i kushtojë vëmendje të veçantë nëse rasti specifik i poshtërimit përfshin viktimën e mitur, e cila do të rriste edhe më shumë peshën e veprës së kryer dhe pasojat e saj, duke pasur parasysh se në atë moshë personaliteti i viktimës nuk është krejtësisht i zhvilluar dhe ai apo ajo varet nga tjerët.¹³⁶

Dyfishimi dhe kujdesi

Ndoshta asnjë rrethanë tjetër rënduese nuk ka më shumë potencial për të përkuar me rrethana tjera dhe për t'u llogaritur dyfish. Siç u përmend më herët, kjo rrethanë ka shumëpeshë në seriozitetin e veprës, dhe nëse vepra kualifikohet në mënyrë të drejtë, kjo duhet të jep një vlerësim të përgjithshëm të saktë të lëndimit të viktimës. Megjithatë, vlerësimi nuk mbaron aty dhe praktikat ndërkombëtare vazhdimisht kanë tentuar që të zgjerojnë fushat të cilat merren parasysh për vlerësim. Në shumë aspekte, kjo është një rrethanë që përfshin të gjitha dhe kërkon nga gjykata që të shikojë të gjitha aspektet e ndikimit në viktimën dhe t'i shqyrtojë ato para se të arrijë në dënimin përfundimtar – duke e përshtatur dënimin për të reflektuar në mënyrë të saktë të gjithë ndikimin në viktimën. Kjo përfshin lëndimet fizike dhe/ose psikologjike si dhe nëse ato lëndime janë afatshkurtra apo të menjëhershme dhe/apo afatgjata dhe të përhershme. Andaj çdo lëndim i paarsyeshëm që tejkalon minimumin e nevojshëm për ta kryer atë vepër duhet të konsiderohet si rrethanë rënduese gjatë matjes së dënimin brenda kufijve të paraparë.

Për më tepër, kjo rrethanë nënvizon faktin se lëndimi nuk do të kufizohet vetëm në viktimën “tradicionale”, por mund të përfshijë edhe anëtarët e familjes në një mori të situatave, si viktima të drejtpërdrejta apo si viktima indirekte. Gjykata duhet të bëjë një vlerësim të kujdesshëm për të shmangur dyfishimin e rrethanave gjatë shqyrtimit të secilës kategori shtesë të rrethanave rënduese.

Pyetjet relevante përfshijnë:

- Cilat janë lëndimet e drejtpërdrejta fizike afatshkurtra?
- A ka kushte / paaftësi / ndikime afatgjata që ndërlidhen me to?
- Cilat janë lëndimet e drejtpërdrejta psikologjike afatshkurtra? A ka kushte/ paaftësi / ndikime afatgjata që ndërlidhen me to?
- A është shkalla e lëndimit më e lartë se minimumi që kërkohet për të plotësuar elementet e veprës penale?
- A ka ngjitje të sëmundjes? A ka ndikime afatgjata nga sëmundja?
- A kanë qenë të pranishëm anëtarët e familjes gjatë kohës së veprës? A e kanë parë veprën? A ka lëndim psikologjik afatshkurtër dhe/apo afatgjatë?
- A ka pasur humbje të shërbimeve për anëtarët e familjes si rezultat i veprës? Sa kanë zgjatur?
- A ka vdekur viktima si rezultat i veprës? Cila ka qenë afërsia? Cili ka qenë ndikimi në

¹³⁶ DCAF, Doracaku i Gjyqtarëve, Konsideratat për vlerësimin e dhunës në familje në Bosnjë dhe Hercegovinë, Sarajevë (2014), fq. 21.

anëtarët e familjes në kuptim financiar dhe psikologjik?

- A ka ndonjë dëm tjetër përveç lëndimeve fizike apo psikologjike ndaj viktimësi rezultat i viktimizimit?
- A ka mjete tjera të mbështetjes financiare? A është kryerësi në gjendje për ta bërë kompensimin? A i mënjanon kjo disa forma të lëndimit dhe nëse po deri nëç'masë?

5.5 Çfarëdo keqpërdorimi të pushtetit ose pozitës zyrtare nga personi i dënuar në kryerjen e veprës penale; dhe dëshmi të shkeljes së besimit nga ana e personit të dënuar¹³⁷

Rrethanat 2.9 dhe 2.10, ndonëse trajtohen ndaras në kod, ato kanë disa elemente të rëndësishme të përbashkëta. Që të dyja në thelb përfshijnë marrëdhënien ndërmjet viktimës dhe kryerësit në të cilën kryerësi ka pushtetin mbi viktimën apo aftësinë për të ushtruar kontroll mbi viktimën apo pasurinë e saj. Ky pushtet mund t'i jetë deleguar nga viktima apo mund të ekzistojë si rezultat i normave shoqërore, marrëdhënies apo ndonjë strukture më formale të pushtetit. Pavarësisht mënyrës se si është krijuar ky mosbalancim, vepra rezulton në tërësi apo pjesërisht nga ushtrimi i paligjshëm i këtij pushteti apo nga përfitimi prej kësaj pabarazie.

Koncepti i dytë i përbashkët është se marrëdhëniet e ngërthyera nga këto dyja janë të rëndësishme për funksionimin e shoqërisë. Kur ndodhin thyerje apo keqpërdorime, ato u shkaktojnë dëm më shumë se një viktimit; ato dëmtojnë besimin kolektiv të shoqërisë për të hyrë apo për të besuar në këto marrëdhënie në të ardhmen. Kjo është veçanërisht e vërtetë kur marrëdhënia ka qenë baza kryesore për kryerjen e veprës. Për shembull, kur zbatuesit e ligjit përdorin pozitën e tyre për të kryer veprë penale, kjo ndikon si në viktimën ashtu edhe në tërë shoqërinë. Qytetarët të cilët dëgjojnë për vepra penale ka më pak gjasë që të bashkëpunojnë me hetimet e organeve të zbatimit të ligjit në të ardhmen apo t'u binden kërkesave legjitime ligjore. Kjo degradon tërë stabilitetin e shoqërisë. Si e tillë, një lloj ashpërsimi i dënimit mbi këtë bazë bëhet për të promovuar dhe/ose rikthyer besimin në këto struktura dhe për të parandaluar keqpërdorimet në të ardhmen.

Gjykata duhet të mbajë në mend se nuk ka ndonjë nivel minimal në të cilin keqtrajtimi apo shkelja duhet të kontribuojë për kryerjen me sukses të veprës penale. Vetë fakti se marrëdhënia ka ekzistuar dhe është shkelur mjafton për të arritur deri te kjo gjetje. Nivelii kontributit është më i zbatueshëm për peshën që kjo rrethanë do ta ketë në ashpërsimin edënimit brenda kufijve të paraparë sesa nëse kjo rrethanë ekziston apo jo.

a. Keqpërdorimi i pushtetit apo pozitës zyrtare

Rrethana 2.9 specifikon keqpërdorimin e pushtetit apo pozitës zyrtare në kuadër të kufijve të paraparë për formën e pacilësuar të veprës. Kjo nënkupton ekzistimin e ndonjë strukture

¹³⁷ Kodi Penal, neni 74, par.2.9 dhe 2.10.

formale apo qeveritare së cilës i është dhënë pushteti i cili ushtrohet. Keqpërdorimi i pushtetit (apo autoritetit) tradicionalisht konsiderohet si ushtrim i funksioneve përkatëse qeveritare, politike apo administrative në kuadër të strukturës legjitime të formalizuar. Kjo mund të jetë ushtrim i papërshtatshëm i pushtetit qeveritar brenda kontekstit të pozitës së individit apo mund të nënkuptojë shfrytëzimin e pushtetit në mënyrë të tërthortë i cili mund të mos jetë i ndërlidhur me autoritetin e qenësishëm brenda pozitës, por bazuar në perceptimin e viktimës të pushtetit të dhënë kryerësit.

Kjo rrethanë përshkruhet më së miri nëse i referohemi vendimit të Dhomave të TPNJ dhe TNPR. Për shembull, në rastin Ntakirutimana,¹³⁸ Trupi Gjykses në përcaktimin e dënimit e kishte konsideruar si relevant statusin e të akuzuarit si mjek dhe faktin se ai kishte keqpërdorur pozitën e tij duke shkatërruar jetët në vend të shpëtimit të tyre dhe kishte shkelur detyrimin etik të cilin ia kishte borxh komunitetit. Arsyetimi ishte i ngjashëm kur Trupi Gjykses në rastin Todorovic kishte observuar se *“në vend se, në pozitën e tij si kryeshef i institucionit që është përgjegjës për zbatimin e ligjit, Stevan Todorovic aktivisht dhe drejtpërdrejtë kishte marrë pjesë në veprat penale të cilat ai do duhej t’i parandalonte apo t’i ndëshkonte...keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit të tij dhe besimit të popullit në institucion qartazi përbën rrethanë rënduese”*.¹³⁹

b. Keqpërdorimi i besimit

Keqpërdorimi i besimit, në dritën e rrethanës 2.9, duhet të konsiderohet si një strukturë më pak e formalizuar e pushtetit joqeveritar. Këto bien në konceptet më tradicionale të keqpërdorimit të besimit në të cilat ka një marrëdhënie të mirëbesimit ndërmjet viktimës dhe kryerësit. Kjo mund të jetë marrëdhënie në të cilën kryerësit me vullnet i është dhënë diskrecioni nga viktimë, siç është marrëdhënia financiare, apo diskrecioni është krijuar nga norma shoqërore apo situata e besimit tradicional, siç është raporti i prindit me fëmijën. Ndonëse është me rëndësi që marrëdhënia apo besimi të shikohet nga perspektiva e viktimës, kjo megjithatë duhet të ekzistojë si diçka më shumë se thjeshtë besimi i viktimës në deklaratat apo sjelljet çorientuese të kryerësit, dhe duhet të bazohet në besim të arsyeshëm.

a. Në kontekst familjar apo të ngjashëm

Kjo rrethanë në përgjithësi mund të mbulojë situatat kur vepra është kryer në kontekste të ndryshme familjare. Kjo mund të përfshijë partnerin martesor të tanishëm apo të mëparshëm, apo partnerin jashtëmartesor. Gjithashtu mund të përfshijë edhe anëtarët e familjes së viktimës, siç janë prindërit dhe gjyshërit, fëmijët, apo personat të cilët kanë marrëdhënie të varësisë familjare me viktimën. Elementi i përbashkët i këtyre rasteve është që pozita e besimit të ketë një shkallë të lartë të lidhjes me dëmin specifik emocional i cili mund të shfaqet nga keqpërdorimi i këtij besimi.

¹³⁸ Rasti Nr. ICTR-96-17-T, Aktgjykimi dhe dënimi, Prokurori kundër Elizaphan dhe Gorard Ntakirutimana, Tribunali Ndërkombëtar Penal për Ruandë (TNPR), (21 shkurt 2003).

¹³⁹ Rasti Nr. IT-95-9/1-S, Aktgjykimi i caktimit të dënimit, Prokurori kundër Stevan Todorovic, Tribunali Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavi, (31 korrik 2001), Par.61, gjithashtu citohet Aktgjykimi i Apelit në rastin Aleksovski, par. 183; Aktgjykimi i Apelit në rastin Celebici, par.745.

Besimi në kontekst familjar nënkupton një pritshmëri të sjelljes së dyanshme e cila tregon konsideratë, ndershmëri, kujdes dhe përgjegjësi. Keqpërdorimi i besimit lidhet me keqpërdorimin e këtij mirëkuptimi i cili mund të bëhet përmes dhunës së drejtpërdrejtë apo keqtrajtimit emocional. Një konsideratë shtesë përfshinë vlerësimin e keqpërdorimit të pushtetit në marrëdhënie përmes kufizimit të autonomisë së individit tjetër. Kjo është shpesh një komponentë e situatave të dhunës në familje dhe mund të përfshijë mbajtjen e kontrollit përmes mjeteve psikologjike, fizike, seksuale, financiare apo emocionale.

Në pothuajse çdo situatë që përfshin veprën e kryer në marrëdhënie familjare, do të ketë ndonjë element të keqpërdorimit të besimit. Kjo natyrisht ndodh sepse ky faktor tradicionalisht konsiderohet si rrethanë për ashpërsimin e dënimit për vepra që përfshijnë marrëdhëniet familjare apo intime. Puna kryesore e gjykatës është që të vlerësojë shkallën e rrethanës rënduese dhe nivelin e ashpërsimit të dënimit. Natyrisht, kjo do të varet nga natyre e veprës dhe në një masë të caktuar edhe nga afërsia e marrëdhënies. Kurkryerësi bashkëjeton me viktimën dhe është i përfshirë në marrëdhënie intime, apo është prind, shkelja do të jetë në nivelin më të madh të mundshëm. Me zbehjen e marrëdhënies, zvogëlohet proporcionalisht edhe shkalla e ashpërsimit të dënimit.

Dyfishimi dhe kujdesi

Sikurse që është rasti edhe me rrethanat tjera, shqetësimi kryesor është që kjo rrethanë të mos llogaritet dyfish, pra të mos merret edhe si element i veprës penale edhe si rrethanë rënduese. Gjykata duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë formulimit në ligj lidhur me dallimin ndërmjet tyre, ndonëse, siç u tha më lartë, jo gjithmonë këto do të jenë formalisht të dallueshme. Prandaj marrëdhënies e cila përfshin një strukturë më joformalemund t'i referohet si keqpërdorim i autoritetit. Pyetja me rëndësi është nëse ka ndonjë formë të strukturës së pabarabartë të pushtetit e cila përdoret dhe e cila është e rëndësishme në kryerjen e veprës. Nëse kjo ekziston si element, atëherë gjykata nuk duhet ta ashpërsojë më tej dënimin në kuadër të kufijve të paraparë.

Dyfishimi me rrethana tjera rënduese gjithashtu mund të ndodh. Gjykata mund të merr parasysh keqpërdorimin e besimit në lëndimin apo seriozitetin përfundimtar të veprës. Mund të ketë dyfishim edhe me nivelin e mizorisë. Për shkak të natyrës së marrëdhënies, mund të argumentohet se kjo rrethanë e rrit nivelin e ndjeshmërisë së viktimës.

Pyetjet relevante përfshijnë:

- A ka ndonjë marrëdhënie apo pabarazi në pushtet ndërmjet kryerësit dhe viktimës?
- A ka ndonjë marrëdhënie formale të mirëbesimit apo kuazi-mirëbesimit ndërmjet kryerësit dhe viktimës?
- A ka kryerësi ndonjë detyrim financiar apo personal ndaj viktimës?
- A është viktimë e varur nga kryerësi për kujdes apo mbështetje financiare?
- A ka ndonjë shkallë të lartë të varësisë emocionale nga viktimë?

- A është varur vepra nga ekzistimi i marrëdhënies apo keqtrajtimit? Nëse jo, a ka qenë faktor në suksesin e përgjithshëm të veprës?
- A ka qenë marrëdhënia apo besimi i arsyeshëm duke marrë parasysh situatën?
- ka ndikuar dhuna në shkallën e dëmit të shkaktuar viktimës?
- A ka ndikuar shkelja në ndonjë rrethanë tjetër rënduese ose a ka qenë e përfshirë në përcaktimin e formës së cilësuar të veprës?

5.6.Nëse vepra penale është kryer si pjesë e veprimtarisë së grupit të organizuar kriminal¹⁴⁰

Rrethana rënduese 2.11 konsideron funksionimin e grupit të organizuar kriminal si rrethanë rënduese në përcaktimin e dënimit përfundimtar. Kur aktiviteti kriminal bëhet më i strukturuar dhe më i shtjelluar, ai paraqet rrezik më të madh për funksionimefektiv të shoqërisë. Ai e zbeh besimin shoqëror në sundimin e ligjit, pengon zhvillimin ekonomik, dhe kontribuon në shkallën e përgjithshme të krimit pasi që strukturat e organizuara janë më të afta për arritje të konsiderueshme. Për shkak të rrezikut, gjetja e kësaj rrethane nga gjykata duhet të ketë ndikim të rëndësishëm në dënimin përfundimtar.

Për përcaktimin e kësaj rrethane është thelbësore ekzistimi i “grupit të organizuar kriminal” i cili përkufizohet në mënyrë specifike në nenin 120 paragrafin 13 të Kodit Penal si “bashkim i strukturuar, që ekziston për një kohë të caktuar, i tre apo më shumë personave për kryerjen e veprave të caktuara penale, që vepron në bashkëpunim me qëllim të kryerjes së një apo më shumë veprave të rënda penale për përfitim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dobisë financiare apo dobisë tjetër pasurore”. Kjo shtjellohet edhe më tej në përkufizimin e “bashkimit të strukturuar” në paragrafin 14, icili përkufizohet si “bashkim i cili nuk është formuar rastësisht për kryerjen e menjëhershme të veprës penale, por nuk është e nevojshme që anëtarët e këtij bashkimi të kenë role formalisht të përcaktuara, vazhdimësi të anëtarësisë së tyre apo strukturë të ndërtuar”.

Ka disa elemente të kësaj rrethane rënduese të cilat duhet të shqyrtohen me kujdes nga gjykata. E para është se duhet të ketë bashkim të strukturuar i cili “nuk është formuar rastësisht” por pa pasur nevojë për vazhdueshmërinë e bashkimit apo ndonjë strukture më të formalizuar hierarkike.

Kjo është për të parandaluar vetë pjesëmarrjen e disa personave për të ashpërsuar dënimin. Një shembull i mirë i formimit të rastësishtëm për kryerjen e menjëhershme të veprës penale do të ishte kalimtarët e rastit të cilët shohin një rrahje dhe vendosin të marrin pjesë në të. Në këtë situatë, ndonëse ata janë të organizuar deri në atë masë sa të gjithë personat marrin pjesë në vepër (dhe mjaftueshëm për të plotësuar kërkesat e përkufizimit), ata janë organizuar për qëllim

¹⁴⁰ Kodi Penal, neni 74, par.2.11

të kryerjes së veprës, mirëpo kryerësit janë formuar rastësisht për ta kryer veprën. Bashkimi mund të thuhet se është formuar në mes të kryerjes së veprës penale, e jo në mënyrë që ta kryejë veprën. Ata rrjedhimisht nuk përbëjnë bashkim të strukturuar. Megjithatë, çdo gjetje e vazhdueshmërisë së bashkimit apo strukturës së formalizuar do të kontribuojë dukshëm në zbatimin e kësaj rrethane.

Aspektet shtesë të cilat duhet nënvizuar janë kërkesa që grupi të përbëhet nga tre apo më shumë persona, që të ketë si qëllim kryerjen e një apo më shumë veprave të rënda penale, dhe që të ekzistojë për një kohë të caktuar. Kërkesa numerike është e thjeshtë. Megjithatë, gjykata duhet ta eliminojë këtë rrethanë vetëm nëse numri që në fillim është i pamjaftueshëm apo nëse numrat e mjaftueshëm janë eliminuar me shpalljen e pafajshme të personave. Grupi gjithashtu duhet të ketë për qëllim kryerjen e një apo më shumë veprave penale. Kjo është një gjetje specifike nga gjykata se organizata apo grupi është formuar apo bashkuar për të kryer të paktën një vepër penale. Përkufizimi nuk kërkon që çështja për të cilën janë bashkuar të jetë edhe çështja për të cilën gjykohen para gjykatës. Kryerësit mundën, për shembull, ta kenë formuar grupin më parë me qëllim të kryerjes së veprës së rëndë penale, por në fakt janë shpallur fajtor vetëm për veprën për të cilën gjykohen. Dhe kërkesa e fundit është që grupi të ketë ekzistuar për një kohë të caktuar. Ndonëse nuk ka ndonjë periudhë specifike kohore që duhet të ketë kaluar për t'u plotësuar ky kusht, për plotësimin e tij mjafton që grupi të mos jetë formuar “rastësisht” me qëllim të kryerjes së veprës penale.

Dyfishimi dhe kujdesi

Brenga kryesore me këtë rrethanë është ndërveprimi ndërmjet saj dhe akuzës formale për krim të organizuar sipas Kodit Penal. Natyrisht pasi që akuza për krim të organizuar përfshin funksionimin e grupit të organizuar kriminal, gjetja fajtor për këtë vepër e përjashton përfshirjen e saj si rrethanë rënduese. Përndryshe, mungesa e akuzës për krim të organizuar apo lirimi nga akuza për këtë vepër nuk e përjashton automatikisht aplikimin e saj si rrethanë rënduese. Gjkata duhet të shqyrtojë me kujdes përse nuk ekziston vepra, dhe nëse kjo gjetje gjithashtu e përjashton edhe elementin e rrethanës rënduese. Nëse nuk përjashtohet ky element, atëherë rrethana mund të aplikohet. Konsiderata primare do të jetë nëse dashja dhe qëllimi i pjesëmarrjes në vepër ka qenë thjeshtë kryerja e veprës penale apo mundësimi i mëtejshëm i ekzistimit dhe prosperitetit të grupit të organizuar kriminal.

Lidhur me dyfishimin e mundshëm me kategori tjera rënduese, mund të ketë dyfishim bazuar në natyrën kërcënuese të aktivitetit të grupit. Në situatat kur më shumë se një person ka qenë i përfshirë në kryerjen e veprës penale kundër një viktime të vetme, është domethënës fakti se viktima me gjasë do të jetë në gjendje të frikësimit më të madh dhe do të ketë një ndjenjë të pambrojtshmërisë. Përveç kësaj, mund të argumentohet se grupi i vë presion vetes për ta përfunduar veprën dhe dinamikat e ndërlidhura mund të çojnë te shkaktimi i dëmit më të madh.

Pyetjet relevante përfshijnë:

- A ka ekzistuar grupi në ndonjë shkallë para kryerjes së veprës?
- A kanë qenë të paktën 3 persona që kanë kontribuar në kryerjen e veprës?
- A kanë kontribuar veprimet e secilit person në kryerjen e veprës?
- A ka qenë qëllimi i grupit për të kryer veprë me qëllim të përfitimit të dobisë financiare apo pasurore (drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë)?
- A është hedhur poshtë akuza për krim të organizuar? Nëse po, cila ka qenë bazapër këtë?
- A ka kontribuar ekzistimi i grupit në dëmin apo a ka luajtur ndonjë rol në përfundimin e suksesshëm të veprës penale?
- A ka pasur ndonjë hierarki të strukturuar apo të gjysëm-strukturuar?

5.7. Nëse vepra penale kryhet ndaj personit ose grupit të personave, ose pronës, për shkak të origjinës etnike ose kombëtare, shtetësisë, gjuhës, besimeve fetare, ose mungesës së besimeve fetare, ngjyrës, gjinisë, orientimeve seksuale, ose për shkak të afërsisë me personat me karakteristikat e lartpërmendura¹⁴¹

Gjykata duhet ta bëjë dallimin në mes të motivit dhe *mens reas* (qëllimit). E para ka të bëjë me arsyet që e shtyjnë personin të veprojë, ndërsa e dyta ka të bëjë me elementin mendor apo dashjen kriminale që kërkohet për veprën e caktuar. Në këtë situatë, gjykata në mënyrë specifike do të gjejë se motivi që ka shtyrë kryerësin të kryejë veprën është fakti se viktima bën pjesë në grupin e caktuar të mbrojtur. Vlen të theksohet se nuk ka ndonjë kërkesë të theksuar qartë që gjykata të përcaktojë se personi apo grupi i personavenë fakt janë anëtar të grupit të mbrojtur. Kjo nuk duhet të jetë objekt shqyrtimi nga gjykata. Mjafton fakti që kryerësi ka pasur bindje të arsyeshme se viktima i përket ndonjë kategori të mbrojtur.

Kjo rrethanë gjithashtu përfshin motivet për afinitetin e individit me grupin e mbrojtur. Edhe në këtë rast, nuk ka ndonjë kërkesë specifike që personi në fakt të ketë afinitet me grupin, mjafton që kryerësi të ketë besuar se ekziston afiniteti i tillë dhe kjo të ketë ndikuar në motivin për kryerjen e veprës. Afiniteti është një kategori e gjerë e cila shkon përtej marrëdhënieve më formale siç janë martesat apo lidhjet familjare. Kjo mund të përfshijë miqësitë, njohjet, apo vullnetin e mirë në përgjithësi.

Përcaktimi i motivit të kryerësit është çështje e shqyrtimit të të gjitha rrethanave. Ndonëse shprehja e motivit nga kryerësi gjatë kryerjes së veprës apo gjatë intervistimevetë mëvonshme mjafton për ta vërtetuar këtë rrethanë, kjo nuk është e nevojshme. Gjykata mund të përdorë çfarëdo veprimi, sjellje dhe/apo qëndrimi të kaluar në raport me grupin për të vërtetuar ekzistimin e kësaj rrethane.

Dyfishimi dhe kujdesi

¹⁴¹ Kodi Penal, neni 74, par.2.12

Shqetësimi kryesor lidhur me këtë rrethanë ka të bëjë me ndërveprimin e saj me akuzat tjera të cilat përfshijnë ndonjë element të motivit bazuar në anëtarësinë apo perceptimin e anëtarësisë në ndonjërin nga kategoritë e përcaktuara. Kjo kryesisht ndodh në fushën e krimeve të urrejtjes siç janë krimet kundër njerëzimit apo nxitja e urrejtjes. Ndonëse këto vepra kryesisht përqendrohen në grupe racore, fetare dhe etnike, vendi i tyre si vepra penale specifike në kod nuk e zbeh rëndësinë e grupeve tjera të mbrojtura. Andaj, ashpërsimi i dënimit për një vepër të motivuar nga orientimi seksual i viktimës meriton të njëjtën shkallë të ashpërsimit sikurse veprat e motivuara nga përkatësia etnike e viktimës. Gjithashtu, nuk ka ndonjë dallim ndërmjet viktimizimit të bazuar në faktin që viktima bën pjesë në grupin e caktuar dhe afinitetit për grupin e caktuar – niveli i ashpërsimit është i njëjtë.

Mund të ketë dyfishim në vlerësimin e shkallës së seriozitetit si dhe numrin e viktimave. Posaçërisht në situata kur vepra shihet si shumë e gjerë dhe motivi është i lidhur më qartë me veprën. Vepra e cila kryhet në vend të hapur publik dhe është qëllimisht dhe haptazi endërlidhur me kategorinë mund të përfshijë më shumë viktima dhe/ose mund të shkaktojë nivel më të lartë të dëmit.

Pyetjet relevante përfshijnë:

- A ka prova se vepra është motivuar nga anëtarësia apo afiniteti për anëtarët e njërës nga kategoritë e mbrojtura?
- A ka bërë i pandehuri ndonjë deklaratë para, gjatë apo pas kryerjes së veprës në të cilën tregon motivin?
- A janë të përfshira disa kategori të mbrojtura?
- A ka sjellje apo deklarata të mëparshme të të pandehurit të cilat tregojnë shënjestrim të kategorisë së mbrojtur?
- A ka qenë vepra qëllimisht e paraparë që të prek një numër të madh personash përveç viktimës së caktuar?
- A ka kryerësi ndonjë të kaluar apo predispozita të ndërveprimit negativ me kategorinë?

5.8. Ndonjë dënim penal të mëparshëm të personit të dënuar¹⁴²

Kjo rrethanë njihet bindjen e përgjithshme se individët të cilët kanë kryer vepra penale në të kaluarën duhet të dënohet më ashpër sesa ata të cilët nuk kanë kryer. Ajo gjithashtu pranon se dënimet e mëparshme kanë dështuar në rehabilitimin apo reformimin e kryerësit. Në esencë, qëllimi i dënimit fillon të shmanget nga perspektiva e rehabilitimit në drejtim të konceptit të parandalimit të veprave të kryerësit në të ardhmen.

¹⁴² Kodi Penal, neni 74, par.2.13

Në këto raste gjykata duhet të shqyrtojë sjelljen e mëparshme dhe të merr parasysh një mori të faktorëve, përfshirë:

- numrin e dënimeve të mëparshme;
- peshën e veprave të mëparshme;
- natyrën e veprave dhe ngjashmërinë e tyre me veprën e tanishme (veprat e ngjashme për nga natyra janë tregues i sjelljes së vazhdueshme si dhe i dështimit të dënimit të mëparshëm për të parandaluar kryerësin nga kryerja e veprave;
- kohën që ka kaluar ndërmjet dënimeve (një kohë më e gjatë ndërmjet dënimit të mëparshëm dhe dënimit aktual është më pak relevante sesa dënimi i mëparshëm); dhe
- dënimet e shqiptuara për veprat e mëparshme (veprat të cilat kanë rezultuar në dënim minimal me burgim apo dënime alternative janë më pak relevante sesa ato që kanë rezultuar me kohëzgjatje të konsiderueshme në burg).

Është me rëndësi të theksohet se kjo është një konsideratë e ndarë nga ashpërsimi i dënimit për recidivizëm të shumëfishtë nga neni 79. Për dallim nga neni 79, i ciliparashëh kualifikime shumë të qarta lidhur me konsiderimin e dënimeve të mëparshme, kjo rrethanë rënduese nuk parasheh dispozita të tilla. **Prandaj çdo dënim i mëparshëm mund të merret parasysh, pavarësisht nga dënimi përfundimtar apo raporti i tyre i përkohshëm me dënimin aktual, nëse gjykata i konsideron relevante për matjen e dënimit.**

Kjo rrethanë rënduese duhet të merret parasysh kur kryerësi është dënuar më parë për vepra penale, veçanërisht për vepra të natyrës së ngjashme. Për shkak të natyrës së dhunës në familje, e cila përsëritet, kjo rrethanë është posaçërisht e rëndësishme në vlerësimin e natyrës së përgjithshme të marrëdhënies dhe nevojës për dënim më të lartë. Në mënyrë që të parandalohet vazhdimi i ciklit të dhunës, prania e dënimeve të mëparshme që kanë lidhje të arsyeshme me mbajtjen apo ushtrimin e kontrollit mbi viktimën duhet të rezultojë në dënime dukshëm më të ashpra.

Në raste të recidivizmit (përsëritjes së veprës), viktimja e dhunës në familje, si rregull, ka ndërmarrë rol aktiv në kërkimin e ndihmës nga sistemi i drejtësisë penale dhe institucionet përkatëse. Andaj recidivizmi është tregues i dështimeve të vazhdueshme të institucioneve të cilat ligjërisht janë të detyruara që të ofrojnë mbrojtje (dhe drejtësi) për viktimën. Në raste të recidivizmit, parandalimi si një nga qëllimet e synuara të sanksionit qartazi nuk është arritur. Për më tepër, recidivizmi mund të tregojë një sjellje të vazhdueshme të dhunës në familje apo të rrahjes, posaçërisht në kombinim me format tjera të sjelljes së dhunshme (dominimi ekstrem, xhelozia obsesive, etj).¹⁴³ Në përgjithësi, gjetja e kësaj rrethane rënduese duhet të rezultojë në një dënim më të ashpër për kryerësin.

Neni 73 paragrafi 4 i Kodit Penal parasheh që kur cakton dënimin për recidivistin, gjykata merr parasysh nëse kryerësi më parë ka kryer vepër penale të njëjtë sikurse veprën e re, nëse

¹⁴³ Rasti nr.IT-95-9/1-S, Aktgjykimi për Caktimin e Dënimit, Prokurori kundër Stevan Todorovic, Tribunali Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavi, (31 korrik 2011), Par. 61, gjithashtu citohet Aktgjykimi i Apelit në rastin Aleksovski, par. 183; Aktgjykimi i Apelit në rastin Celebici, par.745.

të dy veprat janë kryer për të njëjtat motive dhe kohën e kaluar nga shqiptimi i dënimit të mëparshëm apo nga dënimi i mbajtur apo i falur. Kjo pjesë e Koditi lejon gjykatës që ta përshtat dënimin maksimal të paraparë me ligj duke shtuar jo më shumë se gjysmën e maksimumit të dënimit.

Ndonëse çdo vepër penale e mëparshme mund të merret parasysh në matjen e dënimit, nëse gjykata rastis në vepra që zakonisht ndërlidhen me situatat e dhunës në familje, rekomandohet fuqishëm që të zbatohet kjo dispozitë në mënyrë që të ashpërsohet niveli i përgjithshëm i veprës.

Dyfishimi dhe kujdesi

Shqetësimi kryesor me këtë rrethanë është potenciali për konflikt ndërmjet saj dhe nenit 73 lidhur me recidivizmin. Megjithatë, është e mundur që kryerësi të jetë subjekt edhe i ashpërsimit të dënimit për shkak të recidivizmit si dhe i ashpërsimit në kuadër të kufijvetë dënimit të cilësuar. Rasti i tillë duhet të plotësojë në mënyrë të pavarur kushtet e parapara për të dyja këto situata pa aplikuar ndonjërin nga veprat ndaj të dyja kriterëve.

Pyetjet relevante përfshijnë:

- A i plotëson dënimi i mëparshëm kushtet nga neni 73 për aplikimin e ashpërsimit për recidivizëm?
- A janë dënimet e mëparshme të natyrës së ngjashme pa qenë kundër së njëjtës viktimë?
- A tregon dënimi i mëparshëm sjellje të vazhdueshme kriminale?
- A ka pasur dënime të mëparshme të natyrës dhe kohëzgjatjes së ngjashme me dënimin e propozuar?
- Sa kohë ka kaluar nga dënimi i mëparshëm dhe vepra e tanishme? Çfarë ka bërë kryerësi gjatë kësaj kohe? A ka qenë kryerësi anëtar produktiv i shoqërisë gjatë kësaj kohe?

5.9.Rrethanat tjera rënduese

Lista e rrethanave rënduese të parapara në Kod Penal nuk është gjithëpërfshirëse,¹⁴⁴ prandaj gjykata mund të konsiderojë rrethana tjera rënduese. Megjithatë, gjykata duhet të jetë veçanërisht e kujdesshme dhe e sigurt që të ketë prova për të mbështetur zbatimin e tyre. Siç u përmend më parë, kodi parasheh shumicën e dispozitave të cilat rregullisht konsiderohen si rrethana rënduese në praktikën ndërkombëtare. Megjithatë, mund të ketë situata në të cilat është e përshtatshme të konsiderohen rrethana të caktuara rënduese që nuk parashihen në kod bazuar në llojin e veprës së caktuar dhe veçoritë e kryerësit.

Përgjatë këtij udhëzimi janë diskutuar situata në të cilat skenarë të caktuar faktik mund të

¹⁴⁴ Kodi Penal, neni 74, par.2

përfshihen në vlerësimin e njëres nga kategoritë e përcaktuara. Nëse gjykata e vlerëson të përshtatshme, është absolutisht e pranueshme që ta izolojë skenarin faktik dhe ta merr parasysh si rrethanë të pavarur rënduese sipas dispozitave gjithëpërfshirëse.

Rrethanat tjera të mundshme:

5.9.1 Mungesa e pendimit

Dëshmitë faktike se kryerësi nuk ka shfaqur pendesë për kryerjen e veprës gjithmonë duhet të konsiderohen si rrethanë rënduese. Kjo jo vetëm që shpërfaq mungesë të respektit për viktimën por gjithashtu tregon mungesë të përgjithshme të respektit për ligjin. Kryerësi i cili nuk pendohet është një tregues i fuqishëm se rehabilitimi do të dështojë dhe rrjedhimisht nuk duhet të konsiderohet si diçka që ka ndikim kryesor në vendimin përfundimtar. Gjykata duhet të anojë më shumë drejt një dënimi i cili e shmang ndërveprimin e kryerësit me shoqërinë përmes burgimit.

5.9.2 Shkelja e urdhrave të gjykatës

Kryerja e një vepre e cila në proces e sipër shkel urdhrat e mos-ngacmimit të lëshuar në procedurë civile, apo gjersa personi i nënshtrohet ndonjë urdhri tjetër, siç është urdhri mbrojtës, apo në shkelje të urdhrat të gjykatës me të cilin ndalohej ndonjë sjellje e caktuar, do të ashpësojë në mënyrë të konsiderueshme seriozitetin e veprës. Shkelja e urdhrat të shqiptuar me qëllim të mbrojtjes së viktimës mund të shkaktojë dëm dhe/apo ankth të konsiderueshëm. Kjo gjithashtu shpërfaq mosrespektim për autoritetin e gjykatës dhe rrezikon edhe bindjen ndaj urdhrave tjerë. Mos-ashpërsimi i dënimeve për shkelje të urdhrave të gjykatës do të zbeh respektimin e përgjithshëm të urdhrave në raste familjare dhe jofamiljare.

5.9.3. Përsëritja e veprave

Në raste të dhunës në familje, mund të mos jetë e mundur që në mënyrë të saktë të vlerësohet arsyeshmëria duke shikuar incidentin si të izoluar; e kaluara e dhunshme nga ana e cilësdo palë shpesh është thelbësore. Kjo i referohet çfarëdo vepre që është kryerë shumë se një herë nga kryerësi i njëjtë gjatë një periudhe të caktuar kohore. Kjo është rrethanë shumë e rëndësishme pasi që e vë theksin në efektin veçanërisht shkatërrues në viktimën e cila vazhdimisht i nënshtrohet llojit të njëjtë të veprimit kriminal. Kjo rrethanë është veçanërisht e rëndësishme në rastet e dhunës në familje ku kryerësi dhe viktimja jetojnë në të njëjtën shtëpi e cila automatikisht ngrit nevojën për ashpërsim të dënimit.

5.9.4 Përsëritja e kanosjeve për përdorim të dhunës

E kaluara e dëshmuar e dhunës apo kanosjeve nga kryerësi në kontekst familjar është faktor kyç në vlerësimin e peshës së veprës pasi që kjo e njeh efektin kumulativ të incidenteve të dhunshme apo kanosjeve gjatë një periudhe të zgjatur kohore, ku sjellja e tillë është provuar apo pranuar. Sulmet e mëparshme janë të pranueshme për të treguar motivin apo dashjen në

raste të dhunës në familje edhe kur ato janë kryer kohë më parë.

Nëse personi është përfshirë në dhunë të vazhdueshme kundër partnerit intim përgjatë njëkohe, viktima mund ta ketë bindjen e arsyeshme se rreziku është i pashmangshëm nëbazë të shenjave të vogla të sjelljes të cilat mund të kenë pak rëndësi në rastet ku përfshihet dhuna ndërmjet të panjohurve.

KAPITULLI VI

RRETHANAT LEHTËSUERE NGA NENI 74

6.1 Çështje të përgjithshme

Për dallim nga rrethanat rënduese, të cilat përqendrohen në viktimën dhe peshën e veprës penale, rrethanat lehtësuese priren për të zbutur dënimin bazuar në vetitë pozitive të kryerësit siç është pranimi i përgjegjësisë apo bashkëpunimi, rrethanat përtej kontrollit të kryerësit, dhe faktet të cila e zvogëlojnë fajësinë. Ato i përshtaten konceptit të proporcionalitetit si dhe qëllimeve të rehabilitimit. Sikurse me rrethanat rënduese, gjykataduhet të kërkojë mbështetje faktike para se të konkludojë se një rrethanë e caktuar ekziston, veçanërisht kur kërkohet mendimi i ekspertit, për të shmangur shqyrtimin dhe aplikimin e dyfishtë.

Për dallim nga rrethanat rënduese, në të cilat disa rrethana mund të përbëjnë element të veprës penale, rrethanat lehtësuese nuk janë të përfshira në vepër në mënyrë specifike. Pasi që shumica e rrethanave lehtësuese kanë të bëjnë me personin apo ndërveprimin e tyre me organet e zbatimit të ligjit, ato interpretohen gjerësisht për t'u zbatuar në çfarëdo situatë. Ka pak shqetësime lidhur me llogaritjen e dyfishtë të tyre dhe gjykata mund të përqendrohet kryesisht që të mos ketë përkim ndërmjet rrethanave të caktuara.

Çështja kryesore për gjykatën do të jetë kur hyn në fusha apo rrethana të zbutjes të cilat janë të diskutueshme. Kjo mund të ndodh brenda ndonjë rrethane të caktuar që parashihet në kod apo në kuadër të ndonjë rrethane që nuk është e përcaktuar në mënyrë specifike në kod. Pavarësisht, për dallim prej rrethanave rënduese, të cilat janë të përkufizuara në mënyrë relativisht të ngushtë dhe gjerësisht të pranuar nga komuniteti ndërkombëtar, rrethanat lehtësuese janë koncept më fluid i cili vazhdimisht evoluon.

Kategoritë e gjera e bëjnë vlerësimin edhe më të vështirë. Për shembull, rrethanat personale mund të përfshijnë pothuajse çdo gjë që ndërlidhet me jetën e kryerësit. Ndonëse kjo është e rëndësishme për t'u siguruar që gjykata të mos caktojë ndonjë dënim që është më i rëndë se që është e nevojshme, kjo e rrit në mënyrë të konsiderueshme potencialin që preferencat apo bindjet personale të gjykatës të ndikojnë në dënim. Rrjedhimisht, kjo rrit mundësinë e shqiptimit të dënimeve të paharmonizuara për vepra të ngjashme pasi që dy gjykata mund të mos pajtohen nëse një situatë e caktuar është lehtësuese apo jo. Përfundimisht gjykata duhet të vlerësojë me kujdes nëse rrethana është vërtetë lehtësuese dhe në pajtim me standardet përkatëse, apo nëse është bindje personale e gjykatës që ka ndikime më të mëdha në praktikën e përgjithshme të dënimit. Në vlerësimin e fakteve dhe vendimeve gjyqtari gjen një mes ndërmjet ndjeshmërisë, dhembshurisë, mirësisë, disiplinës dhe ashpërsisë në mënyrë që

zbatimi i tij i ligjit të perceptohet si i ligjshëm dhe i drejtë.¹⁴⁵

6.2 Rrethanat të cilat për pak nuk arrijnë të jenë bazë për përjashtimin e përgjegjesisë penale, si për shembull, aftësia e zvogëluar mendore¹⁴⁶

Kjo rrethanë lehtësuese varet nga rrethanat që zvogëlojnë përgjegjësinë penale, siç janë disa gjendje mendore të cilat për pak nuk arrijnë të jenë bazë për përjashtimin e përgjegjesisë penale. Ndonëse kjo kategori nuk është e kufizuar, dhe rrethanat tjeradiskutohen shkurtimisht në vijim, referimi specifik në aftësinë e zvogëluar mendore reflekton qëllimin për t'u përqendruar në shëndetin mendor si mjet primar në bazë të të cilit ekziston kjo rrethanë. Kryerësit pretendojnë se ndonëse e kanë shkelur ligjin, ata nukduhet të mbahen plotësisht të përgjegjshëm penalisht për atë veprim pasi që aftësia e tyre mendore ka qenë e zvogëluar apo e kufizuar.

Kjo përkufizohet më tërësisht në nenin 18 paragrafin 2 të KP:

Personi i cili ka kryer veprë penale konsiderohet se ka aftësi të zvogëluar mendore nëse në kohën e kryerjes së veprës penale aftësia e tij për të kuptuar natyrën dhe rëndësinë apopasojën e veprimeve ose mosveprimeve të tij ka qenë esencialisht e zvogëluar për shkaqete cekura në paragrafin 1 të këtij neni. Personi i tillë konsiderohet penalisht përgjegjës, porkëto rrethana merren parasysh nga gjykata kur vendos për kohëzgjatjen dhe llojin e sanksionit ose masës së trajtimit të detyrueshëm.

Referenca në paragrafin 1 kërkon që aftësia e zvogëluar mendore të burojë nga ndonjë “sëmundje mendore e përkohshme apo e përhershme, çrregullim mendor apo ngecje në zhvillimin mendor që e ka prekur funksionimin e tij mendor”.¹⁴⁷

Lexuar së bashku, gjykata duhet të vlerësojë 2 fakte para se të vendos për zbutje. Së pari, që aftësia e kryerësit për të kuptuar natyrën e veprimeve të tij ka qenë esencialisht e zvogëluar. Dhe së dyti, që aftësia e zvogëluar është drejtpërdrejtë e lidhur me gjendjen mendore në ndonjë formë.

Përfundimisht, konsiderata e kërkuar nga gjykata sipas nenit 18 plotësohet nga kjo rrethanë lehtësuese dhe nuk duhet të ketë zbutje të mëtutjeshme të dënimit për shkak të gjendjes mendore sipas ndonjë rrethane apo teorie tjetër të përgjegjesisë së zvogëluar. Sie tillë, gjetja e kësaj rrethane mund të rezultojë në zbutje të konsiderueshme të dënimit. Megjithatë, për shkak të natyrës teknike të gjetjes së tillë, gjykata duhet të mbështetet në dëshminë mjekësore apo mendimin e ekspertit në konkludimin se gjendja e tillë ekziston dhe është esenciale. Teoritë tjera lidhur me këtë rrethanë lehtësuese përfshijnë mundësinë e zbutjes së dënimit

¹⁴⁵ Rrjeti Evropian i Këshillave për Gjyqësor (RREKJ), Raporti i etikës gjyqësore 2009-2010, fq. 12.

¹⁴⁶ Kodi Penal, neni 74, par.3.1

¹⁴⁷ Kodi Penal neni 18, par. 2.

bazuar në përgjegjësinë e zvogëluar sipas Kapitullit II varësisht nga rrethanat.

- Neni 13 – Nevoja ekstreme – kushtet plotësohen por
 - E keqja e shkaktuar është më e madhe se e keqja e kanosur
 - Dëmi i shkaktuar është për shkak të pakujdesisë së kryerësit

- Neni 14 – Dhuna dhe kanosja
 - Vepra është kryer nën ndikimin e dhunës apo kanosjes së përballueshme dhe raportohet menjëherë pas pushimit të rrezikut

- Neni 15 – Veprat e kryera nën shtrëngim
 - Vepra është kryer në një formë të zvogëluar të shtrëngimit si rezultat i faktit që nga kryerësi mund të pritët të pranojë rrezikun – në veçanti nëse ai ka qenë i detyruar ligjërisht që të ballafaqohet me një dhunë të tillë të atëçastshme apo me kërcënim të dhunës.

Dyfishimi dhe kujdesi

Ka pak gjasa të dyfishimit të kësaj kategorie dhe rrethanave tjera lehtësuese, ndonëse, nëse shëndeti mendor bëhet çështje thelbësore për rastin, atëherë mund të dyfishohet me rrethanat personale të kryerësit. Ndonëse shëndeti mendor do të kontribuoj në mënyrë të konsiderueshme në masat e trajtimit të detyrueshëm apo urdhrat tjerë të përfshirë në dënimin përfundimtar, nuk ka ndonjë vepër për të cilën ulet kategoria apo niveli i veprës për shkak të zotësisë mendore si element.

Pyetjet relevante përfshijnë:

- A ka pasur ndonjë kontroll mjekësor për ta bërë këtë konstatim?
- Cili është serioziteti i gjendjes mjekësore?
- A ka ndonjë histori të diagnostifikimit të gjendjes apo diagnoza ka ardhur vetëm pas kryerjes së veprës?
- A është aftësia e kryerësit për të kuptuar pasojat apo natyrën e veprimeve të tij esencialisht e zvogëluar apo vetëm pjesërisht? A është e mundur të bëhet një konstatim i tillë?
- A është kryerësi plotësisht i paaftë për të kuptuar pasojat e veprimeve të tij?
- A është konkluzioni në harmoni me standardet e pranuar përgjithësisht nga komuniteti mjekësor?
- A do të përmirësohet gjendja mendore e kryerësit apo është e natyrës permanente?
- A është gjendja e përkohshme e krijuar nga kryerësi?
- A e ka kryer veprën për shkak të nevojës ekstreme por dëmi i shkaktuar ka tejkaluar të keqen e kanosur?
- A është krijuar nevoja ekstreme nga pakujdesia e kryerësit?

- A është kryer vepra nën ndikimin e kanosjes së përballueshme e cila menjëherë është lajmëruar te organet kompetente? Cili ka qenë niveli i kanosjes me dhunë?
- A është kryer vepra në proporcion me kanosjen?
- A ka qenë perceptimi/realiteti i kanosjes i arsyeshëm duke marrë parasysh rrethanat e pranishme?
- A është kryer vepra nën shtrëngim, por nga kryerësi mund të pritet që ta pranojë rrezikun?
- A është kryer vepra nën shtrëngim, por kryerësi e ka krijuar apo shkaktuar rrezikun dhe ka qenë i detyruar ligjërisht që të ballafaqohet me rrezikun?

6.3. Dëshmia për provokim nga ana e viktimës¹⁴⁸

Çështja e provokimit është ndoshta çështja që ngjall më së shumti diskutime nga të gjitha rrethanat lehtësuese të pranishme në ligj. Ajo është çështje thellësisht emocionale që shpeshherë përfshin marrëdhëniet njerëzore dhe ndikimin e xhelozisë, hidhërimit dhe frikës. Pasi që shumica e rasteve në të cilat pretendohet si rrethanë lehtësuese përfshijnë dinamika të marrëdhënieve gjinore dhe seksuale, ajo pashmangshëm do të përfshijë vlera shoqërore, kulturore dhe morale. Mund të jetë që qasja e gjyqtarit të caktuar ndaj vlerave sociale dhe morale të ndikojë fuqishëm në vendimin nëse gjykata do t'i konsiderojë veprimet e caktuara të viktimës si “provokim” dhe, deri në një masë të caktuar, të arsyetojë veprimet e kryerësit. Si e tillë, gjykata duhet të bëjë kujdes në këtë drejtim në mënyrë që të sigurohet që bindjet personale të saj të mos mjeçullojnë përdorimin e duhur të kësaj rrethane.

Provokimi nga viktima tradicionalisht përshkruhet si humbje e vetëkontrollit nga kryerësi. Megjithatë, teoritë bashkëkohore kanë ngritur pikëpyetje rreth kësaj qasjeje pasi që ajo përqendrohet në reagimin emocional të kryerësit. Qasjet më të reja vlerësojnë edhe sjelljen e viktimës dhe shkaqet prapa reagimit të kryerësit. Kjo qasje përqendrohet në aspektin nëse veprimet e viktimës kanë qenë të mjaftueshme për t'i dhënë kryerësit ndjenjën se i është bërë shumë e padrejtë. Dhe që reagimi i kryerësit ka qenë i arsyeshëm. Për të ardhur deri te ky përfundim, gjykata duhet të përqendrohet në çështjet në vijim:

- Natyrën, shkallën dhe kontekstin e provokimit.
- Kohëzgjatjen dhe shkallën e veprimeve në përgjigje ndaj provokimit.
- Nëse reagimi ka qenë joproporcional me provokimin.

Në situata ekstreme, siç janë vrasjet, gjykatat duhet të gjejnë nivele të ngjashme ekstreme të provokimit. Për shembull, gjykatat kanë marrë parasysh provokimin kur viktima ka pranuar se ka keqtrajtuar fëmijët e të pandehurit apo viktima qëllimisht ka lënduar fëmijë të pandehurit për një periudhë të zgjatur kohore.

¹⁴⁸ Kodi penal, neni 74, par.3.2

Veprat në afekt

Në disa rrethana gjykatat kanë përfunduar se një incident i vetëm mjafton për të nxitur reagimin e kryerësit. Në këto raste duhet të ketë një ngjarje menjëherë të identifikueshme e cila ka nxitur veprimet e kryerësit. Për më tepër, ngjarja që e nxit veprimet duhet të jetë ekstreme dhe të ndryshojë përshtatshmërisht për të mënjeluar veprën e kryer nga kryerësi. Rrjedhimisht sa më i madh të jetë niveli i reagimit nga kryerësi aq më ekstreme duhet të jetë ngjarja provokuese. Për shembull, gjykata mund të gjejë provokim të mjaftueshëm për të zbutur dënimin nëse kryerësi e gjen bashkëshorten e tij në shtrat me një tjetër person dhe pastaj kundërpërgjigjet duke dëmtuar makinën e atij personi.

Provokimi në kontekst të abuzimit familjar

Abuzuesit shpesh thirren në provokim si rrethanë lehtësuese. Gjykata duhet të shqyrtojë me kujdes pretendimin e provokimit në kontekst të dhunës në familje, duke marrë parasysh faktin se abuzuesit shpeshherë e konsiderojnë si provokim çfarëdo kërcënimi të aftësisë së tyre për të kontrolluar viktimën. Në anën tjetër, partneri i rrezikuar i cili është kundërpërgjigjur ndaj abuzuesit të saj mund ta ngritë çështjen e provokimit bazuar në historinë e kaluar të dhunës së abuzuesit.

Konsiderata e parë është nëse pala e cila pretendon provokimin është abuzuesi apo partneri i rrezikuar i cili është kundërpërgjigjur. Pretendimet e tilla duhet të trajtohen me kujdes të madh, si në vërtetimin nëse ato pretendime kanë bazë faktike ashtu edhe në vlerësimin nëse sjellja e pretenduar përbën provokim të mjaftueshëm për ta zbutur seriozitetin e veprës. Kjo kërkon që gjykata të merr parasysh tërësinë e informacioneve lidhur me natyrën e marrëdhënies së dhunës në familje.

Për ta konsideruar provokimin si rrethanë lehtësuese për partnerin e rrezikuar i cili kundërpërgjigjet, zakonisht duhet të ketë dhunë të pranishme apo të anticipuar – përfshirë keqtrajtimin psikologjik. Provokimi është rrethanë lehtësuese më e fuqishme në këtë kontekst nëse provokimi ka zgjatur për një periudhë të konsiderueshme kohore. Së fundi, gjykata duhet të përcaktojë nivelin e provokimit të përjetuar nga partneri i rrezikuar që është kundërpërgjigjur. Si shembull, paragrafi 4 i nenit 188 të Kodit Penal e ka paraparë ndikimin e provokimit ekstrem në raste të lëndimit trupor: *“Gjykata mund të shqiptojë vërejtjen gjyqësore ndaj kryesit të veprës nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni, nëse kryesi është provokuar nga sjellja çnjerëzore apo e vrazhdë e të dëmtuarit”*.¹⁴⁹

“Provokimi” i kryerësit nga partneri i rrezikuar përmes refuzimit për t’iu bindur rregullave të kryerësit, siç është përfshirja romantike me personin tjetër, apo përqeshja e kryerësit, nuk përbën provokim. Gjithashtu, kanosja për t’u larguar nga marrëdhënia, mosbindja e viktimës, apo çfarëdo shkelje e “nderit” të abuzuesit, qoftë e vërtetë apo e perceptuar, nuk përbën provokim.

¹⁴⁹ Kodi Penal, neni 188, lëndimi i lehtë trupor.

Pyetjet relevante përfshijnë:

- Cila është natyra e marrëdhënies ndërmjet viktimës dhe të pandehurit?
 - A janë të panjohur apo familjar?
 - A ka marrëdhënie intime në mes tyre?
 - A është e përfshirë ndonjë palë e tretë?
- A ka qenë provokimi kriminal në natyrë – qoftë i akuzuar formalisht apo jo? Sa serioze ka qenë vepra?
- A ka ndodhur provokimi në mënyrë të përsëritur apo vetëm një herë?
- A ka ndodhur provokimi gjatë një periudhe të konsiderueshme kohore?
- A ka kaluar ndonjë periudhë e konsiderueshme kohore ndërmjet aktit të provokimit dhe reagimit?
- A ka pasur dhunë apo kanosje të dhunës?
- A kanë qenë aktet provokuese apo kanosjet e vërteta apo të perceptuara?
- A kanë qenë aktet provokuese kërkesa për të drejta të barabarta në marrëdhënie, siç është fillimi apo fundi i një marrëdhënie, kërkimi i shkollimit, kërkimi i punësimit, etj.?
- Cili ka qenë ekuilibri i pushtetit ndërmjet kryerësit dhe provokuesit?
- A ka qenë veprimi kriminal proporcional me provokimin?
 - A ka qenë i ngjashëm në natyrë?
 - Nëse ka pasur disa ngjarje më të vogla, kur bëhen bashkë a e arrijnë nivelin e mjaftueshëm?
- A e shokon ndërgjegjen reagimi pas provokimit?
- A do ta konsideronte aktin si provokim një person i arsyeshëm i ndodhur para së njëjtës situatë?

6.4.Rrethanat personale dhe karakteri i personit të dënuar¹⁵⁰

Rrethanat personale dhe karakteri i mirë i personit të dënuar në përgjithësi janë rrethana lehtësuese në strukturat e dënimit në mbarë botën. Në fakt, shumë studime të matjes së dënimeve përfundojnë se rrethanat personale janë një nga rrethanat lehtësuese që citohen më së shpeshti dhe ndikimi i tyre në dënimin përfundimtar mund të jetë mjaft domethënës. Ato shpesh konsiderohen si mënyra më e mirë për të arritur deri te një dënim vërtetë i personalizuar i cili merr parasysh të gjitha aspektet e jetës dhe rrethanave të kryerësit.

Fatkeqësisht, çështja nëse një rrethanë e caktuar personale vlen të konsiderohet apo jo si rrethanë lehtësuese shpeshherë është vendim subjektiv dhe në masë të madhe mund të varet nga mendimi personal i gjyqtarit. Ajo që konsiderohet nga një gjyqtar si rrethanë lehtësuese, mund të mos konsiderohet si e tillë nga një tjetër, e madje nga një i tretë mund të konsiderohet si rrethanë rënduese. Referimi i përgjithësuar i Kodit në “rrethanat personale” i jep mbështetje nocionit se një listë botërisht e pranuar e rrethanave personale lehtësuese është joekzistuese. Diskutimet në vijim janë një përpjekje e përgjithshme për të përshkruar në mënyrë të arsyeshme disa faktorë të cilët paraqiten shpesh.

Karakteri i mirë

‘Karakteri i mirë’ i të akuzuarit duhet të konsiderohet relevant në matjen e dënimit pasi që tregon se sjellja kriminale nuk është pjesë e sjelljeve të zakonshme të të akuzuarit. Kjo rrethanë mund të ndërlidhet me faktorë tjerë siç janë pranimi i fajësisë, bashkëpunimi me organe, dorëzimi vullnetar, pendimi, ndihma ndaj viktimave, etj. Këta faktorë duhet të ndikojnë në vlerën e rrethanës. Gjatë matjes së dënimit duhet pasur kujdes në lidhje me këtë rrethanë dhe peshën e dhënë varësisht nga ajo nëse karakteri i mirë është treguar pas veprës apo vetëm para gjyqtarit.

Në raste të dhunës në familje, një rrethanë e cila shpesh përmendet nga të pandehurit është karakteri i mirë i kryerësit. Gjykata duhet të jetë veçanërisht skeptike ndaj kërkesave për zbutje të dënimit për shkak të karakterit të mirë.

¹⁵⁰ Kodi Penal, neni 74, par 3.2

Njëra nga dinamikat e këtyre marrëdhënieve që mundëson vazhdimin e pavërejtur të dhunës në familje për periudha të gjata është aftësia e kryerësit për t'i pasur dy personalitete. Personaliteti i shfaqur në komunitet zakonisht është drastikisht i ndryshëm në krahasim me personalitetin e shfaqur në kontekst të marrëdhënies. Gjykata duhet të merr parasysh vetëm karakterin e të pandehurit që ka të bëjë me marrëdhënien. Nëse ka sjellje të vazhdueshme të dhunës në familje, kjo rrethanë nuk duhet të merret parasysh. Partnerët abuziv shpesh e paraqesin veten mirë, pasi që janë të shkathët në ruajtjen e kontrollit.¹⁵¹

Rrethana e karakterit të mirë gjithashtu merret parasysh nga gjykatat lidhur me mundësinë e rehabilitimit të të akuzuarit. Në rastin Blaskic, TNPJ (Tribunali i Hagës) ka theksuar se *“tiparet e karakterit nuk shqyrtohen aq shumë për të kuptuar arsyet e kryerjessë veprës por më shumë për të vlerësuar mundësinë e rehabilitimit të të akuzuarit”*. Pavarësisht kësaj, sikurse në rastin Furundija, kur gjykata po vlerësonte nëse duhej përfshirë moshën e re si rrethanë lehtësuese, në të dyja rastet Trupi Gjykues kishte deklaruar se *“...në një rast serioz si ky dhe përderisa shumë të akuzuar kanë këtorrethana personale, Trupi Gjykues duhet të gjejë se pesha e tyre është e kufizuar apo madje edhe joekzistente në përcaktimin e dënimit”*.¹⁵²

Provat e ‘karakterit të mirë’, të cilat përbëhen nga vlerësimi i aspekteve siç janë reputacioni, kredibiliteti, personaliteti dhe sjellja shoqërore e të akuzuarit, zakonisht kanë për qëllim që të tregojnë se vepra e kryer është jashtë karakterit dhe, në tërësi, kanë për qëllim që t’i paraqesin gjyqtarit informacion më të plotë lidhur me jetën e të akuzuarit, të kaluarën dhe karakteristikat e tij. Në rastin Sikirica, Trupi Gjykues i TNPJ kishte përfunduar se dëshmitë e karakterit të mirë duhet të shpërblehen: *“Trupi Gjykues ka shqyrtuar prova të mjaftueshme të përpjekjeve të Dragan Kolundzisë për të lehtësuar kushtet e rënda në kampin Keraterm për shumë prej të ndaluarve...Në bazë të dëshmive për qasjen e tij dashamirëse ndaj të ndaluarve, Dragan Kolundzija duhet të merr zbutjetë konsiderueshme të dënimit”*.¹⁵³

Gjendja shëndetësore e të akuzuarit

Praktika gjyqësore është mjaft e mangët sa i përket rrethanës së gjendjes shëndetësore të të akuzuarit dhe në shumë raste ka të bëjë me çështje të çrregullimeve post-traumatike dhe çrregullimeve të personalitetit të pësura nga kryerësit pas kryerjes së veprës. Për shembull, nëse i akuzuari vuan nga ndonjë formë e depresionit e cila shoqërohet me ndjenjën e fajit dhe paaftësinë për të ndjekur gjykimin për një periudhë të caktuar, këto elemente mund të merren parasysh veçanërisht si dëshmi të sinqeritetit të pendimit të tij.

¹⁵¹ Doracaku i dhunës në familje për gjyqtarë dhe prokurorë, Rrethanat personale dhe karakteri i personit të dënuar, par.10.6.4. Prishtinë (2016), fq. 76.

¹⁵² Rasti Nr.IT-95-14-T, Aktgjykimi, Prokurori kundër Tihomir Baskic, Tribunali Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavi, (3 mars 2000), Par.782, citohet IT-95-17/1-T, Prokurori kundër Anto Furundija, Aktgjykimi, (10 dhjetor 1998) par. 284.

¹⁵³ Rasti Nr.IT-95-8-S, Aktgjykimi për caktimin e dënimit, Prokurori kundër Dusko Sikirica, Damir Dosen, Dragan Kolundzija, Tribunali Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavi, (13 nëntor 2001), par. 229.

Nevoja

Kur të pandehurit kanë vepruar në rrethana të nevojës së qartë dhe të dëshpëruar, kjo çon peshë për disa gjyqtar si rrethanë lehtësuese. Ka pasur shumë raste të përdorimit të pasaportave apo dokumenteve tjera të identitetit të falsifikuara, dhe në disa prej këtyre rasteve, gjyqtarët janë prekur nga rrëfimet e të pandehurve për vështirësitë e skajshme të tyre.

Varësia nga droga apo alkooli

Në rastet kur vepra është kryer për të siguruar mjetet për të financuar varësinë nga droga, kjo mund të trajtohet si rrethanë lehtësuese apo rënduese, varësisht nëse gjyqtari e sheh këtë si manifestim të fajësisë së zvogëluar apo të rritur.

Punësimi

Në disa raste, puna stabile e të pandehurit apo përfshirja në studime ose trajnim profesional mund të jetë rrethanë lehtësuese. E kaluara e mirë në punë mund të ketë shumë ndikim në veprat më pak të rënda për shkak të shkatërrimit të perspektivëekonomike afatgjate të të pandehurit nëse dërgohet në burg për një periudhë të shkurtër kohore.

Në përgjithësi, punësimi nga kryerësi tregon një formë përgjegjësie dhe lë të kuptohet se ai është person i organizuar për dallim nga shumica e atyre që paraqiten para gjykatës dhe ka më pak gjasë që sërish të kryejnë vepër.

Në të kundërtën, disa gjykata mund ta konsiderojnë këtë rrethanë të parëndësishme. Gjykata mund të argumentojë, veçanërisht kur ka shkallë të mjaftueshme të fajësisë, se kryerësi ka qenë plotësisht i vetëdijshëm për dënimin e mundshëm që mund të rezultojë nga kryerja e veprës, përfshirë humbjen e vendit të punës, dhe prapëseprapë ka vendosur që t'i shpërfill pasojat. Një argument shtesë mund të jetë se marrja parasysh e punësimit në raste të rënda në fakt i penalizon ata të cilët janë të papunë – ndoshta pa fajin e tyre përshkak të rrethanave të vështira ekonomike.

Së fundi, me rritjen e seriozitetit të veprës gjykatat duhet t'i japin më pak vlerë kësaj rrethane. Kjo vlen posaçërisht për krimet e dhunshme.

Gjendja personale dhe familjare

Në përgjithësi, gjykatat rregullisht e kanë marrë parasysh “gjendjen familjare” të të akuzuarit dhe ndikimin që burgimi do ta kishte në të tjerët. Në veçanti, fëmijët e vegjël apo të shumtë të të akuzuarit shpesh janë konsideruar si rrethanë lehtësuese, ashtu siç është konsideruar edhe të qenit prind i vetëm ku burgimi do ta çonte fëmijën në përkujdesje të ndonjë të afërmi tjetër. Konsideratat specifike mund të përfshijnë rrethanat në vijim:

- Numrin e fëmijët.
- Moshën e fëmijëve.
- Nëse kryerësi është mbajtësi i vetëm i familjes.
- Nëse kryerësi kujdeset për të tjerët.
- Nëse kryerësi është prind i vetëm.
- Shëndeti i individëve tjerë.
- Të gjitha rrethanat tjera jetësore të kryerësit të cilat mund të ndikojnë në dënim.

Nëse gjykata vendos për të marrë parasysh rrethanat familjare në zbutje, atëherë përqendrimi duhet të jetë në ndikimin specifik që ndarja do të kishte në familje. Në praktikë, përdorimi i saj duhet të kufizohet vetëm në ato rrethana të cilat prekin familjen në mënyrë të konsiderueshme për shkak të rrethanave të caktuara. Për shembull, nëse fëmijët kanë mbështetje të kufizuar nga të tjerët në rast se kryerësi dërgohet në burgim. Zbutja dekurajohet bazuar në shkakun e vetëm të ekzistimit të familjes.

Një arsye tjetër përse gjykatat duhet që në parim t'i marrin në konsideratë 'shqetësimet familjare' si rrethanë lehtësuese është parimi i drejtësisë restorative ku gjendja personale dhe familjare e të pandehurit mund të shpie gjyqtarët që të besojnë në gjasat e të akuzuarit për rehabilitim. Në parim kujdesi i të pandehurit për familjen e tij tregon disa tipare pozitive personale të cilat mund ta parandalojnë nga kryerja e veprave tjera. Dikushqë kujdeset për vartës të ndjeshëm mund të thuhet se po bën punë për komunitetin, dhe kjo duhet të merret parasysh gjatë caktimit të dënimit për personin e tillë, pasi që 'ne të gjithë u kemi borxh atyre që kujdesen për të tjerët'.

Është jashtëzakonisht e rëndësishme që gjykata ta shqyrtojë rolin e të gjithë anëtarëve të familjes në vepër. Nëse ndonjë anëtar i familjes është viktimë e veprës së kryerësit, atëherë **NUK** duhet të ketë zbutje për rrethanat familjare të cilat kanë të bëjnë me viktimën apo të cilat vënë anëtarët tjerë të familjes në rrezik. Për shembull, nëse kryerësi ka kryer veprë penale seksuale kundër fëmijës, atij nuk duhet zbutur dënimin sepse duhet të kujdeset për fëmijën, e as për faktin se duhet të kujdeset për fëmijët tjerë në shtëpi.

Së fundi, çdo zbutje bazuar në rrethanat familjare duhet t'i nënshtrohet një vlerësimi të kujdesshëm të të gjitha rrethanave të kryerësit dhe një vlerësimi të kujdesshëm nëse zbutja është përfitim apo rrezik. Gjykata nuk duhet të merr parasysh vetëm, për shembull, nëse ka fëmijë të vegjël, por nëse kryerësi është duke u kujdesur për mirëqenien e tyre dhe nëse është duke ndihmuar në rritjen e tyre? Nëse ka të afërm tjerë të sëmurë në shtëpi, a është duke u kujdesur kryerësi për ta në ndonjë mënyrë domethënëse dhe produktive? Nëse kryerësi ka kryer veprë të dhunshme, a ka rrezik për lëndimin e anëtarëve të familjes nëse kryen veprë sërish?

Situatat tjera

- Niveli i shkollimit
- Papunësia
- Shëndeti i kryerësit

Dyfishimi dhe kujdesi

Mund të ketë dyfishim nëse merret parasysh shëndeti i kryerësi kur ka probleme mendoretë cilat kontribuojnë në aftësinë e zvogëluar mendore.

Pyetjet relevante përfshijnë:

- Sa serioze është vepra dhe cilat janë lëndimet nëse ka të tilla?
- A është kryerësi i punësuar? Cila është natyra dhe lloji i punësimit?
- A ka anëtarë të familjes të cilët varen nga ai? Nëse po, çfarë janë moshat e tyre?
- Cili është niveli i varësisë së anëtarëve të familjes nga kryerësi?
- A është ndonjë anëtar i familjes i përfshirë si viktimë?

6.5 Dëshmia që personi i dënuar ka luajtur rol relativisht të vogël në kryerjen e veprës penale; fakti që personi i dënuar ka marrë pjesë në veprën penale jo si kryes kryesor por përmes ndihmës, inkurajimit ose duke ndihmuar tjetrin në ndonjë mënyrë tjetër¹⁵⁴

Që të dy rrethanat lehtësuese në 3.4 dhe 3.5 përqendrohen në rolin e kryerësit dhe fajësinë e tyre në vetë veprën penale. Në shumë aspekte, kjo rrethanë është e kundërta e rrethanës rënduese 2.1. Rrethana 3.4 është e ngjashme për kah natyra me rrethanën 3.5, mirëpo fokusi i 3.4 është më tepër në pjesëmarrjen në veprën penale, e jo në ofrimin e ndihmës në kryerjen e veprës penale. Një shembull i 3.4 do të ishte veprimi i bërjes roje gjatë kryerjes së një grabitjeje. Derisa dënimi i paraparë dhe akuza është e njëjtë, rrethana epërcakton që bërja e rojës është nivel më i ulët i fajësisë dhe meriton dënim më të ulët.

Rrethana 3.5 është adresuar edhe në nenin 33 i cili e përshkruan ndihmën në kryerjen e veprës penale. Ky nen në mënyrë specifike parasheh dënim më të butë kur një individ, për shembull i vë në dispozicion mjetet për kryerjen e veprave, i krijon kushtet apo i mënjanon pengesat për kryerjen e veprës ose bënë përgatitje paraprake për fshehjen e provave të kryerjes së veprës, kryerësin apo identitetin e kryerësit, mjetet e përdorura për kryerjen e veprës penale apo përfitimin që rrjedh nga kryerja e veprës penale. Kriteret e nenit 33 për dënim më të butë për ata që japin ndihmë, përmbushet duke e përdorur rrethanën 3.5 dhe duke shqiptuar dënim më të butë se për ata që marrin pjesë mëformalisht. Në nenin 33 nuk ka kërkesë për zvogëlim më të madh në nivel të veprës përmes zbutjes së dënimit përveç nëse kjo është e duhur.

Është e rëndësishme që gjykata ta mbajë në mend që konstatimi i rrethanës rënduese nga pika

¹⁵⁴ Kodi Penal, neni 74, par 3.4 dhe 3.5

2.1, që kryerësi ka pasur shkallë të lartë të pjesëmarrjes, nuk kërkon që kryerësit tjerë të kanë shkallë të ulët të pjesëmarrjes sipas 3.4. apo ndihmës sipas 3.5. Njashtu, as konstatimi që kryerësi ka qenë kryerës i nivelit të mesëm nuk nënkupton që njeri apo kryerësit tjerë kanë qenë pjesëmarrës të nivelit të ulët.

Për sa i përket rolit të ulët, çdo përfundim që pjesëmarrësi ka pasur rol të ulët do të nënkuptoj konstatim nga gjykata që i pandehuri ka kontribuar minimalisht në kryerjen e krimit, së pari për sa i përket plotësisimit të elementeve të veprës penale, dhe së dyti në krahasim me kryerësit tjerë. Nëse kontributi i kryerësit do të mund të hiqej me ndikim minimal në kryerjen e krimit, gjykata mund të konkludoj me një nivel të sigurisë që rrethana 3.4 ka qenë e pranishme.

Rrethana 3.5 kërkon që gjykata ta vlerësoj jo vetëm nivelin e pjesëmarrjes ndërmjet kryerësit dhe pjesëmarrësve tjerë, por do të kërkoj edhe një vlerësim të afërsisë së kryerësit dhe sa i drejtpërdrejtë ka qenë kontributi i tij në kryerjen e veprës penale. Ka më shumë gjasa që gjykata ta konstatoj ekzistimin e pikës 3.5 kur kryerësi nuk është i pranishëm në vendin e ngjarjes. Një tregues tjetër do të jetë periudha kohore e kontributit të kryerësit. Nëse kontributi i kryerësit ka qenë afër kohës së kryerjes përfundimtare të veprës penale atëherë kryerësi ka gjasa që të konsiderohet si pjesëmarrës ndihmës.

Dyfishimi dhe kujdesi

Nuk duhet të ketë brenga rreth dyfishimit përveç ndërmjet rrethanës 3.4 dhe 3.5. Gjukata nuk duhet ta konstatoj praninë e të dy rrethanave në të njëjtën kohë. Siç është përmendur më herët, rrethana 3.4 duhet të kufizohet vetëm në ato situata ku kryerësi është fizikisht i pranishëm dhe merr pjesë në vetë kryerjen e veprës penale por në rol më të vogël. Ndryshe nga rrethana 3.5 ku kontributi ka ndodhur para apo pas dhe ka ngjarë në rol mbështetës apo planifikues. Presioni dhe ngurrimi i kryerësit për kryerjen e veprës penale nuk duhet vlerësuar në kuadër të rrethanës 3.4 apo 3.5 pasi që ajo është mbuluar në mënyrë më të duhur në rrethanën 3.1.

Pyetjet relevante përfshijnë:

- A ka pasur kryerësi ndonjë shkathtësi apo specializim të nevojshëm përplanifikimin apo kryerjen e veprës penale?
- A e ka planifikuar apo a ka kontribuar kryerësi me informatat apo materialet e nevojshme për kryerjen e veprës penale?
- A ka qenë kontributi i kryerësit në aspektin kohor i largët nga kryerja e vetë veprës penale (para ose pas)?
- A ka pasur një kryerës që ka kontribuar kryesisht apo ka dominuar në kryerjen e veprës penale?
- A ka qenë kryerësi fizikisht i pranishëm në vendin e ngjarjes?
- A do të kishte mundur të ndodhte krimi pa kontributin e kryerësit? A ka qenë kontributi shumë i rëndësishëm për suksesin e veprës penale?
- A mund të izolohen dhe llogariten veprimet e kryerësit në krahasim me ato të kryerësve tjerë?

6.6.Mosha e personit të dënuar, i ri apo i moshuar¹⁵⁵

Mosha është ndër ‘rrethanat personale’ klasike që duhet marr para sysh në përcaktimin e dënimit për kryerësin. Në përgjithësi, janë dy rrethana kryesore që duhet të konsiderohen si rrethana lehtësuese: **mosha e re e** kryerësit dhe **mosha e vjetër** e kryerësit.

Derisa që të dyja janë të ndërlidhura me moshën, ato dallojnë për sa i përket logjikës së zbutjes. Përkryerësit e rinj, zbutja zakonisht i atribuohet papjekurisë së kryerësit. Këtu kryerësi, deri në një masë ka qenë shumë i ri apo i zhvilluar në mënyrë joadekuate për ta kuptuar si duhet natyrën e sjelljes së vet. Andaj, dënimi duhet zvogëluar. Për sa i përket të moshuarve, koncepti është që shëndeti i kryerësit mund të vihet në rrezik apo kohëzgjatja e dënimit mund të jetë e tillë që lë pak gjasa që kryerësi të kthehet në shoqëri.

Të dy situatat e kanë logjikën e njëjtë për sa i përket aftësisë së kryerësit për ta duruar dënimin. Një arsytim shtesë që shpesh përmendet për marrjen në konsideratë të moshës në zbutje të dënimit është koncepti që për të rinjtë dhe të moshuarit, dënimi mund të ketë ndikim të jashtëzakonshëm në kryerësin e caktuar. Këtu dënimi brenda një kufiri “normal” mund të jetë veçanërisht i vështirë për t’u duruar. Në këto situata, brenga është që dënimet duhet të kenë për afërsisht të njëjtin ndikim mbi të gjithë kryerësit dhe kur kryerësi bie në këtë kategori atëherë shkelet ky parim.

Vështirësia me të dy këto rrethana është që nuk ka përkufizim të qartë të asaj që përbën tëri apo të moshuar si rrethanë lehtësuese. Andaj gjykata duhet t’iu qaset zbatimit të kësaj rrethane me kujdes të madh dhe fokus në zbatimin uniform të saj. Në të dy situatat, fundi ekstrem i këtyre kufijve është më pak i vështirë për t’u trajtuar dhe është më pak kontroverse nëse thjeshtë shikohet mosha dhe përcaktohet që duhet të zbatohet zbutja. Kur mosha bëhet më kontroverse, gjykatës do t’i duhet që gjithnjë e më shumë të mbështetet në vlerësimin e arsytimit për zbutje në rend të parë. Për shembull, për ta vlerësuar si duhet rrethanën e ‘moshës së re’ i zbaton elementet si personaliteti i brishtë, pa përvojë, i papjekur apo naiv duhet të merren para sysh; ngjashëm me këtë, rrethana e ‘moshës së vjetër’ duhet të vlerësohet në lidhje me shëndetin, pafuqinë, sëmundjen e kështu me radhë.

Disa nga vështirësitë në zbatimin e kësaj rrethane mund të shihen në praktikën e Tribunalit të Hagës, në adresimin e aspektit të qenit ‘i ri’. Në përgjithësi, dhomat e gjyimit, mesatarisht, e kanë konsideruar që “i ri” është ndërmjet moshës 13 dhe 23 vjeçare në kohën e kryerjes së veprës penale. Derisa kjo mesatare mund të konsiderohet si kufiri i lartë e asaj që mund të konsiderohet i ri apo e re, nuk është vështirë që të pajtohemi me përdorimin e kësaj.

Mirëpo ka pasur raste kur Gjykata ka shkuar aq larg sae ka zbatuar zbutjen e dënimit për dikë që është mbi atë moshë. Andaj, përcaktimi i moshës së “re” varet nga lloji i veprës penale të kryer dhe sa pritët që një kryerës ‘i ri’ ta kuptoj peshën e veprimeve të tij apo aftësinë për t’a

¹⁵⁵ Kodi Penal, neni 74, par 3.6

duruar presionin ekstrem nga një person më i lartë. Me rritjen e moshës, gjykatës do t'i duhet të ofrojë gjithnjë e më shumë arsyetim për paaftësinë e kryerësit për të kuptuar natyrën e veprimeve të tij, që do të mund ta arsyetonte aftësinë e zvogëluar mendore.

Kur të merret para sysh zbatimi i rrethanës së moshës 'së vjetër', nuk duhet të merret në konsideratë aftësia e kryerësit për t'i kuptuar veprimet e tyre apo natyrën e tyre, p.sh. pleqëria apo aftësia e kufizuar. Nëse ka brenga rreth të kuptuarit, kjo trajtohet në mënyrë më adekuate tek rrethana e aftësisë së zvogëluar. Për ta aplikuar këtë rrethanë, gjykata duhet të vlerësoj gjendjen e përgjithshme shëndetësore të kryerësit dhe aftësinë për ta vuajtur dënimin në mënyrë adekuate. Teoria tradicionale tek ky zvogëlim është që për shkak të moshës së shtyer të kryerësit, dënimi do të ketë efekt joproporcionalisht të rëndë në krahasim me një kryerës më të ri i cili e ka pranuar dënimin e njëjtë. Gjykata gjithsesi se mund ta heq këtë rrethanë nëse ekzistojnë prova që kjo gjendje është shfrytëzuar nga kryerësi për ta kryer veprën penale. Në rastin Pllavshiq, mosha e shtyrë e të akuzuarit është marr para sysh për dy arsye: E para, lodhja fizike që është asocuar me vitet e shtyra e bënë vuajtjen e të njëjtit dënim më të vështirë për një të akuzuar të moshuar se sa përnjë të ri. E dyta, kryerësit të moshës së shtyrë mund t'i ketë mbetur pak jetë cilësore përta jetuar pas lirimimit.”¹⁵⁶

Ndryshe nga rasti Pllavshiq, Tribunali i Hagës ka pasur qasje shumë interesante në rastin Simiq, duke vendosur nëse gjendja mjekësore ka ndikim në dënim, ka dhënë arsyetim shumë të gjerë për atë se përse një gjendje e tillë jodomsdoshmërisht konsiderohet si rrethanë lehtësuese. Në këtë rast, mbrojtja kishte paraqitur raport mjekësor ku theksohej që gjendja e z. Simiq do të kërkonte kujdes të plotë mjekësor për tërë pjesën e mbetur të jetës së tij; që ai do të kërkonte edhe ndihmë ditore për higjienën personale, përgatitjen e ushqimit, lëvizjen e karrocës së tij dhe bartjen e tij nga shtrati në karrocën e tij”. Përkundër raportit mjekësor të paraqitur, duke e marr para sysh peshën e veprës së kryer nga kryerësi, dhoma gjyquese ka vlerësuar që “... në raportin mjekësor (prova materiale a) nuk tregohet masa deri në cilën jetëgjatësia e Milan Simiqit do të ndikohej nga të qeniti burgosur. Sipas mendimit të dhomës gjyquese, gjendja mjekësore që në një të ardhme mund të ndikoj në jetëgjatësinë e tij, nuk shpie automatikisht në zvogëlimin e dënimit.” Ishte mendim i Dhomës që vetëm në rrethana përjashtuese apo raste të “të rralla” shëndetit sëmurë mund të konsiderohet si rrethanë lehtësuese.

Përveç kësaj, ndonëse dhoma gjyquese ishte e vetëdijshme që vendi i mbajtjes nuk do të mund t'i plotësonte nevojat e z. Simiq, kjo nuk kishte ndikuar në vendimin për burgim. Dhoma e kishte nxjerr vendimin dhe kishte konsideruar:

“të nevojshme që të theksoj se burgu në të cilin do të caktohet Milan Simiq, për aq sa është e mundshme, duhet të jetë në gjendje për t'i akomoduar nevojat e tij mjekësore

Ndonëse ishte e ndjeshme ndaj komplikimeve mjekësore që Milan Simiq i kishte pasur, dhe gjendjen e tij aktuale mjekësore, Dhoma Gjyquese nuk u bind që problemet mjekësore janë të

¹⁵⁶ Rasti nr. IT-00-39&40/1-S, Aktgjykimi gjyques, Prokurori kundër Biljana Plavsic, Tribunali Ndërkombëtar për Ish Jugosllavi, (27 shkurt 2003) par. 95-106.

pranishme deri në atë masë sa për ta arsyetuar zvogëlimin e dënimit. Gjendja mjekësore e Milan Simiqit nuk duhet të merret para sysh si rrethanë lehtësuesenë përcaktimin e dënimit.”

Dyfishimi dhe Kujdesi

Siç është diskutuar më parë, kjo rrethanë mund të ketë dyfishim të konsiderueshëm me aftësinë e zvogëluar, në veçanti kur të zbatohet kjo rrethanë në kontekst të paaftësisë për t'i kuptuar pasojat.

Pyetjet relevante përfshijnë:

- A ka qenë kryerësi nën moshën 18 vjeçare apo përmbi moshën 65 vjeçare?
- A ka pasur kryerësi moshë të mjaftueshme për ta kuptuar natyrën e veprimeve të tij?
- A ka fakte apo prova që tregojnë se kryerësi në fakt i ka kuptuar veprimet e tij përkundër moshës së tij?
- A ka prova që kryerësi i ka adresuar apo me vetëdije i ka shpërfillur rezultatet e mundshme negative të veprimeve të tij?
- A është duke vuajtur kryerësi nga ndonjë sëmundje akute? A do ta mbijetojë kryerësi dënimin e menduar?
- A ka ndonjë sëmundje mendore që kontribuon në paaftësinë për t'i menduar veprimet e kryerësit?
- A e ka shfrytëzuar kryerësi me vetëdije këtë rrethanë për kryerjen e veprës penale?
- A janë diagnostikuar nga autoritetet mjekësore sëmundjet përkatëse për taplotësuar këtë zbutje?
- A ka ekzistuar kjo sëmundje pra kryerjes së veprës penale?

6.7.Rrethanat që tregojnë pendim dhe bashkëpunim nga kryerësi¹⁵⁷

Rrethanat 3.7 deri 3.12 janë grupuar së bashku për ta paralajmëruar gjykatën për mundësinë e fortë të dyfishimit ndërmjet rrethanave. Nëse nuk qaset me konsideratë të kujdesshme dhe me maturi, ekziston gjasë e fuqishme që kryerësi të pranojë një masë të zbutjes më të butë se që ka të drejtë.

Që të gjashtë këto rrethana hyjnë në konceptin e drejtësisë rehabilituese. Pra që i pandehuri ta ketë pranuar deri në një masë që ka bërë diçka të keqe, e ka pranuar përgjegjësinë, dhe është i gatshëm që t'a korrigjoj atë. Duke theksuar këtë, përqendrimi i gjykatës duhet të jetë në riintegrimin e kryerësit në shoqëri në vend të largimit të tij me qëllim të mbrojtjes së shoqërisë. Pasi që secila nga këto rrethana mund të luaj rol të rëndësishëm në përcaktimin e dënimit të përgjithshëm, duke u konsideruar tregues të fuqishëm të mundësisë së rehabilitimit, Gjykata nuk duhet të lejoj që faktet që vlejné për një rrethanë ta mbështesin edhe një tjetër.

¹⁵⁷ Kodi Penal, neni 74, par 3.7-3.12

Asnjë fushë tjetër nuk është më e ngatërruar dhe me mundësi dyfishimi se sa koncepti i pendimit. Secili faktor në këtë pjesë mund ta mbështesë konstatimin e pendimit dhe t'i rrisë mundësitë e rehabilitimit të kryerësit. Dëmshpërblimi i viktimës mund të konsiderohet tregues i pendimit. Bashkëpunimi me gjykatën mund të konsiderohet pranimit i përgjegjësive dhe pendim. Bërja e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë mund të konsiderohet pranimit i përgjegjësive dhe pendim. Në skemat e caktimit të dënimit dhe ndoshta edhe historikisht asnjë rrethanë tjetër nuk është më e rëndësishme për zbutjen se sa koncepti i pendimit. Ka ndikim emocional mbi gjyqtarët, prokurorët bile edhe viktimat për ta zvogëluar gjykimin e tyre dhe kërkesat e tyre për burgim. Për shkak të potencialit të një ndikimi të tillë të dukshëm, për t'u siguruar përfundimisht që dënimet të jenë të njëtrajtshme për të gjithë kryerësit, dhe për t'u siguruar që zbutja të mos fryhet në mënyrë të duhur, është absolutisht imperativë që Gjykata ta interpretoj kuptimin e rrethanave 3.7-3.12 në mënyrë të ngushtë dhe të mos lejoj zbatim të përgjithshëm.

6.7.1. Dëshmia që personi i dënuar ka bërë restituimin apo kompensimin eviktivës¹⁵⁸

Koncepti i kësaj rrethanë është që është e dobishme që viktimat të jetë dëmshpërblyer, se paku financiarisht, në një gjendje të përafërt me atë para kryerjes së veprës penale. Përveçkësaj, duhet të shikohet që veprimet të konsiderohet meritore për sa i përket kontributit për qëllimet e drejtësisë penale pasi që do ta aktivizoj legjislacionin shtetëror për ofrimin e kompensimit për viktimën. Kjo është veçanërisht e duhur në rast se dëmshpërblimi ndodh pa u nxitur nga gjykata.

Mirëpo, nëse gjykata e zbaton kompensimin e viktimës në këtë rrethanë, nuk mund ta zbatojë atë edhe për dëshmitë për pendim. Jo vetëm që ekzistojnë brenga që zbutja do të llogaritet dy herë, mirëpo ekzistojnë brenga që kryerësi është duke e përpjekur që të përfitoj nga zbritja pa u angazhuar me të vërtetë në atë akt e jo për shkak se është “gjëja e duhur” për ta bërë. Një fushë tjetër brengosëse është nëse kjo rrethanë përqendrohet në mundësinë për të paguar, andaj, a është e duhur që të shpërblehet me zbutje thjeshtë një palë e caktuar për shkak se ka mundësi që të paguaj? Kjo brengë është më e dukshme kur kemi të bashkëpandehur, që të dy e kanë dëshirën për të paguar mirëpo, vetëm njëri e ka mundësinë. Në atë situatë, Gjykata duhet ta shqyrtoj nëse në fakt është duke e penalizuar kryerësin i cili nuk ka para dhe duke e shpërblyer atë që ka. Kjo nuk nënkupton që ky koncept nuk ka merita, në veçanti kur varet nga mundësia e shtetit për të dhënë kompensim në rast se i pandehuri nuk ka mundësi. Fakti që në një rast të caktuar viktimat ka mundësi që t'i paguaj faturat e mjekimit apo pagat e humbura është definitivisht një përfitim. Kjo thjeshtë nënkupton që gjatë përcaktimit nëse do ta zbusë dënimin dhe në çfarë niveli, Gjykata duhet t'i vlerësoj të gjitha rrethanat. Gjykata, në veçanti duhet ta marr para sysh mundësinë e kryerësit për të paguar në proporcion me shumën e paguar.

¹⁵⁸ Kodi Penal, neni 74, par 3.7

Pyetjet relevante përfshijnë:

- A është bërë dëmshpërblimi para arrestit apo intervenimit formal nga policia?
- A ka qenë në dijeni kryerësi se sa i fortë është rasti kundër tij në kohën kur e kabërë dëmshpërblimin?
- A është bërë dëmshpërblimi si rezultat i ndonjë marrëveshjeje me viktimën nëlidhje me ndërmarrjen/mbështetjen e ndjekjes së rastit?
- A ka qenë mundësia e kryerësit për të paguar proporcionale me shumën e paguar? A ka pasur të bashkëpandehur me mundësi të ndryshme për të paguar?
- A është kthyer në gjendjen e mëparshme viktimë si rezultat i dëmshpërblimit?
- A është konsideruar nga dëmshpërblimi që kryerësi është penduar për veprimet e tij? A është shqyrtuar dëmshpërblimi në mbështetje të ndonjë rrethane tjetërlehtësuese?
- A është bërë kompensimi/dëmshpërblimi në ndonjë formë tjetër jomonetare?

5.7.2 Bashkëpunimi i përgjithshëm i personit të dënuar me gjykatën, përfshirë dorëzimin vullnetar¹⁵⁹

Rrethana 3.8 përqendrohet në sjelljen e kryerësit pas kryerjes së veprës penale; në veçantinë ndërveprimin ndërmjet kryerësit dhe gjykatës. Kjo pashmangshëm do të përqendrohet në sjelljen e kryerësit gjatë procesit gjyqësor dhe përfundimisht do të bazohet në perceptimin e Gjykatës. Kjo nuk është dhe nuk duhet të konsiderohet pjesë e bashkëpunimit me prokurorinë e cila është e rezervuar në mënyrë specifike për rrethanën 3.9.

Dorëzimi vullnetar i të akuzuarit mund të ketë implikime për procesin e caktimit të dënimit dhe aftësinë e gjykatës për ta përmyllur procesin andaj edhe është konsideruar sirrethanë në zbutjen e dënimit. Gjykatat gjithashtu supozojnë që dorëzimi paraqitja vullnetare në proces ka implikime më të mëdha dhe mund t'i frymëzoj edhe kryerësit tjerë që të veprojnë në të njëjtën mënyrë, duke e përmirësuar kështu efektshmërinë e përgjithshme të punës së gjykatave. Mirëpo, dorëzimi vullnetar e zbehet **substancialisht** kur procedurat janë të natyrës familjare.

Mirëpo, kjo rrethanë ka pasur rëndësi primare në shqiptimin e dënimeve në tribunalet ndërkombëtare për shkak të natyrës së qenësishme të procedurave. Duke qenë se suksesi i tyre varet shumë në bashkëpunimin ndërshtetëror, që mund të jetë problematik edhe në skenarët më të mirë, Gjykatat i kanë shpërblyer me zbutje kryerësit të cilët vullnetarisht i janë dorëzuar kompetencës së Gjykatës. Në rastin Erdemović, bashkëpunimi i të akuzuarit, dorëzimi i tij vullnetar dhe pranimi i fajësisë ishin konsideruar rrethana lehtësuese: “ ... *Prokurori ka theksuar që nuk ka gjetur papajtueshmëri në informatat që ai ua kishte dhënë atyre; hetimet e tyre i kanë konfirmuar shumicën e gjërave që ai ua kishte thënë, duke treguar që i akuzuari është me vullnet të sinqertë.*

Kjo mbështetet nga pranimi i tij dhe pranimi përputhshëm i fajit, në veçanti nga fakti që ai ka ardhë vullnetarisht dhe ka rrëfyer për rolin e tij në masakra para se përfshirja e tij t'i bëhet e ditur cilitdo autoritet hetimor.”¹⁶⁰

Pavarësisht se a varet procedura nga tribunalet vendore apo ndërkombëtare, çështjakryesore për gjykatën duhet të jetë nëse është e duhur që ta shqyrtoj këtë si rrethanë apo jo. Shpërblimi me zbutje për bashkëpunim me gjykatën në esencë është sjellje shpërblyese që duhet të pritet nga i pandehuri. Një qasje më e duhur do të ishte që të rezervohet zbutja për aktivitete që shkojnë përtej sjelljes që është e pritshme apo e duhur në përgjithësi. Në vend të kësaj, shumë tribunalet e kanë refuzuar shpërblimin e zbutjes për sjellje, dhe kanë zgjedhur që ta dënojnë sjelljen e keqe me ashpërsim të dënimit. Shembujt përfshijnë sjelljen që është përçarëse dhe që është në skaj të vetëdijes për peshën e veprës penale, kërcënimin apo frikësimin e dëshmitarit, dhe mungesën e përgjithshme të respektit për solemnitetin e procesit gjyqësor.

¹⁵⁹ Kodi Penal, neni 74, par 3.263

¹⁶⁰ Rasti nr. IT-96-22-Tbis, Aktgjykimi Dënues, Prokurori kundër Drazen Erdemovic, Tribunali Ndërkombëtar Penal për Ish Jugosllavi, (5 mars 1998), par.16.i.

Pyetjet relevante përfshijnë:

- A është bërë dorëzimi pranë tribunalit apo pranë prokurorisë?
- A është bërë dorëzimi për shkak të përgatitjes së ndonjë intervenimi të policisë?
- A është dorëzuar kryerësi nga një lokacion ndërkombëtar apo vendor?
- A është kjo sjellje përgjithësisht e pritshme nga Gjykata për kryerësin? A ka qenë thjeshtë mungesë e sjelljes së keqe nga kryerësi?
- A ka qenë dorëzimi apo bashkëpunimi i rëndësishëm në thelb për zgjidhjen erastit nga Gjykata? A ka kontribuar në mbylljen e çështjes?

Bashkëpunim vullnetar të personit të personit të dënuar në hetimin ose ndjekjen penale¹⁶¹

Bashkëpunimi mund të merr forma të ndryshme nga lehtësimi i paraqitjes së rastit nga prokurori, dhënia e dëshmisë dhe dhënia e provave për rastet tjera, zbulimi i informatave të reja apo verifikimi i informatave të njohura, si dhe kontributi në identifikimin e kryerësve tjerë të veprave penale. Kjo mund të jetë edhe bashkëpunimi me policinë gjatë fazës së hetimeve.

Është shumë me rëndësi që Gjykata ta mbajë këtë rrethanë të ndarë dhe ta dalloj atë nga marrëveshja mbi pranimin e fajësisë apo bashkëpunimit formal. Aty ku ekziston strukturë formale, ajo në mënyrë të qartë i përvijon kushtet e zbutjes, kufizimet e saj dhe pritjet e prokurorisë. Gjykata duhet të supozojë, përderisa nuk sugjerohet ndryshe nga prokurori, që bashkëpunimi i plotë në të gjitha nivelet e çështjes para gjykatës është llogaritur në marrëveshje. Gjykata nuk duhet ta përdor këtë faktor për reduktim të mëtutjeshëm të një dënimi të dakorduar pasi që zvogëlimi i saj do t'i minojë marrëveshjet në të ardhmen dhe do të rezultojë në llogaritje të dyfishtë të bashkëpunimit.

Vlerësimi i bashkëpunimit të kryerësit varet si nga sasia ashtu edhe cilësia e informatës që ata e japin. Ai gjithashtu varet edhe në spontanitetin dhe vetëmohimin në bashkëpunim. Gjykata duhet ta vlerësoj nëse informata është ndarë pa pritjen e diçkaje si kthim dhe vullnetarisht, apo vetëm pa dëshirë në bazë të një veprimi të pashmangshëm të suksesit të policisë apo prokurorisë. Gjykata do të mund ta përdorte autoritetin e saj për të mësuar nga prokurori apo policia nivelin e rëndësisë apo përfitimit që nxjerrët nga bashkëpunimi me kryerësin.

Nëse gjykata e përcakton që bashkëpunimi ka qenë substancial, kjo rrethanë në përgjithësi konsiderohet si e rëndësishme për zbutje pasi që e ndihmon një gjykimekspeditiv. Në anën tjetër, kur gjyqtarët e përcaktojnë që bashkëpunimi është bërë me ngurrim, ishte sporadik apo i ndërlikur me ndonjë faktor të jashtëm, zbutja do të jetë më e vogël.

¹⁶¹ Kodi Penal, neni 74, par 3.

Pyetjet relevante përfshijnë:

- A ekziston marrëveshje formale mbi pranimin e fajësisë apo bashkëpunimin? Nëse po, a janë cekur kushtet zbutjes në mënyrë të qartë?
- Nëse ekziston marrëveshja, a ka siguruar kryerësi informata më shumë se ato që janë paraparë brenda marrëveshjes?
- A janë dhënë informatat në pritje të zvogëlimit të dënimit?
- A ka ofruar kryerësi bashkëpunim që është substancialisht i rëndësishëm për çështjen? Zgjidhjen e të njëjtës?
- A e ka pranuar kryerësi kryerjen e veprës penale?
- A ka dhënë kryerësi dëshmi inkriminuese kundër ndonjë kryerësi tjetër gjatë hetimit dhe/apo gjykimit?
- A kanë janë gjetur provat në mbështetje të dënimit si rezultat i bashkëpunimit të kryerësit?

6.7.4 Pranimi i fajit¹⁶²

Pranimi i fajit ka qenë për një kohë të gjatë burim i zbutjes së dënimit për shumë arsye. Disa argumentojnë duke e theksuar pranimin nga ana e kryerësit të veprimeve të tij, gatishmërinë për t'u rehabilituar dhe integruar, gatishmërinë për t'u dënuar për krimet e tyre, dhe një shenjë e pendimit ndaj viktimës dhe shoqërisë. Mirëpo, zbatimi kuturu i kësaj rrethane shpie në rrethana të llogaritura dy herë në zbutjen dhe tej-vlerësimin e zbritjes përfundimtare. Praktika aktuale në Kosovë e mbështetë fuqishëm atë kur është e pranishme, kjo rrethanë është joproporcionalisht e rëndësishme në krahasim me rrethanat tjera – që tregon edhe për llogaritjen e dyfishtë dhe mbivendosjen. Për më tepër, ka pak dëshmi për të sugjeruar që zbatimi i gjerë i pranimit të fajit në rrethanat tjera është i arsyeshëm. Duke e pasur para sysh që secila rrethanë që mund ta mbështetë pranimi i fajësisë mund të vlerësohet në mënyrë të pavarur, dhe pranimit të fajësisë i jepet favoriti i vet diskret, Gjykata duhet të përqendrojë vlerësimin e saj vetëm në faktin që i pandehuri eka pranuar fajin. Nuk duhet të lëshohet në pranimin e fajësisë si mbështetje për pendimin, bashkëpunimin apo ndonjë rrethanë tjetër.

Janë disa përfitime që burojnë në mënyrë të qenësishme nga pranimi i fajit që e formojnë bazën për zbutje. Arsyeja kryesore ndërlidhet me përfitimet e shoqërisë që dalin nga shmangia e gjykimit. Pranimi i fajësisë i parandalon shpenzimet që ndërlidhen me dhënien e dëshmisë nga dëshmitarët, sigurimin e pranisë së të pandehurve nga policia, ofrimin e sigurisë për procesin, ndoshta edhe koston e përkthimit, dhe përqendrimin e disa gjyqtarëve në një rast në dëm të shumë rasteve tjera.

Ka edhe kursime psikologjike pasi që viktimat nuk kalojnë nëpër stresin e madh mendor e të qenit të pranishme dhe dhënies së dëshmisë në gjykim. Dhe vetë sistemi mund t'ia përqendroj kohën dhe vëmendje e tij rasteve që janë ndoshta më të vlefshme për burimet e kufizuara financiare të shoqërisë, Përfundimisht, deri në një masë të kufizuar, zbutja e dënimit për ata që

¹⁶² Kodi Penal, neni 74, par 3.10

vullnetarisht e kanë pranuar fajësinë iu çon mesazh tjerëve që ata do të trajtohen në mënyrë të drejtë. i inkurajon tjetër që të lajmërohen, qoftë si të kryerës të paraqiturtashmë apo si të panjohur.

Akti i pranimit të fajit duhet në parim, të shpie në një formë të zvogëlimit të dënimit që i akuzuari do ta kishte marr. Mirëpo, masa e vlerës zbutëse të pranimit të fajësisë varet shumë nga momenti në të cilin është pranuar fajit. Pranimit të hershëm të fajit i jepet më shumë peshë se atij që vjen më vonë, pasi që përfitimet për sistemin dhe ekonomizimin e gjyqimit janë në kulmimin e tyre. Gjithashtu besohet në përgjithësi si më i vërtetë dhe mëspontan se sa për shembull përpjekja e minutës së fundit për të minimizuar dënimin nënjë gjykim ku të pandehurit nuk po i shkon mirë. Me përparimin e procesit gjyqësor, zbutja e mundshme duhet të zvogëlohet proporcionalisht. Mirëpo, porsa të filloj gjykimi duhet të ketë zvogëlim të dukshëm të zbutjes së dhënë pasi që përfitimi i shmangies së gjyqimit tashmë është humbur në masë të madhe – në veçanti nëse viktimat janë thirrur për të dëshmuar. Nëse faji pranohet në mes të gjyqimit gjykata duhet seriozisht ta merr para sysh që të jep zbutje minimale apo fare. Në rastin Sikirica Dhoma e dha këtë vlerësim në lidhje me kohën e pranimit të fajësisë: *“Derisa i akuzuari i cili e pranon fajësinë për akuzat kundër tij para fillimit të gjyqimit zakonisht do të pranoj dobinë e plotë të atij pranimi, ai i cili e pranon fajin në çfarëdo kohe pas kësaj, do të pranoj pak dobi por jo aq sa do të fitonte sikur pranimi i fajësisë të bëhej para fillimit të gjyqimit.”*¹⁶³

Është me rëndësi që të mbahet mend që ky zvogëlim i dukshëm në zbutjen e dënimit pas fillimit të gjyqimit nuk është ndëshkim për shfrytëzimin e të drejtës për gjykim. Është thjeshtë njohje që shpërblimi kryesor për pranimin e fajësisë vjen në rast të shmangies së kostos për shoqërinë.

Përfundimisht, i pandehuri i cili e shfrytëzon të drejtën e tij për gjykim e ka një mundësi të cilën që nuk e ka i pandehuri i cili e pranon fajësinë, dhe ajo është që të shpallet i pafajshëm dhe ta heq dënimin tërësisht.

Përfundimisht, kjo rrethanë nuk duhet të ngatërrohet me marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë. Ato janë konsiderata krejtësisht të ndryshme. Kriteret e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë dhe kufizimet e saj në zvogëlimin e dënimit janë theksuar në mënyrë të qartë në Kodin e Procedurës Penale, Për më tepër marrëveshja mbi pranimin e fajësisë përfshinë të gjitha palët që pajtohen për dënimin përfundimtar për kryerësin – nuk ka zvogëlim shtesë në bazë të kësaj rrethane pasi që do të paraqiste llogaritje të dyfishtë. Vetë marrëveshja duhet të paraqesë në mënyrë adekuate kursimet për shoqërinë si dhe të gjitha rrethanat tjera lehtësuese që janë të duhura. Kjo rrethanë është e rezervuar vetëm për ato situata ku i pandehuri e pranon fajësinë pa marrëveshje me prokurorin.

Nëse gjykata ballafaqohet me situatë ku negociatat janë mbajtur por kanë dështuar, mirëpo i

¹⁶³ Rasti nr. IT-95-8-S, Aktgjykimi Dënues, Prokurori kundër Dusko Sikirica, Damir Dosen, Dragan Kolundzija, Tribunali Ndërkombëtar Penal për Ish Jugosllavi, (nëntor 13, 2001), par. 150

pandehuri në fund e ka pranuar fajin në Gjykatë pa marrëveshje, gjykata duhet tamerr para sysh dënimit e ofruar nga prokurori që ishte refuzuar nga i pandehuri. Nëse gjykata konstaton që rrethanat në lidhje me negociatat për marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë tregojnë që kryerësi e ka refuzuar ofertën për marrëveshje mbi pranimin e fajësisë me shpresë që do të pranoj dënim më të ulët nga Gjykata, ajo duhet ta merr para sysh ndikimin e mundshëm nëse Gjykata vendos që të shqiptoj dënim më të ulët. Shqiptimi i dënimit më të ulët se ai që është ofruar në marrëveshjen për pranimin e fajësisë pa dhënë arsyetim, mund ta dekurajoj mbajtjen e negociatave të ardhshme për marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë.

Pyetjet relevante përfshijnë:

- A e ka pranuar i pandehuri fajin në mundësinë më të hershme të mundshme?
- A ka pasur i pandehuri mundësi për t'i vlerësuar të gjitha provat e propozuara dhe dëshminë e propozuar para se ta pranoj fajësinë?
- A ka filluar gjykimi formalisht? A është dhënë dëshmia?
- A ka dëshmuar viktimë

6.7.5 Keqardhja e shfaqur nga personi i dënuar¹⁶⁴

Në mesin e rrethanave tjera që kanë të bëjnë me personin e akuzuar, 'pendimi' tradicionalisht ka qenë konsideratë e rëndësishme për zbutjen e dënimit në pothuajse secilin sistem. Idealisht përfaqëson një njohje të vuajtjes së viktimave, njohje që vepra ka qenë gabim, marrjen e përgjegjësisë dhe gatishmërinë për t'i pranuar pasojat. Kur pendimi të bashkohet me më shumë se shprehje të keqardhjes, por me ndonjë vepër të vërtetë që demonstroi pendimin, ky është argument detyrues për zbutje. Në situata të tilla, i pandehuri i ka shfaqur të gjitha tiparet e rehabilitimit të suksesshëm dhe riintegrim sipas modelit rehabilitues të dënimit.

Par ta pranuar pendimin si rrethanë lehtësuese për caktimin e dënimit, gjyqtari duhet të jetë i bindur që pendimi i shprehur është i sinqertë. Ky vlerësim është qartazi i vështirë, duke e pasur para sysh që kjo rrethanë është e natyrës subjektive, besueshmëria e së cilës varet vetëm nga kryerësi. Kërkon nga gjykata që t'i merr para sysh jo vetëm fjalët e kryerësit por edhe provat rrethore dhe konkludimeve që mund të nxirren nga veprimet dhe sjellja. Këto tradicionalisht kanë përfshirë gjëra si:

- Deklaratat specifike të bëra nga kryerësi që shfaqin pendim dhe keqardhje.
- Veprimet pozitive të drejtpërdrejta drejt viktimës si kërkimfalja.
- Nëse ka pasur lëndim të viktimës, kërkimi apo ofrimi i menjëhershëm i ndihmës mjekësore.
- Emocionet e kryerësit të vështruara nga viktimja, kryerësi dhe/apo Gjykata.
- Nëse veprimet e kryerësit janë shkaktuar apo ashpërsuar nga ndonjë gjendje e jashtme, si përdorimi i alkoolit apo narkotikëve, kërkimi i trajtimit mjekësor.
- Sjellja e pastajshme e kryerësit si p.sh në gjykatore, me rastin e dorëzimit në polici, gjatë bashkëpunimit me prokurorinë.
- Pranimi i fajit në momentin më të hershëm të mundshëm.

Një shembull i pendimit të shprehur nga i akuzuari mund të merret nga rasti Simiq, i gjykuar pranë Tribunalit të Hagës, në të cilin dhoma gjyquese ka konstatuar si në vijim:

"...fakti që Milan Simiq ... iu ka kërkuar falje dy viktimave të tij ...[dhe] ...gjatë deklaratës së bërë nga Milan Simiq në seancën për caktimin e dënimit në të cilën ai e shprehu "keqardhjen dhe pendimin e tij të sinqertë" për atë që e ua kishte bërë "bashkëqytetarëve dhe miqve të tij në shkollën fillore", dhe që ai e kishte shfrytëzuar mundësinë për "t'iu kërkuar falje publike të gjithë atyre".¹⁶⁵

¹⁶⁴ Kodi Penal, neni 74, par 3.11

¹⁶⁵ Rasti nr. IT-95-9/2-S, Aktgjykimi Dënues, Prokurori kundër Milan Simiq, Tribunali Ndërkombëtar Penal për Ish Jugosllavi, (17 tetor 2002), par.94.

Dyfishimi dhe kujdesi

Siç është diskutuar në fillim të rrethanave 3.7-3.12, shumë nga to shfaqin potencial të fuqishëm për t'u dyfishuar me njëra tjetrën. Siç mund të shihet nga lista e cekur më lartë, shumica e këtyre rrethanave citohen tradicionalisht si prova rrethore për ta mbështetur konstatimin për pendimin e kryerësit, duke rezultuar kështu në zbutje të dukshme. Mirëpo, koha dhe përvoja kanë treguar që shfrytëzimi i këtyre rrethanave si tregues është duke rënë. Me përdorim gjithnjë e më të madh të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë dhe pranimit të fajësisë, caktimi modern i dënimit e ka njohur që veprimet që tradicionalisht iu kanë atribuuar pendimit të kryerësit ndoshta konsiderohen në mënyrë më të duhur si zgjidhje të llogaritura për zvogëlimin e ekspozimit të madh ndaj dënimit. Kodi penal e njeh këtë konsideratë duke ua caktuar shumicës nga to nga një rrethane specifike. Kjo nënkupton që Gjykata duhet ta kufizoj konsideratën e saj vetëm në atofakte dhe rrethana që nuk i atribuohen drejtpërsëdrejti një rrethane tjetër.

Derisa pendimi mund të jetë rrethanë e rëndësishme dhe detyruese për zbutje, mungesa e pendimit nuk duhet të konsiderohet si rrethanë rënduese. Kjo vlen edhe për situatat në të cilat ekziston marrëveshja mbi pranimin e fajësisë.

Në përgjithësi, deklaratat apo kërkimfaljet nga i pandehuri duhet të shikohen me skepticizëm pasi që pendim i rrejshëm mund të jetë pjesë përbërëse e ciklit të dhunës së pranishme në marrëdhëniet e dhunës në familje.

Pyetjet relevante përfshijnë:

- Nëse kemi të bëjmë me lëndim të viktimës a ka ofruar kryerësi trajtim mjekësor? Gjatë kohës në fjalë?
- A i ka shprehur kryerësi pendim të drejtpërdrejtë viktimës apo dëshmitarëve?
- A ka ndërmar kryerësi hapa për të shfaqur pendim apo pranim të përgjegjësisë?
- A ka shprehur kryerësi emocion që e mbështetë pendimin?
- A ka kërkuar kryerësi ndihmë mjekësore/psikologjike pas kryerjes së veprës penale? Në cilën periudhë kohore? A e ka bërë kryerësi këtë kur e ka parë që nuk mund t'i shmanget kapjes apo pas fillimit të procesit?
- A ka shfaqur aktiviteti apo veprimi pendim të vërtetë apo kjo është bërë për ta zvogëluar përgjegjësinë dhe dënimin?
- A ka shfaqur kryerësi pendim si përpjekje për ta bindur viktimën që të lloboj për zvogëlim apo heqje të dënimit? Në rast se është situatë e dhunës në familje?
- A i ka zbutur kryerësi dëmet apo potencialin për shpërndarje tek viktimat tjera nëse kjo është e mundshme?

Sjellja e personit të dënuar pas konfliktit¹⁶⁶

Rrethana 3.12 është në shumë aspekte dispozitë që i përfshinë të gjitha, prandaj edhe kemi dështim të saj për të dhënë shembuj apo hollësi të mëtutjeshme. Nëse gjykata konstaton që sjellja e kryerësit ka merituar një masë të zbutjes, por nuk mund ta zbatoj atë tek asnjë rrethanë tjetër, Gjykata mund ta zbatoj atë te kjo rrethanë. Kjo mund të përfshijë qëndrimin, sjelljen, veprimet, pranimet, apo çfarëdo sjellje tjetër sipas rastit.

Në disa aspekte, përqendrimi në sjelljen pas konfliktit mund të siguroj më shumë mbështetje për ashpërsim të dënimit. Kjo mund të përfshijë:

- Shkatërrimi i ndonjë gjurme apo prove të veprës penale (përveç nëse kjo përbënë vepër të veçantë penale);
- Ndërmarrja e veprimeve të caktuar për t'i bërë presion dëshmitarit dhe ekspertit në cilësi të dëshmitarit për të dhënë dëshmi të rrejshme apo premtimi i ndonjë shpërblimi për arritjen e atij qëllimi (përveç nëse kjo përbënë vepër të veçantë penale);

Pyetjet relevante përfshijnë:

- A është sjellja e tillë për ta merituar zbutjen?
- A e mbështetë sjellja aplikimin e ndonjë rrethane tjetër lehtësuese?
- A duket sjellja e ndërlidhur apo si reagim i një ndonjë veprimi policor apo zyrtarë të bërë rishtazi?

6.7.7 Në rastet kur personi është i dënuar për veprën penale të marrjes së pengjeve, rrëmbimit apo privimit të kundërligjshëm nga liria ose siç përcaktohet në nenet 175, 194 ose 196 të këtij Kodi, kontributi në mënyrë efektive për lëshimin ose për ta sjellë të gjallë personin e rrëmbyer, marrë apo ndalur ose dhënia vullnetare e informatave që kontribuojnë në identifikimin e përgjegjësve të tjerë për vepërpenale.¹⁶⁷

Rrethana 3.13 do të jetë e zbatueshme për gjykatën vetëm në rrethana të kufizuara. Në mënyrë specifike, kur kemi të bëjmë me veprat penale që ndërlidhen me rrëmbimin si Marrja e Pengjeve (175), Rrëmbimi (194), dhe Privimi i Kundërligjshëm i Lirisë (196). Në këto rrethana të kufizuara, Gjykatës do t'i duhet t'i vlerësoj të gjitha rrethanat rreth tyre për ta përcaktuar nëse kjo rrethanë do të aplikohet. Në disa aspekte, rrethana tregon një masë të pendimit nga kryerësi apo së paku një veprim afirmativ në lidhje me viktimënnë përpjekje për të siguruar kthim të sigurt. Ajo gjithashtu parasheh zbutje në rrethanat kur kryerësi ofron informata për identifikimin e tjerëve, pra bashkëpunon me policinë. Qëllimi është që të sigurohet lehtësim kur një pjesë e veprës penale braktiset që ka pasur gjasa të shkoj drejt pasojave më të rënda.

¹⁶⁶ Kodi Penal, neni 74, par 3.12

¹⁶⁷ Kodi Penal, neni 74, par 3.13

Përveç që bien në një rën nga veprat e cekura, ekzistojnë disa kritere shtesë para se gjykata të mund merr në konsideratë zbutjen. Për zbutje në lidhje me viktimën, kodi është i qartë që viktima duhet në fakt të mbijetojë. Kryerësi duhet të ofroj kontribut efektiv për kthim të sigurt të viktimës. Kjo duhet të jetë më shumë se dorëzimi i personit tek autoritetet policore, vepra e dështuar apo ngjarje aksidentale. Duhet të ketë prova që veprimet janë dizajnuar apo formuluar me qëllim të kthimit të viktimës, dhe që kur të vlerësohet tërësia e rrethanave të shihet se ato kanë ndihmuar në sjelljen a rezultatit.

Për zbutje në situatën e dytë, do të kërkohet sigurim vullnetar i informatave në lidhje me bashkëkryerësit. Masa e zbutjes do të varet në vlerësimin e gjykatës për vullnetarizmin e kontributit të kryerësit. Nëse kryerësi vullnetarisht e braktis veprën penale dhe ofron informata në lidhje me bashkëkryerësit para përfshirjes së policisë, do të ketë të drejtë përmë shumë zbutje se sa kur informatat ofrohen në fund të një intervistimi të gjatë nën kërcënimin e një periudhe të gjatë të burgimit.

Dyfishimi dhe Kujdesi

Siç është cekur shkurtimisht më lartë, ekziston potencial për dyfishim të kësaj rrethane me rrethanat tjera lehtësuese. Një veprim pozitiv nga ana e kryerësit që kontribuon në lirimin e sigurt të viktimës e mbështetë teorinë që kryerësi pjesërisht e ka braktisur qëllimin e tij fillestar dhe po kërkon që ta zbus rezultatit përfundimtar. Gjykata mund të konkludoj që kjo shfaqë një nivel të pendimit dhe prandaj ka mundësi për dyfishim. Ngjashëm me këtë, ofrimi vullnetar i informatave që ndërlidhet me bashkëkryerësit dyfishohet në konceptin e bashkëpunimit me policinë. Duke qenë se rrethanat janë aq të ngushta për aplikimin e kësaj rrethane, çdo provë që e mbështetë konstatimin duhet të përqendrohet në këtë rrethanë.

Pyetjet relevante përfshijnë:

- A ka mbijetuar viktima?
- A janë veprimet e kryerësit përgjegjëse për kthim të sigurt të viktimës? Nëse jo tërësisht, deri në çfarë mase? A ka qenë kontributi i papërfillshëm?
- A do të kthehej viktima e sigurt pa kontributin e kryerësit?
- A ka qenë kthimi i sigurt i viktimës qëllimi i veprimeve?
- A ka qenë qëllimi i veprimeve kthimi i sigurt i viktimës?
- A kanë qenë veprimet të motivuara nga intervenimi policor?
- A ka qenë dështimi i veprës penale i afërt me momentin e kontributit?
- A ka qenë policia e vetëdijshme për veprën penale
- A ka qenë kontributi i bazuar në ndonjë masë në braktisjen vullnetare ngakryerësi?
- A ka qenë kryerësi në paraburgim kur i ka dhënë informatat apo kontributin?
- A ka rezultuar identifikimi në kapje të kryerësve tjerë?
- A ka qenë kontributi më i madh se sa identifikimi i kryerësve tjerë?

6.8 Rrethanat Tjera Lehtësuese

Ashtu si rrethanat rënduese, nuk ka kufizime që gjykata të thirret vetëm në ato rrethana të numëruara në Kod. Mirëpo, lista është e përgjithshme dhe e zgjeruar sa duhet sa që shumë gjendje faktike që dëshmohen nga rrethanat lehtësuese tradicionale do të bien në kuadër të njëres nga këto rrethana. Para se të jashtë këtyre kufijve, Gjykata duhet që me kujdes ta vlerësoj nëse rrethana e menduar është në pajtim me praktikën e caktimit të dënimit e jo thjeshtë e bazuar në mendim personal. Lehtësimi i nënshtrohet shumë më shumë vlerave, normave dhe zakoneve shoqërore se sa ashpërsimi dhe lehtë mund ta pengoj qëllimin për zvogëlimin e dallimeve në dënime.

6.8.1 Kalimi i kohës

Një rrethanë tjetër lehtësuese që gjykata mund ta merr para sysh është kalimi i një periudhe të gjatë kohore ndërmjet kryerjes së veprës dhe kohës kur çështja është duke u trajtuar përfundimisht nga gjykata. Teoria prapa kësaj rrethane të mundshme i ka disa aspekte. Ndoshta gjykata e ka para vetës një individ i cili pas kryerjes së veprës ka jetuar jetë shembullore, ka prosperuar dhe ka shfaqur indikacione të braktisjes së çdo gjëje që i ngjason jetës kriminale, duke e shmangur nevojën për parandalim personal. Ndoshta gjykata beson që çështja është zbehur sa duhet nga mendjet e publikut dhe që nuk ekziston më kërkesa e menjëhershme për drejtësi apo nevojë të perceptuar për parandalim të përgjithshëm. Apo ndoshta rasti është shumë i vjetër si rezultat i lënies pas dore apo situatës së mëparshme politike.

Cilado nga këto që u cekën më lartë mund të duken arsye të mundshme për zbutjen e dënimit për të pandehurin, mirëpo, gjykata duhet t'i qaset kësaj rrethane më një dozë skepticizmi. Ndonëse gjykata nuk është e obliguar që t'i shqyrtoj vetëm rrethanat lehtësuese të cekura në kod, ajo prapëseprapë duhet të veproj me kujdes, pasi që nëse del përtej mundësive, rrethana mund të jetë kontroverze apo së paku më pak e pranueshme përgjithësisht. Pavarësisht kësaj, gjykata duhet t'i mbajë në mend disa konsiderata.

Së pari, vetë kalimi i kohës nuk është i mjaftueshëm për të zbutur dënimin. Legjislacioni ika ofruar gjykatave afate procedural mjaftë specifike për seancat si dhe afate të parashkrimit për vepra të caktuara. Këto kontrolle procedural janë vendosur me qëllim të përcaktimit se kur drejtësia nuk është më e mundshme për shkak të vonesave të vazhdueshme. Për më tepër, metodat alternative ndaj burgimit gjithashtu i shërbejnë qëllimit të ndikimit në minimizimin apo parandalimin e të pandehurit gjatë çdo vonese. Ofrimi i një lloji të zbutjes qoftë edhe të përshkallëzuar për shkak të vonesave, krijon nxitjen e mbrapshtë të vonesës së proceseve edhe më tutje me shpresë të nxjerrjes së përfitimeve akoma më të mëdha.

Çfarëdo konsiderate e përfitimit të zbutjes për kryerësin nuk duhet të jepet pa vlerësim të duhur

të veprimeve të kryerësit, posaçërisht nëse vetë veprimet e kryerësit kanë kontribuar në ndonjërin vonesë apo kalim të kohës për të cilën gjykata po kërkon të jep zbutje (në çfarëdo cilësie). Nëse kryerësi ka marr pjesë aktive në krijimin e vonesave, aposhmangien e zbulimit apo identifikimit, nuk duhet të ketë kurrfarë konsiderate, në asnjë masë, të zbutjes së bazuar në këtë teori. Gjykata duhet ta vlerësoj kontributin e mundshëm të kryerësit në mënyrë liberale, pasi që sjellja e vazhdimin pasiv të jetës sikur nuk ka ndodhur asgjë, përgjatë një periudhe të gjatë të kohës, tregon mungesë të njohjes që sjellja ka qenë kriminale. Në fakt, ka një logjikë në argumentin që nëse ka kaluar një periudhë e madhe kohore dhe kryerësi nuk ka bërë gjëra si dëmshpërblimi i viktimës, dorëzimi apo bashkëpunimi me gjykatën, kjo në fakt paraqet sjellje të mungesës së rehabilitimit apo pendimit.

Ngjashëm me këtë, gjykata duhet të shikoj procesin te prokuroria dhe zbatuesit e ligjit dhe të vlerësoj nëse ka pasur trajtim jo të duhur të rastit që ka shkaktuar vonesa të padrejtë. Se a do të meritohet zbutje për këtë është çështje kontroverse dhe e vështirë për t'u vlerësuar. Pavarësisht rrethanave, duhet të ketë prova të qarta të trajtimit të gabuar përveç thjeshtë kalimit të kohës. Siç është cekur më herët, legjislacioni pozitiv duhet ta udhëzoj gjykatën si duhet për atë se si t'i trajtoj vonesat e prokurorisë, në veçanti për shkak se ekzistojnë deri diku merita në faktin që prokuroria ka shpenzuar kohë dhe mund për ta paraqitur çështjen në gjykatë.

6.8.2 Urdhri i lartë

Në lidhje me mundësinë e pretendimit tradicional të urdhrit nga lartë për të akuzuarin icili është dashur ta zbatoj atë urdhër (p.sh. një formë e detyrimit'), Neni 16 në mënyrë specifike e ndalon përjashtimin e plotë përveç në rrethana shumë të ngushta. Për sa i përket aplikimit të tij si rrethanë lehtësuese, një vlerësim i tillë do të varet shumë nga faktet dhe i mundshëm vetëm në situata ekstreme, e veçanërisht jo kur ka prova që kryerësi ka qenë pjesëmarrës me vullnet në kryerjen e veprës penale. Në një situatë të rrallë ku rrethanat mund të shprijnë në zbatim të zbutjes, Gjykata duhet ta merr para sysh nëse do të kategorizohet më mirë në Rrethanën lehtësuese 3.1.

6.8.3 Krimet e nderit

Gjyqtarët nuk duhet ta marrin para sysh zvogëlimin e dënimit për veprat penale të kryera nga anëtari i familjes në bazë të pretendimit të kryerësit për veprim nga respekti për kulturën, traditën, fenë apo traditën, apo për kthim të të ashtuquajturit "nder". Gjykatat duhet të sigurohen që ndalimi i këtyre arsyeve asnjëherë nuk konsiderohet si kufizimi të drejtave dhe lirive kulturore a fetare të kryerësit. Kjo është thelbësisht e rëndësishme në shoqëritë ku komunitete të ndryshme etnike dhe fetare jetojnë së bashku dhe në të cilat qëndrimet mbizotëruese për pranueshmërinë e dhunës në familje dallojnë varësisht nga historiku kulturor apo fetar. Në fakt, neni 46 i Konventës së Stambollit¹⁶⁸ kërkon dënimmë të ashpër

¹⁶⁸ Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunën në familje, e hapur për nënshkrim më 11 maj 2011 në Stamboll, Turqi. Konventa ka hyrë në fuqi më 1 gusht 2014.

nëse vepra penale kryhet nga anëtari i familjes apo nga dy e më shumë persona që veprojnë së bashku.

6.8.4 Mungesa e dënimeve të mëparshme penale

Rrethana që kryerësi nuk ka dënime të mëparshme penale (andaj edhe quhet kryerës për herë të parë) shpesh konsiderohet rrethanë lehtësuese, me supozimin që personi i akuzuar i cili asnjëherë nuk ka kryer veprë penale më parë ka perspektivë më të mirë të rehabilitimit dhe reagon në mënyrë më pozitive ndaj efektit parandalues të tërë procesit gjyqësor. Kjo mund të shpie në zvogëlim të dënimit për të akuzuarin. Të qenit kryerës përherë të parë është gjithashtu në pajtim me konstatimin e ‘karakterit të mirë’ para veprës, andaj të dy rrethanat shpesh shqyrtohen në lidhje me njëra tjetrën. Mirëpo, rëndësia e sjelljes së mëparshme e të akuzuarit është rrethanë e ndërlikuar që ka implikime të mëdhanë ndikimet shoqërore, pasurinë etj. Nëse gjykata e konstaton mungesën e dënimeve të mëparshme penale dhe mund të jepet zbutja, do të kërkoj gjetje të fakteve që e mbështesin përfundimin e sjelljes përkatëse dhe predispozitat për rehabilitim.

6.8.5 Sjellja e mëparshme seksuale e viktimës

Në shumë shtete, historia e mëparshme seksuale e viktimës vazhdon të përdoret me qëllim që në mënyrë jo të duhur të zhvendoset vëmendja i akuzuari tek viktima. Historia e kaluar e viktimës nuk është relevante për besueshmërinë e saj. Nuk duhet të jetë as arsye për zvogëlimin e dënimit të kryerësit.¹⁶⁹ Përfundimisht, provat për historinë seksuale të ankueses/të mbijetuarës nuk duhet të merren para sysh për zbutjen e dënimit të kryerësit.

6.8.6 Mbështetja nga viktima

Dëshirat e viktimës apo familjes së viktimës për trajtim më të butë të kryerësit nganjëherë merren para sysh për zbutjen e dënimit. Nëse gjykata është duke e shqyrtuar një zvogëlim të tillë, duhet të jetë e vëmendshme për disa çështje. E para, dëshirat e viktimës (dhe dëmshpërblimi), ndonëse shumë të rëndësishme, janë vetëm një komponentë e dënimit të përgjithshëm. Edhe nëse gjykata i heq konsideratat e viktimës në bazë të dëshirës së viktimës, prapë duhet të japë dënim i cili i plotëson nevojat e shoqërisë për sa i përket drejtësisë, parandalimit etj. Nuk duhet të jetë rrethana vendimtare për përcaktimin e dënimit përfundimtar. Kur viktimizimi është i bazuar në pronë apo humbje financiare, dëshirat e viktimës mund të merren në konsideratë më tepër në dënimin përfundimtar. Mirëpo, dënimi i shqiptuar për veprën e dhunës duhet të përcaktohet në bazë të ashpërsisë së veprës, e jo nga dëshirat e shprehura të viktimës.

Së dyti, gjykata duhet të veproj me shumë maturi nëse ka indikacione të dhunës në familje në veprë. Për të bërë zbutje Gjykata duhet të sigurohet që viktima nuk do të ekspozohet ndaj rrezikut të lartë të dhunës së mëtejshme. Kjo është detyrë shumë vështirë në shumicën e rasteve të dhunës në familje. Pajtimi është pjesë themelore e ciklittë dhunës në rastet e dhunës

¹⁶⁹ Doracaku për gjyqtarë e prokurorë mbi dhunën në familje, Historiku i viktimës, par.10.7.3 Prishtinë(2016) , fq.78.

në familje dhe në shumë situata ekzistojnë periudha ku viktimat do të vendos kundër parashtrimit të padisë apo do t'ia falë të pandehurit. Për çdo kërkesë të tillë, historia e mëparshme e marrëdhënies duhet të vlerësohet në mënyrë të thukët, në veçanti për të parë nëse ka pasur situata të ngjashme më parë ku viktimat e ka braktisur ndjekjen. Ekzistojnë një numër i arsyeve të ngjashme përse arsyet shitesë mund të jetë veçanërisht e rëndësishme që ky parim të respektohet në rastet e dhunës në familje:¹⁷⁰

- Nuk është e dëshirueshme që viktimat të ndjehet përgjegjëse për dënimin e shqiptuar.
- Ekziston rreziku që lutja për mëshirë e bërë nga viktimat do të apo ka qenë e nxitur nga kërcënimet e bëra nga apo, nga frika nga kryerësi.
- Pranimi i kërkesave të tilla do t'i rrisë gjasat e përsëritjes së veprës në të ardhmen dhe tregon kryerësit dhe abuzuesve tjerë që ata mund ta kontrollojnë rezultatin duke e kontrolluar viktimit.

¹⁷⁰ Po aty. Dëshirat e viktimit dhe efekti i tyre në dënim, fq.7

ZBATIMI I UDHËZUESIT NË PRAKTIKË

KAPITULLI VII

RREGULLIMI (AKORDIMI) I DËNIMEVE

7.1 Caktimi i peshës së rrethanave

Porsa gjykata t'i ketë vlerësuar si duhet të gjitha rrethanat e mundshme rënduese dhe lehtësuese, mbështetjen e tyre faktike dhe nëse ato janë relevante apo jo, ajo duhet të angazhohet në vlerësim kuantitativ. Hapi i 4 përfshinë vlerësimin dhe caktimin e peshës për secilën rrethanë të pranishme, duke i krahasuar dhe baraspeshuar rrethanat rënduese dhe lehtësuese dhe duke vlerësuar nëse ka në dispozicion rregullime shtesë. Këta hapa duhet të bëhen në lidhje me referencën në Shtojcën 1.

Caktimi i peshës së rrethanave kërkon nga gjykata që të angazhohet në një proces me dy hapa. i pari, vlerësimi i secilës rrethanë ka rëndësi të brendshme. Së dyti, gjykata duhet tapërcaktoj rëndësinë e përgjithshme të veprës.

7.2 Rëndësia e brendshme e rrethanës

Në shumë situata, vlerësimi i rrethanave do të jetë thjeshtë një vlerësim nëse ato ekzistojnë apo jo. Për ato situata ku rrethanat nuk ekzistojnë, Gjukata thjeshtë mund të kaloj në rrethanën tjetër dhe të mos e shqyrtoj atë. Mirëpo, kur një rrethanë nuk ekziston, vlerësimi nuk ndalet aty. Gjukata pastaj duhet ta vlerësoj peshën që do t'i jepet secilës rrethanë. Përcaktimi i peshës së rrethanës kërkon nga gjykata krijimin e një strukture hierarkike brenda rrethanës së caktuar dhe pastaj vlerësim të asaj se ku bie rasti i caktuar në kuadër të asaj hierarkie. Kjo do të krijoj peshë relative për atë rrethanë.

Një shembull klasik e përfshinë të pandehurin i cili e pranon fajësinë gjatë procesit gjyqësor. Vetëm për shkak se i pandehuri e ka pranuar fajësinë, ai/ajo nuk ka të drejtë automatikisht që të merr sasinë maksimale të zbutjes për shkak se e ka bërë këtë. Brenda kësaj rrethane ekzistojnë një sërë nivelesh që ndikojnë në rëndësinë e rrethanës individuale. Një i pandehur i cili e pranon fajësinë në mundësinë e parë që i jepet duhet të pranoj zbutjen maksimale në dispozicion për këtë rrethanë lehtësuese. Si krahasim, i pandehuri i cili e pranon fajësinë pak para gjykimit mund të përfitoj nga zbutja, mirëpo do të jetë substancialisht më pak. i pandehuri i cili e pranon fajësinë gjatë gjykimit nuk dotë merr pothuajse asnjë përfitim nga pranimi. Nëse e konsiderojmë që përfitimi i përgjithshëm për sistemin për sa i përket shpenzimit të burimeve është qëllimi i lejimit të zbutjes për pranim të fajësisë, atëherë sa më shumë burime që të kursehen aq më shumë zbutje do të ofrohet.

Për secilën rrethanë gjykata duhet të bëjë analiza për ta përcaktuar nëse i pandehuri ka të drejtë që të ketë përfitim të plotë të rrethanës në bazë të fakteve të prezantuara. Secila rrethanë e paraqitur në pjesët e paraqitura më pjesët e mëparshme për rrethanat lehtësuesedhe rënduese i parashohin disa ndarje të mundshme për t'u marr në konsideratë nga gjykata, mirëpo lista nuk është shtruese.

7.3 Serioziteti i veprës penale

Porsa gjykata ta ketë përfunduar shqyrtimin e të gjitha rrethanave, ta ketë përcaktuar praninë e tyre dhe vlerësuar vlerën e tyre të brendshme, hapi i radhës është që tapërcaktoj seriozitetin e përgjithshëm të veprës në bazë të rrethanave që janë në ligj dhe atyre që nuk janë. Serioziteti është komponenti kyç i përcaktimit të dënimit përfundimtar dhe është kombinim i shqyrtimit të dy aspekteve kyçe, fajësisë së të pandehurit nëkryerjen e veprës dhe dëmi e shkaktuar nga vepra penale. Në përgjithësi sa më e lartë fajësia e të pandehurit dhe dëmi i shkaktuar, aq më i lartë duhet të jetë dënimi. Serioziteti nuk do t'i përfshijë të gjitha rrethanat e cekura në kod, por vetëm ato që tradicionalisht konsiderohen të duhura. Porsa të jetë vlerësuar serioziteti, mund të merren në konsideratë edhe rrethanat tjera të mbetura.

Me shqyrtimin nga ana e gjykatës së këtyre dy rrethanave duhet të theksohet prapë që NUK duhet të ketë llogaritje të dyfishtë të rrethanave nëse rrethanat janë element i veprës penale. Siç është diskutuar më herët, Kodi Penal përmban shumë vepra penale derivative që TASHMË marrin në konsideratë rrethanat e parapara në ligj të numëruara më poshtë, ato nuk mund të përdoren prapë për ta shqyrtuar seriozitetit të veprës penale. Përveç kësaj, siç është shpjeguar më herët, rrethanat e numëruara më poshtë kanë potencial për t'u dyfishuar me njëra tjetrën. Gjukata duhet të jetë e kujdesshme për të mos e marr para sysh cilindo fakt të një rasti të caktuar për më shumë se një rrethanë.

7.3.1 Rrethanat që ndikojnë në fajësinë e të pandehurit

Rrethanat në vijim janë rrethana relevante për të përcaktuar nivelin e fajësisë së të pandehurit. Këto rrethana do të tregojnë që i pandehuri ka qenë pjesëmarrës me dashje dhe ka qenë kontribues i madh ose arkitekt i veprës apo, e kundërta, pjesëmarrja ka qenë minimale apo ka pasur rrethana që ndikojnë në nivelin e vlerësuar të pjesëmarrjes. Në përgjithësi, shkalla e ndryshme e fajësisë do të dallojë nga niveli i një kryerësi të zakonshëm.

7.3.1.1 Shkallë më e lartë e fajësisë

a. Rrethanat e cekura në ligj

2.1 shkalla lartë e pjesëmarrjes së personit të dënuar në veprën penale;

2.2. shkalla e lartë e dashjes nga ana e personi të dënuar, përfshirë çfarëdo prove të paramendimit;

2.11. nëse vepra penale është kryer si pjesë e veprimtarisë së grupit të organizuarkriminal

dhe/ose;

2.9.çfarëdo keqpërdorimi të pushtetit ose pozitës zyrtare nga personi i dënuar në kryerjete veprës penale;

2.10.dëshmi të shkeljes së besimit nga ana e personit të dënuar;

b. Rrethanat që nuk janë cekur në ligj

- Nëse i pandehuri qëllimisht ka shkaktuar dëm më të madh se që ka qenë e nevojshme për kryerjen e veprës penale
- Nëse i pandehuri i ka shënjestruar viktimat për shkak të cenueshmërisë, moshësapo të qenit të pambrojtur

7.3.2.1 Shkallë më e ulët e fajësisë

3.1. rrethanat të cilat për pak nuk arrijnë të jenë bazë për përjashtimin e përgjegjësisë penale, si për shembull, aftësia e zvogëluar mendore;

3.4.dëshmia që personi i dënuar ka luajtur rol relativisht të vogël në veprën penale;

3.5.fakti që personi i dënuar ka marrë pjesë në veprën penale jo si kryes kryesor por përmes ndihmës, inkurajimit ose duke ndihmuar tjetrin në ndonjë mënyrë tjetër;

3.2. dëshmia për provokim nga ana e viktimës;

3.6. mosha e personit të dënuar, i ri apo i moshuar;

7.3.2 Rrethanat që kanë ndikim në nivelin e dëmit

Rrethanat në vijim janë rrethana relevante për të përcaktuar nivelin e dëmit të shkaktuar nga vepra penale. Në përgjithësi këto rrethana do të tregojnë që vepra penale ka pasur shkallë më të lartë apo më të ulët se ajo e theksuar nga dispozitat specifike të veprës penale në Kod. Këto mund të përfshijnë numrin e viktimave apo shkallën e lëndimit të viktimave.

7.3.2.1 Shkallë më e lartë e dëmit

a. Rrethanat e cekura në ligj

2.3. prania e dhunës ose kanosjes me dhunë në kryerjen e veprës penale;

2.4. nëse vepra penale është kryer në mënyrë posaçërisht mizore;

2.5. nëse vepra penale përfshin disa viktimë;

2.6. nëse viktimë e veprës penale ka qenë posaçërisht e pambrojtur apo e ndjeshme;

2.7. mosha e viktimës, nëse është i ri apo i moshuar;

2.8. shkallën e dëmit të shkaktuar nga personi i dënuar, përfshirë vdekjen, lëndimin e përhershëm, transmetimin e sëmundjes tek viktimë apo çfarëdo dëmi tjetër të shkaktuar viktimës ose familjes së saj/tij;

b. Rrethanat që nuk janë cekur në ligj

- Nëse i pandehuri qëllimisht ka shkaktuar dëm më të madh se që ka qenë e nevojshme për kryerjen e veprës penale dhe niveli i dëmit nuk është cekur si rrethanë cekur më lartë.
- Niveli i dëmit të shkaktuar jofizik apo humbja financiare ka qenë dukshëm më e madhe se që ka qenë e nevojshme apo është shkaktuar përveç dëmit fizik.

7.3.2.2 Shkallë më e ulët e dëmit

3.7. dëshmia që personi i dënuar ka bërë restituimin apo kompensimin e viktimës;

7.4 Rëndësia relative dhe qëllimet e dënimit

Përveç rregullave të përgjithshme për përcaktimin e peshës së secilës rrethanë të përshkruar më lartë, Gjykata duhet t'i merr para sysh edhe aspektet në vijim për ta përshtatur edhe më tutje dënimin.

E para është rëndësia relative. Siç është diskutuar në tërë doracakun, jo të gjitharrethanat duhet/do të konsiderohen të barabarta njëra me tjetrën në llogaritjen e përgjithshme. Rekomandimi i Këshillit të Evropës në lidhje me njëtrajtshmërinë e dënimeve thotë: *“Kurdo që është e mundshme, ligji apo praktika duhet të bëjë përpjekje për përkufizimin edhe të këtyre rrethanave të cilat duhet të konsiderohen relevante për sa i përket veprave të caktuara.”*⁸⁵ Në përgjithësi duhet të zbatohen parimet në vijim:

- Ashpërsimi i dukshëm
- Trauma/lëndimi i vuajtur nga viktimat(t)
- Cenueshmëria e viktimës(ave)
- Mizoria e shkaktuar
- Keqpërdorimi i autoritetit apo besimit
- Pjesëmarrja e shprehur
- Zbutja e dukshme
- Pendimi/përpjekjet për minimizim të ndikimit
- Pranimi i fajit
- Pjesëmarrja indirekte/ pjesëmarrja përmes presionit
- Bashkëpunimi me autoritetet
- Njohuria e kufizuar e veprimeve
- Konsiderata e ulët
- E kaluara kriminale (përveç nëse është recidivist)
- Moshë
- Karakteri i mirë
- Statusi familjar

E para është rëndësia relative. Elementi i dytë që duhet të merret parasysh gjatë vlerësimit të rrethanave relevante rënduese dhe lehtësuese për shqiptim të dënimit është që ato duhet të jenë koherente me

synimin që e ka dënimi. Për shembull nëse njëri nga synimet kryesore është rehabilitimi apo risocializimi, atëherë rrethanat si pendimi dhe bashkëpunimi i kryerësit do të marrin rol dhe rëndësi qendrore në caktimin e dënimit; ndërsa nëse qasja ndëshkuese mbizotëron në caktimin e dënimit, duhet të mbizotërojnë rrethanat që ndërlidhen me rolin e të akuzuarit në kryerjen e veprës penale dhe me dëmin e shkaktuar viktimës. Kjo do ta inkurajojë, për shembull, dënime më të rënda për vepra penale në të cilat është shkelur pozita e besimit apo autoritetit, dhe për veprat penale të kryera me mizori, sadizëm apo të motivuara nga paragjykimi, diskriminimi apo urrejtja për viktimat veçanërisht të cenueshme; dhe të shqiptojnë dënime më pak të ashpra në lidhje me rastet ku kemi pendim, dhe bashkëpunim me të akuzuarin, prokurorin dhe autoritetet gjyqësore. Ashtu si te shqyrtimi i rrethanave të rëndësishme, për hir të thjeshtësisë, sugjerohet që thjeshtë të bëhet zvogëlim deri në 25% për ato rrethana që nuk ndërlidhen drejtpërsëdrejti me qëllimet e përgjithshme të caktimit të dënimit që gjykata i ka identifikuar. Nëse gjykata e ka marr qasjen që të gjitha qëllimet e dënimit janë njëlloj të rëndësishme, nuk do të ketë nevojë të angazhohet në këtë akordim.

Ajo që është e dukshme është që rrethanat që merren para sysh në përcaktimin e dënimeve janë të natyrës së ndryshme por esencialisht të ndërlidhura me: qëllimet e caktuara për dënimin, ndikimin që ushtrohet nga parimet e përgjithshme, rrethanat specifike të rastit dhe aspektet e tij procedurale.

VEPRAT PENALE KUNDËR JETËS DHE TRUPIT

Më poshtë është dhënë përshkrim i rrethanave që do të përdoren kur të përcaktohet niveli i zbutjes/ashpërsimit në këtë kategori të veprave dhe një shembull i procesit të vlerësimit. Lista nuk është shteruese e as nuk duhet të konsiderohet si kumulative pasi që kjo kategori do të mund të përfshij ngaveprat që janë të vogla për nga natyra deri të ato të rënda. Varësisht nga rrethanat e rastit, pesha e veprës specifike në këtë kategori dhe elementet e asaj vepre të caktuar gjyqtarët duhet ta shqyrtojnë se cilat rrethana do të vlejné në këtë kategori. Përshkrimi narrativ i rrethanave të ndryshme lehtësuese dhe rënduese në udhëzues përfshinë analizë më të thukët të rrethanave dhe gjyqtarët inkurajohen që t'i referohen një pjese specifike të tekstit me qëllim të individualizimit të dënimit.

Pikat individuale të fillimit janë përkufizuar për një dënim apo kufij specifik të paraparë për atë vepër. Zbutja dhe ashpërsimi do të shqyrtohen vetëm pasi të jetë specifikuar pika fillestare:

Shembuj të rrethanave lehtësuese relevante të mundshme dhe përdorimit të tyre për zbutje të dënimit	
Rrethanat e zbutjes së dënimit	Sqarimi
Provokimi nga viktima	<p>Varësisht nga specifikat e veprës penale, provokimi mund të luaj rol shumë të rëndësishëm në zbutjen e dënimit apo mund të mos ketë fare rol në të. Provokimi mund të jetë rrethanë më e fuqishme në veçanti nëse ka ndodhur për periudhë të gjatë kohore.</p> <p>Në rastet kur kemi të bëjmë me marrëdhënie të dhunshme, provokimi shpesh përdoret si mbrojtje nga kryerësit, mirëpo në raste të tilla, provokimi nuk duhet të shërbej për zbutje të dënimit, e as nderi apo tradhtia në marrëdhënie nuk duhet të llogariten si provokim. Në pjesën përshkruese të udhëzuesit që i referohet provokimit, gjyqtarët mund të gjejnë më shumë udhëzime për përdorimin e provokimit si rrethanë lehtësuese për rrethana të ndryshme dhe pyetjet e parashtruara me qëllim të përcaktimit se çka mund të konsiderohet si provokim i vlefshëm (për më shumë informata shiko fq.106-109).</p>
Vetëmbrojtje e tepruar	<p>Kjo rrethanë do të përdoret për zbutjen e rasteve të caktuara të ngacmimit të vazhdueshëm nga viktima (shembull. Ngacmim i personit nga bashkëmoshatarët) apo në kontekst familjar kur ka pasur dhunë të vazhdueshme në marrëdhënie. Këto situata mund të nxisin reagime të çuditshme nga viktima i cili/e cila në këtë rast bëhet kryerës.</p> <p>Ekziston hulumtim shkencor për atë që quhet sondomi i gruas së rrahur që është gjendje fizike dhe psikologjike e personit i cili ka vuajtur nga abuzimi i vazhdueshëm emocional, fizik apo seksual nga partneri në marrëdhënie familjare. Viktimat e abuzimit të tillë të vazhdueshëm mund të reagojnë në mënyrë të tepruar dhe jodomosdoshmërisht reagojnë në momentin kur ka ndodhur abuzimi dhe si të tilla nuk e plotësojnë kriterin e mbrojtjes së nevojshme, mirëpo mund të konsiderohet si rrethanë shumë e rëndësishme për zbutjen e dënimit.</p>

<p>Pozita e pafavorshme sociale</p>	<p>Janë personat që pranojnë asistencë sociale, jetimët, kryerësi që jeton në mjedis të prirur për dhunë dhe vepra tjera penale. Për shkak të situatës personale dhe/apo mjedisit në të cilin këta persona jetojnë, ata kanë më shumë potencial për t'u përfshirë në këtë lloj të veprave, shpesh me qëllim të mbijetesës në tëzonë. Kjo rrethanë e mundshme lehtësuese mund të përdoret vetëm si zbutje më e ulët.</p>
<p>Rol i vogël i kryerësit apo rastet kur kryerësi nuk ka qenë kryerësi kryesor në rastet si ndihma dhe nxitja, apo dhënia e asistencës personit tjetër.</p>	<p>Nëse vepra penale është kryer nga më shumë se një person, gjykata duhet ta vlerësoj rolin dhe kontributin e secilit kryerës në kryerjen e veprës penale dhe nëse roli është më i vogël, apo në krahasim me kryerësin/it e tjerë ky kryerës nuk ka përdorur armë apo nuk ka qenë mizor ndaj viktimës etj. pra çdo gjë që mund ta tregoj rolin më të vogël të këtij kryerësi. (për më shumë informata shiko fq.115-117).</p>
<p>Mosha dhe/apo mungesa e pjekurisë kandikim në përgjegjësinë e kryerësit</p>	<p>Nëse kryerësi është i moshës së re, p.sh. më i ri se 18 vjeç, kjo mund të jetë rrethanë për ta treguar mungesën e pjekurisë. Një kryerës më i moshuar gjithashtu mund të mos jetë i vetëdijshëm për peshën e veprimeve të tij dhe që ato e rrisin nivelin e veprës penale. Varësisht se a është kryerësi i ri apo i moshuar, gjyqtari duhet ta vlerësoj nivelin e zbutjes nga kjo rrethanë për ta përcaktuar dënimin përfundimtar, mirëpo nuk duhet automatikisht të llogaritet si rrethanë lehtësuese. (për më shumë informata shiko fq.117-121).</p>
<p>Goditje e vetme/incident i izoluar</p>	<p>Kjo rrethanë ka të bëjë me mungesën e paramendimit. Derisa paramendimi luan rol shumë të rëndësishëm në ashpërsimin e veprës penale, mungesa e paramendimit gjithmonë duhet të vlerësohet në lidhje me rrethanat tjera, p.sh nëse personi është recidivist etj. Rrethanat do ta përcaktojnë</p>

	pastaj se çfarë peshe ka.
<p>Përcaktimi/demonstrimi i hapave që janë ndërmarr për ta trajtuar varësinë esjelljeve të kryerësit</p>	<p>Një shembull i kësaj rrethane do të ishte nëse kryerësi është i varur nga droga apo alkooli dhe kryen veprë penale derisa është në ndikim të substancave të tilla. Zbutja do të ishte e mundshme nëse i njëjti do të ndërmerre hapa vullnetarisht për ta adresuar këtë çështje si pjesëmarrja në ndonjë lloj trajtimi. E njëjta do të vlente për personat të cilët mund të kenë problem me zemërimin dhe të cilët vullnetarisht shkojnë në trajtim të menaxhimit të zemërimit apo edhe në terapi për çiftin në rast të ndonjë incidenti në familje. Mirëpo kjo rrethanë nuk do të kishte peshë të rëndësishme nëse nuk bëhet vullnetarisht por urdhërohet nga gjykata.</p>
<p>Sjellja e kryerësit pas kryerjes së veprës penale/pendimi;</p>	<p>Sjellja shembullore e kryerësit mund të konsiderohet si rrethanë lehtësuese. Në çdo rrethanë, pesha e kësaj rrethane duhet të vlerësohet në mënyrën se si ndërlidhet me rrethanat tjera si: ofrimi i ndihmës dhe dërgimi i viktimës në spital si veprim i pendimit. Është me rëndësi të vlerësohet se çka nënkupton pendimi dhe kur ndodh dhe si ndërlidhet me veprimet që ndërmerren për ta vërtetuar pendimin e tillë.</p>

	<p>Kjo është edhe provë për hapat që kryerësi i ka ndërmarr për ta zbutur dëmin e shkaktuar nga vetë ai. Varësisht nga rrethanat e përgjithshme, kjo rrethanë mund të ketë rol të madh apo të vogël në zbutje (për më shumë informata shiko fq.110, 121-133) .</p>
<p>Kryerësi e ka dëmshpërblyer apo kompensuar viktimën</p>	<p>Duhet të ekzistoj dallim ndërmjet kohës kur është bërë kompensimi, a ka qenë menjëherë pas kryerjes së veprës, apo pas një periudhe të shkurtër, nga koha kur është bërë kompensimi nën kërcënim të dënimit.</p> <p>Kjo mund të ndikoj në peshën që i jepet kësaj rrethane gjatë përcaktimit të dënimit (për më shumë informata shiko fq.122-123).</p>
<p>Bashkëpunimi i përgjithshëm i kryerësit me gjykatën</p>	<p>Nëse merret para sysh kjo duhet të llogaritet kumulativisht si një rrethanë lehtësuese e cila përfshinë: dorëzimin vullnetar, sjelljen e mirë gjatë procesit gjyqësor, respektimin e urdhrave të gjykatës. Pështja i jepet në bazë të nivelit të bashkëpunimit të tillë. Ndoshta një shembull i dy personave që janë dorëzuar vullnetarisht, ku njëri ka pasur edhe sjellje të mirë gjatë gjykimit kurse tjetri nuk ka pasur sjellje të mirë gjatë gjykimit. Vlerësimi mund të jetë që ky i dyti e ka humbur shansin e llogaritjes së dorëzimit të tij vullnetar si rrethanë lehtësuese. Kërkohej vëmendje në rastet e dhunës në familje, duke e pasur para sysh dinamikën e përgjithshme të marrëdhënies së dhunshme. Sjellja e kryerësit si rregull në këto vepra penale nuk duhet të ketë kurrfarë peshe për zbutjen e dënimit (për më shumë informata shiko fq.121-125).</p>
<p>Pranimi i fajësisë</p>	<p>Kjo është çështje më e gjerë që ndërlidhet me disa kategorizime kur dhe si ka ndodhur, nëse është bërë ndonjë dëmshpërblim për viktimën dhe nëse ndërlidhet me rrethanat tjera si pendimi etj. (për më shumë informata shiko fq.31,42,127-129 dhe më shumë referenca tjera në tërë tekstin e Udhëzuesit).</p>
<p>Marrëveshja mbi pranimin e fajësisë</p>	<p>Ashtu si në rastet tjera, ndikimi që marrëveshja mbi pranimin e fajësisë do ta ketë në një veprë të caktuar varet nga koha kur kryerësi e ka lidhur marrëveshjen, përmbajtja e marrëveshjes, nëse është përfshirë edhe dëmshpërblimi, ndonjë bashkëpunim dhe dobia që ka dalë nga ai bashkëpunim, nëse kryerësi dhe familja e tij/saj mund të jenë në rrezik potencial për shkak të bashkëpunimit. Për më tepër për vlerën e marrëveshjes mbi</p>

	<p>pranimin e fajësisë shih shpjegimin (për më shumë informata shiko fq.13,126, 191-194 dhe më shumë referenca tjera në tërë tekstin e Udhëzuesit).</p>
<p>Kujdestar dhe mbajtës kryesor i tëafërmve të varur nga ai</p>	<p>Kjo rrethanë mund të përdoret për zbutje të dënimit varësisht nga rrethanat e rastit si “dëm anësor” që burgimi do të kishte në anëtarët e varur të familjes së kryerësit por, nuk duhet të përfshihet automatikisht vetëm për shkak se kryerësi ka familje. Kërkohet kujdes kur të vlerësohet kjo rrethanë në rastet e veprave penale të kryera në familje (shih f. 113).</p>
<p>Kalimi i kohës nga ngjarja e veprës penale</p>	<p>Duhet të ketë vlerësim thukët të kësaj rrethane . Hapi i parë është që të vlerësohet nëse kryerësi ka kontribuar në kalimin e kësaj kohe në të cilën rast kjo rrethanë do të përdorej si rrethanë rënduese. Në të kundërtën, kalimi i kohës nëse nuk bëhet me fajin e kryerësit dhe nëse shoqërohet me sjellje tjetër shembullore të kryerësit etj. do të mund të luante rol të rëndësishëm në zbutje (për më shumë informata shiko fq.135-137).</p>

Shembuj të rrethanave rënduese relevante të mundshme dhe përdorimit të tyre për ashpërsim të dënimit

Rrethanat rënduese	Sqarimi
<p>Prania e tjerëve si anëtarët e familjesapo publiku</p>	<p>Kjo rrethanë mund të ketë peshë rënduese në caktimin e dënimit. Mund të zgjerohet për ta përfshirë poshtërimin në sy të tjerëve por edhe efektin që do ta ketë në viktimën dhe tjerët. Në veçanti nëse për shembull kur sulmi ka ndodhur në mjedis shkollor, viktima do të mund të ngacmohej më tutje nga tjerët. Shembull tjetër do të ishte për shembull nëse viktima është figurë publike dhe sulmi ka ndodhur në publik (për më shumë informata shiko fq. 47,73 etj).</p>
<p>Përdorimi i armës apo sendit të barasvlershëm (për shembull përdorimi i acidit, kafshës etj.)</p>	<p>Varësisht nga mjetet që përdoren për ta kryer këtë kategori të veprës penale, kjo rrethanë mund të ketë peshë të madhe në ashpërsim. Nuk është e nevojshme që medoemos të ketë pasur armë të përfshirë. Mjete tjera të përshkruara në kolonë mund të jenë edhe më serioze (për më shumë informata shiko fq.67)</p>
<p>Qëllimi për të shkaktuar dëm më tëmadh se ai që është shkaktuar me veprën penale</p>	<p>Shembull i këtij ashpërsimi do të ishte goditja e viktimës me shkop të drunjtë apo metalik me qëllim të vrasjes apo lëndimit të rëndë të viktimës që fatmirësisht ka përfunduar me lëndim më të vogël të viktimës. Qëllimi duhet të mbajë peshë serioze në ashpërsim.</p>
<p>Kryerja e veprës penale në mënyrë mizore apo çnjerëzore/qëllimshëm shkakton dëm më të rëndë se që është i nevojshëm për kryerjen e veprës</p>	<p>Pjesa shpjeguese e udhëzimeve përmban përshkrim të zgjeruar të kësaj rrethane (për më shumë informata shiko fq.32,45, 68-75 dhe në tërë tekstin e Udhëzuesit). Kjo rrethanë është shumë e rëndësishme për ashpërsim të madh të dënimit.</p>

<p>Keqpërdorimi i pozitës së besimit</p>	<p>Rrethanë rënduese nëse kryerësi është kujdestar, infermiere apo dikush të cilit iu është besuar personi i pambrojtur. Kjo ndërlidhet me rrethanat tjera rënduese si viktima e cënueshme e moshuar etj. (për më shumë informata shiko fq. 41, 88-90).</p>
<p>Dënimet e mëparshme dhe/apo sjellja e keqe e përsëritur ndaj viktimës</p>	<p>Shumë e rëndësishme si rrethanë rënduese në veçanti nëse është bërë sjellje e njëjtë apo agresive ndajapo kundër viktimës së njëjtë. (për më shumë informata shiko fq.47,73-75,95-99 dhe në tërë tekstin e Udhëzuesit në veçanti ato që i referohen veprave në kontekst familjar).</p>
<p>Vepra penale e kryer në grup prej dy e më shumë personave/Shkalla e lartë e pjesëmarrjes së personit të dënuar</p>	<p>Një vepër e kësaj kategorie e kryer nga më shumë se një individ ka më shumë potencial për të shkaktuar dëm. Ashpërsimi varet nga cënueshmëria e viktimës, mizorisë së veprës, e kombinuar me përdorim të mjeteve për kryerjen e veprës etj. Ashtu siç merret para sysh shkalla e ulët e pjesëmarrjes së kryerësit, shkalla e lartë e pjesëmarrjes së kryerësit në veprën e kryer nga më shumë se një person duhet të adresohet si rrethanë shumë e rëndësishme rënduese (për më shumë informata shiko fq.57,64-66, 90-92 etj.)</p>

Çfarëdo prove për paramendim	Paramendimi është rrethanë serioze e ashpërsimit, në veçanti kur shoqërohet me rrethanat tjera (për më shumë informata shiko fq. 46,64-66).
Vepra e kryer kundër shumë viktimave	Rrethanë shumë e rëndësishme për ashpërsim. Duhet të merret në konsideratë edhe në rastet e dhunës në familje kur ka fëmijë në atë marrëdhënie. Fëmija, ndonëse nuk është viktimë e drejtpërdrejt e abuzimit fizik, të jetuarit në një shtëpi të dhunshme ka ndikim shumë të rëndë psikologjik mbi atë fëmijë (për më shumë informata shiko fq. 75-78, 142 dhe në tërë tekstin që i referohet viktimizimit).
Vepra e kryer ndaj viktimave të pambrojtura dhe/apo armiqësia ndaj viktimit e bazuar në aftësinë e kufizuar, shkakun se është fëmijë, i moshuar etj.	Në raste të shpeshta veprat penale kundër jetës dhe trupit kryhen kundër kategorive më të cenueshme siç është përshkruar në kolonë. Kryerësi është shumë më i pushtetshëm se sa viktima, apo ata janë dukshëm në pozitë të pabarabartë me njëri tjetrin (për më shumë informata shiko fq. 46-47,68,79-83).
Vepra e kryer ndaj personit apo grupit të personave për shkak të origjinës, kombësisë, orientimit seksual apo tjera	Armiqësia dhe veprat që si shënjestër e kanë një grup të caktuar, duhet të përfshihen gjithmonë si rrethana rënduese (për më shumë informata shiko fq. 93-96).
Efekti psikologjik mbi viktimën apofamiljen e viktimit;	Kjo rrethanë është shumë e rëndësishme në krimet shumë të rënda që shpijnë në aftësi të kufizuar të viktimit apo edhe vdekje. Sulmi i vazhdueshëm ndaj të njëjtës viktimë mund të shpie në efekte afatgjata dhe t'i bëjë viktimat të ndjehen të kërcënuara gjatë gjithë kohës. Ndikimi që krimi e ka në familje duhet të llogaritet për ashpërsimin e dënimit gjatë gjithë kohës. (për më shumë informata shiko fq.46-47, 72-83 etc).
Vendi ku është kryer vepra penale	Kjo rrethanë mund të nënkuptoj kryerjen e veprës penale në afërsi të shkollës apo vendeve tjera të ngjashme. Në veçanti gjyqtari mund ta konsideroj këtë si rrethanë shumë rënduese kur kryerësi qëllimisht e ka joshur viktimën në një vend më të largët apo zonë të izoluar ku nuk ka qasje për ndihmë mjekësore pasi që kjo mund të nënkuptoj që është përfshirë edhe paramendimi dhe përpjekja për t'i fshehur provat, andaj edhe do të shpie në dënim maksimal. (shih edhe fq.41).

7.6 Baraspeshimi i rrethanave – Vlerësimi i dënimit

Koncepti i baraspeshimit të rrethanave rënduese dhe lehtësuese është funksioni thelbësori Gjykatës në llogaritjen e dënimit përfundimtar. Koncepti, i cili drejtpërsëdrejti përshtatet në strukturën e kodit penal, është që Gjykata e përcakton nëse rrethanat rënduese apo lehtësuese janë të zbatueshme, Gjykata do ta lëvizë dënimin lartë apo poshtë brenda kufijve të përcaktuar. Porsa ti ketë vlerësuar secilën rrethanë lehtësuese dhe rënduese, ta ketë marrë para sysh ekzistimin e tyre dhe përcaktuar peshën e tyre, gjykata duhet ta përcaktoj nëse njëra rrethanë ka peshë më të madhe se tjetra dhe kështu përcaktoj dënimin. Kjo arrihet përmes përdorimit të diagramit të caktimit të dënimit në shtojcën 1.

Shtojca 1 i përcakton minimumet e dënimit të të gjitha dënimet ligjore të parapara në ligj në Kodin Penal dhe legjislacionin ekzistues. Numrat dhe shkronjat në krye dhe anash shtojcës janë vetëm për qëllim të referimit dhe nuk kanë ndikim në mënyrën e llogaritjes së dënimit. Çdo vepër penale në kod dhe legjislacion ekzistues është përfaqësuar në kolonën 1 siç është përshkruar në këtë Kod. Nuk ka dallim mes veprave të ndryshme që ekanë dënimin e njëjtë. Andaj, dënimet e numëruara në katrorin A1 prej 3 muaj deri 1 vit do të vlejnjë për SECILËN vepër që mbartë dënim prej 3 muaj deri 1 vit. Janë shtatëgrupe të dënimeve të aranzhuar në bazë të dënimeve të ngjashme. Për shembull, të gjitha dënimet që nuk kanë dënim minimal dalin në kategorinë I, dënimet minimale prej 1 viti paraqiten në kategorinë III etj. Kjo është vetëm për lehtësi të referimit.

Në krye të diagramit janë 9 kolona. Kolona 2 është për referencë të shpejtë për atë se a i plotëson kushtet ndonjë vepër e caktuar sipas CILËSDO rrethanë për dënim me kusht siç është përkufizuar dhe kufizuar në nenin 52, Kolonat 3 dhe 4 vlejnjë vetëm kur kemi zbutjenga neni 75. Përfundimisht, shumica e tabelës, kolonat 5-9 i përcaktojnë kufijtë minimal të dënimit varësisht nga sasia e zbutjes dhe ashpërsimit.

Siç është përshkruar më lartë në doracak, dënimi në kolonën 7 përbënë pikënisjen për gjykatën gjatë përcaktimit të dënimit përfundimtar dhe përbënë përafërsisht gjysmën e dënimit të përcaktuar me ligj. Mirëpo, kjo nuk është VETËM pikënisje. Ky dënim do të jetë dënimi përfundimtar në situatat ku Gjykata përcakton që nuk ka ASNJË rrethanë rënduese apo lehtësuese apo që ato e kanë anuluar njëra tjetrën, p.sh. nëse ajo janë të barabarta njëra me tjetrën.

7.6.1 Bërja e dallimit mes kategorive

Një vendim i rëndësishëm në përcaktimin e dënimit përfundimtar është vendimi se cila kolonë vlen për situatën specifike të të pandehurit. Ndonëse nuk ka ndonjë mënyrëmatematikore për ta vërë këtë përcaktim, ekzistojnë disa parime që duhet të shërbejnë si udhëzime për gjykatën. Është me rëndësi që të theksohet se informatat në fillim të secilës kolonë në shtojcën 1 janë vetëm për udhëzim të përgjithshëm. Më poshtë janë disa konsiderata dhe përshkrime që

japin më shumë hollësi për atë se çfarë rrethanash vlejnë për secilën kolonë.

Kolona 7: Pikënisja

- Nuk ka as rrethana rënduese e as lehtësuese;
- Rrethanat rënduese dhe lehtësuese janë të barabarta dhe asnjëra nuk mbizotëron mbi tjetrën (nuk ka rëndësi nëse ka sasi të madhe apo të parëndësishme – por vetëm që ato e anulojnë njëra tjetrën).

Kolona 6: Zbutja më e madhe se Ashpërsimi

- Ekzistimi i së paku një rrethane për zvogëlim të fajësisë, dëmit apo zbutje tjetër, në çfarëdo sasi, dhe nuk ka asnjë rrethanë rënduese;
- Ekzistimi i pak rrethanave rënduese së bashku me shumë rrethana lehtësuese apo zbutëse (rrethanë individuale apo rrethana të kombinuara) në sasi më të madhe se sa rrethanat rënduese.

Kolona 5: Zbutja dukshëm më e madhe se sa ashpërsimi

- Ekzistimi i së paku dy rrethanave për zvogëlim të fajësisë apo dëmit dhe asnjë/ose një rrethanë të vogël rënduese (mund të jenë dy rrethana të një lloji apo kombinim);
- Marrëveshja mbi pranimin e fajësisë apo pranimit të fajësisë në fazë të hershme të procesit pa asnjë asnjë/ose një rrethanë të vogël rënduese
- Rrethana lehtësuese të kombinuara në përgjithësi (të cilitdo lloj) në sasi shumë më të madhe se sa rrethanat rënduese.

Kolona 4: zbutja nga neni 75

- Zbutje veçanërisht e dukshme e bazuar në ekzistimin e zbutjes së dukshme në shumë rrethana dhe asnjë/ose një rrethanë të vogël rënduese;
- Ekzistimi i së paku dy rrethanave për zvogëlim të fajësisë apo dëmit (mund të jenë dy rrethana të një lloji apo kombinim) së bashku me rrethana tjera lehtësuese dhe asnjë/ose një rrethanë të vogël rënduese;
- Marrëveshja mbi pranimin e fajësisë apo pranimit të fajësisë në fazë të hershmesë bashku me rrethana lehtësuese shtesë dhe pa asnjë/ose një rrethanë të vogël rënduese;

Kolona 3: Zbutja nga neni 75

- Ekzistimi i së paku dy rrethanave për zvogëlim të fajësisë apo dëmit (mund të jenë dy rrethana të një lloji apo kombinim) së bashku me rrethana tjera të dukshme të zbutjes dhe asnjë rrethanë rënduese;
- Rrethana të jashtëzakonshme lehtësuese dhe asnjë rënduese;
- Marrëveshja mbi pranimin e fajësisë në fazën më të hershme me orientim të dëshmuar

të rehabilitimit dhe/apo bashkëpunimit pa asnjë rrethanë rënduese.

Ashpërsimi

Kolona 8: Fajësia apo dëmi më i madh

- Një rrethanë të fajësisë apo dëmit të shtuar pa asnjë apo me një rrethanë të vogël lehtësuese;
- Totali i rrethanave rënduese e tejkalon atë të rrethanave lehtësuese.

Kolona 9: Fajësia apo dëmi dukshëm më i madh.

- Dy apo më shumë rrethana të fajësisë apo dëmit të shtuar pa asnjë rrethanë lehtësuese;
- Rrethana rënduese të dukshme pas asnjë rrethanë lehtësuese
- Totali i rrethanave rënduese e tejkalon dukshëm më shumë atë të rrethanave lehtësuese

Shembull:

I pandehuri kryen grabitje nga neni 329 paragrafi 1 që mbartë dënim ligjor prej 3 deri 12 vite dhe gjobë. Shtojca 1 në tabelën V rreshti e. jep këto udhëzime:

V	Dënim i aplikueshëm	Përshtatshmëria për dënim me kusht	Zbutja maksimale e kur aplikohet neni 75	Zbutja e pjesshme kur aplikohet neni 75	Rrethanat që arsyetojnë zbutjen maksimale të dënimit brenda kufirit	Faktorët që tregojnë më shumë rrethana lehtësuese sesa rënduese	Pikënisja për matjen e dënimit (Rënd.= Leht.)	Faktorët që tregojnë më shumë rrethana rënduese sesa lehtësuese	Faktorët që arsyetojnë në dënimin maksimal brenda kufirit
a	3-12vjet	Jo	min. 1 vit	min. 2 vjet	min. 3 vjet	min. 5 vjet	7 vjet	maks. 10 vjet	maks. 12 vjet

Nëse gjykata përcakton që nuk ka as rrethana lehtësuese e as rënduese, apo që pesha e të dyjave e ka anuluar njëra tjetrën, atëherë i pandehuri do të pranoj dënimin themelor prej 7 viteve.

Nëse e shtojmë faktin që i pandehuri ka luajtur rol relativisht të vogël në grabitje, që nënkupton më pak fajësi dhe nëse nuk ka rrethana tjera lehtësuese apo rënduese, ose zbutje ose ashpërsim. Në këtë rast gjykata mund të konstatoj që kufiri i radhës më i ulët është i përshtatshëm, p.sh. E6 që e mbartë dënimin minimal prej 5 viteve. Në këtë rast gjykata është e lirë që të caktoj dënim kudo brenda kufirit prej 5 deri te niveli tjetër më i lartë që është 7 vite. Është me rëndësi që

gjkata ta mbaj në mend që dënimi NUK KA NEVOJË ME ÇDO KUSHT TË JETË 5 VITE. Ky është thjeshtë MINIMUMI që duhet të caktohet në bazë të nivelit të zbutjes. Ky rregull vlen për të gjitha nivelet e dënimeve nën pikënisjen. Andaj nëse gjykata përcakton që ka rrethana të dukshme lehtësuese, ajo mund të përcaktoj që dënimi minimal prej 3 viteve të jetë ai i duhuri (E5) dhe është e lirë që ta caktoj dënimin diku brenda kufirit prej 3 deri 5 vite. Si alternativë, në situatat kur kemi nivel të rritur të dëmit apo fajësisë, gjykata do të kalojë në kufijtë më të lartë si E8 apo E9. Në të dyja rastet gjykata e ka në dispozicion dënimin MAKSIMAL që mund të shqiptohet. Ashtu si me dënimet e nivelit të ulët, gjykata nuk kufizohet në dënimin nga ai katror por është e lirë që ta caktoj dënimin diku ndërmjet kategorive. Nëse duhet përdorur katrori E8, atëherë gjykata mund të shqiptoj dënim nga 7 vite (pikënisja) deri në 10 vite maksimum në katrorin E8. Katrori E9 lejon dënim mes 10 deri maksimum 12 vite.

7.7 Rregullimi shtesë i dënimeve – Modifikimi i llogaritjes

7.7.1 Parimi i zbutjes

Ekziston për të arsytuar që kur niveli kuantitativ dhe kualitativ i rrethanave lehtësuese e mbipeshon atë të rrethanave rënduese, kjo natyrshëm do ta vë të pandehurin në situatë jashtë normës së rasteve normale apo tipike. Andaj, gjykata duhet të jetë shumë e bindur që kjo nuk është situatë e zakonshme. Kur situata është veçanërisht e pazakonshme, kodii parasheh disa rrethana të veçanta në të cilat fundi i poshtëm i kufirit të dënimin mund të shtyhet edhe më poshtë. Neni 75 dhe 76 ia sigurojnë gjykatës kufizimet brenda së cilave mund të bëhet edhe zbutja dhe ulja e mëtutjeshme e kufijve. Duke qenë se ky lloj izbutjes mund të ketë ndikim shumë të rëndësishëm në dënimin përfundimtar, në veçanti për shkak se sasia nuk është rregulluar në proporcion me kufijtë e dënimin fillestar, Gjukata duhet të jetë shumë e kujdesshme në zbatimin e tyre dhe t'i rezervoj ato vetëm për situatat më të përshtatshme.

Neni 75 parasheh rregullimin e fundit të poshtëm të kufijve për dënimet në 3 rrethana specifike si në vijim:

1. Gjukata mund të shqiptojë dënim nën kufirin e paraparë me ligj apo të shqiptojë lloj më të butë të dënimin:
 - 1.1 kur ligji parasheh që dënimi i kryesit mund të zbutet apo të zvogëlohet;
 - 1.2 kur gjykata konstaton se ekzistojnë rrethana posaçërisht lehtësuese të cilat tregojnë seqëllimi i dënimin mund të arrihet edhe me shqiptimin e dënimin më të butë; ose
 - 1.3 në rastet kur kryesi pranon fajësinë ose ka arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë.

Nëse gjykata konstaton që ekziston njëra nga rrethanat e cekura më lartë, lejohet që ta ulë fundin e poshtëm të kufijve të dënimin deri në sasinë e specifikuar në nenin 76 të kodit. Andaj, për shembull, të gjitha dënimet që e kanë të vendosur si minimum 10 apo më shumë vite si dënim përfundimtar, mund të zbutet në minimum të ri të dënimin prej 5 viteve. Sipas paragrafit 1., dënimet me minimum prej 5 viteve dhe më pak se 10 vite, mund të akordohen edhe përtej

kufirit të poshtëm në 3 vite. Kjo strukturë shkon deri te mundësia e zëvendësimit me gjobë përdonjë dënim për të cilin me ligj nuk parashihet periudha minimale e burgimit.

7.7.1.1.Parimi i zbutjes i zbatuar dhe llogaritur sipas Shtojcës 1

Para se të diskutohet se si është përcaktuar dhe llogaritur zbatimi i zbutjes në shtojcën e udhëzimeve, duhet të trajtohen disa çështje:

✚ **E para,** nuk ka ASNJË kriter që nëse zbatohet neni 75, Gjykata duhet ta zbatoj zvogëlimin sipas nenit 76. Për më tepër, NUK kërkohet që të jepet as sasia maksimale në asnjë situatë. Është e lejueshme që Gjykata të përcaktoj se në bazë të tërësisë së rrethanave dhe duke e marr para sysh rastin specifik, nuk do të jepet zbutja e dënimit andaj edhe nuk është bërë asnjë akordim. Gjithashtu është e lejueshme që gjykata të përcaktoj që zbutja në maksimum nuk është e përshtatshme –por vetëm e një pjese.

Për shembull, i pandehuri është fajtor për kryerjen e veprës penale që mbartë kufijtëe dënimit prej 3-5 vite (Kategoria V dënimi b). Nëse i pandehuri eventualisht e pranon fajësinë, atëherë gjykata mund ta merr në konsideratë zbutjen ashtu siç vlen në nenin 75 paragrafin 1.3. Sipas nenit 76, gjykata mund ta ulë dënimin në një vit.Siç është sqaruar më lartë, gjykata NUK ËSHTË E OBLIGUAR që ta zbatoj zbutjen nga neni 75 – kjo është thjeshtë një mundësi. Gjithashtu, gjykata nuk është e obliguarqë të pandehurit t’ia shqiptoj dënimin prej 1 viti sipas nenit 76. Nëse për shembull i pandehuri e pranon fajësinë në momentin e fundit të mundshëm, gjykata mund të përcaktoj që ndonëse mund të zbatohet zbutja, ajo nuk është e obligueshme, apo e obligueshme në më pak se gjysmën e dënimit maksimal.

✚ **E dyta,** Gjykata duhet “veçanërisht” ta shqyrtoj maksimumin dhe minimumin e dënimit të paraparë në kod. Kjo dispozitë është paraparë për shkak të akordimit të qasjes së gjykatës në frymën e numrit të madh të dënimeve që përdoren në kod dhe në veçanti për shkak se maksimumi i tyre mund të jetë shumë i larmishëm. Nëse zbutja e dënimit zbatohet pro forma në çdo dënim, kjo bie në nenin 75 dhe mund të ketë ndikim shumë disproporcional. Le ta marrim për shembull dënimin 3-5 vite. Nëse zbutet minimumi i ri i mundshëm është një vit. i njëjti zvogëlim është në dispozicion edhe për dënimin me së paku 4 vite. Në shkallën e parë, përfitimimaksimal i mundshëm nga zvogëlimi në një vit është 4 vite (nga maksimumi prej 5 viteve). Në rastin e së paku 4 viteve, që nuk ka maksimum (25 vite sipas kodit), zvogëlimi i mundshëm në dispozicion është 24 vite.

Kolonat 4 dhe 5 i dedikohen atyre situatave në të cilat gjykata ka përcaktuar që zbutja nganeni 75 është në dispozicion dhe në fakt vlen për atë situatë. Kur ka hapësirë të mjaftueshme për të, Shtojca 1 e ndanë rrethanat lehtësuese në dy kolona të ndara. Kolona 4 i dedikohet vetëm situatave ku mund të jepet zbutja maksimale. Kolona 5 është e rezervuar për situatat ku mund të zbatohet zbutja mirëpo nuk lejohet zbutja maksimale.

7.7.1.2 Përcaktimi i zbatueshmërisë së parimeve të zbutjes

Siç është përshkruar më lart, janë tri situata në të cilat Gjykata mund ta zbatoj zbutjen e paraparë në nenin 76. Mirëpo, për t'i sistematizuar dhe zbatuar ato proporcionalisht, ekzistojnë disa kufizime që gjykata duhet t'i ketë para sysh.

Situata 1: Neni 75 paragrafi 1.1 parasheh që Gjykata mund ta merr para sysh zbutjen kur ligji në mënyrë specifike parasheh që dënimi mund të zbutet apo zvogëlohet. Ndonëse kjonuk shfaqet në shumë vepra specifike brenda kodit penal, nuk ka ndonjë aplikim në Kapitullin II për përgjegjësinë penale për veprat që për pak sa nuk përbëjnë përjashtime në raste të veçanta. Këtu gjykata mund ta jap zbutjen sipas dispozitave të duhura në nenit 13 Nevoja Ekstreme, nenit 14 dhuna ose kanosja, nenit 15 veprat e kryera nën shtrëngim, nenit 18 paaftësia mendore dhe aftësia e zvogëluar mendore, nenin 26 lajthimi juridik, nenin 33 ndihma, dhe nenin 34 bashkimi kriminal. Gjykata duhet të konstatoj që kriteret specifike të numëruara në dispozitë janë plotësuar dhe pastaj përcakton nëse duhet të caktohet zbutja.

Situata 2: Neni 75, paragrafi 1.2 është konstatim afirmativ i rrethanave “posaçërisht” lehtësuese që tregojnë se qëllimi i dënimit do të arrihet me dënim më të ulët. Derisa kjo nuk është përkufizuar qartë, ajo tregon për një situatë që është mjaftë jashtë normës aponë nivel të një kryerësi mesatar. Këtu gjykata duhet të jetë mjaftë e qartë se cilat janë qëllimet e dënimit në lidhje me kryerësin dhe veçantitë e kryerësit, apo situata e tyre i tregon që ato qëllime do të realizohen me dënim më të ulët. Kryerësi, për shembull mund të ketë shfaqur veprime të rëndësishme të pendimit dhe përpjekje për t'i bërë korrigjime viktimës që janë jashtë normës së asaj që mund të konsiderohet normale. Në këto situata, Gjykata lejohet që ta zbatoj zbutjen dhe t'i rregulloj kufijtë përshtatshmërisht. Gjykata pastaj duhet t'i shqyrtoj rrethanat në lidhje me kufijtë e ri. Në përgjithësi, gjykata duhet t'ia tregoj aplikimin e zbutjes sipas këtij neni nëse rrethanat rënduese i mbipeshojnë ato lehtësuese.

Situata 3: Sipas nenit 75, paragrafit 1.3 mundësia e tretë i ka dy komponentë:

- Komponenti i parë është që gjykata mund t'i rregulloj kufijtë kurdo që kryerësi pranon fajësinë në gjykatë pa pasur marrëveshje mbi pranimin e fajësisë.
- E dyta është kur ka marrëveshje mbi pranimin e fajësisë.

Në situatën e parë, vendimi i Gjykatës duhet të akordohet me kohën e pranimit të fajësisë. Zbutja nuk është në dispozicion për të pandehurin thjeshtë sepse diku gjatë procesit ai vendos që ta pranoj fajësinë. Përfitimi substancial që jepet për pranim të fajësisë është i bazuar në kursimin e kostos për shoqërinë për sa i përket kohës, parave dhe shpenzimeve emocionale që ndërliken me dëshminë dhe viktimizimin. Këto përfitime zhduken dukshëm me fillimin e gjykimit. Andaj, zbutja sipas nenit 75 nuk duhet të jetë më në dispozicion kur të filloj gjykimi. Nëse kryerësi e pranon fajësinë me kohë dhe Gjykata konstaton që zbutja është e përshtatshme, ashtu si me dy kategorinë e para, gjykata prapëseprapë duhet të kaloj nëpër procesin e vlerësimit për ta përcaktuar se cilët duhet të jenë kufijtë përfundimtar dhe nëse zbutja e mëtutjeshme është në dispozicion. Ndonëse kodi parasheh që pranimi i fajësisë mund të jetë i

mjaftueshëm për të zbutur dënimin, gjuha e mëtutjeshme në kod që kërkon marrjen e mendimeve të të gjitha palëve të interesit, tregon anim të fortë kundër zbatimit të zbutjes nga neni 76 kur ka kundërshtime. Kjo ka kuptim kur e kemi para sysh që pranimi i fajësisë (jo marrëveshja mbi pranimin e fajësisë) është thjeshtë njëra nga 13 mundësitë e zbutjes të cekura në kod. Duke e pasur para sysh që arsyeja kryesore për zbutje e bazuar në pranim të fajësisë është kursimi i burimeve, kundërshtimi nga palët i bazuar në të njëjtin arsyetim tregon që ekzistojnë konsiderata tjera që e mënjanojnë atë përfitim të dukshëm për të pandehurin. Andaj, kundërshtimi nga ndonjëra palë, në bazë të dyshimit të arsyeshëm, apo konstatimit të ndonjë rrethane rënduese, duhet të eliminoj caktimin automatik të zbutjes nga neni 76 thjeshtë në bazë të pranimit të fajësisë dhe të kërkoj konstatimin e zbutjes së jashtëzakonshme në pajtim me udhëzimet. Se a do të konsiderohen argumentet e palëve sibatë e arsyeshme për refuzim, kjo qartazi i lihet gjykatës për ta shqyrtuar.

Në situatën e dytë sipas nenit 75 paragrafit 1.3, zbutja është në dispozicion për kryerësinin cili e ka bërë marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë me prokurorin. Ndonëse marrëveshjet mbi pranimin e fajësisë dhe dënimin janë diskutuar në më shumë hollësi mëvonë, kjo dispozitë në esencë ia lejon prokurorit që t'i bëjë negociatat për marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë me kufij të zbutur në dispozicion. Andaj në një situatë të duhur, prokurori është në gjendje që të ofroj kufijtë e plotë të dënimeve të zbutura që janë në dispozicion sipas ligjit për Gjykatën. Kjo është e ndarë dhe veçuar nga miratimi përfundimtar nga gjykata i dënimit të tillë. Kjo dispozitë nuk e lidh gjykatën për ta pranuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë nëse e konstaton që dënimi i dakorduar nuk është i lejuar.

7.7.1.3 Veprat e narkotikëve

Në përgjithësi veprat e narkotikëve duhet t'i nënshtrohen akuzave të duhura nga prokurorët në bazë të asaj se a është poseduar, synuar për shpërndarje apo është shpërndarë. Kodi parasheh disa ligje në bazë të së cilave prokurori mund të veproj, ku secili parasheh nivel më të lartë të dënimit. Mirëpo, praktika dhe studimet ndërkombëtare kanë treguar që një komponentë e rëndësishme e këtij dallimi është e bazuar në sasinë e narkotikëve. Në përgjithësi, me rritjen e sasisë së poseduar, rriten edhe gjasat që narkotikët të jenë destinuar për shpërndarje dhe që kryerësi përbënë kërcënim më të madh për shoqërinë. Ndonëse shumë vepra të narkotikëve nga kapitulli 23 i KP lejohet që t'i nënshtrohen zbutjes sipas nenit 7 dhe 76, duhet të zbatohen udhëzimet në vijim:

- Substancat apo preparatet e shpallura me ligj si droga narkotike, substanca psikotrope apo analoge në sasi **më të madhe se 5 gramë** nuk duhet t'i nënshtrohen zbutjes nëse kanë qenë pjesë të akuzave sipas neneve 273, 274, 275.
- Nëse akuzat janë bërë për vepër penale sipas nenit 281, 1.1-1.8, dhe sasia e drogës së përfshirë është **më e madhe se 3 gramë** vepra nuk duhet t'i nënshtrohet zbutjes.
- Nëse akuza është bërë për vepër penale sipas nenit 281, 1.9, dhe sasia e drogës së përfshirë është **më e madhe se 15 gramë** vepra nuk duhet t'i nënshtrohet zbutjes.

7.7.2 Lirimi nga dënimi

Neni 77 dhe 78 ia lejojnë gjykatës që tërësisht ta lirojnë kryerësin nga dënimi në dy situata. Sipas nenit 77, Gjykata lejohet që ta heq dënimin kur kodi në mënyrë specifike e lejon lirimin nga dënimi pavarësisht kufizimit për zbutje të paraparë në nenin 76. Ky lloj ilirimit nga dënimi ndodh në dy situata. E para është lirimi nga dënimi për veprë të veçantë penale kur plotësohen kushtet e duhura. Gjykata do të duhet ta vlerësoj veprën penale specifike sipas kodit për ta përcaktuar zbatimin e nenit 77. E dyta, çdo veprë e kryer në forma të caktuara të përgjegjësisë së modifikuar penale apo bashkëpunimit ka potencial që të kualifikohet për lirim nga përgjegjësia. Këto përfshijnë nenin 12 mbrojtjete nevojshme, nenin 13 nevojën ekstreme, nenin 29 tentativën e papërshtatshme, nenin 30 heqjen dorë vullnetare dhe nenin 34 bashkimi kriminal.

Lirimi nga dënimi nga neni 78 është specifik për veprat penale të kryera nga pakujdesia dhe me përmbushjen e dy kriterëve. E para, kryerësi duhet të preket aq rëndë nga pasojat sa që dënimi është i panevojshëm për arritjen e qëllimit të tij. E dyta, kryerësi duhet menjëherë të bëjë përpjekje për eliminimin dhe zvogëlimin e pasojës dhe ta kompensojë dëmin e shkaktuar tërësisht apo në masë të madhe. Kriteri i parë do të kërkoj vlerësim të thukët të ndikimit të kryerësit. Ky nuk është vlerësim objektiv por subjektiv dhe që ndërlidhet drejtpërsëdrejti me kryerësin e caktuar. Kriteri i dytë kërkon veprim të menjëhershëm për tu kualifikuar për zbutje. Kjo natyrisht që do të jetë element shumë i rëndësishëm për të përcaktuar nëse kriteri i parë është plotësuar, pasi që përpjekjet për zbutje do të ndikojnë në kryerësin. Mirëpo, nuk kërkohet që këto përpjekje të kenë qenë të suksesshme. Ajo që kërkohet është tentative objektive në masë të arsyeshme për ta bërë këtë. Përfundimisht, duhet të ketë një lloj të kompensimit. Duke qenë se aftësia për të paguar mund të jetë rrethanë që e përcakton lirimin nga dënimi, gjykata duhet ta kushtëzoj këtë konstatim në pagesën e menjëhershme. Nëse kryerësi është në gjendje dhe ka vullnet për të bërë këtë, me kalimin e kohës Gjykata duhet ta liroj nga dënimi pas monitorimit të pagesës së suksesshme.

7.7.3 Ashpërsimi për recidivizëm të shumëfishtë

Neni 79 e ofron mundësinë e vetme në Kod për të shtuar apo rregulluar nga lartë dënimin maksimal të paraparë me ligj për një veprë të caktuar. Në rastet ku dënimi me burgim të përjetshëm nuk është përfshirë, Gjykata lejohet që ta shtoj ½ e dënimin maksimal për veprën si dënim shtesë. Mirëpo, veprat e mëparshme të kryerësit duhet t'i plotësojnë disa kualifikime:

- ❖ Dy vepra të mëparshme që
 - Kanë rezultuar në një vit ose më shumë burgim dhe
 - Kur janë kryer në nivel ndërkombëtar
- ❖ Më pak se 5 vite kanë kaluar nga përfundimi i dënimin të mëparshëm

Porsa Gjykata të përcaktoj se kryerësi i plotëson këto rrethana, kërkohet që ta shqyrtoj në veçanti pranimin e fajësisë, motivet, rrethanat dhe ngjashmërinë e veprave të mëparshme, si dhe nevojën për shqiptim të dënimin për përmbushjen e qëllimeve të dënimin. Këto konsiderata janë relevante por nuk janë absolute për sa i përket kriterëve. Prandaj, derisa është sigurisht relevante që veprat penale të kenë qenë të ngjashme për kah natyra etj. Nuk kërkohet që ato të

janë të ngjashme para se gjykata t'i ashpërsoj kufijtë e dënimit. Samë të ngjashme për nga natyra, aq më shumë gjykata duhet ta merr para sysh ashpërsimin maksimal të mundshëm pasi që kjo do të nënkuptoj gjithashtu që dënimet paraprake përtë njëjtën vepër kanë dështuar që ta rehabilitojnë apo parandalojnë kryerësin nga kryerja eserishme e veprës dhe qëllimet e dënimit do të akordohen për qëllim të mbrojtjes së shoqërisë nga kryerësi.

7.7.4 Dënimi i veprave penale bashkekzistuese

Pasi që ndërlikueshmëria e procesit të caktimit të dënimit rritet substancialisht kur kemi disa vepra të përfshira apo ashpërsim të bazuar në recidivizëm, është shumë vështirë që procesi të paraqitet në format të diagramit. Mirëpo, porsa gjykata ta ketë vlerësuar në mënyrë gjithëpërfshirëse zbutjen dhe ashpërsimin, është thjeshtë çështje e zbatimit të procesit të përshkruar më lartë për secilën vepër dhe e llogaritjes së dënimit. Kufiri përfundimtar në dispozicion, për të qenë në pajtim me dispozitat e nenit 80, është çështje mbledhjes së dënimit si maksimum dhe përcaktimit të minimumit.

Për shembull, i pandehuri kryen tri vepra, dy kanë kufij prej 3-5 vite dhe njëra kufij 1-4 vite. Nëse gjykata e dënon të pandehurin me dy dënime nga 4 vite dhe një dënim 3 vite, neni 80 kërkon që dënimi përfundimtar të jetë më i lartë se secili dënim individual (p.sh. më shumë se 4 vite) por më e ulët se shumta e totalit të dënimeve (p.sh. 11 vite). Fatkeqësisht kodi nuk jep shumë udhëzime përtej kësaj për të përcaktuar, se cili duhet të jetë dënimi përfundimtar për shembullin e dhënë më lart.

Një çështje e rëndësishme për ta cekur është supozimi që vlera e ashpërsimit/zbutjes ka qenë e njëjtë për të gjitha veprat. Derisa në shumë situata kjo mund të jetë e vërtetë, nuk endalon gjykatën që të konstatoj se vlera apo rrethana të ndryshme vlejné për veprat e ndryshme. Gjukata mund të konstatoj që kryerësi, për shembull, është penduar shumë përkryerjen e njëres vepër, por jo për tjetrën. Njëra viktimë mund të jetë viktimë e cenueshme derisa tjetra jo. Shembulli thjeshtë e shtjellon procesin. Gjukata duhet ta vlerësoj secilën vepër individualisht.

Konsiderata shtesë që mund të përdoren nga gjykata për të rregulluar dënimin e bashkuar përfundimtar më lartë apo më poshtë dënimit të supozuar mund të përfshijnë:

- Kur secili dënim individualisht bie në spektrin e kufijve në dispozicion. Nëse ka zbutje substanciale për secilin dënim individual, dënimi përfundimtar duhet gjithashtu të përfitoj nga zbutja substanciale dhe e kundërta.
- Prevalenca e sjelljes penale në komunitet dhe nevoja për t'i parandaluar kryerësit në të ardhmen.
- Nëse secila vepër ka përfshirë edhe viktimë tjetër përveç shtetit.
- Serioziteti i veprave penale në lidhje me njëra tjetrën (kundërvajtjet mund të kenë më pak nevojë për t'u reflektuar në dënimin unik se veprat e rënda).

- Ngjashmëria e veprave me njëra tjetrën në bazë të elementeve të tyre.
- Gjasat për rehabilitim dhe riintegrim përball nevojës për ta mbrojtur shoqërinë nga kryerësi.
- A ka reflektim të mjaftueshëm për secilën vepër penale në dënimin përfundimtar ashtu që të mos ketë vepra penale të “pandëshkueshme” apoviktima të që nuk pranojnë drejtësi.

7.8 Vendimet e trupit gjykues për caktimin e dënimit

Një konsideratë tjetër e rëndësishme për gjykatën është se si ta përcaktoj dënimin përfundimtar kur kemi trup gjykues. Metoda e rekomanduar është që të përcaktohet vlera mesatare e dëmit nga të gjitha vendimet përfundimtare për ata gjyqtarë që e konsiderojnë të pandehurin fajtor për veprën penale. Çfarëdo konstatimi i pafajësisë duhet të eliminohet nga llogaritje përfundimtare. Sugjerohet që çdo gjyqtar në mënyrë të pavarur t'i vlerësoj rrethanat në gjykatë dhe ta përcaktoj vlerën përfundimtare për ashpërsim dhe zbutje.

Në situatat kur njëri gjyqtar del me rezultat dukshëm më të ndryshëm të caktimit të dënimit në krahasim me tjerët, duhet të ketë një hap shtesë në të cilin gjyqtarët konsultohen me njëri tjetrin për atë se cilat rrethana janë marrë në konsideratë apo janë konstatuar/nuk janë konstatuar për zbutje/ashpërsim. Kjo duhet të ndodhë në çdo situatëku njëri anëtar i kolegjit del me dënim që është substancialisht i ndryshëm nga ai i gjyqtarëve tjerë. Kjo bëhet me qëllim që të sigurohemi se gjykata nuk e ka lënë anash rastësisht apo nuk e ka marrë në konsideratë një rrethanë. Është theksuar që ndonëse ky konsultim shtesë mund të ketë ndikim përfundimtar në ndryshimin e mendimit të gjyqtarit; nuk duhet të konsiderohet si qëllim kryesor i konsultimit. Ai bëhet thjeshtë për ta mbrojtur vendimin në nivel të apelit. Nëse vendimi mbetet i njëjtë, prapë do të merret mesatarja e secilit dënim.

KAPITULLI VIII

ZBATIMI I DËNIMEVE ALTERNATIVE

8.1 Çështje të përgjithshme


Porsa gjykata të arrijë në hapin 5 në shumicën e rasteve do të arrijë në kohëzgjatjen përfundimtare të burgimit apo dënimit. Hapi tjetër është që të përcaktohet mënyra në të cilën do të mbahet dënimi dhe nëse mund të zëvendësohet me një formë tjetër. Neni 49 i parasheh mundësitë për dënime alternative. Qortimi gjyqësor është përfshirë në këtë diskutim si zëvendësim për burgun efektiv, ndonëse për vepra relativisht më të vogla.

8.2 Dënimet me kusht

Dënimet me kusht janë ndoshta forma më së shpeshti e përdorur e dënimeve alternative dhe kodi e përvijon procesin dhe procedurën në nenin 50-59. Dënimi me kusht mund të jetë shumë i dobishëm dhe t'i ruaj të drejtat e njeriut kur përdoret në situata të duhura, pormund të bëhet edhe kundërthënës sepse mund të duket pothuaj si lirim i plotë i kryerësit nga të gjitha përgjegjësitë pa pasoja. E para dhe më e rëndësishmja, gjykata duhet të ofrojarsyetim për zëvendësimin që është i thukët dhe i plotëson dispozitat e ligjit – në veçanti që zëvendësimi do t'i plotësoj njëllloj qëllimet e dënimit. Kriteret e nenit 50 në mënyrë të qartë e theksojnë që dënimi me kusht është rezervuar për vepra që nuk janë të ashpra dhe pastaj kërcënimi i dënimit të jetë i mjaftueshëm për ta parandaluar kryerësin nga kryerja e një veprë tjetër. Historiku, mentaliteti dhe qëndrimet e kryerësit janë të një rëndësie të veçantë në procesin e vlerësimit. Nëse gjykata nuk i adreson në mënyrë të qartë obligimet saj nga neni 50 dhe neni 52 gjykata shqyrtuese duhet automatikisht ta kthej vendimin nëgjykatën më të ulët.

Mënyra e funksionimit të dënimit me kusht është që Gjukata e përcakton dënimin ekzekutimi i së cilit pezullohet për një periudhë kohore, me kusht që kryerësi të moskryej vepër tjetër penale dhe i plotëson e respekton të gjitha kushtet e caktuara nga Gjukata. Shkelja e kushtit mund të shpie në ekzekutim të menjëhershëm të dënimit ashtu siç është përcaktuar tashmë. Ihtarët e dënimit me kusht besojnë që dënimi absolut iparacaktuar është parandalues më efektiv dhe motivues se sa ai i pacaktuar që ende ka mundësi për përpjekje të zbutjes nga kryerësi. Pavarësisht kësaj, efektshmëria e dënimeve me kusht është drejtpërsëdrejti e lidhur me vullnetin e gjykatës për t'i revokuar ato dhe caktimin e kushteve të duhura shtesë.

h



Neni 81 e paraqet kornizën dhe përshtatshmërinë që një dënim të pezullohet. Ekzistojnë dy udhëzime që e kontrollojnë pezullimin. E para, çdo vepër penale që mund të dënohet me më së shumti 5 vite apo më pak mund të pezullohet. Së dyti çdo vepër penale që mund të dënohet me burgim prej më së shumti 10 vite apo më pak mund të pezullohet, mirëpo vetëm nëse vlejné dispozitat për zbutje. Nga këto dy udhëzime mund të konkludohet që vepra penale që mund të dënohet me më shumë se 10 vite nuk mund të pezullohet.

Kolona 3 e shtojcës 1 parasheh referencë të shpejtë për gjykatën që ajo fillimisht ta përcaktoj nëse dënimi penal është i përshtatshëm për pezullim. Gjykata duhet ta mbajë në mend që vetëm pse dënimi ka qenë fillimisht i përshtatshëm për dënim me kusht, nuk nënkupton që gjykata ka të drejtë që automatikisht ta përdor këtë alternativë. Ajo duhet të angazhohet në vlerësim dhe përfundimisht të vijë në një dënim brenda kufijve të lejuar prej 2 vite apo më pak.

8.2.1 Pezullimi i dënimit në rastet me maksimum prej 5 viteve

Nëse gjykata ballafaqohet me një apo më shumë vepra prej më së shumti pesë viteve, ajo duhet ta vlerësoj secilën vepër në bazë të meritave të saj siç është cekur në këtë udhëzues dhe të arrijë në dënim brenda kufijve të parapara në Shtojcën 1.

Nëse kryerësi është fajtor për një vepër të vetme dhe dënimi i llogaritur është dy vite apo më pak, ajo mund ta pezulloj dënimin sipas paragrafit 3 të nenit 52. Mirëpo, gjykataduhet të konstatoj gjithashtu që në bazë të rrethanave të cekura në paragrafin 4, i cili përqendrohet në sjelljen e veçantë të kryerësit në të kaluarën si dhe rrethanat personale, kandidati është i përshtatshëm për dënim me kusht dhe qëllimet e dënimit janë përmbushur. Nëse dënimi është

më i madh se dy vite, gjykata nuk mund ta pezulloj dënimin. Për shembull, kryerësi është dënuar për vepër penale që dënohet me burgim prej 1-5 vite. Sipas Shtojcën 1, kjo i bartë kufijtë supozues 3 vite. Në këtë moment nëse nuk ka zbutje të mjaftueshme për të kaluar në kolonën 5, Gjukata nuk mund ta shqiptoj dënimin me kusht për shkak se kohëzgjatja e supozuar është me e gjatë se 2 vite. Vetëm dënimet që bartin dënim me më së shumti 5 vite si mundësi, e kanë afatin e supozuar të tillë që nuk mund të pezullohet dhe kërkojnë rregullim me ndihmën e rrethanave lehtësuese.

Derisa i njëjti kriter vlen edhe kur kemi disa dënime për vepra prej më pak se 5 vite, Gjukata duhet të angazhohet në procesin e mbledhjes siç është paraparë në nenin 80 (të përshkruar në hapin 4 më lart). Gjukata duhet ta përcaktoj dënimin individual në bazë të udhëzimeve për secilën vepër penale dhe pastaj t'i mbledh ato në dënimin unik përfundimtar. Nëse është e pamundshme që ato të mbledhen siç është përkufizuar nënenin 80 pa arritur në dënim më të lartë se 2 vite, Gjukata nuk mund ta pezulloj këtë dënim.

Dënimi me kusht nuk duhet të merret parasysh kur kemi shkelje të urdhrit mbrojtës, në veçanti kur akti që e përbën shkeljen është i natyrës së dhunshme. Kryerësi në këto raste tashmë ka shfaqur mosbindje ndaj urdhrave të gjykatës duke mos e respektuar Urdhrin Mbrojtës.

8.2.2 Pezullimi i dënimit në rastet me maksimum prej 10 viteve

Ndryshe nga dënimet me kusht për veprat prej më pak se 5 vite, veprat që bartin dënim të mundshëm prej me pak së 10 vite e kërkojnë edhe një hap shtesë. Para se të mund të merren para sysh për dënim me kusht, ato duhet ta kalojnë se pari procesin e zbutjes. Kjo nënkupton që ato duhet ta plotësojnë njërin nga kualifikimet nga neni 75. Pra, 1.kur ligji parasheh që dënimi i kryesit mund të zbutet apo të zvogëlohet, 2. kur ekzistojnë rrethana posaçërisht lehtësuese; ose (3) kur kryesi pranon fajësinë (ose ka arritur marrëveshje mbi pranimin e fajësisë). Procesi i zbutjes është përshkruar në më shumë hollësi në hapin 4 tek dispozitat për rregullime shtesë të dënimeve. Mirëpo, ky është vetëm hap fillestar i kualifikimit, nuk i jep menjëherë të drejt gjykatës që të shqiptoj dënimin me kusht. Gjukata duhet të kaloj nëpër procesin e vlerësimit të rrethanave rënduese dhe lehtësuese dhe në mënyrë të pavarur të arrijë tek kufijtë e dënimit që e lejojnë dënimin prej 2 ose më pak viteve siç kërkohet me nenin 52. Gjukata duhet gjithashtu të arrijë në përfundim qënë bazë të rrethanave të numëruara në paragrafin 4, i cili përqendrohet në sjelljen e kaluar të veçantë të kryerësit si dhe rrethanat personale, kandidati është i përshtatshëm për shqiptimin e dënimit me kusht dhe se janë përmbushur qëllimet e dënimit.

8.2.3 Obligimet dhe kushtet e dënimeve me kusht

Për shkak se qëllimi kryesor i dënimit me kusht është shmangia e burgut efektiv kur kërcënim i dënimit është i mjaftueshëm, Gjukata duhet të sigurohet që kryerësit t'i jepen mjetet e duhura për të shmangur kryerjen e serishme të veprave penale dhe për t'u riintegruar në komunitet.

Duke qenë se dënimet me kusht në përgjithësi vlejné për situatatku sjellja nuk është normale, zakonisht do të ketë diçka që ka kontribuar në motivimin për ato veprime. Dënimet me kusht me asnjë kusht tjetër përveç ndalimit të përgjithshëm për kryerjen e serishme të veprave duhet të ndodhe sa më rrallë dhe rezervohet vetëm për situatat me të vogla ku ka indikacione të forta të pendimit, dëmshpërblimit të ndonjë viktime dhe bashkëpunim me gjykatën dhe zbatuesit e ligjit. Në esencë nuk ka qëllim apomjet të dukshëm në dispozicion për gjykatën. Gjykatat këshillohen fuqimisht që dënimet me kusht pa kushte të kontrollohen me kujdes dhe mungesa e kushteve duhet të shpjegohet në mënyrë të thukët. Përfundimisht, duke i pasur para sysh rrethanat lehtësuese dhe të verifikueshme, dënimi me kusht që nuk ka kushte DUHET të revokohet në rastet kur shkelet.

Gjykata duhet me kujdes ta vlerësoj situatën dhe caktoj obligime dhe kushte për dënimin të cilat e adresojné sjelljen. Kodi i parasheh 15 kushte të mundshme në nenin 59 me mundësi të mbikëqyrjes nga shërbimi sprovues. Përveç këtyre dispozitave, dënimet plotësuese nga neni 62 janë në dispozicion dhe duhet gjithmonë të merren parasysh përveç kushteve të dënimin me kusht. Këto janë trajtuar në më shumë hollësi në Hapin 6 më poshtë.

1.1.1.1. mjekimi ose rehabilitimi në entin e kujdesit shëndetësor;

1.1.1.2. nënshtrimi në programin e trajtimit mjekësor ose të rehabilitimit;

1.1.1.3. vizita te psikologu ose te këshilluesit e tjerë dhe veprimi në pajtim merkomandimet e tyre;

Kushtet 1.1-1.3 duhet gjithmonë t'i caktohen situatave ku ka probleme të shëndetitmendor apo kushte mjekësore si motivim për kryerjen e veprës penale. 1.3 duhet të përdoret me maturi nga gjykata nëse ka indikacione që shëndeti mendor mund të jetë faktor kontribuues por nuk ka diagnozë mjekësore në kohën e dënimin.

1.1 aftësimi profesional në një profesion të caktuar;

1.2 kryerja e aktiviteteve punuese;

1.3 shfrytëzimi i pagës dhe i të ardhurave apo pasurisë tjetër për përmbushjen edetyrimeve familjare;

Çfarëdo vepra e vogël që përfshin dështimin e ofrimit të ndonjë forme të mbështetjes financiare duhet të ketë dispozita për përmbushje të pagesave. Kjo mund të përfshijë shitjen e pronës për përmbushjen e obligimit përderisa jeta e kryerësit nuk shkatërrohet. Nëse ka indikacione që vepra është motivuar nga mungesa e mjeteve financiare apo edhe mërzitja, Gjykata duhet që t'i caktoj kushtet që kërkojnë nga kryerësi përvetësimin e shkathtësive për t'u bërë pjesëtar produktiv i shoqërisë.

1.4 mos ndërrimi i vendbanimit pa informuar shërbimin sprovues;

Nëse përdoret mbikëqyrja nga shërbimi sprovues, kjo duhet të jetë dispozitë e detyrueshme. Përveç kësaj, kjo dispozitë duhet gjithmonë të përdoret nëse ka indikacione që kryerësi ka mjete/aftësi për tu zhvendosur. Qëllimi për tu bartur pa arsytim është tregues i mundshëm i zhvendosjes për të vazhduar sjelljen e keqe dhe mund të parandalohet duke kërkuar që të bëjë njoftim për këtë.

1.5 heqja dorë nga përdorimi i alkoolit apo i drogës;

Çdo indikacion i abuzimit të drogës/alkoolit, qoftë drejtpërsëdrejti i pranishëm në kohë kryerjes së veprës penale apo jo, duhet të shoqërohet me kufizim të përdorimit përveç ndonjë forme të vlerësimit si në pikën 1.3. Nëse varësia nga droga apo alkooli ka qenë motivi kryesor për kryerjen e veprës penale, në nenin 57 kërkohet trajtimi i detyrueshëm i rehabilitimit.

1.6 heqja dorë nga frekuentimi i vendeve apo lokaleve të caktuara;

1.7 heqja dorë nga shoqërimi ose kontaktimi me persona të caktuar;

Nëse vepra penale nuk ka ndodhur rastësisht por është përqendruar më shumë në personin a vendin e caktuar, Gjykata duhet gjithmonë ta përfshijë kufizimin e frekuentimit të vendit apo personit të caktuar. Këto duhet të përdoren në veçanti në situatat familjare ku vepra penale është drejtpërsëdrejti e lidhur me kontaktin me personine caktuar. Duke e pasur para sysh që vetë natyra e marrëdhënies së dhunës në familje është që ta përjetësoj situatën përmes përsëritjes, ka pak **gjasa** që një suspendim i thjeshtë të jetë efektiv pa kufizime. Gjykata duhet të jetë shumë specifike në emërimin/përshkrimin e personave dhe vendeve që kryerësi duhet t'i shmang, përfshirë ndonjë anëtarë të familjes së gjerë. Shkelja e këtyre dispozitave duhet të jetë bazë e menjëhershme për revokim të dënimit me kusht. Duhet të caktohet edhe monitorimi nga shërbimi sprovues.

1.8 heqja dorë nga mbajtja e çfarëdo lloji të armëve;

Çdo vepër që ndërlihet me posedimin e armës apo përdorimin e saj për ta lënduar apo frikësuar dikë, duhet të pezullohet me kufizime për bartjen apo posedimin e armëve. Kufizimi duhet të jetë i përgjithshëm për nga natyra e jo thjeshtë i kufizuar në një armë të caktuar që është përdorur. Kjo dispozitë duhet ta përfshijë edhe posedimin përveç bartjes së armës.

Nëse ka indikacione që ekziston komponenti i dhunës në familje në vepër penale, kufizimet në qasje/posedim të armës duhet të përfshihen, pavarësisht se a ndërlihet posedimi drejtpërsëdrejti me vetë veprën penale apo jo. Vetë posedimi si i tillë mund të jetë shtrëngim dhe frikësim për viktimën. Hulumtimet shkencore kanë treguar që prania e armës së zjarrit në posedim të kryerësit të dhunës në familje, e rritë dukshëm rrezikun e lëndimit të rëndë trupor apo vdekjen e viktimës, fëmijëve dhe tjerëve. Si rezultat, bëhet shumë e rëndësishme për gjykatën që të bëjë pyetje dhe të urdhëroj konfiskimin e çfarëdoarme të zjarrit të qasshme për kryerësin.

Kjo është e lejueshme edhe kur abuzuesi ka posedim të ligjshëm të armës.¹⁷¹ Prania e armës në shtëpi është shpesh komponentë kritikepër krijimin e frikës tek viktima përmes gjendjes së vazhdueshme të rrezikut. Arma mund të jetë përdorur në ndonjë incident të mëparshëm qoftë të dhunës së vërtetë apo kërcënimit, dhe prania e saj e vazhdueshme e nënkupton mundësinë e vazhdueshme që sjellja do të riprodukohet. Ajo gjithashtu shërben për ta parandaluar viktimën nga braktisja e agresorit apo raportimin e incidenteve të mëparshme tek autoritetet. Hulumentimet tregojnë që përdorimi i armës apo mjeteve të rrezikshme apo kërcënimi për përdorimin e tyre në kontekst të dhunës në familje paraqet tregues të qartë të eskalimitdhe tregues vendimtar i rezultateve fatale.¹⁷²

1.9 të kompensojë ose dëmshpërblejë viktimën e veprës penale;

Çdo dënim me kusht që përfshinë viktimë ku kryerësi ka mundësi apo mjete për të bërë dëmshpërblim duhet të shoqërohet me këtë kusht. Kjo do ta parandaloj nevojën për parashtrim të padisë civile, do ta liroj shtetin nga çfarëdo obligimi që mund ta ketë dhe t'isiguroj viktimës ndihmë të drejtpërdrejtë në të cilën ka të drejtë.

1.10 të kthejë dobinë pasurore të fituar me kryerjen e veprës penale;

Çdo situatë në të cilën ka dobi materiale të fituar si rezultat i veprës duhet ta përfshijë dispozitën e kthimit të asaj dobie. Nëse kryerësi e ka konvertuar dobinë materiale në një formë tjetër, Gjykata duhet ta urdhëroj shitjen apo kthimin e formës së konvertuar nëse ende është në pronësi të vetme të kryerësit.

1.11 të mos posedojë apo përdor kompjuterin ose të mos qaset në internet siçkërkohet nga gjykata;

Veprat që janë kryer me kompjuter apo kanë komponentë të internetit në to duhet të shoqërohet nga këto kufizime. Kjo nuk duhet të kufizohet në veprat me kompjuterë. Çdo vepër penale ku gjykata konstaton që përdorimi i kompjuterit ka qenë në masë të arsyeshme i ndërlidhur për kryerjen e veprës penale apo e ka lehtësuar kryerjen e veprës, duhet të ketë dispozitë të kufizimit.

Nëse kryerësi ka lidhje biznesore apo përdorim legjitim jashtë kryerjes së veprave, Gjykata duhet që në mënyrë të ngushtë t'i hartoj kufizimet sipas nevojës.

1.12 të ofrojë raporte financiare siç kërkohet nga gjykata.

Nëse ekziston komponenti financiar në kryerjen e veprës penale dhe/apo motivohet nga dobia financiare, kjo rrethanë duhet të caktohet. Raportet periodike janë mjet i shkëlqyeshëm për gjykatën që ta monitoroj nëse të ardhurat nga kryerësi janë legjitime apo të ndërlidhura me aktivitet kriminal.

¹⁷¹ Doracaku për gjyqtarë e prokurorë mbi dhunën në familje, Konfiskimi i mjetit të përdorur apo që mund të përdoret për të kryer dhunë, par.6.9 Prishtinë (2016) , fq.44, që është edhe citim i Ligjit nr.05/1-22 për armët, (2015) Neni 10, neni 36 dhe neni 38.

¹⁷² Po aty. fq.66

Përveç dispozitave të nenit 59, kodi i referohet vazhdimisht paragrafit 3 të nenit 51 i cili parasheh dispozitat e mundshme për dënimet me kusht. Mirëpo, vetëm një rrethanë e përmendur dallon dukshëm nga kushtet e nenit 59. Kjo nënkupton që gjykata mund të kërkojë që kryerësi të bëjë dëmshpërblim për dëmin e shkaktuar nga vepra. Ky është kusht më i përgjithshëm se sa kushti i dëmshpërblimit në dispozitat e nenit 59.

Të gjitha kushtet janë dizajnuar për t'i monitoruar veprimet e të pandehurit dhe mund të përshtaten për pothuajse secilën vepër penale apo situatë. Sugjerimet e parapara për secilin kusht janë specifike për veprat penale/motivet për të cilat ato janë dizajnuar për t'imonitoruar. Mirëpo, kodi nuk e kufizon aplikimin e këtyre kushteve, dhe gjykata inkurajohet që t'i kombinojë ato siç e shih të përshtatshme për të zhvilluar mjete efektive për monitorimin e përparimit të kryerësit dhe të sigurojë që dënimi me kusht të përfundojë me sukses. Pavarësisht numrit të kushteve, Gjkata duhet t'i përfshijë afatet për secilin kusht me dispozita të duhura të monitorimit të cilat do të mundësojnë akordime të kushteve.

Kur të caktohen këto kushte, Gjkata duhet të jetë e vëmendshme për kushtet dherrethanat në jetën e kryerësit. Disa nga këto konsiderata janë theksuar në nenin 51, paragrafin 3 dhe tregojnë një vetëdije të përgjithshme që Gjkata nuk duhet të caktoj kushte që janë të pamundshme apo shumë të vështira për tu kryer, për shkak të rrethanave të vlefshme/relevante. Kjo nuk nënkupton që Gjkata duhet të mbështetet vetëm në fjalën e kryerësit për ekzistimin e kushteve të tilla. Gjkata duhet të kërkojë dëshmi të rrethanave të tilla dhe nëse i pranon ato të kërkojë alternativa tjera.

8.2.4 Periudha e Verifikimit

Kodi parasheh periudhë të verifikimit apo përmbushjes së dënimit me kusht që zgjatë nga 1-5 vite. Ndonëse Gjkata është e lirë për ta përcaktuar kohëzgjatjen e duhur, sugjerohet fuqimisht që Gjkata ta rrisë periudhën në proporcion me seriozitetin e veprës. Në vijim janë paraqitur periudhat e sugjeruara të verifikimit:

- ❖ Cilado vepër që kërkon zbatimin e zbutjes nga neni 76 për tu pezulluar dënimi (Neni 52, paragrafi 2)
 - Së paku 3 vite verifikim
 - vite verifikim nëse ka qenë i mundshëm shqiptimi i dënimit prej më së shumti 10 viteve
- ❖ Veprat penale bashkekzistuese të pezulluara – së paku 3 vite
- ❖ Veprat penale të vetme pa zbutje (Neni 52, paragrafi 1)
 - Më pak se 3 vite – të mundshme

8.2.5 Monitorimi nga shërbimi sprovues

Neni 58 ia lejon gjykatës që të caktoj monitorim nga shërbimi sprovues për dënimin me kusht. Kjo mund të jetë për monitorim aktiv të kryerësit për respektim të kushteve të caktuara apo

thjeshtë kërkesë për raportim periodik që e detyron kryerësin që të takohet me shërbimin sprovues. Derisa disa nga kushtet e parapara në kod nuk kanë nevojë për monitorim aktiv, praktika tregon që monitorimi aktiv dhe i rregullt i përparimit drejt përmbushjes së kushteve është mënyra më efektive për të siguruar respektim të kushteve, riintegrim dhe sukses të përgjithshëm të dënimit me kusht. Së paku, kryerësi do të jetë i vetëdijshëm për praninë e gjykatës dhe interesimin e vazhduar në rezultate, dhe rikujtohet rregullisht që dështimet do të identifikohen shpejtë dhe do të dënohen. Dënimet me kusht pa kushte kanë më shumë gjasa për të dështuar se ato që kanë kushte dhe monitorohen në mënyrë aktive. Mirëpo, Kodi lejon vetëm periudhë të monitorimit prej 6 muaj deri 3 vite. Ndonëse në këtë periudhë nuk mund të monitorohet e gjithë periudha verifikuese e dënimit të mundshëm me kusht prej 5 viteve, Gjykatat duhet ta përdorin aktivisht periudhën e lejuar. Sugjerohet fuqishëm që çdo periudhë e verifikimit prej 3 e më shumë viteve që përfshinë obligime për kryerësin, të shoqërohet me periudhë 3 vjeçare të monitorimit nga shërbimi sprovues.

8.2.6 Shkeljet

Shkeljet janë relativisht të drejtpërdrejta në kod dhe mbulohen në përgjithësi nga nenet 53-55 të cilat i përshkruajnë kushtet për revokim pas kryerjes së veprave të reja, duke dështuar kështu që t'i plotësojnë kushtet, dhe duke u dënuar për veprën e kryer më parë.

Neni 53 kërkon revokim të detyrueshëm të dënimit me kusht kurdo që të jetë kryer veprë re penale që rezulton në dënimin prej 2 e më shumë viteve burgim. Gjykata duhet pastajta zbatoj nenin 80 për ashpërsimin e dënimeve. Mirëpo nëse dënimi është më pak se dy vite apo gjobë, revokimi nuk është i detyrueshëm, mirëpo Gjykata inkurajohet që ta vlerësoj shkeljen në bazë të rrethanave, motivit dhe llojit të veprës penale. i sugjeron gjykatës që vepra e re e kryer përkundër faktit të ekzistimit të dënimit me kusht, është tregues i fortë që dënimi me kusht ka **dështuar** ta arrijë qëllimin e tij. Revokimi duhet të supozohet përveç nëse ka prova bindëse nga kryerësi për t'i arsyetuar veprimet e tilla. Nëse vepra penale është identike/e ngjashme në natyrë, me motiv e viktimë të njëjtë, revokimi duhet të jetë i menjëhershëm.

Kryerja e veprës së re penale mund të jetë dëshmi bindëse për revokim të dënimit me kusht; mirëpo, shkelja e kushteve kërkon analizë dhe konsideratë më të thukët. Neni 55 i alejon gjykatës revokimin e dënimit me kusht dhe shqiptimin e dënimit të caktuar më parë për mospërmbushje të kushteve të caktuara në bazë të paragrafit 3 të nenit 51 apo nenit 59 në tërësi. Kodi është mjaft fleksibil në lejimin e Gjykatës që të vlerësoj rrethanat në lidhje me përmbushjen e kushteve dhe ta shqyrtoj nëse revokimi është i duhur apo nëse është e arsyeshme që të vazhdohet kushti. Nëse mospërmbushja e kushteve ka arsyetim, Gjykata kërkohet që ta heq kushtin apo ta zëvendësoj atë me një kusht më të përshtatshëm. Mirëpo, çdo zgjatje e periudhës për plotësim të kushteve apo plotësi të kushteve të reja, duhet të jetë deri në fund të periudhës së përmbushjes.

Gjykata vendos që ta revokoj dënimin me kusht për mospërmbushje të kushtit, sipas nenit 56 kjo duhet të bëhet brenda 1 viti të afatit të përcaktuar (dhe para skadimit të periudhës së

verifikimit). Për shembull, Gjykata kërkon që kryerësi ta përfundoj një program të rehabilitimit nga droga brenda 1 viti dhe parasheh periudhë 5 vjeçare të verifikimit. Nëse Gjykata nuk mëson për dështimin deri në vitin e 4-rt, mund ta revokoj dënimin për mospërbushje të kushtit. Kjo duhet të ndodh para përfundimit të vitit të 2-të.

Këto janë konsiderata relevante për revokimin/zgjatjen e kushtit:

- Gjykata nuk duhet që thjeshtë ta shtyjë periudhën e përbushjes vazhdimisht derisa të skadon periudha e verifikimit. Duhet të jepet arsytim për mospërbushjen.
- I pandehuri e bartë barrën e arsytimit të mospërbushjes së kushteve të dënimit me kusht apo të tregoj që kushti duhet të zëvendësohet.
- Zëvendësimi apo heqja e kushteve duhet të jetë për shkak të mospërbushjes në bazë të rrethanave që janë jashtë kontrollit të kryerësit (Për shembull – i pandehuri nuk është në gjendje që ta plotësoj trajnimin profesional për shkak se shkolla profesionale është mbyllur).
- Mospërbushjet që shfaqin mungesë të seriozitetit apo mosrespekt të autoritetit të gjykatës, duhet të rezultojnë në revokim të dënimit me kusht. Vazhdimi i këtyre kushteve ka pak gjasa që të shpie në respektim dhe e gërryen respektin përsistemin gjyqësor si tërësi.
- Vazhdimet e bazuara në arsytime të diskutueshme mund të bëhen, mirëpo asnjëherë më shumë se një herë për të njëjtin arsytim të diskutueshëm.
- Nëse nuk caktohet monitorim nga shërbimi sprovues, Gjykata duhet në mënyrë aktive t'i kontrolloj dosjet apo mbajë seanca në periudhën e afatit përfundimtar të vendosur për kushtet, për të përcaktuar përbushjen.
- Gjykata duhet ta mbajë së paku një seancë diku kah fundi i periudhës verifikuese për të përcaktuar nëse të gjitha kushtet janë plotësuar dhe/apo të merr vendim përfundimtar për revokim.

Dënimet me kusht janë mjet efektiv në dispozicion të gjykatës për të minimizuar dënimin me burg efektiv dhe për ta çuar në maksimum rehabilitimin e kryerësve. Mirëpo, ato nuk janë shumë efektive pa kushte të qarta, monitorim të përbushjes dhe gatishmërisë së gjykatës për t'i revokuar ato kur kushtet nuk janë plotësuar. Ato nuk duhet të përdoren si mjet për kryerjen e lëndëve që konsiderohen joserioze pasi që nuk do të shërbejnë për ndonjë qëllim të dobishëm dhe rehabilitimi do të dështoj. Gjykata duhet të jetë e gatshme që të merr kohë për të krijuar dënim efektiv me kusht në mënyrë që shoqëria t'a korrë përfitimin nga to.

8.3 Shërbimi në dobi të përgjithshme / Gjysmëliria

Si gjysmëliria ashtu edhe puna në dobi të përgjithshme janë mjete alternative për ta kryer një dënim me të urdhëruar nga gjykata prej deri një viti burgim. Që të dyja e bartin mundësinë e kushteve shtesë si pjesë e dënimit. Këto duhet të përdoren nga Gjykata për t'i adresuar çështjet kontribuuese dhe për ta dizajnuar një program për riintegrim tëduhur.

Duke qenë se puna në dobi të përgjithshme potencialisht e zëvendëson dhe zvogëlon periudhën

e burgimit prej një viti në më së shumti 30 ditë të punës, duhet të përdoret më rrallë se gjysmëliria, e cila kërkon periudha të burgimit efektiv. Pasi që periudha e performancës nuk është me e madhe se një vit, gjykata duhet ta parashoh një periudhë fillestare të një kohëzgjatje substancialisht më të shkurtë për ta vlerësuar përmbushjen dhe për t'i rritur në maksimum mundësitë e gjykatës.

8.4 Qortimi Gjyqësor

Neni 85 dhe 86 i japin mundësi gjykatës për të shqiptuar qortim gjyqësor. Qortimigjyqësor është në esencë zëvendësim i dënimit me burg me një paralajmërim zyrtar nga gjykata që nëse kjo sjellje përsëritet, do të ketë dënim më të ashpër. Siç është cekur në kod, qortimi është në dispozicion për të gjitha veprat e dënueshme me deri një vit burgim dhe veprat e dënueshme deri 3 vite që në mënyrë specifike e parashohin qortimin. Vetëm vepra nga neni 188 lëndimi i lehtë trupor përmban mundësinë e qortimit gjyqësor për veprë të dënueshme me deri 3 vite burgim.

Përdorimi i qortimit gjyqësor për vepra që bartin dënim të mundshëm deri në një vit burgim kufizohet edhe më tutje vetëm për ato raste ku ka rrethana lehtësuese të mjaftueshme për ta bërë veprën veçanërisht të vogël. Andaj gjykata duhet të kaloj nëpër proces të vlerësimit të rrethanave rënduese dhe lehtësuese. Nëse gjykata e përcakton që rrethanat rënduese janë të barabarta apo më të mëdha se ato lehtësuese, nuk mund ta zëvendësoj dënimin me qortim gjyqësor. Për më tepër, nëse nuk ka sa duhet rrethana lehtësuese për ta bërë veprën veçanërisht të vogël, gjykata nuk mund ta përdor qortimin gjyqësor. Një metodë e vlerësimit është që të shqyrtohet se sa afër kanë qenë veprimet e kryerësit për të mos e përmbushur kriterin për të qenë veprë penale. Lëndimet që mezi e plotësojnë këtë prag të veprës penale kanë më shumë gjasa për ta kualifikuar veprën për qortim gjyqësor. Siç është theksuar në paragrafin 5 të nenit 86, konsideratat e rëndësishme për plotësuar nivelin e veprës së vogël janë veprimet e kryerësit gjatë dhe pas kryerjes së veprës penale. Përqendrimi i gjykatës nuk është vetëm në atë se a kualifikohen veprimet e kryerësit si sjellje devijuese, por nëse kryerësi e ka kuptuar sjelljen dhe ka ndërmarr masa korrigjuese.

KAPITULLI IX

DËNIMET PLOTËSUESE DHE DISPOZITATTJERA

9.1 Dënimet plotësuese

Dënimet plotësuese nga neni 62 mund të shqiptohen me ÇDO dënim kryesor apo alternativ. Ndonëse ato ndryshojnë për nga zbatimi i tyre i detyruar, gjykata duhet të vlerësojë zbatueshmërinë e tyre para se të shqiptojë dënimin përfundimtar. Kjo vlen veçanërisht për dënimin me kusht pasi që kjo rrit mundësinë e përshtatjes së dënimit nevojave të veçanta të kryerësit dhe maksimizon perspektivën e reintegrimit.

9.1.1 Heqja e të drejtës për t'u zgjedhur¹⁷³

Heqja e të drejtës për t'u zgjedhur është dënim plotësues i detyrueshëm. Ky dënim përfshin veprat nga Kapitulli 18 (Veprat penale kundër të drejtave të votimit) dhe veprat tjera penale për të cilat është paraparë dënimi me së paku dy vjet burgim nëse vepra është kryer me qëllim për t'u zgjedhur. Periudha e heqjes së të drejtës është 1-4 vjet.

Gjykata duhet ta shfrytëzojë këtë dispozitë me mençuri pasi që këto vepra tregojnë një mosrespekt themelor ndaj vlerave demokratike. Në përgjithësi, nëse gjykata ka shqiptuar dënim me burgim, e drejta për t'u zgjedhur duhet të shqiptohet për së paku 3 vjet. Ndërkaq në rastet kur është shqiptuar dënimi alternativ i dënimit me kusht, periudha e heqjes së të drejtës duhet të jetë së paku aq sa edhe dënimi i cili është kushtëzuar.

9.1.2 Urdhri për kompensimin e humbjes apo dëmit¹⁷⁴

Kjo është dispozitë e detyrueshme e cila duhet të përfshihet në çdo rast kur ka ndonjë humbje apo dëmtim të pasurisë së viktimës. Për dallim nga kompensimi për lëndimin mjekësor apo dëmtimin fizik, kjo masë përqendrohet vetëm në humbjen pasurore. Përveç vlerës së vetë pasurisë, gjykata duhet të urdhërojë edhe humbjen e të ardhurave të cilat viktimat i përjeton si rezultat i veprës. Nuk ka ndonjë kufizim të kompensimit bazuar në aftësinë e kryerësit për të paguar apo aftësinë e viktimës për të siguruar kompensimin në ndonjë mënyrë tjetër.

9.1.3 Ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik¹⁷⁵

Ndalesat nga paragrafi 2.3 janë vlerësime të detyrueshme për gjykatën. Ndalesat mund të jenë

¹⁷³ Neni 62 i Kodit Penal, par 2.312

¹⁷⁴ Neni 62 i Kodit Penal, par 2.3

¹⁷⁵ Neni 62 i Kodit Penal, par 2.3

nga 1-5 vjet nëse shqiptohet dënimi me burgim dhe 1-3 vjet nëse shqiptohet dënimi me gjobë apo dënimi me kusht. Për shqyrtimin e gjykatës është e rëndësishme që të këtë keqpërdorim të funksioneve nga ushtrimi i funksioneve në administratën publike apo shërbimin publik. Kjo nuk kufizohet vetëm në akuzat formale të keqpërdorimit të pozitës zyrtare apo madje as të korrupsionit zyrtar nga Kapitulli 34. Gjykata është e lirë ta shqiptojë këtë ndalesë nëse thjeshtë ka vetëm ndonjë element të keqpërdorimit të pushtetit apo ndihmës në kryerjen e veprës së tillë.

Çdo vepër e cila mbartë me vete dënim të mundshëm prej 5 apo më shumë vjet duhet ta përfshijë ndalesën prej së paku 3 viteve, pavarësisht periudhës së dënimit të shqiptuar me burgim apo periudhës së dënimit me kusht. Për çdo vepër që përfshin korrupsionin zyrtar nga Kapitulli 34 (Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare), për të cilën shqiptohet dënim me burgim, duhet të caktohet periudha prej 5 viteve e ndalesës së ushtrimit të funksioneve. Në përgjithësi, periudha e ndalesës duhet të jetë proporcionale në raport me peshën e veprës.

9.1.4 Ndalimi i ushtrimit të profesionit, veprimtarisë apo detyrës¹⁷⁶

Dispozita 2.4 i drejtohet individëve të cilët keqpërdorin autoritetin e tyre si pjesë e veprësapo drejtpërdrejtë në kryerjen e veprës duke mundësuar kufizimin e aftësisë së tyre për ta ushtruar atë pozitë apo detyrat tjera të parapara në nenin 66. Kjo nuk kufizohet vetëm në pozitat në organe publike dhe nuk e kufizon gjykatën vetëm në veprat ku keqpërdorimi i pozitës është element formal. Mjafton që gjykata të gjejë apo të përcaktojë se pozita ështëkeqpërdorur në kryerjen e veprës. Periudha e ndalesës është 1-5 vjet dhe koha e mbajtur në burg ose në institucionin e kujdesit shëndetësor nuk llogaritet në kohëzgjatjen e saj.

Gjatë përcaktimit nëse duhet ndaluar ushtrimin e profesionit, veprimtarisë apo detyrës, gjykata nuk kufizohet vetëm në ndalimin e atij profesioni, veprimtarie apo detyre që ështëkeqpërdorur gjatë kryerjes së veprës. Gjykata gjithashtu mund ta kufizojë edhe qasjen nëse ka arsye për të besuar se mund të keqpërdoret në të ardhmen. Për shembull, gjykata mund ta ndalojë punësimin e kryerësit si mësues nëse pozita e tillë është keqpërdorur për të ngacmuar seksualisht ndonjë fëmijë. Gjykata gjithashtu mund t'ia ndalojë kryerësit mbikëqyrjen e fëmijëve në çfarëdo kapaciteti profesional nëse ka arsye për të besuar se autoriteti në këtë pozitë mund të rrisë gjasat e keqpërdorimit të serishëm të këtij autoriteti.

Së paku 4 vjet ndalesë duhet të shqiptohen për vepra penale seksuale, vepra që përfshijnë viktima të ndjeshme, dhe vepra që përfshijnë lëndime serioze. Nëse autoriteti ka qenë esencial në kryerjen e veprës, ndalesa duhet të jetë së paku 3 vjet. Në përgjithësi,periudha e ndalesës duhet të jetë proporcionale me peshën e veprës.

¹⁷⁶N eni 62 i Kodit Penal, par 2.4

9.1.5 Ndalimi i drejtimit të automjetit¹⁷⁷

Paragrafi 2.5 kryesisht përqendrohet në ato vepra të cilat përfshijnë drejtimin e automjetit në situata të cilat rrezikojnë sigurinë publike. Megjithatë, kjo nuk është e kufizuar vetëm në veprat ku vetë vepra është kryer me automjet. Kjo mjafton të ndërlidhet me kryerjen e veprës në atë mënyrë që të jetë përfshirë vozitja e tillë që ka rrezikuar sigurinë publike. Sikurse me shumicën e dispozitave, kjo ndalesë duhet të jetë në proporcion të drejtpërdrejtë me rrezikun e shkaktuar dhe peshën e veprës. Një rrethanë e rëndësishme është rëndësia apo domosdoshmëria e automjetit në kryerjen e veprës. Sa më i madh të jetë roli i tij në kryerjen e veprës, aq më e gjatë duhet të jetë periudha e ndalesës.

9.1.6 Marrja e lejes së vozitjes¹⁷⁸

Marrja e lejes së vozitjes nga neni 68 është e ngjashme për nga natyra me ndalesën nga paragrafi 2.5, megjithatë kjo mundëson marrjen e lejes apo ndalesën për cilindo automjet (e jo në mënyrë specifike ndonjë tip/model të automjetit). Rreziku është i njëjtë sikur te 2.5 në kuptimin që ka rrezik për trafikun publik. Megjithatë, gjykata është e kufizuar në veprat të cilat përfshijnë vdekjen apo lëndimin e rëndë trupor ose nëse gjykata konstaton se pjesëmarrja e mëtejshme e kryerësit në trafikun publik është e rrezikshme për shkak të paaftësisë së ngasësit për drejtimin e sigurt të automjetit. Sikurse te 2.5, ndalesa duhet të jetë proporcionale me peshën e veprës. Nëse vepra shkakton vdekjen apo lëndimin erëndë trupor dhe është drejtpërdrejtë e lidhur me drejtimin e mjetit motorik, periudha e marrjes së lejes duhet të jetë 5 vjet.

9.1.7 Marrja e sendit¹⁷⁹

Konfiskimi i sendit është i detyrueshëm në të gjitha rastet kur sendi është përdorur në kryerjen e veprës penale dhe është përfituar nga kryerja e veprës penale. Ndonëse konfiskimi është i detyrueshëm, procedurat përkatëse të konfiskimit duhet të ndiqen ashtusiq përcaktohen me KPP. Sendi i cili nuk është pronë e kryerësit mund të konfiskohet nëse nuk ndikon dëmshëm mbi të drejtat e palës së tretë për të marrë kompensim nga kryerësi.

Ndonëse dispozitat e 2.7 janë të detyrueshme, ato nuk mund të zbatohen pa ndjekur procedurën përkatëse. Nëse sendi i është nënshtruar sekuestrimit, gjykata duhet t'i referohet dispozitave të KPP në vlerësimin nëse sendi mund të konfiskohet në mënyrë legjitime. Nëse procedurat përkatëse janë përfillur në mënyrë të duhur, atëherë konfiskimi duhet të urdhërohet menjëherë së bashku me dënimin.

Ndonëse sipas kësaj dispozite mund të konfiskohet edhe sendi i cili nuk është pronë e kryerësit nëse nuk ndikon dëmshëm mbi të drejtat e palës së tretë për të marrë kompensim, kjo në përgjithësi nuk është e këshillueshme, veçanërisht nëse nuk ka pasur ndonjë procedurë apo

¹⁷⁷ Neni 62 i Kodit Penal, par 2.5

¹⁷⁸ Neni 62 i Kodit Penal, par 2.6

¹⁷⁹ Neni 62 i Kodit Penal, par 2.4

mundësi për palët e treta që të dëgjohen apo nëse nuk janë njoftuar në mënyrë të duhur. Për më tepër, qasja në të drejtën për të rikthyer sendin nuk mjafton për t'i siguruar palës së tretë mundësi të mirëfilltë për ta rikthyer sendin, veçanërisht nëse pjesë e madhe e pasurisë së kryerësit është konfiskuar dhe nëse ata janë dërguar në mbajtje të dënimit. Nëse gjykata ka arsye për të besuar se pala e tretë ka bërë përpjekje për ta mbrojtur apo për ta fshehur sendin, jashtë kufizimeve të parapara në KPP, atëherë kjo dispozitë mund të jetë e përshtatshme. Megjithatë, nëse ka indikacione se pala e tretë është pronar i pafajshëm i sendit apo ka vetëm lidhje të rastësishme me veprën, gjykata duhet ta shmang konfiskimin nëse nuk arsyetohet.

9.1.8. Urdhri për publikimin e aktgjykimeve⁹⁵

Pika 2.8 lejon publikimin e aktgjykimeve dhe kjo shpjegohet më në detaje në nenin 70. Kjo dispozitë duhet të zbatohet kur është në interes të përgjithshëm që aktgjykimi të publikohet në një mënyrë më të hapur dhe më të qasshme sesa qasja tradicionale në regjistrat publik. Përdorimi i kësaj dispozite duhet të kufizohet veçanërisht kur rrezikohet privatësia e personave apo kur publikimi mund të identifikojë persona të cilët nuk kanë të bëjnë me kryerjen e veprës. Kjo dispozitë mund të jetë posaçërisht e dobishme kur përfshihen figura publike apo kur ka implikime më të mëdha për stabilitetin e përgjithshëm.

9.1.9 Dëbimi i të huajve nga territori i Republikës së Kosovës⁹⁶

Dispozitat e 2.9 janë vetëshpjeguese dhe lejojnë dëbimin e të huajve në kohëzgjatje prej 1-10 vjet. Gjukata duhet të merr parasysh peshën e veprës, motivet e kryerjes së veprës dhe lidhjen e kryerësit gjatë përcaktimit të kohëzgjatjes së këtij dënimi.

9.2 Masat e trajtimit të detyrueshëm

Kapitulli V i KP parasheh masat e trajtimit të detyrueshëm. Këto dispozita zbatohen vetëm për kryerësit të cilët nuk kanë përgjegjësi penale për shkak të paaftësisë mendore, kanë aftësi esencialisht të zvogëluar mendore apo janë të varur nga droga apo alkooli. Si të tilla këto masa janë përtej shtrirjes së udhëzimit për caktimin e dënimit. Shumica e konstatimeve në këto raste janë gjetje faktike që vërtetojnë se kryerësi nuk është penalishtpërgjegjës apo ka pësuar nga aftësia esencialisht e zvogëluar mendore sa që trajtimi i gjendjes së tillë është i rëndësisë primare. Së fundi, në rastet kur ndëshkimi penal mund të zbatohet sipas udhëzimit, gjykata mund ta zëvendësojë dënimin me ndonjë periudhë të caktuar të trajtimit të detyrueshëm, me kusht që vepra të jetë kryer nën ndikimin apo kryesisht si rezultat i përdorimit të drogës apo alkoolit.

KAPITULLI X DHËNIA E ARSYETIMIT

Dhënia e arsyetimit adekuat për dënimin përfundimtar është e rëndësishme parësore. Arsyetimi dhe analizimi i qartë janë kërkesa thelbësore të vendimeve gjyqësore dhe një aspekt i rëndësishëm i së drejtës në gjykim të drejtë të paraparë në nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut. Cilësia e vendimeve gjyqësore varet kryesisht nga cilësia e arsyetimit të tyre. Arsyetimi adekuat është domosdoshmëri e cila nuk duhet neglizhuar në interes të shpejtësisë.¹⁸⁰

Arsyetimi i qartë gjithashtu i jep kryerësit njoftimin e duhur lidhur me arsyet e vendimit dhe ua mundëson viktimave dhe prokurorëve që ta dinë se shqetësimet dhe argumentet e tyre janë trajtuar. Për më tepër, arsyetimi i duhur u jep garancitë e nevojshme gjykatave më të larta se të gjitha dispozitat e ligjit janë shqyrtuar në mënyrë adekuate dhe kjo në mënyrë të pashmangshme do ta zvogëlojë numrin e ankesave të suksesshme bazuar në mungesën e arsyetimit apo pamundësinë e gjykatës më të lartë për të vlerësuar bazën për caktimin e dënimit. Gjyqtari sigurohet që aktgjykimet e tij të jenë të kuptueshme. Ai jep arsyet e tij për vendimin e marrë në mënyrë që të gjitha palët e përfshira ta kuptojnë logjikën në të cilën gjyqtari ka bazuar vendimin e tij.¹⁸¹ Theksimi i arsyeve jo vetëm që e bën vendimin më të lehtë për palët që ta kuptojnë dhe pranojnë, por mbi të gjitha është garanci kundër arbitraritetit. Së pari, kjo e obligon gjyqtarin që t'i përgjigjet parashtresave të palëve dhe të cek arsyet të cilat e justifikojnë vendimin dhe e bëjnë të ligjshëm; së dyti, i mundëson shoqërisë që ta kuptojë funksionimin e sistemit gjyqësor.¹⁸²

Ndjekja e parimeve dhe qasjes së shtruar në udhëzim do të eliminojë shumicën dërrmuesetë ankesave. Megjithatë, caktimi i dënimit bazuar në udhëzim nuk është zëvendësim për arsyetimin dhe shqyrtimin e duhur. Kjo nuk është askund më e debatueshme dhe problematike se te shqyrtimi i rrethanave rënduese/lehtësuese. Për ta thjeshtësuar procesin e shqyrtimit, Shtojca 2 parasheh një formë standarde për përdorimin e gjykatës në llogaritjen dhe arsyetimin e dënimit.

Forma paraqet një varg të rreshtave për secilën rrethanë të mundshme rënduese dhe lehtësuese. Gjykata pastaj thjeshtë duhet që të jep arsyetimin faktik për secilën rrethanë sipas nevojës. Kjo i ofron gjykatës një referencë të shpejtë në faktet të cilat e mbështesin rrethanën e caktuar. Kjo e bën përpilimin e aktgjykimëve të detajuara shumë më të shpejtë.

¹⁸⁰ Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropian (KKGJE), Opinioni Nr. 11 i KKGJE për vëmendjen e Këshillit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi cilësinë e vendimeve gjyqësore, Strasburg (2008) nr. 3.

¹⁸¹ Rrjeti Evropian i Këshillave për Gjyqësorin (RREKGJ), Raporti i etikës gjyqësore 2009-2010, Dëgjimide komunikimi, fq. 14.

¹⁸² Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropian (KKGJE), Opinioni Nr. 11 i KKGJE për vëmendjen e Këshillit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi cilësinë e vendimeve gjyqësore, Strasburg (2008) nr. 35.

Identifikimi i kufijve të dënimit përfundimtar është thjeshtë çështje e përcaktimit të rrethanave të përgjithshme rënduese në krahasim me ato lehtësuese, dhe shqyrtimit nëse ndonjë çështje tjetër, siç është zbutja, ka ndikuar në dënim. Me të finalizuar këtë, gjykata përcakton kufijtë e përshatshëm dhe cakton dënimin përfundimtar brenda këtyre kufijve. Gjykata pastaj bën korrigjimet përfundimtare siç është kushtëzimi i dënimit apo përcaktimi i dënimeve alternative. Së fundi, gjykata përcakton nëse zbatohet ndonjë dënim plotësues dhe/ose kushtet e dënimit me kusht.

Përveç caktimit të dënimit përfundimtar bazuar në rrethanat rënduese/lehtësuese dhe dispozitat tjera të zbatueshme, Shtojca 2 ofron një listë të kushteve për dënimet me kusht si dhe dënimet plotësuese që janë të zbatueshme për të gjitha dënimet. Kjo duhet t'ia përkujtojë gjykatës të gjitha rrethanat e mundshme dhe ta inkurajojë shfrytëzimin e tyre në shqiptimin e dënimeve kuptimplota të cilat kanë gjasë të kenë sukses.

Gjatë përpilimit të vendimit përfundimtar me shkrim, gjykata duhet të zbatojë sugjerimet në vijim:

- Çdo rrethanë për të cilën gjykata vërteton se ekziston duhet të ceket qartë në aktgjykimi – si rënduese ashtu edhe lehtësuese.
- Gjykata duhet të paraqesë një përmbledhje relativisht të detajuar të fakteve të cilat gjykata beson se e mbështesin dhe e arsyetojnë gjetjen e rrethanës.
- Gjykata duhet të cek vlerën e përgjithshme të caktuar për secilën rrethanë pas deklarimit të fakteve në mbështetje të rrethanës.
- Gjykata duhet t'i referohet numrave të të gjitha rrethanave të cilat nuk ekzistojnë dhe të theksojë se nuk ka fakte që mbështesin rrethanën.
- Nëse ka prova të paraqitura në mbështetje të një rrethane të caktuar lehtësuese/rënduese të cilat gjykata nuk i gjen të besueshme, atëherë duhet ta theksojë këtë në mënyrë specifike dhe ta jep një arsyetim të shkurtë për këtë.
- Gjykata duhet ta theksojë qartë nëse rrethanat janë të barabarta, joekzistuese, mbipeshojnë apo mbipeshojnë në mënyrë të konsiderueshme.
- Kufijtë përfundimtar duhet të theksohen në aktgjykim së bashku me dënimin përfundimtar.
- Dënimet me kusht duhet të përfshijnë një arsyetim specifik lidhur me atë se përse gjykata beson se kërcënimi i dënimit mjafton për ta parandaluar kryerësin nga kryerja e ndonjë vepre tjetër.
- Zbutja e dënimeve nga neni 75 duhet të përfshijë në mënyrë specifike sqarimin se në cilat dispozita të Kodit është mbështetur gjykata për zbutjen e dënimit.

Për të qenë e cilësisë së lartë, vendimi gjyqësor duhet të perceptohet nga palët dhe nga shoqëria në përgjithësi si rezultat i zbatimit adekuat të rregullave juridike, procedurës së drejtë dhe vlerësimit adekuat faktik, si dhe efektivisht i zbatueshëm. Vetëm atëherë palët do të binden se rasti i tyre është shqyrtuar në mënyrë të duhur dhe shoqëria do ta perceptojë vendimin si faktor në rivendosjen e harmonisë sociale. Për t'i arritur këto qëllime, duhet të plotësohen një varg kriteresh.¹⁸³

¹⁸³ Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropian (KKGjE), Opinioni nr. 11 I KKGjE për vëmendje të Këshillit të Ministrave të Këshillit të Evropës në lidhje me cilësinë e vendimeve gjyqësore, Strasburg(2008) nr.35.

KAPITULLI XI

PRAKTIKAT ALTERNATIVE

Ndonëse praktikat alternative për zgjidhjen e rasteve janë relativisht të reja, ato kanë fituar popullaritet anembanë botës si metoda për të ruajtur dhe priorizuar burimet. Në vijim do të paraqiten udhëzime të përgjithshme të cilat duhet të rregullojnë mënyrën në të cilën gjykatat iu qasen këtyre praktikave.

11.1 Marrëveshja mbi pranimin e fajësisë

Ndonëse gjykata ka aftësi të kufizuar për t'u përfshirë në negocimin ndërmjet kryerësit dhe prokurorit, megjithatë ajo e ka fjalën e fundit nëse marrëveshja mbi praninë të fajësisë do të pranohet apo jo. Dispozitat e marrëveshjes mbi praninë të fajësisë kryesisht janë të rregulluara me nenin 233 të Kodit të Procedurës Penale dhe dispozitat që kanë të bëjnë me dënimet në Kodin Penal. Ka disa konsiderata të rëndësishme të cilave gjykata duhet t'iu përmbahet.

Në përgjithësi, prokurori ka mundësi të ofrojë një dënim i cili është brenda kufizimeve të parapara në Kod. Çdo dënim ligjërisht i mundshëm mund të ofrohet nga prokurori dhe të pranohet nga kryerësi. Kjo nuk nënkupton që prokurori duhet ta bëjë ofertën minimale kurdo që është në dispozicion. Përcaktimi i marrëveshjes së duhur mbi praninë e fajësisë është vendim brenda gjykimit të prokurorit që duhet t'i merr në konsideratë një sërë rrethanash. Pavarësisht kësaj, fakti që prokurori e jep një ofertë të caktuar, NUK nënkupton që gjykata DUHET ta pranojë dhe zbatojë atë. Gjykata është përcaktuesi përfundimtar i asaj nëse marrëveshja mbi praninë e fajësisë është e pranueshme, mirëpo duhet t'a respektoj deri në masë të caktuar vendimin e prokurorit.

Për shembull, nëse për veprën është paraparë dënim prej 3-5 vjet, dënimi minimal mund të zbutet (përmes dispozitave për marrëveshjen e pranimit të fajësisë në nenin 75, paragrafi 1.3) deri në 12 muaj sipas nenit 76. Neni 233, paragrafi 7 i KPP i jep prokurorit aftësi maksimale për ta zbutur dënimin. Nëse marrëveshja arrihet para shqyrtimit gjyqësor, dënimi i mundshëm është 80% e 12 muajve (90% e 12 muajve nëse gjykimi ka filluar – Mirëpo siç është diskutuar më lartë, duhet të ketë indikacione të forta që të MOS ofrohet përfitimi i dukshëm për praninë e fajësisë apo marrëveshjet mbi praninë e fajësisë që bëhen gjatë shqyrtimit gjyqësor). Zbutjet e mëtejshme janë të mundshme kur kryerësi fillon të bashkëpunojë në mënyrë proaktive me prokurorinë si dëshmitar bashkëpunues dhe siguron prova në procedurë (60% e minimumit) dhe në rastet kur merr pjesë si dëshmitar bashkëpunues në hetim të fshehtë (40% e minimumit). Prokurori duhet të përfshijë në marrëveshje për praninë të fajësisë së paku:

- i. Pikat e aktakuzës për të cilat i pandehuri pranon fajësinë;
- ii. Nëse i pandehuri pranon të bashkëpunojë;
- iii. Të drejtat nga të cilat hiqet dorë;
- iv. Përgjegjësia e të pandehurit për kompensimin e të dëmtuarit dhe konfiskimi i të gjitha pasurive të cilat i nënshtrohen konfiskimit.

Ndonëse prokurori ka mundësi për të arritur marrëveshje për pranim të fajësisë deri në nivelin e përcaktuar në KPP, kjo nuk nënkupton se gjykata është e detyruar t'i pranojë ato. Neni 233 shpjegon se për ta pranuar marrëveshjen për pranim të fajësisë, gjykata duhet të vlerësojë pozitivisht disa rrethana, të cilat janë:

- 18.1 i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë;
- 18.2 pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, nëse ka mbrojtës, dhe se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë;
- 18.3. pranimi i fajësisë mbështetet në fakte dhe prova materiale të rastit konkret, të cilat paraqiten në aktakuzë, apo me provat materiale të paraqitura nga prokurori për plotësimin e aktakuzës dhe të pranuar nga i pandehuri, si dhe me dëshmi tjera, siç mund të jenë deklaratat e dëshmitarëve të paraqitura nga prokurori apo i pandehuri; dhe
- 18.4. nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253, paragrafët 1. Dhe 2 të këtij Kodi.

Padyshim se shqetësimi kryesor i gjykatës do të jetë dënimi i ofruar/rekomanduar nga prokurori dhe nëse gjykata pajtohet se ky dënim është i pranueshëm. Proceduralisht, kodii lejon gjykatës që ta pranojë marrëveshjen dhe të shqiptojë dënim i cili është më i lartë sedënimi i rekomanduar nga prokurori. Kjo kryesisht bazohet në shqetësimin se pas pranimit të marrëveshjes, gjykata mund të vlerësojë se ka rrethana të pamjaftueshme për të arritur deri te dënimi i rekomanduar nga prokurori apo mund të ketë fakte të cilat e ndryshojnë pozitën e gjykatës në mënyrë substanciale. Ndonëse kjo i jep gjykatës fleksibilitet maksimal për të caktuar një dënim i cili arsyetohet nga faktet, shqiptimi i dënimit më të lartë se dënimi i rekomanduar do të shkatërrojë motivimin për arritjen e marrëveshjeve për pranim të fajësisë, e që në radhë të parë është siguria e dënimit të cilin e pret i pandehuri në shkëmbim të heqjes dorë nga gjykimi i rregullt.

Për të korrigjuar këtë problem potencial, gjykata duhet që ta refuzojë marrëveshjen në seancën për shqyrtim të marrëveshjes nëse ka shqetësime se dënimi i propozuar nuk është i arsyeshëm. Gjykatës i lejohet ta bëjë këtë sipas paragrafit 18.1 (më lartë) bazuar në argumentin se kryerësi nuk e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e marrëveshjes mbi pranim të fajësisë, respektivisht se atyre do t'u shqiptohet dënim i cili është më i lartë se dënimi i negociuar. Nëse gjykata tashmë e ka pranuar marrëveshjen fillestare dhe mëson për fakte të cilat nuk do të lejojnë shqiptimin e dënimit të dakorduar në marrëveshje, ajo mund ta njoftojë të pandehurin dhe ta refuzojë marrëveshjen duke u thirrur në bazën se i pandehuri tanimë nuk i kupton pasojat e marrëveshjes.

Nuk ka ndonjë kërkesë specifike nëse të pandehurit duhet ofruar një dënim brendakufijve të

caktuar apo një dënim specifik në shkëmbim të pranimit të fajësisë. Secila i ka meritat e veta. Gjithashtu, nuk ka ndonjë kërkesë që i pandehuri ta pranojë fajësinë për secilën veprë penale të përfshirë në aktakuzë. Gjykata duhet ta vlerësojë dënimin e rekomanduar dhe akuzat në tërësinë e tyre dhe të vendos nëse ka bazë të mjaftueshme për të shqiptuar dënimin e propozuar. Gjykata çdoherë duhet të kërkojë nga prokuroria dhe mbrojtja që ta arsyetojnë dënimin e propozuar.

Përfundimisht, në mënyrë që të lehtësohet marrëveshja mbi pranimin e fajësisë dhe të shpejtohet procesimi i rastit, gjykatat inkurajohen fuqishëm që t'i refuzojnë marrëveshjet për pranim të fajësisë të cilat janë të papranueshme dhe të lejojnë rinegociimin e tyre në vend se të shqiptojnë dënim jashtë dënimit të propozuar në marrëveshje dhe kështu të shmangin ankesat dhe zgjidhjen e rastit në nivel të shkallës së apelit.

11.1 Urdhri ndëshkimor

Kapitulli 30 i Kodit të Procedurës Penale parasheh dhënien e urdhrin ndëshkimor. Kjo i lejon prokurorit që në aktakuzë të kërkojë nga gjykata që të jep urdhër ndëshkimor për vepra penale për të cilat parashihet dënimi maksimal deri në 3 vjet burgim. Dënimet janë të kufizuara kryesisht në masa joizoluese, vërejtja gjyqësore dhe konfiskimi i kufizuar. Ajo që është e rëndësishme për gjykatën në këtë drejtim është se nuk është i domosdoshëm pëlqimi i të pandehurit për dhënien e urdhrin ndëshkimor. Gjykata mund ta refuzojë kërkesën nëse, ngjashëm si te marrëveshja mbi pranim të fajësisë, gjykata nuk bindet se masat e propozuara janë adekuate dhe/ose se nga të dhënat faktike në aktakuzë mund të pritët shqiptimi i ndonjë dënimi tjetër

Sikurse në të gjitha rastet tjera, viktimës duhet dhënë mundësia që t'i drejtohet gjykatës lidhur me zgjidhjen e çështjes dhe ndikimit që urdhri mund ta ketë në gjasat për kompensim. Prandaj, para se të pranohet urdhri ndëshkimor, gjykata duhet të kërkojë dëshmi nga prokurori se viktima është kontaktuar dhe është njoftuar për urdhrin ndëshkimor, përfshirë mundësinë për t'i paraqitur prova gjykatës, apo se prokurori nuk ka arritur ta kontaktojë viktimën dhe përpjekjet e bëra në këtë drejtim.

KAPITULLI XII

SHQYRTIMI NGA APELI

12.1 Diskrecioni i Gjykatës së Apelit për shqyrtimin e dënimit

Siç është diskutuar përgjatë këtij manuali, një nga qëllimet më të rëndësishme të udhëzimit për caktimin e dënimit është që të zvogëlohet dallimi apo pabarazia në dënime pa hequr diskrecionin e gjyqtarëve për t'iu adaptuar situatave të veçanta. Nëse udhëzimet ndiqen siç duhet, nevoja për shqyrtim nga Apeli do të zvogëlohet dukshëm sikurse që do të zvogëlohen edhe bazat mbi të cilat gjykata duhet ta shqyrtojë vendimin e gjykatës së shkallës më të ultë.

12.2 Eliminimi i dallimeve apo pabarazive

Një kritikë e gjithmbarshme e procedurave të dënimit për të cilat nuk lejohet shqyrtimi nga shkalla e apelit është pabarazia që rezulton nga dënimet në raste të cilat nuk duken të jenë shumë të ndryshme nga njëra tjetra. Në mendjen e publikut, dënimet e pabarabarta tëshqiptuara ndaj të pandehurve të dënuar për të njëjtën vepër, pa ndonjë arsytim konkret, përbëjnë teke të gjykatës dhe mund të çojnë në humbjen e respektit për sistemin gjyqësor. Dallimet e pajustificuara në dënime gjithashtu janë të prirura për të penguar rehabilitimin e të burgosurve. Efektet e tilla të padëshirueshme të dallimeve në dënime pengojnë qëllimet e dënimit të parandalimit dhe rehabilitimit.¹⁸⁴ Andaj, në thelbin e saj, Gjykata e Apelit ka detyrën e rëndësishme të eliminimit të dallimeve potenciale ndërmjet dënimeve, sigurimit të arsytimeve adekuate dhe zvogëlimit të arbitraritetit.

Në vendet e së drejtës zakonore, vendimet e gjykatave më të larta me të cilat zgjidhet një çështje ligjore shërbejnë si precedentë të detyrueshëm në mosmarrëveshje të ngjashme në të ardhmen. Në vendet e së drejtës kontinentale, vendimet nuk e kanë këtë efekt por pavarësisht kësaj mund të japin udhëzime të vlefshme për gjyqtarët tjerë që merren me raste apo çështje të ngjashme, në rastet të cilat ngritin ndonjë çështje të gjerë shoqërore apo ndonjë çështje të rëndësishme ligjore. Prandaj theksimi i arsyeve, të cilat rrjedhin nganjë studim i detajuar i çështjeve ligjore të trajtuara, duhet të bëhet me kujdes të veçantë në raste të tilla në mënyrë që të përmbushen pritjet e palëve dhe të shoqërisë.¹⁸⁵

¹⁸⁴ Dupree Julian Glenn, Revista e së drejtës së Luizianas (Louisiana Laë Revieë), Volumi 33/No.4, ABA Standardet minimale për drejtësinë penale-A, Shqyrtimi i dënimit nga apeli, fq. 561.

¹⁸⁵ Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropian (KKGJE), Opinioni Nr. 11 i KKGJE për vëmendjen e Këshillit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi cilësinë e vendimeve gjyqësore, Strasburg (2008).

Dallimet dëmtojnë sigurinë dhe qartësinë e zbatueshmërisë së kontrollit socio-juridik dhe dëmtojnë rendin shoqëror. Kur dënimet uniforme janë të përcaktuara, atëherë çdo shmangie nga dënimi i përcaktuar do të ishte e qartë dhe e dukshme dhe mund të korrigjohet brenda procesit ligjor. Në sistemet juridike bashkëkohore për trajtimin edallimeve të tillë përdoren zgjidhje procedurale dhe rivendosja e harmonizimit të dënimeve është funksioni i Gjykatës së Apelit. Andaj, kur dy raste identike vijnë para Gjykatës së Apelit dhe për to janë shqiptuar dënime të ndryshme nga gjykatat e instancave më të ulëta, Gjykata e Apelit mund t'i zgjidh këto dallime duke vendosur se cila gjykatë e instancës më të ultë ka pasur të drejtë apo duke shqiptuar dënime të reja identike ndaj kryerësve. Megjithatë, rastet krejtësisht identike me karakteristika identike personale dhe jopersonale janë shumë të rralla. Kur dallimet në dënime vijnë si rezultat i gjendjeve të ndryshme faktike të rasteve, mund të arsyetohet në aspektin social pasi që rastet e ndryshme kërkojnë trajtim të ndryshëm social. Por kur dallimet në dënime vijnë si rezultat i përvojave të ndryshme gjyqësore apo pikëpamjeve të ndryshme të gjykatave, atëherë kjo kuptohet si një padrejtësi që kërkon korrigjim.¹⁸⁶

Një vendim gjyqësor duhet të plotësojë një numër kërkesash në lidhje me atë se cilat parime të përgjithshme mund të identifikohen, pavarësisht karakteristikave specifike të secilit sistem gjyqësor dhe praktikave të gjykatave në vendet e ndryshme. Pikënisja është se qëllimi i vendimit gjyqësor është jo vetëm për të zgjidhur kontestin për t'u dhënë palëve siguri juridike, por shpesh edhe për të krijuar praktikën gjyqësore e cila mund të parandalojë shfaqjen e kontesteve tjera dhe të sigurojë harmoninë shoqërore. Gjyqtarët nëpërgjithësi duhet ta zbatojnë ligjin në mënyrë konsistente. Megjithatë, kur gjykata vendospër t'u shmang nga praktika e mëparshme gjyqësore, kjo duhet të ceket qartë në vendimin e saj. Në rrethana të jashtëzakonshme, mund të jetë e përshtatshme për gjykatën që të specifikojë se ky interpretim i ri zbatohet vetëm nga data e vendimit në fjalë apo nga data e përcaktuar në vendimin e tillë.¹⁸⁷

12.3 Standardi i 'gabimit të dukshëm'

Sipas Dhomës së Apelit të TNPJ, "*ankesa kundër dënimit është ankesë stricto sensu; është korrigjuese në natyrë dhe jo gjykim de novo (i ri). Trupat gjykues janë të autorizuar me diskrecion të gjerë në caktimin e dënimit të përshtatshëm, për shkak të detyrimit të tyre për të individualizuar dënimet për t'iu përshtatur rrethanave të të akuzuarit dhe peshës së veprës. Si rregull, Dhoma e Apelit nuk do ta zëvendësojë dënimin e saj për atë të shqiptuar nga trupi gjykues përveç nëse pala ankimore dëshmon se trupi gjykues ka bërë "gabim të dukshëm" në ushtrimin e diskrecionit të saj apo në rast se ka dështuar përta zbatuar ligjin e aplikueshëm. i mbetet palës e cila e kundërshton dënimin për të dëshmuar se si trupi gjykues ka tejkaluar kornizën e saj diskrecionale në shqiptimin e dënimit... Në këtë drejtim, ankuesi duhet të dëshmojë se trupi gjykues: (i) i ka dhënë peshë konsideratave të parëndësishme apo jorelevante; (ii) ka dështuar t'i jep peshë apo peshë të mjaftueshme konsideratave relevante; (iii) ka bërë gabim të qartë lidhur me faktet mbi të cilat ka ushtruar diskrecionin e saj; apo*

¹⁸⁶ Hallevy, Gabriel. E drejta për t'u dënuar: dënimi modern doktrinal. Springer Science & Business Media, 2012.

¹⁸⁷ Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropian (KKGJE), Opinioni Nr. 11 i KKGJE për vëmendjen e Këshillit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi cilësinë e vendimeve gjyqësore, Strasburg (2008).

(iv) ka marrë vendim i cili është aq i paarsyeshëm apo thjeshtë i padrejtë sa që Dhoma e Apelit është në gjendje të nxjerr përfundimin se trupi gjykues ka dështuar ta ushtrojë drejtë diskrecionin e tij.¹⁸⁸

I njëjti parim është përdorur edhe në rastin Aleksovski dhe Tadic: "Në sisteme juridike kontinentale siç është Gjermania dhe Italia, Kodet Penale përkatëse përcaktojnë se cilat rrethana duhet t'i merr parasysh gjyqtari me rastin e shqiptimin të dënimit. Gjykatat e Apelit mund të ndërhyjnë në diskrecionin e gjykatave më të ulëta nëse shqyrtimet e tyre kanë shkuar përtej atyre rrethanave apo nëse kanë shkelur dënimin e paraparë minimal apo maksimal. Dhoma e Apelit e ka ndjekur këtë praktikë të përgjithshme. Prandaj në rastin Prokurori kundër Tadic, Dhoma e Apelit ka mbajtur qëndrimin se nuk duhet të ndërhyjë në ushtrimin e diskrecionit të Trupit Gjykues lidhur me dënimin përveç nëse ka ndonjë "gabim të dukshëm"... Ky gabim konsistonte në dhënie të peshës pamjaftueshme shkallës së sjelljes nga Parashtruesi i Ankesës dhe dështimit për ta trajtuar pozitën e tij si komandant si rrethanë rënduese në raport me përgjegjësinë e tij sipas nenit 7(1) të Statutit".¹⁸⁹

Si e tillë, gjykata duhet të bëjë përpjekje t'i kufizojë shqyrtimet e saj të "përshtatshmërisë" së dënimit në situatat në të cilat ka nevojë për ta zgjidhur në mënyrë definitive ndonjë çështje dhe/ose nëse ka zbatim të gabuar të dispozitave të ligjit.

¹⁸⁸ Rasti nr.IT-08-91-A, Aktgjykimi i Dhomës së Apelit në rastin Prokurori kundër Mico Stanisic & Stojan Zupljanin, Tribunali Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavi, (30 qershor 2016), Par.1100

¹⁸⁹ Rasti Nr.IT-95-14/1-A, Aktgjykimi, Prokurori kundër Zlatko Aleksovski, Tribunali Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavi, (24 mars 2000), Par.186-187, citohet Prokurori kundër Tadic, Rasti Nr.: IT-94-1-A dhe IT-94-1-Abis, Aktgjykimi në ankesën ndaj dënimit.

Shtojca I
TABELA PËR MATJEN E DËNIMIT

	1	2	3	4	5	6	7	8	9
I.	Dënimi i aplikueshëm	arshtatshmëria përdënim me kusht	putja maksimale kuraplikohet neni 75	putja e pjesshme kur aplikohet neni 75	rrethanat që arsyetojnë zbutjen maksimale të dënimit brenda kufirit	Faktorët që tregojnë më shumë rrethana lehtësuese sesa rënduese	Pikënisja për matjen e dënimit (Rënd.= Leht.)	Faktorët që tregojnë më shumë rrethana rënduesesesa lehtësuese	Faktorët që arsyetojnë dënimin maksimal brendakufirit
a.	vetëm gjobë	X			x	x	x	x	x
b.	1,2 deri 3 muaj	Po			min.1 muaj	min. 40ditë	45 ditë	maks. 2muaj	maks. 3muaj
c.	1,2 deri 6 muaj	Po			min.1 muaj	min. 2 muaj	3 muaj	maks. 5 muaj	maks. 6muaj
d.	1,2 deri 1vit	Po			min.1 muaj	min. 4 muaj	6 muaj	maks. 10 muaj	maks. 1vit
e.	1 deri 2vjet	Po			min.1 muaj	min. 6muaj	1 vit	maks. 1vit e 6muaj	maks. 2 vjet
f.	1 deri 3vjet	Po			min.1 muaj	min. 8 muaj	1 vit	maks. 2vjet	maks. 3 vjet
g.	1 deri 5vjet	Po			min.1 muaj	min. 1vit	2 vjet	maks. 4 vjet	maks. 5 vjet
ë.	1 deri 7vjet	nëse zbutet			min. 1 vit	min. 2 vjet	3 vjet	maks. 5vjet	maks. 7 vjet
i.	1 deri 8vjet	nëse zbutet			min. 1 vit	min. 3vjet	4 vjet	maks. 6vjet	maks. 8 vjet
j.	1 deri 10vjet	nëse zbutet			min. 1 vit	min. 4vjet	5 vjet	maks. 8 vjet	maks. 10 vjet
k.	1 deri 15vjet	Jo			min.1 vit	min. 5vjet	7 vjet	maks. 12 vjet	maks. 15 vjet
l.	1 deri 20vjet	Jo			min. 1 vit	min. 6vjet	10 vjet	maks. 16 vjet	maks. 20 vjet
m.	1 deri 25vjet	Jo			min. 1 vit	min. 7vjet	12 vjet	maks. 20 vjet	maks. 25 vjet
II.	Dënimi i aplikueshëm	arshtatshmëria përdënim me kusht	putja maksimale kuraplikohet neni 75	putja e pjesshme kur aplikohet neni 75	rrethanat që arsyetojnë zbutjen maksimale të dënimit brenda kufirit	Faktorët që tregojnë më shumë rrethana lehtësuese sesa rënduese	Pikënisja për matjen e dënimit (Rënd.= Leht.)	Faktorët që tregojnë më shumë rrethana rënduesesesa lehtësuese	Faktorët që arsyetojnë dënimin maksimal brendakufirit
a.	3 muaj -1vit	Po		min. 1 muaj	min. 3 muaj	min. 6muaj	7muaj	maks. 10muaj	maks. 1 vit
b.	3 muaj - 3vjet	Po		min. 1 muaj	min. 3 muaj	min. 10 muaj	1 vjet e 6muaj	maks. 2vjet	maks. 3 vjet
c.	3 muaj - 5vjet	Po		min. 1 muaj	min. 3 muaj	min. 15muaj	2 vjet e 6muaj	maks. 4 vjet	maks. 5 vjet
d.	6 muaj-1vit	Po		min. 1 muaj	min. 6 muaj	min. 7 muaj	9muaj	maks. 10muaj	maks. 1 vit
e.	6 muaj-2vjet	Po		min. 1 muaj	min. 6muaj	min. 10muaj	1 vit	maks. 1vit e 6 muaj	maks. 2 vjet
f.	6 muaj-3vjet	Po		min. 1 muaj	min. 6 muaj	min. 1 vit	1 vjet e 6muaj	maks. 2vjet	maks. 3 vjet
g.	6muaj-4vjet	Po		min. 1 muaj	min. 6muaj	min. 15muaj	2vjet	maks. 3 vjet	maks. 4 vjet
ë.	6 muaj-5vjet	Po		min. 1 muaj	min. 6muaj	min.1vit e 6 muaj	2 vjet e 6muaj	maks. 4 vjet	maks. 5 vjet
i.	6 muaj-8vjet	nëse zbutet	min. 1 muaj	min. 3 muaj	min. 6muaj	min. 2 vjet	4 vjet	maks. 6 vjet	maks. 8 vjet
j.	6muaj-10vjet	nëse zbutet	min. 1 muaj	min. 3 muaj	min. 6muaj	min.2 vjet e 6muaj	5vjet	maks. 8 vjet	maks. 10 vjet

	1	2	3	4	5	6	7	8	9
III.	Dënimi i aplikueshëm	Prishtatshmëria përdënim me kusht	Uutja maksimale kuraplikohet nën 75	Uutja e pjesshme kuraplikohet nën 75	rrethanat që arsyetojnë zbutjen maksimale të dënimit brenda kufirit	Faktorët që tregojnë më shumë rrethana lehtësuese sesa rënduese	Pikënisja për matjen e dënimit (Rënd.=Leht.)	Faktorët që tregojnë më shumë rrethana rënduese sesa lehtësuese	Faktorët që arsyetojnë dënimin maksimal brenda kufirit
a.	1-2vjet	Po	min. 3 muaj	min. 6 muaj	min. 1 vit	min. 1 vit e 3 muaj	1 vit e 6 muaj	maks. 1 vit e 8 muaj	maks. 2 vjet
b.	1-3vjet	Po	min. 3 muaj	min. 6 muaj	min. 1 vit	min. 1 vit e 6 muaj	2 vjet	maks. 2 vjet e 6 muaj	maks. 3 vjet
c.	1-4vjet	Po	min. 3 muaj	min. 6 muaj	min. 1 vit	min. 1 vit e 9 muaj	2 vjet	maks. 3 vjet	maks. 4 vjet
d.	1-5 vjet	Po	min. 3 muaj	min. 6 muaj	min. 1 vit	min. 2 vjet	3 vjet	maks. 4 vjet	maks. 5 vjet
e.	1-6vjet	nëse zbutet	min. 3 muaj	min. 6 muaj	min. 1 vit	min. 2 vjet e 3 muaj	3 vjet	maks. 5 vjet	maks. 6 vjet
f.	1-7vjet	nëse zbutet	min. 3 muaj	min. 6 muaj	min. 1 vit	min. 2 vjet e 6 muaj	3 vjet e 6 muaj	maks. 6 vjet	maks. 7 vjet
g.	1-8vjet	nëse zbutet	min. 3 muaj	min. 6 muaj	min. 1 vit	min. 3vjet	4 vjet	maks. 6 vjet	maks. 8 vjet
ë.	1-10vjet	nëse zbutet	min. 3 muaj	min. 6 muaj	min. 1 vit	min. 3 vjet	5 vjet	maks. 8 vjet	maks. 10 vjet
i.	1-12vjet	Jo	min. 3 muaj	min. 6 muaj	min. 1 vit	min. 4 vjet	6 vjet	maks. 10 vjet	maks. 12 vjet
j.	1-15vjet	Jo	min. 3 muaj	min. 6 muaj	min. 1 vit	min. 5 vjet	8 vjet	maks. 12 vjet	maks. 15 vjet
	1	3	4	5	6	7	8	9	10
IV.	Dënimi i aplikueshëm	Prishtatshmëria përdënim me kusht	Uutja maksimale kuraplikohet nën 75	Uutja e pjesshme kuraplikohet nën 75	rrethanat që arsyetojnë zbutjen maksimale të dënimit brenda kufirit	Faktorët që tregojnë më shumë rrethana lehtësuese sesa rënduese	Pikënisja për matjen e dënimit (Rënd.=Leht.)	Faktorët që tregojnë më shumë rrethana rënduese sesa lehtësuese	Faktorët që arsyetojnë dënimin maksimal brenda kufirit
a.	2-5vjet	Po	min. 6muaj	min. 1 vit	min. 2 vjet	min. 2 vjet e 6 muaj	3 vjet	maks. 4 vjet	maks. 5 vjet
b.	2-7vjet	nëse zbutet	min. 6 muaj	min. 1 vit	min. 2 vjet	min. 3 vjet	4 vjet	maks. 6 vjet	maks. 7 vjet
c.	2-8vjet	nëse zbutet	min. 6muaj	min. 1 vit	min. 2 vjet	min. 3 vjet e 6 muaj	5 vjet	maks. 7 vjet	maks. 8 vjet
d.	2-10vjet	nëse zbutet	min. 6 muaj	min. 1 vit	min. 2 vjet	min. 4 vjet	6 vjet	maks. 8 vjet	maks. 10 vjet
e.	2-12vjet	Jo	min. 6muaj	min. 1 vit	min. 2 vjet	min. 5 vjet	7 vjet	maks. 10 vjet	maks. 12 vjet
f.	së paku 2vjet	Jo	min. 6 muaj	min. 1 vit	min. 2 vjet	min. 7 vjet	12vjet	maks. 20 vjet	maks. 25 vjet
	1	2	3	4	5	6	7	8	9

V.	Dënimi i aplikueshëm	Prishtatshmëria përdënim me kusht	Uthja maksimale kur aplikohet nën 75	Uthja e pjesshme kur aplikohet nën 75	Rrethanat që arsyetojnë zbutjen maksimale të dënimit brenda kufirit	Faktorët që tregojnë më shumë rrethana lehtësuese sesa rënduese	Pikënisja për matjen e dënimit (Rënd.= Leht.)	Faktorët që tregojnë më shumë rrethana rënduese sesa lehtësuese	Faktorët që arsyetojnë dënimin maksimal brenda kufirit
a.	3vjet	Po	min. 1 vit	min. 2 vjet	3 vjet	3 vjet	3 vjet	3 vjet	maks. 3 vjet
b.	3-5vjet	Po	min. 1 vit	min. 2 vjet	min. 3 vjet	min. 3 vjet e 6 muaj	4 vjet	maks. 4 vjet e 6 muaj	maks. 5 vjet
c.	3-7vjet	nëse zbutet	min. 1 vit	min. 2 vjet	min. 3 vjet	min. 4 vjet	5 vjet	maks. 6 vjet	maks. 7 vjet
d.	3-10vjet	nëse zbutet	min. 1 vit	min. 2 vjet	min. 3 vjet	min. 4 vjet e 6 muaj	6 vjet	maks. 8 vjet	maks. 10 vjet
e.	3-12vjet	Jo	min. 1 vit	min. 2 vjet	min. 3 vjet	min. 5 vjet	7 vjet	maks. 10 vjet	maks. 12 vjet
f.	3-15vjet	Jo	min. 1 vit	min. 2 vjet	min. 3 vjet	min. 6 vjet	9 vjet	maks. 13 vjet	maks. 15 vjet
g.	në pak se 3/ sëpaku 3vjet	Jo	min. 1 vit	min. 2 vjet	min. 3 vjet	min. 7 vjet	13 vjet	maks. 20 vjet	maks. 25 vjet
ë.	së paku 4 vjet	Jo	min. 1 vit	min. 2 years	min. 4 vjet	min. 8 vjet	14 vjet	maks. 21 vjet	maks. 25 vjet

	1	2	3	4	5	6	7	8	9
VI.	Dënimi i aplikueshëm	Prishtatshmëria përdënim me kusht	Uthja maksimale kur aplikohet nën 75	Uthja e pjesshme kur aplikohet nën 75	Rrethanat që arsyetojnë zbutjen maksimale të dënimit brenda kufirit	Faktorët që tregojnë më shumë rrethana lehtësuese sesa rënduese	Pikënisja për matjen e dënimit (Rënd.= Leht.)	Faktorët që tregojnë më shumë rrethana rënduese sesa lehtësuese	Faktorët që arsyetojnë dënimin maksimal brenda kufirit
a.	5-10vjet	nëse zbutet	min. 3 vjet	min. 4 vjet	min. 5 vjet	min. 6 vjet	7 vjet	maks. 9 vjet	maks. 10 vjet
b.	5-12vjet	Jo	min. 3 vjet	min. 4 vjet	min. 5 vjet	min. 7 vjet	8 vjet	maks. 10 vjet	maks. 12 vjet
c.	5-15vjet	Jo	min. 3 vjet	min. 4 vjet	min. 5 vjet	min. 8 vjet	10 vjet	maks. 13 vjet	maks. 15 vjet
d.	5-20vjet	Jo	min. 3 vjet	min. 4 vjet	min. 5 vjet	min. 8 vjet	12 vjet	maks. 17 vjet	maks. 20 vjet
e.	jo më pak se 5/ së paku 5vjet	Jo	min. 3 vjet	min. 4 vjet	min. 5 vjet	min. 9 vjet	15 vjet	maks. 21 vjet	maks. 25 vjet
	1	2	3	4	5	6	7	8	9

VII.	Dënimi i aplikueshëm	Prishtatshmëria e përdënimit me kusht	Uthja maksimale kur aplikohet nën 75	Uthja e pjesshme kur aplikohet nën 75	rrethanat që arsyetojnë zbutjen maksimale të dënimit brenda kufirit	Faktorët që tregojnë më shumë rrethana lehtësuese sesa rënduese	Pikënisja për matjen e dënimit (Rënd.= Leht.)	Faktorët që tregojnë më shumë rrethana rënduese sesa lehtësuese	Faktorët që arsyetojnë dënimin maksimal brendakufirit
a.	7-12vjet	Jo	min. 3 vjet	min. 5 vjet	min. 7 vjet	min. 8 vjet	9 vjet	maks. 11 vjet	maks. 12 vjet
b.	7-15vjet	Jo	min. 3 vjet	min. 5 vjet	min. 7 vjet	min. 9 vjet	11 vjet	maks. 13 vjet	maks. 15 vjet
c.	7-20vjet	Jo	min. 3 vjet	min. 5 vjet	min. 7 vjet	min. 10 vjet	13 vjet	maks. 17 vjet	maks. 20 vjet
d.	së paku 7vjet	Jo	min. 3 vjet	min. 5 vjet	min. 7 vjet	min. 11 vjet	15 vjet	maks. 21 vjet	maks. 25 vjet
e.	së paku 8vjet	Jo	min. 3 vjet	min. 5 vjet	min. 8 vjet	min. 12 vjet	16 vjet	maks. 23 vjet	maks. 25 vjet
f.	10vjet	nëse zbutet	min. 5 vjet	min. 8 vjet	10 vjet	10 vjet	10 vjet	10 vjet	maks. 10 vjet
g.	10-20vjet	Jo	min. 5 vjet	min. 8 vjet	min. 10 vjet	min. 12 vjet	15 vjet	maks. 18 vjet	maks. 20 vjet
ë.	jo më pak se 10/ së paku 10vjet	Jo	min. 5 vjet	min. 8 vjet	min. 10 vjet	min. 13 vjet	17 vjet	maks. 22 vjet	maks. 25 vjet
i.	15vjet	Jo	min. 5 vjet	min. 10 vjet	15 vjet	15 vjet	15 vjet	15 vjet	maks. 15 vjet
j.	jo më pak se 15/ së paku 15vjet	Jo	min. 5 vjet	min. 10 vjet	min. 15 vjet	min. 17 vjet	20 vjet	maks. 23 vjet	maks. 25 vjet
k.	së paku 20vjet	Jo	min.5 vjet	min. 13 vjet	min. 20 vjet	min. 21 vjet	22 vjet	maks. 24 vjet	maks. 25 vjet

¹ Gjoha mund ta zëvendësohet për tërë dënimin.

² Është në dispozicion qortimi gjyqësor



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Seanca e Përgjithshme e Gjykatës Supreme të Kosovës, në bazë të nenit 26 paragrafi 1, pika 1.4 të Ligjit për Gjykatat, me datë 10 qershor 2021, nxjerrë këtë:

UDHËZUES

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, është kompetente për lëshimin e urdhri që i autorizon anëtarët e Autoritetit (*Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës*) të hyjnë pa paralajmërim paraprak ose leje të veçantë, në selinë dhe çfarëdo pronë dhe vend tjetër të ndërmarrjes që shfrytëzohet për kryerjen e aktiviteteve afariste nëse ekziston rreziku i fshehjes apo shkatërrimit të provave.

A r s y e t i m

Gjykata Supreme e Kosovës, në muajin mars 2021, ka pranuar një kërkesë nga Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, për nxjerrjen e një mendimi juridik apo qëndrimi parimor lidhur me kompetencën e gjykatës për lëshimin e urdhri që i autorizon anëtarët e Autoritetit (*Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës*) të hyjnë pa paralajmërim paraprak ose leje të veçantë, në selinë dhe çfarëdo pronë dhe vend tjetër të ndërmarrjes që shfrytëzohet për kryerjen e aktiviteteve afariste nëse ekziston rreziku i fshehjes apo shkatërrimit të provave.

Gjykata Supreme e Kosovë për të shqyrtuar nevojën e nxjerrjes së një udhëzuesi për këtë çështje, fillimisht e ka hulumtuar praktikën gjyqësore ekzistuese dhe bazën ligjore, dhe nga hulumtimi paraprak ka konstatuara se:

Për çështjen e mbrojtjes nga konkurrenca në Republikën e Kosovës është nxjerr Ligjin Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen nga Konkurrenca, i publikuar në Gazetën Zyrtare më datë 25 nëntor 2010, me të cilin është shfuqizuar Ligji për Konkurrencën me nr. 2004/36 si dhe të gjitha aktet nënligjore që janë në kundërshtim me këtë ligj.

Me dispozitat e nenit 28 të Ligjin Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen nga Konkurrenca, janë përcaktuar “**Detyrat dhe Përgjegjësit e Komisionit**”¹⁹⁰. Me dispozitën e nenit 28, paragrafi 1, të Ligjin Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen nga Konkurrenca, përcaktohet se: “*Komisioni ka këto detyra dhe përgjegjës*”, ndërsa në pikën 1.6, të nenit të njëjtë përcaktohet se: “*merr vendim mbi bazën e të cilit Autoriteti i parashtron kërkesë Gjykatës kompetente për lëshimin e urdhrin për të hetuar pa paralajmërim paraprak në selinë ose objekte tjera, depove të hapura dhe mjetet transportuese, dokumentet personale dhe gjësende që gjenden atje si dhe vulosjen me plumb dhe sekuestrimin e përkohshëm të sendeve të hetimit bazuar në nenin 40 paragrafi 1. dhe nenit 42 të këtij ligji*”.

Me dispozitën e cituara një prej kompetencave si e drejtë dhe përgjegjësi e Komisionit të Konkurrencës është edhe e drejta për të parashtruar kërkesë gjykatës kompetente për lëshimin e urdhrin për të hetuar pa paralajmërim paraprak.

Urdhri për hetim paraprak nënkupton hetimin në:

- selinë ose objekte tjera;
- depove të hapura dhe mjetet transportuese;
- dokumentet personale dhe gjësende që gjenden atje; si dhe
- vulosjen me plumb dhe sekuestrimin e përkohshëm të sendeve të hetimit bazuar në nenin 40 paragrafi 1. dhe nenit 42 të këtij ligji.

Me dispozitën e nenit 40 të Ligjin Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen nga Konkurrenca, është rregulluar “**Zbatimi i Kontrollit të Paparalajmëruar**”, me ç ‘rast është përcaktuar se: “*Nëse ndërmarrja refuzon të lejojë hyrjen e personave të autorizuar në lokalet afariste, ose pengon shikimin në librat afariste dhe dokumente tjera, ose në ndonjë mënyrë tjetër vështirëson zbatimin e kontrollit të paparalajmëruar, personat e autorizuar mundën me ndihmën e punëtorëve të autorizuar të Ministrisë se Punëve të Brendshme edhe kundër vullnetit të ndërmarrësit të hyjë në lokalet afariste dhe të kryej inspektimin e të dhënave në librat afariste dhe dokumentet tjera*”.

Nga dispozita e cituara në mënyrë parimore nënkuptohet se personat e autorizuar të Komisionit të Konkurrencës nën kushtet e caktuara ligjore realizojnë kontrollin e paparalajmëruar, gjithmonë duke respektuar kompetencat lidhur me objektin e kontrollit, megjithatë në rast se ndërmarrja refuzon të zbatohet kontrolli i paparalajmëruar, atëherë kontrolli do të realizohet me ndihmën e punëtorëve të autorizuar të Ministrisë se Punëve të Brendshme edhe kundër vullnetit të ndërmarrësit.

Çështja qëndron në atë se zbatimi i kontrollit të paparalajmëruara bëhet vetëm nga personat e autorizuar të Komisionit të Konkurrencës, përjashtim bëjnë rastet e refuzimit të ndërmarrësit për të lejuar personat e autorizuar të zbatojnë kontrollin e paparalajmëruar.Me dispozitat e nenit 42 të Ligjin Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen nga Konkurrenca, është rregulluar “**Përjashtimi i dokumentacionit në kontrollin e paparalajmëruar**”. Me dispozitat e nenit 42 të Ligjin Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen nga Konkurrenca rregullohen çështjet si në vijim: “

¹⁹⁰ Komision i Konkurrencës (në tekstin e mëtejme Komision) - struktura vendimmarrëse e Autoritetit të Konkurrencës.

1). Gjatë kontrollit të paparalajmëruar nga dokumentacioni që është duke u kontrolluar bëjnë përjashtim letrat, shënimet dhe format tjera të komunikimit në mes të ndërmarrjes që është duke u zhvilluar procedura dhe të autorizuarit të tij, të cilat konsiderohen informacione të fshehta.

2). Autoriteti ka të drejtë të inspektojë dokumente nëse ndërmarrja ose i autorizuari i tij refuzojnë të japin në shikim dokumentacionin duke u thirr në fshehtësi të informacionit të referuar në paragrafin 1. të këtij neni.

3). Në rast se personi i autorizuar i Autoritetit konsideron se nuk është fjala për informacion konfidencial të referuar në paragrafin 1. të këtij neni është i detyruar që atë dokument ose kopjen e atij dokumenti të vërtetuar ta futë në një zarf të posaçëm para ndërmarrësit dhe të autorizuarit të tij nëse është prezent, ta mbyllë, të shënoj datën dhe të vulosë me vulën zyrtare të Autoritetit, të cilën do ta nënshkruajnë të gjitha palët prezent dhe të autorizuarit.

4). Në rastet e referuara në paragrafin 2. dhe 3. të këtij neni, aplikohen dispozitat e ligjit për Procedurën Administrative për të vendosë lidhur me këtë çështje”.

Dispozitat e cituara nga neni 42, rregullojnë çështjen e përjashtimit të dokumentacionit në kontrollin e paparalajmëruar dhe kjo nënkupton se personat e autorizuar gjatë zbatimit të kontrollit të paparalajmëruar duhet të jenë të kufizuara vetëm brenda përgjegjësive të Komisionit të Konkurrencës (neni 28, paragrafi 1, pika 1.6 të Ligjin Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen nga Konkurrenca) dhe brenda autorizimeve që rrjedhin nga zbatimi i urdhrin për kontrollin e paparalajmëruar (neni 39 paragraf 6 të Ligjin Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen nga Konkurrenca).

Një çështje me rendësi në këtë rast ka të bëjë me situatat nga neni 42 i Ligjin Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen nga Konkurrenca, paragrafi 2 dhe 3, për të cilat situata parashihet se aplikohen dispozitat e ligjit për Procedurën Administrative për të vendosë lidhur me këtë çështje, respektivisht dispozita e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Me dispozitat e nenit 39 të Ligjin Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen nga Konkurrenca, përcaktohet **“Kontrolli i Paparalajmëruar në Objekte Afariste dhe Objekte tjera”**, ndërsa në paragrafin 1, të këtij neni përcaktohet se: **“Para kryerjes së kontrollit të paparalajmëruar në objektet afariste, depot e hapura dhe mjetet e transportit, Autoriteti kërkon nga Gjykata e Qarkut lëshimin e një urdhri që i autorizon anëtarët e Autoritetit të hyjnë pa paralajmërim paraprak ose leje të veçantë, në selinë dhe çfarëdo pronë dhe vend tjetër të ndërmarrjes që shfrytëzohet për kryerjen e aktiviteteve afariste nëse ekziston rreziku i fshehjes apo shkatërrimit të provave”**.

Lidhur me zbatimin e dispozitës së cituar në praktikë, Gjykata Supreme e Kosovës, gjen se departamente e Gjykatës Themelore në Prishtinë (Departamenti për Çështje Administrative dhe Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal) kanë pas paqartësi rrethe kompetencës për të lëshuar urdhrin për kontrollin e paparalajmëruara. Kjo rrethanë konfirmohet nga shkresat bashkangjitura në kërkesën e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës”.

Me Ligjin Nr. 04/l-226 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/l-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, janë ndryshuara dhe plotësuar dispozitat nga neni 2, 3, 4, 7, 9, 10, 13, 15, 18, 20, 24, 25, 26, 27, 28, 30, 33, 25, 36, 38, 44, 46, 53, 57, 58 dhe 62, por nuk është ndryshuara

dhe plotësuar neni 39, respektivisht nuk është ndryshuar përmbajtja e tekstit ku theksohet “*Autoriteti kërkon nga Gjykata e Qarkut lëshimin e një urdhri,....*”.

Më qëllim të interpretimit adekuat të dispozitës së cituara nga neni 39 Ligjin Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen nga Konkurrenca, i cili interpretim përveç të tjerave duhet të behët sipas metodës së interpretimit sistematik të dispozitave ligjore, Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se të rëndësishëm janë edhe ndryshim plotësimet e Ligjit nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, në këtë rast dispozita nga neni 33, 35, 36 dhe 38.

Me Ligjin Nr. 04/L-226 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, neni 17, 18, 19 dhe 20, ndryshon plotëson dispozita nga neni 33, 35, 36 dhe 38, me përmbajtje si në vinim:

Neni 17 Neni 33 i ligjit bazik, paragrafi 5, togfjalëshi “*Gjykata kompetente e Republikës së Kosovës*” zëvendësohet me togfjalëshin “*Gjykata kompetente për çështje administrative*”.

Neni 18 Neni 35 i ligjit bazik paragrafi 6, togfjalëshi “*Gjykata kompetente e Republikës së Kosovës*” zëvendësohet me togfjalëshin “*Gjykata kompetente për çështje administrative*”.

Neni 19 Neni 36 i ligjit bazik paragrafi 2, togfjalëshi “*Gjykata kompetente e Republikës së Kosovës*” zëvendësohet me togfjalëshin “*Gjykata kompetente për çështje administrative*”.

Neni 20 Neni 38 i ligjit bazik paragrafi 3, togfjalëshi “*Gjykatës kompetente të Republikës së Kosovës*” zëvendësohet me togfjalëshin “*Gjykata kompetente për çështje administrative*”.

Përveç dispozitave të cituara të cilat kanë referencë në kompetencën e gjykatës kompetente për çështje administrative, me Ligjit nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, neni 32, zhvillimi i procedurës nga autoriteti përcakton se: “*Autoriteti ne ushtrimin e funksionit të tij zbaton dispozitat e Ligjit për Procedurën Administrative përveç rasteve kur ky ligj përcakton ndryshe*”.

Në logjikën e trajtimit me procedurë administrative të çështjes objekt i procedurës sipas Ligjit nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, janë edhe dispozitat në vijim:

Neni 24, paragraf 4, me të cilën përcaktohet se: “***Masat ndëshkuese, dënimet të cilat i shqipton Autoriteti janë të hyra që derdhen në Buxhetin e Republikës së Kosovës***”.

Neni 60, paragraf 5, me të cilën përcaktohet se: “*Shqiptimi i masës ndëshkuese, sipas këtij ligji, nuk është përgjegjësi penale ndaj personave të cilëve u është shqiptuar masa në pajtim me dispozitat e këtij ligji*”.

Neni 48, paragraf 5, me të cilën përcaktohet se: “*Kundër vendimit për masat e përkohshme nga paragrafi 1. i këtij neni nuk është e lejuar ankesa, por pala, me padi, mund të iniciojë konflikt administrativ pranë Gjykatës Kompetente të Kosovës*”.

Edhe dispozitat nga neni 60, që i referohen mbrojtjes gjyqësore përcaktojnë se çështja nga Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, kalon me padi në konflikt administrativ. Për këtë qëllim me dispozitën e nenit 60, paragraf 1, përcaktohet se: “*Kundër vendimit të Autoritetit, me të cilin konstatohet shkelja e këtij ligji dhe shqiptohet masa ndëshkuese si dhe vendimit me të cilin ndërpritet procedura për shkak të çështjeve paraprake, nuk është e lejuar ankesa,*

mirëpo pala në afatin prej tridhjetë (30) ditësh, me padi mund të inicioj konfliktin administrativ në Gjykatën kompetente të Kosovës”.

Gjykata Supreme e Kosovës, në kontekstin e dispozitave të cituara, vlerëson se duke e marrë në konsideratë edhe qëllimin e Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen nga Konkurrenca, e që është: *“të përcaktohen rregullat dhe masat për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, kompetencat, organizimi i Autoritetit për mbrojtjen e konkurrencës si dhe procedurat në zbatim të këtij ligji”* vlerëson dhe vendos përmes këtij udhëzuesi që kompetente për lëshimin e urdhri që i autorizon anëtarët e Autoritetit (*Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës*) të hyjnë pa paralajmërim paraprak ose leje të veçantë, në selinë dhe çfarëdo pronë dhe vend tjetër të ndërmarrjes që shfrytëzohet për kryerjen e aktiviteteve afariste nëse ekziston rreziku i fshehjes apo shkatërrimit të provave është Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Në logjikën e këtij qëndrimi parimor (udhëzuesi, mendimi apo qëndrimi) është edhe natyra e procedurës që zhvillohet pran Autoritetit të Konkurrencës, e cila si procedurë ka referenca në Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen nga Konkurrenca dhe Ligjin për Procedurën Administrative, respektivisht Ligjin për Procedurën e përgjithshme Administrative. Nga kjo rrjedh edhe kuptimi se urdhri që i autorizon anëtarët e Autoritetit (*Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës*) të hyjnë pa paralajmërim paraprak ose leje të veçantë, në selinë dhe çfarëdo pronë dhe vend tjetër të ndërmarrjes që shfrytëzohet për kryerjen e aktiviteteve afariste nëse ekziston rreziku i fshehjes apo shkatërrimit të provave, nuk mund të jetë veprim i procedurës penale, pasi që shqiptimi i masës ndëshkuese, sipas këtij ligji, nuk është përgjegjësi penale ndaj personave të cilëve u është shqiptuar masa në pajtim me dispozitat e këtij ligji (*neni 60 paragrafi 5*). Qëllimi i urdhrit *“për hyrje pa paralajmërim”* është në funksion të hetimit administrativ që ka si kompetencë Komisioni i Konkurrencës i cili ndërmerr veprime për zbatimin e dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen nga Konkurrenca, e sipas të cilit mundë të shqiptohen masa ndëshkues ligjshmëria e të cilave do të vlerësohet dhe konstatohet sipas padisë për hapjen e konfliktit administrativ pran gjykatës kompetente.

Gjykata Supreme, gjithashtu vlerëson se nuk është e zakonshëm dhe as logjike që të nxirret urdhri në procedurë penale, sipas kërkesës së një autoriteti i cili nuk është i autorizuar të hetoj veprat penale dhe as të parashtrij akuzë për veprat penale, prandaj në këtë rast natyra e urdhrit dhe kompetenca e gjykatës sipas nenit 39 paragraf 1, është interpretuar në frymën e procedurës për të cilën nxirret urdhri.

Argument shtesë për këtë qëllim sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme është edhe fakti se në cilën procedurë do të mund të shihet dhe vlerësohet ligjshmëria e urdhërit të nxjerr *“për hyrje pa paralajmërim”*. Nëse udhëri do të nxirret në procedurë penale, atëherë do të pamundësohej vlerësimi i ligjshmërisë së urdhërit sepse masa eventuale e shqiptuar do të vlerësohej në procedurën e konfliktit administrativ, në të cilën procedurë nuk do të mund të shikohej dhe çliësohej ligjshmëria e urdhrit të nxjerrë në procedurë penale për shkak të mungesës së kompetencës lëndore.

(Udhëzuesi i miratuar në Seancën e Përgjithshme të Gjykatës Supreme, i mbajtur më 10 qershor 2021).



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Mbledhja e Përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 26 paragrafi 1. pika 1.4 të Ligjit për Gjykatat, më datë 10 qershor 2021, me vota unanime të gjithë gjyqtarëve prezent nxjerr këtë:

UDHËZUES

Organet kompetente për shqiptimin e masave ndëshkimore sipas nenit 23 të ligjit nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid – 19 në Republikën e Kosovës, janë Policia e Kosovës, Inspektorati Shëndetësor, Inspektorati Farmaceutik, Inspektorati Sanitar dhe inspektoratet komunale, pa marrë parasysh lartësinë e gjobës të paraparë me këtë ligj.

A r s y e t i m

Shefi i Sektorit për Çështje Ligjore i Policisë së Kosovës Çlirim Hajdini i është drejtuar kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës me kërkesë për dhënien e udhëzimeve për kompetencën e organeve kompetente për shqiptimin e masave ndëshkimore sipas Ligjit nr. 07/L-006 Për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid – 19, me arsyetim se lidhur kërkesat për fillimin e procedurës së kundërvajtjes gjykatat Themelore Divizioni për kundërvajtje janë shpall jo kompetente . Në këtë drejtim në kërkesë kërkojnë që kjo gjykatë të qartësoj aplikimin e dispozitës së nenit 23 Ligjit nr. 07/L-006 Për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid – 19, si dhe nenin 56 të Ligjit nr. 05/L-087 Për Kundërvajtje dhe kompetencën e organit të kundërvajtjes dhe gjykatës.

Fillimisht dega penale e Gjykatës Supreme të Kosovës gjatë analizës paraprake ka marr qëndrim që në bazë të nenit 26 paragrafi 1. pika 1.4 të Ligjit për Gjykatat ka kompetencë mes tjerash edhe të nxjerr një udhëzues për zbatimin unik të ligjeve nga gjykatat në territorin e Kosovës.

Kësisoj, gjatë analizës u konstatua si vijon:

Ligji nr. 07/L-006 Për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid – 19, në paragrafin 1. të nenit 23 ka përcaktuar se, organet kompetente për shqiptimin e masave ndëshkimore, “*janë Policia e Kosovës, Inspektorati Shëndetësor, Inspektorati Farmaceutik, Inspektorati Sanitar dhe inspektoratet komunale*”.

Ligjit nr. 05/L-87 Për Kundërvajtje në nenin 55 ka rregulluar çështjen e kompetencës dhe përbërjen e gjykatës, kësijoj paragrafi 1 përcakton se, gjykata gjykon në kufijtë e kompetencës së saj lëndore të paraparë me ligj ndërsa në paragrafin 4 thuhet se, “*për disa kundërvajtje të përcaktuara me ligj apo rregullore të Kuvendit të Komunës, procedura e kundërvajtjes mund të zhvillohet dhe sanksionin kundërvajtës mund ta shqiptoj organi i administratës shtetërore ose organi i cili kryen autorizime publike të mbikëqyrjes për zbatimin e ligjit, në të cilin janë paraparë kundërvajtja*”. Sipas interpretimit të kësaj dispozite ligjore nënkuptohet se për disa kundërvajtje të përcaktuara me ligj procedura e kundërvajtjes zhvillohet dhe sanksionin kundërvajtës mund ta shqiptoj organi i administratës shtetërore për të cilin është caktuar si mbikëqyrës të zbatimit të ligjit. Meqenëse, siç u cek më lartë Ligji nr. 07/L-006 Për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid – 19, në paragrafin 1. të nenit 23 ka përcaktuar qartë se, organet kompetente për shqiptimin e masave ndëshkimore, “*janë Policia e Kosovës, Inspektorati Shëndetësor, Inspektorati Farmaceutik, Inspektorati Sanitar dhe inspektoratet komunale*”, nënkuptohet se edhe Policia e Kosovës është kompetent për shqiptimin e gjobave edhe mbi 1000 euro pasi që ligji në fjalë e ka caktuar kompetencën e organit për shqiptimin e gjobave në shumat e parapara pa ndonjë kufizim.

Sa i takon nenit 56 të Ligjit nr. 05/L-87 Për Kundërvajtje dhe paqartësitë e Policisë së Kosovës rreth kompetencës, me të njetin ligji është përcaktuar kompetenca e organit të kundërvajtjes sipas të cilit shprehimisht në paragrafi 1. të këtij neni thuhet se “*organi i kundërvajtjes zhvillon procedurën kundërvajtës nëse me ligj është parapa kompetenca ekskluzive për veprimin e saj*”. Pra, në Ligjin nr. 07/L-006 Për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid – 19, në paragrafin 1. të nenit 23 ka përcaktuar organet kompetente për shqiptimin e masave ndëshkimore të cekura më lart në mesin e të cilave edhe Policin e Kosovës. Po ashtu sipas qëndrimit të kësaj gjykate sa i përket paragrafit 2 të nenit 56 të Ligjit për kundërvajtje në të njëjtin parashihet rregulli i përjashtimit nga paragrafi 1 i këtij nenin, kur organi për kundërvajtje është kompetent për të gjitha kundërvajtjet e që specifikisht janë: “*për të cilat është parapa sanksioni i gjobës në shumën e caktuar; për të cilat është paraparë sanksioni për personat fizik gjoba deri 500 (pesëqind) euro dhe personin juridik 1000 (njëmijë) euro, si dhe për kundërvajtjet për të cilat është parapa shqiptimi i gjobës në vend,*” kështu që për këto raste ka përjashtuar kompetencën e Divizionit për Kundërvajtje të Gjykatave Themelore në Kosovë por që ky përjashtim nuk nënkupton edhe përjashtimin e paragrafit 1 i këtij ligji pasi që organi i kundërvajtjes zhvillon procedurën e kundërvajtjes pasi që në rastin konkret vet Ligji Për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid – 19, ka përcaktuar kompetencën e organeve për shqiptimin e masave ndëshkimore.

Kësisoj në kapitullin XI të Ligjit nr. 05/L-87 Për Kundërvajtje përcaktohet procedura e veçantë e kundërvajtjes para organit të kundërvajtjes, me autorizime dhe rregulla të veçanta jashtë kompetencës së gjykatave të rregullta. Për më tepër kundër vendimeve përfundimtare të organit të kundërvajtjes sa i takon mbrojtjes gjyqësore mundë të zhvillohet konflikt administrativ sipas padisë pranë gjykatës kompetentë e që është Departamenti Administrativ i Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe vlej në rregullat e Ligjit Për Konflikt Administrativ.

(Udhëzuesi i miratuar në Seancën e Përgjithshme të Gjykatës Supreme, i mbajtur më 10 qershor 2021)



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Seanca e Përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 26 paragrafi 1 pika 1.4 të Ligjit për Gjykatat, më datë 04.02.2021, me shumicë të votave, vendos për:

Revokimin e udhëzimit të nxjerrë në Seancën e Përgjithshme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës të datës 25.09.2020, GJ.A 190/2020, lidhur me kompetencën e organit përmbarrimor për zbatimin e detyrueshëm të aktvendimeve të gjykatave themelore-divizionet për kundërvajtje;

Dhe nxjerr këtë:

UDHËZUES

PËR KOMPETENCËN E ORGANIT PËRMBARRIMOR DHE PËR PROCEDURËN E PËRMBARRIMIT TË VENDIMEVE GJYQËSORE PËR GJOBAT E DHËNA PËR KUNDËRVAJTJE

- I. Organ kompetentë përmbarrues për ekzekutimin e gjobave të dhëna për kundërvajtje është gjykata që e ka dhënë gjobën (ndëshkimin).
- II. Urdhri (vendimi) kundërvajtës me të cilin shqiptohet gjoba, cilësohet dokument përmbarrues në përputhje me dispozitat e Ligjit për Procedurën Përmbarrimore.
- III. Zbatimi i përmbarrimit të detyrueshëm për gjobën e dhënë për kundërvajtje bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit për Procedurën Përmbarrimore.
- IV. Për gjobën e papaguar brenda afatit të caktuar, zbatohet përmbarrimi i detyrueshëm në pajtim me dispozitat e Ligjit për Procedurën Përmbarrimore.

- V. Arkëtimi me dhunë i gjobës për kundërvajtjen e kryer dhe për shpenzimet e procedurës së kundërvajtjes bëhet sipas dispozitave mbi arkëtimin me dhunë të tatimit.
- VI. Për ekzekutimin e masës mbrojtëse të konfiskimit të sendit, gjykata mund të vendos për shitjen e sendeve sipas dispozitave që vlejné për ekzekutimin e tatimit, apo për dorëzimin e sendit/ëve ndonjë institucioni profesional ose publik (përkatës).

A r s y e t i m

Gjykata Supreme e Kosovës, pas nxjerrjes së udhëzimit Gj.A.190/2020, të datës 25.09.2020, ka pranuar shqetësime nga kryetarët e Gjykatave Themelore dhe Këshilli Gjyqësor, sa i përket zbatimit të udhëzimit për përmbarimin e detyrueshëm për gjobat e shqiptuara në procedurën kundërvajtëse, për shkak të ndikimit në buxhetin e Këshillit Gjyqësor, por edhe procedurës për bartjen e lëndëve tek përmbaruesit privat si organ përmbarimor.

Në kontekstin e këtyre shqetësimeve, Gjykata Supreme e Kosovës e ka hapur debatin e brendshëm, dhe njëkohësisht ka zhvilluar diskutime edhe me kryetarët e gjykatave dhe Këshillin Gjyqësor për rishikimin e mundshëm të udhëzimit në fjalë.

Nga diskutimet e brendshme të zhvilluara ka rezultuar se dykuptimësia e dispozitave të Ligjit për Kundërvajtje nr.05/L-087, por edhe të dispozitës së nenit 1 paragrafi 2 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, ka ndikuar që Gjykata Supreme në seancën e datës 25.09.2020, ta miratojë udhëzimin Gj.A.190/2020, me arsyetimet e përshkruara në këtë udhëzim. Megjithatë, pas analizë se serishme të dispozitave të ligjit në fjalë u arrit në vlerësimin dhe konkludimin që të revokohet udhëzimit Gj.A.190/2020, i datës 25.09.2020, dhe të miratohet ky udhëzim duke u mbështetur në arsyet si në vijim.

Me dispozitën e nenit 1 paragrafi 2 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, përcaktohet se: *“Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për përmbarimin e vendimit të marrë në procedurën administrative dhe për kundërvajtje me të cilin është caktuar detyrimi në të holla, përveç se kur për përmbarimin e tillë është paraparë me ligj kompetenca e organit tjetër”*.

Nga interpretimi i dispozitës në fjalë rezulton se për përmbarimin e vendimit për kundërvajtje me të cilin është caktuar detyrimi në të holla zbatohen dispozitat e këtij ligji, përveç kur parashihen përjashtime në ligj sa i përket kompetencës së organit tjetër, mirëpo përmbajtja e dispozitës në fjalë nuk e cakton organin kompetent përmbarimor. Pra, nga kjo dispozitë përcaktohet se cilat dispozita ligjore zbatohen në procedurën e përmbarimit, pa caktuar se cili është organ përmbarimor.

Me dispozitën e neni 1 paragrafi 1 të Ligjit për Kundërvajtje nr.05/L-087, përcaktohet se: *“Me këtë ligj rregullohen kushtet për përcaktimin e kundërvajtjeve dhe sanksioneve për kundërvajtje, palët dhe përgjegjësia për kundërvajtje, procedura e kundërvajtjes, procedura e veçantë për të mitur dhe procedura e ekzekutimit të sanksioneve për kundërvajtje”*.

Nga interpretimi i dispozitës në fjalë, konkludohet se përveç të tjerash në këtë ligj është rregulluar edhe procedura e ekzekutimit të sanksioneve për kundërvajtje.

Me dispozitat e nenit 27 të Ligjit për Kundërvajtje nr.05/L-087, janë rregulluar llojet, mënyra e përcaktimit dhe shqiptimi i sanksioneve kundërvajtëse, ndërsa me dispozitën e nenit 27 paragrafi 1 pika 1.2 është përcaktuar se: *“për kundërvajtje mund të përcaktohet gjobë”*.

Me dispozitat e nenit 29 të Ligjit për Kundërvajtje nr.05/L-087, është përcaktuar gjoba si sanksion kundërvajtës, ndërsa me nenin 30 paragrafi 4 të të njëjtit ligj është përcaktuar se: *“Nëse kryerësi pjesërisht ose në tërësi nuk e paguan gjobën në afatin e përcaktuar, do të zbatohet përmbartimi i detyrueshëm në pajtim me dispozitat e ligjit për përmbartim. Urdhëri kundërvajtës përmes të cilit shqiptohet gjoba do të cilësohet dokument përmbartues në përputhje me dispozitat e ligjit për procedurën përmbartimore”*.

Nga interpretimi i dispozitës së cituar, rezulton se pavarësisht se në nenin 1 paragrafi 1 të Ligjit për Kundërvajtje nr.05/L-087, përcaktohet se me këtë ligj rregullohet procedura e ekzekutimit të sanksioneve kundërvajtëse, dispozita e cituar nga nenin 30 paragrafi 4 të Ligjit për Kundërvajtje nr.05/L-087, shërben si dispozitë udhëzuese (blankete), që në procedurën e përmbartimit të detyrueshëm për sanksionin kundërvajtës me gjobë të zbatohen dispozitat e Ligjit për Procedurën Përmbartimore.

Kjo, nënkupton se sa i përket zbatimit të detyrueshëm të sanksionit kundërvajtës me gjobë duhet të zbatohen dispozitat e Ligjit për Procedurën Përmbartimore në tërësi, për aq sa ndërlihdet me zbatimin e detyrueshëm të sanksionit me gjobë.

Dispozita e cituar përveç të tjerash është e ndërlihdur edhe me përmbajtjen e dispozitës se nenin 1 paragrafi 2 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore, e cila përcakton se Ligji për Procedurën Përmbartimore zbatohet edhe për përmbartimin e vendimit për kundërvajtje me të cilën është caktuar detyrimi në të holla (*nënkuptohet gjoba dhe shpenzimet e procedurës*). Dispozita e nenit 30 paragrafi 4 të Ligjit për Kundërvajtje nr.05/L-087, dhe dispozita e nenit 1 paragrafi 2 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore, janë në harmoni dhe nuk e përjashtojnë njëra tjetrën, sa i përket ligjit i cili duhet të zbatohet në procedurën e përmbartimit të detyrueshëm për sanksionin kundërvajtës me gjobë.

Me dispozitën e cituar nga nenin 30 paragrafi 4 të Ligjit për Kundërvajtje nr.05/L-087, është përcaktuar se urdhri kundërvajtës përmes të cilit shqiptohet gjoba do të cilësohet dokument përmbartues në përputhje me dispozitat e LPP-së. Me dispozitat nenin 22 paragrafi 1 pika 1.1 deri tek pika 1.9 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore, janë përcaktuar dhe kategorizuar dokumentet përmbartuese. Me dispozitat nenin 22 paragrafi 1 pika 1.9 të të njëjtit ligj, është përcaktuar se dokument përmbartues janë: *“dokumenti tjetër që me ligj është quajtur dokument përmbartues”*.

Nga interpretimi i kësaj dispozite del se pavarësisht se në ligjin për procedurën përmbartimore neni 22 paragrafi 1 pika 1.1 deri te pika 1.8, janë përcaktuar në mënyrë taksative dhe specifike dokumentet përmbartuese, me pikën 1.9 të nenit në fjalë krijohet bazë ligjore që edhe ndonjë dokument tjetër përmbartues në qoftë se përcaktohet me ligj të cilësohet dokument përmbartimor, siç ndodh në rastin konkret me përcaktimin e dispozitës së nenit 30 paragrafi 4

të Ligjit për Kundërvajtje nr.05/L-087, e cila dispozitë përveç të tjerash urdhrin kundërvajtës përmes të cilës shqiptohet gjoba, e cilëson si dokument përbarimor.

Arsyeshmëria e zbatimit të dispozitave të Ligjit për Procedurën Përbarimore justifikohet edhe nga fakti se urdhri kundërvajtës për shqiptimin e gjobës ka cilësinë e dokumentit përbarimor, përbarimi i të cilave bëhet sipas dispozitave të Ligjit për Procedurën Përbarimore.

Me dispozitat e kapitullit 29 të Ligjit për Kundërvajtje nr.05/L-087, është rregulluar procedura e ekzekutimit të sanksioneve për kundërvajtje, ndërsa në mënyrë specifike me dispozitën e nenit 161 paragrafi 3 të të njëjtit ligj është përcaktuar se: *“ekzekutimi i vendimeve-vendimi për kundërvajtjen me të cilin është dhënë gjoba ose është vendosur për kompensimin e shpenzimeve të procedurës, dhe për kompensimin e dëmit ose është dhënë masa mbrojtëse e marrjes së përfitimit pasuror, ekzekutohet kur kalon afati i caktuar me aktvendim për pagimin e gjobës, shpenzimet e procedurës, kompensimin i dëmit, respektivisht të përfitimit pasuror”*.

Nga dispozita e cituar paraqitën me rëndësi dy çështje. E para, në mënyrë parimore vendimi për kundërvajtje ekzekutohet kur kalon afati i caktuar me aktvendim për pagimin e gjobës, shpenzimeve, kompensimit, respektivisht përfitimin pasuror. Çështja e dytë me rëndësi është se pas kalimit të afatit të caktuar me vendim për kundërvajtje për pagesën e gjobës, shpenzimeve, kompensimit, respektivisht përfitimit pasuror kalohet drejtpërdrejtë në procedurën e zbatimit të përbarimit. Pra, në procedurën e përbarimit të gjobës kundërvajtëse dhe shpenzimeve të procedurës gjykata si organ përbarues, kalon drejtpërdrejtë në zbatim të përbarimit pas kalimit të afatit për pagesën e gjobës, pa kaluar në procedurën e lejimit të përbarimit, vendosjes sipas prapësimit apo ankesës.

Me dispozitat e nenit 163 të Ligjit për Kundërvajtje nr.05/L-087, përcaktohet ekzekutimi i dënimit me gjobë dhe shpenzimeve tjera, ndërsa në paragrafin 1 të të njëjtit nen përcaktohet se: *“gjobën e dhënë për kundërvajtje dhe shpenzimet e procedurës së kundërvajtjes i ekzekuton gjykata që ka dhënë ndëshkimin”*.

Dispozita e cituar është dispozitë bazë e cila përcakton se organ përbarues për ekzekutimin e gjobës së dhënë në kundërvajtje dhe shpenzimeve të procedurës së kundërvajtjes është gjykata që e ka shqiptuar sanksionin.

Vlerësohet se dispozitat tjera të nenit 163 të Ligjit për Kundërvajtje nr.05/L-087, me të cilat përcaktohet mënyra e arkëtimit me dhunë për gjobën dhe për shpenzimet e procedurës nuk duhet të krijojë dilemë se kush është organ përbarues për ekzekutimin e detyrueshëm të sanksionit kundërvajtës me gjobë.

Kjo për arsye se mënyra e arkëtimit me dhunë e gjobës dhe shpenzimeve të procedurës nuk ndikon në cilësinë e organit përbarues, respektivisht nuk e përcakton se kush është organ përbarues.

Me dispozitat e nenit 163 paragrafi 4 të Ligjit për Kundërvajtje nr.05/L-087, përcaktohet se: *“arkëtimi me dhunë i gjobës për kundërvajtjen e kryer dhe i shpenzimeve të procedurës së kundërvajtjes bëhet sipas dispozitave mbi arkëtimin me dhunë të tatimit”*, ndërsa me paragrafin 5 të të njëjtit nen përcaktohet se: *“organi kompetent për arkëtim me dhunë nga paragrafi 1 i*

këtij neni është i obliguar që ta informojë pa shtyrje gjykatën kompetente të kundërvajtjes lidhur me arkëtimin e bërë si dhe për pamundësinë eventuale të arkëtitimit të dhunshëm”.

Dispozitat e cituara fillimisht kanë krijuar edhe dilemën e sipër theksuar se kush duhet të jetë organ përmbarues, megjithatë vlerësohet se dispozita e nenit 163 paragrafi 4 është dispozitë udhëzuese për mjetet e ekzekutimit (*mjetet e ekzekutimit janë metoda me të cilat gjykata me dhunë e realizon kredinë e kreditorit*) të cilat zbatohen në pajtim me dispozita mbi arkëtimin me dhunë të tatimit.

Referenca në dispozitat e arkëtitimit me dhunë të tatimit edhe sa i përket gjobës dhe shpenzimeve kundërvajtëse nuk paraqet vështirësi për organin përmbarues, për shkak se zbatimi i dispozitave mbi arkëtimin me dhunë të tatimit është veç një mënyrë- metodë e zbatimit të përmbarimit sikurse mënyrat tjera p.sh, përmbarimin e sendeve të luajtshme, përmbarimi për kreditë e debitorit, përmbarimi në të ardhura personale dhe të ardhura tjera të përhershme në të holla, përmbarimi për kredinë përmes llogarisë bankare etj.

Pra, në këtë rast me Ligjin për Kundërvajtje është përcaktuar që për mënyrën-metodën e përmbarimit, organi përmbarimor sa i përket sanksionit kundërvajtës me gjobë dhe shpenzimet e procedurës duhet të zbatojë dispozitat për arkëtimin me dhunë të tatimit. P.sh në dispozitat e Ligjit për Administratën Tatimore është rregulluar çështja e pagesave, interesi, rendi i pagesave, kreditimi dhe rimbursimet, tatimi që është i detyrueshëm dhe i pagueshëm, barra, masa për marrjen e pasurisë, zbatimi në përmbarim i masës së marrjes, shitja në ankand publik, kufizimet mbi mbledhjen e detyrueshme etj. Në këtë kontekst konkludohet që si mënyrë-metodë e përmbarimit të zbatohet mënyra e arkëtitimit me dhunë të tatimeve.

Dispozita nga neni 163 paragrafi 5 të Ligjit për Kundërvajtje nr.05/L-087, krijon dilemën sepse nga interpretimi gjuhësor duket sikur bëhet fjalë për dy organe dhe atë, organi kompetent për arkëtim me dhunë, dhe gjykata kompetente për kundërvajtje, pasi që përcaktohet se organi kompetent për arkëtim me dhunë nga paragrafi 1 i këtij neni, është i obliguar që ta njoftojë pa shtyrje gjykatën kompetente për kundërvajtje lidhur me arkëtimin e bërë, ndërsa paragrafi 1 të të njëjtit nen përcakton se gjobën e ekzekuton gjykata që e ka dhënë ndëshkimin.

Pra, në këtë rast bëhet fjalë për gjykatën e njëjtë, edhe si gjykatë që ka dhënë sanksionin kundërvajtës me gjobë, por edhe si gjykatë që ekzekuton vet gjobën e dhënë, megjithatë kjo dispozitë nuk paraqet ndonjë vështirësi në zbatimin e përmbarimit sepse edhe mund të jetë menduar se gjykata për kundërvajtje operon në dy cilësi dhe atë: në cilësinë e gjykatës që shqipton sanksionin kundërvajtës, dhe në cilësinë organit përmbarues për zbatimin e detyrueshëm të sanksionit kundërvajtës me gjobë.

Me dispozitat e nenit 164 të Ligjit për Kundërvajtje nr.05/L-087, rregullohet ekzekutimi i masës mbrojtëse të konfiskimit të sendit. Me dispozitat e nenit 164 paragrafi 1, përcaktohet se: *“masën mbrojtëse të konfiskimit të sendit që është përdorë ose ka qenë e destinuar për kryerjen e kundërvajtjes, ose ka lindur me kundërvajtjen e kryer, e ekzekuton gjykatat që në shkallën e parë e ka dhënë këtë masë”*, ndërsa në paragrafin 2 të të njëjtit nen përcaktohet se: *“sipas natyrës së sendeve të marra, gjykata nga paragrafi 1 i këtij neni, me aktvendim do të vendosë, a do të shiten sendet e këtilla sipas dispozitave që vlejné për ekzekutimin e tatimit sipas*

dispozitave mbi tatimet, apo do t'i dorëzohen ndonjë institucioni profesional ose publik kriminalistik, organizate, apo do të asgjësohen”.

Dispozitat e cituara i referohen ekzekutimit të masës mbrojtëse të konfiskimit të sendit të cilat shqiptohen si masa të veçanta kundërvajtëse në kuptim të dispozitave nga neni 38- konfiskimi i pasurisë dhe dobisë pasurore dhe marrja e sendit, dhe dispozitave nga neni 39- konfiskimi i pasurisë dhe dobisë pasurore, ekzekutimi i të cilave përcaktohet të bëhet nga gjykata e shkallës së parë që ka dhënë masën dhe atë në dy mënyra: duke e dorëzuar sendin në ndonjë institucion profesional ose publik kriminalistik, organizatë, apo të asgjësohet, dhe mënyra e dytë përmes zbatimit të dispozitave që vlejnjë për ekzekutimin e tatimit, e që ekskluzivisht i referohet shitjes me ankand publik.

Nga arsyet e cekura është vendosur si në këtë udhëzues.

(Udhëzues i miratuar në Seancën e Përgjithshme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, mbajtur më 04.02.2021)



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Seanca e Përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 26 paragrafi 1 pika 1.4 të Ligjit për Gjykatat, më datë 04.02.2021, me shumicë të votave, vendosë për:

Revokimin e udhëzimit të nxjerrë në Seancën e Përgjithshme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës të datës 25.09.2020, GJ.A 189/2020, lidhur me kompetencën e organit përmbarrimor për zbatimin e vendimeve të gjykatave dhe institucioneve tjera lidhur me çështjet nga e drejta familjare, kthimin e punëtorëve dhe shërbyesve civil në punë dhe kompensimet tjera;

dhe nxjerr këtë:

UDHËZUES

PËR KOMPETENCËN E ORGANIT PËRMBARIMOR LIDHUR ME VENDOSJEN NË PROCEDURËN E PËRMBARIMIT DHE LIDHUR ME ZBATIMIN E PËRMBARIMIT PËR ÇËSHTJET NGA E DREJTA FAMILJARE; KTHIMIN E PUNËTORËVE DHE SHËRBYESVE CIVIL NË PUNË; DHE KOMPENSIMET TJERA

- I. Organ kompetent përmbarrimor për të vendosur në procedurën e përmbarrimit dhe për të zbatuar përmbarrimin në:
- *Të gjitha çështjet nga e drejta familjare;*
 - *Kthimin e punëtorëve dhe shërbyesve civil në punë; dhe*
 - *Kompensimet tjera (përfshirë pagat, pagat jubilarë, pagat e përcjelljes në pension, shujtat, bonuste, etj),*
- është gjykata, pa marrë parasysh se vendimin përmbarrues (*dokumentin përmbarrimor*), e ka nxjerrë gjykata apo ndonjë institucion, respektivisht organ tjetër.

- II. Ky udhëzues nuk u referohet rasteve në të cilat është lejuara përmbartimi para datës së nxjerrjes së këtij udhëzuesi.

A r s y e t i m

Gjykata Supreme e Kosovës, pas nxjerrjes së udhëzimit Gj.A.189/2020, të datës 25.09.2020, ka pranuar shqetësime nga Oda e Përmbartuesve të Kosovës, dhe nga gjyqtarët të cilët vendosin në procedurën e përmbartimit, sa i përket zbatimit të udhëzimit për përmbartimin e të gjitha çështjeve nga e drejta familjare, kthimin e punëtorëve dhe shërbyesve civil në punë dhe kompensimet tjera. Në kontekstin e këtyre shqetësimeve Gjykata Supreme e Kosovës e ka hapur debatin e brendshëm, dhe njëkohësisht ka zhvilluar diskutime edhe me Odën e përmbartuesve të Kosovës, dhe me gjyqtarët që vendosin në procedurën e përmbartimit për rishikimin e mundshëm të udhëzimit në fjalë.

Nga diskutimet e zhvilluara ka rezultuar se vështirësitë në zbatimin e udhëzimit Gj.A.189/2020, të datës 25.09.2020, paraqiten kryesisht për shkak të pamundësisë së zbatimit të gjobave në procedurën e përmbartimit e të cilat parashihen si mekanizëm i rëndësishëm në procedurën e zbatimit të përmbartimit për çështjet në fjalë. Nga debati i brendshëm në Gjykatën Supreme të Kosovës, është konkluduar se udhëzimi Gj.A.189/2020, të datës 25.09.2020, është nxjerrë me referencë në dispozitat e nenit 5 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore, konkretisht dispozitës nga neni 5 paragrafi 6 me të cilën përcaktohet se: *“gjykata është kompetente të vendosë në procedurën e përmbartimit dhe të zbatojë përmbartimin e vendimeve gjyqësore lidhur me: 6.1. të gjitha çështjet nga e drejta familjare dhe 6.2. kthimin e punëtorëve dhe shërbyesve civil në punë me kompensime tjera”*.

Nga dispozita e cituar ka rezultuar se gjykata është kompetente të vendosë në procedurën e përmbartimit dhe të zbatojë përmbartimin e vendimeve gjyqësore. Pra, konkretisht dispozita e cituar ka specifikuar se gjykata e bënë zbatimin e përmbartimit të vendimeve gjyqësore, pa krijuar bazë që nga ana e gjykatës të bëhet edhe zbatimi i dokumenteve tjera përmbartimore për çështjet në fjalë. Megjithatë pas analizimit të serishëm të dispozitave të ligjit në fjalë rezultoi si nevojë për efikasitet në procedurën e përmbartimit revokimi i udhëzimit Gj.A.189/2020, i datës 25.09.2020, dhe miratimi i këtij udhëzimi mbështetur në arsyet si në vijim:

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se kompetenca e gjykatës si organ përmbartues nga ligjdhënësi është përcaktuar duke e pas në konsideratë natyrën e çështjeve (*të gjitha çështjet nga e drejta familjare dhe kthimin e punëtorëve dhe shërbyesve civil në punë dhe kompensimet tjera*), dhe jo duke marrë në konsideratë se dokumentin përmbartimor e ka nxjerrë gjykata apo ndonjë organ tjetër jashtëgjyqësor.

Në këtë kontekst, Gjykata Supreme vlerëson se natyra e çështjeve në fjalë është përcaktuese për kompetencën e gjykatës si organ përmbartimor, prandaj, në këtë rast ka vlerësuar dhe ka vendosur se organi i cili e ka nxjerrë dokumentin përmbartimor të mos jetë me ndikim për të përcaktuar kompetencën e gjykatës si organ përmbartimor.

Me dispozitën e nenit 312 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore, përcaktohet kompetenca territoriale për përmbartimin e vendimit për kthim në vendin e punë, ashtu që në paragrafin 1 të të njëjtit nen përcaktohet se: *“për vendosje për propozimin për përmbartim në bazë të dokumentit përmbartues me të cilin punëdhënësi është urdhëruar që punëtorin ta kthejë në punë, apo që ta sistemojë në vendin përkatës të punës dhe për zbatimin e përmbartimit, e kompetencës territoriale është gjykata në territorin e së cilës është krijuar marrëdhënia e punës”,* ndërsa në paragrafin 2 të të njëjtit nen përcaktohet se: *“gjykata ka kompetencë ekskluzive për përmbartimin e vendimeve lidhur me kthimin e punëtorëve dhe shërbyesve civil në punë”*.

Nga interpretimi i dispozitës nga neni 312 paragrafi 1, Ligjin për Procedurën Përmbartimore, rezulton se ligjdhënësi e përcakton kompetencën e gjykatës si organ përmbartimor për të vendosur për propozimin për përmbartim në bazë të *“dokumentit përmbartues”*, ndërsa në nenin 5 paragrafi 6 të Ligjin për Procedurën Përmbartimore, gjykatën e përcakton si organ përmbartimor kompetent që të vendosë në procedurën e përmbartimit dhe zbatojë përmbartimin e *“vendimeve gjyqësore”*.

Dispozita e nenit 5 paragrafi 6, dhe dispozita e nenit 312 paragrafi 1 të Ligjin për Procedurën Përmbartimore kanë një kundërthënie në mes tyre, për shkak se në nenin 5 paragrafi 6 referohet në përmbartimin e *“vendimeve gjyqësore”*, ndërsa në nenin 312 paragrafi 1, referohet në përmbartimin e *“dokumentit përmbartues”*. Megjithatë dilemën e eviton dispozita e nenit 312 paragrafi 2 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore, e cila përcakton se gjykata ka kompetencë ekskluzive për përmbartimin e vendimeve lidhur me kthimin e punëtorit dhe shërbyesit civil në punë.

Dispozita e nenit 312 paragrafi 2 nuk vendosë një ndarje në mes të vendimeve gjyqësore dhe vendimeve të organeve dhe institucioneve tjera, por paracakton zbatimin e vendimeve pa përjashtim për çështjet lidhur me kthimin e punëtorëve dhe shërbyesve civil në punë.

Mbi këto arsye vlerësohet se gjykata është organ përmbartues për çështjet në fjalë pa marrë parasysh se vendimi i cili shërben si dokument përmbartues është nxjerrë nga gjykata apo nga ndonjë organ apo institucion tjetër.

Gjykata Supreme e ka shqyrtuar edhe çështjen e kompetencës për përmbartimin e dokumenteve përmbartimore lidhur me kompensimet materiale të cilat rrjedhin nga marrëdhënia e punës, dhe pas analizës ligjore për këtë çështje konkludon se Organ kompetentë përmbartimor për të vendosur në procedurën e përmbartimit dhe për të zbatuar përmbartimin për kompensimet material si: pagat, pagat jubilarë, pagat e përcjelljes në pension, shujtat, bonuset, etj), është gjykata.

Në kompetencën e gjykatës si organ përmbartimor nuk përfshihen rastet e kërkesave për përmbartimin e dokumenteve përmbartimore lidhur me kompensimin e dëmit për shkak të lëndimit në punë.

Baza ligjore për këtë konkludim është dispozita e nenit 5 e Ligjit për Procedurën Përmbartimore, konkretisht dispozita nga neni 5 paragrafi 6 të cilën përcaktohet se: *“gjkata është kompetente të vendosë në procedurën e përmbartimit dhe të zbatojë përmbartimin e vendimeve gjyqësore lidhur me: pika 6.2. kthimin e punëtorëve dhe shërbyesve civil në punë me kompensime tjera”*.

Përveç kësaj Gjykata Supreme, vlerëson së përmbartimi i dokumenteve përmbartimore nga ana e gjykatës edhe për kërkesat materiale është në pajtim me parimin e mbrojtjes së debitorit, që nënkupton se procedura e përmbartimit duhet të realizohet me sa më pak shpenzime në mënyrë që të mos ngarkohet pozita e debitorit.

Me dispozitën e nenit 6 paragrafi 3 përcaktohet se: *“Organi përmbartues mund të konkludojë se natyra e kredisë kërkon trajtim të përshpejtuar të rastit nëse ka rrezik legjitim që pasuritë e debitorit në atë rast të mos jenë në dispozicion për konfiskim apo do t'i bie vlera shumë në rast të vonesës. Gjyqtari mund të pranojë ekzistimin e rrethanave të veçanta, dhe të veprojë shpejt, në rastet që kanë të bëjnë me punësimin, çështjet familjare, alimentacionin apo pagesat për fëmijë nëse interesat e palës mund të ndikohen negativisht si rezultat i vonesës.”*

Nga dispozita e cituar taksativisht theksohet se *“gjyqtari”* mund të pranojë ekzistimin e rrethanave të veçanta, dhe të veprojë shpejtë, në rastet që kanë të bëjnë me punësimin, çështjet familjare, alimentacionin apo pagesat për fëmijë nëse interesat e palës mund të ndikohen negativisht si rezultat i vonesës. Pra, emërtimi *“gjyqtari”*, nuk mund të zëvendësohet me emërtimin *“përmbartuesi”*, për shkak se edhe nga kjo dispozitë ligjdhënësi u ka njohur urgjencën çështjeve për të cilat edhe Gjykata Supreme me këtë udhëzim vlerëson se janë në kompetencë të gjykatës si organ përmbartues.

Me dispozitat e nenit 15 paragrafi 1 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore, përcaktohet se: *“Gjobat e parapara nga ky nen mund të shqiptohen, me vendim të Gjykatës, për çdo veprim apo mosveprim me të cilat shkelen dispozitat e këtij ligji apo të vendimit të organit përmbartues në pajtim me këtë ligj. Këto gjoba mund të shqiptohen nga Gjykata sipas detyrës zyrtare, si dhe në bazë të propozimit të arsyetuar të përmbartuesit privat nëse në procedurën që zhvillohet pranë përmbartuesit privat janë plotësuar kushtet për shqiptimin e gjobës”*.

Me dispozitat e nenit 314 paragrafi 1 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore, përcaktohet se: *“Përmbartimi në bazë të dokumentit përmbartues sipas të cilit punëdhënësi është i detyruar që punëtorin ta kthejë në punë, apo që ta sistemoj në vendin përkatës të punës, zbatohet me anë të caktimit të gjobave në të holla kundër punëdhënësit dhe personit përgjegjës në të”* ndërsa me dispozitat e nenit 320 paragrafi 3 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore përcaktohet se: *“Me aktvendimin për përmbartimin, Gjykata i cakton debitorit afat prej tri (3) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar aktvendimi, që fëmijën t'ia dorëzoj prindit, apo personit tjetër, respektivisht institucionit të cilit fëmija i është besuar në ruajtje dhe edukim, me kërcënim të shqiptimit të gjobës në të holla”*.

Nga dispozita e cituar e neni 15 paragrafi 1, të Ligjit për Procedurën Përmbaremore, përcaktohet në mënyrë taksative se gjoba mund të shqiptohet sipas detyrës zyrtare nga gjykata, dhe në bazë të propozimit të arsyetuar të përmbaruesit privat nëse në procedurën që zhvillohet pranë përmbaruesit privat janë plotësuar kushtet për shqiptimin e gjobës.

Pra, qartësisht theksohet se vetëm gjykata mund të shqiptojë gjobë, prandaj, logjikisht rrjedh se gjoba është mjet i rëndësishëm për zbatimin e përmbarimit të vendimit për kthimin e punëtorëve në vendin e punës, dhe për përmbarimin e vendimeve nga fusha e së drejtës familjare-dorëzimi dhe marrja e fëmijës, e të cilën sipas depozitave të cituara po ashtu mund ta shqiptojë vetëm gjykata në procedurën e zbatimit të përmbarimit.

Gjykata Supreme ka vendosur që ky udhëzues nuk u referohet rasteve në të cilat është lejuar përmbarimi para datës së nxjerrjes së këtij udhëzuesi, sepse në rastet ku është lejuar përmbarimi janë inkasuar taksat e përmbarimit dhe janë vlerësuar afatet e lejueshmërisë së përmbarimit. Lëvizja e lëndëve do të ndikonte në pozitën financiare të debitorit, gjë që do të ishte ndesh me parimin e mbrojtjes së debitorit dhe gjithashtu mund të krijonte komplikime lidhur me afatet e inicimit të procedurave, prandaj nga arsytet e cekura është vendosur si në këtë udhëzues.

(Udhëzues i miratuar në Seancën e Përgjithshme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, mbajtur më 04.02.2021).



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

C-IV-20-0059

15 tetor 2020

Agjencia Kosovare e Privatizimit – AKP.

Parashtruesi i kërkesës

Për: AKP

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), Kolegji i përbërë nga Sylejman Shumolli gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Teuta Ibrahim, gjyqtarë, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur me 15 tetor 2020, lëshon këtë:

U D H Ë Z I M

1. AKP udhëzohet që së pari të bëjë një spot informues, me qëllim të informimit të palëve të interesit se të gjitha informatat në lidhje me publikimin e njoftimeve nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, nuk do të publikohen më në gazetat e shkruara, por tani e tutje publikimi i njoftimeve do të bëhet vetëm në mediat televizive dhe ato elektronike. Spoti informues duhet të transmetohet në televizionin publik RTK 1 në gjuhën shqipe dhe RTK 2 në gjuhën serbe si dhe në portalet online, për 5 ditë njëpasnjëshme në kohëzgjatje minimale prej 30 sekonda me video dhe zë, duke filluar ndërmjet orës 17:00 – 21:00.
2. AKP udhëzohet që për çdo Njoftim të Fillimit të Procedurës së Likuidimit të NSH-ve dhe Publikimit të Listës së Punëtorëve me të Drejta Legjitime në 20 % të të Ardhurave nga Privatizimi ose Likuidimi i NSH, të publikoj njoftimet në lidhje me to në RTK 1 dhe RTK 2, për 5 ditë të njëpasnjëshme, në kohëzgjatje prej minimum 30 sekonda me video dhe zë, duke filluar ndërmjet orës 17:00 deri në 21:00.
3. Të gjitha shpalljet duhet të lidhen me faqen e internetit të AKP-së.

4. Ky udhëzim mbetet në fuqi deri në rifillimin e shtypjes së gazetave ditore në Republikën e Kosovës.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 21 shtator 2020, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) parashtrroi kërkesë për udhëzim ligjor, me të cilën kërkoi që Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme (Dhoma e Posaçme) të ofrojë udhëzim sa i përket çështjes se *“deri në përfundimin e situatës së pandemisë globale të shpallur nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (më tej OBSH) për virusin Covid-19, a mund të vazhdoj AKP të shpallë njoftimet sa i përket fillimit të likuidimit dhe listave të 20 % të shitjes së aseteve vetëm në portalet online në Republikën e Kosovës, për një afat të arsyeshëm kohor, shpallje këto të cilat do të ndërlihdeshin automatikisht me faqen e internetit të AKP”*.

Me 01 tetor 2020, Dhoma e Posaçme lëshoi urdhër për parashtruesin e kërkesës, duke kërkuar nga e njëjta që të precizoj kërkesën për udhëzim ligjor në drejtim të: mënyrave të komunikimit që i ka zbatuar AKP lidhur me fillimin e likuidimit të NSH, deri më tani, me kreditorët potencial, sa është e mundur që komunikimi për listat përfundimtare për 20 %, të komunikohet drejt për së drejti me ish punëtorët e NSH, apo përmes sindikatës së NSH dhe në gjendjen e tanishme, cilat janë propozimet konkrete për të komunikuar me kreditorët potencial lidhur me fillimin e procedurave të likuidimit të NSH dhe punëtorët të cilët nuk janë përfshirë në listën preliminare apo përfundimtare për 20 %. Lidhur me këtë çështje gjykata caktoi seancë dëgjimore.

Me 05 tetor 2020, Dhoma e Posaçme mbajti seancë dëgjimore. Në fjalën e tyre përfaqësuesit e AKP-së kanë elaboruar kërkesën për udhëzim ligjor. Ndër të tjerash pohuan se, në shtojcën e ligjit të AKP janë të caktuara afatet kohore për publikimin e procesit të likuidimit, pas 15 ditëve të bëhet shpallja e dytë dhe se në Kosovë gazetat e shtypura nuk shtypën më, kjo e ka bërë të pa mundur procesin e shpalljes së likuidimit në rastin konkret për NSH Vello Trogovina. Më tej, pohuan se sa i përket shpalljes së listave të punëtorëve në kërkesën për udhëzim janë referuar në rregulloren e UNMIK-ut 2003/13, neni 10.3 që lista zyrtare e të punësuarve me të drejta legjitime të lëshuar nga AKP së bashku me të drejtën e ankesës në pajtim me nenin 10.6 të Rregullores, publikohen në dy ditë të një pas njëshme dhe në fundjavë në gazetat kryesore të gjuhës shqipe dhe në gazetat kryesore në gjuhën serbe. Në fund, përfaqësuesit e AKP-së janë udhëzuar nga gjyqtari kryesues, se mund të dorëzojnë një precizim më shkrim sa i përket mënyrës së publikimit dhe çështjeve të tjera që lidhen me publikimin e njoftimeve.

Me 07 tetor 2020 AKP dorëzoi një parashtresë me të cilën precizoi kërkesën për udhëzim ligjor, në drejtim të mënyrave të komunikimit me kreditorët potencial dhe përfituesit potencial të listës së 20 %, si dhe orarit se kur duhet të bëhen publikimet online dhe kohëzgjatjes së këtyre publikimeve.

Arsyetimi Ligjor

Kërkesa për udhëzim ligjor është e pranueshme.

Neni 48.1 i shtojës së Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit nr. 04/1-034 (shtojca e Ligjit për AKP) parasheh:

Në çdo kohë gjatë procedurës së Likuidimit, Autoriteti i Likuidimit mund të parashtrojë kërkesë me shkrim për të kërkuar nga Gjykata udhëzime në lidhje me dispozita të ligjit, përfshirë çështjet e pajtueshmërisë me këtë Ligj. Autoriteti i Likuidimit në të njëjtën kohë i siguron një kopje të kërkesës së tillë Komitetit të Kreditorëve (nëse ekziston) dhe palëve të tjera të interesit sipas udhëzimit të Gjykatës. Gjykata lëshon vendim lidhur me këtë kërkesë brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve të punës pas dorëzimit.

Neni 7.1 i Shtojcës së Ligjit për AKP parasheh:

Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas datës së Vendimit për likuidim, Agjencia publikon, apo kërkon nga Autoriteti i Likuidimit të publikojë njoftimin me informatat e cekura në paragrafin 2 të këtij neni (Njoftimi për likuidim). Publikimi i Njoftimit për likuidim bëhet në pajtim me Dispozitat për Shpallje të kësaj Shtojce.

Neni 49 i shtojcës së Ligjit për AKP parasheh:

Të gjitha njoftimet formale sipas këtij Ligji publikohen, së paku, si në vijim; 1.1.në serbisht dhe shqip në gazetat me tirazh më të madh në Kosovë; dhe 1.2.në serbisht në një apo më shumë gazeta të gjuhës serbe me tirazh të madh në Serbi dhe Mal të Zi, nëse Autoriteti i Likuidimit konsideron se është e nevojshme. 1.3.në një publikim në gjuhën angleze që ka tirazh të madh në Evropë.

Neni 10.3 i rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13 parasheh:

Lista Zyrtare e të punësuarve me të drejta legjitime të lëshuar nga Agjencia, së bashku me njoftimin për të drejtën e ankesës, në pajtim me paragrafin 10.6 publikohen në dy ditë pune të njëpasnjëshme dhe në fundjavën vijuese në gazetat kryesore në gjuhën shqipe me tirazh të gjerë në Kosovë dhe në gazetat kryesore në gjuhën serbe.

Dhoma e Posaçme vlerëson se në rrethana normale, dispozitat e lartcekura e rregullojnë mjaftueshëm çështjen e shpalljes së njoftimeve për fillimin e procesit të likuidimit për Ndërmarrjet Shoqërore (NSH), nën autoritetin administrativ të AKP dhe shpalljen e listave të punëtorëve të NSH për 20 % të shitjes së asetëve të tyre. Nën rrethanat e ditura botërisht dhe nga gjendja e pandemisë globale të shpallur nga OBSH-ja prej datës 11 mars 2020, lidhur me situatën e krijuar me virusin Covid-19 “Coronavirus”, është e nevojshme të gjendet një zgjidhje alternative për zbatim të këtyre dispozitave ligjore, me qëllim që AKP si organ i pavarur publik të ndërmerri hapa të mëtutjeshëm rreth përmbushjes së mandatit të saj, në përputhje me ligjin nr. 04/L-034, sa i përket njoftimit lidhur me fillimin e likuidimit si dhe publikimin e listave të punëtorëve për përfitimin nga 20 % i privatizimit dhe likuidimit të NSH-ve.

Dhoma e Posaçme konsideron se duhet të bëhet një zgjidhje alternative për zbatim të dispozitave ligjore të lartcekura, me qëllim që palët e interesit (kreditorët potencial ndaj NSH-

ve dhe punëtorët që preken nga lista e 20 %), të njoftohen me kohë dhe në mënyrë të duhur për mënyrën e shpalljeve që do ta zbatoj tani e tutje AKP. Palët duhet të informohen mirë dhe në mënyrë të duhur për të drejtat që ju takojnë dhe për rrugët që duhet ti ndjekin për realizimin e të drejtave të tyre të pretenduara. Njoftimi me kohë dhe në mënyrë të duhur i palëve është një detyrim ligjor i Agjencisë. Pra, palët duhet të informohen drejt mbi ecurinë e një procedurë që pritet të zhvillohet ose që është zhvilluar nga Agjencia si dhe të drejtën e njoftimit me mjete të përshtatshme juridike për kundërshtimin e atyre veprimeve ose vendimeve. Agjencia, gjatë gjithë zhvillimit të një procedure duhet të siguroj që mos informimi / mosdija e palës të mos përkeqësojë mbrojtjen e të drejtave dhe interesave juridike, që ajo ka sipas ligjit. Në veçanti, Agjencia duhet të informoj palët për të drejtat dhe detyrimet e tyre në procedurë, si dhe për pasojat juridike të veprimeve a mosveprimeve të tyre gjatë procedurës. Si rregull, organi që zhvillon një procedurë duhet ti siguron personave të interesuar dhe palëve informacion të saktë, të qartë dhe të kuptueshëm rreth mënyrës si të fillojnë një procedurë të caktuar për të kërkuar ndonjë të drejtë apo për të zhvilluar procedurën ndaj një akti të nxjerrë nga organi dhe mjetet juridike në dispozicion të palës dhe mënyrën e ushtrimit të tyre.

Në rastin konkret duket objektivisht e pamundur komunikimi individual me të gjitha palët e përfshira nga vet Agjencia si për shkak të mungesës së resurseve, ashtu edhe për faktin e mungesës së të dhënave në lidhje me adresat apo mundësitë e kontaktit me palët e përfshira. Për më tepër një standard i tillë nuk është aplikuar nga Agjencia as në rrethana normale dhe nuk duket të ketë detyrime të tilla ligjore për AKP-në, veçanërisht në rrethanat aktuale.

Andaj, Dhoma e Posaçme vlerëson se AKP siç është udhëzuar në pikën 1 të këtij udhëzimi, duhet që së pari të bëjë një spot informues, i cili duhet të transmetohet në televizionin publik RTK 1 në gjuhën shqipe dhe RTK 2 në gjuhën serbe, për 5 ditë njëpasnjëshme në kohëzgjatje minimum 30 sekonda me video dhe zë, duke filluar ndërmjet orës 17:00 – 21:00, me të cilin do të informohen palët e interesit se për shkak të pandemisë nuk janë duke u shtypur gazetatat ditore dhe se tash e tutje të gjitha njoftimet lidhur me likuidimin e NSH dhe publikimin e listave për 20 % do të bëhen në televizionin publik RTK 1 në gjuhën shqipe, RTK 2 në gjuhën serbe dhe në portalet online.

Dhoma e Posaçme e ka udhëzuar AKP si në pikën 2 të këtij udhëzimi, ashtu që e njëjta duhet që për çdo procedurë sa i përket fillimit të likuidimit të NSH dhe publikimit të listës së 20 % të punëtorëve të NSH, të bëjë publikimin e njoftimeve në RTK1 dhe RTK 2, për 5 ditë të njëpasnjëshme, në kohëzgjatje prej minimum 30 sekonda me video dhe zë, duke filluar ndërmjet orës 17:00 deri në 21:00. Njoftimi duhet të jetë lehtë i kuptueshëm për palët e interesit dhe duhet të përmbaj informata që palët e interesuara t'i qasen lehtë faqes zyrtare të internetit të AKP. Po ashtu, AKP është udhëzuar që njoftimet ti publikoj në 3 portale në Republikën e Kosovës në gjuhën shqipe dhe serbe, për 5 ditë të njëpasnjëshme dhe t'i referohet faqes së internetit të AKP.

Andaj, Dhoma e Posaçme, vie në përfundim se me qëllim që AKP si organ i pavarur publik të mund të përmbush mandatin e saj sipas ligjit nr. 04/L-034 dhe Shtojcës së tij, në rrethanat e krijuara si pasojë e Covid-19, për aq kohë sa zgjat kjo gjendje dhe në varësi të kufizimeve apo lehtësimeve të masave të parapara për mbrojtje nga Covid-19, të përcaktuara nga qeveria dhe institucionet shëndetësore, pa paragjykuar efektet, si dhe me qëllim që palët e interesit të

njoftohen në mënyrë të rregullt dhe të drejtë, ofron këtë zgjidhje specifike si në dispozitiv të këtij udhëzimi.

Për këtë, në pajtim me nenin 48.1 të Shtojcës së Ligjit për AKP dhe kërkesës së saj, jepet ky udhëzim.

Shpenzimet Gjyqësore

Parashtruesi i kërkesës tani më ka paguar taksën gjyqësore për kërkesën për udhëzim ligjor në shumë prej 100.00 € dhe nuk ngarkohet me taksa shtesë.

Sylejman Shumolli, Gjyqtar kryesues

Shkelzen Sylaj, Gjyqtar

Teuta Ibrahim, Gjyqtare

Urdhër për zyrën e regjistrimit

Udhëzimi duhet t'i dorëzohet:

-AKP-së,

-Të gjithë gjyqtarëve të Dhomës së Posaçme, si dhe

-Të publikohet në web-faqe të gjykatës.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Parashtruesi i kërkesës

Autoriteti i Likuidimit, C-IV-22-0277

10 tetor 2022

Agjencia Kosovare e Privatizimit – AKP, rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Për: AKP

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), Kolegji i përbërë nga Sylejman Shumolli gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Diellza Hoxha, gjyqtarë, pas seancës dëgjimore dhe asaj vendimmarrëse të mbajtur me 10 tetor 2022, lëshon këtë:

U D H Ë Z I M

1. AKP udhëzohet se mund të bëj shpërndarjen e 5% (pesë për qind) e të ardhurave nga qiraja për të gjitha NSH-të që janë në likuidim, në llogarinë bankare “*Tarifa Administrative e AKP-së*” që mbahet në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

2. Kjo shpërndarje mund të bëhet në lartësinë sa AKP e sheh të nevojshme në pajtim me dispozitat ligjore, mandatin dhe autoritetin e saj si administruese në mirëbesim e NSH-ve.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 10 gusht 2022, parashtruesi i kërkesës duke vepruar në emër të Autoritetit të Likuidimit (AL) për Ndërmarrjet Shoqërore (NSH) nën administrim të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej: AKP ose Agjencia) parashtror kërkesë për udhëzim ligjor, me të cilën kërkoi që Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme (Dhoma e Posaçme) të ofrojë udhëzim sa i përket çështjes se:

A mundet AKP të bëj shpërndarjen e 5% (pesë përqind) të të ardhurave nga qiraja për të gjitha NSH-të që janë në likuidim, në llogarinë bankare “Tarifa Administrative (TA) e AKP-së” që mbahet në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

Parashtruesi i kërkesës më tej pohon se udhëzimi është i nevojshëm për Agjencinë e cila si organ i pavarur publik duhet të ndërmerr hapat e mëtutjeshëm në mënyrë më të përsheptuar rreth përmbushjes së mandatit të saj në përputhje me ligjin sa i përket fillimit të procesit të likuidimit si dhe publikimin e listave të punëtorëve për disa NSH.

Me 30 shtator 2022, Dhoma e Posaçme mbajti seancë dëgjimore. Në cilësinë e përfaqësuesve të AKP-së morën pjesë: Arben Limani, drejtor menaxhues i Agjencisë, Armend Hamzaj zv. Drejtor i Zyrës Ligjore të Agjencisë dhe Albert Matoshi kryesues i AL. Në fjalën e tyre përfaqësuesit e Agjencisë kanë elaboruar kërkesën për udhëzim ligjor në lidhje me 5% (pesë përqind) e të ardhurave nga qiraja për të gjitha NSH-të në likuidim. Drejtori menaxhues në fjalën e tij ndër të tjera pohoi se AKP-ja gjatë tre viteve të fundit pjesërisht apo plotësisht është e detyruar të financohet edhe për paga, por edhe për nevojat tjera nga buxheti i Kosovës. Nga viti 2018 pjesërisht mandej plotësisht. Arsyeja është sepse siç e dini edhe ju si DHPGJS ka pasur ndërprerje në shitjen e aseteve qoftë përmes shitjes me tender qoftë përmes shitjes direkte, për arsye të ndryshme qoftë të jashtme nga ana e qeverisë rreth privatizimit apo mungesa e bordit. Me stagnimin e shitjeve, tarifa administrative (TA) nuk ka mund me siguria të hyra, andaj alternativa ka qenë që të kërkohen para nga buxheti. Do të kishte qenë mirë sikur që në fillim të interpretohet ky nen dhe të hyrat nga qiratë të jenë subjekt i ndarjes të këtij 5% dhe transferimi i tyre në xhirollogarinë e TA, por kjo nuk ka ndodh sepse nuk është paraqit nevojë akute, është edhe një dimension tjetër për çka na shërben TA përveç pagave dhe buxhetit të AKP-së, e që ka të bëjë me administrimin e NSH-ve sidomos rastet e NSH-ve që futen nën administrim direkt, ku zakonisht nuk gjejmë buxhet operativ në ato NSH në mënyrë që të kemi financa për të administruar. Andaj, AKP duke vepruar si administratore huazon para nga TA, ashtu që NSH të financoj punëtorët, riparimet eventuale, shpenzimet operative dhe pastaj NSH krijojnë të hyra nga qiradhëniet dhe atëherë në të plotësojnë TA-në. Prandaj, arsyet pse na duhet më së shumti TA, inkasimi i 5% nga të hyrat prej qirave, janë për të mundësuar administrim efikas dhe vënie të rregullit në ndërmarrjet nën administrim të AKP-së. Dhe këtë po e kërkojmë për arsye se kemi mungesë të buxhetit nga 5% i të hyrave nga shitjet për shkak që siç dihet, pezullimit të shitjeve për një periudhë të gjatë dhe aktualisht pezullimit të shitjes të rreth 1400 aseteve me vlerë, duke pritur transferimin e tyre në fondin sovran (për të cilin qeveria është

duke punuar për ta themeluar). As bordi i drejtorëve nuk ka dhënë diçka specifike për këtë rast, mirëpo kërkesa për udhëzim ka qenë e drejtuar me qëllim të sigurimit të ligjshmërisë së këtij veprimi ose procesi që AKP mëton të ndërmer për të vetmen arsye sepse nuk është zbatua me kohë ose prej fillimit. Në mbështetje të kërkesës për udhëzim ligjor përfaqësuesit e Agjencisë kanë dorëzuar në seancë dokumentet në kopje si: Memorandum për Bordin e Drejtorëve, i datës 18 korrik 2022 së bashku me Opinionin e datës 13 korrik 2022 (e-mail) për të kërkuar Udhëzim nga Dhoma e Posaçme në lidhje me TA 5% dhe dokumenti i titulluar “Analizë e 5% të qirave të inkasuara deri më tani” nga qiratë e 241 NSH-vë nën administrim të AKP-së.

Arsyetimi Ligjor

Kërkesa për udhëzim ligjor është e pranueshme.

Neni 48.1 i Shtojcës së Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit nr. 04/I-034 (shtojca e Ligjit për AKP) parasheh:

Në çdo kohë gjatë procedurës së Likuidimit, Autoriteti i Likuidimit mund të parashtrojë kërkesë me shkrim për të kërkuar nga Gjykata udhëzime në lidhje me dispozita të ligjit, përfshirë çështjet e pajtueshmërisë me këtë Ligj. Autoriteti i Likuidimit në të njëjtën kohë i siguron një kopje të kërkesës së tillë Komitetit të Kreditorëve (nëse ekziston) dhe palëve të tjera të interesit sipas udhëzimit të Gjykatës. Gjykata lëshon vendim lidhur me këtë kërkesë brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve të punës pas dorëzimit.

Neni 21.2 i Ligjit për AKP parasheh:

Të gjitha të ardhurat e Agjencisë do të jenë të ardhura të dedikuara të Agjencisë sipas nenit 64 të LMFPP-së. Përveç kësaj, pesë përqind (5%) e të gjitha të hyrave të pranuar si rrjedhojë e çfarëdo shitje në të kaluarën apo të ardhmen, transferimit, privatizimit, likuidimit apo mënyrave tjera të disponimit me cilëndo ndërmarrje apo aset, pavarësisht nëse është bërë nga agjencia apo paraardhësja e saj, do të jetë tarifë administrative e Agjencisë për të mbuluar shpenzimet e veta të përgjithshme administrative dhe operative; dhe ajo tarifë do të jetë pjesë e të ardhurave të dedikuara të Agjencisë. Agjencia menjëherë transferon dhe depoziton të gjitha ato të ardhura nga tarifa në Fondin e Konsoliduar të Kosovës në pajtim me rregullat ne fuqi të LMFPP-së; Thesari dhe Ministria e Financave sigurojnë që ato fonde të vendosen dhe mbahen në llogarinë e dedikuar të të ardhurave të Agjencisë.

Neni 32 i shtojcës së Ligjit për AKP parasheh:

Të hyrat e pranuar nga shfrytëzimi i pronës së Ndërmarrjes (siç janë qiratë) janë pronë e ndërmarrjes në likuidim dhe mbrohen dhe regjistrohen nga Autoriteti i Likuidimit.

Neni 3.1.1.18 i Ligjit për AKP parasheh:

Të ardhurat - të ardhurat nga shitja, transferimi ose likuidimi i një ndërmarrje ose asetit sipas neneve 6, 8 ose 9 të këtij ligji, pas pagimit të taksave administrative të agjencisë të parapara në nenin 21.2 të këtij ligji dhe pagesave që duhet të bëhen sipas nenit 10 të Rregullores mbi Transformimin e Pronës së Patundshme.

Duke u nisur nga dispozitat e lartcekura ligjore dhe gjendja e krijuar tek Agjencia, si pasojë e veprimeve të ndërmarrja nga ana e qeverisë në lidhje me procesin e privatizimit, respektivisht pezullimit të shitjeve, Dhoma e Posaçme e merr në shqyrtim këtë kërkesë për udhëzime ligjore. Edhe pse dispozitat ligjore mjaftueshëm e trajtojnë këtë çështje, pyetja është nëse 5% (pesë përqind) e të gjitha të hyrave të pranuar si rrjedhojë e çfarëdo shitje, transferimi, privatizimi, likuidimi apo tjetër përfshin edhe 5% (pesë përqind) të të hyrave nga qiratë tek togfjalëshi “...apo mënyrave tjera të disponimit me cilëndo ndërmarrje apo aset...”. Pra, nga ky interpretim të kuptohet nëse 5% (pesë përqind) e të gjitha të hyrave përfshihen edhe 5% (pesë përqind) e të hyrave nga qiratë, si Tarifë Administrative.

Në lidhje me këtë çështje gjykata vëren se neni 21.2 i Ligjit të AKP-së, e le të hapur mundësinë e përfshirjes edhe të 5% (pesë përqind) të hyrave nga qiratë në kuadër të Tarifës Administrative të Agjencisë, kjo pasi 5% (pesë përqind) i të hyrave i referohet në përgjithësi të hyrave të pranuar nga çfarëdo shitje, transferimi, privatizimi, likuidimi apo mënyrave tjera të disponimit me cilëndo ndërmarrje apo aset, si TA për Agjencinë për t’i mbuluar shpenzimet e veta të përgjithshme administrative dhe operative. Pra, dispozita në fjalë i referohet edhe mënyrave tjera të disponimit dhe sipas gjykatës mënyrë tjetër e disponimit është edhe dhënia e pronës së NSH-së apo asetëve të saj me qira nga Agjencia. Ndërsa qiratë janë të hyra të pranuar nga shfrytëzimi i pronës së ndërmarrjes.

Neni 32 i Shtojcës së Ligjit për AKP, specifikisht i përcakton të hyrat nga qiratë si pronë e ndërmarrjes në likuidim, duke përcaktuar mënyrën se si trajtohen ato të hyra, rrjedhimisht nuk e përjashton mundësinë e aplikimit të 5% (pesë përqind) e të hyrave nga qiratë si TA. Megjithatë gjykata konsideron se gjatë zbatimit të këtij Udhëzimi, Agjencia do t’i përmbahet parimit të aplikimit vetëm të 5% (pesë përqind) të të hyrave nga qiratë që mund të jenë të duhura për të mbuluar shpenzimet e nevojshme dhe të arsyeshme si administratore në mirëbesim e NSH-ve përkatësisht asetëve të tyre.

Neni 3.1.1.18 i Ligjit për AKP, që i referohet përkufizimeve të shprehjeve të përdorura në ligjin në fjalë, nuk ka të bëjë konkretisht me 5% (pesë përqind) e të hyrave nga qiratë si TA, çështje kjo e ngritur nga Agjencia, pasi administrimi, privatizimi dhe likuidimi i kryer nga Agjencia përcaktohet në detaje me ligjin e AKP-së dhe ligjet tjera që ndërlidhen me procesin e transformimit të pronës shoqërore në vend. Kjo dispozitë e përmend pagesën e tarifës administrative të Agjencisë mirëpo vetëm në kuptim të përkufizimit.

Andaj, Dhoma e Posaçme konsideron se AKP siç është udhëzuar në pikën 1 të këtij udhëzimi, mund të aplikoj 5% (pesë përqind) e të hyrave nga qiratë në kuadër të Tarifës Administrative të Agjencisë, me qëllim të përmbushjes së mandatit të saj në mënyrën e duhur dhe duke mbrojtur e rritur vlerën e NSH-ve apo asetëve të tyre, të cilat i ka nën administrim, përderisa pika 2 i referohet kryesisht nevojave të Agjencisë për 5% (pesë përqind) e të hyrave nga qiratë.

Andaj, Dhoma e Posaçme, vie në përfundim se me qëllim që AKP si organ i pavarur publik të mund të përmbush mandatin e saj sipas ligjit nr. 04/L-034 dhe Shtojcës së tij, në rrethanat e krijuara si pasojë e pezullimit të shitjeve, veprime këto kryesisht jashtë kontrollit të Agjencisë, për aq kohë sa zgjat kjo gjendje dhe në varësi të të hyrave në të ardhmen, pa paragjykuar efektet e përgjithshme të procesit të privatizimit dhe likuidimit të ndërmarrjeve shoqërore dhe me qëllim të mbrojtjes së palëve të interesit, ofron këtë zgjidhje specifike si në dispozitiv të këtij udhëzimi.

Për këtë, në pajtim me nenin 48.1 të Shtojcës së Ligjit për AKP dhe kërkesës së saj, jepet ky udhëzim.

Shpenzimet gjyqësore

Parashtruesi i kërkesës tani më ka paguar taksën gjyqësore për kërkesën për udhëzim ligjor në shumë prej 100.00 € dhe nuk ngarkohet me taksa shtesë.

Sylejman Shumolli, Gjyqtar kryesues

Shkelzen Sylaj, Gjyqtar

Diellza Hoxha, Gjyqtare

Urdhër për zyrën e regjistrimit

Udhëzimi duhet t'i dorëzohet:

-Parashtruesit të kërkesës: AL / AKP,

**OPINIONE TË KOMITETIT KËSHILLËDHËNËS
PËR ETIKË GJYQËSORE**



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KOMITETI KËSHILLËDHËNËS PËR ETIKË GJYQËSORE

KKEGJ. Nr. 04/2022

Komiteti këshillëdhënës për etikë gjyqësore (KKEGJ), në bazë të nenit 10.1, të Rregullores nr. 01/2022, për themelimin e Komitetit Këshillëdhënës për Etikë Gjyqësore, duke vendosur lidhur me kërkesën e Kryetares së Gjykatës Themelore në Prishtinë të datës 18.07.2022, jepë këtë:

OPINION KËSHILLËDHËNËS

LIDHUR ME TRAJTIMIN ME PRIORITET TË RASTEVE TË PËRFSHIRA NË KËRKESËN E KRYETARES SË GJYKATËS THEMELORE NË PRISHTINË

I.Baza ligjore e punës të Komitetit

Komiteti Këshillëdhënës për Etikë Gjyqësore(KKEGJ), është themeluar nga KGJK-ja me Vendimin KGJK.nr.10/2022 të datës 21 janar 2022, duke u bazuar në Rregulloren nr.01/2022 e aprovuar nga KGJK-ja po ashtu me datë 21 janar 2022.

Mandati dhe fushëveprimi i KKEGJ është përcaktuar me Rregulloren në fjalë.

Sipas nenit 1.2 të Rregullores, “ 2. Ky Komitet do ti ndihmoj gjyqtarët me informacione dhe këshilla rreth pyetjeve apo çështjeve etike të identifikuar për interpretim në lidhje me Kodin e Etikës Profesionale për Gjyqtar dhe Ligjit të Procedurës Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve”.

Sipas nenit 1.3 të kësaj rregullore ”3. Komiteti do të shërbej si platformë ku gjyqtarët mund të këshillohen si ti trajtojnë situatat apo sjelljet e ardhshme të cilat mund të konsiderohen në kundërshtim me Kodin e Etikës Profesionale për Gjyqtarët”.

Rregullorja në fjalë në nenin 6.1 ka përcaktuar” 1. Kryetarët dhe gjyqtarët e të gjitha niveleve të gjykatave, mund ti drejtohen Komitetit me kërkesa për dhënie të opinioneve, lidhur me situatat apo sjelljet e ardhshme të cilat mund të konsiderohen në kundërshtim me Kodin e Etikës Profesionale për Gjyqtarë “.

II. Faktet e cekura në Kërkesën e Kryetares së Gjykatës Themelore në Prishtinë

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, me datë 18 korrik 2022 e parashton një Kërkesë për KKEGJ, dhe kërkon nga ky Komitet që të lëshohet një Opinion këshillëdhënës, për mundësinë e trajtimit me prioritet ligjor të dy lëndëve në pritje me bazë juridike “Kompensim dëmi”, dhe atë të lëndës C.nr.1070/19(2019:1944) në pritje për trajtim në Gjykatën Themelore në Prishtinë, dhe lëndës C.nr.623/20(2020:057194) në pritje për trajtim në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Dega në Glllogoc.

Të dy këto lëndë në bazë të Rekomandimeve të Avokatit të popullit është kërkuar të trajtohen me prioritet, pasi siç thuhet në Rekomandimet e Avokatit të popullit, bëhet fjalë për lëndët në të cilat si palë janë përfshirë fëmijë me aftësi të kufizuara dhe janë lëndë me ndjeshmëri të lartë.

Tutje në kërkesë Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë ka sqaruar se lëndët me bazë ligjore “Kompensim dëmi” sipas Strategjisë së KGJK-së për zgjidhjen e lëndëve të vjetra, nuk konsiderohen lëndë me prioritet, andaj meqenëse ka lëndë më të vjetra në pritje se këto dy lëndë që ende nuk janë trajtuar, Kryetarja në kërkesën e saj shfaqë interes të marrë opinion këshillëdhënës nga KKEGJ, nëse këto lëndë të përfshira në Rekomandimet e Avokatit të Popullit, mund të trajtohen me prioritet më të lartë, para lëndëve tjera më të vjetra me të njëjtën bazë ligjore.

III. Legjislacioni i zbatueshëm ndërkombëtar

Në bazë të nenit 6 të KEDNJ, “Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme(...) “. Sipas nenit 13 të KEDNJ, është përcaktuar që “Çdo njeri të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me këtë Konventë, ka të drejtë për mjetet ligjore efektive për rivendosjen e së drejtës nga një autoritet kombëtar (...) “. Ndërsa me nenin 50 [Të drejtat e Fëmijës], përcaktohet se “Të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët, të ndërmarra qoftë nga institucionet e pushtetit publik, qoftë nga institucionet private do të jenë në interesin më të mirë të fëmijëve”.

Në bazë të nenit 3 të Konventës së të Drejtave të Fëmijëve(1989), “Në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucione publike ose private të përkrahjes shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislative, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese”. Ndërkaq kjo Konventë në nenin 20 ka

përcaktuar që “ 1.Një fëmijë, të cilit i mohohet në mënyrë të përkohshme ose të përhershme mjedisi i tij familjar, ose kur nuk është në interesin e tij më të lartë të qëndroj në këtë mjedis, ka të drejtë për një mbrojtje dhe një ndihmë të posaçme nga shteti”.

Në bazë të nenit 13 të Konventës Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara , përcaktohet që “Shtetet palë do të sigurojnë akçes efektiv në organet e drejtësisë për personat me aftësi të kufizuara njësoj si pjesa tjetër e popullsisë, duke përfshirë akomodime të përshtatshme procedural dhe sipas përkatësisë së moshës me qëllim të lehtësimit të tyre si pjesëmarrës direkt dhe indirekt [...]”.

IV. Legjislacioni i zbatueshëm vendor

Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 54 [Mbrojtja gjyqësore e të Drejtave], ka përcaktuar se” Çdo kush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore, nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur” , ndërsa në nenin 132 paragrafi 3 [Roli dhe Kompetencat e Avokatit t; Popullit], Kushtetuta e Republikës së Kosovës, ka përcaktuar se “Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar tu përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe ti paraqesin atij të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj“.

Ligji për gjykatat në nenin 7.5 ka paraparë që “Të gjitha gjykatat duhet të funksionojnë në mënyrë të shpejtë dhe efikase për të siguruar zgjidhjen e shpejtë të lëndëve “.

Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës në nenin 5, paragrafi 4 ka përcaktuar se “Për të siguruar interesin më të mirë të fëmijës duhet të respektohen parimet si në vijim: 4.3 Vendimet administrative dhe gjyqësore që prekin fëmijën duhet të merren dhe zbatohen me shpejtësi dhe pa vonesa të pa arsyeshme”. Ky ligj në nenin 46 ka paraparë që të “[...] eliminohen të gjitha barrierat infrastrukturore, sociale, mjedisore, **institucionale dhe ligjore** në fushat e arsimit, punësimit dhe arsimit profesional, kujdesit shëndetësor, rehabilitimit, aktiviteteve kulturore, argëtuese dhe sportive që fëmijët me aftësi të kufizuara të ushtrojnë të drejtat e parashikuara në këtë ligj”.

Neni 5, paragrafi 5.5 i Kodit të etikës profesionale për gjyqtar ka paraparë që “Gjyqtari ushtron funksionin e tij në mënyrë efikase dhe të ligjshme “.

V. Të gjeturat dhe rekomandimet

KKEGJ konstaton se në bazë të nenit 1.2 të Rregullores nr.01/2022 të datë 21 janar 2022, për themelimin e Komitetit Këshillëdhënës për Etikë Gjyqësore (KKEGJ), Komiteti ka mandat të japë informacione dhe këshilla për çështjet etike, vetëm për gjyqtarët (përfshirë Kryetarët e gjykatave) të të gjitha niveleve të gjykatave. Në këtë rast kërkesa ka ardhur nga Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë që është autoritet kompetent për të kërkuar nga KKEGJ opinionin këshillëdhënës për çështjen lëndore, andaj kjo kërkesë do të merret në shqyrtim.

Tutje KKEGJ vëren se çështja lëndore e kërkesës së Kryetares së Gjykatës Themelore në Prishtinë, është çështje ekskluzivisht ligjore, dhe po ashtu është edhe çështje që në ndonjë mënyrë lidhet edhe me “situatat apo sjelljet e ardhshme” etike, e që ka nevojë të sqarohet, nëse trajtimi me prioritet i çështjes lëndore mund të konsiderohet ose jo si sjellje që është në kundërshtim me Kodin e etikës për gjyqtar dhe prokurorë, e për të cilat situata të ardhshme është mandatuar KKEGJ, të japë Opinione këshillëdhënëse sipas nenit 1.4 të Rregullores në fjalë.

KKEGJ vëren se sipas kërkesës së Kryetares së Gjykatës Themelore në Prishtinë, bëhet fjalë për dy raste në lëndët e cekura në kërkesë, ku të përfshira janë palët me status ligjor të fëmijës dhe për më tepër fëmijë që janë me aftësi të kufizuara. Këto të gjetura faktike lidhur me gjendjen fizike dhe shëndetësore të fëmijëve janë të përfshira në Rekomandimet e Avokatit të Popullit, andaj ato të gjetura KKEGJ i konsideron si të mirëqena, dhe të pa kontestuara edhe nga vetë kërkesa e Kryetares.

Këto dy raste në tërësinë e rasteve në pritje me bazë të njëjtë ligjore “Kompensim dëmi”, janë raste me numër të papërfillshëm, që në esencë substancialisht nuk mund të kufizojnë trajtimin e barabartë kohor të gjitha palëve të përfshira në lëndët në pritje me bazë të njëjtë ligjor “Kompensim dëmi”.

Në praktikën e gjykatave mund të shfaqen raste të rralla si këto, në të cilat për shkak të ndjeshmërisë së lartë që kanë, në parim mund të trajtohen me prioritet më të lartë nga rastet tjera më të hershme në pritje që kanë të njëjtën bazë ligjore.

Për më tepër KKEGJ në Opinionin këshillëdhënës nr.1 të dhënë me vetiniciativë në muajin Prill 2022, ka vënë në pahë se “gjyqtarët në bazë të legjislacionit në fuqi gjatë trajtimit të lëndëve me të cilat ata janë të ngarkuar (përfshirë lëndët për të cilat ligji u jep përparësi në trajtim), ata duhet ti trajtojnë lëndët sipas radhës dhe kronologjisë kohore të regjistrimit të tyre në gjykatë, në mënyrë që kështu të sigurohet në mënyrë efektive respektimi i parimit të trajtimit të barabartë të palëve në procedurë edhe në aspektin kohor të dhënies së drejtësisë së kërkuar”. Ky opinion këshillëdhënës i KKEGJ, nuk i përjashton rastet, kur vet ligji një lëndë konkrete i jep përparësi ligjore në trajtim.

Në dy rastet në fjalë siç ka vënë në pahë Rekomandimi i Avokatit të popullit A.nr.230/2021 i datës 30 maj 2022, çështja lëndore është edhe çështje ligjore.

Vetë Ligji për Mbrojtjen e fëmijës në nenin 5 paragrafi 4 ka përcaktuar se ”4.3. Vendimet administrativ dhe gjyqësore që prekin fëmijën duhet të merren me shpejtësi dhe pa vonesa të arsyeshme”. Ky përkufizim kaq shprehimor dhe i drejtpërdrejtë ligjor, nuk lë shumë hapësirë për të hamendësuar. Vetë ligji përcakton detyrimin e autoritetit publik, në këtë rast të gjykatës që të veprojnë shpejtë dhe pa vonesa të paarsyeshme, sigurisht me qëllim që autoriteti publik sa më parë që të jetë e mundur të merre vendimin që e pret pala e prekur, dhe të zgjidhë çështjen lëndore. Kjo për shkak se është në pyetje mbrojtja e interesit legjitim të fëmijës, e në këtë rast të fëmijës me aftësi të kufizuara, e që e bënë edhe më urgjente çështjen lëndore.

Siç ka vë në pahë me të drejtë Avokati i Popullit në Rekomandimin e tij A.nr.585/2021 të datës 30 maj 2022, edhe Konventa për të Drejtat e Fëmijëve, që është e aplikueshme në bazë të nenit 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në nenin 3 ka përcaktuar “të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijës, të marra çoftë nga institucionet publike ose private të përkrahjes shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative, apo organeve legjislative, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese”. Edhe ky përkufizim i këtij instrumenti juridiko ndërkombëtar shumë çartë shpreh kërkesën themelore, që çështja duhet të merret sa ma shpejtë që të jetë e mundur në trajtim, andaj është një obligim që rrjedhë nga një konventë ndërkombëtare, që nuk ka mundësi të anashkalohet, dhe të mos zbatohet nga cili do autoritet publik, përfshirë edhe gjykatat.

Dy rastet në fjalë siç u tha janë çështje ligjore, çështje që ndërlidhen me statusin ligjor të fëmijës, e në këtë rast edhe më rëndë të fëmijës me aftësi të kufizuara.

Fakti se rastet me bazë ligjore “Kompensim dëmi” sipas Strategjisë së KGJK-së për zgjidhjen e lëndëve të vjetra, nuk përcaktohen si lëndë me prioritet në trajtim, kjo assesi nuk duhet ta pengoi gjykatën ta marrë rastin me bazë të tillë ligjore, në trajtim më shpejtë se rastet tilla të ardhura më herët në gjykatë. Strategjia e KGJK-së për zgjidhjen e lëndëve të vjetra, nuk mund të jetë mbi ligjin që ofron mbrojtje efikase institucionale për fëmijën.

Gjykata si autoritet publik e ka detyrimin ligjor që dele nga ligji dhe Konventa ndërkombëtare, ta marrë rastin në trajtim ku janë të përfshirë si palë fëmijët, duke i dhënë pa hezitim prioritet në trajtim para lëndëve tjera të regjistruara më herët në gjykatë me bazë të njëjtë ligjore.

Nuk është shumë e rëndësishme se ky detyrim a vjen nga ndonjë ligj material apo procedural. Të gjitha obligimet ligjore që rrjedhin nga ligji material apo ai procedural duhet të zbatohen në tërësi, dhe këtu gjykatës nuk i është dhënë diskrecion të vendos nëse duhet zbatohen obligimet ligjore.

KKEGJ, mund të konstaton se mbrojtja efikase në aspektin kohor e interesit ligjor të fëmijës e parasë gjithash fëmijës me aftësi të kufizuara, në lëndët me bazë të njëjtë ligjore, ka prioritet para çdo interesi ligjor të cilës do palë tjetër çoftë person fizik ose juridik. Interesi i fëmijës përfshirë posaçërisht ata me aftësi të kufizuara për shkak të ndjeshmërisë, peshon më rëndë se çdo interes tjetër që duhet mbrojtur.

Andaj gjykata si autoritet publik, nuk ka bazë ligjore të hamendësohet dhe të mos trajtoj rastin e tillë, duke i dhënë prioritet të lartë para lëndëve më të vjetra me bazë të njëjtë ligjore.

Barazia e palëve në aspektin kohor të trajtimit të lëndëve në pritje është vlerë që duhet të mbrohet në çdo rast, por ky parim nuk duhet ta mbisundojë dhe të vihet mbi parimin tjetër ligjor të trajtimit të lëndëve ku vet ligji ka përcaktuar prioritetin ligjor të trajtimit, siç janë rastet e përfshira në Rekomandimet e Avokatit të Popullit, e të cekura në kërkesën e Kryetares së Gjykatës Themelore në Prishtinë.

IV. Konkluzionet

Komitetit Këshillëdhënës për Etikë Gjyqësore, duke shqyrtuar kërkesën e Kryetares së Gjykatës Themelore në Prishtinë, jep opinionin e tij këshillëdhënës, duke i këshilluar gjyqtarët e tri niveleve të Gjykatave të Republikës së Kosovës, se rastet e tilla ku në lëndët në pritje me bazë të njëjtë ligjore “Kompensim dëmi”, apo me ndonjë bazë tjetër ligjore të njëjtë, janë përfshirë palët me status ligjor të fëmijës (përfshirë rastet e fëmijëve me aftësi të kufizuara), duhet pa hezitim të merren me prioritet në trajtim, edhe nëse në pritje ka lëndë më të vjetra, pasi që vet ligji në këto raste ka përcaktuar prioritetin ligjor të trajtimit të këtyre lëndëve.

Prandaj gjyqtarët janë të obliguar ti zbatojnë këto detyrime ligjore, pavarësisht faktit se rastet me bazë ligjore “Kompensim dëmi” në bazë të Strategjisë të KGJK-së, nuk konsiderohen lëndë me prioritet.

KKEGJ konsideron se gjyqtarët kanë obligime kushtetuese ti marrin në konsideratë dhe ti zbatojnë edhe Rekomandimet e Avokatit të popullit, posaçërisht për rastet si ato të Kërkesës së Kryetares së Gjykatës Themelore në Prishtinë, pasi që zbatimi i këtyre rekomandimeve, nuk e cenon në asnjë mënyrë pavarësinë e punës së gjyqtarit. Zbatimi i rekomandimeve të tilla shkon në funksion të zbatimit të obligimeve ligjore që i ka gjyqtari gjatë trajtimit të rastit, dhe kjo nuk mund të konsiderohet ndërhyrje në punën e pavarur të gjykatës dhe të gjyqtarit që ai e ka në bazë të Kushtetutës, ligjit dhe Kodit të Etikës për gjyqtar.

**Kryetari i Komitetit,
Muhamet Rexha**



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KOMITETI KËSHILLËDHËNËS PËR ETIKË GJYQËSORE

KKEGJ. Nr. 3/2022

Komiteti këshillëdhënës për etikë gjyqësore, në bazë të nenit 8 lidhur me nenin 10, të Rregullores nr. 01/2022, për themelimin e Komitetit Këshillëdhënës për Etikë Gjyqësore (KKEGJ), në takimin e Komitetit të mbajtur me datën 12 korrik 2022, me vet iniciativë, jepë këtë:

OPINION KËSHILLËDHËNËS

**PËR STANDARDET ETIKE TË ZBATUESHME, NË RASTIN E KOMUNIKIMIT
TË GJYQTARIT ME MEDIA DHE ME MONITORUESIT E SISTEMIT TË
DREJTËSISË DHE MBROJTJES SË INTEGRITETIT TË PROCEDURËS
GJYQËSORE GJATË TRAJTIMIT TË NJË RASTI KONKRET**

I.Çështja etike e parashtruar

Kuvendi i Republikës së Kosovës, me 23 nëntor 2018 ka aprovuar Ligjin Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe në nenin 5.2 nën paragrafi 2.10 të këtij ligji një ndër shkeljet e detyrave të gjyqtarit është përcaktuar “ *2.10 bën deklarata publike gjatë procedurave që janë duke u zhvilluar e të cilat mund, ose duket se ndikojnë negativisht në gjykim të drejtë dhe trajtim të barabartë të palëve në procedure ose të cilat mund të dëmtojnë besueshmërinë dhe reputacionin e gjykatës apo i komunikon informata publikut rreth përbërjes së paneleve gjyqësore, dëshmimeve dhe vendimeve që kanë të bëjnë me ndonjë rast, përveq nëse zbulimi i një informacioni të tillë kërkohet me ligj.* “

Ligdhënsi me këtë dispozitë ligjore është e qartë se ka synuar ti mbroj disa vlera etike gjyqësore, që ndërlidhen me gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe trajtim të barabartë të palëve në një rast konkret gjyqësor.

Gjyqtari i ngarkuar me rastin konkret gjyqësor, asesi nuk mund ti ekspoj publikut nëpërmes mediave(mediave të shkruara apo medimeve televizive) apo edhe monitoruesve të sistemit gjyqësor, të dhëna të tilla, që e dëmtojnë ose duket se mund të dëmtojnë besueshmërinë dhe reputacionin e gjykatës, pastaj nuk mund të komunikon informatata lidhur me përbërjen e paneleve gjyqësore, informata lidhur me dëshmit e rastit dhe informata lidhur me vendimet e deritanishme gjyqësore për rastin konkret që ende nuk papërfunduar.

Po ashtu Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), ka miratuar Kodin e Etikës Profesionale për gjyqtar, me vendimin Nr. 01/238, date 17.08.2016. Një nga standardet e parashikuara me këtë kod është ai se *“Gjyqtari nuk komenton publikisht apo privatisht për çfardo lëndë në procedure gjyqësore e që mund të nxitë dyshimin në paanshmërinë e tij”*. Sipas këtij standardi etik, gjyqtari gjatë punës së tij duhet ti nënshtrohet kufizimeve të domosdoshme nga komunikimi me media por edhe nga komunikimi me monitoruesit e sistemit të drejtësisë, dhe këtë për të ruajtur integritetin e pacënueshëm të procedurës gjyqësore lidhur me rastin konkret me të cilin ai është i ngarkuar.

II. Vlerësime të përgjithshme

Një gjyqësor efektiv dhe i pavarur, kërkon standarde dhe integritet të lartë të gjyqtarëve, me qëllim realizimin e misionit të tyre, e që ka të bëjë me dhënien e drejtësisë. Në funksion të kësaj, respektimi i rregullave të sjelljes nga ana e gjyqtarëve gjatë kohës sa e ushtrojnë këtë funksion, ndikon drejtpërsëdrejti në garantimin e shtetit të së drejtës.

Mirëbesimi në publik dhe respekti për gjyqësorin janë garancion të efektivitetit të sistemit gjyqësor, ndërsa sjellja e gjyqtarëve në aktivitetet e tyre profesionale, konsiderohet nga anëtarët e publikut si thelbësore për kredibilitetin e gjykatës. Në këtë vështrim, për gjyqtarët është e rëndësishme të kuptojnë jo vetëm kufijtë që ligji ka përcaktuar në ushtrimin e funksionit të tyre, por edhe standardet e sjelljes etike që ata janë të detyruar të respektojnë. Në lidhje me këtë, roli i gjyqtarëve është që ti shërbejnë qytetarëve, përmes zgjidhjes së çështjeve gjyqësore në përputhje me ligjin, duke garantuar trajtim të barabartë për të gjitha palët¹⁹¹.

Prestigji i sistemit gjyqësor është thelbësor në një sistem demokratik, në një shtet të së drejtës, ku gjyqësori ushtron pushtetin e tij si i pavarur. Sjellja e gjyqtarëve vlerësohet se është e lidhur ngushtë me rritjen e besimit në integritetin e gjyqësorit në tërësi. Gjyqtarët në çdo sistem ligjor edhe në sistemin tonë gjyqësor kanë rolë kyq dhe të pazëvendësueshëm në sigurimin e zbatimit të standardëve të përcaktuara etike gjyqësore. Gjyqtarët me punën e tyre efikase dhe transparente dhe me zbatimin e standardeve etike gjyqësore e sigurojnë rritjen e besimit të publikut në sistemin gjyqësor, dhe e kundërta nëse nuk ka punë efikase dhe transparente dhe

¹⁹¹ Komentari i “Parimeve të Bangalores për sjellje në gjyqësor”.

nëse gjyqtari dështon në masë të madhe në zbatimin e parimeve të përcaktuara të etiks gjyqësore (përfshirë edhe kufizimet që i ka ai në raport me mediat), dobësohet besimi i publikut në drejtësi. Ndërsa besimi i publikut është çështje kruciale, për të arritur një sistem llogaridhënës, transparent dhe efikas gjyqësor.

1. Standardet ndërkombëtare, në garantimin e paprekshmërisë së integritetit të procedurës gjyqësore

Gjatë përgatitjes së opinionit për këtë temë, KKEGJ ka shqyrtuar dhe ka marr për bazë disa dokumente të aprovuara ndërkombëtare, të cilat ndërlidhen me çështjen etike të parashtruar. Në vazhdim në kontekstin e trajtimit të kësaj teme do të përmendim disa të tilla:

1. Parimet themelore të pavarësisë së gjyqësorit të Kombeve të Bashkuara (1985). Sipas pikes 15 të këtyre parimeve, “Gjyqësia do të përbetohet me fshehtësi profesionale lidhur me diskutimet e tyre dhe se informatat e besueshme (konfidenciale) të fituara në rrjedhën e detyrave të tyre jashtë proceseve gjyqësore nuk do të përdoren si dëshmi në çështjet e tilla. “

Ky dokument ndërkombëtar përcakton obligimet e gjyqtarëve që ata duhet të ruajnë të gjitha fshehtësit profesionale që ndërlidhen me diskutimet që bëhen gjatë trajtimit të rastit. Kjo ka mundësi të interpretohet edhe si obligim etik i gjyqtarit që çështjet e tilla të mos i transferohen publikut në për mes mediave apo monitoruesve të sistemit të drejtësisë.

2. Rekomandimin Nr. R (94) 12 të Komisionit të Ministrave të Këshillit të Evropës më pavarësinë, efikasitetin dhe rolin e gjyqtarëve. Sipas këtij Rekomandimi parimi V-Përgjegjësit gjyqësore, pika 2” Gjykatësit kanë detyrë dhe duhet të kenë fuqinë që të ushtrojnë përgjegjësit e tyre gjyqësore për të siguruar që ligji të aplikohet në mënyrë të përshtatshme dhe që rastet trajtohen në mënyrë korrekte, efikase dhe me shpejtësi të duhur. “

Ky parim etik gjyqësor që është përcaktuar nga ky dokument ndërkombëtar mund të interpretohet si detyrim i gjyqtarit që përgjegjësit e tij kushtetuese ligjore dhe etike që dalin nga funksioni publik që e ushtron, gjatë trajtimit procedural të rastit konkret me të cilin ai është i ngarkuar, ti kryejë vetëm në pajtim me ligjin, e jo jashta suazave ligjore të tij. Në raport me mediat për rastin konkret që e trajton, ai nuk ka diskrecion të zgjedhë në mes zones së ndaluar të përcaktuar ligjore dhe asaj të lejuar të përcaktuar ligjore.

3. Deklarata e Parimeve të Pavarësisë së Gjyqësorit e aprovuar nga Konferenca e Kryetarëve të Gjykatave të Larta të Evropës Qendrore dhe Lindore, e aprovuar me 14 tetor 2015, në Brijuni, Kroaci. Në pikën e 8 të kësaj Deklarate është paraparë që “*Gjyqtarët duhet të mbështesin integritetin dhe pavarësinë e gjyqësorit dhe fitojnë besimin e popullit duke shmangur sjellje të pahijshme dhe shfaqjen e sjelljes së pahishme në të gjithë veprimtarin e tyre zyrtare dhe private* “

4. Opinioni nr. 3 i Këshillit Këshillëdhënës të Gjyqtarëve Evropian, KKGjE (2002) Op. Nr 3, datë 19 Nëntor 2002. Në pikën e 40 të këtij dokumenti ndër të tjera përcaktohet “...*gjyqtarët duhet të shfaqin kujdes në mardhëniet e tyre me mediat dhe të mund të ruajnë pavarësinë dhe*

objektivitetin e tyre duke u përmbajtur nga shfrytëzimi i mardhënieve personale me gazetar dhe ndonjë koment të paarsyetuar për rastet që i trajtojnë.... “.

Të gjitha këto dokumente ndërkombëtare në përmbajtjen e tyre në një formë apo tjetër i kushtojnë rendësi të veçantë përgjegjësisë së gjyqtarit në sigurimin e respektimit të integritetit të procedurës gjyqësore, e që ndërlidhet edhe me obligimin e tyre që për raste të caktuara të cilat i kanë në shqyrtim ti përmbahen kufizimeve të përcaktuara ligjore dhe etike të paraqitjes së tyre në media.

2. Rregullativa ligjore vendore, në sigurimin e integritetit të procedurës gjyqësore

KKEGJ konstaton se në Republikën e Kosovës, është miratuar rregullativë ligjore adekuate, e cila normon detyrimin e gjykatave, përkatësisht gjyqtarëve që të kujdesen në sigurimin e integritetit të procedurës gjyqësore për një rast specifik të caktuar.

Një detyrim i tillë për gjyqtarët në kuadër të parimit të sigurimit të integritetit të procedurës gjyqësore, ekziston edhe për zbatimin e kufizimeve të përcaktuara ligjore dhe etike të paraqitjes së tyre në media.

Në funksion të mbrojtjes efektive të këtij parimi, ligjet përkatëse në fushat të ndryshme (*penale, civile, administrative, ekonomike etj*), përcaktojnë detyrime për gjyqtarët që të mbrojnë integritetin e procedurës përkatëse, duke mos vënë në dispozicion të publikut çështjet që trajtohen gjatë procedurës për një rast konkretë.

Ligji për Përgjegjësinë Disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe Kodi i Etikës Profesionale për gjyqtarë, siç u tha më sipër parashohin dispozita me të cilat rregullohen përgjegjësitë dhe detyrat të cilat i kanë gjyqtarët në ushtrimin e funksionit gjyqësor, përfshirë këtu përmbajtjen nga kufizimet që i kanë gjyqtarët në raport me media.

Kodi i Etikës Profesionale të gjyqtarëve, i hartuar në përputhje me standardet ndërkombëtare të cekura më lartë, kërkon nga gjyqtarët që përveç respektimit dhe zbatimit të parimeve të tjera siç janë pavarësia, paanësia, integriteti etj, të zbatojnë me rigorizitet edhe parimin e zbatimit të kufizimeve të paraqitjes në media për raste të caktuara, me qëllim të mbrojtjes së integritetit të procedurës gjyqësore dhe sigurimin e respektimit të dinjitetit të gjykatës që ajo duhet ta ketë në publik.

Rregullorja për Zyrtarët për informim publik në Gjykata e aprovuar nga KGJK-ja në muajin maj 2014, në nenin 3.1 ka përcaktuar, që ” *Për të gjitha pyetjet që kanë të bëjnë me lëndë në gjykatë dhe çështje tjera të ndieshme të ndërlidhura me punën e Gjykatës, Kryetari i Gjykatës ka autoritetin të komunikoj direkt me publikun dhe me median. “.* Sipas pikës 3.2 “ *Në mungesë të Kryetarit të Gjykatës, Nënkryetari i Gjykatës mund të komunikoj me median sa i përket informacionit të ndërlidhur me gjykatën “.* Kurse sipas nenit 3.3, “ *ZIP, me autorizim paraparak të Kryetarit të Gjykatës, mund të jap prononcime për të gjitha mediat “.*

Po ashtu me Rregulloren nr.02/2020 Për Organizimin dhe veprimtarin e mbrendshme të Gjykatave të Republikës së Kosovës të aprovuar nga KGJK-ja me 23 qershor 2020, në nenin

11.13 është përcaktuar që “ *Kryetari i Gjykatës apo personi i autorizuar është përgjegjës për të komunikuar me publikun për të gjitha çështjet rreth lëndëve dhe çështjeve tjera të ndieshme me punën e Gjykatës*”.

Nga përmbajtja e dispozitave të rregullativës ligjore vendore që ndërlidhet me këtë parim ligjor dhe etik, KKEGJ mund të konstatojë se gjyqtari është i obliguar të silltet në atë mënyrë, që e afirmojnë besimin e publikut dhe e sigurojnë integritetin e sistemit gjyqësor të Kosovës. Gjyqtarët në bazë të rregullativës ligjore nëpër mes mediave nuk mund të zbulojnë informata për çështjen lëndore procedurale në tajtim, për palët, për faktet dhe provat e shqyrtuara apo ato që duhet të shqyrtohen deri në përfundimin e rastit konkret. Gjyqtarët po ashtu janë të detyruar të përmbahen nga komentet publike në lidhje me punën dhe veprimtarin apo efikasitetin e gjyqtarëve tjerë apo sistemit gjyqësor në përgjithësi, nga se kjo ka mundësi të ndikojë në zvogëlimin e reputacionit që e ka sistemi gjyqësor në publik.

III. Faktet e çështjes etike të parashtruar

KKEGJ konstatojë se Kuvendi i Republikës së Kosovës me miratimin e ligjeve përkatëse për gjyqësorin, dhe KGJK-ja me miratimin e Rregullorës për Zyrtarët për informim publik në Gjykata e aprovuar në muajin maj 2014, dhe me miratimin e Rregullores nr.02/2020 Për Organizimin dhe veprimtarin e mbrendshme të Gjykatave të Republikës së Kosovës të aprovuar me 23 qershor 2020, por edhe Rregullorës tjetër përkatëse që i referohet publikimit të vendimeve gjyqësore, ka krijuar bazën e mjaftueshme ligjore për institucionet gjyqësore, që ato lidhur me punën e tyre ndaj publikut të jenë të hapura dhe transparente.

Transparenca në institucionet e sistemit gjyqësor realizohet në forma të ndryshme, duke filluar nga seancat e hapura për publikun gjatë trajtimit të rasteve të caktuara, publikimi i vendimeve gjyqësore dhe i raporteve të punës së gjykatave në Web faqen e gjykatës përkatëse, e deri te komunikimi i kohë pas kohshëm i Kryetarëve të Gjykatave, apo Zyrtarëve për informim të gjykatave, me përfaqësues të mediave, me monitorues të sistemit të drejtësisë dhe antarë të shoqërisë civile.

Legjislacioni që e rregullon transparencën e gjyqësorit vlerësohet se është i mjaftueshëm dhe ai ka krijuar adresat ku përfaqësuesit e mediave, antarët e shoqërisë civile dhe monitoruesit e sistemit të drejtësisë, duhet të shkojnë për të kërkuar informacione konkrete për punën e secilit institucion gjyqësor.

KKEGJ konstatojë se në raste jo të rralla ka presion nga mediat apo monitoruesit e sistemit të drejtësisë që informacionet e caktuara sidomos për rastet konkrete mediatike të kërkohen edhe nga gjyqtarët që i trajtojnë rastet përkatëse, megjithëse ato duhet ta dinë që legjislacioni në fuqi dhe Kodi i Etikës profesionale për gjyqtarë, nuk lejon mundësinë për gjyqtarët që për rastet që i kanë në trajtim të japin informacione.

Në praktikën gjyqësore jo rallë herë shfaqen raste kur edhe gjyqtari i rastit konkret gjyqësor në trajtim i Gjykatës përkatëse, jep informacione të llojeve të ndryshme për rastin që është duke u trajtuar proceduralishtë.

Mund të konstatohet se këto raste nuk janë bërë dukuri në gjithë sistemin gjyqësor, por megjithatë edhe si raste sporadike që paraqiten nga një herë, ato duhet të trajtohen nga autoritet kompetente të sistemit gjyqësor, pasi që veprimet e tilla të gjyqtarëve bien në kundërshtim me dispozitat përkatëse të Ligjit për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe me Kodin e Etikës profesionale për gjyqtarë.

Kjo praktikë e rasteve të paraqitura sporadike, nuk ka mbështetje ligjore, dhe sigurisht që nuk i shërben as interesave dhe objektivave që i ka sistemi gjyqësor, për të ndërtuar një sistem të pavarur, të besueshëm, llogaridhënës dhe transparent, i cili duhet të shërbejë forcimit të sundimit të ligjit në Kosovë dhe ndërtimit të shtetit të së drejtës.

Madje mund të thuhet se kjo praktikë ndikon drejtpërdrejtë në shkeljen e parimit të paprekshmërisë së integritetit të procedurës të rastit përkatës që është proceduralisht në trajtim. Praktika të tilla edhe pse sporadike vlerësohen se janë të dëmshme dhe çenojnë parimin e zbatimit të kufizimeve ligjore dhe etike që i ka gjyqtari në raport me mediat gjatë trajtimit të rastit konkret në procedurë gjyqësore. Këto praktika duhet medeomos që të ndalohen në të ardhmen.

IV. Gjetjet dhe rekomandimet

KKEGJ vlerëson se Ligji për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, Nr.06/L-057, në nenin 5.2, nën-pika 2.10 ka përcaktuar si shkelje të detyrave të gjyqtarit, nëse gjyqtari: ” *2.10 bën deklarata publike gjatë procedurave që janë duke u zhvilluar e të cilat mund, ose duket se ndikojnë negativisht në gjykim të drejtë dhe trajtim të barabartë të palëve në procedure ose të cilat mund të dëmtojnë besueshmërinë dhe reputacionin e gjykatës apo i komunikon informata publikut rreth përbërjes së paneleve gjyqësore, dëshmime dhe vendimeve që kanë të bëjnë me ndonjë rast, përveq nëse zbulimi i një informacioni të tillë kërkohet me ligj.* “

Sipas vlerësimit të KKEGJ kjo dispozitë ligjore i mbulon të gjitha shkeljet e mundshme që mund të kryhen nga gjyqtarët gjatë ushtrimit të detyrës së tyre, nëse ai për rastin konkret që e ka në trajtim, vendos të paraqitet në media.

Është mjaftueshëm e qartë se Ligjdhënësi me këtë dispozitë ligjore ka synuar që të mbrohet integriteti i procedures gjyqësore, dhe po ashtu edhe integriteti jo vetëm i palëve të përfshira në procedure, por edhe i gjithë asaj që duhet të trajtohet në një procedurë gjyqësore për rastin konkret.

Në anën tjetër, Kodi i Etikës Profesionale për gjyqtarë i aprovuar nga KGJK-ja me datë 17 gusht 2016, në nenin 3 paragrafi 1 ka paraparë shprehimisht se “*Gjyqtari nuk komenton publikisht apo privatisht për çfardo lëndë në procedure gjyqësore e që mund të nxitë dyshimin në paanshmërinë e tij* “

Ky përkufizim kuptimplotë i kësaj dispozite të Kodit të Etikës Profesionale për gjyqtar, në mënyrë shumë të qartë dhe të drejtpërdrejtë e ka paraparë edhe përgjegjësinë etike të gjyqtarit,

që të zbatoj kufizimet ligjore dhe etike të tij në paraqitjen e tij në media apo komunikim me antarët e shoqërisë civile.

Përgjegjësia për zbatimin e këtyre obligimeve ligjore në rend të pare bie mbi gjyqtarët, por kjo përgjegjësi duhet të shtrihet edhe tek Kryetarët e Gjykatave dhe Gjyqtarët mbikqyrës.

Kryetari i gjykatës mban përgjegjësi menaxheriale, madje ka edhe autorizime dhe obligim ligjore që të inicioj procedura gjyqësore në rastet kur konstaton se gjyqtari përkatës gjatë trajtimit procedural të rastit konkret, ka kryer shkelje të tilla ligjore dhe etike.

V. Konkluzionet përfundimtare

Gjyqtarët në të gjitha instancat gjyqësore kanë përgjegjësi ligjore dhe etike, lidhur me respektimin e parimit të mbrojtjes së integritetit të procedurës gjyqësore gjatë trajtimit të rastit konkret, me të cilin ata janë të ngarkuar.

Gjyqtarët duhet ti zbatojnë kufizimet e përcaktuara ligjore dhe etike në paraqitjen e tyre në media. Ata janë të ndaluar me nenin 5.2 nën paragrafi 2.10 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, Nr.06/L-057, dhe me nenin 2.4 të Kodit të Etikës Profesionale për gjyqtarë, të komunikojnë me media gjatë trajtimit të rastit konkret me të cilin ata janë të ngarkuar.

Çdo shmangie me vetëdije apo pa të nga respektimi i këtij parimi, konsiderohet se paraqet shkelje të detyrave ligjore dhe etike të gjyqtarit, ndërsa kjo sjellje e gjyqtarit vlerësohet se është në kundërshtim me këto dispozita ligjore dhe etike.

Kryetari i Komitetit,

Muhamet Rexha



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KOMITETI KËSHILLËDHËNËS PËR ETIKË GJYQËSORE

KKEGJ. Nr. 02/2022

Komiteti këshillëdhënës për etikë gjyqësore(KKEGJ), në bazë të nenit 7.1 lidhur me nenin 10.1, të Rregullores nr. 01/2022, për themelimin e Komitetit Këshillëdhënës për Etikë Gjyqësore, duke vendosur lidhur me kërkesën e Zyrës për vlerësim dhe verifikim gjyqësor(ZVVGJ), pranë KGJK-së, jepë këtë:

OPINION KËSHILLËDHËNËS

**LIDHUR ME KËRKESËN E ZYRËS PËR VLERËSIM DHE VERIFIKIM
GJYQËSOR(ZVVGJ)**

I.Baza ligjore

Komiteti Këshillëdhënës për Etikë Gjyqësore(KKEGJ), është themeluar nga KGJK-ja me Vendimin KGJK.nr.10/2022 të datës 21 janar 2022, duke u bazuar në Rregulloren nr.01/2022 e aprovuar nga KGJK-ja po ashtu me datë 21 janar 2022.

Mandati dhe fushëveprimi i KKEGJ është përcaktuar me Rregulloren në fjalë.

Sipas nenit 1.2 të Rregullores, “ 2. Ky Komitet do ti ndihmoj gjyqtarët me informacione dhe këshilla rreth pyetjeve apo çështjeve etike të identifikuar për interpretim në lidhje me Kodin e Etikës Profesionale për Gjyqtar dhe Ligjit të Procedurës Disiplinore të Gjytarëve dhe Prokurorëve”.

Sipas nenit 1.3 të kësaj rregullore ”3. Komiteti do të shërbej si platformë ku gjyqtarët mund të këshillohen si ti trajtojnë situatat apo sjelljet e ardhshme të cilat mund të konsiderohen në kundërshtim me Kodin e Etikës Profesionale për Gjyqtarët “.

Rregullorja në fjalë në nenin 6.1 ka përcaktuar” 1. Kryetarët dhe gjyqtarët e të gjitha niveleve të gjykatave, mund ti drejtohen Komitetit me kërkesa për dhënie të opinioneve, lidhur me situatat apo sjelljet e ardhshme të cilat mund të konsiderohen në kundërshtim me Kodin e Etikës Profesionale për Gjyqtarë “.

II.Kërkesa e ZVVGJ, dhe faktet e cekura në kërkesë

Zyra për vlerësim dhe verifikim gjyqësor(ZVVGJ), me datë 13 maj 2022 e parashtron një Kërkesë për KKEGJ, dhe kërkon nga ky Komitet që të lëshohet një Opinion, për rastin e një kandidati gjyqtar për ngritje në detyrë, i cili sipas kërkesës ka ngritur përfundimin lidhur me parashkrimin për një rast të një mase disiplinore. Për më tepër në këtë kërkesë thuhet, “Megenëse në mes periudhës së shkeljes disiplinore(korrik 2014 dhe vendimit disiplinor(shkurt 2020) janë bërë ndryshime ligjore, Paneli për shqyrtimin e aplikacioneve e ka vlerësuar të nevojshme që të marrë opinionin nga Komiteti i Etikës gjyqësore lidhur me përfundimin për parashkrim të paraqitura nga kandidati. Sidomos për shkak se në Ligjin për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe të prokurorëve aplikohet në mënyrë analoge dispozita e Kodit Penal dhe procedurës penale nga rrjedhë se për disa çështje potencialisht mund të aplikohet ligji më i favorshëm për subjektin në hetim “.

III.Të gjeturat dhe rekomandimet

KKEGJ konstaton se në bazë të nenit 1.2 të Rregullores nr.01/2022 të datë 21 janar 2022, për themelimin e Komitetit Këshilldhënës për Etikë Gjyqësore (KKEGJ), Komiteti ka mandat të japë informacione dhe këshilla për çështjet etike, vetëm për gjyqtarët(përfshirë Kryetarët e gjykatave) të të gjitha niveleve të gjykatave, ai nuk ka mandat të jepe opinione dhe këshilla për subjektet e tjera të interesuara, siç është rasti i ZVVGJ, apo të Panelit për shqyrtim të aplikacioneve, anipse kjo Zyre dhe komisionet e themeluara nga KGJK-ja që veprojnë pranë saj janë mekanizma të

KGJK-së dhe punojnë për çështjet e mandatuara, në kuadër të sistemit gjyqësor të Kosovës në përgjithësi.

Tutje çështja lëndore e kërkesës së ZVVGJ, është çështje ekskluzivisht ligjore, nuk është çështje që në ndonjë mënyrë lidhet me” situatat apo sjelljet e ardhshme” etike, e që mund të konsiderohet në kundërshtim me Kodin e etikës për gjyqtar dhe prokurorë, e për të cilat situata të ardhshme është mandatar KKEGJ, të japë Opinione këshilldhënëse sipas nenit 1.4 të Rregullores në fjalë.

KKEGJ vëren se sipas kërkesës së ZVVGJ, bëhet fjalë për një rast individual të një kandidati gjyqtar për ngritje në detyrë. Ky rast i përketë asaj që tashmë ka ndodhë, nuk është rat që i

përketë situatave apo sjelljeve të ardhshme, që potencialisht mund të ndodhin. Andaj mandati i KKEGJ në bazë të Rregullores nr.01/2022 të datë 21 janar 2022, për themelimin e Komitetit Këshilldhënës për Etikë Gjyqësore, nuk është për çështjet tashmë të ndodhura. Për më tepër kërkesa për interpretim të çështjes lëndore, nuk ka ardhë nga vetë gjyqtari.

KKEGJ konsideron se për çështjen lëndore të kërkesës, edhe nëse vet kërkesa do të paraqitej nga gjyqtari i apostrofuar, nuk do të kishte mandat të japë opinionin të caktuar, pasi që bëhet fjalë për një çështje tashmë që ka ndodhur. Kjo situatë e cekur si në kërkesë, është e përcaktuar me nenin 7.1 të Rregullores nr.01/2022 të datë 21 janar 2022, për themelimin e Komitetit Këshilldhënës për Etikë Gjyqësore.

ZVVGJ dhe Paneli për shqyrtimin e aplikacioneve, është e çartë se i kanë mëdyshjet e veta se si ta trajtojë situatën ligjore të përshkruar në Kërkesë, por këta mekanizma të KGJK-së janë të mandatuara që vetë ti zgjidhin çështjet që potencialisht mund të dalin të pasqaruara.

Andaj nga të gjeturat dhe arsyet e cekura, KKEGJ konsideron se ai nuk ka mandat në bazë të Rregullores nr.01/2022 të datë 21 janar 2022, për themelimin e Komitetit Këshilldhënës për Etikë Gjyqësore, që të japë opinionin e kërkuar nga ZVVGJ, për çështjen lëndore të kërkesës.

IV.Konkluzionet

Nga arsyerat e cekura, e duke u bazuar në nenin 7.1 të Rregullores nr.01/2022 të datë 21 janar 2022, për themelimin e Komitetit Këshilldhënës për Etikë Gjyqësore, KKEGJ, e refuzon kërkesën e ZVVGJ për të dhënë opinion për çështjen lëndore.

**Kryetari i Komitetit,
Muhamet Rexha**



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KOMITETI KËSHILLËDHËNËS PËR ETIKË GJYQËSORE

KKEGJ. Nr. 1/2022

Komiteti Këshillëdhënës për Etikë Gjyqësore, në bazë të nenit 8 lidhur me nenin 10, të Rregullores nr. 01/2022, për themelimin e Komitetit Këshillëdhënës për Etikë Gjyqësore (KKEGJ), në takimin e mbajtur me datën 13 prill 2022, me vet iniciativë, jepë këtë:

OPINION KËSHILLËDHËNËS

**PËR STANDARDET ETIKE TË ZBATUESHME, NË RASTIN E BARAZISË SË
PALËVE, TRAJTIMIT TË LËNDËVE GJYQËSORE SIPAS PRIORITETIT DHE
RADHËS SË REGJISTRIMIT TË TYRE NË GJYKATË**

I. Çështja etike e parashtruar

Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), ka miratuar Kodin e Etikës Profesionale për gjyqtar, me vendimin Nr. 01/238, date 17.08.2016. Një nga standardet e parashikuara me këtë kod është ai i *“trajtimit të barabartë të palëve në procedurë gjyqësore”*, sipas të cilit gjyqtari gjatë punës së tij i respekton parimet e barazisë së palëve në procedurë, duke njohur dhe respektuar diversitetin në shoqëri në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, përkatësisë fetare, përkatësisë nacionale etj. Në kuadër të këtij parimi, rregullat e sjelljes së parashikuara në Kodin e Etikës (pika 3), nuk e lejojnë gjyqtarin që të bëjë procedimin dhe zgjidhjen e lëndëve në mënyrë

selektive, por kërkojnë përkushtim maksimal të gjyqtarëve që të njëjtat ti trajtojnë sipas prioritetit të përcaktuar në ligj, si dhe radhës së regjistrimit të tyre në gjykatë. Kohëve të fundit janë ngritur shqetësime nga qytetarët, mediat, por edhe nga Organizatat Joqeveritare, si dhe organizatat ndërkombëtare të cilat e monitorojnë punën e Sistemit të Drejtësisë në Kosovë, përmes publikimit të raporteve të monitorimit, se në gjykatat e Republikës së Kosovës janë vërejtur qasje selektive të gjyqtarëve në kryerjen e lëndëve gjyqësore. Në lidhje me këtë, është vlerësuar se një qasje e tillë selektive në trajtimin e lëndëve gjyqësore, drejtpërdrejtë ka ndikuar dhe vazhdon të ndikojë në uljen e nivelit të besueshmërisë dhe pritshmërisë së publikut në pushtetin gjyqësor. Publikimi i tyre ka nxitur Komitetin Këshillëdhënës për Etikë Gjyqësore (KKEGJ), që me seriozitet dhe urgjencë ta trajtojë këtë çështje në kuadër të mandatit të tij këshillëdhënës, në mënyrë që përmes nxjerrjes së një opinioni këshillëdhënës, ti vë në dijeni gjyqtarët për detyrimet e tyre kushtetuese, ligjore dhe etike, lidhur me trajtimin e barabartë të palëve dhe vendosjen e lëndëve gjyqësore sipas prioritetit të përcaktuar me ligj dhe kohës së arritjes së tyre në gjykatë.

II. Vlerësime të përgjithshme

Një gjyqësor efektiv dhe i pavarur, kërkon standarde dhe integritet të lartë të gjyqtarëve, me qëllim realizimin e misionit të tyre, e që ka të bëjë me dhënien e drejtësisë. Në funksion të kësaj, respektimi i rregullave të sjelljes nga ana e gjyqtarëve gjatë kohës sa e ushtrojnë këtë funksion, ndikon drejtpërsëdrejti në garantimin e shtetit të së drejtës.

Mirëbesimi në publik dhe respekti për gjyqësorin janë garancion të efektivitetit të sistemit gjyqësor, ndërsa sjellja e gjyqtarëve në aktivitetet e tyre profesionale, konsiderohet nga anëtarët e publikut si thelbësore për kredibilitetin e gjykatës. Në këtë vështrim, për gjyqtarët është e rëndësishme të kuptojnë jo vetëm kufijtë që ligji ka përcaktuar në ushtrimin e funksionit të tyre, por edhe standardet e sjelljes që ata janë të detyruar të respektojnë. Në lidhje me këtë, roli i gjyqtarëve është që ti shërbejnë qytetarëve, përmes zgjidhjes së çështjeve gjyqësore në përputhje me ligjin, duke garantuar trajtim të barabartë për të gjitha palët¹⁹².

Prestigji i sistemit gjyqësor është thelbësor në një sistem demokratik, në një shtet të së drejtës, ku gjyqësori ushtron pushtetin e tij si i pavarur. Sjellja e gjyqtarëve vlerësohet se është e lidhur ngushtë me rritjen e besimit në integritetin e gjyqësorit në tërësi. Kjo arritje do të cenohej në rastin kur gjyqtari me vetëdije apo edhe pa vetëdije, lejon ngritjen e paragjykimeve mbi mënyrën se si ai e ushtron funksionin e tij. Gjyqtari me sjelljen e tij ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen e besimit të publikut në tek sistemi i drejtësisë. Andaj, gjyqtari nuk duhet të lejojë në asnjë rast që ngarkesa në punë apo afati kohor, të ndikojë në dhënien e drejtësisë, duke cenuar barazinë e palëve në procedurë gjyqësore¹⁹³.

Gjyqtarët në çdo sistem ligjor edhe në sistemin tonë gjyqësor kanë rolë kyq dhe të pazëvendësueshëm në sigurimin e standardëve kohore të barabarta gjatë trajtimit të çështjeve

¹⁹² Komentari i “Parimeve të Bangalores për sjellje në gjyqësor”.

¹⁹³ Po aty, Komentari i “Parimeve të Bangalores për sjellje në gjyqësor”.

të tyre në procedura gjyqësore. Roli i gjyqtarëve është që ti shërbejnë qytetarëve përmes zgjidhjes së çështjeve të tyre gjyqësore në përputhje me ligjin dhe respektimit të standardeve të njëjta kohore për lëndët gjyqësore të fushës së njëjtë juridikionale. Gjyqtarët me punën e tyre efikase dhe transparente e sigurojnë rritjen e besimit të publikut në sistemin gjyqësor, dhe e kundërta nëse nuk ka punë efikase dhe transparente dobësohet besimi i publikut në drejtësi. Ndërsa besimi i publikut është çështje kruciale, për të arritur një sistem llogaridhënës, transparent dhe efikas gjyqësor.

Standardet ndërkombëtare, në trajtimin e barabartë të palëve në procedurë gjyqësore

Parimet e sjelljes gjyqësore të miratuara në Bangalore të Indisë në vitin 2002¹⁹⁴, janë instrumenti ndërkombëtar më i plotë, i cili ka shërbyer si referencë për çështjen e trajtuar, qoftë në nivelin kombëtar, qoftë edhe në atë ndërkombëtar. Këto parime janë përcaktuar si vlera thelbësore që duhet të udhëheqin çdo gjyqtar gjatë ushtrimit të funksionit të tij. Të njëjtat parime (*pavarësia, paanësia, integriteti, sjellja korrekte e gjyqtarit, barazia, si dhe kompetenca, profesionalizmi dhe korrektësia*), janë inkorporuar si vlera themelore edhe në Kodin e Etikës dhe sjelljes profesionale të gjyqtarëve, i miratuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës. Në lidhje me çështjen etike të parashtruar, Parimet e Bangalore, përcaktojnë se: *“Garantimi i barazisë para gjykatave është një parim themelor për kryerjen në mënyrën e duhur të funksioneve gjyqësore. Gjyqtari duhet të sigurojë/garantojë trajtimin e barabartë dhe të njëjtë të të gjithë individëve, duke shmangur çdo lloj diskriminimi”*.

Gjatë përgatitjes së opinionit, KKEGJ ka shqyrtuar dhe ka marr për bazë edhe disa dokumente tjera ndërkombëtare, të cilat ndërlidhen me çështjen etike të parashtruar, e posaçërisht: “Parimet themelore të pavarësisë së gjyqësorit” të Kombeve të Bashkuara (1985)¹⁹⁵, Rekomandimin Nr. R (94) 12 të Komisionit të Ministrave të Këshillit të Evropës më pavarësinë, efikasitetin dhe rolin e gjyqtarëve; Aktin Evropian mbi Statutin e Gjyqtarëve (1998) (DAJ/DOC(98)23); Kodin e mirësjelljes gjyqësore, drafti Bangalore, Opinionin nr. 3 i Këshillit Këshilldhënës të Gjyqtarëve Evropian, KKGjE (2002) Op. Nr 3, datë 19 Nëntor 2002, etj. Të gjitha këto dokumente ndërkombëtare në përmbajtjen e tyre i kushtojnë rendësi të veçantë përgjegjësisë së gjyqtarit në trajtimin e barabartë të palëve në procedurë gjyqësore, e që ndërlidhet edhe me obligimin e tyre për trajtimin e lëndëve sipas prioritetit dhe kohës së arritjes në gjykatë.

Në këtë drejtim, edhe Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KEDNJ), e zbatuar drejtpërdrejtë në Kosovë përmes nenit 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në nenin 6, përcakton se *“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme”*.

Nisur nga rëndësia e jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) dhe standardeve të kësaj gjykate në rendin juridik të Kosovës, në kuptim të çështjes së trajtuar,

¹⁹⁴ Bangalore Principles of Judicial Conduct (2002).

¹⁹⁵ I rishikuar në nëntor 2002 për t'u shndërruar në Parimet e Bangalore të Mirësjelljes Gjyqësore.

është e rëndësishme të theksohen edhe disa vendime gjyqësore nga jurisprudenca e GjEDNj-it¹⁹⁶. Në këtë drejtim, neni 6 i KEDNj-it kërkon që proceset të zhvillohen brenda “një afati të arsyeshëm”. Në kërkesën që gjykimi i çështjeve të bëhet brenda “një afati të arsyeshëm”, GjEDNj në rastin “H kundër Francës” vë theksin tek rëndësia e administrimit të drejtësisë pa vonesa, ndërsa e kundërta e së cilës mund të kërcënoj efektshmërinë dhe besueshmërinë e saj¹⁹⁷. Si rrjedhojë e garantimit të së drejtës së qytetarëve për një proces gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm, GjEDNj në rastin *Stogmuller kundër Austrisë*, ndër të tjera ka përcaktuar se e drejta e gjyqësorit brenda afatit të arsyeshëm, garanton dhe mbron të gjitha palët në proces gjyqësor nga vonesat e gjata procedurale¹⁹⁸.

1. Rregullativa ligjore vendore, në trajtimin e barabartë të palëve në procedurë gjyqësore

KKEGJ konstaton se në Republikën e Kosovës, është miratuar rregullativë ligjore adekuate, e cila normon detyrimin e gjykatave, përkatësisht gjyqtarëve që të gjitha palët gjyqësore ti trajtojnë në mënyrë të barabartë dhe pa kurrfarë diskriminimi. Një detyrim i tillë për gjyqtarët në kuadër të parimit të barazisë së palëve, ekziston edhe në trajtimin e lëndëve me prioritet ligjor, por edhe zgjidhjes së tyre në bazë të radhës së regjistrimit të tyre në gjykatë, e jo në mënyrë selektive.

Në funksion të kësaj, Kushtetuta e Republikës së Kosovës (*neni 21.paragrafi 2 dhe 3, neni 22 dhe neni 24 paragrafi 1*), ligjet përkatëse në fushat të ndryshme (*penale, civile, administrative, ekonomike etj*), Ligji për Përgjegjësinë Disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe Kodi i Etikës Profesionale për gjyqtarë, parashohin dispozita me të cilat rregullohen përgjegjësitë dhe detyrat të cilat i kanë autoritete publike, e ndër ta edhe gjyqtarët në ushtrimin e funksionit gjyqësor, përfshirë këtu trajtimin kohor dhe të barabartë të palëve në procedurë gjyqësore.

Edhe Ligji për Gjykatat (Ligji Nr.06/L-054), në dispozitën e nenit 7 parag. 1, ndër të tjera obligon gjykatat dhe gjyqtarët që “*të trajtojnë të gjithë personat në mënyrë të barabartë, ndërsa askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare apo shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, gjendjes sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal*”. Ndërsa parag.2 i këtij nenin përcakton se: “*Çdo person ka qasje të barabartë në gjykata dhe askujt nuk i mohohet e drejta në gjykim të drejtë në përputhje me procedurën e rregullt ligjore ose të drejtë në mbrojtje të barabartë me ligj. Çdo person fizik apo juridik ka të drejtë në gjykim të drejtë dhe brenda afatit të arsyeshëm kohor*”. Ky përkufizim kaq shprehimor dhe i drejtpërdrejtë i këtyre dispozitave të këtij ligji, i cili edhe garanton zbatimin e parimit të barazisë së palëve, nuk lenë hapësirë për gjyqtarët që

¹⁹⁶ E zbatuar në Kosovë, përmes nenit 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se “*Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*”.

¹⁹⁷ H kundër Francës, 24 Tetor 1989, para.58.

¹⁹⁸ Stögmüller kundër Austrisë, 10 Nëntor 1969, para. 5.

të zbatojnë praktikën e trajtimit të pabarabartë të palëve në procedurë gjyqësore, përfshirë këtu edhe trajtimin e çështjeve të tyre në aspektin kohor.

Kodi i Etikës Profesionale të gjyqtarëve, i hartuar në përputhje me standardet ndërkombëtare të cekura më lartë, kërkon nga gjyqtarët që përveç respektimit dhe zbatimit të parimeve të tjera siç janë pavarësia, paanësia, integriteti etj, të zbatojnë me rigorizitet edhe parimin e barazisë së palëve në procedurë gjyqësore. Në lidhje me këtë, neni 3.2 i Kodit të Etikës Gjyqësore në Kosovë kërkon që gjyqtari të sigurojë trajtim të barabartë të palëve në procedurë, pa asnjë lloj diskriminimi. Ndërsa neni 5.2 i këtij Kodi, përcakton se gjyqtarët kanë përgjegjësi për të organizuar punën e gjykatës në mënyrë efektive e efikase. Përgjegjësia e gjyqtarit për të shqyrtuar lëndë ka prioritet ndaj të gjitha aktiviteteve të tjera të gjyqtarit¹⁹⁹. Kjo ndër të tjera nënkupton edhe sigurimin e parimit të pritjes së njëjtë kohore të palëve gjatë dhënies së drejtësisë së kërkuar.

III. Faktet e çështjes etike të parashtruar

KKEGJ vlerëson se sistemi gjyqësor i Kosovës me vite të tëra është duke u përballur me probleme dhe vështirësi të shumta, të cilat kanë ndikuar dhe ende po ndikojnë që të mos kemi një sistem efikas gjyqësor. Ndërsa një ndër problemet e sistemit gjyqësor është mungesa e numrit të mjaftueshëm të gjyqtarëve në detyrë, por edhe e resurseve të tjera (*mungesa e stafit profesional dhe administrativ, por edhe e resurseve financiare*). Kjo ka ndikuar që të rritet vazhdimisht ngarkesa e gjyqtarit me numër të papërballueshëm të lëndëve. Si rezultat i kësaj, pa qëllim apo për shkak të neglizhencës, në masë të madhe janë cenuar edhe të drejtat e palëve në procedurë, të cilët me të drejtë presin dhe kërkojnë drejtësi nga Gjykatat e Kosovës, që lëndët e tyre të zgjidhen brenda një afati të arsyeshëm kohor. Pra është evidente se palët presin me vite të tëra për drejtësinë të cilët ata e kërkojnë nga Gjykatat e Kosovës.

KKEGJ është i ndërgjegjshëm dhe pranon faktin që shumica e gjyqtarëve në sistemin gjyqësor për veç ngarkesës të madhe me lëndë, ata ballafaqohen edhe me pengesa dhe vështirësi të shumta të natyrës materiale, procedurale dhe kadrovike, që edhe më tepër e ngarkojnë situatën edhe ashtu të rëndë. Mirëpo, këto probleme që me vite të tëra ekzistojnë e që në mënyrë të ngadalshme po zgjidhen, nuk mund të jenë arsye dhe as shkas që gjyqtarët të mos i kryejnë përgjegjësitë e tyre kushtetuese dhe ligjore në mënyrë efikase, në rrafshin e sigurimit të trajtimit të barabartë të palëve në kuptimin kohor të dhënies së drejtësisë. Të gjitha palët që parashtrojnë kërkesa për realizimin e të drejtave të tyre subjektive të garantuara me kushtetutë dhe ligj në gjykatat e Kosovës, në bazë të legjislacionit në fuqi janë të barabartë, për çka edhe gjyqtarët në punën e tyre kanë detyrim kushtetues, ligjor dhe etik që të veprojnë në atë mënyrë që të njëjtit (palët) të ndihen se po trajtohen në mënyrë të barabartë nga gjykatat dhe gjyqtarët e Republikës së Kosovës, e jo në mënyrë selektive.

¹⁹⁹ Neni 5.1 I Kodit të Etikës Profesionale të gjyqtarëve.

Respektimin në plotni të këtij parimi, KKEGJ e vlerëson si shumë të rëndësishme, pasi që kjo ndikon drejtpërdrejtë në rritjen e besimit të publikut në pushtetin gjyqësor, i cili besim jo vetëm që i duhet sistemit gjyqësor, por është imperative për tu arritur nga gjyqësori i Kosovës.

KKEGJ vlerëson se në bazë të dhënave statistikore të cilat i përpunon për çdo vit SKGJK për Gjykatat e Republikës së Kosovës, rezulton se ka ende një numër shumë të madh të lëndëve të pa zgjidhura, e që i përkasin të gjitha lëmive, e që palët presin me vite të tëra për vendosjen e tyre. Lidhur me këtë, KGJK-ja siç dihet para disa viteve e kishte miratuar Strategjinë për zgjidhjen e lëndëve të vjetra. Lëndë e vjetër në kuptimin e këtij dokumenti të aprovuar të KGJK-së konsiderohej lënda e regjistruar dhe e cila nuk ishte zgjidhur, brenda dy viteve nga koha e arritjes në gjykatë.

KKEGJ bazuar në të dhënat statistikore të KGJK-së²⁰⁰, por edhe në të gjeturat e raporteve për monitorim të punës së gjykatave nga organizatat jo qeveritare vendore²⁰¹ dhe atyre të organizatave ndërkombëtare, i ka rezultuar se në shumicën e Gjykatave, si dhe pothuajse në të gjitha nivelet, është evidentuar një praktikë e dëmshme dhe jo në përputhje me rregullativen ligjore dhe Kodin e Etikës. Një praktikë e tillë, ka të bëjë me kryerjen e lëndëve gjyqësore në mënyrë selektive, duke cenuar parimin e barazisë së palëve në procedurë gjyqësore. Në këtë mënyrë, kryerja e lëndëve të reja para atyre të vjetra (*përrjashto këtu lëndët të cilat kanë prioritet sipas ligjit*), dhe mos trajtimi i barabartë i lëndëve sipas kohës së arritjes së tyre në gjykatë, ka ndikuar drejtpërsëdrejti edhe në perceptimin negativ të publikut në besueshmërinë në Gjykatat e Kosovës.

Kjo praktikë që nuk ka mbështetje ligjore, sigurisht që nuk i shërben interesave dhe objektivave që i ka sistemi gjyqësor, për të ndërtuar një sistem të pavarur, të besueshëm, llogaridhënës dhe transparent, i cili duhet ti shërbejë forcimit të sundimit të ligjit në Kosovë dhe ndërtimit të shtetit të së drejtës. Madje mund të thuhet se kjo praktikë ndikon drejtpërdrejtë në shkeljen e parimit të trajtimit të barabartë të palëve në kuptimin kohor të dhënies së drejtësisë së kërkuar. Praktika të tilla të cilat vlerësohen të dëmshme dhe cenojnë parimin e barazisë së palëve në procedurë gjyqësore, duhet medoemos që të ndalohen në të ardhmen²⁰².

KKEGJ e njehë faktin që disa lëndë të vjetra edhe mund të mos mund të trajtohen me kohë për shkak të problemeve procedurale që mund të dalin në procedurë, mungesës së sigurimit të palës, problemeve me adresa apo problemeve tjera të shumta procedurale, mirëpo jo të gjitha lëndët kanë probleme të tilla, ndërsa ato nuk merren në shqyrtim për vite të tëra, apo merren në mënyrë selektive. Tutje KKEGJ është i vetëdijshëm që në bazë të ligjeve përkatëse në fusha të ndryshme juridikcionale, është paraparë përparësia ligjore e trajtimit të disa lëndëve me natyrë urgjente (*masat e përkohshme, dhuna në familje, kontestet nga marrëdhëniet e punës,*

²⁰⁰ Në bazë të dhënave statistikore të SKGJK, aktualisht në gjykatat e Kosovës janë të pa trajtuara rreth 39732 lëndë të fushës penale, prej të cilave 16816 janë më të vjetra se dy vite, si dhe 85087 lëndë të fushës civile prej të cilave 28651 janë më të vjetra se dy vite.

²⁰¹ Raport i monitorimit, “Drejtësia Civile për vitin 2019”, i publikuar nga Instituti i Kosovës për Drejtësi, Nëntor 2020.

²⁰² Nga të gjeturat për hartimin e këtij opinioni, janë evidentuar një numër i madh i rasteve, kur palët presin me vite të tëra (5 e më shumë vite) për zgjidhjen e lëndëve të tyre nga gjykata, por edhe shumë raste të tjera kur palët brenda një kohe të shkurtër (brenda 1 viti ose edhe më pak) e marrin vendimin gjyqësor për çështjen e tyre nga gjykata.

pengim posedimi etj), mirëpo këto raste nuk e përbëjnë tërësinë e problemit të lëndëve të vjetra të pazgjidhura.

KKEGJ vlerëson se është një numër i madh i lëndëve që kanë statusin e lëndës së vjetër në shumë fusha, para se gjithash lëndë pronësore, të cilat me vite të tëra në sistemin gjyqësor për shkaqe të ndryshme kanë mbetur pa u kryer. E në ndërkohë statistikisht tregojnë se në shumë gjykata të Kosovës vazhdojnë të zgjidhen lëndë më të reja, për kahe viti i regjistrimit të tyre në gjykatë. Kjo edhe është thelbi i çështjes që KKEGJ dëshiron të trajtoj përmes këtij Opinioni këshillëdhënës.

IV. Gjetjet dhe rekomandimet

KKEGJ vlerëson se Ligji për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, Nr.06/L-057, në nenin 5.2, nën-pika 2.2 ka përcaktuar si shkelje të detyrave të gjyqtarit, nëse gjyqtari: *”nuk i trajton siç kërkohet me ligj palët në procedurë...“*. Sipas vlerësimit të KKEGJ kjo dispozitë ligjore i mbulon të gjitha shkeljet e mundshme që mund të kryhen nga gjyqtarët gjatë ushtrimit të detyrës së tyre, përfshirë këtu edhe shkeljet në kontekstin apo rafshin e trajtimit të barabartë të palëve në aspektin kohor, në procesin e dhënies së drejtësisë që ata e kanë kërkuar në gjykatën kompetente. Është mjaftueshëm e qartë se Ligjdhënësi me këtë dispozitë ligjore ka synuar që palëve tu ofrohet mbrojtje e duhur ligjore gjatë trajtimit të tyre në procedurë gjyqësore.

Në anën tjetër, Kodi i Etikës Profesionale për gjyqtarë i aprovuar nga KGJK-ja me datë 17 gusht 2016, në nenin 3 paragrafi 1 ka paraparë shprehimisht se *“Gjyqtari gjatë punës së tij respekton parimet e barazisë së palëve në procedurë duke njohur dhe respektuar diversitetin në shoqëri në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, përkatësisë fetare, përkatësisë nacionale, orientimit seksual, nevojave të veçanta, moshës, statusit martesor, shoqëror dhe ekonomik dhe çdo kriteri tjetër, si dhe i trajton në mënyrë të barabartë të gjithë ata me të cilët ka kontakte profesionale”*.

Ky përkufizim kuptimplotë i kësaj dispozite të Kodit të Etikës Profesionale për gjyqtar, në mënyrë shumë të qartë dhe të drejtëpërdrejtë e ka paraparë edhe përgjegjësinë etike të gjyqtarit, që të ofroj për aq sa është e mundur trajtim të barabartë për palët në procedurë gjyqësore. Kodi i Etikës, ngjashëm me ligjin e cekur më lartë, e ngarkon gjyqtarin me përgjegjësi etike, në lidhje me respektimin dhe zbatimin e parimit të barazisë së palëve, me theks të veçantë në trajtimin e lëndëve sipas kohës së arritjes në gjykatë, duke përjashtuar përzgjedhjen në mënyrë selektive të tyre.

Kjo barazi e palëve jo vetëm që duhet të jetë e plotë, pa bërë asnjë dallim në asnjë bazë (*edhe në aspektin kohor të trajtimit të lëndëve*), por duhet të jetë barazi efektive dhe e dukshme edhe për të tjerët, nga se në këtë mënyrë edhe forcohet besimi i publikut në pushtetin gjyqësor. Në këtë drejtim, përgjegjësia kryesore ligjore dhe etike për trajtim të barabartë të palëve në procedurë gjyqësore (*përfshirë edhe trajtimin e lëndëve sipas kohës së arritjes në gjykatë*), bie mbi gjyqtarin i cili zhvillon procedurën gjyqësore, për lëndët me të cilat është i ngarkuar.

Kjo përgjegjësi jashtë procedurës konkrete gjyqësore, në kuptim të menaxhimit, mbikëqyrjes, por edhe të llogaridhënies, bie edhe tek Kryetari i Gjykatës dhe gjyqtarët mbikëqyrës. Menaxhmenti i gjykatës mban përgjegjësi menaxheriale, në kuptim të ofrimit të kushteve të punës, shpërndarjen e barabartë të lëndëve tek gjyqtarët, por edhe shpërndarjen në mënyrë të barabartë të resurseve disponuese njerëzore të gjykatës (*stafin profesional dhe mbështetës*), për ti dhënë mbështetje profesionale dhe administrative gjyqtarit. Përveç kësaj, menaxhmenti i gjykatës, në përputhje me autoritetin dhe përgjegjësitë e tij të përcaktuara me Ligjin për Gjykatat, por edhe Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të gjyqtarëve (*si autoritet kompetent*), ka përgjegjësi që në vazhdimësi të monitorojë punën e gjyqtarëve, në lidhje me zbatimin e parimit për trajtim të barabartë të palëve në procedure gjyqësore, si dhe trajtimin të lëndëve sipas kohës së arritjes në gjykatë. Në anën tjetër, në të gjitha rastet kur evidentohet se gjyqtarët përkundër paralajmërimit dhe detyrimit të tyre ligjor e etik, vazhdojnë të trajtojnë në mënyrë të pabarabartë palët në procedura gjyqësore, si dhe vazhdojnë të gjykojnë lëndë në mënyrë selektive, atëherë kjo çështje duhet të trajtohet në pajtim me dispozitat e Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të gjyqtarëve dhe Kodit të Etikës Profesionale të gjyqtarëve.

Në këtë drejtim, përveç përgjegjësi të gjyqtarit dhe kryetarit të gjykatës, sigurisht se edhe KGJK konform detyrimeve të tyre kushtetuese dhe ligjore, duhet të marrin përgjegjësi në hartimin e politikave të veprimit efektiv të gjykatave, duke aprovuar akte nënligjore dhe plane strategjike, të cilat do të shkonin në funksion të plotësisht të kushteve për punë të gjykatave, përkatësisht gjyqtarëve (*sigurimit të kushteve të punës, sigurimit të resurseve adekuate njerëzore-bashkëpunëtor profesional dhe staf tjetër administrative etj*) dhe të ngarkesës së tyre të barabartë me lëndë, për aq sa është e mundur. Në lidhje me këtë, është e nevojshme që me qëllim të zbatimit të parimit të barazisë së palëve në gjykatë, si dhe trajtimin të lëndëve sipas kohës së arritjes në gjykatë, e jo në mënyrë selektive, KGJK të krijoj mekanizma adekuat të mbikëqyrjes dhe llogaridhënies. Ndërsa njëri ndër këta mekanizma i cili do të kishte ndikim pozitiv në zbatimin e këtij parimi, është edhe përfshirja e një kriteri të veçantë në rregulloren për vlerësimin e performances së gjyqtarëve, e që ka të bëjë me sigurimin e saktë të të dhënave për trajtimin e barabartë të palëve nga gjyqtari, si dhe trajtimin të lëndëve sipas kohës së arritjes së tyre në gjykatë. Në funksion të arritjes së respektimit dhe zbatimit të këtij parimi, KGJK do duhej të krijonte mekanizëm të veçantë të mbikëqyrjes dhe llogaridhënies për gjyqtarët dhe kryetarët e gjykatave, në mënyrë që në të gjitha rastet kur evidentohet se ka neglizhencë dhe zgjidhje të lëndëve në mënyrë selektive nga gjyqtarët, kjo të ketë impakt më pas në rastet kur të njëjtit aplikojnë për ngritje në detyrë.

V. Konkluzionet përfundimtare

Gjyqtarët në të gjitha instancat gjyqësore kanë përgjegjësi kushtetuese, ligjore dhe etike, lidhur me respektimin e parimit të barazisë së palëve në procedurë gjyqësore. Përveç kësaj, gjyqtari ka për detyrim që të gjitha palët në procedurë ti trajtojnë në mënyrë të barabartë dhe pa kurrfarë diskriminimi. Kjo do të thotë se gjyqtarët duhet ti trajtojnë lëndët sipas radhës dhe kronologjisë kohore të regjistrimit të tyre në gjykatë. Respektimi i këtij parimi, siguron në mënyrë efektive

trajtimin e barabartë të palëve në procedurë gjyqësore, përfshirë këtu edhe aspektin kohor të dhënies së drejtësisë së kërkuar.

Gjyqtarët duhet të mos tregojnë qasje selektive dhe trajtim të pabarabartë të palëve, duke trajtuar lëndë të reja para atyre të vjetra, përjashtimisht rasteve kur prioriteti është i caktuar me ligj apo vendim të KGJK-së. Gjyqtarët të cilët veprojnë në këtë mënyrë i shkelin rregullat e Kodit të Etikës Profesionale të gjyqtarëve, ndërsa për këtë duhet të mbahen përgjegjës nga KGJK.

Çdo shmangie me vetëdije apo pa të nga respektimi i këtij parimi, konsiderohet se paraqet shkelje të detyrave ligjore dhe etike të gjyqtarit, ndërsa kjo sjellje e gjyqtarit vlerësohet se është në kundërshtim me nenin 5.2 nën paragrafi 2.2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, Nr.06/L-057, si dhe me nenin 3 paragrafi 1 të Kodit të Etikës Profesionale për gjyqtarë.

Kryetari i Komitetit,

Muhamet Rexha
